BOTA SHPIRTËRORE *e Myslimanit*



Osman Nuri TOPBASH

PROGRESI BOTIME



Aliu رضي الله عنه thotë:

"Jepini jetë zemrës suaj me këshilla dhe ndriçojeni me urtësi."

"Qetësojini shpirtrat tuaj me fjalë dhe vepra të urta, sepse siç lodhet dhe dobësohet trupi, ashtu lodhet edhe shpirti."

"Paralajmëroji njerëzit me fjalë të mençura që nxitin mendimin, në mënyrë që zemrat e tyre të gjejnë paqe."

Shkodër, 2023

TITULLI ORIGJINAL
MÜSLÜMANIN
GÖNÜL DÜNYASI

PËRKTHEU
Ilir Hoxha

REDAKTOI
Albert Halili

FAQOSJA
Bledar Xama

PROGRESI BOTIME
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

BOTA
SHPIRTËRORE
e Myslimanit

Osman Nuri TOPBASH

PROGRESI
BOTIME

PËRMBAJTJA

PREZANTIM 7

PARAFJALA 9

TË LEXOSH ME SYRIN E ZEMRËS
misteret dhe urtësitë këtij universi 15

TË JESH ME ALLAHUN 43

KURANI FAMËLARTË 63

PROFETI ﷺ 83

NDJEKJA E TRADITËS PROFETIKE ME DASHURI 107

DHURIMI, pasruia e vërtetë 125

DISTANCIMI NGA SHPËRDORIMI,
KOPRRACIA dhe AMBICIA E TEPRUAR 151

TASAVUFI 175

PASTRIMI I EGOS,
PURIFIKIMI I ZEMRËS 195

KËRKIMI I FALJES 211

NAMAZI I NATËS 223

ADHURIMET 231

MODESTIA 263

RUAJTJA NGA MBURRJA
DHE MENDJEMADHËSIA 279

FALJA, TOLERANCA
DHE PËRMBAJTJA 291

FALËNDERIMI 311

DURIMI dhe KËNAQËSIA 323

DASHURIA DHE URREJTJA PËR HIR TË ALLAHUT 347

QËNDRIMI ME NJERËZIT E MIRË DHE TË DEVOTSHËM 361

RUAJTJA NGA HARAMET 385

ÇERDHJA E NGROHTË FAMILJARE 421

SHQETËSIMI PËR BREZAT 447

DITURIA E VËRTETË 465

PREDIKIMI DHE METODA 489

EDUKATA 515

NJERI I MËSHIRSHËM 533

SHËRBIMI 551

NDJESHMËRIA PËR PROBLEMET E UMETIT 587

TË PREFEROSH AHIRETIN PARA DYNJASË 611

UDHËTIMI I PËRJETËSISË 627

PREZANTIM

Të arrish të japësh frymën e fundit si mysliman, është çështja më e rëndësishme e një besimtari. Të vdesësh si mysliman, do të thotë të jesh në gjendje të japësh frymën e fundit me zemrën myslimane. Zemra myslimane është një zemër e formuar nga Islami. Ajo është një zemër e pastër dhe aq e tejdukshme sa mund të merret në dorë e të thuhet: "Shikoni njerëz, këtu nuk ka asgjë kundër jush!"

Kjo zemër është dhurata më e bukur për t'i çuar Allahut ﷻ, sepse ajo është "një pasqyrë e ndriçuar, e pastruar, e purifikuar dhe e hijshme, në të cilën manifestohen Emrat e Bukur të Allahut".

Të arrish pjekurin e një zemre që nuk lëndon, nuk lëndohet dhe nuk pret asgjë në këmbim të mirësive që bën, në këtë epokë të "injorancës bashkëkohore", është po aq e vështirë sa të mbash prush në dorë. Pjekuria e zemrës njihet nga gjendja që merr kur dëgjon Emrin dhe ajetet e Allahut. Dhe, për ta arritur atë gjendje, duhet ta mbash zemrën të pastër shpirtërisht. Të qëndrosh i pastër, do të thotë të jetosh në një klimë frike ndaj Allahut, sepse kjo frikë është mënyra për ta mbajtur zemrën në gjendjen e dëshiruar. Zemra pa frikë ndaj Zotit, bëhet e zymtë. Kurse zymtësia, është humbja e pjekurisë së zemrës, për më tepër, përshpejtimi në drejtim negativ drejt ngurtësimit.

Bota e zemrës së myslimanit njihet për përpjekjen për të udhëtuar prej gropës së errët e për t'u ngritur drejt qiellit të frikës me mëshirën e Kuranit. Ajo është një pjekuri e atillë, sa s'ka gjë më të rëndësishme se ruajtja e saj, sepse udhëtimi drejt ftesës hyjnore "kthehu te Zoti yt", mund të ndalet në çdo moment. Nëse nuk e dimë se kur do të arrijë kjo ftesë, duhet të shqetësohemi që të marrim sa më shpejt pjekurinë e duhur dhe ta ruajmë atë. Pjekuria, është çështje standardi, atmosfere dhe mjedisi. Është thelbësore t'i kushtohet vëmendje se çfarë, kush dhe si e përcakton rregullimin e një organi të njohur për të hyrë nga një gjendje në tjetrën si zemra. Ashtu siç kërkohen kushte të caktuara për të ruajtur një ushqim që duhet të shërbehet i ftohtë ose i nxehtë, ashtu ekziston edhe një gjendje që do ta bëjë zemrën të ndjejë lidhjen me Zotin ose një element që do ta bëjë të meritojë titullin "e pastër". Ky element kërkon një klimë në të cilën do të ruajë vitalitetin e tij. E, kjo klimë është rreth njerëzve besnikë dhe të drejtë. Për më tepër, çdo zemër ka nevojë për një vëmendje të veçantë me vetitë e veta ngrohëse, bashkimi dhe zbutjeje. Cili mjedis dhe cilët miq ndikojnë pozitivisht në strukturën e

zemrës? Cilat kushte ofrojnë konsistencën e dëshiruar? Çfarë lloj horizonti është zemra myslimane?

Këtyre pyetjeve synon t'u përgjigjet "Bota e zemrës së myslimanit", të cilën revista jonë ua ka bërë dhuratë lexuesve këtë vit.

Kjo vepër, e cila u përgatit me refleksionet që burojnë nga zemra e hoxhës sonë të nderuar Osman Nuri Topbash, duke përfituar nga kultura dhe të urtësia Islame, që mund ta quajmë si pronë e ummetit, përmban kriteret në lidhje me pjekurinë e dëshiruar të zemrës myslimane.

Këto kritereve përmbajnë kuptime në përmasat e një libri, si një arkiv dixhital, në të cilin po të klikohet hapen qindra nën-skedarë. Mjaftojnë disa shembuj të këtyre fjalive të çmuara për të vërtetuar këtë fakt:

"Të njohësh të Dërguarin e Allahut nga afër dhe të jesh në gjendje të lidhesh me respekt dhe dashuri me të, është edukimi më i rëndësishëm që duhet të shohim në shkollën e kësaj bote.

Njeriu i privuar nga ky edukim, pra një person që nuk e njeh të Dërguarin e Allahut, është ende injorant -edhe nëse ka lexuar mijëra libra dhe ka ruajtur informacione të panumërta në mendjen e tij-.

"Sufizmi konsiston në përpjekjen për të jetuar Sheriatin me një zemër të pastër, të purifikuar dhe të kulluar."

"Misticizëm, nuk do të thotë të shfaqësh "bukurinë fizike" i veshur me pozita të caktuara në kërkim të interesave të kësaj bote. Përkundrazi, do të thotë të largohesh nga dëshirat e ulëta të egos, të largosh prirjen e kësaj bote nga zemra, t'i nënshtrohesh Allahut të Plotfuqishëm me një ndjenjë përulësie dhe ta shohësh veten si një " rob të pafuqishëm"."

"Trëndafili e arrin përsosmërinë dhe bukurinë falë miqësisë dhe mirëkuptimit me gjembin. Domethënë, duke duruar gjembat, ai fiton një formë të bukur dhe një aromë delikate. Kështu edhe njeriu; pastrohet dhe arrin një nivel shpirtëror në atë masën që i duron edhe sprovat e mundimet."

Urojmë që libri ynë dhuratë i titulluar "Bota e Zemrës së Myslimanit", i përgatitur me përpikërinë e Shtëpisë Botuese Erkam, të na sigurojë të gjithëve, veçanërisht juve, lexuesve tanë të nderuar, ushqimin shpirtëror në rrugën për të arritur zemrën e pastër.

I shprehim mirënjohjen tonë Hoxhës së nderuar që ndau me ne këto vepra të vlefshme dhe lutemi që jeta e tij të jetë e gjatë dhe shërbimi i tij të jetë i frytshëm.

PARAFJALA

Falënderimet e pafundme takojnë Allahut, i Cili na krijoi nga asgjëja si njerëz, na bëri krijesat më të nderuara mes të gjitha krijesave, na nderoi duke na bërë besimtarë dhe umetin e Muhamedit ﷺ.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë ﷺ, i cili është profeti i fundit dhe një personalitet shembullor i pakrahasueshëm për mbarë njerëzimin, si dhe mbi familjen e tij të pastër dhe shokët e tij të nderuar.

Meqenëse universi është një Kuran i heshtur dhe Kurani është një univers me fjalë, një besimtar është gjithashtu një pikë referimi dhe manifestim i urtësisë, i vendosur në udhëkryqin e të dyjave. Njeriu, i cili u krijua si shembull i delikatesave të paarritshme dhe thellësive të padukshme, mund ta ruajë vlerën e tij të lartë vetëm duke jetuar në drejtimin e Kuranit dhe Sunetit.

Një nga bekimet më të rëndësishme të Islamit është zhvillimi i zemrës së njeriut. Për këtë arsye, robi duhet të thellohet në meditimin e ajeteve Kuranore dhe të vargjeve universale të Librit të Gjithësisë. Kjo, sepse, Allahu i Madhëruar i fton robërit e Tij në dashurinë, afërsinë dhe miqësinë e Tij me këto veçori shpirtërore.

Ja pra, robërit e drejtë dhe të mençur që ishin në gjendje t'i përgjigjen kësaj ftese, e kuptuan se:

– Qiejt e stolisur me tufa llambadarësh me yje,

–Toka e stolisur me zbukurime të ndryshme,

– Ky univers i mrekullueshëm, i cili është zbukuruar me qëndisje të panumërta hyjnore dhe i është dhuruar njeriut si një reflektim

i përsosmërisë, nuk është aspak një krijim i kotë dhe i rastësishëm. Përkundrazi, në gjuhën e vet të posaçme, ai u flet njerëzve që kuptojnë dhe u thotë se në çdo grimcë të tij ka shumë sekrete dhe urtësi.

Në fakt, ky univers, përtej perceptimit dhe kënaqësisë njerëzore, i pajisur me kujdesin e dhomës së nuses - me bimët, kafshët, njerëzit dhe gjërat e ngurta - deri në qelizat dhe grimcat e tij më të vogla, deri tek elementët e tij misterioz si elektronet, neutronet, protonet dhe kuarke ende të pazbuluara në atom, është si një vitrinë e manifestimeve të fuqisë dhe madhështisë hyjnore.

Vepra është dëshmia e Artistit. Zemrat që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë, në këtë univers nuk shohin asgjë tjetër përveç shfaqjeve të fuqisë dhe madhështisë hyjnore. Ata e njohin gjuhën e veçantë të trëndafilave, zymbyleve dhe bilbilave, që janë vargjet e krijimit në këtë botë. Ata shikojnë shfaqjet e emrave "el-Bari" dhe "el-Musavvir" të Allahut të Plotfuqishëm në çdo qenie dhe dëgjojnë deklaratat e heshtura të erërave, lumenjve dhe maleve. Ata besimtarë shikojnë vullnetin hyjnor në sfondin e të gjitha ngjarjeve të hidhura e të ëmbla që hasin dhe lexojnë me syrin e zemrës së tyre mesazhet hyjnore.

Robërit e ditur që kanë arritur këtë horizont të zemrës kanë përjetuar shfaqje të ndryshme të miqësisë me Allahun. Zoti ynë i bëri disa prej tyre Shah-i Nakshibend dhe i bëri një det unik hiri në njohje dhe dije; disa prej tyre enden në shkretëtirat e dashurisë si Mexhnuni; disa prej tyre enden në luginat e mrekullisë, disa prej tyre ishin memec përballë madhështisë hyjnore; disa prej tyre i bëri një bilbil dashurie, si Junus Emre; e disa prej tyre, si Hazret Mevlana, i cili u bë një det kuptimi që shpërndau perlat e urtësisë prej tij.

Besimtarët që përparojnë shumë në njohjen e Allahut, për shkak se gëzojnë shfaqjet e jashtëzakonshme të pasionit dhe dashurisë hyjnore, ata çdo gjë e shohin me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Ata shohin urtësinë në çdo qenie dhe ngjarje.

Për këtë arsye, tek ata nuk gjendet shkujdesja e njerëzve të zakonshëm që i shohin mrekullitë e universit si të rëndomta. Në të vërtetë, ndërkohë që një person i zakonshëm i sodit me admirim të madh pikturat e krijuara nga një artist që ka imituar natyrën, ai nuk ka të njëjtën ndjenjë vlerësimi përpara universit dhe Krijuesit të tij. Ai i konsideron të gjitha mrekullitë si "ef'al-i adije" (vepra të zakonshme). Miqtë e Allahut, nga ana tjetër, jetojnë me një zemër të mahnitur dhe të emocionuar nga Artisti i vërtetë dhe veprat e Tij.

Ata shijojnë mrekullitë e pafundme të krijuara në natyrë nga Fuqia Hyjnore:

– Gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve, lënda e të cilave është e njëjta tokë, cilësitë e tyre, pemët që shfaqin ndryshime të pafundme në ngjyrë, erë, shije, formë dhe fruta,

– Dekoret e mrekullueshme të në krahët e fluturave, të cilat kanë një jetëgjatësi prej vetëm një ose dy javësh,

– Ata shikojnë mrekullinë e krijimit njerëzor dhe i kushtojnë vëmendje mrekullive të pafundme hyjnore si shikimi i syrit e perceptimi i trurit, dhe e kuptojnë gjuhën e tyre misterioze.

Për robër të tillë, i gjithë universi është si një libër që pret të lexohet.

Allahu i Plotfuqishëm dëshiron që një besimtar të kuptojë madhështinë hyjnore, misterin dhe urtësinë e këtij rendi madhështor, në natyrën e tij të vërtetë.

Mënyra për ta bërë këtë është të pranojmë me gjithë zemër urdhrat dhe ndalesat e Zotit të Madhëruar dhe të përpiqemi për ta jetuar Islamin në horizontin e dashurisë, ekstazës dhe aspiratës.

Feja jonë madhështore, Islami, rregullon të gjithë përmbajtjen e jetës. Ai gërsheton çdo moment të jetës njerëzore me parime hyjnore.

Një besimtar mund të shfaqë një personalitet shembullor Islam për aq sa ai i zbaton kriteret e besimit, adhurimit, moralit, trajtimit, sjelljes dhe mëshirës ndaj së drejtës dhe ligjit që predikon kjo fe.

Prandaj, besimtari e gjen përsosmërinë deri në atë masë sa mund të kuptojë dimensionet jetëdhënëse të Islamit në unitetin e së jashtmes dhe të brendshmes, harmoninë e zemrës dhe trupit, shpirtit dhe formës. Që të ndodhë ky evolucion, është e nevojshme që një besimtar të gatuajë botën e mendjes dhe të zemrës me kriteret e Kuranit dhe Sunetit, të thellohet në meditimin e urtësisë dhe të vërtetës hyjnore dhe të përpiqet të jetojë në një vijë të drejtë deri në frymën e fundit. Nga ana tjetër, është thelbësore që të shmangen me përpikëri të gjitha gjërat negative që e mbajnë robin larg Zotit të tij.

Sepse, siç ka thënë Imam Shafiu:

"Nëse nuk merreni me të vërtetën, do t'ju pushtojë e kota."

Po ashtu, siç thotë Mevlana:

"Nëse meditimi juaj janë trëndafilat, ju jeni në një kopsht me trëndafila. Nëse meditimi juaj është një gjemb, (nëse jeni të mposhtur nga dëshirat shpirtërore të mendjes-idesë suaj), ju jeni një trung që do të digjet në zjarr."

Kjo do të thotë se; meditimi i çështjeve sublime që kanë lidhje me Mëshiruesin, u fal zemrave butësi, rrit frikën në adhurim, e çliron robin nga robëria e pasioneve egoiste dhe e bën zemrën të njohur me sekretet dhe urtësitë. Ndryshe nga kjo, meditimi i çështjeve të ulëta dhe djallëzore e shpie njeriun në shkujdesje dhe e bën atë skllav të egos të tij.

Sot, për fat të keq, ekziston një epokë moderne e injorancës, në të cilën gënjeshtra, ligësia dhe materializmi po godasin zemrat dhe mendjet nga të gjitha anët, duke i larguar njerëzit nga qëllimi i tyre i ekzistencës, duke prishur orientimin e tyre dhe duke i bërë ata të har-

rojnë botën tjetër. Njerëzimi po tërhiqet zvarrë në katastrofa materiale dhe morale nga ndikimet negative të televizionit, internetit, mediave botuese dhe sistemeve arsimore laike që pasqyrojnë botëkuptime materialiste, kapitaliste dhe liberale.

Të këqijat e kohës, që i dehin zemrat me shkujdesje, njerëzit që nuk kanë përfituar siç duhet nga e drejta dhe e vërteta, i marrin para si trungje në një përmbytje. As ai që bie nuk e kupton se ka rënë dhe as ai që shkatërrohet, nuk e kupton se është shkatërruar. Haramet, të urryerat, prirjet kundër natyrës dhe të gjitha llojet e poshtërsive që bëhen shkak i mundimeve të dhimbshme në ahiret, janë të këndshme për egon, si një melodi e ëmbël.

Për këtë arsye, si besimtarë, duhet të mbrojmë veten dhe brezin tonë nga këto gërryerje morale, rrëshqitje shpirtërore dhe vorbulla të së keqes. Për këtë arsye, sot të kapemi edhe më fort pas vlerave tona të larta që na bëjnë ata që jemi.

Pa dyshim se nga këto vlera, më kryesoret janë dy amanetet e mëdha të të Dërguarit të Allahut, Kurani dhe Suneti.

Më pas, vijnë sahabët, dijetarët, të devotshmit dhe njerëzit të mençur, të cilët janë interpretime të gjalla të Kuranit dhe Sunetit me jetën e tyre shembullore.

Ajo që po përpiqemi të bëjmë me këtë vepër, është; të shërbejmë si një makinë shkrimi për mesazhin dhe udhëzimin e profetëve, sahabëve dhe miqve të Zotit, plot ndriçim dhe frymëzim shpirtëror.

Të gjitha mirësitë në këtë vepër, i përkasin asaj sfere shpirtërore, prej së cilës kemi përfituar. Kurse gabimet dhe të metat janë nga nefsi ynë.

Siç urdhërohet në hadith: *"Besimtari është si bleta..."*[1].

1. Ahmed, II , 199; Hakim, I, 147; Bejhaki, Shuab, V, 58; Sujuti, el-xhami, nr: 8147.

Bleta nuk endet në plehra, por në kopshte lulesh. Bleta mbledh nektarin e luleve të panumërta për të mbushur hojet e saja, bart polenin, e më pas i kthen në një mjaltë shërues dhe të shijshëm.

Kështu edhe ne, zgjodhëm thënie nga mesazhet tona të përditshme që i publikojmë në internet, nga artikujt dhe librat tanë të botuar deri më sot dhe kemi përgatitur librin e quajtur "Perlat e të Vërtetave Ekzistenciale". Pas disa vitesh, si vazhdim i atij libri, ne përgatitëm këtë përmbledhje të mesazheve të shkurtra.

Në këtë libër, ne jemi përpjekur t'ju paraqesim juve, lexuesve tanë të nderuar fjalët tona të përulura, duke i zbukuruar ato me buqeta urtësie që kemi mbledhur nga zemrat e dijetarëve dhe të urtëve.

Me këtë rast, dëshirojmë të falënderojmë Mehmet Akif Günay dhe Ibrahim Hakkı Uzun, të cilët kontribuuan në përgatitjen e kësaj vepre dhe i lutemi Zotit tonë të Madhërishëm që ky shërbim të jetë një bamirësi për ta.

Zoti ynë, i drejtoftë gjithmonë zemrat tona drejt së vërtetës, mirësisë, urtësisë dhe së vërtetës. Allahu i bekoftë gjithmonë ndjenjat dhe idetë, gjendjen dhe sjelljen tonë me pëlqimin e Tij. Allahu na ruajt ne dhe brezat tanë nga neglizhenca e kërkimit të lumturisë në pazaret e mjerimit. Allahu, me mirësinë e Tij, na bashkoftë ne, robërit e Vetë të pafuqishëm, në grupin e robërve të Tij të lumtur, të cilëve u ka falur mëshirë, falje, pëlqim dhe dashuri të përjetshme.

Amin!..

Osman Nuri TOPBASH

Uskudar 1442 / 2021



TË LEXOSH
ME SYRIN E ZEMRËS
MISTERET DHE URTËSITË
KËTIJ UNIVERSI

Shfaqjet e fuqisë hyjnore në gjithësi, janë si poezi hyjnore të heshtura e pafjalë. Këto poezi hyjnore, thellohen në varësi të ndjenjave në zemra.

Të endesh në këtë botë sprovash i hutuar dhe i dëshpëruar; të mos kuptosh asgjë nga gjuha e gjendjes së trëndafilave, zymbyleve, bilbilave, erërave, përrenjve dhe maleve, nuk është gjë tjetër veç se shprehje e një zemre të errësuar

Kjo botë është një shkollë që shërben për të njohur Allahun. Nxënësit e kësaj shkolle janë të gjithë njerëzit, ndërsa mësuesit, janë profetët. Profetët i kanë mësuar njerëzve Librin, urtësinë dhe edukatën.

Kjo shkollë ka dy lloj librash:

1. Libri me fjalë, i cili është Kurani.

2. Libri me vepra, i cili është universi.



Kurani dhe universi janë dy zbulesa hyjnore të ndryshme që shpjegojnë njëri-tjetrin. Allahu, fenomenet dhe dukuritë që ka shpalosur në univers i shpjegon përmes Kuranit, ndërsa ajetet kuranore i shpjegon përmes universit.

Allahu, siç na qorton dhe udhëzon përmes fjalëve kuranore, herë pas herë të njëjtën gjë e bën edhe përmes dukurive natyrore.

Prandaj, shkujdesja dhe shpërfillja ndaj mesazheve që japin dukuritë natyrore është po aq fatkeqësi e madhe sa shkujdesja ndaj ajeteve kuranore.



Allahu i Madhëruar, në 137 vende të Kuranit Fisnik, e fton njeriun të meditojë mbi veprat e fuqisë dhe manifestimet e madhështisë hyjnore që Ai ka ekspozuar në gjithësi.

Kurani është një univers i veshur me fjalë, që flet dhe jep këshilla...

Njeriu është një vepër që gjendet në qendër të Kuranit dhe universit...

Universi është një libër i mbushur me urtësi, fshehtësi dhe mrekulli. Ai është si një Kuran i heshtur.



Atyre që e shohin gjithësinë me syrin e urtësisë, u zgjerohen horizontet shpirtërore në atë mënyrë sa që qielli mbi ta duket si një llambadar i kristaltë që shpërndan urtësi hyjnore....

Ndërsa pemët dhe gjethet duken sikur kanë hapur duart dhe i luten Zotit gjithë përgjërim...

Bari i gjelbër duket sikur ka mbirë si një sexhade për umetin islam, ndërsa lulet mbi të, valëviten sikur të ishin një bashkësi...

Zogjtë e vegjël duket sikur falënderojnë gjithë përzemërsi Krijuesin e gjithësisë...

Malet që janë simbol i fuqisë, duken si kur qëndrojnë në gjendje kijami përballë audiencës hyjnore...

Retë që janë simbol i begatisë dhe mirësisë, duken si një oqean në qiell...

Erërat janë si lajmëtare të të fshehtave frymëzuese hyjnore...

Vetëtimat janë shenjë e shpresës dhe e frikës.... Shkreptimat dhe bubullimat janë sinjalizues për të kontrolluar veten...

Ditët dhe netët janë një thirrje për reflektim në urtësitë dhe të fshehtat e universit...

Shkurtimisht; gjëja më e domosdoshme që i duhet besimtarit të zbatojë urdhëresën hyjnore, është: **"Lexo me emrin e Zotit tënd!"** (Alak, 1) Vetëm duke iu bindur kësaj urdhërese, mund të arrijmë gradа të larta në këtë botë dhe botën tjetër.



Rruga për të fituar dashurinë e Allahut është të fokusohemi tek Krijuesi, jo tek vepra, të shkojmë nga pasoja tek shkaku, nga mirësia tek dhuruesi i mirësisë; vetëm atëherë do të arrijmë të formojmë një atmosferë shpirtërore.



Gjithë universi është shfaqje e madhështisë hyjnore. Allahu e ka rregulluar sistemin në atë mënyrë, që ai të jetë i perceptueshëm nga njeriu. Mjafton që njeriu t'i qaset universit me syrin e zemrës, urtësisë dhe reflektimit...



Shfaqjet e fuqisë hyjnore në gjithësi, janë si poezi hyjnore të heshtura e pafjalë. Këto poezi hyjnore, thellohen në varësi të ndjenjave në zemra.

Sekreti i zemrës është të lexojë shfaqjet hyjnore dhe madhështinë hyjnore në univers përmes ajetit **" Lexo me emrin e Zotit tënd"**



Ekuilibri i përsosur në univers që i bën të mundur jetën njeriut në tokë, është njëkohësisht një tregues i fort se; asgjë nuk mund të jetë e rastësishme. Prandaj urdhëresa e parë kuranore është:

"Lexo me emrin e Zotit tënd!" (Alak, 1)

Pra lexoje Kuranin me syrin e zemrës!

Lexoje duke reflektuar mbi krijimin tënd!

Lexoje me vetëdijen e jetës kalimtare në këtë botë!

Lexoje duke analizuar veten dhe duke reflektuar për ditën kur do të të jepet libri i veprave për ta lexuar!..



Asnjë atom në univers, asnjë shkronjë në Kuran dhe asnjë qelizë tek njeriu, nuk është krijuar kot. Mirëpo, njeriu, duke menduar se është krijuar nga rastësia, dëshiron të jetojë në mënyrë të papërgjegjshme, si krijesat e tjera jo inteligjente. Kjo është një verbëri ndaj urtësisë dhe të vërtetave hyjnore.

Ndërkohë që ekuilibri në univers vazhdon në mënyrë të përsosur si një tregues i qartë i krijimit hyjnor, a mundet njeriu, si krijesa më e çmuar, të mendojë se gjithësia është rastësi dhe se njerëzit janë krijuar pa një qëllim të caktuar?

Ajeti kuranor thotë:

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Mu’minun, 115.)

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36.)



O njeri! Mos e mendo jetën dhe universin si diçka që është krijuar paqëllim...

Allahu i Plotfuqishëm ka krijuar gjithçka që gjendet në tokë dhe në qiej, në gjithësi dhe në brendësi të njeriut, si treguese të qarta të ekzistencës, unitetit dhe fuqisë së Tij, me qëllim që ne të meditojmë mbi to.

Çdo gjë që ka krijuar Allahu, në tokë apo në qiell, jashtë apo

brenda njeriut, është tregues i ekzistencës dhe fuqisë së Tij dhe, njëkohësisht, si shenja për të medituar mbi to.



Allahu e ka krijuar gjithçka në mënyrë të përsosur. Çdo gjë; që prej botës mikro deri tek bota makro, funksionon sipas një sistemi të mrekullueshëm hyjnor.

Kur ndodheni në sipërfaqen e tokës, a mund të thotë dikush se; nesër, ajrit me 21% oksigjen dhe 78% azot mund të ndryshojë dhe ju duhet të dilni me maska oksigjeni?! Edhe ateisti nuk ka rrugë tjetër përveçse t'i dorëzohet rendit hyjnor, edhe pse verbëria e zemrës bëhet pengesë për besimin në Zot...



Shtresa e magmës në tokë është një oqean i jashtëzakonshëm zjarri. Ndërsa dielli sipër nesh; një top i pamasë flake. Asnjëri prej tyre nuk prek në kufirin e tjetrit. Në mesin e këtyre dy zjarreve, Krijuesi ynë na fal ne robërve të Tij një jetë të qetë e të freskët.

Megjithëse brenda dhe jashtë trupit tonë ndodhen me dhjetëra viruse dhe baktere, ne kalojmë një jetë të shëndetshme. Kjo është një nga mirësitë e Allahut për ne. Prandaj, është fatkeqësi e madhe për njeriun t'i mendojë këto si rastësi...



Universi është një shkollë për meditim dhe një laborator për besimin. Duhet të kesh probleme të theksuara mendore për të mos besuar...

Një njeri që arrin të reflektojë si duhet mbi urtësitë e pafundme të universit, i cili është një art i përsosur hyjnor, e kupton menjëherë që çdo gjallesë ka nevojë për një ndihmë të madhe për të

përballuar jetën. Ai e kupton menjëherë dobësinë dhe pranon se është një vepër e përsosur hyjnore në këtë botë...



Njeriu duhet të pyesë veten:

Nga kemi ardhur dhe për ku jemi nisur? Cili është qëllimi i ardhjes dhe largimit tonë nga kjo botë? Në pronën e kujt jetojmë? Kush na i ka dhënë gjithë këto mirësi që i shfrytëzojmë? Nga vijnë gjithë këto mirësi dhe për çfarë qëllimi janë? A mund të jenë të rastësishme të gjitha këto?..

Duke i bërë vetes pyetje të tilla, njeriu e kupton se sa nevojë ka për Allahun!..



Kur hedhim shikimin në univers, vërejmë se çdo gjë është në lëvizje dhe aktivitet të vazhdueshëm. Dielli, Hëna, qielli, toka, dhe të gjitha gjallesat kryejnë me rigorozitetin më të madh funksionin për të cilin janë krijuar. E njëjta gjë ndodh edhe në mikrobotën; brenda një atomi lëvizin me një shpejtësi të madhe grimca më të vogla si protonet, elektronet dhe kuarket. Pra, janë vazhdimisht në një lëvizje...

Të qëndrosh indiferent, inaktiv dhe larg veprave të mira përballë një dizajni të tillë të përkryer, është një shkarje shumë e rëndë.

Në univers, gjithçka është në gjendje aktiviteti, duke filluar nga makro universi deri tek mikro universi: Miliarda galaktika janë vazhdimisht në lëvizje. Dielli, Hëna dhe yjet nuk pushojnë së lëvizuri për asnjë moment. Zemra nuk kërkon pushim vjetor për punën që bën. Në bërthamën e atomit lëvizin me një shpejtësi marramendëse elektronet, protonet dhe neutronet. Një elektron i atomit të hidrogjenit sillet rreth bërthamës me një shpejtësi 2000 km për sekondë...

Të gjitha këto, janë një mesazh për jetën tonë shpirtërore dhe për të treguar vendosmëri dhe qëndrueshmëri në rrugën drejt Zotit.

Sahabët, të cilët janë një model vendosmërie dhe përpjekje në rrugën e predikimit të Islamit, shkuan në katër anët e botës për të përhapur Islamin, pa marrë parasysh kushtet e vështira të kohës. Ata i dërguan mbretërve të kohës mesazhin e Profetit ﷺ, pa treguar asnjë shenjë lodhje dhe frike. Kënaqësia që buronte nga adhurimi i Allahut, i ushqente ata me një energji të madhe.

Pra, për myslimanin; pushimi fillon në varr, për të vazhduar në botën tjetër vetëm pas një jete plot adhurim dhe shërbim në rrugën e Allahut...



Në univers nuk ekziston asgjë pa urtësi. Universi është një libër meditimi mbi urtësitë hyjnore të cilat mund të lexohen përmes syrit të zemrës. Leximi i tij është i lidhur ngushtë nga gjendja shpirtërore.

Kur vjen pranvera, stina në të cilën çelin lulet, toka fillon të gjallërohet dhe lumenjtë rrjedhin vrullshëm. Kështu; kur një person që ka arritur pjekurinë shpirtërore, e shikon këtë panoramë, fillon të meditojë dhe të nxjerrë mësime praj saj. Ai, përballë kësaj gjallërie fillon të mendojë se edhe ai duhet të jetë më i gjallë dhe të tregojë më shumë përpjekje në realizimin e adhurimeve.

Po ashtu, edhe stinën e vjeshtës ai e lexon me syrin e zemrës, duke nxjerrë mësime dhe mesazhe prej saj. Rënia e gjetheve në stinën e vjeshtës, i kujton atij kohën e kufizuar në këtë botë. Perëndimi i diellit i kujton vdekjen. Dhe, të gjitha këto, e nxitin atë të nxitojë në bamirësi dhe vepra të mira pa humbur kohë...



Dituria, madhështia dhe urtësia që shfaqet në krijim i kujton njeriut dobësinë e vet para madhështisë hyjnore. Një dele ushqehet me bar dhe ujë për të prodhuar qumësht. Kurse njeriu, me gjithë zhvillimin e madh teknologjik, nuk ka arritur ende që; përmes një fabrike, të përdor si lëndë të parë barin dhe ujin, e të prodhojë qumësht.

Qëkur është krijuar bota e deri më sot, janë shtruar sofra të panumërta hyjnore dhe vazhdojnë të shtrohen çdo moment, duke mos u neglizhuar furnizimi i asnjë krijese. Nëse mendojmë për një çast; tre të katërtat e tokës janë të mbuluara me ujë. Ndërsa një e katërta e tokës përbëhet nga shkëmbinj ose shkretëtira, ku bimët nuk mund të zhvillohen. Vetëm një pjesë e vogël që mbetet, është tokë e përdorshme. Mirëpo, fuqia madhështore e Allahut Teala, ka bërë që toka, me anë të një lloj metamorfoze (ndryshimi i stinëve), të jetë burim ushqimi për të gjitha gjallesat.

Një numër i madh organizmash në trupin tonë punojnë si fabrika ku kryhet një numër i pafund procesesh biokimike. Dhe të gjitha këto, funksionojnë në një rend të caktuar dhe të mrekullueshëm, jashtë vetëdijes sonë. Nëse do të na ishte lënë në dorë për një ditë programi hyjnor i trupit të njeriut, që punon me një rregull të mahnitshëm, i ndonjë organi ose edhe i një qelize të vetme, ku zhvillohen me qindra reaksione kimike, nuk do të kishim duruar qoftë edhe disa minuta. E, kushedi se sa dëme mund të shkaktonim!?

Kjo tregon qartë pafuqinë dhe nevojën e njeriut. Prandaj, mjafton të thuhet se; bindja, nënshtrimi dhe mirënjohja ndaj Allahut janë thelbësore.

“O njeri, ç’të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i

Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe, që të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!" (Infitar, 6-8.)

Si mund të dalë një pemë madhështore nga një farë dhe si mund të japë fruta me tonelata? Si mund ta fshehë ajo farë planin dhe programin e misterit të formimit të kësaj peme?

Si mund të dalë nga veza një zog apo gjallesë tjetër? Po njeriu? Si formohet nga një grimcë? Cila fuqi i ruan të gjitha organet në atë grimcë? Meditimi është një çelës i besimit. Edhe dija duhet të jetë produkt i meditimit.

Sa e mahnitshme është kur shohim se nga një anë, një elefant dhjetëra tonësh mund të komandohet nga një fëmijë dhjetëvjeçar (nëse Allahu i jep aftësinë) dhe nga ana tjetër shohim se një virus i vogël, aq sa nuk mund të shihet me sy të zhveshur, mposht trupa me fuqi të madhe!..

Kjo nënkupton se; njeriu, asnjëherë nuk duhet të mburret dhe nuk duhet t'ia atribuojë vetes forcën që ia ka falur Allahu Teala. Ai nuk duhet të harrojë pronarin e vërtetë të mirësive, dhe për këtë, duhet të jetojë gjithmonë me ndjenja mirënjohjeje dhe falënderim. Gjithashtu, ai duhet të kuptojë se nuk është as sa një thërrmijë pluhuri përpara fuqisë hyjnore dhe se duhet të kërkojë strehim tek Krijuesi i tij, sepse edhe fryma që jep e merr, është një prej mirësive të mëdha hyjnore.

Shejh Sadi Shirazi tregon:

"*Allahu i Madhëruar ka krijuar prej tokës ngjyra, aroma, lule dhe ushqime, me qëllim që të kënaqet syri, hunda dhe mendja jote. Po ashtu, (si një gosti hyjnore), Ai ka krijuar për ty pemën e hurmës*

nga fara e saj, frutin e hurmës prej pemës së saj dhe mjaltë prej bletës.

Për ty ka krijuar edhe trëndafilin mes gjembave, miskun prej barkut të kaprollit, arin prej tokës dhe gjethet e gjelbra prej degëve të thata.

Sytë dhe vetullat e tua i ka pikturuar me dorën e Tij. Ai është i Plotfuqishëm dhe kështu i ushqen robërit e Vet mes nazeve dhe mirësive.

Atëherë, a nuk duhet që ti të falënderosh jo vetëm me gjuhën tënde, por edhe me të gjitha gjymtyrët e tu, vazhdimisht dhe me gjithë shpirt?

Allahu kërkon prej nesh të reflektojmë dhe mendojmë mbi madhështinë e Allahut. Allahu kërkon nga ne të lexojmë shenjat dhe fenomenet në univers me syrin e zemrës.

Toka na kujton ne përkohshmërinë. Mbi të njëjtën tokë që ecim ne sot, para mijëra vjetësh kanë ecur njerëz të tjerë. Gjithashtu, edhe produktet për brezat e ardhshëm do të prodhohen po prej asaj toke. Pra, panorama madhështore e jona është nga toka në tokë!..

A është e mundur të mos mahnitesh nga madhështia e krijimit të Allahut që na shfaqet në natyre? Le të meditojmë për pak mbi një gotë ujë që e pimë:

Uji përbëhet nga 2 molekula hidrogjen dhe një molekulë oksigjen. Nga këto dy lloje molekulash është krijuar uji si baza e jetës në tokë.

Uji që mbetet mbi tokë, u shërben njerëzve, përdoret në ushqimin, pijen, pastrimin dhe plotësimin e nevojave të ndryshme të

tyre dhe nganjëherë ndotet për këtë arsye. Por, ai ujë i ndotur, ngrihet përsëri drejt qiellit duke avulluar si pasojë e nxehtësisë së diellit, pastaj kthehet në re dhe përsëri zbret në sipërfaqen e tokës si mëshirë nga Zoti.

Kushedi sa herë ka avulluar dhe është ngritur në qiell një gotë uji që e pimë, që nga dita që ka ardhur në ekzistencë!? Pastaj, kushedi sa herë ka zbritur si mëshirë në sipërfaqen e tokës; për cilat farëra është bërë ushqim; e në cilat vende ka shëtitur dhe ka qëndruar brenda tyre!? E, kush e di se çfarë mund të ndodhë këtej e tutje me të?!. Nëse do të tentohet të shkruhet kjo aventurë, që në fakt është e pamundur ta njohim plotësisht, do të dilnin libra me shumë vëllime, por prapë se prapë nuk do të kishte fund.

Duke e bërë ujin të flas me gjuhën e gjendjes së tij, Mevlana tregon:

"Uji ushqen nevojtarët dhe jetimët e rruzullit tokësor dhe u fal jetë atyre që janë përvëluar nga mungesa e ujit dhe etja. Por, kur nuk është i pastër dhe kur ndotet mbi sipërfaqen e tokës pikërisht si ne, mbetet i shastisur. Brenda vetes fillon e bërtet me të madhe duke thënë:

O Zot! Çfarëdo që më ke dhënë, ua kam shpërndarë dhe ua ka dhënë të gjitha atyre. Tashmë unë kam mbetur i varfër. Kapitalin dhe çdo gjë që posedoja e kam derdhur edhe te të pastrit, edhe te të papastrit...

O Zot që jep kapital! Më jep edhe më shumë mua!

Allahu i Lartësuar i thotë resë së këtyre lutjeve dhe përgjërimeve:

"Çoje atë në një vend të mirë pa e dërrmuar!"

Edhe diellit i jep këtë urdhër:

"Lartësoje menjëherë atë drejt qiellit me nxehtësinë tënde!.."

Kështu që, e çon atë në rrugë të ndryshme. Pasi ta pastrojë atë në qiell, e lëshon përsëri në sipërfaqen e tokës; nganjëherë si shi, nganjëherë si dëborë dhe nganjëherë si breshër. Më në fund, e shpie atë në një det pa anë e pafund."

"Çdo grimcë (atom) në gjithësi, që është krijuar me një harmoni dhe sistem te mrekullueshëm, është e mbushur plot e përplot me shumë të fshehta dhe urtësi. Edhe njeriu, që është bebja e syrit të gjithësisë dhe thelbi i saj, është në të njëjtën mënyrë një enigmë e mbushur plot e përplot me të fshehta dhe urtësi."

Mevlana, i cili e transmeton këtë fenomen natyror që e dëshmojmë çdo stinë, i drejtohet njeriut në mënyrë figurative:

"Pastroje veten nga të gjitha papastërtitë e nefsit, duke u afruar te Allahu Teala pikërisht siç pastrohet uji në qiell! Kështu bëhu edhe ti si shiu! Përhap begati dhe mëshirë!"

Uji është vetëm një nga mirësitë që shfrytëzojmë. Uji që pimë, ajri që thithim, ushqimi që hamë dhe shumë mirësitë të tjera për të cilat jemi të pavetëdijshëm, duhet të na ndërgjegjësojnë për faktin se sa të pafuqishëm jemi në falënderimin e Allahut.

Besimtari duhet të jetë vazhdimisht në gjendje falënderimi për mirësitë e mëdha që i ka falur Allahu. Në këtë mënyrë, ai do të pranojë dhe ndjejë dobësinë e vet, duke e mbushur në këtë mënyrë zemrën me falënderim ndaj Allahut.

Në stinën e dimrit bie borë. Përveç njëmijenjë urtësive që bart, ajo e zbukuron tokën me pamjen e saj të bardhë, si dhomën e një nuseje. Në stinën e dimrit, kur netët zgjaten dhe errësirat shtohen, ajo i rehaton soditësit me ngjyrën e saj të bardhë. Po sikur bora që bie prej qiellit të ishte në ngjyrën e tmerrshme të gjakut, ose në ngjyrën e zezë, që të kujton zinë dhe papastërtinë; kushedi sa e vështirë do të ishte për ne! Njerëzimi do të çmendej!

Poshtë asaj bore të akullt, në gjirin e tokës ruhen me mijëra gjallesa, pa u ngrirë dhe pa ngordhur. Kur vjen pranvera dhe shkrin bora, mbi tokë nuk dalin kufomat e insekteve, por lloj-lloj krijesash. Allahu i Madhëruar, tregon me argumente se; arti i Tij i veçantë nuk është i kufizuar me kushte. Për shembull, në stinën e dimrit, ku shumica e bimëve nuk mund të mbijetojnë, Allahu ka krijuar luleborën që çel nën borë.

Pra kur i qasemi krijimit me syrin e urtësisë dhe zemrës, gjithë krijimi bëhet një dëshmitar i madhështisë hyjnore.

Shiko këtë lule se si mbin nga një tokë e zezë? Sa ngjyrues apo sa dekorues punojnë për të? Kujt ia fal Krijuesi i Gjithësisë këtë lule? Përse nuk ka shfaqje të tilla në planetë apo yje ku nuk gjenden njerëzit? Çdo krijesë është argument për ekzistencën e Krijuesit të Gjithësisë. Natyrisht për ata që kuptojnë...

Një fëmijë i vogël, është në gjendje të marrë përpara një tufë të madhe me fëmijë. Po ashtu, një virus i padukshëm për syrin e njeriut, arrin të mposhtë njeriun dhe shtetet e mëdha. Të gjitha këto janë mësime për ata që mendojnë...

Shejh Sadi, domosdoshmërinë e qasjes me urtësi ndaj universit e shpreh kështu:

"Nxirr mësim nga fatkeqësitë që kanë kaluar të tjerët para teje në mënyrë që të tjerët të mos marrin mësim nga fatkeqësitë e tua."



"A nuk e ke parë ç'i bëri era popullit të Adit?! A nuk e ke dëgjuar ç'bëri uji dhe tufani!? Si e zhduku Deti i Kuq Faraonin; si e përpiu dheu Karunin?!.. Ç'i bënë zogjtë Ebabil ushtrisë së elefantëve?! Si një mizë e vogël e shkatërroi Nemrudin që e quante veten Zot?!..

"A nuk e di se si ra shiu i gurëve mbi popullin e paturpshëm të Lutit, e se si u fundosën ata në ujërat e errëta e të pista të një liqeni?"

"Sikur të të tregoja gjerë e gjatë për krijesat që duken të pajeta në këtë botë; se si i kanë ndihmuar profetët, si të ishin njerëz me mend, Mesnevia (vepra) ime do të bëhej aq e gjatë dhe aq e rëndë, sa që nuk do ta mbartnin dot dyzet deve!.."

"Meqenëse Allahu është shpirti i shpirtit të çdo gjëje, atëherë ki frikë që shpirti yt të mos ndahet nga shpirti i shpirtit tënd! Bindju urdhrave të Tij!"



Kurani jep shembuj të popujve që janë sprovuar me dënime të ndryshme për shkak të mos marrjes parasysh të paralajmërimeve dhe qortimeve hyjnore. Këto histori kuranore nuk janë thjesht si dokument historik për popujt e kaluar, por shërbejnë për t'i tërhequr vëmendjen gjithë njerëzimit deri në ditën e gjykimit për dënimet e mundshme që mund të përballen nëse neglizhojnë mësimet hyjnore.

Fatkeqësisht, sot, në arenën botërore mbizotëron krimi dhe

padrejtësitë e atyre popujve të shthurur, shndërrimi i njerëzve të dobët dhe të varfër në skllevër modernë, shfrytëzimi i njerëzve si ingranazhe të rrotës së ekonomisë dhe paraqitja e perversiteteve të tilla si homoseksualizmi si «e drejtë njerëzore», dhe madje, kundërshtimi e saj si krim.

Allahu në Kuran thotë:

"Sikur Allahu t'i dënonte njerëzit sipas veprave që bëjnë, nuk do të mbetej në sipërfaqen e Tokës asgjë e gjallë, por Ai i shtyn ata deri në afatin e caktuar dhe, kur t'u vijë afati i tyre, ata do ta dinë se Allahu i mbikëqyr mirë robërit e Vet." (Fatir, 45.)

Pra Allahu, pjesën më të madhe të dënimet e ka lënë për në botën tjetër.

Nemrudi, i cili pati pretenduar cilësi hyjnore, u shkatërrua nga një mizë, ndërsa Ebreheja, i cili doli për të shkatërruar Qaben, u shkatërrua nga zogjtë Ebabilë. Allahu, herë pas here dërgon sprova dhe dënime të ndryshme mbi njerëzit, për t'u tërhequr vëmendjen për arrogancën dhe mendjemadhësinë.

Edhe pandemia e korona virusit, që ka prekur njerëzimin në vitin 2020 duke u përhapur në gjithë botën, duhet lexuar në këtë aspekt dhe këndvështrim. Një virus i vogël, paralizoi pothuajse çdo aktivitet të njeriut në tokë. Shkenca dhe teknologjia, me gjithë zhvillimin e madh të tyre, mbetën të pafuqishme përballë një virusi të padukshëm.

Sot, njerëzit diskutojnë se kush e solli virusin!?. Ai që ka sjellë zogjtë Ebabilë ka sjellë edhe virusin.

Sot bota ka hyrë në një krizë të rëndë morale, ku i forti e shtyp të dobëtin, fuqitë globale shtypin dhe shfrytëzojnë pamëshirë ven-

det e vogla. Superfuqitë botërore po bëjnë masakra mbi popullin e thjeshtë të shumë vendeve myslimane, duke i detyruar të shpërngulen nga vendet e tyre për shkak të luftës. Shembuj të tipik të kësaj tabloje, janë Siria dhe Mjanmari... Shumë vende myslimane janë në gjendje shumë të mjerueshme.

Është shumë mbresëlënës fakti se; në vendet e varfra, përhapja e virusit është shumë më e vogël, krahasuar me vendet e zhvilluara ekonomikisht. Vendet e ashtuquajtura superfuqi, po përpëliten të pashpresa dhe të pafuqishme përballë forcës së virusit. Kurse vendet e varfra, sikur janë marrë nën mbrojtje nga vullneti hyjnor.

Në kampet ku janë refugjatët sirian, virusi nuk është shumë i përhapur duke marrë parasysh që kushtet higjenike lënë për të dëshiruar. Duket sikur virusi është i vetëdijshëm për detyrën e tij.

Cila është zgjidhja? Zgjidhja e vetme është kthimi tek Allahu, kërkimi i faljes dhe lutjes me përgjërim. Ne duhet të ndihmojmë të varfrit dhe të fitojmë dashurinë dhe lutjet e tyre, në mënyrë që ndihma dhe mbështetja e Allahut të jetë pranë nesh.

Besimtari duhet t'i qaset jetës, universit dhe fenomeneve, jo me këndvështrimin e ngushtë materialist dhe shekularist, por me këndvështrimin e gjerë që i ofron bota shpirtërore. Besimtari duhet t'i analizojë ngjarjet gjithmonë me syrin e zemrës.

Tërmetet, zjarret, përmbytjet dhe pandemia e fundit që ka pushtuar njerëzimin, ofrojnë kuptime të ndryshme sipas gjendjes shpirtërore të personit.

Dikush e konsideron si mundësi për t'u ngjitur në gradën e dëshmorit.

Dikush si pastrim nga mëkatet,

Dikush si lartësim,

Dikush si qortim,

Dhe dikush si dënim.

Ashtu si në aspektin fizik, gjithsecili merr masat e veta edhe në planin shpirtëror dhe njeriu nxjerr mësime e mesazhe sipas gjendjes shpirtërore.

Ngjarje dhe ndodhi të tilla, duhet të na nxisin si individ dhe si shoqëri të kontrollojmë veten, të zgjohemi nga gjumi i neglizhencës, të marrim përgjegjësitë tona para Krijuesit të gjithësisë, t'i kërkojmë falje dhe t'i lutemi me përgjërim të thellë Allahut. Vetëm pasi të strehohemi dhe mbështetemi sinqerisht tek Allahu do të rregullohet gjendja jonë.

Besimtari, çdo ngjarje me të cilën përballet, duhet ta vlerësojë sipas mësimeve të besimit. Sidomos kur përballet me sprova; ai nuk duhet të harrojë kurrë që, ajo mund të jetë një shfaqje e sprovës hyjnore. Në raste të tilla, përveç masave të jashtme duhet të merren edhe masa shpirtërore të përcaktuara nga Kurani dhe Tradita profetike.

Allahu thotë në Kuran:

"Ne u kemi dërguar profetë edhe popujve para teje. (Pastaj) **Ne i kemi dënuar ata me skamje dhe fatkeqësi, për t'u bërë të dëgjueshëm.** (Të paktën) **Sikur të përuleshin kur u erdhi ndëshkimi Ynë! Por zemrat e tyre u bënë gur, ndërsa shejtani ua paraqiste si të bukura veprat e tyre të këqija."** (En'am, 42-43.)

Pra, faktori kryesor për t'u mbrojtur nga sprovat është pendimi, kërkimi i faljes dhe lutja tek Allahu. Kjo është e lidhur ngushtë me jetën e ibadetit, që e ndihmon njeriun të njohë vetveten dhe të pranojë dobësinë dhe pafuqinë e vet përballë madhështisë hyjnore. Ata që nxjerrin mësim mbrohen nga sprovat e jetës, kurse ata që kanë një jetë të varfër shpirtërore nuk nxjerrin mësime prej sprovave dhe, për pasojë, nuk kërkojnë falje dhe pendim.

Sadi Shirazi thotë:

"*Nëse nuk dëgjon këshillat, një ditë do ta shikosh veten të prangosur me zinxhirë.*"

Çdo fenomen ka shkakun e dukshëm dhe të padukshëm. Të gjithë njerëzit fokusohen vetëm tek shkaku u dukshëm duke anashkaluar shkakun e padukshëm dhe njëkohësisht edhe më kryesorin.

Në univers çdo gjë funksion sipas ligjeve të vendosura nga Allahu. Dielli dhe hëna ndjekin një trajektore koncize të përcaktuar qartë, për të cilën askush nuk dyshon. Raporti oksigjen-azot gjithashtu është i përcaktuar në mënyrë koncize. Si këto, funksion çdo gjë në univers...

Allahu, disa ngjarje i ka përjashtuar nga ligjet e përgjithshme, me qëllim që të shërbejnë si një qortim hyjnor për njerëzit. Këto ngjarje i kujtojnë njeriut madhështinë e Allahut dhe dobësinë e vet. Këto ngjarje e ftojnë njeriun në reflektim, falje dhe pendim.

Pa vullnetin dhe dijeninë e Allahut nuk bie asnjë gjethe nga pema. E si mund të ndodhin tërmete, cuname, zjarre dhe fatkeqësi të tjera natyrore rastësisht? A mendoni se virusi që ka përfshirë gjithë botën, ka ardhur rastësisht?..

Profeti ﷺ, thotë:

"*Kur marrëdhëniet seksuale jashtë martesore, përfshi prostitucionin (e thënë ndryshe, tradhtia bashkëshortore, anormalitetet seksuale në dëm të të tretëve si dhe ushqyerja e ndjenjave sensuale) fillojnë të veprojnë haptazi në një shoqëri, në mënyrë të dukshme me sy, pra, përhapen gjerësisht, mjedisin e kaplojnë sëmundjet epidemike të panjohura më parë.*" (shih. Ibn-i Maxhe, Fiten, 22; Hakim, IV, 583/8623.)

Para disa dekadash, u shfaq virus HIV (SIDA), prej të cilit mendohet të kenë vdekur deri tani mbi 30 milion njerëz. Kurse në shoqëritë që tregojnë kujdes në ruajtjen e nderit, ky virus pothuajse nuk është përhapur fare. E, ndërkohë që mjekësia përpiqet të gjejë një zgjidhje për këtë virus, papritur shfaqet një virus tjetër.

Një virus shumë i vogël, i pa kapshëm nga sytë, arrin të nënshtrojë gjithë atë trup të madh. Madje me frikën që përhapet prej tij rrezikon edhe vendet e fuqishme industriale të cilat e pandehin veten të pamposhtur. Një virus i vogël i detyron vendet të marrin masa në çdo fushë të jetës duke filluar nga udhëtimet, tregtia, mjekësia dhe arsimi.

Ndërsa shqetësohemi për sëmundjet që nuk dihet nëse do të na infektojnë sot dhe po marrim masa të shumta, sa shqetësohemi për vdekjen tonë të pashmangshme?

Sa të preokupuar jemi ne me jetën e varrit dhe ahiretit, që është jeta reale? Sa vend zë ajo në agjendën tonë? Çfarë masash po marrim sot që të mos ngecim aty dhe të mos bëhemi pishman? Sa shumë mundohemi të mbrojmë veten, familjen dhe brezin tonë nga të këqijat e kohës dhe haramet?

Të mos harrojmë se; dëmi i virusit është vetëm për këtë botë. Por viruset e mosbesimit dhe imoralitetit që shkatërrojnë shpirtin e njeriut janë pikërisht ato që e kthejnë jetën e përhershme në një mundim të dhimbshëm.



Ka shumë për të thënë në lidhje me përhapjen e madhe të sëmundjeve epidemike, tërmeteve, përmbytjeve dhe shumë sprovave të tjera:

- Njerëzimi ka hyrë në një garë lakmitare për të shfrytëzuar resurset tokësore,

- Është braktisur ushqimi hallall dhe i pastër duke rendur pas ushqimeve të konservuara apo të ndryshuara gjenetikisht,

- Gjakderdhja e njerëzve të pafajshëm dhe dëbimi i njerëzve nga vendet e tyre,

- Indiferenca e madhe ndaj vendeve dhe njerëzve të varfër deri në atë gjendje sa Deti Mesdhe është kthyer në një varrezë masive për njerëzit e pafajshëm që kërkojnë të shpëtojnë nga lufta dhe bombardimet,

- Mungesa e mëshirës dhe e dhembshurisë ndaj fëmijëve që vdesin nga lufta apo uria ne vendet e varfra,

- Egoizmi, lakmia dhe arroganca e njeriut ka bërë që epoka moderne të shndërrohet në një epokë injorance.

Në lidhje me këtë mund të përmenden shkaqe pafund. Por këto janë shkaqet kryesore që kanë larguar prej nesh mëshirën dhe begatinë hyjnore.

Nëse do duhet t'i përmbledhim të gjitha në një shkak, mund të themi që është**: "Harrimi i Allahut dhe botës tjetër**"

Pra, kur njeriu harron madhështinë e Allahut dhe gjykimin në botën tjetër, bëhet despot dhe tiran.



Në këtë botë herë pas herë ndodhin fatkeqësi. Dhe për t'i kapërcyer vështirësitë sa më lehtë, duhen marrë dhe respektuar masat e nevojshme.

Por, fatkeqësia më e madhe, është të mos nxjerrësh mësim dhe të mos i lexosh si duhet shenjat dhe qortimet hyjnore, ose qasja materialiste dhe pozitiviste ndaj këtyre fenomeneve.

Allahu thotë në Kuran:

"Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) **do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen** (në përmirësim)**."** (Rrum, 41.)

Ky paralajmërim hyjnor na kujton përgjegjësitë përballë fatkeqësive të ndryshme që ndodhin.

Anashkalimi i shkaqeve shpirtërore të cilat ndezin reaksionin e shkaqeve materiale, është një fatkeqësi shumë më e madhe. Mos nxjerra e mësimeve të duhura dhe mos përballja me thelbin e problemit është fatkeqësi e madhe.

Fatkeqësia më e madhe është të besosh tek forca e shkencës, teknologjisë dhe mjekësisë duke harruar vdekjen, dobësitë tona dhe nevojën tonë të madhe për Krijuesin.

Allahu thotë në Kuran:

"A janë të sigurt ata nga të papriturat e Allahut? Vetëm ata që janë të humbur nuk u frikësohen të papriturave të Allahut."
(Araf, 99.)

Fatkeqësia e vërtetë është të bësh një jetë neglizhente ndaj Allahut, të harrosh vdekjen dhe botën tjetër.



Allahu thotë në Kuran:

"Kur hipin në anije, ata i luten Allahut me devotshmëri të sinqertë, por kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë, menjëherë ata i veshin Atij ortakë (në adhurim)." (Ankebut, 65.)

Shembulli i anijes në ajetin e lartpërmendur mund të zbatohet në shumë situata të tjera. Për shembull; kur gjatë një fluturimi me avion ndodhin turbulenca ajrore, të gjithë pasagjerët i luten Zotit. Por, kur zbresin shëndoshë e mirë në tokë, harrojnë dhe vazhdojnë përsëri jetën në indiferencë.

Rikthimi në jetën indiferente pasi i je drejtuar njëherë Zotit dhe lutjeve ndaj Tij në këtë kohë sprovash, do të ishte një humbje e madhe. Madje, kjo gjë bëhet shkak për sprova të tjera edhe më të rënda.

Prandaj është e domosdoshme që të ruajmë gjendjen adhurimit përballë çdo situate, qoftë kjo mirësi apo sprovë.

Asgjë në univers nuk është krijuar pa urtësi dhe një qëllim të caktuar. Normalisht kjo përmban mësime për ata që mendojnë dhe arsyetojnë. Kurse për të shkujdesurit çdo gjë është rastësi e natyrës.

Një i urtë thotë:

"Për të mençurit, kjo botë është meditim mbi shfaqjet madhështore të fuqisë hyjnore, ndërsa për mendjeshkurtrit, është ushqim dhe kënaqje e epsheve."



Kjo botë është një shkollë e madhe e mbushur me fshehtësi hyjnore. Njerëzit e urtë, përmes leximit të urtësive arrijnë grada të larta në njohjen e Allahut. Kurse të shkujdesurit, e pandehin botën si një vend i krijuar pa ndonjë qëllimtë caktuar, si një vend argëtimi. Allahu thotë në Kuran:

"Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t'u zbavitur!" (Duhan, 38.)

Shejh Sadi thotë:

"*Për shpirtrat e ndriçuar, edhe gjethja e një peme mjafton për të njohur dhe falënderuar Allahun. Ndërsa për të shkujdesurit, të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethe.*"

"*Njeriu i mençur nxjerr mësime urtësie edhe prej shakasë e përrallës. Ndërsa indiferenti, edhe sikur të lexojë njëqind fjalë të urta, i duken përralla.*"

Nëse një personi që ka lindur i verbër, i vjen shikimi për një moment, ai do të tronditej jashtë mase. Kushedi sa do të çuditej ky njeri kur të shihte detet, pemët, zogjtë që fluturojnë dhe sa e sa gjëra të tjera që s'i ka parë asnjëherë!.. Madje, ai do të thoshte: *"Sa bukur i ka krijuar Zoti im!"*

Kurse njeriu që sheh me mijëra bukuri të tilla çdo ditë, jeton pa i vënë re ato, kalon i pavetëdijshëm pranë tyre dhe nuk arrin t'i hapë një shteg meditimit të thellë dhe të hollësishëm; njëjtë si shembulli i shkëmbinjve të fortë që, edhe pse mbi ta bien shirat e begatshëm të prillit, ata nuk kanë asnjë dobi prej tyre.

Sa keq për ata që janë plotësisht indiferentë ndaj manifestimeve të cilësive **"el-Bari"** (Krijuesi i përkryer pa model e shembull) dhe **"el-Musauuir"** (Krijuesi në forma të llojllojshme origjinale) të Allahut të Madhëruar dhe për ato zemra të mefshta që nuk ndjejnë asgjë prej gjuhës së heshtur të erërave, përrenjve dhe maleve!.. Gjendja e zemrave të verbra ndaj shfaqjeve të madhështisë hyjnore është thuajse e njëjtë me gjendjen e fatkeqëve që vdesin të uritur mbi thesare...

Sa keq për ata shpirtra të papjekur; që nuk mund ta zgjidhin fjalëkryqin e jetës e të gjithësisë; që nuk kuptojnë gjuhën e trëndafilave, pemëve, ujqërve e zogjve dhe; kalojnë nga kjo botë duke i parë me fytyrë e egër dhe të vrenjtur deklarimet e heshtura e jo verbale të erërave, maleve, përrenjve dhe bahçeve, për shkak se nuk e kanë arritur dashurinë, kënaqësinë dhe entuziazmin e besimit.

Këtë shkujdesje të madhe Mevlana e shpreh në këtë mënyrë me anë të përngjasimit:

"Një mëzat papritur hyri në Bagdad dhe e shëtiti qytetin nga fillimi e deri në fund. Por sytë i panë vetëm lëvoret e shalqinjve dhe bostaneve. (Ai nuk e pa dot madhështinë e Bagdadit, i cili ishte një qendër civilizimi dhe madhështinë e lumit Tigër. Në të vërtetë, çfarë mund të shikojnë tjetër sytë e gomarëve dhe të mëzetërve përveç ushqimit dhe epshit në këtë botë!)

Mëzetërit dhe gomarët janë të dhënë ose pas kashtës së derdhur nëpër rrugë, ose pas barërave të shkelur nga këmbët e kalimtarëve, ose pas lëvoreve të shalqinjve dhe bostaneve të hedhura nëpër qoshet e rrugës! (Edhe nëse shndërrohen në sy nga këmbët e deri te koka, ata nuk mund ta shikojnë dot madhështinë e artit hyjnor në gjithësi...)"

Njeriu që e ka syrin e zemrës të verbër, e ka të pamundur të përfitojë prej urtësisë. Ashtu siç nuk mund të shikojë asgjë një person që ka mbyllur sytë, ashtu edhe ai i cili është i kushtëzuar dhe fanatik, nuk përfiton dot prej urtësive. Zemra e tij është shndërruar në një burg të errët, ai ka humbur të gjitha aftësitë e perceptimit shpirtëror.

Njerëzit e urtë kanë thënë:

"Kush e sheh këtë botë pa marrë mësim, syri i zemrës së tij verbohet aq sa është edhe niveli i pakujdesisë së tij." (Ibn-i Kethir, I, 448)

Ata që kalojnë një jetë të shkujdesur dhe indiferente duke e konsideruar botën vetëm si një vend argëtimi, në botën tjetër do të shndërrohen në të verbër të përjetshëm. Allahu thotë në Kuran:

"Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë." (Isra, 72.)

"Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër."

"Ai do të thotë: "O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?"

"(Allahu) **do t'i thotë: "Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar."** (Taha, 124-126.)

Osmani ﷺ, thotë:

"*Një rob (indiferent ndaj të vërtetave hyjnore), duhet të ketë frikë se mos Allahu e ringjall të verbër në Ditën e Kiametit, edhe pse ai ka parë me sytë e tij në këtë botë! Atij që kupton urtësitë, i mjafton edhe një fjalë me kuptim. Por, ata që janë të shurdhër shpirtërisht, nuk mund ta dëgjojnë të vërtetën!..*"

Meditimi është çelësi i besimit. Një person që nuk është i verbër përballë të vërtetës e ka të pamundur të mos shikojë mrekullinë dhe madhështinë e Allahut në univers. Edhe nëse nuk i shikojnë sytë ai mund ta ndjejë madhështinë me syrin e zemrës.

Rumiu thotë:

"Edhe një verbër e kupton që ka lindur dielli nga nxehtësia".

O Zot! Na jep dritë që të shikojmë të vërtetën! Na bëj të dëgjojmë zërin e të mirës dhe të drejtës! Na jep dritë në zemër në mënyrë që të ndjejmë madhështinë Tënde!..

O Zot! Na jep qetësi në zemra, qetësi në shpirt dhe shërim nga sëmundjet fizike dhe shpirtërore! O Zot! Na bëj të mundur t'i shikojmë me syrin e zemrës mesazhet e Tuaj në Kuran dhe univers. O Zot! Na e bëj të mundur të mbërrijmë tek Ti me besim dhe vepra të mira!

Amin!...



"Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni."
(Hadid, 4)

TË JESH ME ALLAHUN

Kush është me Allahun nuk ndjen vetmi.

Njerëzit më të lumtur të botës janë besimtarët që në zemrat e tyre kanë dashurinë për Allahun.

"Çfarë humbi ai që të gjeti Ty? Çfarë gjeti ai që të humbi Ty?.." *(Ataullah el-Iskenderî)*

Kush është me Allahun nuk ndjen vetmi.

Poeti Nexhip Fazëll thotë:

"Nga se është i privuar ai person që në zemrën e tij ka Allahun?! Dhe çfarë zotëron ai që është i privuar nga dashuria e Allahut?!"

Zemra që është me Allahun, nuk pëson asnjë humbje; kurse zemra që është e shkujdesur, zbrazëtinë e saj nuk mund ta mbushë asgjë.

Ata që bëjnë një jetë larg Allahut, janë si një varrezë. Zemrat që bëjnë një jetë larg Allahut janë si një ndërtesë e rrënuar.

Sa bukur thotë Ataullah el- Iskenderi :

"Çfarë humbi ai që të gjeti Ty? Çfarë gjeti ai që të humbi Ty?.."

Musa efendiu thotë:

"Një person, preokupimi i të cilit është arritja e dashurisë së Allahut, ka fituar gjithçka. Kurse një person që është i shkujdesur, edhe sikur të zotërojë gjithë pasurinë e botës, ai prapë është i varfër dhe në humbje."

Nëse na jepet e gjithë pasuria e botës, por jemi të privuar nga dashuria e Allahut, atëherë asgjë nuk ka vlerë, sepse çdo pasuri e kësaj bote është e përkohshme. Kurse përfitimet që sjellë dashuria ndaj, Allahut është lumturi e përhershme!..

Njeriu i shkujdesur, është në humbje edhe sikur të jetë i pasur sa Sulejmani ﷺ. Njeriu i shkujdesur, është në humbje edhe nëse është i bukur si Jusufi ﷺ. Shpëtimi është vetëm përmes besimit dhe veprave të mira.

Njeriu, për nga natyra është i prirë të besojë. Çdo fëmijë lind me natyrën e pastër për të qenë mysliman. Prandaj, potencialin për të besuar e ka çdo njeri. Por, ky potencial është në subkoshiencë. Besimi konsiston në nxjerrjen në pah të këtij potenciali. Nëse nuk nxirret në nivelin e koshiencës, ai mbetet i fshehur në subkoshiencë. Një zemër që nuk e ka arritur imanin, është një zemër e shqetësuar dhe e trazuar. Një zemër e tillë, është e shqetësuar për të ardhmen dhe jetën pas vdekjes. Duke mos qenë në gjendje të gjejë kuptim, ajo zhytet në kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote.

Qetësia e përhershme e zemrës arrihet përmes besimit dhe veprave të mira. Për një zemër të qetë dhe një ndërgjegje të pastër, është i domosdoshëm besimi dhe vetëdija e mbikëqyrjes hyjnore. Ajeti kuranor e shpreh kështu arritjen e qetësisë dhe prehjes shpirtërore:

"Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!" (Rrad, 28.)

Shah Nakshibendi thotë:

"Thelbi i kësaj rruge është gjallërimi i zemrës. Kthimi me zemër tek Allahu dhe përmendja e Tij e shumtë."

Njerëzit më të lumtur nuk janë ata që i plotësojnë dëshirat në çdo moment, por besimtarët që në zemër kanë çdo moment dashurinë e Allahut.

Hasan el-Basri, shprehet:

"Nëse Allahu është me ty, nga kush frikësohesh? E nëse Allahu nuk është me ty, atëherë tek kush i mban shpresat dhe tek kush do të strehohesh?"

Lumturia më e madhe është kur zemra është e mbushur me dashurinë ndaj Allahut. Lumturia e vërtetë është gdhendja në zemër e dashurisë ndaj Allahut.

Ata që e harrojnë e Allahun, i Cili thotë se; "është më afër nesh se damari i qafës sonë", dhe e humbin Atë prej botës së tyre të zemrës, janë udhëtarët më të hutuar të kësaj jete!..

Një zemër që nuk e harron Allahun kur gëzon mirëqenie dhe rehati materiale e shpirtërore, do ta gjejë afër Allahun edhe kur të ndodhet në vështirësi.

Bota është një vend sprove. Për të ruajtur gjendjen, si në mirësi ashtu edhe në vështirësi, është kusht që zemra të jetë gjithmonë me Allahun. Kjo gjendje, është arti i zemrës.

Xheneti së pari jetohet në këtë botë, pastaj shfaqet në botën tjetër. Xheneti i kësaj bote konsiston në një zemër të qetë e të mbushur me dashuri ndaj Allahut.

Sa më shumë ta përmendim Allahun në këtë botë, aq më shumë do të kemi pranë mëshirën hyjnore në botën tjetër.

A do të jetë kjo botë xhenet apo xhehenem, varet nga niveli i dashurisë ndaj Allahut në zemrat tona.

Një zemër që është e mbushur me dashurinë e Allahut, është shenjë e suksesit në këtë botë sprovash.

Qëndrimi larg dhikrit, është një humbje e madhe në këtë botë të përkohshme. Në një hadith Profeti ﷺ, thotë:

"Banorët e xhenetit, nuk do të ndjejnë mall dhe pendim për asgjë tjetër përveç se për momentet që i kanë kaluar pa e përmendur Allahun në këtë botë!" (Hejthemi, X, 73-74)

Ne duhet ta mbrojmë gjuhën nga fjalët rëndomta dhe të pavlera. Gjuha duhet të zbukurohet me përmendjen e Allahut dhe me fjalë të bukura. Besimtarët të cilët shfaqën këtë mënyrë sjellje kanë shprehje të bukura për çdo rast:

- Besimtarët, ushqimin e fillojnë me emrin e Allahut dhe e mbarojnë me falënderim ndaj Tij,

- Kur takohen me përshëndeten me selam, kur ndahen luten për njëri-tjetrin,
- Kur janë në udhëtim bëjnë lutjen e udhëtimit,
- Kur janë duke qëndruar përmendin Allahun dhe i luten Atij,
- Besimtarët, të sapomartuarve u urojnë lumturi në familje,
- Në tregti i urojnë njërit tjetrit begati,
- Në sëmundje i urojnë dhe luten për shërim,
- Kur lind dikush e urojnë për mirësi në fëmijë,
- Kur vdes dikush luten që Allahu ta falë dhe ta përfshijë në Xhenet,

Besimtari duhet të predikojë besimin me gjuhë, mendim dhe moral.

Allahu thotë në Kuran:

"Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet." (Kaf, 16.)

Në ditën e gjykimit njeriu do të pyetet nga Zoti:

"Unë isha me ty po ti me kë ishe?!"

Sot, një besimtar duhet ta pyesë veten çdo moment:

Me kë je?

Me kë është bota e zemrës tënde, ndjenjat dhe mendimet e tua, morali dhe sjelljet e tua? Me të kujt ngjajnë ato?

Me kë jemi ne në veprimtaritë e ndryshme gjatë jetës së përditshme? Me kë jemi kur rrimë para televizorit apo internetit?

Për sa kohë që nuk i bëjmë këto llogari, nuk do të mund të ruhemi asnjëherë nga ndikimi i indiferencës dhe devijimit që sulmon nga të gjitha anët si radiacion.

Allahu thotë:

"Kur robërit e Mi (besimtarë) **të pyesin për Mua,** (thuaju se) **Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë."** (Bekare, 186.)

Në çfarë gjendje jemi ne, krahasuar me modelin shembullor të sahabëve?

Në çfarë gjendje është vetëdija jonë ndaj mbikëqyrjes së Allahut?

Sa e zbatojmë ne ajetin kuranor:

"Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne." (Sexhde, 16.)

Profeti ﷺ thotë:

"*Grada më e lartë e besimit, është vetëdija se Allahu është bashkë me ty kudo që të jesh.*" (Hejthemi, I, 60.)

Vigjilenca shpirtërore, intuita dhe urtësia arrihet vetëm përmes vetëdijes së plotë për mbikëqyrjen e plotë të Allahut mbi gjithçka.

Shah Nakshibendi thotë:

"Qëllimi i kësaj rruge është vetëdija e plotë për mbikëqyrjen e vazhdueshme të Allahut."

Shah Nakshibendi thotë:

"Udhëtari në këtë botë, edhe rrugët që duken të zbrazura dhe pa asnjë një njeri, duhet t'i konsiderojë sikur janë plot me njerëz. Udhëtari, në këtë rrugë sillet në të njëjtën mënyrë edhe kur është vetëm edhe kur është me njerëz..."

Njeriu mund t'i fsheh mendimet dhe ndjenjat nga njerëzit e tjerë, por ai nuk mund t'i fsheh ato nga Allahu. Të gjitha janë brenda diturisë së Allahut. Ajeti kuranor thotë:

"O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyn midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!" (Enfal, 24.)

"Allahu e di shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra." (Gafir, 19.)

Njerëzit mund të qëndrojnë në rrugën e drejtë në vende të shkreta ku nuk ka njeri. Madje, mund të ruhen edhe prej gjynaheve kur janë larg syve të njerëzve... Por, vetëm atëherë kur brenda tyre ekziston vetëdija: "Allahu më sheh në çdo kohë dhe në çdo vend!"

Çdo moment duhet ta kalojmë në gjendje dhikri, sepse gjynahet eprohen kur harrohet Allahu.

Kur harrohet Zoti, njeriu bëhet më i egër se çdo krijesë tjetër. Por, kur në zemrën e njeriut është Zoti, atëherë ai bëhet krijesa më e nderuar në univers.

Të gjitha humbjet materiale dhe shpirtërore janë si pasojë e harresës së Allahut. Allahu thotë:

"Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut)." (Hashr, 19.)

Të gjitha gjynahet realizohen kur harrohet Zoti. Kur në zemrën e njeriut gjendet besimi në Zot dhe në botën tjetër, ai përpiqet të jetë i kujdesshëm në sjellje dhe moral. Kështu, besimtari përpiqet të bëjë një jetë pa zemëruar dhe thyer asnjë zemër.

Ritet kryhen në një kohë të caktuar. Kurse besimi nënkupton që zemra të jetë vazhdimisht me Allahun. Në këtë pikëpamje, ibadeti nuk është i lidhur me kohën. Ne nuk duhet ta harrojmë Allahun në asnjë mënyrë.

Allahu thotë në Kuran:

"O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe, që të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!" (Infitar, 6-8.)

Ibadeti i vërtetë është të jetosh vazhdimisht me vetëdijen e mbikëqyrjes hyjnore...

Është fatkeqësi e madhe të mbushet zemra me gjëra të kota në dobi të babëzisë së egos. Kjo i ngjason mbushjes me plehra të një arke për gurë të çmuar.

Sa i pafat është një gurë i çmuar i hedhur në plehra. Është shumë e dhimbshme të mbushësh zemrën me dëshira miskine.

Njeriu është krijuar me aftësinë për të krijuar miqësi me Allahun. Të jepesh pas dëshirave dhe kënaqësive të përkohshme në vend të shpërblimit të jashtëzakonshëm që vjen nga miqësia me Allahun, është një veprim që nuk i ka hije besimtarit. Tregtia më fitimprurëse në këtë botë është besimi dhe veprat e mira.

Besimtari duhet ta pastrojë zemrën nga gjërat e kota dhe ta mbushë atë me dashurinë për Allahun. Imam Shafiu thotë:

"Zemra që nuk angazhohet me të drejtën, e pushton e kota."

Ashtu si një vend nuk është i qetë kur është i pushtuar nga armiku, ashtu edhe zemra nuk është e qetë kur pushtohet nga dëshira të ulëta.

Sa e trishtë është të zvarritesh pas kënaqësive të egos në këtë botë, kur mund të zotërosh një thesar të mrekullueshëm lumturie, siç është afrimi me devotshmëri ndaj Krijuesit Fuqiplotë!

Allahu na ka pajisur me aftësi për të njohur Atë dhe për të fituar dashurinë e Tij. Ai na ka krijuar në mënyrë të përsosur dhe na ka dhuruar mirësi pafund. Ai na ka dërguar Profetin ﷺ, për të na udhëzuar në rrugën e drejtë. Të gjitha këto mirësi janë dhuratë prej Allahut.

Allahu ka përgatitur Xhenetin për besimtarët. Por, fitimi i tij është i varur nga një zemër e mbushur me dashurinë për Allahun.

Ibrahimi عليه السلام, e pastroi zemrën nga të gjitha angazhimet e kësaj bote. Ai pranoi të digjet në zjarr për të ruajtur besimin e pastër monoteist. Ai ishte i gatshëm të sakrifikonte gjithçka të kësaj bote për një moment dhikër. Ai ishte i gatshëm të sakrifikonte djalin e tij të dashur Ismailin për hir të dashurisë ndaj Allahut. Për shkak të kësaj gjendje të tij, Allahu e quajti atë mik.

Rumiu thotë:

"O udhëtar i së vërtetës! Lidhe miqësinë me mbretin e të vërtetës (Zotin tënd), para se të vijë dita e gjykimit, me qëllim që në ato momente të vështira, të të mbajë për dore, sepse askush nuk të ndihmon dot pa lejen e Tij. Atë ditë njeriu do të largohet nga vëllai, nëna, babai, njerëzit e afërm dhe fëmijët e tij. Prandaj kuptoje drejt miqësinë me Zotin dhe dije se miqësia e ngushtë është thelbi i frymës së fundit."

Krijimi i miqësisë me Allahun është i mundur duke pastruar zemrën nga dëshirat e rëndomta. Ata që bëhen miq me dëshirat e veta privohen nga dashuria e Allahut.

Njohje e Allahut, do të thotë të mos e harrosh kurrë Atë. Mirëpo ne, duke u dhënë pas fitimit dhe pasurisë, harrojmë Sunduesin dhe Zotëruesin e gjithçkaje..!

Indiferencë, do të thotë të shkatërrosh lumturinë e përjetshme për kënaqësi çasti; marrëzia e preferimit të jetës kalimtare të kësaj bote ndaj jetës së pafundme të xhenetit.

Gafleti/indiferenca, i ngjan personit që ka humbur diellin në mesin e ditës. Një person i rënë në gaflet i ngjan anijes së cilës i është thyer timoni në mesin e oqeanit dhe nuk i dihet se në cilën vorbull do të mbytet.

Gaflet, është vendosja e një perdeje ndërmjet të vërtetës dhe zemrës. Do të thotë të vraposh në mënyrë të shkujdesur në një fushë të minuar; të shëtisësh pa vëmendje në buzë të humnerës. Shprehur sipas Rumiut, gaflet, është dashuria e deles ndaj ujkut.

Shah Nakshibendi thotë:

"Dhikr, do të thotë të pastrohesh nga gafleti. Kur pastrohesh nga gafleti, konsiderohesh në gjendje dhikri, edhe nëse je në heshtje."

Shumë njerëz sot e kërkojnë lumturinë në vende të gabuara. Shumë njerëz shpresojnë të gjejnë lumturinë dhe kënaqësinë shpirtërore në meditacion dhe joga. Fatkeqësisht, këto nuk ofrojnë asgjë për qetësinë e shpirtit; ato ofrojnë vetëm një qetësi të përkohshme...

Për një besimtar, burimi i lumturisë në këtë botë dhe botën tjetër, është besimi dhe veprat e mira. Nuk duhet të harrojmë se; Islami është i përsosur, dhe si i tillë, nuk ka nevojë për asnjë tentativë përmirësuese.

Një nga faktorët që shkakton dënimin e Allahut është dhënia e njeriut pas gjëra të përkohshme duke i kthyer shpinën hyjnores. Nuk ka mosmirënjohje më të rëndë se të kërkosh dhe shpresosh mirësi nga dyer të tjera duke harruar Furnizuesin e vërtetë.

Allahu thotë në Kuran:

"Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t'ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke Mu bindur) **e mos i mohoni dhuntitë e Mia** (me mosbindje)**!"** (Bekare, 152.)

Njeriu vazhdimisht duhet ta falënderojë Zotin (xh.xh.), kundrejt gjithë këtyre mirësive hyjnore. Por;

Zgjedhja i përket njeriut! Nëse dëshiron, mund të zgjedhë xhenetin; nëse dëshiron, mund të zgjedhë xhehenemin!.. Vetëm se njeriu, nuk ka mundësi ta durojë zjarrin, qoftë edhe për një moment. Për këtë arsye, Allahu Teala është limani i vetëm i vërtetë te i Cili mund të strehohemi, mund të kërkojmë mbrojtje, mund të mbështetemi dhe mund të marrim ndihmë!..

Allahu thotë në Kuran:

"Vraponi për tek Allahu..." (Dharijat, 50.)

Njeriu duhet të mbështet, strehohet dhe të kërkojë ndihmë tek Allahu në çdo etapë të jetës dhe në çdo situatë.

Kështu, kur Ibn Abbasi ﷺ, komentoi ajetin:

"O ju që keni besuar! Përkujtojeni shumë Allahun!" (Ahzab, 41.), tha:

"Allahu Teala, çdo adhurimi, që ua ka bërë farz njerëzve, i ka caktuar një kufi. Në këtë çështje, i ka pranuar edhe arsyetimet e atyre që s'kanë mundësi. Por, dhikri bën përjashtim. Për dhikrin, Allahu Teala nuk ka caktuar ndonjë kufi, fundi i të cilit mund të arrihet. Prandaj, askujt nuk ia pranon as arsyetimin e lënies së dhikrit, përveç atij që është me të meta mendore. Allahu i ka urdhëruar njerëzit që ta përkujtojnë në çdo lloj mënyre." (Taberi, Xhamiu'l-Beyan an Te'vili Aji'l-Kuran, Bejrut 1995, XXII, 22; Kurtubi, XIV, 197.)

Bistamiu thotë:

"Dhikri nuk vlerësohet me sasi por me cilësi."

Rumiu thotë:

"Dhikri i vërtetë, vë në lëvizje mendimin. Dhikri i jep diell mendimit të ngrirë."

"Dhikri që bëhet vetëm me gojë, me gjuhë, pa ndjerë e pa menduar, është thjeshtë përsëritje e mangët. Ndërsa dhikri, i cili bëhet me gjithë zemër dhe përulje, është i dëlirë nga fjalët... O ti që mjaftohesh vetëm me emrin e Tij, pa e gjetur Atë! Si mund të shpëtoni nga dëshirat e egos pa pirë nga burimi i miqësisë me Zotin?»

Dhikri nuk është një artikulim numerik i shprehjeve të caktuara. Por në kuptimin e vërtetë, dhikri është një meditim dhe përsiatje e thellë mbi madhështinë hyjnore, duke pastruar nga zemra çdo gjë që të largon prej Allahut. Pra, që zemra të jetë gjithmonë me Allahun.

"Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoju krejtësisht Atij!" (Muzemmil, 8.)

Dhikri nuk është thjeshtë përsëritje e fjalës Allah. Dhikri konsiston në kujtimin e Allahut dhe madhështisë së Tij në çdo gjë që shikon syri dhe ndjen zemra. Dhikr, do të thotë të shikosh madhështinë hyjnore në krijimin e Allahut.

Dhikr, do të thotë të thellohesh në meditim kur shikon diellin dhe hënën, të cilët lëvizin sipas trajektores së tyre të përcaktuar pa devijuar asnjë milimetër. Dhikri është meditimi mbi fenomenet dhe ekuilibrat natyror duke falënderuar Krijuesin dhe Formëdhënësin e tyre.

Një zemër që nuk e harron Allahun dhe thellohet në shfaqjet e madhështisë së Allahut në Kuran dhe univers, është një zemër që ka arritur dhikrin e vërtetë.

Ta përmendësh Allahun, pa dyshim që nuk do të thotë vetëm të përsërisësh fjalën "Allah". Vetëm atëherë kur dhikri (përmendja) zë vend në qendrën e aftësisë së ndjenjave, që është zemra, ai bëhet faktor i ngritjes së nivelit të qëllimeve dhe veprave tona.

Dhikri është tre nivele:

1. Gjuha bën dhikër kurse zemra është indiferente.
2. Gjuha dhe zemra bëjnë dhikër njëkohësisht.
3. Gjuha, zemra dhe çdo pjesë e trupit është në gjendje dhikri.

Drita e dhikrit është sipas gjendjes së personit. Për një dhikër të pranuar, duhet një distancim i plotë prej harameve dhe të dyshimtave. Personi duhet të pastrojë zemrën nga çdo angazhim i kësaj bote dhe nga çdo dëshirë egoiste.

Besimtarët, në çdo situatë të jetës janë në gjendje dhikri. Qëndrimi larg dhikrit dhe lutjes, është shenjë e largësisë ndaj Allahut. Hasan Basriu thotë:

"Nuk frikësohem se nuk do t'u pranohen lutjet. Por frikësohem se nga indiferenca, nuk do të jeni në gjendje të bëni lutje!.."

Kur e pyeten Xhafer Sadikun ﷺ, se; përse nuk na pranohen lutjet, ai u përgjigj:

"Sepse ju i luteni një Zoti që nuk e njihni!

Pra ju jeni larg një adhurimi të denjë për të, larg devotshmërisë, larg përmendjes dhe larg njohjes si duhet të Zotit. Ky është shkaku që nuk ju pranohen lutjet..."

Veprimi më i vogël që bëhet me zemër, është më i vlefshëm se veprat e pasinqerta që duken sa një mal. Dhe, manifestimi më i rëndësishëm i kësaj, e tregon veten në dashurinë për Allahun,

që është edhe niveli më i lartë i dashurisë. Megjithatë, ashtu si për çdo gjë tjetër, edhe krijuesi i dashurisë, është Vet Allahu i Madhëruar. Pra, nëse nuk do Ai, robi nuk mund të ngrihet në këtë gradë. Prandaj, ajo që i takon robit në këtë çështje, është të vazhdojë t'i lutet Allahut dhe të strehohet tek Ai.

Një besimtar që ka arritur përsosmërinë morale, arrin edhe majat e vetëdijes së afërsisë me Allahun. Ai e ndjen veten gjithmonë në audiencën e Allahut dhe nën kamerat hyjnore. Ai është gjithmonë në udhëtim, nga besimi në mirësi.

Çdo vepër e mirë dhe e sinqertë që bëhet sikur je duke e parë Allahun, lëshon filiza në degët e sinqeritetit, çel lulet e devotshmërisë dhe pjek frutat e frikë-respektit ndaj Allahut.

Për robërit që shijojnë ëmbëlsinë e dashurisë hyjnore, duke arritur të vërtetën e dhikrit, të gjitha gjërat e kësaj bote e humbasin vlerën e tyre. Për rrjedhojë, Ibrahim bin Et'hemi, i cili i la mënjanë mirësitë e kësaj bote dhe u zhyt në detin e dashurisë hyjnore, thotë:

"Nëse pasioni dhe zhytja jonë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka materiale, mbretërit do të sakrifikonin të gjithë mbretërinë dhe thesaret e tyre për ta marrë atë."

Ashtu si një fëmijë i porsalindur, i cili në fillim ushqehet vetëm me qumështin e nënës dhe me kalimin e kohës fillon të shijojë dhe provojë ushqime të tjera të ndryshme, e njëjta gjë ndodh edhe në jetën shpirtërore. Njerëzit e rëndomtë i konsiderojnë si

thelbësore kënaqësitë materiale. Kurse tek njerëzit e urtë; shijet, pikëpamjet dhe vizioni i tyre fiton thellësi dhe larmishmëri ndërkohë që përparojnë në rrugëtimin e tyre shpirtëror. Kështu, të gjitha mirësitë materiale, shndërrohen në gjëra të pavlera për ta; tashmë ato duken si lodra fëmijësh në sytë e tyre. Dhe kjo, sepse kënaqësia më e madhe për ta, është dashuria ndaj Allahut dhe takimi me Të.

Ai që bëhet rob i devotshëm i Allahut, shpëton nga robëria ndaj krijesave të Tij dhe fiton lirinë e vërtetë. Në të kundërt, njeriu nuk mund të shpëtojë nga të qenit skllav i tiranëve, peng i pasurisë dhe rob i dëshirave të egos. Dhe, shpagesa e vetme për shpëtimin nga këto lloj robërish, është lidhja me Allahun Tealа dhe dorëzimi ndaj urdhrave të Tij. Për besimtarin, në jetën e kësaj bote nuk ka tregti më fitimprurëse se kjo, sepse vetëm ai që ia shet veten Allahut, pra që heq dorë nga dëshirat dhe epshet e egos dhe i dorëzohet plotësisht urdhrave të Allahut, ka dobi nga kjo botë. Në të kundërtën, ai që lidhet fort me këtë botë, privohet nga kënaqësia e Allahut.

Ebu Bekri ﷺ, thotë:

"Midis Allahut dhe krijesave të Tij nuk ka asnjë lidhje familjare. Afërsia me Allahun është e mundur vetëm me bindjen ndaj urdhrave të Tij."

Allahu në Kuran thotë:

"Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë." (Huxhurat, 13.)

Rumiu thotë:

"Lutja dhe ibadeti është të jesh gjithmonë me Allahun. Jeta dhe vdekja e një personi që është gjithmonë me Allahun është e bukur. Por jeta e një personi që nuk ka në zemër dashurinë e Allahut është ferr."

Për ata që janë pavetëdijshëm ndaj Allahut dhe përplasen nga erërat e fatit në shirësen e jetës, nuk qan as bota që lënë pas, e nuk qesh as bota tjetër që u del përballë e i pret...



KURANI FAMËLARTË

Ashtu sikurse qiejt që do të qëndrojnë me yjet si një fuqi mbretërore deri në ditën e gjykimit, ashtu edhe Kurani me yjet e Tij, ajetet, do të ndriçojë si qielli i të ardhmes së njerëzimit dhe do të jetojë deri në ditën e gjykimit. Kjo është edhe arsyeja që njerëzit më me vlerë të gjithësisë janë ato që mblidhen nën hijen e Kuranit dhe ushqehen me dritën e jetës së tij.

Rumiu thotë:

"Para se të lexosh ajetet e Kuranit Fisnik dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut ﷺ, rregullo veten! Nëse nuk arrin ta ndjesh aromën e trëndafilave në kopshtin e trëndafilave, mos e kërko fajin tek kopshti, por në zemrën dhe hundën tënde!.."

Kurani Fisnik është një litar i fortë, njëra anë e të cilit gjendet në dorën e plotfuqishme të Allahut, ndërsa ana tjetër na është zgjatur neve. Rruga për t'u afruar me Allahun është të kapesh fort pas tij.



Kurani është mesazhi dhe ftesa e fundit hyjnore që i dërgohet njerëzve që arsyetojnë dhe mendojnë.



Një nga mirësitë më të mëdha që Allahu i ka dhuruar njerëzimit është Kurani Fisnik.



Ebu'l-Hasan Harakani, thotë:

"Çfarëdo që të jetë ajo që e udhëzon robin drejt Allahun e Madhëruar, më e bukura prej tyre, është Kurani Fisnik. Pra, Allahun e Madhëruar, duhet ta kërkoni në rrugën e Kuranit." (Hadaiku'l-Uerdije, fq. 458.)



Kurani është themeli i besimit të vërtetë dhe kulturës fetare. Një ndërtesë pa themel të fortë, është e destinuar të shembet.



Allahu thotë në Kuran:

"I Gjithëmëshirshmi, ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij)**, ka krijuar njeriun, dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë**."
(Rrahman, 1-4.)

Njeriu mund ta gjejë lumturinë dhe qetësinë vetëm duke jetuar sipas Kuranit. Njeriu mund ta arrijë gradën e lartë shpirtërore vetëm duke zbatuar mësimet kuranore. Përmes Kuranit, urtësitë dhe mesazhet bëhen të dukshme. Njeriu arrin gjendjen e përsosur në raport të drejtë me përkushtimin ndaj Kuranit.



Ashtu sikurse qiejt që do të qëndrojnë bashkë me yjet si një fuqi mbretërore deri në ditën e kiametit, ashtu edhe Kurani me yjet, ajetet e Tij, do të ndriçojnë qiellin e së ardhmes së njerëzimit dhe do të jetojë deri në ditën e kiametit. Kjo është edhe arsyeja që njerëzit më me vlerë të gjithësisë, janë ata që mblidhen nën hijen e Kuranit dhe ushqehen me dritën e jetës së tij.



Kurani është i vetmi libër që kënaq mendjen dhe zemrën; ai është i vetmi libër që i siguron njeriut nxjerrjen nga errësira në dritë.



Rumiu thotë:

"Fjalët e Kuranit Fisnik, mund të shkruhen edhe me një shishe bojë. Por për të shprehur të gjitha misteret që përmban ai, nuk do të mjaftonte edhe sikur të kishim gjithë detet e paanë si bojë dhe të gjitha pemët e tokës si lapsa."

Meditimi i vërtetë fillon në pikën ku takohen mendja dhe zemra e frymëzuar me shpalljen.



Pa frymëzimin dhe udhëzimin e pashtershëm të Kuranit, bota jonë e mendimeve dhe e ndjenjave do të ishte shumë e varfër.



Brenda njeriut gjenden dy pole të kundërta; njëri urdhëron për të mirë e devotshmëri dhe tjetri për të keqe e kryeneçësi. Çdokush jeton duke udhëtuar midis përplasjeve të këtyre dy poleve të kundërta. I nderuari Mevlana, thotë:

"O udhëtari i së vërtetës! Nëse dëshiron të mësosh të vërtetën, dije se; as Musai dhe as Faraoni nuk kanë vdekur. Ata jetojnë brenda teje dhe vazhdojnë luftën e tyre në shpirtin tënd!"



Kultura e vërtetë dhe informacioni i domosdoshëm që mund të kultivojmë në vete, por edhe te fëmijët tanë, është pikërisht kjo; Kurani mbush me dritë të dyja botët. Ai i kultivon në mënyrën më të bukur ato.

Të gjitha kulturat dhe dituritë e kësaj bote lidhen thjeshtë me këtë botë. Ato janë disa thërrime të një diturie të vogël që Allahu i Lartmadhëruar i ka dhënë njeriut në lidhje me jetën e kësaj bote. Dedikimi i njeriut tërë jetën vetëm këtyre diturive, përfshirja e tij me tepri në to deri në harrimin e Zotit dhe të vërtetave të përjetshme, do të thotë që ai po shkatërron dhe kthen në rrënojë ahiretin e tij. Ky është edhe fundi i trishtë i indiferenteve.



Rumiu ka thënë:

"*Nëse toka do të armiqësohej me qiellin, atëherë ajo do shkretohej dhe do të vdiste.*"

Njeriu duhet ta dijë mirë për kë ka nevojë, dhe pikërisht prej Tij duhet të kërkojë ndihmë. Nëse njeriu i lexon dhe i dëgjon mesazhet hyjnore dhe nëse e përdor intelektin dhe mendjen e tij brenda kontureve të shpalljes, atëherë ai realizon meditimin dhe reflektimin më të mirë dhe më të domosdoshëm të mundshëm.



Si shumë mirësi, edhe mendja është si një thikë me dy tehe, e cila mund të përdoret për mirë dhe për keq. Shejtani kundërshtoi urdhrin e Allahut si rezultat i arsyetimit që bëri. Për pasojë, ai u dëbua nga xheneti dhe mori mbi vetë mallkimin hyjnor. Prandaj, që mendja të luaj rolin e saj të një faktori që e udhëzon njeriun për mirë, duhet me patjetër të kalojë përmes edukimit të shpalljes hyjnore.



Për të kuptuar fenë, nuk mjafton vetëm mendja, prandaj Allahu ka dërguar profetët dhe librat hyjnorë. Profetët, ngaqë kanë qenë të mbështetur nga shpallja hyjnore, kanë miratuar njëri-tjetrin. Kurse filozofët, të cilët kanë qenë larg shpalljes hyjnore dhe të mbështetur vetëm në arsye, gjithmonë kanë kundërshtuar dhe mohuar njëri-tjetrin. Profetët e kanë predikuar të vërtetën nën dritën hyjnore. Kurse filozofia, e cila bazohet vetëm në arsye, nuk ka arritur t'i sigurojë lumturinë njeriut.



I pari që mbajti një qëndrim kundër urdhrit hyjnor ishte she-

jtani. Edhe sot ka nga ata që kundërshtojnë udhëzimet hyjnore në Kuran. Ka prej tyre që nën maskën e arsyes gjykojnë sipas dëshirave dhe thonë se; një pjesë e ajeteve janë të kufizuar në kohë dhe hapësirë. Madje, një pjesë e mirë e tyre i kanë marrë këto mendime nga orientalistët armiq të Islamit. Prandaj, kjo nuk është gjë tjetër përveç se një devijim dhe shthurje totale.

Mosbindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ dhe përpjeka për ta kritikuar Kuranin dhe Sunetin, nuk përputhet me asnjë anë të karakterit të myslimanit. Në lidhje me këtë, Allahu thotë në Kuran në formë qortimi:

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!" (Muhammed, 33.)

Indiferentët që nuk hyjnë në botën kuptimore të Kuranit, njohin vetëm pjesën sipërfaqësore të jetës dhe janë krejtësisht të privuar nga urtësitë dhe të vërtetat e botës shpirtërore. Ata gjatë gjithë jetës vrapojnë pas plotësimit të dëshirave por harrojnë qëllimin kryesor për të cilin janë krijuar. Ata përfitojnë në mënyrë të shfrenuar nga mirësitë e Allahut në tokë, por harrojnë Krijuesin e mirësive. Madje, edhe kur u vijnë sprova, si paralajmërime hyjnore, ata nuk nxjerrin mësim, por i konsiderojnë ato thjesht si dukuri natyrore. Ata jetojnë në pronën e Allahut dhe fatkeqësisht sillen armiqësisht me Të.

Jeta larg Kuranit, është një vetëvrasje e përjetshme.

Sa bukur e shpreh një i urtë faktin se Kurani Fisnik është shkak për një fisnikëri dhe nder madhështor:

"Xhebraili ﷺ, zbriti Kuranin. Si rrjedhojë, ai u bë meleku më i virtytshëm.

Kurani i zbriti Muhamedit ﷺ. Si rrjedhojë, ai u bë më i nderuari i të gjithë të dërguarve.

Kurani i erdhi umetit të Muhamedit. Si rrjedhojë ky umet u bë umeti më i mirë.

Kurani zbriti në muajin e Ramazanit. Si rrjedhojë ai muaj u bë muaji më i mirë.

Kurani zbriti në Natën e Kadrit. Si rrjedhojë ajo natë u bë nata më e mirë dhe më e virtytshme. Ajo u bë më e mirë se një mijë muaj në të cilta nuk gjendet Nata e Kadrit.

Nëse Kurani zbret në zemrën dhe jetën tënde, bëhesh më i miri prej njerëzve. Bëhesh një "njeri i mëshirës" nga dora, gjuha dhe zemra e të cilit përhapet vetëm mëshirë."

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

"Padyshim që ka prej njerëzve, të cilët janë të afërt me Allahun!"

Sahabët fisnikë e pyetën:

"O i Dërguar i Allahut! Kush janë ata?"

Profeti ﷺ, u përgjigj:

"Ata janë zotëruesit e Kuranit dhe robërit e mirë të Allahut!"

(Ibn Maxhe, Mukaddime, 16.)

Për t'u konsideruar ndjekës i Kuranit, duhet që zemrat t'i zbukurojmë me Kuran dhe sjelljet të jenë një Kurani i gjallë. Gjithashtu, është e domosdoshme të përhapim dhe predikojmë mësimet e Kuranit.



"Vetëm dy persona mund të kihen zili: Njëri është ai të cilit Allahu Teala i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon në rrugë të Tij. Ndërsa tjetri, është ai të cilit Allahu Teala i ka dhënë dituri dhe ai përveçse punon me të, ua mëson edhe të tjerëve." (Buhari, Ilm, 5.)



Njerëzit më të mirë në sipërfaqen e tokës janë ata që jetojnë nën hijen e Kuranit dhe të cilët e ndriçojnë jetën me dritën kuranore; pra, ata që me sjelljet e tyre arrijnë të bëhen një Kuran i gjallë. Puna për t'u bërë një Kurani i gjallë fillon duke e mësuar dhe jetuar atë.



Profeti ﷺ, thotë:

"Më i mirë prej jush është ai që mëson Kuranin dhe ia mëson atë të tjerëve." (Buhari, Fedailul Kuran, 21.)



Kurani duhet të jetë kriteri për të vlerësuar jetën tonë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të mjaftohemi thjesht me leximin e tij por duhet që mësimet e tij t'i pasqyrojmë në jetë dhe sjellje.



Abdullah ibn Mes'ud thotë:

"Kurani ka zbritur që të veprohet sipas tij kurse njerëzit veprim konsiderojnë thjesht leximin e tij..." (Shih. Serahsi, Mebsut, I, 200, Bejrut,1331.)



Për të arritur mirësinë nuk mjafton thjeshtë të lexojmë Kuranin. Thelbësore është që; ajeti i lexuar, të aplikohet në jetën e përditshme.



Ashtu siç memorizohet në mendje, Kurani duhet të ruhet edhe në zemër. Vetëm në këtë mënyrë ai pasqyrohet në sjellje.



Mësimi i Kurani kalon nëpër tri faza:

1. Faza e parë, është mësimi i shkronjave dhe shqiptimi i saktë i tyre. Kjo na bën të mundur të lexojmë Kuranin dhe të fitojmë sevape nga leximi. Namazi në të cilin nuk lexohet Kuran, nuk është i vlefshëm.
2. Faza e dytë, është respektimi i urdhëresave dhe ndalesave hyjnore.
3. Faza e tretë, është zbukurimi i moralit me moralin Kuranor.



Kurani duhet lexuar sipas rregullave, duke kuptuar domethëniet e tij dhe duke zbatuar me përpikëri mësimet hyjnore.

Siç do të shprehej edhe vetë Gazaliu: *"Gjuha duhet të lexojë. Mendja me urtësinë e saj duhet të përkthejë dhe të meditojë.*

Ndërsa zemra, duhet të përvetësojë dhe të marrë mësim." (Shih. Ihja'u-Ulumi'd-Din, I, 816.)

Allahu thotë në Kuran:

"Po, kështu është! Ndërsa kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij." (Haxh, 32.)

Prandaj Kurani, Ezani, xhamia dhe Qabja janë shenja të Allahut në tokë. Respekti ndaj këtyre nuk duhet neglizhuar për asnjë moment.

Myslimani duhet të tregojë vëmendje gjatë leximit të Kuranit. Duhet të ketë respekt për mësimet që jep ai, nuk duhet ta prekë pa abdes, nuk duhet të vendosë gjëra të tjera mbi të dhe nuk duhet të hyhet në banjë me të. Pra, ne duhet të tregojmë gjithë respektin e mundshëm ndaj tij. Po ashtu, këtë respekt ndaj Kuranit, duhet ta kultivojmë edhe tek brezat pasardhës, sepse të gjitha këto ,janë shenjë e devotshmërisë në zemër.

Kurani duhet prekur dhe hapur me respekt, ai duhet të lexohet me vetëdijen e plotë se gjatë leximit të tij zbret mëshira e Allahut.

Allahu thotë:

"I **Gjithëmëshirshmi, ua ka mësuar Kuranin** (robërve të Tij)" (Rrahman, 1-2.)

"Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni." (Araf, 204.)

Për të fituar mëshirën hyjnore, duhet t'i afrohesh Kuranit me edukatë, ta dëgjosh me përkushtim dhe ta zbatosh me përpikëri.

Nuk duhet të harrojmë se; nuk mjafton vetëm të dëgjosh zërin e Kuranit dhe t'i hedhësh një sy hartës së të vërtetave, por është i domosdoshëm zbatimi me përpikëri i urdhrave të shenjtë që tregojnë rrugët e shpëtimit të jetës tjetër. Kjo, sepse besimtari është ai që hyn në një luftë shpirtërore të fortë me atmosferën e Kuranit kundra mësymjeve armiqësore.

Osmani ﷺ, thotë:

"Sikur të kishit zemrat e pastra, nuk do të ngopeshit me fjalën e Allahut." (Ali el-Muttaki, II, 287/4022.)

Kur merr abdes, besimtari e pastron gojën, duke e përgatitur atë për leximin e Kuranit Fisnik dhe përmendjen e Allahut të Madhëruar. Në të njëjtën mënyrë, me anë të pendimit, kërkimit të faljes dhe lotëve, ai duhet ta lajë atë edhe nga gënjeshtrat, përgojimi, shpifja dhe vese të tjera të këqija, duke e nënshtruar zemrën ndaj një pastrimi shpirtëror. Kjo, sepse në të vërtetë, Kurani Fisnik lexohet me zemër. Prej një leximi që nuk bëhet me zemër të pastër, nuk mund të merret një frymëzim shpirtëron në kuptimin e plotë të fjalës.

Rumiu thotë: *"Para se të lexosh ajetet e Kuranit Fisnik dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut ﷺ, rregullo veten! Nëse nuk arrin ta ndjesh aromën e trëndafilave në kopshtin e trëndafilave, mos e kërko fajin tek kopshti, por në zemrën dhe hundën tënde!.."*

Në Kuran, Allahu na e sqaron kështu gjendje e atyre që përfitojnë nga Kurani:

"Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit ﷺ)**. Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes** (duke bërë vepra të ndaluara)**, disa janë në rrugë të mesme** (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat)**, ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe."** (Fatir, 32.)

Ummeti më i zgjedhur është umeti i Muhamedit ﷺ dhe më i nderuari midis tyre është besimtari që lexon Kuranin, e mëson atë dhe vepron sipas tij.

Një pjesë e njerëzve i bëjnë padrejtësi vetes duke mos vepruar sipas tij, megjithëse e lexojnë dhe e mësojnë atë. Dhe ky është një shpërdorim i madh.

Disa të tjerë janë në rrugë të mesme, dhe nganjëherë veprojnë sipas mësimeve të tij, e nganjëherë e neglizhojnë atë.

Kurse një pjesë tjetër përparojnë në bamirësi të ndryshme. Këta do të jenë njerëzit më të fituar në ditën e gjykimit.

Edhe pse të gjithë lexojnë Kuran para së njëjtës rahle, gjithsecili përfiton prej Kuranit sipas nivelit shpirtëror që zotëron. Kuptimet e Kuranit, i shpalosen robit aq sa ai është i afërt me Allahun. Urtësitë dhe misteret e Kuranit janë të thella si një oqean dhe gjithkush mund të përfitojë prej tij sipas thellësisë së shpirtit të vet. Nëse thellësia e shpirtit të dikujt është sa gishtëza e rrobaqepësit, aq do të përfitojë edhe ai nga oqeani i paanë e pafund.

Allahu thotë në Kuran:

"Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje." (Isra, 82.)



Në lidhje me përfitimin prej Kuranit, Rumiu thotë:

"Dielli është afër, edhe për degën e tharë, por edhe për degën e njomë. Koha kalon, e nga afërsia e diellit me degën e njomë dhe të freskët, dalin fruta të dashura, të shijshme, të pjekura e të bukura. Po nga dega e tharë, edhe pse e prekur nga dielli njëlloj, a buron diçka tjetër veç thellimit të tharjes?"

Në një hadith profetik thuhet:

"Më i keqi i njerëzve, është i shthururi guximtar; ai që e lexon librin e Allahut por nuk përfiton prej tij" (Ahmed, III , 37, 41.)



Kurani është si një tokë e cila sapo ta gërmosh fillon e nxjerr thesare. Mjafton që zemra dhe mendja të jenë të gatshme dhe të hapura.



Aliu ﷺ, thotë:

"Adhurimit pa dije dhe leximit të Kuranit pa medituar, i pakësohet dobia dhe frymëzimi."



Prej dritës se Kuranit mund të përfitojnë vetëm zemrat e hapura dhe pa paragjykime, zemrat të cila janë mbrujtur me dashuri dhe mirësi. Kurse zemrat e ngurta nuk përfitojnë edhe

sikur mbi to të bien pika eliksiri. Ato janë si një shkëmb i fortë mbi të cilin nuk mbin asgjë edhe pse bie shumë shi...



Rumiu thotë:

"Kurani shpreh gjendjen dhe cilësitë e Profetëve. Nëse e lexon dhe e zbaton atë, konsideroje veten se je takuar me profetët. Nëse e lexon, por nuk e zbaton, atëherë çfarë dobie mund të kesh nga takimi me profetët?... Ata që e kuptojnë më mirë Kuranin, janë ata që e jetojnë atë."



Personat që e kuptojnë më mirë Kuranin janë personat që janë më afër Allahut me devotshmëri. Prandaj, për të përfituar nga Kurani, dhe për rrjedhojë, për të arritur lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër, është e domosdoshme devotshmëria.



Sahabët e konsideronin zbritjen e një ajeti si një sofër e zbritur nga qielli. Me këtë vetëdije, ata përfitonin shumë prej Kuranit. Po vetëdija jonë në krahasim me të atyre si është?

Kur një nga sahabët shkonte në shtëpi, gruaja e tij e pyeste menjëherë për këto dy gjëra:

1- Sa ajete të Kuranit u zbritën sot?

2- Sa hadithe të Profetit ﷺ, mësove përmendsh?" (Abdulhamid Keshk, Fi Rihabi't-Tefsir, I, 26)



Ne duhet të pyesim veten:

- Në çfarë gjendje është afrimiteti ynë me Kuranin?

- Sa horizont na hapin të vërtetat hyjnore? Me sa thellësi shpirtërore mund t'i lexojmë ne ato?

- A është interesi ynë ndaj Kuranit, letrës që na ka dërguar Krijuesi i Madhëruar që ka krijuar çdo gjë nga asgjëja, në mënyrë të pakrahasueshme më i madh se ndaj letrave që na vijnë nga njerëzit? Sa e lexojmë dhe sa mundohemi t'i kuptojmë urtësitë e tij?

Kur t'u përgjigjemi në mënyrë të kënaqshme pyetjeve të tilla, mund të familjarizohemi me gjuhën e mëshirës së Kuranit.

Besimtarët e pasur, duhet ta vënë pasurinë e tyre në shërbim të dijes, moralit dhe atyre që ia kanë kushtuar jetën shërbimit ndaj Kuranit Fisnik. Po ashtu, ata duhet të interesohen për nevojtarët dhe të varfrit dhe nuk duhet të largohen prej ambienteve ku jetojnë besimtarët e vuajtur.

Allahu thotë:

"(Lëmosha) **u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato."** (Bekare, 273.)

Për të shëruar plagët shoqërore, duhet të gjallërojmë kurset e Kuranit. Duhet që të gjithë të kontribuojnë për të mbajtur gjallë këto institucione. Duhet të tregojmë përpjekje të madhe për ta bërë rininë me një zemër të lidhur me xhaminë.

Sepse në ditët e sotme rinia është nën ndikimin e fortë të reklamave dhe mediave që kërkojnë një rini të shthurur dhe të dhënë pas kënaqësive të kësaj bote. Ne si besimtarë, duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet tona për ta tërhequr rininë në rrugën e drejtë.

Profeti ﷺ, në ato ditë të vështira në periudhën e Mekës e shndërroi shtëpinë e Erkamit në një kurs Kurani. Po ashtu veproi edhe kur shkoi në Medinë, duke ndërtuar shkollën e Sufes, ku sahabët mësonin Kuranin.

Për të qene edhe ne pjesë e hadithit *"Njeriu është me atë që do"* (Buhari, Edeb, 96.), duhet të tregojmë të njëjtën ndjeshmëri ndaj Kuranit dhe të përpiqemi me të gjitha mundësitë tona ta mbajmë gjallë mësimin e Kuranit. Kjo, sepse mënyra më e mirë që të takohemi me Profetin ﷺ dhe të jemi me të në Ditën e Gjykimit, është shërbimi në rrugën e Allahut, dhe veçanërisht mësimi i Kuranit.

Neglizhenca ndaj Kuranit Famëlartë, është një gabim i madh që errëson jetën shpirtërore të njeriut.

Neglizhimi i përgjegjësive tona ndaj tij dhe mospërfillja e tij, janë shkaqe të një dështimi të tmerrshëm dhe të përjetshëm.

Përpjekja në shërbim të Kuranit Fisnik, është receta më e mirë e shpëtimit në të dyja botët. Në kohën tonë, përpjekje të tilla kanë rëndësi jetike, sepse ky është edhe shërbimi kryesor që do të sigurojë shkundjen dhe rikthimin në identitet të umetit Islam në ditët tona.

Parandalimi i anarshisë shoqërore është i mundur vetëm përmes edukimit kuranor.



E ardhmja jonë varet nga lidhja, respekti dhe dashuria që do të tregojmë ne dhe pasardhësit tanë ndaj Kuranit. Nuk duhet të harrojmë se; mirësitë dhe begatitë hyjnore do të vërshojnë mbi ata që e jetojnë dhe zbatojnë Kuranin.



Lumturia e kësaj bote dhe e botës tjetër, është e mundur duke i mësuar pasardhësve tanë Kuranin.



Të bësh njëmijenjë sakrifica vetëm e vetëm që fëmija të mësojë një gjuhë të huaj, duke përzgjedhur dhe bërë krahasime mes kolegjeve ndërkohë që nënvleftëson Kurset e Kuranit, duke i privuar kështu fëmijët nga fjala hyjnore, është një vetëmashtrim shumë i hidhur.



Ne duhet t'i japim vlerë edukimit kuranor të fëmijëve tanë po aq sa edukimit të tyre me dijet e tjera, sepse kjo teston sinqeritetin tonë ndaj Allahut të Madhëruar dhe Profetit ﷺ. Po ashtu, ne duhet t'i kushtojmë vëmendje mësimit të gjuhës së Kuranit, po aq sa mësimi i një gjuhe të huaj, sepse kjo është motoja e devotshmërisë sonë.



"Lexoni Kuran, sepse ditën e kiametit, ai do të ndërmjetësojë për ata të cilët janë angazhuar me të!" (Muslim, Musafirin, 252.)

Për të fituar ndërmjetësimin e Kuranit në botën tjetër, duhet ta lexojmë dhe zbatojmë atë në të gjitha aspektet e jetës. Gjithë jetën tonë duhet ta rregullojmë sipas mësimeve të tij. Duhet që fëmijët tanë t'i dërgojmë në kurset e Kuranit për ta mësuar atë dhe për t'u zbukuruar me moralin kuranor. Në të kundërt, në vend që të jetë në favorin tonë, Ditën e Gjykimit ai mund të dalë kundra nesh.



Nuk duhet harruar se; një vdekje e lumtur, është shpërblimi për një jetë të mbushur me kënaqësi shpirtërore nën dritën e Kuranit dhe Sunetit. Në varret e atyre që mësojnë dhe zbatojnë Kuranin, do të ketë dritë, ndërsa Ditën e Gjykimit, Kuranin do ta kenë në favor të tyre.



Lum si besimtarët që në zemër kanë imanin dhe Kuranin, shpirtin e kanë në shërbim të Kuranit dhe veten e kanë zbukuruar me moralin kuranor. Në këtë mënyrë, besimtarët do të shijojnë kënaqësitë e pafundme shpirtërore.



Lum si ata që i kanë mësuar Kuranin fëmijëve dhe brezave të ardhshëm. Lum si ata që e kanë plotësuar si duhet përgjegjësinë që kanë pasur ndaj Kuranit.



E lusim Allahun të na bëjë prej atyre që janë zbukuruar me moralin Kuranor dhe veprojnë sipas mësimeve të tij.

Amin!..





PROFETI ﷺ

Allahu i Lartë e ka krijuar atë qenie të bekuar si "usve-i hasene", pra si shembulli i moralit më të mrekullueshëm.

Kjo është edhe arsyeja që Allahu i Lartë e ka përcjellë këtë qenie në të gjitha shkallët e jetës, duke filluar që nga "fëmijëria jetime" si faza e parë për sa i përket vuajtjeve brenda shoqërisë njerëzore, dhe e ka ngritur atë deri në pikën më të lartë për sa i përket fuqisë dhe kompetencës, pra në shkallën e drejtuesit të shtetit dhe të profetit. Aty ku çdokush, në çfarëdo lloj pozicioni të jetë, të marrë prej Tij shembujt më të mrekullueshëm të sjelljeve dhe të mundohet t'i realizojë ato sipas fuqisë dhe aftësisë së tij.

Allahu i Lartë e ka krijuar atë qenie të bekuar si "usve-i hasene", pra si shembulli i moralit më të mrekullueshëm.

Kjo është edhe arsyeja që Allahu i Lartë e ka përcjellë këtë qenie në të gjitha shkallët e jetës, duke filluar që nga "fëmijëria jetime" si faza e parë për sa i përket vuajtjeve brenda shoqërisë njerëzore, dhe e ka ngritur atë deri në pikën më të lartë për sa i përket fuqisë dhe kompetencës, pra në shkallën e drejtuesit të shtetit dhe të profetit. Aty ku çdokush, në çfarëdo lloj pozicioni të jetë, të marrë prej Tij shembujt më të mrekullueshëm të sjelljeve dhe të mundohet t'i realizojë ato sipas fuqisë dhe aftësisë së tij.

Profeti ﷺ, nuk mori mësim nga asnjë njeri. Por sot, ai ka arritur majat në të gjitha fushat e shkencave të cilat i drejtohen njeriut, si psikologjia, antropologjia sociale, pedagogjia etj. Mësuesi i tij ishte Zoti i Madhëruar. Kjo ishte edhe arsyeja pse tek ai mund të gjeje të gjitha recetat e zgjidhjeve për shqetësimet e të gjithë njerëzimit. Në shoqërinë e tij nuk mund të gjeje një person në depresion apo me probleme psikologjike.

Gjenialiteti i një artisti kuptohet nga vepra e tij. Nisur nga ky fakt, edukuesi i një brezi të ndritur sahabësh në kohën e injorancës, Profeti ynë i nderuar ﷺ, mbetet mësuesi dhe edukuesi më i përsosur i njerëzimit.

Profeti ﷺ, gjatë 23 viteve të shpalljes edukoi një brez të tërë si shembull për gjithë njerëzimin. Sahabët janë produkt i edukimit profetik. Cili pedagog, cili psikolog dhe cili antropolog social mund ta japë këtë edukim sot?..

Profeti ﷺ, lindi në një periudhë të errët të historisë njerëzore. Me ardhjen e tij, rilindi humanizmi. Ai shëro zemrat dhe plagët shpirtërore të njerëzimit. Ai zbuti zemrat e ashpra të atyre që i varrosnin të gjalla vajzat e tyre. Ai bëri që në zemrat e njerëzve të shkretëtirës të lulëzonte mëshira. Ata që u përpoqën ta vrisnin atë, gjetën jetë tek ai.

Ashtu si shumë vende me ferra që kthehen në trëndafilishte që të kënaqin shpirtin pasi të jetë kujdesur një kopshtar i aftë, ashtu edhe shkretëtirat që ishin kthyer në pellgje gjaku, u shndërruan në një oazë paqeje me ardhjen e Profetit tonë ﷺ. Buzëqeshja e fytyrës së tij të trëndafiltë, gjelbëroi shumë zemra shterpe dhe i stolisi me lulet e mëshirës. Zemrat, që thuajse ishin djegur në errësirën e politeizmit dhe mosbesimit, u shndërruan në diamante të shkëlqyer me bekimet e mesazhit dhe udhëzimit të Tij. Prej tij u edukuan personalitete vezulluese që do të shkëlqejnë në qiellin e virtyteve dhe do ta udhëheqin njerëzimin deri në ditën e kiametit.

Historiani francez Lamartin, do ta shprehte kështu madhështinë dhe gjenialitetin e Profetit ﷺ:

"Në qoftë se madhështia e qëllimit, pamundësia e mjeteve dhe pafundësia e rezultateve të arritura, do të ishin tri kritere për të

matur gjenialitetin njerëzor, atëherë kush do të guxonte të përqaste njerëzit më të mëdhenj të kohëve moderne me figurën e Muhamedit?

As më të shquarit prej tyre nuk arritën gjë tjetër, veçse të ngrinin ca ushtri, ligje, perandori e të themelonin autoritete fizike të pushtimit, disa prej të cilave u rrënuan para syve të tyre.

Kurse Muhamedi nuk lëvizi nga vendi vetëm ushtritë, ligjet, perandoritë, popullatat, dinastitë, por edhe miliona njerëz të një të tretës së botës. Për më tepër, ai lëvizi nga altarët idhujt, idetë dhe shpirtrat."

Kurse shkrimtari Thomas Carlyle thotë:

"Asnjë perandor nuk është respektuar dhe dashur sa Muhamedi ﷺ, i cili arnonte mantelin e tij me dorën e vet."

Njëri ndër themeluesit ideologjikë të Revolucionit Francez, filozofi Lafajet; më 1789 para shpalljes së "Deklaratës së të drejtave të njeriut", kishte studiuar dhe shqyrtuar me kujdes dhe përpikëri të gjitha sistemet juridike. Kur e pa lartësinë dhe epërsinë e të Drejtës Islame, vlerësimin dhe admirimin e tij ndaj Profetit ﷺ, e shprehu kështu:

"O Muhamed! Atë që ti ke sjellë dhe aplikuar në botë, nuk e ka bërë askush tjetër. Ti e ke sjellë drejtësinë në një shkallë të paarritshme!.."

Goethe, i cili u ndikua shumë nga leximi i Divanit të poetit të famshëm pers Hafizit, në lidhje me Profetin ﷺ, ka këto vargje në divanin e tij:

Ti je një burim mali
Të gjithë vëllezërit tuaj i përqafove,
I shpëtove nga shkretëtira djegëse,
Si lumi që kapërcen male arrin në oqeanin e përjetësisë"

Gjenialitetin dhe madhështinë e Profetit ﷺ, janë detyruar ta pranojnë edhe jomyslimanët të cilët nuk kanë qenë të verbëruar nga fanatizmi.

Ashtu si dje, edhe sot, edhe nesër, e vetmja rrugëzgjidhje për ne si njerëzim, është gjithmonë i Dërguari i Allahut ﷺ, sepse faktori kyç që e shndërroi epokën e injorancës në një epokë lumturie, është pikërisht morali i tij madhështor. Kriteret e tij jetëdhënëse janë receta e vetme e paqes jo vetëm për epokën e tij, por për të gjithë shekujt dhe brezat e ardhshëm deri në kiamet.

Nëse i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk lind si një diell në shpirtin e njerëzimit, nuk mund të ndriçohet as errësira e zezë në të cilën ka tërhequr njerëzimin injoranca moderne, me mizorinë, padrejtësinë dhe egërsinë e saj. Nëse zemrat nuk lahen me zemzemin e Kuranit dhe Sunetit, është e pamundur të pastrohen bloza dhe tymi i xhehenemit të mosbesimit dhe imoralitetit dhe të shpëtohet nga krizat shpirtërore.

Allahu thotë në Kuran:

"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij,

i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) **e urtësinë** (diturinë e thellë fetare)**, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar."** (Al-i Imran, 164.)

Profeti ﷺ, është pasuria jonë më e madhe shpirtërore. Nëse nuk do të njihnim Profetin ﷺ, çfarë vlere do të kishin edhe sikur të zotëronim të gjitha pasuritë e kësaj bote?! Sepse jeta jonë në këtë botë është e përkohshme... Kurse qetësia dhe lumturia që sjell njohja dhe ndjekja e Profetit ﷺ, është e përjetshme...

Në çdo çast të jetës sonë, duhet të jemi të lumtur dhe të gëzuar që Allahu Teala na ka dhënë mirësinë për të qenë umet i të Dërguarit të Allahut, ﷺ, i cili është një zemër e butë dhe e mbushur plot me dhembshuri për ne. Në këtë mënyrë, ne nuk duhet të mbytemi në dallgët e dyshimeve dhe të shqetësimeve të përkohshme.

Po ashtu duhet të mendojmë:

A ka dhuratë, pasuri dhe mirësi më të madhe se të qenët umet i të Dërguarit të Allahut ﷺ?

A mundet një zemër që i është bindur Atij, të mendojë ndonjë mirësi dhe nderim më të madh se ky?

Mirësia e të qenit njeri midis të gjitha krijesave, e të qenit besimtar midis gjithë njerëzve, e të qenit prej umetit të Muhamed Mustafait në mesin e 124 mijë profetëve... Sa të vetëdijshëm jemi ne për këtë mirësi? Sa po përfitojmë prej kësaj mirësie dhe begatie të madhe shpirtërore që na është dhuruar? A jemi sa duhet

mirënjohës për këtë mirësi kaq të madhe? Ne duhet të përpiqemi të jemi një umet i denjë i Profetit ﷺ.

Profeti ﷺ, thotë:

"Kush harron dhe neglizhon të më dërgojë salavatë dhe selame, devijon nga rruga e xhenetit." (Ibn Maxhe, Ikamet, 25.)

"Koprraci i vërtetë, është ai që nuk më dërgon salavat dhe selam kur përmendet emri im pranë tij." (Tirmidhi, Deauat, 100/3546.)

Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

"Nëse dikush, pranë të cilit përmendem unë, nuk më bën salavat të plotë për mua, ai nuk është prej meje dhe unë nuk jam prej tij. O Zoti im! Vazhdoje lidhjen Tënde me atë që e ruan lidhjen me mua dhe shkëpute me atë që e shkëput me mua!" (Dejlemi, el-Firdeus, III, 634.)

Omeri رضي الله عنه thotë:

"Lutja rri varur mes tokës e qiellit. Nuk ngrihet deri tek Allahu derisa nuk themi salavate për të Dërguarin e Allahut." (Tirmidhi, Vitr, 21/486.)

Ebu Bekri رضي الله عنه, thotë:

"T'i dërgosh salavat Profetit ﷺ, i fshin gjynahet më shpejt nga ç'e shuan uji zjarrin. T'i dërgosh selam (me dashuri dhe sinqeritet)

është më e vlefshme se sa të lirosh disa skllevër. Ndërsa, ta duash Resulullahun ﷺ, është më sublime se sa të luftosh me nefsin apo të luftosh me shpatë në rrugë të Allahut." (Bagdadi, Tarihu Bagdad, VII, 161.)

Kjo nënkupton të ndjekësh Profetin ﷺ, në besim, vepra, moral, sjellje; shkurtimisht në çdo aspekt të jetës. Vetëm këta mund të arrijnë dashurinë e Profeti ﷺ.

Nëse i japim selam dikujt gjatë namazit, ky veprim e prish namazin. Mirëpo, nëse i dërgojmë selame Profetit tonë ﷺ, ky veprim përkundrazi e plotëson namazin.

Kushdo që tregon mungesë respekti ndaj Profetit ﷺ, është injorant dhe me zhvillim mendor shumë të mangët. (Shih: Huxhurat, 4.)

Një besimtar pavarësisht gjendjeve të zemrës me të cilat përballet duhet të vazhdojë rrugën e vet duke u kapur fort pas Kuranit dhe Sunetit. Kriteri i vetëm për të vlerësuar veten duhet të jetë Kurani dhe Suneti.

Ky ajet kuranor duhet të ngulitet fort në zemrat e besimtarëve:

"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) **Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm."** (Huxhurat, 1.)

Sjelljet e edukatës me të cilat njoftohemi në ajetet si, «të mos nxitohet para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit, të mos e ngr-

ihet zëri para të Dërguarit», në të njëjtën kohë janë edhe porosi të rëndësishme se si duhet ta ndjekim Profetin ﷺ. Me fjalë të tjera, një besimtar nuk duhet të nxjerrë kurrë në plan të parë mendimin dhe dëshirën e tij kur në ndonjë çështje ekziston udhëzimi profetik. Edhe nëse nuk i përshtatet dëshirave dhe interesave të tij, ai duhet të besojë gjithmonë se ka mëshirë, urtësi, bollëk dhe mirësi në urdhrat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe të veprojë në përputhje me to.

Për të jetuar një jetë fetare në përputhje me vullnetin e Allahut, ne duhet të shmangim interpretimin e fesë sipas mendjes sonë, të mos veprojmë sipas qejfit tonë dhe të mos e braktisim atë që nuk na pëlqen. Pra, ne duhet të shmangim zhvillimin e të kuptuarit të Islamit sipas dëshirës sonë.

Islami nuk është diçka prej së cilës mund të marrim pjesën që pëlqen mendja jonë dhe të hedhim poshtë atë që nuk e pëlqen; Islami është një tërësi. Kushdo që nuk e pranon plotësisht dhe nuk e miraton atë, nuk mund të jetë besimtar. Besimi nuk pranon ndarje, pra nuk mund të ndahet në pjesë; ai është i vlefshëm vetëm në tërësi. Sa i përket përfundimit të një personi, nuk ka asnjë dallim ndërmjet mohimit të tërë Kuranit dhe mohimit të një prej urdhrave të tij. Të dyja situatat e bëjnë një person të humbasë besimin e tij.

Allahut thotë:

“O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju

thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyn midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!" (Enfal, 24.)

"...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër." (Hashr, 7.)

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!" (Muhammed, 33.)

Pavarësisht nëse i dinin apo jo urtësitë e tyre, sahabët i zbatonin menjëherë urdhrat e Profetit ﷺ, pa qenë nevoja t'i pyesnin ato brenda kufijve të ngushtë të arsyes. Kjo, sepse Profeti ynë ﷺ, i merrte udhëzimet nga Zoti i Plotfuqishëm, i Cili ka krijuar të gjitha mendjet. Në këtë aspekt, ndjekja e të Dërguarit të Allahut ﷺ, i cili është njeriu me mendjen më të shëndoshë, është gjëja më e mençur për njerëzit, mendja e të cilëve është e kufizuar nga shumë dyshime dhe iluzione. Siç ka thënë edhe Jusuf Has Haxhibi: *"Fjala e të urtit është syri i të marrit"*.

Kur njeriu vepron sipas mendjes së vet, mund të gabojë. Ndaj dhe kurrë nuk duhet kaluar para Allahut dhe Resulullahut, pra duke pasur gjykimet e qarta të Kuranit, nuk duhet thënë kurrë "sipas meje".

Nexhip Fazëll e ka shprehur në këtë mënyrë bindjen ndaj Profetit ﷺ:

"Mos thuaj kam sy, mendje e ide, vriti të gjitha tani!
Nëse ai thotë është liqen ajo që të duket shkretëtirë, liqen është ai!"

Nëse mendja nuk disiplinohet nën rregullat dhe mësimet që ka sjellë Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë ﷺ, nuk e çon njerëzimin në mirësi, por përkundrazi e shpie në ligësi. Rumiu shprehet kështu:

"Edhe pse mendja është e suksesshme në punët e kësaj bote, për shkak të natyrës së saj, ajo është e pamjaftueshme për të arritur te hakikati dhe të fshehtat hyjnore, domethënë te «marifetu'll-llahu / njohja e Allahut». Për këtë udhëtim sublim duhet një ndërmjetës. E ky ndërmjetës, është zemra dhe dashuria!"

Sahabët dhe njerëzit e devotshëm, iu bindën të gjitha urdhrave dhe udhëzimeve të Profetit ﷺ, me një nënshtrim pasionant. Kështu, edhe ne, duke i marrë shembull ata, duhet të shmangim sëmundjen e "neglizhimit të sunetit", që është një nga gabimet më të shpeshta që bëhen sot.

Ndjekja me përpikëri e sunetit profetik, është më shumë çështje zemre dhe nënshtrimi sesa mendjeje. Botëkuptimi ynë përballë të vërtetave profetike, nuk është i ndryshëm nga të kuptuarit e një fëmije përballë ngjarjeve metafizike.

Vajza e Sulltanit Selçuk, njëkohësisht edhe nxënësja e Mevlanës së nderuar, Gyrxhy Hatun, e dërgon piktorin më të famshëm të sarajit tek Mevlana, me qëllim që të pikturonte portretin e tij në mënyrë të fshehtë. Piktori i brengosur shkon pranë Mevlanës dhe i tregon gjithçka. Ndërsa Mevlana, duke buzëqeshur i thotë:

"Nëse mundesh, bëj atë që të është urdhëruar dhe ashtu siç dëshiron!".

Piktori filloi të pikturonte, por, kur përfundoi, vuri re se imazhi i vërtetë i Mevlanës nuk përngjante aspak me atë që ai kishte pikturuar. Kështu që, filloi ta pikturonte nga e para. Ai shpenzoi njëzet fletë duke u munduar të pikturonte Mevlanën, por gjithmonë pa sukses. Më në fund, e kuptoi se nuk mundej më dhe u detyrua të hiqte dorë nga kjo punë. (Këto piktura gjenden edhe sot në muzeun e Mevlanës.)

Kjo ndodhi, zgjon shpirtin e piktorit dhe e zhyt atë në mendime të thella, duke e bërë atë një shëtitës të botës së shpirtit. Më në fund, në zemrën e piktorit hapet një dritare, prej së cilës zhytet në përfytyrimin e Profetit ﷺ dhe nga gjuha e tij rrjedhin këto fjalë:

"Nëse është i tillë veliu i një feje, kush e di se si është profeti i saj?.."

Gjatë një ekspedite ushtarake, Halid bin Uelidi ﷺ, kalon natën tek një fis mysliman. Kryetari i fisit e pyet:

- A na tregon ndonjë gjë në lidhje me Profetin ﷺ?

Halid bin Uelidi ﷺ, thotë: - Jam i paaftë për të treguar bukuritë e të Dërguarit të Allahut. Nëse dëshironi t'jua tregoj me detaje, kjo nuk është e mundur!

Kryetari thotë: -Na trego me aq sa di! Përshkruaje shkurt!

Atëherë Halidi ﷺ, thotë:

"I Dërguari është përfaqësues i denjë i Dërguesit të tij!.."

Pra, meqenëse Dërguesi është Zoti i botëve, madhështinë e të Dërguarit të Tij mendoje vetë!..

Të gjithë kuptojnë dhe perceptojnë sipas gjendjes së zemrës. Pikëpamjet janë të varura nga gjendja e zemrës. Ajo që shikon është zemra jo syri. Kur Ebu Bekri ﷺ, pa Profetin ﷺ, ai vuri re tek ai besnikëri, sinqeritet dhe virtyte të vyera. Kështu, i mahnitur nga cilësitë dhe personaliteti shembullor i Profetit ﷺ, ai tha: "Jeta, pasuria dhe gjithçka e imja të qoftë falë o i Dërguari i Allahut!".

Nga ana tjetër, kemi gjendjen e Ebu Xhehlit, i cili vepronte i zhytur në errësirën e shirkut dhe injorancës. Dhe kjo, pavarësisht faktit që ai kishte pasur mundësinë ta shihte Profetin ﷺ, kushedi sa herë kur ishte në jetën e tij. Kurse shumë të dashuruar të tjerë pas Profetit ﷺ, nuk e panë kurrë fytyrën e tij të bekuar. Mirëpo, ai mushrik i tërbuar, ishte zhytur në interesa të ngushta të kësaj bote dhe, për shkak të errësirës verbuese që kishte në zemër, syri i tij nuk mundi ta shohë dritën e xhenetit që qëndronte para tij.

Profeti ﷺ, thotë:

"Përveç asaj pjese të njerëzve dhe xhinëve që kundërshtojnë, të gjitha qeniet në qiej e në tokë e dinë se unë jam i Dërguari i Allahut!" (Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 310.)

Sytë e shikojnë me patjetër Profetin ﷺ, nëse nuk janë të verbër. Ata që përpiqen të gjejnë mangësi tek Profeti ﷺ, nuk bëjnë gjë tjetër veçse tregojnë mangësitë, gabimet dhe marrëzinë e tyre.

Njerëzimi duhet të mendojë si të shprehi mirënjohjen për Profetin ﷺ, sepse nuk është zemër ajo, e cila nuk mbushet me ndjenjat e falënderimit ndaj mundit dhe përpjekjeve që ai bëri gjatë gjithë jetës së tij për shpëtimin dhe udhëzimin e njerëzimit.

I vetmi njeri në historinë e njerëzimit, i cili ka të llogaritur edhe detajin më të vogël të jetës së tij, është Profeti ﷺ. Të gjitha veprat e shkruara në kulturën Islame, janë shkruar për të shpjeguar një njeri.

Vallë, sa kanë mundur ta shprehin Muhamedin ﷺ, librat e Sirës, që janë shkruar me mundësitë e kufizuara të fjalëve?!. Mbi të gjitha, kur çdo kalem që ngrihet për të treguar atë, është i fuqishëm aq sa dashuria në zemrën e të zotit...

Të mësosh "Sijer-i Nebi" (historinë e Profetit ﷺ), nuk arrihet vetëm me një lexim kronologjik të ngjarjeve. Ata që e dinë më mirë "Sijer-i Nebi", janë ata, jeta e të cilëve u përngjan më së shumti jetës së Profetit ﷺ. Ata që e njohin më mirë atë, janë ata që jetojnë me devotshmëri dhe përpikëri sunetin e tij, janë të dashurit e Allahut, të cilët jetojnë të përmalluar për atë diell të mëshirës. Ata ecin në gjurmët e të Dërguarit të Allahut, ashtu siç ecën hija mbas të zotit.

Mësimi i vërtetë i jetës së Profetit ﷺ, arrihet duke ndjekur dhe realizuar çdo veprimtari që rrit dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ.

Më shumë se sa duke lexuar librat, Profetin ﷺ, mund ta njohim duke lexuar zemrat. Pra, duke përfituar prej botës shpirtërore të njerëzve të devotshëm dhe të diturve, që janë edukuar me moralin profetik

Përveç njohjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ, me anë të thënieve, veprimeve dhe sjelljeve të tij, është e nevojshme edhe njohja në aspektin e ndjeshmërisë së zemrës. Dhe kjo, do të thotë ta njohim me të gjitha gjendjet dhe sjelljet shembullore:

- Me preferencën e tij ndaj ahiretit,
- Devotshmërinë dhe vetëkontrollin,
- Sinqeritetin dhe frikë-respektin ndaj Allahut,
- Ndjenjën e të qenit bashkë me Allahun,
- Përkushtimin në adhurim,
- Frikën, dobësinë dhe meditimin e thellë përballë shfaqjeve të fuqisë dhe madhështisë hyjnore,
- Mirësjelljen, hirin, edukatën dhe modestinë e jashtëzakonshme në marrëdhëniet njerëzore,
- Dhembshurinë dhe mëshirën e tij të pamasë ndaj të gjitha krijesave,
- Bujarinë e pashoqe, altruizmin dhe vetëmohimin e tij...

E megjithatë, nuk është e mundur të njohësh Profetin ﷺ, duke qëndruar brenda përmbajtjes së ngushtë të rreshtave. Ne mund ta njohim atë vetëm në masën që arrijmë të jetojmë në përputhje me sunetin e tij.

Allahut thotë:

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." (Teube, 128.)

Dashuria dhe dhembshuria e tij ndaj umetit ishte aq e madhe saqë nuk mund të krahasohet as me dashurinë e një nëne që dridhet mbas fëmijës së vet.

Njëherë, Profeti ﷺ, iu drejtua sahabëve dhe u tha:

"Bëni kujdes! Për sa kohë jam gjallë, jam shkak i sigurisë suaj. Por kur të ndërroj jetë, do t'i përgjërohem Zotit «O Zot, ummeti, ummeti!», derisa t'i fryhet surit për herë të parë..." (Ali el-Muttaki, Kenzu-l Ummal, V.14, fq. 414.)

Shqetësimi më i madh i të Dërguarit të Allahut ﷺ, ishte paqja dhe shpëtimi i përjetshëm i umetit të tij. Prandaj, është detyrë e besnikërisë së çdo besimtari, që është i nderuar të jetë ummet i tij, që të mund t'i përgjigjet me të njëjtën dashuri të Dërguarit të Allahut ﷺ, i cili e ka mbajtur umetin e vet në gjuhë dhe në zemër gjatë gjithë jetës së tij.

Madje, edhe në çastet e fundit të jetës, shqetësimi më i madh i Profetit ﷺ, ishte shpëtimi i umetit. Saherë që kishte mundësi të fliste, përsëriste të njëjtat fjalë:

"Namazin, në veçanti keni kujdes namazin. Frikohuni Allahut për të drejtat e atyre që keni nën vete!" Kjo gjendje e tij deri në frymën e fundit, duhet të shërbejë si motivim për ne në përpjekjen për të rritur atmosferën e ibadetit.

Profeti ﷺ, ishte shumë i mëshirshëm dhe i dhembshur ndaj umetit. Po ne sa e duam Profetin ﷺ? Sa dashuri dhe mëshirë shprehim ne?

Zemra e tij rrihte fort për të mjerët, të pashpresët, jetimët dhe ata që prisnin udhëzim. Po ne, sa të ndjeshëm jemi ndaj tyre?

Sa e përfaqësojmë ne, si umet i atij njeriu me moral të lartë, çiltërsinë, pastërtinë e shpirtit dhe zemrës, mirësjelljen, delikatesën dhe estetikën e Islamit?

Sa e predikojmë ne Islamin ndaj atyre që presin udhëzim me sjellje dhe me fjalë?

Profeti ﷺ, thotë:

"Jeta ime është në dobinë tuaj; ju flisni me mua dhe njoftoheni (me shpalljen hyjnore dhe ligjet). Por edhe vdekja ime është në dobinë tuaj. Punët tuaja më tregohen edhe mua. Kur shoh një punë të mirë, falënderoj Allahun, e kur shoh një punë të keqe, i kërkoj falje Atij për ju." (Hejthemi, IX, 24.)

Veprat e umetit i paraqiten të Dërguarit të Allahut ﷺ. Vallë, gjatë kësaj paraqitjeje, a e trishtojmë zemrën e tij apo e mbushim me lavdërime e falënderime? Nesër, në vendin e Gjykimit, veprat tona do t'i paraqiten përsëri atij. E ai shpirt i butë dhe i mëshirshëm, nuk do ta ngrejë kokën nga sexhdeja, duke kërkuar faljen tonë... Në atë kohë, a do të jemi prej të ftuarve nën flamurin e Hamdit, apo prej atyre që dëbohen duke u thënë: *"Ju e keni braktisur Sunetin e Tij! Qëndroni larg! Qëndroni larg!»?..*

Profeti ﷺ, për besimtarët, ishte më i mëshirshëm se sa prindi për fëmijët e vet. Në hutben e lamtumirës, Profeti ﷺ, është shprehur:

"...Ta dini se unë do të shkoj përpara jush në burimin e Keutherit e do t'ju pres atje. Përballë umeteve të tjerë unë do t'i gëzohem numrit tuaj të shumtë. Kujdes mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!" (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76.)

Shqetësimi i të Dërguarit të Allahut ﷺ, ishte halli i umetit të tij. Për rrjedhojë, edhe shqetësimi ynë duhet të jetë halli i umetit të Muhamedit ﷺ. Shqetësimi ynë duhet të jetë; si ta bëjmë të buzëqeshë fytyrën e bekuar të Profetit tonë ﷺ. Nëse ne merremi me hallet e umetit, edhe fytyra e bukur e Profetit tonë ﷺ, do të buzëqeshë për ne. Por, nëse ne mbytemi në vorbullën e egoizmit dhe moskokëçarjes, duke e konsumuar jetën tonë në egoizëm dhe koprraci, ai do të jetë i hidhëruar dhe i shqetësuar për ne.

Nuk duhet harruar se; i vetmi lum mëshire dhe dashuri që të çon në oqeanin e dashurisë për Allahun, është Profeti ynë ﷺ, sepse dashuria për të, është dashuri për Allahun, bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut dhe mosbindja ndaj tij, është mosbindje ndaj Allahut. Nisur nga kjo, ekzistenca e Profetit tonë ﷺ, është strehë dashurie për të gjithë njerëzimin. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"Thuaju (o Muhamed)**: "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë"**. (Al-i Imran, 31.)

Pra, dashuria e Allahut të Madhëruar mund të arrihet vetëm duke iu bindur e dorëzuar të dashurit të Tij, e veçanërisht duke ndjerë dashuri për të. Atij që neglizhon sado pak në këtë rrugë,

ngurron apo dyshon, dera e dashurisë hyjnore mbetet e mbyllur për të. Ekzistojnë ajete të qarta që tregojnë se dashuria për Profetin ﷺ, është dashuri për Allahun; bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut; e mosbindja ndaj tij, është mosbindje ndaj Allahut.

Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë), transmeton:

"Sahabët e nderuar i thanë Profetit ﷺ:

«- O i Dërguar i Allahut! Ne e duam shumë Allahun Teala. Mirëpo, a na thua se cili është treguesi i dashurisë së vërtetë për Allahun?»

Për këtë arsye, Allahu Teala zbriti një ajet fisnik, në të cilin thuhet:

"Thuaju (o Muhamed)**: "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë".** (Al-i Imran, 31) (Shih. Taberi, Xhamiu'l-Bejan, nr. 6845, 684.6)

Në zemrat e sahabëve nuk ekzistonte dashuri më e madhe se dashuria për Allahun dhe Profetin ﷺ. As dashuria për pasurinë dhe as dashuria për famë dhe pozitë... sepse të gjitha këto do të mbesin në dynja, kurse dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, do të jenë pasuri e çmuar në botën e amshuar.

Kush dashuron me të vërtetë, edhe vuajtja, edhe sakrifica në rrugën e atij që dashuron, kthehet në kënaqësi. Për këtë arsye, sahabët fisnikë kanë plotësuar edhe dëshirat më të vogla të Profetit

ﷺ, duke thënë: *"Të qofshin falë nëna, babai, pasuria dhe jeta ime, o Resulullah!"*

Kështu, ata i bartën letrat e udhëzimit Islam të Profetit ﷺ, deri në vendet më të largëta, Kinë, Semerkand, Afrikë e Stamboll, duke u përpjekur të vërtetojnë dashurinë që ndjenin për të Dërguarin e Allahut ﷺ.

Sahabët arritën paqen shpirtërore duke i zgjidhur të gjitha konfliktet e tyre shpirtërore dhe pikëpyetjet e egos në enën e nënshtrimit ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sepse ata e njihnin të Dërguarin e Allahut ﷺ, nga afër dhe e admironin atë. Për këtë arsye ata preferuan të kishin një vend të vogël në zemrën e tij në vend të lumturisë së botës dhe të gjitha sakrificat e tyre për këtë kauzë i konsideronin kënaqësi shpirtërore.

Në cilindo nivel të arrijnë zemrat në dashurinë e tyre për të Dërguarin e Allahut ﷺ, në po atë nivel do të arrijë edhe në paqen në këtë botë dhe grada në ahiret.

Të jesh umeti i Profetit ﷺ, është një lumturi e madhe. Të kesh fatin të pish nga Hauzi i Keutherit të tij në Ahiret, të mblidhesh nën flamurin e Hamdit dhe të gëzosh ndërmjetësimin e tij të mirë, duhet ta duash atë më shumë se veten.

Profeti ﷺ, e shpreh në këtë mënyrë dashurinë që duhet të ushqejmë për të:

"Nëse ndonjëri prej jush nuk më do më tepër se veten e tij, prindin, familjen dhe të gjithë njerëzit, nuk mund të ketë besuar në kuptimin e vërtetë të fjalës!.." (Buhari, Iman, 8.)

Ata që nuk e kanë dashurinë e të Dërguarit të Allahut ﷺ, në zemrat e tyre, nuk mund të shijojnë ëmbëlsinë e dashurisë së vërtetë. Fara e dashurisë së vërtetë mbin vetëm në tokën e dashurisë për të, sepse Profeti ﷺ, është qendra e shfaqjes së dashurisë hyjnore, e cila e lartëson dashurinë kalimtare të krijimit duke e evoluar atë. Ai është burimi i bollëkut dhe begatisë për zemrën. Toka e tij e dashurisë ka lartësuar shumë zemra të ngurtësuara në pastërtinë e një xhevahiri.

Rumiu jep këto këshilla:

"O njeri indiferent! Vështro mrekullitë e Musait dhe Ahmedit! Si u bë shkopi gjarpër, si u bë i vetëdijshëm trungu hurmës?

Dëgjoje thelbin e dashurisë prej një trungu dhe nxirr mësime! Mos e burgos veten në dëshirat trupore dhe materiale. Lumturia dhe pozita e vërtetë është përtej trupores dhe materiales. Dije që lumturia e vërtetë arrihet kur shkëputesh nga dëshirat trupore dhe jepesh pas botës së përjetshme."

Poeti i Mevludit, Sulejman Çelebi, me vargun e mëposhtëm, në mënyrë metaforike shprehet se dielli i sillet rrotull si flutur të Dërguarit të Allahut; domethënë se, edhe trupat jo të gjallë janë të dashuruar pas tij:

"Një bukuri e veçantë që dielli i sillet si flutur përreth..."

Profeti ynë ﷺ, duke treguar dashurinë e thellë që umeti i tij ndjente për të, tha:

"Një pjesë e atyre që do të më duan mua nga umeti im, do të jenë prej atyre që do të vijnë pas meje. Ata janë të gatshëm të sakrifikojnë pasurinë dhe familjen e tyre për të më parë mua." (Muslim, Xhenet, 12; Hakim, IV, 95.)

Në një hadith fisnik Profeti Muhamed ﷺ, thotë:

"Ai që më viziton mua pas vdekjes, është njësoj si të më ketë vizituar në gjallje!" (Darekutni, Sunen, II, 278.)

Bezmi Alem Valide Sulltan ka thënë:

"Nga dashuria ka ardhur Muhamedi, Si mund të ketë dashuri pa Muhamedin?"

Domethënë; nëse nuk ecim gjurmëve të tij, nëse nuk i duam ato që ka dashur ai dhe nëse nuk mund ta shndërrojnë dashurinë në aktivitete për vepra të mira, atëherë fjalët e dashurisë që na dalin nga goja nuk janë të vërteta.

Për besimtarin e vërtetë, besnikëria ndaj Profetit ﷺ, është një trëndafil që nuk vyshket kurrë. Besnikëria nuk ka vjeshtë. Bes-

imtarët që ushqehen nga burimi i besnikërisë ndaj Tij e shndërrojnë botën shpirtërore në një lulishte me trëndafila. Në një lulishte të tillë, ku ndodhen gonxhet e dhikrit, bilbilat e tespihve, burimet e veprave të mira dhe ku lulëzojnë lulet e besimit, urtësisë dhe mirësive.

Trëndafili është simbol i Profetit ﷺ. Lum për atë që arrin të bëhet bulëz vese në petalet e atij trëndafili!..



NDJEKJA E TRADITËS PROFETIKE ME DASHURI

Në çdo moment të jetës sonë, duhet të përpiqemi të jetojmë në rrugën që na tregoi i Dërguari i Allahut ﷺ, ashtu si besnikëria e një hijeje ndaj të zotit të saj. Aq, sa më tepër se gojët tona, duhet të jetë gjendja dhe sjellja jonë që duhet të tregojnë se jemi umeti i Profetit të Mëshirës.

Imam Maliku thotë:

"Suneti është si anija e Nuhut. Kushdo që hipë në të do të shpëtojë. Dhe kushdo që e braktis atë do të humbasë."

Qëllimi i jetës është të jetosh si një rob i devotshëm dhe të vdesësh si i tillë, sepse synimi është të pajisemi me moralin profetik, të cilin Allahu i Madhëruar ia dhuroi njerëzimit. Pra, të bëhemi robër të ndjeshëm, të edukuar, të mençur dhe të kujdesshëm.



Profili i Profetit ﷺ, është si një pasqyrë e pastër dhe e qartë. Çdo njeri mund të shikojë botën e tij të brendshme dhe të jashtme, gjendjen dhe veprat, moralin dhe sjelljet në atë pasqyrë dhe të balancojë gjendjen e vet. Madje, është detyrë e çdo besimtari të përmirësojë gjendjen e vet sipas asaj që sheh në këtë pasqyrë.



Allahu i Plotfuqishëm, formën më të përsosur dhe më të pranueshme të robërisë ndaj Tij, e shfaqi në personin e të Dërguarit të Tij ﷺ. Në këtë aspekt, vlera jonë tek Allahu është vetëm në atë nivel; në nivelin e bashkimit, afërsisë dhe ngjashmërisë sonë me Profetin ﷺ.



Nëse një besimtar nuk udhëhiqet nga Suneti i Profetit ﷺ, ai nuk mund të bëhet «njeri i plotësuar»; pra njeriu ideal që synon Islami.



Dashuria që ushqejmë ndaj Profetit ﷺ, duhet të pasqyrohet si qetësi në adhurim, si mirësjellje në marrëdhëniet njerëzore, si finesë në moral, si dhembshuri në zemër, si nur në fytyrë, si urtësi në gjuhë dhe si mësim në shikim.



Çdo profet ka një cilësi të lartë për t'u marrë si shembull. Dhe, pika më e përsosur e të gjitha këtyre cilësive gjendet tek Profeti ynë ﷺ. Në këtë aspekt, Islami nuk mund të njihet siç duhet pa e njohur mirë Profetin ﷺ.



Në një ajet fisnik urdhërohet:

"Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) **në zemrën tënde** (o Muhamed)**, që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe."** (Shuara, 193-195.)

Pa kuptuar dhe njohur jetën, moralin dhe sjelljet e Profetit ﷺ, nuk mund ta kuptojmë siç duhet as Kuranin.

Jeta e tij profetike prej 23 vjetësh, është një tefsir më vete i Kuranit Kerim. Prandaj, të fshehtat dhe urtësitë e Kuranit mund të kuptohen vetëm duke përfituar prej ndjesive të tij shpirtërore. Pa njohur traditën profetike, Kurani nuk kuptohet dhe Islami nuk mund të zbatohet siç duhet. Allahu ka thënë në Kuran:

"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut." (Nisa, 80)



Nuk duhet të harrojmë se; "Tradita Profetike", është një udhëzues unik për të kuptuar Kuranin. Prandaj, nuk duhet harruar kurrë edhe se; çdo kundërshtim ndaj Traditës Profetike është

kundërshtim edhe ndaj Kuranit, e për rrjedhojë edhe ndaj Krijuesit të Gjithësisë.



Të njohësh dhe të kuptosh të Dërguarin e Allahut ﷺ, është shkalla më e lartë e devotshmërisë ndaj Allahut. Pa e kuptuar dhe pa e njohur atë, pa ndjekur gjurmët e tij dhe pa përfituar prej ndjesive të tij shpirtërore, as besim i ynë nuk është i plotë, as Kuranin nuk mund ta kuptojmë siç duhet dhe as devotshmëria jonë nuk është e përsosur...



Në historinë e feve, shohim se degjenerimi i Judaizmit dhe Krishterimit filloi me braktisjen e suneteve. Pra, në fillim u braktisën sunetet e profetëve. Kështu që, më pas i erdhi radha falsifikimit të sistemit të besimit dhe adhurimeve, mburoja shpirtërore e të cilave tashmë ishte shkatërruar. Në fund u braktis namazi dhe u zëvendësua me mesha, u braktis agjërimi dhe u zëvendësua me pehriz, u braktis mbulesa e grave dhe u la vetëm për murgeshat, të cilat sot kanë filluar të heqin edhe ato.



Sot, lëvizje manipuluese që synojnë dobësimin dhe shkatërrimin e Islamit, filluan duke thënë; «Ç'na duhen medh'hebet?». Pastaj u ngritën kritika injorante kundër imamëve muxhtehidë dhe dijetarëve. Më pas, duke thënë; «Na mjafton Kurani!» dhe duke hedhur poshtë edhe hadithet autentike, filluan sulmet për të diskredituar Sunetin. Së fundi, disa ajete që përmbajnë dispozita u munduan t'i nxirrnin në pension duke thënë; «Këto dispozita janë për kohën kur u shpall!». Të gjitha këto janë hapa tinëzare në projektin për ta bërë Islamin një fe të degjeneruar, ashtu si krishterimi, i cili tashmë është zbrazur plotësisht. Sot

është përgjegjësi e rëndësishme e besimit, që të tregohet vigjilencë ndaj këtyre manipulimeve dhe të mos i lihet hapësirë deformimeve të Islamit.



Abdullah ibn Dejlemi, lidhjen e fortë që duhet të ketë besimtari me sunetin, e shpreh kështu: *"Humbja e fesë, fillon me braktisjen e sunnetit. Ashtu siç zgjidhet litari fije fije dhe në fund këputet, ashtu do të humbasë edhe feja me braktisjen një nga një të sunneteve."* (Darimi, Mukaddime, 16.)



Resulullahu ﷺ, ka thënë:

"Do të vijë një kohë, kur nuk do të ketë asgjë më me vlerë se këto tri gjëra: Paraja hallall, një vëlla që të shoqëron me gjithë shpirt dhe një Sunet me të cilin mund të veprohet." (Hejthemi, I, 172.)



Në çdo periudhë, gjithmonë ka pasur manipulues fetarë që kanë dashur të prishin fenë e Allahut dhe të trazojnë zemrat e besimtarëve. Në të tilla raste, për besimtarët fiton rëndësi më të madhe atributi «faruk», pra aftësia për të dalluar të vërtetën nga e kota dhe të drejtën nga e gabuara. Për këtë arsye, ne, veçanërisht brezat e rinj, duhet të kapemi më fort pas Kuranit dhe Sunetit dhe të pengojmë kurthet e manipuluesve fetarë.



Jeta e të Dërguarit të Allahut ﷺ, është një interpretim i gjallë i Kuranit. Suneti i tij është shpjegimi dhe komentimi më i saktë i Kuranit. Sot, ata që përjashtojnë Sunetin në emër të «Islamit të Kuranit», janë manipuluesit e fesë, të cilët dëshirojnë ta inter-

pretojnë vetë Kuranin, jo i Dërguari i Allahut ﷺ. Prandaj, sot, duhet bërë shumë kujdes nga këta lloj manipuluesish të maskuar si dijetarë të fesë dhe nuk duhet të lejojmë të luhen lojëra ndaj fesë sonë.



I Dërguari i Allahut i tha Abdullah bin Omerit رضي الله عنه:

"O Ibn Omer! Përqafoje fort fenë tënde, përqafoje fort fenë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Ki kujdes nga kush e mëson fenë tënde! Shkencat dhe dispozitat fetare t'i mësosh nga dijetarët e devotshëm, jo nga ata që orvaten majtas djathtas për interesat e kësaj bote!" (Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, el-Medinetu'l-Munevvere, el-Mektebetu'l-Ilmijje, fq. 121.)



"Mos të guxojë ndonjëri prej jush, ashtu i mbështetur në kollttukun e vet, që kur t'i vijë një çështje që unë e kam urdhëruar apo e kam ndaluar, të thotë: «Atë nuk e dimë, ne ndjekim atë që gjejmë në Librin e Allahut dhe kaq!»" (Ebu Daud, Sunnet 5; Tirmidhi, Ilm 10; Ibni Maxhe, Mukaddime 2.)



Jeta e të Dërguarit të Allahut ﷺ, ka qenë në karakterin e tefsirit të Kuranit dhe për këtë arsye, pa sunetin e tij, shumë ajete janë të vështira për t'u kuptuar...



Zbatimi i një pjese të urdhrave hyjnore në Kuranin Fisnik, nuk na janë bërë të ditura me detaje. Ato i mësojmë vetëm në sajë të zbatimeve të Profetit tonë ﷺ.

Për shembull; në Kuranin Fisnik, është bërë e ditur se ngrënia e cofëtinës është haram. Mirëpo, peshku i cili kapet i gjallë dhe më pas ngordh vetvetiu, është një përjashtim brenda këtij rregulli. Dhe këtë, ne e mësojmë nga suneti i Profetit ﷺ.

Po ashtu, në Kuran urdhërohet edhe namazi, por detajet se si duhet ta falim atë, numrin e rekatëve, suret dhe duatë që duhet të lexohen në të, dhe çështje të tjera si, rregullat e qëndrimit në namaz, ne i mësojmë nga suneti.



Trashëgimia më me vlerë që i Dërguari i Allahut ﷺ, la pas, është shembulli i tij i lartë i karakterit dhe personalitetit. Ai dëshironte që edhe ne ta pasojmë këtë shembull dhe t'i mësojmë të tjerët me të. Ai tha: *"Po ju lë dy amanete: Kuranin dhe Traditën Profetike."* (Muvatta, Kader, 3.)

Pra, nuk thotë po ju lë vetëm Kuranin, ai ju mjafton, sepse Kuranin e shpjegon dhe qartëson Tradita profetike. Pa Traditën profetike nuk mund të aplikohet Islami.



Resulullahu ﷺ, ka thënë:

"Umeti im do të ndahet në shtatë dhjetë e tre grupe."

Sahabët e pyetën se kush do të jetë grupi i shpëtuar?

Profeti ﷺ, u përgjigj:

"Ata që ndjekin rrugën time dhe shokëve të mi!.." (Tirmidhi, Iman, 18; Ibn Maxhe, Fiten, 17.)

Prandaj, është e domosdoshme të kapemi fort pas Traditës profetike, e aq më tepër në ditët tona, kur përpjekjet për të devijuar besimtarët nga rruga e drejtë janë më të mëdha dhe të shumta.



Imam Maliku thotë:

"Suneti është si anija e Nuhit. Kush hipën në të shpëton, kush e braktis atë mbytet."



Qëllimi ynë duhet të jetë të qëndrojmë fort në rrugën që na ka përcaktuar Profeti ﷺ, sepse të gjitha rrugët e tjera janë rrugë pakrye!..



Ajeti kuranor thotë:

"Por Allahu nuk do t'i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe, Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij." (Enfal, 33.)

Për sa kohë që në zemrat e besimtarëve do të ekzistojë dashuria për Profetin ﷺ, ata do të jenë të mbrojtur nga dënimi hyjnor.



I Dërguari i Allahut ﷺ, është një kandil udhëzues që ndriçon vazhdimisht mbarë njerëzimin. Allahu i Madhëruar e ka dhuruar atë dritë si mëshirë për botët. Ajo që duhet të bëjmë ne, është të përpiqemi të jemi bashkë me të në gjendje, vepra, ndjenja dhe mendime, në të gjitha rrethanat, si mirënjohje për këtë mirësi të jashtëzakonshme të Zotit të Plotfuqishëm.



Profeti ﷺ, thotë:

"Njeriu është me atë që do." (Buhari, Edeb, 96.)

Dashuria për Profetin duhet të pasqyrohet në zemër, fjalë dhe vepra.



Në një dashuri të vërtetë, i dashuruari dashuron cilësitë e të dashurit të tij. Pra nëse e duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, duhet të bëjmë një jetë sipas Kuranit dhe Sunetit. Duhet të duam ata që do Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe të urrejmë ata që urren Allahu dhe i Dërguari i Tij.



Hasan Basriu ka thënë:

"O njerëz! Mos e keqkuptoni hadithin e Profetit ﷺ; «Njeriu është me atë që do». Pa zbatuar dhe jetuar si vepër mirët, nuk mund të jeni së bashku me ta. Edhe jahuditë (hebrenjtë) dhe të krishterët, sipas formës së tyre, ushqejnë dashuri për profetët e tyre, por ama nuk janë së bashku me ta." (Ihja, v. II, fq. 402.)



Duhet të mos harrojmë se; aq sa është përkushtimi ynë ndaj Allahut, të Dërguarit të Allahut dhe Kuranit, aq do të përfitojmë edhe prej hadithit: *"Njeriu është me atë që e do"*.



Njeriu që dashuron dikë, e imiton atë aq sa dashuri ndjen për të; nuk e nxjerr atë nga zemra dhe nuk e lëshon nga gjuha. Dhe,

treguesi më i mirë i një lidhje të tillë shpirtërore me Profetin ﷺ, është përhapja e sunetit të tij në çdo pjesë të jetës.

Nuk mjafton të thuash: "Unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij!" Kjo dashuri duhet të pasqyrohet në shtëpitë, në punët, në edukimin e fëmijëve tanë, në zgjedhjet tona në shoqëri, në adhurimin, trajtimin dhe moralin tonë, në përpjekjet tona në rrugën e Allahut; shkurt, në çdo aspekt të jetës sonë.

Dashuria e vërtetë, lind nga përbashkësia e karakteristikave të dy të dashuruarve. I dashuri ka të njëjtat ndjenja me atë që dashuron dhe përpiqet të jetë në të njëjtën gjendje shpirtërore me të. Ai dëshiron të marrë ngjyrën e tij dhe të harmonizohet me të.

Ne e duam shumë të Dërguarin e Allahut ﷺ. Ne shpresojmë në ndërmjetësimin e tij në botën tjetër, përmallohemi për Ravzën e tij në dynja dhe dëshirojmë të takohemi me të në Hauzin e Keutherit në ahiret. Por;

– Sa të përbashkëta kemi ne kur bëhet fjalë për dhembshurinë, mëshirën, vetëmohimin dhe bujarinë?

– Sa prej mirësive tona i shpenzojmë për veten dhe sa për të tjerët?

Nëse e duam vërtet të Dërguarin e Allahut ﷺ, duhet ta vërtetojmë dashurinë tonë duke bërë përpjekje vetëmohuese në rrugën e tij. Le të pyesim veten:

– Çfarë mundëm të sakrifikonim për dashurinë ndaj Profetit tonë ﷺ, umeti i të cilit kemi nderin të jemi?

– Sahabët sakrifikuan sytë. Po ne, a kemi mundur t'i ruajmë sytë nga shikimi i haramit?

– Sahabët sakrifikuan jetën e tyre. Po ne, a mund ta durojmë qoftë edhe një gjemb në rrugën e Allahut?

– Sahabët dhuruan pasurinë e tyre. Po ne, a mund ta paguajmë siç duhet zekatin dhe lëmoshën tonë?

– Nëse na pyesin se; "cila është prova e dashurisë suaj", cila do të jetë përgjigja jonë?..



Sa besnikë jemi ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ? A mund të premtojmë se do t'i shërbejmë me të gjitha mundësitë tona fesë së sjellë prej tij? Në këtë epokë të injorancës moderne, a mund të bëjmë përpjekje për të udhëzuar pjesën e umetit, që pret udhëzimin, dhe për të sakrifikuar në këtë rrugë?



Çdo shekull i jetuar larg Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, është në thelb një shekull injorance. Mizoritë e çdo shekulli të pareformuar nga mësimet hyjnore dhe profetike, janë barabarta me njëra-tjetrën.

Fakti që koha, vendi, kushtet e jetesës dhe titujt kanë ndryshuar, nuk e ndryshon natyrën njerëzore. Përveçse ndryshimit në veshje, çfarë dallimi tjetër ka mes injorancës moderne, që sot jeton e fokusuar në kënaqësi dhe shpejtësi, dhe injorancës beduine 14 shekuj më parë?



Çdo periudhë pa Profetin ﷺ, është injorancë...

Një zemër që nuk rrah për të, është mizore...

Çdo ndërgjegje që nuk e aprovon atë, është e verbër dhe e errët...

Ne jemi gjithmonë nevojtarë për parimet e tij që janë si ujë jete për ne...

Në këto kohë që po jetojmë, çdo ditë e më tepër kemi nevojë...



Profeti ﷺ, thotë:

"Ummeti im i ngjan shiut, që nuk dihet se cila pjesë është më e mirë; fillimi apo fundi i tij" (Tirmidhi, Edeb, 81/2869; Ahmed, III, 130.)

Profeti ﷺ, bashkë me sahabët çrrënjosën injorancën e asaj kohë. Ndërsa ata që do të çrrënjosin injorancën moderne, do të jenë besimtarët e sotëm.

Lum për ne nëse bëhemi qoftë edhe një pikë nga ai shi i begatë. Vetëm kështu mund të shpresojmë të jemi prej atyre që do t'i presë Profeti ﷺ, në krye të Hauzit.



Sado larg që jemi nga koha e Profetit ﷺ, afrimiteti me të Dërguarin e Allahut ﷻ, është i lidhur me devotshmërinë; ashtu siç është edhe vlera e njeriut tek Allahu sipas devotshmërisë.

Profeti ﷺ, është shprehur:

"Njerëzit më të afërt me mua janë të devotshmit, të cilët kudo

dhe me këdo që të ndodhen, i frikësohen vetëm Allahut." (Ahmed, V, 235; Hejthemi, IX, 22.)



Profeti u kthye nga Jemeni dhe tha:

«*Unë e ndjej frymën e Rrahmanit që vjen nga Jemeni.*» (Taberani, Kebir, VII , 52/6358.)

Të mos harrojmë se; për të qenë përfitues i asaj fryme të Rrahmanit, varet nga shkalla e devotshmërisë në zemra.



Ashtu si sahabët që ishin nxënësit e Profetit ﷺ, të cilët u gjunjëzuan para mësimeve të tij, ashtu edhe ne jemi pasuesit e të Dërguarit të Allahut ﷺ, në fundin e kohës, të cilëve u drejtohen të njëjtat ajete dhe hadithe 14 shekuj më vonë. Edukimi më i rëndësishëm shpirtëror që mund të marrim nga Profeti ﷺ, është të bashkojmë botën tonë të brendshme me ndjenjat në zemrën e tij.



Në veprën e tij *"Gylistani"*, shejh Sadi shprehet në mënyrë krahasuese në lidhje me ndikimin e Profetit ﷺ, tek të dashurit e Allahut:

"Një njeri shkoi në hamam dhe një nga miqtë e tij i dha një copë argjile me erë të këndshme për t'u pastruar. Prej argjilës përhapej një aromë e këndshme, që të ledhatonte shpirtin. Prandaj dhe njeriu e pyeti argjilën:

- Ah, moj e bekuar! Mos je gjë misk apo amber? Aroma jote ma kënaqi shpirtin...

Argjila i thotë:

- Unë nuk jam as misk dhe as amber, por veçse një copë tokë. Por, gjendem poshtë rrënjëve të një trëndafili dhe çdo mëngjes lagem prej pikave të vesës që bien nga gonxhet e tij. Pra, edhe aroma e këndshme që të kënaqi shpirtin, vjen prej atij trëndafili...



Bota shpirtërore e të Dërguarit të Allahut ﷺ, është si një bahçe Xheneti, ku gjenden lulet më të bukura, më të rralla dhe trëndafilat me aromë më të këndshme. Një person që kërkon aty mund të gjejë sjelljet më të bukura që i duhen si model.



Por, sa po përfitojmë ne prej flladeve shpirtërore, që vijnë prej asaj bahçeje të Xhenetit?

- Sa ngjan jeta jonë familjare me atë të tijën?

- Sa ngjajnë marrëdhëniet tona tregtare e shoqërore me ato të tijat?

- Si umet i atij njeriu me moral të lartë, sa e përfaqësojmë ne çiltërsinë, pastërtinë e shpirtit dhe zemrës, mirësjelljen, delikatesën dhe estetikën e Islamit?

- Sa mikpritës jemi ne për nevojtarët?



Allahu në Kuran, duke përshkruar cilësitë e atyre që janë pranë Profetit ﷺ, thotë:

"Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis

tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. (Fet'h, 29.)

Habibi i Allahut, Muhamed Mustafai ﷺ; bota e tij shpirtërore është si një bahçe Xheneti, ku gjenden lulet më të bukura e më të rralla dhe trëndafilat me aromë më të këndshme. Prandaj, në këtë pikë jemi të detyruar t'i bëjmë disa pyetje vetvetes:

- Sa po përfitojmë prej flladeve shpirtërore, që vijnë prej asaj bahçeje të Xhenetit?

- Sa i ngjan jeta jonë familjare jetës së tij familjare?

- Sa i zbatojmë rregullat që vendosi ai në lidhje me tregtinë?

- Sa i zbatojmë rregullat që vendosi ai në lidhje me jetën shoqërore?

Zemra e tij rrihte fort për të mjerët, të pashpresët, jetimët dhe ata që prisnin udhëzim. Po ne, sa të ndjeshëm jemi ndaj tyre?



Marrëdhënia e një myslimani me të Dërguarin e Allahut ﷺ, nuk përbëhet nga një ritual specifik vetëm për kohë të caktuara. Për këtë arsye, mënyra më e mirë për të ringjallur përkujtimin ndaj tij, të cilin e realizojmë çdo vit, është:

– Të jemi bashkë me Profetin ﷺ, me gjithë zemër gjatë gjithë jetës sonë, të përvetësojmë zakonet e jetesës së tij dhe t'i bindemi atij me besnikëri.

– Deri në frymën e fundit, të bartim në zemrat tona ndjenjën: «Sikur i Dërguari i Allahut të ishte me ne tani, a do t'i buzëqeshte gjendjes sonë, apo do të trishtohej zemra e tij e bekuar?"

– Të kemi një zemër të ndjeshme që; çdo vendim që marrim dhe çdo hap të rëndësishëm që hedhim në jetë, ta bëjmë në përputhje me pëlqimin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ.



Të mos harrojmë se; gjatë historisë Islame, edhe populli ynë ka pasur nderin që me entuziazmin e besimit dhe dashurinë për Profetin ﷺ, të jetë flamurtar i rrugës së tij. Prandaj, për të arritur edhe njëherë atë nder të lartë, duhet ta duam atë Profet më shumë se jetët tona dhe ta peshojmë gjendjen tonë me gjendjen dhe sjelljet e tij. Por, për ta realizuar këtë, pikësëpari jemi të detyruar të kuptojmë se si mund të përparojmë në gjurmët dhe rrugën e tij. Sot, është e rëndësishme të bëjmë përpjekje për t'u përkushtuar plotësisht ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, sa kemi mundësi, sepse, nuk do të kishte dobi që nesër, në botën tjetër, të vajtonim si jobesimtarët që shijojnë dënimin e xhehenemit, e thonë:

"...Mjerë ne! Ah sikur t'i ishim bindur Allahut dhe Profetit!" (el-Ahzab, 66.)





DHURIMI, PASRUIA E VËRTETË

Pasuria jonë e vërtetë është ajo çfarë ne dhurojmë. Gjithçka që mund të japim për Zotin, është e jona. Bamirësia që bëjmë është e jona. I varfëri, i vetmuari, jetimi që marrim në zemër është i yni, sepse, nëpërmjet tyre do të fitojmë pëlqimin e Allahut – inshaAllah-. Prandaj, ne duhet t'i konsiderojmë ato si mirësi hyjnore.

Thesari më i çmuar i grumbulluar në këtë botë, janë zemrat e fituara. Ndërsa pasuria më e vlefshme, janë lutjet e mira si mëshirë për ne, të cilat ngjiten tek Allahu duke dalë nga zemrat e trishtuara që ne i bëjmë të lumtura.

Allahu i Lartmadhëruar është Dhuruesi e Dhënësi më bujar, Ai është më Bujari i bujarëve. Mëshira e Tij ndaj të varfërve, nevojtarëve dhe zemërthyerve është e pafundme. Mirësia dhe begatia e Tij ndaj robërve të Vet janë shumë të gjëra. Allahu i Lartmadhëruar kërkon prej besimtarëve që i ka krijuar si zëdhënësit e Tij në tokë e si dëshmuesit e Qenies së Tij, të pajisen me cilësitë më të bukura; pra Ai dëshiron që edhe besimtarët të jenë të mëshirshëm, bujarë, të ndërgjegjshëm, të ndjeshëm dhe delikatë.

Islami përgatit personalitete zemërgjerë dhe mjaft të ndjeshëm. Ai e ka bërë farz zekatin për të mënjanuar urrejtjen dhe armiqësinë mes të varfërve dhe të pasurve në shoqërinë njerëzore, për të ruajtur ekuilibrin dhe për të siguruar lidhjen shpirtërore. Ai ka inkurajuar dhurimin duke e ngritur atë në nivelin e "Isarit" për të forcuar vëllazërimin Islam si dhe për ta plotësuar besimtarin "me shpirt të pasur".

Kur e kanë pyetur Muhamed Hakimin se; çfarë është dhurimi?

Ka thënë: *"Dhurimi është qetësia shpirtërore që ndjen kur gëzon dikë"*.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

"Kur Allahu ia do të mirën dikujt, e bën atë të përparojë në rrugën e shërbimit dhe të kryerjes së nevojave të të tjerëve." (Sujuti, II, 4/3924.)

"Më i miri ndër njerëzit, është ai më i dobishmi për të tjerët." (Bejhaki, Shuab VI, 117.)

"Ai që bëhet shkaktar për një punë të mirë, është njësoj si ta ketë kryer vetë atë." (Tirmidhi, Ilim, 14.)

Me dëshirën për t'u përfshirë në sihariqin në fjalë të Profetit, Aliu رضي الله عنه, është shprehur:

"Janë dy mirësi që nuk e di se cila prej tyre më gëzon më shumë. E para, kur një njeri vjen tek unë (më zgjedh mua) duke shpresuar se unë mund t'ia plotësojë nevojën dhe më kërkon ndihmë me sinqeritet të plotë. Ndërsa e dyta, kur Allahu Teala ia plotëson kërkesën këtij personi ose ia lehtëson çështjen në sajin tim. Për mua është më mirë t'i plotësojë nevojën një myslimani, se sa të kem një botë të tërë me ar e argjend." (Ali el-Muttaki, Kendhul-Ummal, VI, 598/17049.)

Njëri prej emrave të bukur të Zotit (xh.xh.), është edhe "Vehhab", që do të thotë "Dhënës me bollëk dhe pa hesap". Prandaj, edhe njeriu është krijuar me natyrën për të dhënë.

Për shembull, bleta prodhon mjaltë shumë herë më tepër se sa ka nevojë. Më pas, ajo e vulos atë në mënyrën më të mirë, ku një pjesë të vogël e përdor për vete, ndërsa një pjesë e le për njerëzit.

Bujaria e pëlqyer nga Allahu, është dhënia e diçkaje nga pjesa më e mirë e saj. Dhënia e bën njeriun të meritojë pëlqimin hyjnor në atë masë, sa t'i kushtojë kujdes këtij kriteri.

Pemët japin fruta të cilat janë shumë të rëndësishme për jetën e njeriut. Midis mijërave frutave, mjafton vetëm një farë për të kultivuar një pemë, pjesa tjetër e frutave i ofrohet njeriut.

Po ashtu edhe kafshët që theren për mish, i ofrohen njeriut për ushqim.

Të gjithë shembujt dhe mjedisi që na rrethon, na inkurajojnë të jemi altruistë dhe bujarë; një pjesë të asaj që fitojmë, ta dhurojmë për të plotësuar nevojat e të tjerëve. Kurse në disa ajete, bujaria është përngjasuar me shitblerjen dhe është konsideruar si një borxh i bukur që i jepet vetë Allahut dhe që vetë Allahu siguron që do t'ia kthejë shumë fish.

Sadi Shirazi thotë:

"Bujari është si pema që jep fruta, ndërsa koprraci është si pema që rritet në mal."

Në një hadith, Profeti ﷺ, thotë:

"Njeriu bujar, është pranë Allahut, xhenetit e njerëzve dhe larg zjarrit të xhehenemit. Kurse njeriu koprrac, është larg Allahut, xhenetit e njerëzve dhe pranë zjarrit të xhehenemit!" (Tirmidhi, Birr, 40/1961.)

Shejh Sadi thotë:

«Një njeri bujar që ha dhe u jep ushqim të tjerëve, është më i mirë se një adhurues që agjëron vullnetarisht dhe nuk i jep asgjë askujt.»

Të jesh në gjendje të shpenzosh nga jeta, pasuria dhe të gjitha llojet e mirësive për hir të Allahut, do të thotë të përjetosh lumturinë e pasurisë së vërtetë. Koprracët dhe hipokritët janë të privuar nga kjo lumturi. Prandaj, është e nevojshme të dihet se; aftësia për të shpenzuar duke respektuar dinjitetin e njeriut, është një bekim dhe lumturi e madhe.

Në një ajet, është urdhëruar: **"...Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty!.."** (Kasas, 77.)

Për rrjedhojë, besimtari duhet të dëshirojë për vëllain e tij atë që dëshiron për veten e tij. Ai duhet ta konsiderojë bekim dhe lumturi faktin që është në gjendje të ndihmojë vëllain e vet. Për këtë arsye, ai duhet të ndajë mirësitë që ka në dispozicion, pa më të voglin shqetësim; por përkundrazi, me kënaqësi dhe gëzim të papërshkrueshëm. Madje, ai duhet ta konsiderojë si fitim atë që mund të ndajë, sepse ajo që ai jep, është fitimi i vërtetë.

Një ditë, familja e Profetit ﷺ, kishte prerë një dele. Pasi kishin dhuruar një pjesë të mirë të saj, I Dërguari i Allahut ﷺ, i pyeti se çfarë kishte mbetur nga delja që kishin prerë. Aishja رضي الله عنها, iu përgjigj:

- Ka mbetur vetëm një shpatull.

I Dërguari i Allahut ﷺ, i qe përgjigjur:

- *"Në fakt, neve na paska mbetur e gjitha, me përjashtim të një shpatulle."* (Tirmidhi, Kiamet, 33/2470.)

Njeriu mërzitet kur i pakësohet pasuria materiale dhe gëzohet kur i shtohet. Kurse një zemër e mbushur plot me besim dhe

e pastruar nga çdo lloj interesi material, kënaqet me dashurinë e Allahut.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) **nga ajo** (pasuri) **që e doni..."** (Al-i Imran, 92.)

Sipas këtij ajeti, ne duhet të testojmë përpjekjet dhe bujarinë tonë në rrugën e Allahut dhe të rishikojmë nivelin tonë në këtë çështje. Ndërkohë që bëjmë një mirësi, duhet të kontrollojmë zemrën tonë: "Vallë, a jemi të lumtur kur japim? Apo mos ndoshta përjetojmë shqetësime të kësaj bote, hezitime shpirtërore dhe vështirësi brenda nesh?»

Allahut thotë:

"O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t'i pranonit ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë." (Bekare, 267.)

Një ditë, nëna jonë Aishja ﵂, dëshiroi të jepte si sadaka një sasi mishi, të cilit i kishte ndryshuar pak era. Mirëpo, Resulullahu ﷺ, e qorton duke i thënë:

"O Aishe! A dëshiron të falësh diçka që nuk e ha as vetë?!" (Hejthemi, III, 113.)

Në një hadith të kudsi, Allahu thotë:

"Jep o biri njeriut! Që edhe ty të të jepet!" (Buhari, Tefsir, 11/2; Muslim, Zekat, 36, 37.)

Kjo është e vlefshme për të gjitha gjendjet:

Fal që të falesh! Mëshiro që të mëshirohesh! Mbulo mangësitë e të tjerëve, në mënyrë që të mbulohen edhe të tujat! Largo një vështirësi të vëllait që të largohet edhe ty një vështirësi!..

Shejh Sadi thotë:

"Nëse dëshiron që Allahu të të japë mirësi, edhe ti bëju mirë robërve të Allahut. Kush e lumturon dikë për hir të Allahut, edhe Allahu e bën të lumtur atë."

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Allahu Azze ue Xhle, ka urdhëruar: ***"Dhuro dhe unë do të dhuroj ty"****. Thesaret e Allahut janë të mëdha. Asgjë prej asaj me të cilën furnizon krijesat, nuk e pakëson thesarin e Tij. Ai dhuron dhe furnizon ditë e natë pa ndërprerje. Mendo pak për ato që ka dhuruar Allahu qëkur ka krijuar qiellin dhe tokën! Ato nuk kanë pakësuar asgjë nga pasuria e Tij."* (Buhari, Tefsir 11/2, Teuhid, 22.)

Nëse një farë e vogël në hambar mbillet në kohë dhe siç duhet, ajo do të kthehet me më shumë bollëk dhe do ta mbushë përsëri hambarin. Po kështu, shpenzimi i mirësive të dhëna nga Allahu në rrugën e pëlqimit të Tij, nuk i pakëson, por përkundrazi, i shton ato.

Mevlana thotë:

"Për sa kohë që tek një njeri nuk ka gjë më të shenjtë se shpirti, atëherë ai (shpirti) me të vërtetë është i shenjtë. Mirëpo, nëse diçka fiton më tepër vlerë se shpirti, atëherë ai as nuk do të përmendet fare (do të harrohet). Pasuria dhe shpirti shkrihen si bora. Por nëse ato harxhohen në rrugën e Allahut, atëherë është pikërisht Allahu që i merr ato. Në Kuran thuhet**: "Allahu i Lartmadhëruar i bleu shpirtrat dhe pasuritë e besimtarëve në këmbim të xhenetit..."** (Teube, 111.)

Diçka që e ka blerë Allahu i Plotfuqishëm, do të shpëtojë nga humbja dhe shkatërrimi, e do të bëhet e përjetshme, duke fituar vlerë dhe nder të madh.

Sadi Shirazi thotë:

"Jep zekatin e pasurisë, sepse kur vreshtari i krasit hardhitë, ato japin më shumë prodhim!"

"Janë tri cilësi për të cilat mund të flas duke u betuar; mbajini mend mirë: Pasuria e njeriut nuk pakësohet duke dhënë sadaka. Allahu ia shton nderin atij që duron ndaj padrejtësisë që ka pësuar. Ndërsa atij që i hap vetes derën e lypjes, Allahu i hap derën e varfërisë!" (Tirmidhi, Zuhd, 17.)

Është fakt se; dhurimet në rrugën e Allahut, nuk e pakësojnë pasurinë. Përkundrazi, Ai na begaton në raport me sinqeritetin në dhënie. Deri më tani, nuk është parë që njeriu, i cili fiton në

rrugë hallall dhe jep në rrugë hallall për hir të Allahut, të bjerë në varfëri për shkak të dhurimeve të tij.

Allahut thotë:

"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllejnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) **edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm."** (Bekare, 261.)

Allahut thotë:

"Thuaj: «Me të vërtetë, Zoti im i jep begati të bollshme kujt të dojë nga robërit e Tij dhe ia pakëson kujt të dojë. Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë.»" (Sebe, 39.)

Babai im i ndjerë, Musa Efendia, hidhërohej shumë me ata që u thoshin lypësve;

"Zoti të dhëntë, Zoti të dhëntë!"- dhe thoshte:

"Vallë po neve kush na jep? Përse na jep neve Allahu? Vetëm për veten tonë?"

Pra, duhet të mendojmë:

Edhe ne kërkojmë vazhdimisht nga Zoti ynë, e prapë kërkojmë!.. Pasuria është e gjitha e Allahut. Prandaj robi nuk duhet ta harrojë se ai është vetëm përdoruesi i asaj pasurie, që është sprovë e jetës së kësaj bote. Po ashtu, nuk duhet të harrojmë kurrë se; të pasurit kanë gjithmonë përgjegjësi ndaj nevojtarëve.

Shejh Sadi, ka thënë:

"Nëse të troket ndonjë hallexhi në derë, mos e nis atë duarbosh! Larg qoftë, ndoshta një ditë bëhesh ti vetë i tillë, e detyrohesh të trokasësh derë më derë."

Sidomos në ditët tona ku çmenduria e shpenzimit ka arritur kulmin, besimtarët nuk duhet të harrojnë mirësitë dhe mundësitë që u ka dhënë Allahu.

Nuk duhet të harrojmë kurrë se; në pasurinë dhe mirësitë që zotërojmë, Allahu ka caktuar një pjesë për të varfrit dhe nevojtarët. Nëse nuk e shpenzojmë për hir të Allahut, mbesim krejtësisht të pambrojtur kundër fatkeqësive. Prandaj, bamirësia dhe shpenzimi në rrugën e Allahu është puna më e mençur që mund të bëhet.

Shejh Sadi ka thënë:

"O Trim! Mos ua thyej dorën të dobëtëve, duke i besuar fuqisë tënde! Mos ua plagos zemrat atyre, sepse edhe ti mund të biesh nën tiraninë e dikujt që është më i fuqishëm se ti..."

Nëse nuk duam që Zoti ynë të na largojë duarbosh nga prezenca e Tij Madhështore, edhe ne duhet të përpiqemi të mos e largojmë askënd nga dera jonë duarbosh dhe të trishtuar...

Jetët, pasuritë dhe mundësitë e tjera që na janë lënë amanet, nuk do të mbeten përgjithmonë në duart tona. Me siguri, një ditë, në mënyrë të papritur, do t'u themi lamtumirë të gjithëve dhe gjithçka do të kthehet në origjinën e vet. Prandaj, në këtë

jetë që na jepet vetëm një herë, le t'i shpenzojmë dhe t'i dhurojmë këto amanete hyjnore në një mënyrë që e kënaq Allahun, në mënyrë që të shpëtojmë edhe nga përgjegjësia e tyre në botën tjetër, por edhe të mos privohemi nga bekimet dhe mirësitë e jashtëzakonshme të Zotit tonë në këtë botë.

Ajo që i ka hije besimtarit, është që mirësitë e kësaj bote, të cilat me siguri një ditë do t'i dorëzojë, t'i përdorë në drejtim të kënaqësisë së Allahut, për të përfituar nga lumturia e vërtetë dhe e përhershme. Kjo, sepse pasuria e vërtetë e besimtarit, është ajo që ai ka grumbulluar për jetën e tij të përjetshme duke bërë vepra të mira.

Pasuria e kësaj bote, duhet fituar me qëllim që të fitohet prehja shpirtërore dhe lumturia e ahiretit, duke filluar me ndihmën material ndaj të afërmve, për të përfunduar tek të ngratët, të papërkrahurit dhe të mjerët e shoqërisë. Po qe se fitimi i pasurisë bëhet me këtë qëllim, vendin e ngurtësisë, sëmundjeve, krizave dhe shqetësimeve që u shkaktojnë zemrave kokëçarjet dhe dyshimet e kësaj jete, do ta zënë qetësia dhe prehja shpirtërore.

Profeti ﷺ, thotë:

"Po qe se dëshiron të të zbutet zemra, ushqe të varfrin dhe përkëdhele kokën e një jetimi!.." (Ahmed bin Hanbel, II, 263.)

Hadithi profetik thotë:

"Nxitoni në dhënien e lëmoshës, sepse fatkeqësia nuk mund t'ia kalojë lëmoshës." (Hejthemi, III, 110.)

Ahmet ibn Hanbeli thotë:

"Bëni bamirësi para se të dalin pengesa për ta realizuar atë."

Siç është më i vlefshëm namazi, kur falet në kohën e tij, ashtu edhe sadakaja është më e vlefshme kur jepet pa u vonuar.

Allahu thotë:

"Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t'i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: «O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!»" (Munafikun, 10.)

Ndërkohë që dhurojmë, duhet bërë kujdes në respektimin e disa rregullave:

1. Duhet treguar kujdes në sinqeritet. Dhënia dhe mirësia nuk duhen për synime materiale e të përkohshme, por vetëm për pëlqim të Allahut. (shih. Bekare, 264.)

2. Duhet të dhurojmë në atë mënyrë që, kur të japë dora e djathtë, të mos e shohë dora e majtë. Ata që japin në këtë mënyrë, do të falen dhe do të meritojnë të hyjnë nën hijen e Arshit në ditën e gjykimit. (shih. Bekare, 271; Buhari, Ezan, 36.)

3. Nuk duhet ta përmendim të mirën që kemi bërë. Kurani këmbëngul fort në lidhje me këtë. (shih. Bekare, 262-264.)

4. Duhet të japim gjëra që i dëshiron edhe për vete. (shih. Bekare, 267.)

5. Dhuruesi duhet të falënderojë marrësin e sadakasë, sepse në këtë mënyrë ai shpëton nga përgjegjësia dhe fiton shpërblime.

Për të mos qenë lypës nesër në Ditën e Kiametit apo i falimentuar i botës tjetër, duhet ta konsiderojmë mirësi dhurimin dhe bamirësinë me buzëqeshje dhe gjuhë të ëmbël ndaj nevojtarëve, vetëm duke shpresuar kënaqësinë e Allahut, pa pritur asnjë shpërblim të kësaj bote.

I Dërguari i Allahut ﷺ, kur nuk kishte asgjë për t'u dhënë të varfërve, e kthente kokën në anën tjetër prej turpit. Në lidhje më këtë situatë, u shpall ky ajet:

"Por nëse shmangesh nga ata (kur nuk ke asgjë për të dhënë)**, duke shpresuar në mëshirën e Zotit tënd, atëherë thuaju atyre ndonjë fjalë të butë."** (Isra, 28.)

Prandaj theksojmë faktin se, t'i buzëqeshësh vëllait tënd mysliman, t'i japësh selam atij dhe t'i thuash fjalë të ëmbla, është një adhurim shoqëror, i cili nuk duhet të nënvlerësohet.

Nëse Profeti ﷺ, e shihte një person në gjendje të mjerueshme, ngjyra e fytyrës së tij të bekuar ndryshonte për shkak të trishtimit. Por, kur ai ia plotësonte nevojat atij dhe e bënte të buzëqeshte, drita e paqes dhe lumturisë që ndjente reflektohej në fytyrën e tij të bukur. Madje, ai ndjente një gëzim më të madh se ata të cilëve u bëhej mirësi.

Një poet, gjendjen e isarit të Profetit ﷺ, e shpreh kështu:

"Nëse një ditë ndonjëri do të të krahasonte me retë për nga bujaria, do të gabonte, sepse retë kur japin qajnë, kurse ti kur jep qesh."

Sadi Shirazi shprehet:

"Miqtë e vërtetë të Allahut, bëjnë pazar në dyqanet ku nuk shkon askush..."

Pra, ata i njohin në fytyrë nevojtarët që nuk mund të tregojnë gjendjen e tyre, bëhen atë afërmit e të vetmuarve, dëgjojnë rënkimet e tyre të heshtura e jo të heshtura, dhe ashtu si dielli, ndriçojnë edhe vendet më të errëta.

Virtyti i vërtetë; është t'i dalësh zot një nevojtari apo një shërbimi vetëm për hir të Allahut, atëherë kur askush nuk e bën këtë.

Allahu i Plotfuqishëm, është me zemërthyerit. Prandaj, është e nevojshme të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe të sjellshëm ndaj të vuajturve dhe viktimave. Asnjë lloj merhemi nuk mund ta shërojë një plagë që shkaktojnë fjalët vulgare dhe lënduese në zemrat e trishtuara. Nëse qelqi thyhet njëherë, nuk do të jetë kurrë si më parë, sado të ngjitet më pas; ai mbetet përjetësisht me shenjë.

Zoti ynë urdhëron:

"Prandaj, mos e shtyp jetimin, e lypësin mos e shty me ashpërsi!" (Duha, 9-10.)

Shejh Sadi thotë:

"Mos e rrëno gemin e trëndafilit në vjeshtë, që të mos privohesh nga bukuria e tij në pranverë!"

"Kur t'i bësh mirë ndonjë njeriu, mos u mburr, duke thënë: «Unë jam zotëri, ndërsa ai ma ka nevojën mua!» Mos thuaj që koha e ka goditur atë! Shpata që godet, akoma nuk ka hyrë në këllëf. Mundet që një ditë, shpata në fjalë të të godasë edhe ty."

Mevlana, në vargjet e tij të famshme, ka thënë:

"Nevojtarët janë pasqyra e të pasurve. Mos i thuaj kurrë asaj fjalë fyese që thyejnë zemrën, në mënyrë që ajo të mos vishet me avull."

Aliu ﷺ, thotë:

"Të jesh nevojtar dhe i privuar është më mirë se të detyrohesh t'i jesh mirënjohës dikujt."

Si mirënjohje për mirësitë që zotërojmë, ne duhet ta konsiderojmë lumturi shërbimin dhe ndihmën ndaj atyre që janë të privuar nga ato mirësi. Madje, ne duhet të japim, duke qenë falënderues. Pra, duhet të dhurojmë në atë mënyrë që, mirënjohës të jetë dhënësi, jo marrësi. Kështu, sahabët e nderuar, të cilët janë brezi më shembullor i myslimanëve, kur i jepnin diçka dikujt, i thoshin:

"...Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura."
(Insan, 9-10.)

Ebu'l-Lejs Semerkandi, ka thënë:

"Personi që jep duhet ta qerasë marrësin në shenjë falënderimi për pranimin e dhurimit." Sepse ai që dhuron, në saje të këtij dhurimi do të arrijë te pëlqimi i Allahut Teala, e kështu do të përpiqet që të largojë fatkeqësitë, sëmundjet, shqetësimet dhe vështirësitë e ndryshme nëpërmjet duave të hajrit që do të fitojë përmes njerëzve që u ka dhuruar nga pasuria e tij.

Kur babai ynë i ndjerë, Musa Efendia, i jepte dikujt, ai tregohej shumë i mirësjellshëm dhe i kujdesshëm. Ai ishte i vetëdijshëm se; një dhuratë kalon në duart e Allahut, para se të shkojë tek nevojtarët. Kështu, ai e vendoste në një zarf shumën që do të jepte, dhe mbi të shkruante: *"I nderuar, zotëri! Faleminderit që pranuat dhuratën tonë!»*

Rumiu thotë:

"Ashtu siç ka nevojë një i varfër për bujari dhe mirësi, ashtu edhe një bujar dhe bamirës ka nevojë për të varfrin."

Në këtë botë, i varfri është nevojtar i të pasurit. Në botën tjetër, i pasuri do të ketë nevojë për duanë e të varfrit dhe për shpërblimin e lëmoshës që i ka dhënë të varfrit.

Në një hadithi thuhet:

"Duaji dhe afroji të varfrit, që të të afrojë Allahu Ditën e Kiametit". (Tirmidhi, Zuhd, 37/2352.)

Një dijetar përgatit një sofër shumë të begatë me plot të mira për një mysafir të verbër që do t'i vinte. Njerëzit përreth i thanë:

"Zotëri, pse u munduat kaq shumë? I ftuari juaj është i verbër dhe nuk mund ta shohë sofrën tuaj të begatë!"

Ai njeri i mençur, u dha një përgjigje të mrekullueshme:

«Po, ai i verbër nuk mund t'i shohë begatitë që kam përgatitur, por Zoti i tij i sheh!»

Zekati është sasia minimale që duhet të jepet. Dhënia e zekatit, më tepër se shfaqje e një virtyti, është shlyerje e një borxhi, sepse zekati është e drejta e të varfrit në pasurinë e besimtarit të pasur. Për rrjedhojë, kush nuk e paguan atë, do të thotë se ka grabitur të drejtën e dikujt.

Babai im i ndjerë, Musa Efendia -Allahu e mëshiroftë-, thoshte:

"Vjedhja më e shëmtuar, është vjedhja e pasurisë së të varfërve nga ana e të pasurve duke mos e dhënë zekatin."

Njëri prej adhurimeve pasurore që pothuajse është harruar, është "e dhjeta" ose "zekati i prodhimeve të tokës". Ata që s'e japin të dhjetën, janë fajtorë para Allahut ashtu si dhe ata që s'e japin zekatin. Duke mos e dhënë të dhjetën, ata grabisin të drejtat e të varfërve, nevojtarëve dhe të atyre që luftojnë në rrugën e Allahut.

Siç rrëfehet, një jemenas bujar kishte vreshta, kopshte hurmash dhe toka buke në afërsi të Sanas. Në kohën e mbledhjes së prodhimeve, ky njeri bujar veçonte për të varfrit, të vetmuarit dhe të dobëtit pjesën e të dhjetës dhe më tepër. Por, pas vdekjes së tij, të bijtë, të pushtuar nga etja për fitime të mëdha, menduan dhe vendosën së bashku kështu:

"Familja jonë është shumë e madhe, kurse mallin e kemi të pakët. Këtej e tutje nuk do t'u japim gjë të varfërve! Prodhimin do ta mbledhim sa pa ardhur ata!.."

Për shkak të këtij qëllimi të keq të tyre, Zoti ua shkatërroi prodhimet, kopshtet, vreshtat dhe arat ua ktheu në gërmadha të zeza.

Ndërkohë që fjala zekat përmendet në 32 vende në Kuran, fjala infak përmendet në 72 vende, në forma të ndryshme. Kjo tregon se besimtari nuk duhet të kënaqet me zekatin, i cili është masa minimale në sakrifikimin e pasurisë, por duhet të përpiqet të dhurojë më shumë nga vetja e tij.

Zekati është urdhër hyjnor për ata që janë të pasur fetarisht, kurse të qenit bujar dhe bamirës, është urdhër hyjnor për çdo besimtar, i pasur apo i varfër qoftë. Bujaria duhet të jetë natyra e çdo myslimani, pavarësisht nga rrethanat.

Kur zbritën ajetet e dhurimit, nxënësit e varfër të Suffes, nuk u justifikuan me varfërinë e tyre e të thonë: "Nuk kemi pasuri, andaj s'kemi çfarë të dhurojmë." Por përkundrazi, ata shkuan bënë dru zjarri në male, i shitën dhe të ardhurat ia sollën të Dërguarit të Allahut, në mënyrë që t'i përgjigjeshin thirrjes së ajetit, duke e praktikuar atë. Ata mësuan çdo gjë duke e jetuar dhe duke e vënë në praktikë. Ata e mësuan adhurimin në saje të praktikimit me sinqeritet, me përkushtim dhe devotshmëri.

Profeti ﷺ, kërkonte që të gjithë besimtarët të bënin bamirësi. Njëherë, Profeti ﷺ, i drejtua Ebu Dherrit ؓ, që ishte një sahabi shumë i varfër dhe i tha:

"Kur të gatuash supë shto ujë. Pastaj mendo se cili nga fqinjët e tu është më nevojtar dhe çoji edh atij një pjatë supë për të ngrënë."
(Muslim, Birr, 143.)

Siç kuptohet nga hadithi:

1. Fqinjët kanë të drejta dhe detyrime ndaj njëri-tjetrit.

2. Fqinjët duhet të bëjnë bamirësi ndaj njëri-tjetrit në mënyrë që të forcohen lidhjet midis tyre.

3. Kujdesi ndaj fqinjit nuk është detyrë vetëm për të pasurin por për çdo besimtar.

Allahu i Madhëruar në Kuran urdhëron:

"Ata të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi..." (Al-i Imran, 134.)

Për këtë arsye, Profeti ﷺ, edhe sahabët e tij, të cilët nuk kishin gjë tjetër veç një hurme, i inkurajonte të dhuronin qoftë edhe një gjysmë hurme. Domethënë, edhe ai që merr zekatin, duhet të japë diçka për hir të Allahut, me aq sa mundet.

Një ditë, i Dërguari i Zotit tha:

"Një dirhem i ka kaluar 100 dirhemët."

"Si ka mundësi diçka e tillë?" - e pyetën sahabët.

"Një burrë kishte dy dirhemë. Njërin prej tyre, më të mirin, e dhuroi si lëmoshë (pra dhuroi gjysmën e pasurisë). Kurse një tjetër (që ishte shumë i pasur) dhuroi nga pasuria e tij njëqind mijë dërhem."- u përgjigj Profeti ﷺ. (Nesai, zekat, 49.)

Allahu i Madhëruar, e shton të paktën e një personi, qëllimi i të cilit është i sinqertë. Një sadaka e vogël e dhënë me sinqeritet, është më e vlefshme se një mal bamirësie e dhënë në mënyrë të pavullnetshme.

Vlera e një fitoreje është më e madhe në raport me vështirësitë e kaluara për ta arritur atë. Për këtë arsye, të qenit bujar, altruist dhe vetëmohues edhe në kushte të vështira, është arti i zemrave që kanë brenda Zotin. Për këtë arsye, sakrificat e bëra gjatë kohës së vështirësive dhe varfërisë para çlirimit të Mekës, u konsideruan shumë më të vlefshme se sakrificat e bëra gjatë kohës së rehatisë pas çlirimit të saj.

Dhurimi i gotës së ujit, pas betejës së Jermukut, të cilën tre shehidët kërkonin t'ia dhuronin njëri-tjetrit edhe teksa po jepnin frymën e fundit, por që në fund mbeti e pa pirë nga asnjëri prej tyre, i ka tejkaluar mijëra e mijëra shembuj dhurimesh që mund të vlerësohen të mëdha për shkak të vlerave monetare që janë shpenzuar.

Isari është kulmi i bujarisë. Tekefundit, bujari është të dhurosh atë që ke tepër, të dhurosh atë që nuk të duhet. Ndërsa Isari është ta shkëpusësh nga vetja, të japësh një diçka për të cilën ke vetë nevojë. Të arrish t'i mundësh kundërshtimet e egos, dhe t'u bëhesh pengesë dëshirave të papërmbajtura të saj, është një fitore e shpirtit.

Ka një ndryshim të madh në vlerë dhe rëndësi midis ujit që i ofrohet dikujt pranë një burimi dhe ujit që i ofrohet ndërkohë që është duke vdekur nga etja në mes të një shkretëtire të djegur nga dielli; e para të shuan etjen, ndërsa e dyta të shpëton jetën.

Sheh Sadi ka thënë:

"Allahu nuk ia ka mbyllur askujt derën e mirësisë. Dije mirë

se; mirësia e çdokujt është në varësi të fuqisë së tij. Një sasi me ar që jep një i pasur nuk është e njëjtë me një karat të fituar me mundin e krahëve që jep një i varfër. Këmba e karkalecit, është peshë e rëndë për milingonën."

Bujaria, e cila është motoja e besimtarëve të drejtë, nuk do të thotë domosdoshmërisht të japësh nga pasuria materiale. Një buzëqeshje, një fjalë e ëmbël, një mbajtje e dorës atij që bie, dëgjimi i halleve të një vëllai të fesë, ndarja e kohës, punës, diturisë, urtësisë dhe zemrës me të, janë gjithashtu dhurime. Për këtë arsye, Islami nuk e pranon varfërinë si justifikim për dhurim dhe dëshiron që edhe besimtari më i varfër të jetë sakrifikues, bujar dhe altruist.

Profeti ﷺ thotë:

"Çdo punë legjitime dhe e bukur është sadaka!" (Buhari, Edeb, 33.)

Të dhurosh kur je i pasur nuk është shumë e vështirë. Kjo gjë nuk e vë në siklet dhuruesin, pasi ai po jep të tepërtën, pa hyrë fare në ndonjë ngushtësi. E vështirë është të jesh një njeri bujar duke qenë në mesin e varfërisë.

Aliu رضي الله عنه, ka thënë:

"Kur jeta të ofron pasuri të ndryshme, bëhu bujar. Tekembramja, të dhurosh, nuk e pakëson pasurinë. Por, edhe kur të mirat të pakësohen, ti sërish jep e dhuro. Ato jo gjithmonë do të qëndrojnë me ty."

Allahu thotë në Kuran:

"...Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: «Tepricën!»..." (Bekare, 219.)

Besimtari do të punojë dhe fitojë, dhe ajo që mbet përtej nevojës duhet të dhurohet. Edhe në nevojat e veta duhet të tregohet modest.

Kënaqësia më e madhe e të Dërguarit të Allahut ishte të dhuronte; të përmbushte nevojën e një të dobëti, të varfri, të vetmuari dhe nevojtari. Këtë ia mësoi edhe umetit (pasuesve) të tij.

Xhabiri ﷺ, thotë:

"Nuk njoh ndonjë sahab që të ketë pasur mall e pasuri e të mos e ketë dhuruar atë." (Ibnu Kudame, el-Mugni, V, 598.)

Paraardhësit tanë, osmanët, të cilët përfaqësojnë një periudhë të lavdishme në historinë e Islamit, pas Epokës së Lumturisë, themeluan një «qytetërim madhështor vakëfesh». Sulltanët, Nënat e sulltanëve dhe të pasurit, në vend të pasurive dhe xhevahireve të çmuara, lanë trashëgim xhami, medrese dhe komplekse të shumta; domethënë lanë një pasuri të madhe në bamirësi.

Ata e thurën thuajse gjithë shoqërinë me një rrjet vakëfesh, që janë institucione të dhembshurisë dhe mëshirës. Çdo lagje u bë siguria e të vejave dhe jetimëve, të varfërve dhe nevojtarëve. Ndërsa zemrat u bënë shtëpiza mëshire.

Në një shoqëri ku të vuajturit, të vetmuarit dhe të varfrit mbrohen nga institucionet e dhembshurisë, mëshirës dhe bamirësisë, krijohet një atmosferë vëllazërie e tillë, që asnjë politikan, soci-

olog apo psikolog nuk mund ta sigurojë. Zemrat bartin mëshirë për njëra-tjetrën. Zemrat bëhen strehë dhe mbështetje për të mjerët...

Ne akoma përfitojmë nga institucionet e bamirësisë që kanë lënë të parët tanë. Po ne çfarë do të lëmë pas? A do jemi në gjendje të lëmë monumente shërbimi dhe mëshirë?

Veprat e mira dhe dhurimet e bëra në këtë botë, janë si farat e mbjella për të korrat në botën tjetër.

Ne jemi udhëtarë për në ahiret, të cilëve një ditë do t'u merret e gjithë pasuria e përkohshme. Prandaj, le të dhurojmë me duart tona sot, para se të na i marrë vdekja me dhunë, e të shkojmë duarbosh në botën tjetër.

Bamirësia më e mirë është ajo që bëhet ndërsa je gjallë. Allahu thotë në Kuran:

Dhe, kur të sillet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet por ç'i duhet se u kujtua! Ai do të thotë: "Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!" (Fexhr, 23-24.)

Shejh Sadi ka thënë:

"Njerëzit e mençur e marrin pasurinë e tyre edhe kur shkojnë në botën tjetër. Ndërsa dorështrënguarit shkojnë duke lënë gjithçka në këtë botë."

I nderuari Es'ad Erbili ka thënë:

"Dihet se; kur qiraxhinjtë transferohen nga një shtëpi në tjetrën, marrin me vete të gjitha plaçkat dhe nuk lënë pas asnjë prej sendeve që i duan. Prandaj, është shumë e çuditshme që njerëzit të mos marrin me vete qoftë edhe një pjesë të sendeve që i duan, kur shkojnë në shtëpinë e varrit (duke i çuar përpara vetes në botën tjetër me anë të dhurimit)." (Mektubat, fq. 16, nr: 5.)

Pasuria jonë e vërtetë është ajo që kemi shpenzuar për bamirësi për hir të Allahut. Profeti ﷺ, thotë:

"Biri i Ademit thotë vetëm: «pasuria ime, pasuria ime!». O biri i Ademit! A mos ke pasuri tjetër përveç asaj që ha dhe konsumon, që vesh dhe e vjetron dhe asaj që e dërgon në botën tjetër si shpërblim, të cilin e ke fituar duke dhënë sadaka (lëmoshë)!?" (Muslim, Zuhd, 3-4; Tirmidhi, Zuhd, 34.)

Allahut thotë:

"O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) **në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë."** (Bekare, 254.)

Profeti ﷺ thotë:

"...Ata që kanë shumë pasuri në këtë botë, do të kenë pak sevape ditën e kiametit, përveç atyre që japin kështu, kështu, e kështu. Mirëpo, edhe ata janë shumë pak!.." (Buhari, Istikradh 3, Rikak 14; Muslim, Zekat, 32.)

Ata që ikin nga kjo botë, qofshin skllevër apo sulltanë, i gjithë kapitali i tyre në botën tjetër, është vetëm ai që kanë dërguar nga kjo botë...

Fëmijë besnik, është ai që e kemi rritur në rrugën e Allahut dhe që do të jetë sadaka e rrjedhshme për ne pasi të vdesim. Mik besnik, është ai, të cilin e duam për hir të Allahut dhe bëhemi vëllezër në kohë të vështira. Kurse pasuria besnike e kësaj bote, është ajo që tashmë e kemi shpenzuar dhe e kemi dërguar në ahiret.

Edhe në ditët tona ka nevojë për lëmoshë dhe bujari, brenda mundësive që kemi. Nuk duhet të harrojmë se ne mund të ishim në vendin e njerëzve të vuajtur dhe nevojtarë. Për këtë arsye, bujaria dhe zemërgjerësia jonë ndaj të sëmurëve, të dobëtëve, të vetmuarve, nevojtarëve dhe të uriturve, është borxh falënderimi ndaj Zotit.

Le t'i ndajmë përzemërsisht me nevojtarët mirësitë që kemi, me qëllim që zemrat të cilat i kënaqim dhe i lumturojmë, të jenë qetësia jonë shpirtërore në këtë botë, ndihma jonë në ahiret dhe lumturia jonë në xhenet.



DISTANCIMI NGA SHPËRDORIMI, KOPRRACIA DHE AMBICIA E TEPRUAR

Njerëzit e urtë kanë thënë:

"Kur vdes, njeriu përballet me dy fatkeqësi në lidhje me pasurinë, të cilat nuk i ka imagjinuar kurrë më parë. E para, humbet gjithë pasurinë dhe e dyta do të japë llogari për gjithë pasurinë megjithëse nuk e zotëron më."

Në sistemet njerëzore, prona i përket ose shoqërisë ose individëve. Në Islam, pasuria është e Allahut. Dy gabimet më të zakonshme në përdorimin e pronës dhe pasurisë janë; "shpërdorimi" dhe "koprracia".

Shpërdorimi, është shpenzimi pa kriter i pasurisë për dëshirat e ulëta egoiste, për të treguar fuqinë dhe për të shtypur ndjenjën e inferioritetit. Kurse koprracia, është kursim për veten. Të dyja janë atribute të shëmtuara që i kanë rrënjët në xhehenem.



Një nga fatkeqësitë më të mëdha të kohës sonë, është shpërdorimi. Është dëshira në formë sëmundjeje për t'u mburrur me gjërat e famës dhe të markës. Është çmenduri të blesh të njëjtin artikull shumë herë më shtrenjtë, vetëm për t'u mburrur me markën. Për më tepër, ato marka, kryesisht janë nga një kapital global sionist, armiqësor ndaj Islamit. Për rrjedhojë, me paratë e myslimanëve indiferentë, mbështeten zullumqarët.



Allahut thotë:

"Dorëshpuarit, në të vërtetë, janë vëllezërit e shejtanit dhe ai është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij." (Isra, 27)



Çmenduria e konsumit, mania për t'u dukur dhe dëshira për të demonstruar forcën, e nxitur nga bota e sotme materialiste dhe kapitaliste, fatkeqësisht i shtyn njerëzit në një nxitim sfilitës si kuajt e garës, për të fituar dhe shpenzuar sa më shumë. Kjo, sepse vlera e çdo gjëje, matet thuajse vetëm në kritere materialë, gjë e cila i helmatis së tepërmi shpirtrat e njerëzve. Madje, kjo e verbon ndërgjegjen, e bën robin të harrojë ahiretin dhe e qërron përballë të ardhmes së amshuar. Po ashtu, kjo ua thanë burimin e falënderimit, mirënjohjes, pëlqimit, kënaqësisë dhe përulësisë dhe qetësisë shpirtërore. Mirëpo, asnjë pasuri materiale nuk mund të sigurojë paqen shpirtërore që mund të fitohet duke jetuar një jetë të thjeshtë me bindje dhe përulësi.

Shpenzimi i pasurisë, e cila është një mjet sprove hyjnore, në një mënyrë që e kënaq Allahun, bëhet kapitali i një lumturie të përjetshme. Në të kundërtën, shpërdorimi i saj me ekstravagancë dhe koprraci, bëhet shkak i zhgënjimit të përjetshëm.

Çdo person do të mbajë përgjegjësi për mënyrën se si e ka fituar dhe shpenzuar pasurinë e tij, e cila i është dhënë si mjet sprove. Prandaj, të dish të përdorësh saktë pronën dhe pasurinë në shkollën e kësaj bote, është një art i vërtetë, sepse të shpenzosh pasurinë vetëm për qejfet e egos, është shpërdorim, dhe ta mbash atë vetëm për veten është koprraci.

Sadiu thotë:

"Koprraci mbledh para me vështirësi, i fsheh me përpikëri dhe ndërron jetë duke u mallëngjyer për to. Ari del duke gërmuar tokën,

kurse pasuria nga njeriu koprrac, del bashkë me shpirtin. Dy veta janë lodhur kot. I pari është ai që mëson dituri por nuk vepron sipas saj, i dyti është ai që ka pasuri por nuk shpenzo për bamirësi."



Aliu ﷺ, thotë:

"Është shumë interesante gjendja e koprracëve. Në këtë botë jetojnë si të varfër kurse në botën tjetër japin llogari si të pasur."



Shejh Sadi, -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

"Një njeri të urtë e pyetën:

«Kush quhet fatlum, e kush quhet fatkeq?»

Ai u përgjigj:

«Fatlum quhet ai që ha dhe mbjell. Ndërsa fatkeq quhet ai që (kursen dhe) kur vdes ikën dhe lë gjithçka.»



Në një ajet fisnik urdhërohet:

"Shejtani ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij..." (Bekare, 268.)

Allahu i Madhëruar nuk dëshiron që robi i Tij të jetë dorështrënguar. Koprracia është dobësi e besimit që lind nga frika e rënies në varfëri dhe nga mungesa e besimit te Zoti. Kjo nënkupton strehimin e robit tek pasuria e tij e përkohshme, në vend që të strehohet te Krijuesi i tij. Kështu, në njëfarë pike, ai fillon ta kthejë pasurinë në një idhull. Mirëpo, Allahu i Madhëruar është Ai që ia ka dhënë atë pasuri.

Prandaj, besimtari duhet të mbështetet gjithmonë te Zoti i tij dhe me guximin e besimit ta mposhtë koprracinë e shpirtit dhe frikën nga varfëria, që është cytje e shejtanit.

Egoja e njerëzve të shkujdesur, është dorështrënguar. Ai e përqafon fort pasurinë e tij, duke menduar se ajo do ta bëjë të përjetshëm. Ai nuk i beson premtimit hyjnor se dhurimi e shton pasurinë, por iluzionin djallëzor se ai do të bëhet i varfër nëse dhuron. Megjithatë, të qenit dorështrënguar dhe të kapur pas pasurisë, nuk mund të largojë kurrë caktimin e Allahut. Domethënë, nëse Zoti i Madhëruar dëshiron t'ia marrë përsëri pasurinë që i është besuar, koprracia e tij nuk mund të pengojë humbjen e saj.

Sadi Shirazi thotë:

"Sikur njerëzit të mbështeteshin tek Allahu aq sa janë të lidhur pas sigurimit të jetesës, do të kalonin edhe engjëjt në grada të larta."

Pasuria është amanet nga Allahu i Madhëruar; nuk i dihet kurrë se; kur ta jep dhe kur ta merr. Prandaj, është gabim i madh të mendosh se do ta zotërosh gjithmonë atë dhe të mbështetesh te ajo, e jo tek Ai që ta ka dhuruar.

Junus Emre, gjendje e tyre që janë mashtruar nga pasuria e kësaj bote e shpreh kështu:

O i pasur, o pronar!
E njeh vallë Pronarin e parë?
Edhe pasuria edhe prona gënjeshtra janë
Të mashtruar ty qëllim e kanë.

Çuditërisht, të shkujdesurit jetojnë në pronën e Zotit, por mbeten të pavëmendshëm ndaj pronarit të vërtetë të pronës dhe bëhen robër të dëshirave të tyre. Përballë madhështisë dhe rrjedhave të fuqisë hyjnore, ata jetojnë në konfuzion dhe dëshpërim, dhe si rrjedhojë, ata bien në humbje të përjetshme. Sa kuptimisht e shpreh shkujdesjen poeti Nexhip Fazëll, kur thotë se ajo është sikur të braktisësh të vërtetat hyjnore që janë po aq të dukshme sa dielli dhe të mashtrohesh nga mirazhet kalimtare:

Ndërsa zemra ime dëshiron të fluturojë në mbretëritë qiellore,
Këmbët e mia pengohen ndër hijet në tokësore...

Rumiu thotë:

"Ata që ia kanë dhënë zemrën kësaj bote, i ngjajnë gjuetarit që gjuan hijen. Si mund të jetë hija gjahu i tyre? Në këtë mënyrë, një i çmendur pandehu se hija e zogut ishte vetë zog dhe dëshiroi ta kapë. Por edhe zogu në degë, u habit nga ky budallallëk."

Besimtari është ruajtësi i amanetit të Allahut, Pronarit të vërtetë të pasurisë. Ai është si një arkëtar, që është përgjegjës për përdorimin e pasurive dhe mjeteve të tij në përputhje me udhëzimet hyjnore. Prandaj, është absurde që arkëtari të dashurohet pas parave që i janë besuar. Detyra e tij e vetme është të përmbushë detyrën e dhënë nga pronarët e vërtetë të parave.

Jemi në një botë sprove që konsiston në ofrimin e asaj që Allahu na ka dhuruar njëherë. Vërtet, e kujt është jeta dhe pasuria? Kush jep jetë, kush jep pasuri? Kur jemi dorështrënguar, kë po privojmë nga ajo pasuri?

Ne nuk erdhëm në këtë botë për të zotëruar, por për të qenë dëshmitarë. Me fjalë të tjera, ne nuk erdhëm për të grumbulluar mallrat e botës kalimtare, por për të fituar ahiretin tonë si dëshmitar të Allahut në tokë dhe përfaqësues të Islamit. Prandaj, është e nevojshme që ne t'i bëjmë mirësitë e kësaj bote dëshmitare të besimit tonë. Për këtë, para së gjithash, ne duhet ta shohim pasurinë jo si «pronën tonë», por si «amanet të Zotit».

Sot, disa prona quhen «*time-share*» dhe përdoren nga njerëz të ndryshëm në kohë të ndryshme. Mirëpo, kur shikohen nga pikëpamja e besimit, të gjitha pasuritë e përkohshme janë të tilla.

Të mendosh se je «zotëruesit» absolut dhe të mos japësh asgjë prej këtyre pronave «*time-share*», nga të cilat vdekja do t'i ndajë një ditë, është vetëm një shenjë e indiferencës së thellë. Ne nuk u dërguam në këtë botë për të humbur jetën tonë pas lodrave kalimtare.

Imam Shafiu thotë:

"O ti që mendon se ke gjetur fisnikëri me dynjanë dhe gjërat e bukura të saj! Vdekja do t'i vijë edhe ndërtesës, edhe atij që e ka ndërtuar... Kushdo që ka për fisnikëri dynjanë dhe gjërat e bukura të saj, le ta dijë se fisnikëria e tij është shumë e pakët, provizore dhe e përkohshme... Dije se thesaret e kësaj bote janë prej floriri. Ti formoje thesarin tënd prej mirësive dhe besimit!.."

Qytetërimet e rreme, të cilat janë larg dhembshurisë dhe mëshirës, ngrenë monumentet e pakuptimta dhe të vdekshme të artit dhe pandershmërisë, krenarisë dhe mendjemadhësisë, duke qenë larg Artistit Madhështor. Ata ndërtojnë arena ku hedhin qeniet njerëzore në gojët e egërsirave; ndërtojnë pallate ku argëtohen si të çmendur, egoistë dhe moskokëçarës. Madje, për të shfaqur fuqinë dhe pushtetin e tyre, ata e lartësojnë padrejtësinë dhe mendjemadhësinë duke ngritur piramida nën forcën e dhunës dhe ndjehen të kënaqur nga lavdet që u thurin servilët dhe duartrokitjet e tyre të shëmtuara. Por, do të vijë dita që ata do të shkatërrohen, dhe në monumentet e tyre të mendjemadhësisë, do të shëtisin qentë.

Ne nuk duhet të mashtrohemi nga mirëqenia dhe lumturia e kësaj bote e jobesimtarëve, njerëzve të gënjeshtrës, mëkatarëve, njerëzve të këqij që janë përgjegjës për korrupsionin dhe degjenerimin, dhe nuk duhet të imitojmë asgjë prej tyre. Ata që dikur e admironin me zili pasurinë dhe madhështinë e Karunit, e panë fundin e tij të trishtuar dhe u penduan për atë që kishin bërë.

Aliu ﷺ, thotë:

"Miqtë e Allahut, janë ata që shohin anën e brendshme të botës, kur njerëzit shohin anën e jashtme të saj."

Ata që nuk e mësojnë në këtë jetë se; të gjitha mirësitë janë një amanet i Allahut të Madhëruar, në varr do ta kuptojnë se; në të vërtetë, nuk kanë zotëruar qoftë edhe një gjilpërë!

Ja varrezat!..

Me triliona njerëz prehen aty (në varreza) me duart bosh. Pranë tyre kanë vetëm një qefin prej dynjasë. Edhe ai tashmë është kalbur plotësisht. Tani nuk kanë asnjë gjë prej atyre që pohonin se janë të tyre.

Këtë nuk duhet ta harrojmë asnjëherë: Në dhe do të varrosemi me veprat tona të mira apo të këqija.



Një i urtë, thotë:

"Çudi!.. Njerëzit e kësaj bote po hanë njëri tjetrin për gjërat që po pendohen ata që janë në varre..."

Ata që janë në varreza e kanë kuptuar tashmë që gjërat mbas të cilave vraponin nuk vlenin për asgjë, por tani është tepër vonë!



Një besimtar, nuk duhet ta harrojë këtë mësim në lidhje me shërbimin dhe dhënien e ndihmesës:

Pasi varroset një xhenaze, farefisi i ka mbaruar ngushëllimet, ndërkohë që krimbat arrijnë tek trupi. Më pas, ndërsa trashëgimtarët fillojnë takimet për ndarjen e mallit, toka ka filluar ta copëtojë dhe ta tretë trupin. Të dy këto veprime, në një farë mënyre fillojnë dhe përfundojnë së bashku. Ndërkohë që nga njëra anë tretet trupi, nga ana tjetër tretet pasuria. Shpirti, i cili e sheh me habi këtë situatë, kërkon të rrahë gjunjët me duar, si për të shprehur pendimin për atë çfarë ka bërë; por tashmë nuk ka as dorë dhe as gju! Vetëm punët e tij veçohen! Punët e devotshme dhe të dobishme në këtë botë, do të bëhen pasuria e tij më e dobishme në jetën tjetër.



Jeta e kësaj bote është një udhëtim me pengesa, të cilat duhet të kapërcehen, sepse fundja kjo botë është vend sprove dhe jo vend rehatie. Një person që harron rrugën se për ku është nisur, është i destinuar të humbasë dhe të mbetet pa furnizime. Një udhëtar që niset drejt një vendi, nuk humbet kohë me gjëra të pavlefshme gjatë rrugës, por përgatitet seriozisht për të arritur sa më i sigurt dhe shëndoshë e mirë në destinacionin e duhur.

Pasuritë e përkohshme të pazarit të kësaj bote, të cilat të verbojnë sytë, të magjepsin zemrën dhe pas cilave shpenzohet jeta, mbeten po në këtë botë. Kur njeriu shkon në varr, ai merr me vete vetëm një qefin si gjë e dynjasë. Zoti i Plotfuqishëm, për njerëzit fatkeq që e kalojnë jetën në ndjekje të pasioneve të tyre të kësaj bote dhe shkojnë në ahiret duarbosh, urdhëron;

«عَامِلَةٌ نَاصِبَةٌ» «**Kanë punuar e janë rraskapitur** (kot)» (Gashije, 3)

Hafiz Shirazi, thotë:

"Njeriu; një pikë gjak, mijëra shqetësime"

Dhe me të vërtetë që; trupi i njeriut përbëhet nga mishi dhe kockat. Por, bota e tij e brendshme, ka një mijë e një shqetësime: Shqetësimi për ushqimin, shqetësimi për shëndetin, shqetësimi për të ardhmen, ëndrrat e pafundme, planet, ambiciet...

Ndërsa, kur të vijë vdekja, të gjithë do të këputen papritur, duke u shndërruar në hije që zhduken.

Pra njeriu;

– Nuk duhet të mashtrohet as nga thesaret që gjen në botën e ëndrrave të tij.

– Nuk duhet të ankohet e të vajtojë as për gjendjen e keqe në të cilën ndodhet.

– Nuk duhet as ta kthejë jetën e tij të përjetshme në humbje për hir të dashurive kalimtare.

–Ai duhet ta shikojë gjithmonë botën e vdekshme nga horizonti i përjetësisë.

– Ai duhet të mbrojë zemrën e tij nga të qenit burg shqetësimesh kalimtare dhe të gjejë qetësinë e nënshtrimit dhe dorëzimit ndaj Zotit...

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Në këshillin tuaj mos pranoni në asnjë mënyrë këta tre persona:

Koprracin, frikacakun dhe lakmitarin. Koprraci ju largon nga bamirësia, duke ju frikësuar me vështirësitë dhe problemet që mund të shfaqen në të ardhmen. Frikacaku ju dobëson guximin dhe vullnetin për punë të mëdha. Ndërsa lakmitari jua zbukuron lakminë dhe ju nxit në padrejtësi."

Përballë veprave të mira, dalin shumë justifikime që burojnë nga egoja dhe shejtani. Për shembull, personi që duhet të japë lëmoshë, justifikohet duke thënë: "-A nuk është mëkat të lypësh? Kur t'ia jap këtë lypësit, a nuk do ta inkurajoj atë të lypë më shumë?».

Edhe pse fjalë të tilla mund të duken të logjikshme, ato janë një justifikim për koprraci. Për këtë arsye, babai ynë i ndjerë Musa Efendi ka thënë:

"Duhet të japësh, qoftë edhe pak; por jo të mundesh nga koprracia e egos..."



Sa tablo mësimdhënëse është që:

Shumë vende evropiane, të cilat tregohen dorështrënguar për të mos ndihmuar refugjatët dhe për të mos ndarë pasurinë e tyre me ta, iu desh të shpenzonin shumë më tepër para gjatë epidemisë. Sa kuptimplote janë thëniet e mëposhtme të Shejh Sadiut përballë kësaj skene:

"Në ditët tuaja të mira, fitonin zemrën e të varfërve, të vetmuarve dhe nevojtarëve! Fitimi i zemrave të tyre do të largojë belatë që mund t'ju vijnë. Nëse nevojtari të kërkon diçka duke paraqitur gjendjen e vet tek ty, jepja! Nëse nuk e bën, do të dalë ndonjë mizor dhe do ta marrë me dhunë».



Bujaria, është kushti i parë dhe thelbësor për të qenë mik i Allahut. Nga ana tjetër, koprracia është arsyeja kryesore e privimit nga begatitë shpirtërore.

Mevlana e përshkruan këtë të vërtetë si vijon:

"(O Zoti im!) Koprracët dhe të shkujdesurit nuk mund të përfitojnë nga shkalla e fshehtë që ke vendosur para robërve të tu për t'u ngjitur në miraxh. Ti ua tregon shkallën e miraxhit njerëzve të besueshëm, të drejtë dhe bujarë, në mënyrë që karvani i shpirtrave të mirë, të ngrihet drejt qiejve të Tu." (Divan-i Kebir)



Aliu ﷺ, thotë:

"Pasuria (që nuk shpenzohet) është lënda e parë e dëshirave egoiste. Ndërsa dëshirat egoiste janë gjithashtu çelësi i telasheve."

Shejh Said thotë:

"Njeriu ka nevojë fillimisht për mendje dhe zemër. Pasuria vjen pas këtyre, sepse pasuria dhe fuqia e të shkujdesurve mund të jetë një armë lufte kundër Allahut."

Çdo mirësi që robi e bën kapital të egos së tij, në të vërtetë nuk është mirësi, por fatkeqësi shpirtërore që do t'ia kthejë jetën e përtejme në vuajtje.

Omeri ﷺ, ka thënë:

"Pakësoji dëshirat e tua në lidhje me këtë botë, që të jetosh i lirë! Pakësoji gjynahet që vdekja të të vijë e lehtë!"

Rumiu thotë:

"Mos u jep shumë mbas pasurisë dhe pozitës; që kur të vijë koha mos ta kesh të vështirë shkëputjen prej saj. Jepe pa u menduar, shko e fito sevap! Dhuroja veten Atij që të mban; Ai është i Pari, e Ai është i Fundit. Nëse dëshiron ta gjesh Atë, hiqe peshën e nefsit që ta fundos varkën e shpirtit, që të arrish ku dëshiron!"

Imam Shafiu ka thënë:

"Kush thotë se mund të mbledhë në një vend edhe dashurinë për dynjanë, edhe dashurinë për Allahun, veçse ka gënjyer!"



Profeti ﷺ, thotë:

"Kur umeti im të fillojë ta vlerësojë botën shumë (si rob i pasioneve të egos), atyre do t'u hiqet madhështia dhe dinjiteti i Islamit. Kur të braktisin urdhërimin në punë të mirë dhe ndalimin nga e keqja, do të privohen nga begatia e shpalljes, pra kuptimi i Kuranit." (Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, nr: 1610; Ali el-Muttaki, Kenz, III, 183/6070.)



Profetit ﷺ, i takonte një e pesta e plaçkës së luftës; po të dëshironte mund të bënte një jetë mjaft të pasur me të. Por ai zgjodhi të bëjë një jetë të thjeshtë dhe pa luks. Ai u mjaftua me plotësimin e nevojave kryesore. Në këtë mënyrë, u bë shembull për të pasurit falënderues. Kur në shtëpinë e tij nuk kishte gjë tjetër përveç ujit, duronte dhe falënderonte duke u bërë shembull i të varfrit durimtar. Shembull dhe model praktik në çdo aspekt...



Njeriu indiferent, i cili nuk e kupton se jeta e vërtetë është ajo e ahiretit, përpiqet të kapet fort pas mirësive të përkohshme të kësaj bote, në të cilën ai është vetëm mysafir. Ai mendon se mundësitë e tij të përkohshme, si prona dhe pasuria, do ta mbrojnë dhe madje do ta bëjnë të përjetshëm në këtë botë. Mirëpo, në të vërtetë, cilësia më dalluese e kësaj bote, është mungesa e besnikërisë.



Rumiu ka thënë:

"Dynjaja (vendi i sprovave), është si një magnet (i dëshirave të ulëta), që tërheq të gjithë kashtën. Prej saj shpëton vetëm gruri (pra, besimtari i mençur, bota e brendshme e të cilit është e mbushur me urtësi)."



Zhytja në një jetë, e cila jetohet e pavetëdijshme ndaj së vërtetës së botës tjetër, me lojëra të përkohshme dhe interesa të kësaj bote që tundojnë dëshirat e egos, është një mashtrim i frikshëm në krahasim me ardhmërinë e madhe e të pafundme.



Dynjaja është si një mirazh mashtrues, që u ngjan si ujë egove të papërpunuara, të cilat nuk e kanë arritur përsosmërinë. Në mënyrë figurative, mund të krahasohet me mollën e sheqerit që pëlqehet shumë nga fëmijët; nga jashtë reflekton ngjyra të ëmbla, por në fakt brendësia ka përmbajtje të thartë dhe të prishur.



Të robërohesh nga tundimet e praruara të kënaqësive të kësaj bote, të mashtrohesh nga gënjeshtrat mashtruese të makijazheve të rreme, do të thotë ta pandehësh «mjerimin» si «lumturi»



Tipari dallues i kësaj bote është pabesia. Një ditë, ajo patjetër do të marrë atë që ta ka dhënë. Ajo i sakrifikon shpejt ata që janë të dashuruar pas saj. Një ditë të ngre, të nesërmen e gropos në fund të tokës. Ajo është si një hije. Nëse përpiqeni ta kapni, ajo gjithmonë do të ikë. Por edhe nëse ti i ikën asaj, nuk të lë të ikësh...



Rumiu ka thënë:

"Dynja, do të thotë të jesh indiferent ndaj Allahut, e jo të zotërosh para, veshje të bukura, gra dhe fëmijë! Çdo gjë që të bën ta harrosh Allahun, është dynjaja jote!"



Allahu i Madhëruar, i ka dhënë njeriut një zemër që të jetë i zënë me dhikër, meditim dhe falënderimi. Nëse robi ia kushton zemrën e tij Allahut, nëse ndjek rrugën e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe i bën vend besimit, Islamit dhe ihsanit, nuk dëmtohet nga punët e dynjasë. Por, nëse ai ia jep zemrën dashurive të kësaj bote kalimtare dhe mbetet i pavëmendshëm ndaj Zotit të tij, nuk do të arrijë ëmbëlsi dhe frymëzim shpirtëror në adhurimin e tij.



E gabuar, nuk është të kërkosh pjesën tënde nga kjo botë, por të dashurohesh me të, të neglizhosh detyrat fetare, të jesh shpërdorues ose koprrac, duke u bërë kështu rob i dynjasë. Nuk duhet harruar se; vendi i parave është në kasafortë ose në çantë, e jo në zemër!



Devotshmëria, zuhdi dhe takua, nuk është të braktisësh botën; por, ashtu siç veproi edhe Sulejmani عليه السلام, të mos lejosh që dashuria për botën të zërë vend në zemër.



Njëherë, Sulejmani عليه السلام, po kalonte në një vend me ushtrinë e vet, të përbërë prej njerëzve, xhinëve dhe shpendëve. Kur arriti në Luginën e milingonave, një prej tyre, e vuri re ushtrinë e Sulejmanit عليه السلام dhe u thirri milingonave të tjera:

"...O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!" (Neml, 18.)

Sulejmani ﷺ, i cili e njihte gjuhën e kafshëve, i dëgjoi këto fjalë dhe tha:

"Jo, pushteti im është i përkohshëm! Edhe jeta ime e kësaj bote është e kufizuar. Ndërsa lumturia hyjnore që i sjell dikujt Kelime-i Teuhid, është e pafund!"

Nëse e gjithë bota do t'i jepej vetëm një personi dhe ai do të mbretëronte për njëmijë vjet me kënaqësi e argëtim, përsëri ai do të vdiste një ditë dhe ato mirësi do të mbeteshin në këtë botë. Të jesh në gjendje të falënderosh Allahun dhe të marrësh pëlqimin hyjnor me anë të mirësive kalimtare, është kapitali i vërtetë i lumturisë së përjetshme në ahiret, që është jeta e vërtetë.

Mirësitë e kësaj bote janë një mjet i lumturisë së përjetshme, kur përdoren siç duhet. Por, nëse ato pushojnë së qeni mjet dhe bëhen qëllim, atëherë kthehen në fatkeqësi për zotëruesin.

Le të pyesim veten:

A jemi dërguar ne në këtë botë për të plotësuar dëshirat e egos, për të fituar një diplomë të mirë, për të marrë grada të larta dhe për të grumbulluar mall dhe pasuri? Apo mos vallë kemi rënë në neglizhencën e shndërrimit në qëllim të këtyre mjeteve, që supozohet të rregullojnë rrjedhën e jetës?!.

Shejh Said thotë:

"Paraja dhe prona janë për komoditetin e jetës dhe mirëqenien e jetës. Përndryshe, qëllimi i jetës nuk është të grumbullosh pasuri dhe para."



Marrëdhënia e një besimtari të drejtë dhe të urtë me të mirat e kësaj bote, duhet të jetë si marrëdhënia e një anijeje me detin. Deti është bartës për anijen. Por, nëse uji futet në anije, ajo e fundos atë dhe e gëlltit si një kafshatë. E, nëse anija nuk fut ujë brenda, ajo do të lundrojë mbi det e sigurt dhe do të arrijë në destinacionin që dëshiron të arrijë. Pra, uji i detit është një provë që mund të jetë edhe mirësi, edhe fatkeqësi. Të zotët e mendjes, e përdorin atë si një mirësi; ata që janë larg këtij botëkuptimi, mbyten në vorbullat e tij.



"Ka shumë peshq, të cilët janë të sigurt nga çdo gjë brenda në ujë, por për shkak të lakmisë ata bien në grep."



Shejh Sadi thotë:

"Dhjetë burra hanë të qetë në një tryezë. Kurse gjendja e njerëzve lakmitarë, i ngjan dy qenëve nuk arrijnë të ndajnë dot as një kërmë. Nëse ia jep gjithë botën një lakmitari, ai nuk do të ngopet. Kurse njeriu i kënaqur ngopet me një copë bukë thatë."



Egoja primitive është e pangopur. Një besimtar që ka shijuar ëmbëlsinë e besimit, falënderon për sasinë e mjaftueshme të ushqimit dhe madje kërkon dikë që ta ndajë me të.



Fariduddin Attar thotë:

«Si mund t'i pasurojnë të mirat e kësaj bote ata që nuk kanë të ngopur?»



Hadithi profetik thotë:

"Pasuria më e mirë, është pasuria shpirtërore." (İbn-i Asâkir, Muʿcem, I, 566.)

Pasuria e vërtetë nuk është pasuria materiale, por pasuria e zemrës. Mjaftueshmëria është pasuria më e madhe.



Ahmet ibn Hanbel thotë:

"Besimtarit i mjafton pak pasuri, sepse kur shpenzon për bamirësi besimtari ndjen begatinë në pasuri. Kurse të babëziturit nuk i mjafton as pasuria e madhe, sepse ai është në krizë të vazhdueshme për shkak të shpenzimeve."



Lakmitari i ngjan një ene, të cilës sado ujë t'i hedhësh, nuk zë më tepër se kapaciteti që ka.



Nuk duhet të harrojmë se; lakmia për këtë botë nuk e shton pasurinë; ajo vetëm prish qetësinë e zemrës, dëmton atmosferën shpirtërore dhe largon begatinë. Sado lakmitar të jetë, njeriu nuk ka për fituar më shumë sesa i është caktuar.



Nëse zemra jonë ka për synim ahiretin, edhe pasuria e kësaj bote do të na vijë pas. Por, nëse ne preferojmë këtë botë, atëherë do të humbim edhe dynjanë edhe ahiretin.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Kush dëshiron botën tjetër, Allahu ia pasuron zemrën dhe ia lehtëson punët; e kjo botë, i vjen nga pas e nënshtruar. Kush dëshiron këtë botë, Allahu vendos varfërinë midis dy syve të tij dhe ia vështirëson punët; e prej kësaj bote nuk përfiton më shumë sesa i është caktuar." (Tirmidhi, Kiamet, 30/2465.)



Shejh Sadi thotë:

«Dy gjëra janë të pamundura: Njëra, është të hash më shumë se rrizku që të është caktuar, dhe tjetra, është të vdesësh para se të vijë koha.»



Nëse ia jep botën njeriut të shkujdesur, ai do të thotë; «Vallë a kam edhe një parcelë në hënë?». Pasionet e egos nuk kanë fund. Ndërsa paqja e zemrës, është në kënaqësinë, pëlqimin dhe mirënjohjen.



Ambicia është kanceri i shpirtit.

Profeti ﷺ, thotë:

"Sikur njeriut t'i jepej një luginë me ar, ai do të kërkonte një të dytë; njeriun e ngop vetëm dheu." (Buhari, Rikak, 10.)



Deri më sot, asnjë zog nuk është përpjekur të bëjë më shumë fole se sa fqinji i vet. Deri më sot, asnjë dhelpër nuk është mërzitur se ka vetëm një vrimë ku të futet. Deri më sot, asnjë ketër nuk ka ngordhur prej stresit se nuk ka grumbulluar arra për dy dimra, por veç për një, dhe asnjë qen nuk ka kaluar netët e tij pa gjumë se nuk ka mbledhur kocka për vitet e tij të pleqërisë. Pra, ndërkohë që të gjitha krijesat i mbështeten dhe i dorëzohen kaq shumë Allahut, po ti, ç'e ke gjithë këtë lakmi o njeri?!.

Imam Shafiu thotë:

"Qëndrimi afër me ata që janë dhënë pas kësaj bote, është sëmundje."

Aliu ﷺ, thotë:

"Dëshirat dhe shpresat e kota verbojnë edhe njerëzit e urtë."

Ebu Hazim ka thënë:

"Çdo mirësi që nuk të afron me Allahun është fatkeqësi."

Shpesh duhet të llogarisim me veten:

– Deri në çfarë mase përpiqemi të marrim pëlqimin e Allahut me mjetet që na ka dhuruar Ai?

– Sa mund të shprehim mirënjohje për të mirat që na ka dhuruar Allahu?

– A i përdorim mjetet që kemi në dispozicion për të rritur afërsinë tonë me Zotin?

– Apo po i bëjmë këto begati pengesë mes nesh dhe Zotit të Madhëruar?!.



Rumiu thotë:

"Pasuria e kësaj bote është sprovë nga ana e Allahut Teala; pasuria e kësaj bote na deh dhe na mashtron. Për këtë arsye, syri i zemrës së atyre që jepen tërësisht pas kësaj dynjaje është i verbër, sepse ata pijnë ujin e hidhur dhe të kripur të baltës."



Sadiu thotë:

"Kur njeriu jepet pas kësaj bote, i ngjason një mize të zhytur në mjaltë."



Gjendja e atyre që harrojnë ahiretin dhe i kushtojnë zemrat dynjasë, është si një anije në mes të oqeanit, timoni i së cilës është thyer dhe nuk dihet se në cilën vorbull do të shkatërrohet...



Imam Shafiu thotë:

"Ashtu si mirazhi, që i mashtron ata që e shohin dhe ua shkatërron shpresën e atyre që mbështeten tek ai, ashtu kanë shkatërruar shumë njerëz edhe dëshirat dhe pasionet egoiste, qejfet dhe tekat e kësaj bote."



Sa mirë thotë Zija Pasha:

"Në të vërtetë, nuk ka asnjë gëzim në argjendin, arin dhe pasuritë e tjera të kësaj bote kalimtare, sepse, gjatë udhëtimit të tij në mbretërinë e përjetshme, pra në frymën e tij të fundit, njeriu i lë pas të gjitha këto dhe shkon i vetëm në atë udhëtim!"

Me pak fjalë, aftësia më e madhe në këtë botë kalimtare, është të dish të përdorësh jetën dhe pasurinë në rrugë të Allahut.





TASAVUFI

Rumiu thotë:

"Për sa kohë të kem shpirt, unë jam robi i Kuranit. Jam pluhuri i rrugës së Muhamedit ﷺ".

Kapja fort pas Kuranit dhe Sunetit është mrekullia më e madhe e kësaj kohe. Tasavufi është devotshmëria shpirtërore.

Mistika Islame, do të thotë të pish deri në ngopje prej burimit të dorëzimit ndaj Allahut dhe të bartësh "besimin" drejt një horizonti më të lartë, siç është "mirësia".

Ajo është arti i miqësisë me Allahun, duke qenë i kënaqur me caktimin e tij në çdo kohë dhe vend. Ajo është aftësia për të qenë gjithmonë një rob i mirë, ndërkohë që ruan ekuilibrin përballë kushteve dhe surprizave të ndryshme të jetës dhe i harron ankesat dhe qarjet.

Është rruga drejt devotshmërisë duke u shmangur nga çdo gjë që të largon nga Krijuesi i Gjithësisë. Me fjalë të tjera, Tasavufi, është të jetuarit me vetëdijen e mbikëqyrjes dhe vëzhgimit hyjnor; është ndërgjegjësimi dhe perceptimi i zemrës ndaj kësaj të vërtete. Natyrisht, kjo nuk arrihet duke lexuar një libër apo nga puna mendore. Kjo gjendje, është rezultat i përkushtimit shpirtëror.

Tasavufi është aftësia për të qenë përherë mik me Allahun duke treguar pëlqim ndaj çdo caktimi hyjnor. Është ruajtja e një ekuilibri shpirtëror ndaj çdo ulje-ngritje të jetës, e çdo surprize të ëmbël apo të hidhur të saj. Tasavufi është arti i njohjes së Allahut.

Tasavufi është një disiplinë e pastrimit të shpirtit dhe një mënyrë për të arritur devotshmërinë duke braktisur çdo gjë që të largon prej Allahut. Tasavufi është një shkollë e përsosmërisë së vazhdueshme shpirtërore. Tasavufi është një luftë e vazhdueshme shpirtërore kundër egos. Egoja mund të edukohet vetëm përmes përpjekjeve të mëdha, vetëm atëherë ajo mund të shndërrohet në një fuqi të madhe.

Ebu Hasan Harakani thotë:

"Tasavufi është paqe me njerëzit dhe luftë me egon. Pra, sjellje e mirë me njerëzit dhe luftë e vazhdueshme me egon.

Tasavufi është përpjekja për të realizuar adhurimin ndaj Allahut në formën më të mirë brenda kornizave të Kuranit dhe Sunetit.

Tasavufi është eliminim i pengesave që pengojnë adhurimin dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për realizimin e adhurimit.

Qëllimi i Tasavufit është realizimi i një personaliteti të pjekur ku zemra dhe fjala të jenë një, trupi dhe shpirti të jenë në paqe dhe gjuha dhe vepra të jenë në një drejtim. Siç thotë Rumiu: Ose bëhu siç dukesh, ose duku siç je.

Botëkuptime të tilla, si: *"Mjafton të kesh zemrën e pastër, edhe pse nuk përpiqesh të bësh punë të mira"*, të njerëzve që i kanë hapur rrugën dëshirave egoiste, nuk kanë asnjë lidhje me tasavufin si një shërbëtor i vërtetë i fesë.

Zhveshja e jetës islame nga tasavufit, i cili është një edukim shpirtëror, nuk e çon njeriun në vetëdijesimin e mbikëqyrjes hyjnore.

Tasavufi është gjithmonë rruga e udhëzimit, është përpjekja për ta kthyer zemrën në dergjah. Dhe në këtë dergjah ka vend për këdo që pendohet, edhe nëse ai ka qenë rebel apo gjynahqar. Ky dergjah, është vendi i udhëzimit të ngrohtë për çdokënd. Ky dergjah është dergjahu i udhëzimit, dergjahu i përmirësimit, dergjahu i pjekurisë, dergjahu i edukimit dhe disiplinës. Bota shpirtërore e çdo besimtari të vërtetë që reflekton nga zemra e tij mëshirë e rahmet, është në fakt një dergjah i tillë. Kjo zemër ka fituar aftësinë për të parë krijimin nëpërmjet syrit të Krijuesit.

Tasavufi është përpjekja për ta jetuar sheriatin në mënyrë të plotë dhe të përsosur, duke edukuar ndjenjat e botës së brendshme të njeriut. Njeriu nuk përsoset vetëm duke lexuar libra. Ai përsoset duke pastruar botën e tij të brendshme nga gjynahet dhe papastërtitë. Për këtë arsye themi se; Tasavuf, do të thotë të jetosh sheriatin me qetësi dhe pastërti.

Që zemra jonë të ngrihet në grada të larta, është e mundur vetëm nëse fitojmë një pjesë të shkëlqimit dhe botës shpirtërore të Kuranit, duke u pajisur me moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Është e pamundur të arrihet një përparim shpirtëror pa kuptuar urtësinë dhe të vërtetat e shpallura nga Kurani.

Nuk ka kuptim të pritet një shfaqje mistike tek një person që nuk i kushton rëndësi kritereve fetare në adhurime, në marrëdhëniet ndërnjerëzore, në etikë dhe në rendin e jetës.

Kriteret e vendosura nga Kurani dhe Suneti janë themeli i fesë Islame. Nëse themelet e një godine nuk janë të forta, ajo është e

destinuar të shembet nga çdo tërmet. Nuk mund të ndërtohet një godinë mbi një themel të dobët. Kjo është e vlefshme edhe për gjendjen shpirtërore. Është e domosdoshme të ndërtohet jeta rituale mbi standardet e Kuranit dhe sunetit.

Kurani dhe Suneti janë dy pasqyra të sigurta ku çdo besimtar duhet të shikojë dhe korrigjojë gabimet e veta.

Që feja të jetohet me entuziazëm dhe kënaqësi, duhet që Kurani dhe tradita profetike të përfshijë çdo aspekt të jetës së besimtarit.

Ashtu si një trup pa shpirt nuk ka bukuri, ashtu edhe jeta larg Kuranit dhe sunetit nuk ka vlerë.

Është detyrë e çdo myslimani të bëjë përpjekje për të jetuar sipas mësimeve të Kuranit dhe Sunetit. Tekefundit, nuk ka rrugë tjetër për lumturi dhe paqe. Të gjitha rrugët e tjera janë humbje.

Thelbi i edukimit mistik, është përpjekja për t'u zbukuruar me moralin profetik; të gjitha fjalët, veprat dhe gjendja, të jenë ngjyrosur nga morali profetik.

Tasavufi i vërtetë, është realizimi në maksimum i mësime të Kuranit dhe Sunetit, gjë e cila nënkupton një jetë brena devotshmërisë dhe mirësisë. Rumiu, përkufizimin e tasavufit e ka bërë në këtë mënyrë:

"Për sa kohë të kem shpirt, unë jam robi i Kuranit. Jam pluhuri i rrugës së Muhamedit ﷺ"

Që të realizohet siç duhet ibadeti ndaj Allahut, duhet që ai të zbatohet në çdo aspekt dhe fushë të jetës. Nuk mjafton të thuash: "Unë jam mysliman"! Në Kuranin Fisnik, fjala "devotshmëri" përdoret në 258 vende në mënyra të ndryshme. Pra, Kurani na sugjeron vazhdimisht "takua".

Lufta e besimtarit me egon nuk duhet të zhvillohet vetëm në fronte të caktuara, por duhet të fokusohet në të gjitha frontet. Besimtari duhet të realizojë çdo aspekt të jetës së tij sipas mësimeve hyjnore.

Babai ynë i ndjerë, Musa Efendiu, për të kuptuar afërsinë shpirtërore me Zotin të atyre që vinin për të marrë mësime, bënte pyetjet e mëposhtme:

– Si është gjendja juaj materiale dhe shpirtërore?

– Si e siguroni jetesën? A janë hallall të ardhurat tuaja? A jeni i përfshirë në interes bankar? Keni ndonjë situatë haram apo të dyshimtë?

– Nëse jeni nëpunës civil, a e bëni punën saktë dhe si duhet? A i kushtoni vëmendje punës tuaj? A e ruani veten nga neglizhenca, favorizimi, ryshfeti etj.?

– Nëse jeni tregtar, si e keni biznesin? A ka ndonjë gjë të gabuar me shit-blerjet tuaja? A ruheni me përpikëri nga gënjeshtrat, mashtrimet, zhvatjet, tregu i zi dhe haramet e ngjashme?

– Gjërat që blini dhe shitni a janë hallall apo diçka që Allahu e ka ndaluar?

– Nëse keni një pronë me qira, për çfarë punësh e keni dhënë me qira? A ka ndonjë gjë të paligjshme apo të dyshimtë në lidhje me të ardhurat tuaja nga kjo pronë?

– Nëse jeni punëdhënës, si jeni me respektimin e ligjit? A i kushtoni rëndësi të drejtës së punëtorit? A ua jepni të drejtat punonjësve tuaj në kohë, para se t'u thahet djersa?

– Nëse keni mundësi; sa është sakrifica juaj në zekat, të dhjetën e pasurisë, sadaka, bamirësi dhe dhurime?

– Me kë shoqëroheni? A qëndroni me njerëzit e drejtë dhe besnikë, dhe a largoheni nga njerëzit e shkujdesur dhe mëkatarë?

– Si është jeta juaj familjare? A mund t'u mësoni dhe t'u ngulitni në zemra udhëzimet hyjnore anëtarëve të familjes suaj? A u jepni atyre një shembull të mirë në këtë drejtim?

- Si janë prindërit e tu? A i respektoni të drejtat e tyre?

– Çfarë po bëni për edukimin e fëmijëve tuaj, të cilët ju janë besuar nga Allahu? A i jepni më shumë rëndësi të ardhmes së përjetshme të fëmijëve tuaj, apo të ardhmes së tyre të kësaj bote?

Me pak fjalë;

Musa Efendia, për ata që donin të merrnin mësime shpirtërore, vuri kusht që; së pari të bënin një jetë brenda standardeve të Kuranit dhe Sunetit. Ai nuk do të kishte dhënë mësime nëse nuk plotësoheshin këto kushte. Po ashtu, ai nuk e pa të arsyeshme të shikonte vetëm pjesën e mësimit që kishin për të bërë, sepse, qëllimi i tasavufit është të jetojmë sheriatin në një kuptim e plotë të fjalës, në çdo fazë të jetës sonë. Pra, më parë duhet siguruar respektimin e urdhrave dhe ndalesave hyjnore.

Islami është një i tërë. Islami nuk mund të fragmentizohet. Të zbatosh një pjesë dhe të braktisësh pjesën tjetër, nuk është gjë tjetër përveçse një tregues i dobësisë së besimit. Kushti për t'u bërë një besimtar i mirë, është ta përfshish Islamin në çdo aspekt të jetës, duke përfshirë jetën profesionale dhe tregtare... Islami nuk është vetëm për një vend dhe kohë të caktuar, por është një sistem që rregullon çdo detaj të jetës.

Tasavufi i vërtetë, i formësuar nën frymën e Traditës Profetike, është përpjekja për t'u unifikuar dukshëm dhe fshehurazi me parimet jetësore të Profetit ﷺ. Çdo besimtar, pa marrë parasysh pozicionin, sektin apo tarikatin e tij, është i detyruar të jetë i qartë ndaj përgjegjësive fetare duke marrë shembull të Dërguarin e Allahut ﷺ, që pavarësisht faktit se ishte në kulmin e përsosjes shpirtërore, plotësonte me përkujdesje të madhe çdo detyrim të fesë.

Mistika Islame është pjesa e brendshme e fesë, thelbi dhe thellësia shpirtërore e saj. Nga ky aspekt, ajo është si laktoza brenda qumështit. Nëse hiqet ajo, nuk mbetet tjetër veçse një tufë rregullash të thata.

Qëllimi i tasavufit, është edukimi i anës shpirtërore me qëllim që të përmbushen dispozitat e fesë në mënyrë sa më të plotë. Tasavufi nuk është injorim apo anashkalim i praktikimit të fesë në emër të zhytjes në botën shpirtërore. Por, fatkeqësisht, ka prej atyre që anashkalojnë çështjet themelore të fesë duke pretenduar përkatësi ndaj një tarikati të caktuar. Ata i nënvlerësojnë dispozitat praktike të fesë, pra Sheriatin. Mirëpo, kjo nuk është gjë tjetër vetëm se një tregues i qartë i shmangies nga e vërteta e tasavufit.

Mendimi se; "E rëndësishme është të kem zemrën e pastër...", krijon qartazi një terren të përshtatshëm për egon. Kjo nuk ka të bëjë aspak me tasavufin, si shërbyesin e vërtetë të fesë.

Të mos harrojmë se; Islami është një recetë... Është një recetë për lumturinë e përjetshme. Ne e morëm recetën, e pranuam, por, nëse nuk i zbatojmë kurat dhe dietat e shkruara në të, nuk kemi të drejtë të themi; «*Pse nuk po gjejmë shërim, pse nuk po lehtësohemi?*»

Kurani dhe Suneti janë plot me receta shërimi dhe mëshirë për njerëzimin deri në Ditën e Fundit. Por, rezultatet pozitive mund të shihen vetëm nëse ato aplikohen.

Çdo aspekt i jetës së një besimtari, duhet të jetë në përputhje me Kuranin dhe Sunetin. Aty ku Islami shpërfillet, Allahu e largon mëshirën e Tij; aty mbaron paqja, zhduket bollëku, fillojnë telashet fizike dhe shpirtërore.

Kapja fort pas Kuranit dhe Sunetit dhe qëndrimi bindshëm sipas mësimeve të tyre, është mrekullia më e madhe e kohëve tona.

Jusuf Hemedani ka thënë:

"Ai person që nuk ecën në rrugën e fesë dhe sheriatit, edhe nëse bën njëmijë mrekulli në ditë, është rob i shejtanit. Ai që beson diçka, e cila është në kundërshtim me Sunetin, edhe nëse ka mësuar

përmendësh të gjitha dituritë e botës, të gjitha përpjekjet e tilla, për të janë thjesht vetëm lodhje."

Ebu Hasan Harakani ka thënë:

"Janë dy persona që sjellin përçarje në fe, gjë të cilën as shejtani nuk e shkakton dot:

1. Dijetari i kapluar nga ambicia për të mirat e kësaj dynjaje.

2. Sufiu i privuar nga dituritë (fetare)."

Xhunejd Bagdadi thotë:

"Nëse shihni një person (të ulur në kolltukun e tij) teksa flutu-ron në ajër, dhe ai nuk i bindet Kuranit dhe Sunetit, (mos e merrni për bazë atë).

Një besimtar duhet së pari të mësojë natyrën e së vërtetës dhe të drejtës nga Kurani dhe Suneti. Pastaj, ai duhet të kërkojë personin që do ta marrë si mësues sipas këtyre kritereve dhe të përpiqet të jetojë në drejtimin e Kuranit dhe Sunetit. Kjo, sepse, edhe një mësues i vërtetë nuk do të jetë i dobishëm për një per-son që nuk ndjek Kuranin dhe Sunetin.

Asnjë qëllim legjitim nuk mund të ndiqet me mjete jolegji-time. Prandaj, bindja dhe nënshtrimi nuk mund të tregohet kurrë ndaj atyre që i konsiderojnë të lejuara ndalesat e Allahut me pretendimin se i shërbejnë një qëllimi të lartë. Kjo nuk është bindje, është rebelim.

Profeti ﷺ, ka thënë

"Për sa kohë që nuk urdhërohet për të kryer gjynah, myslimani është i detyruar t'i bindet drejtuesit të shtetit, edhe në çështjet që i pëlqejnë, edhe në ato që nuk i pëlqejnë. Në momentin që e urdhërojnë të kryej gjynah, ai nuk e dëgjon dhe nuk i bindet." (Muslim, Imare, 38.)

Besimtari, në çdo çështje duhet të bazohet në Kuran dhe sunet. Urdhrat dhe udhëzimet që vijnë nga drejtuesit duhet të vlerësohen sipas kritereve fetare. Në çfarë do kushtesh qoftë, besimtari duhet t'i bindet vetëm të vërtetës dhe të largohet nga e shtrembëta. Në asnjë mënyrë nuk duhet të marrë vendime që bien ndesh me mësimet Kuranore dhe Traditën Profetike. Prandaj, pavarësisht se kush e jep urdhrin, besimtari gjithmonë duhet të marrë në konsideratë përputhshmërinë me fenë.

Bindja ndaj prindërve është e detyrueshme. Por, nëse një prind e detyron fëmijën e tij të bëjë diçka që Allahu e ka ndaluar, atëherë as bindja ndaj tyre nuk lejohet. Nëse një prind i pavëmendshëm e urdhëron vajzën e tij të zbulojë kokën, nuk ka bindje në këtë pikë. Fëmija nuk bëhet gjynahqar vetëm sepse nuk i dëgjoi ata në këtë çështje. Përkundrazi, ai merr shpërblim për bindjen ndaj Allahut.

Në hutben e lamtumirës Profeti ﷺ, deklaroi se; për t'u mbrojtur nga devijimet, na ka lënë Kuranin dhe Sunetin. Kush i nënshtrohet diçkaje apo dikujt tjetër që bie ndesh me këto dy amanete, është në një gjendje shumë të dobët besimi.

Të refuzosh plotësisht diçka duke përdorur shembuj të këqij si justifikim - pa bërë dallimin e të mirëve - do të thotë të bëhesh ortak në gjynahun e atyre që e bëjnë një të keqe. Për shembull, mjekësia nuk mund të refuzohet për shkak se disa mjekë abuzojnë me profesionin e tyre. Ligji nuk mund të braktiset vetëm sepse disa avokatë abuzojnë me profesionin e tyre. Po kështu, jo të gjitha xhematet, tarikatet dhe liderët shpirtërorë mund të fajësohen për shkak të atyre që abuzojnë me ndjenjat fetare të njerëzve.

Pash një beduin, i cili i thoshte të birit:

"Biri im! Ditën e Kiametit do të të pyesin «çfarë fitove?» dhe jo «prej cilit fis je?»! Pra, do të të pyesin për veprat, e jo për prejardhjen!.."

Sot, për fat të keq, disa injorantë mendojnë se; «po të kapen pas ndonjë lideri shpirtëror, ai do t'i shpëtojë në ahiret...». Mirëpo, as ai person pas të cilit do të kapet ai, nuk ka ndonjë garanci që të mund të ikë me sigurinë e besimit në frymën e fundit.

Nuk duhet të harrojmë kurrë gjendjen e Bel'am bin Baura, i cili u mposht nga egoja e tij dhe pësoi humbje të përjetshme edhe pasi arriti grada të larta shpirtërore. Domethënë, robi është i paaftë në përcaktimin e fundit të vet, pavarësisht se çfarë gradash zotëron; ai gjithmonë ka nevojë për mëshirën e Zotit të tij.

Për këtë arsye, është mashtrim i madh të mbështetesh tek njerëzit, në vend që të përpiqesh të kryesh me përpikëri detyrat e devotshmërisë dhe të strehohesh në mëshirën e Allahut, për shpëtimin e përjetshëm.

Disa njerëz indiferentë, shkojnë në ekstrem në dashurinë e tyre ndaj njerëzve, të cilët i marrin si udhërrëfyes, dhe flasin me mburrje e injorancë, duke thënë; «*Shejhu im nuk bën kurrë gabime!*». Kjo është një pikëpamje jashtëzakonisht e gabuar, sepse edhe Ebu Bekri ﷺ, i cili në disa transmetime thuhet se është robi më i mirë pas profetëve, në hutben e tij të parë, pasi u zgjodh kalif, vendosi një kriter madhështor që do të ishte shembull për të gjithë udhëheqësit besimtarë që do të vijnë deri në fund të botës. Ai tha:

"O njerëz! Edhe pse nuk jam më i miri prej jush, unë jam zgjedhur si kalif mbi ju. Ju lutem më ndihmoni nëse e bëj detyrën time siç duhet. Por, nëse gaboj, më tregoni rrugën e drejtë... Mu bindni për sa kohë që unë i bindem Allahut dhe të Dërguarit të Tij! Por, nëse unë nuk u bindem, as ju nuk duhet të më bindeni!.."

Nëse njeriu më i virtytshëm i umetit thotë kështu, çfarë lloj përulësie duhet të kenë ata që duhet ta marrin si shembull atë?

Botëkuptimi i tasavufit: Islami nuk kërkon shfaqjen e hireve trupore, por hireve shpirtërore. Pra, ai nuk synon dukjen, famën dhe postin, por kuptimin e dobësisë përballë Allahut dhe dorëzimin e shpirtit ndaj dëshirave hyjnore.

Ka njerëz që presin një shpëtimtar si «Mehdiu» në vend që të përpiqen në rrugën e Allahut. Mirëpo, ajo që do të na shpëtojë në ahiret, nuk është ardhja apo jo e Mehdiut. Ajo që do të na shpëtojë atje, pavarësisht se në cilën kohë dhe vend jemi, është devotshmëria ndaj Allahut dhe prekjet në rrugën e Tij. Nëse Mehdiu shfaqet në kohën tonë, ne duhet të përpiqemi që tani të bëjmë një jetë të devotshme, me qëllim që të meritojmë të jemi me të.

Nëse ne i bëjmë këto përpjekje, nuk na bën dëm edhe nëse nuk e arrijmë dot Mehdiun. Por, nëse ne nuk e bëjmë një përpjekje të tillë, nuk do të fitojmë asgjë në ahiret, edhe nëse arrijmë në kohën e Mehdiut.

Ka shumë njerëz të pavëmendshëm, që për shpëtimin e tyre të përjetshëm, mbështeten vetëm në afrimitetin me njerëzit e devotshëm, në vend që të kryejnë veprat e njerëzve të devotshëm, e të përpiqen në rrugën e Allahut. Këta njerëz, Mevlana i paralajmëron me këto fjalë:

"Për shembull; ju mund të mbani në dorë shkopin e Musait عليه السلام. Por a keni forcën e tij që ta bëni atë një gjarpër dhe të mund ta nënshtroni?»

"Le të themi se keni frymën e Isait عليه السلام, i cili solli në jetë të vdekurit dhe e dini lutjen e tij. Por, o të pakujdesshëm! A e keni gojën (pa gjynahe) si të Isait عليه السلام, që të mund t'i ringjallni zemrat e vdekura me frymën tuaj dhe t'i gjallëroni ato me kënaqësinë e dashurisë?»

"Le të themi se ju trashëgoni shpatën e Aliut رضي الله عنه, të quajtur Zulfikar. Por, a e keni ju krahun e Aliut, Luanit të Allahut, që ta përdorni shpatën e tij?!"

Si përfundim:

«Dijeni se; njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.» (shih. Nexhm, 39.)

Mevlana na jep të gjithëve një kriter dhe thotë:

"Në rrugën e Allahut, mund të hidhesh edhe në zjarr nëse është

e nevojshme. Por, para se të hidheni në zjarr, shikoni veten nëse jeni apo jo si Ibrahimi ﷺ! Sepse zjarri i njeh Ibrahimët dhe nuk i djeg ata!"

Si një paralajmërim për njerëzit injorantë, të cilët në jetën shpirtërore i japin rëndësi fjalës e jo thelbit të saj; i japin rëndësi formës dhe jo zemrës, kjo ngjarje është shumë mësimdhënëse:

Një nxënës i thotë Bajezid Bistamit:

- Zotëri! A bën të më jepni një copë nga gëzofi juaj, që ta mbaj që të më sjellë begati!

Bajezid Bistami, me qëllim që t'i tregojë se thellësia shpirtërore nuk mund të arrihet vetëm me anë të formës, i thotë:

- Biri im! Nëse nuk bëhesh njeri, jo gëzofin e Bajezidit të veshësh, por edhe po t'i marrësh lëkurën e futesh brenda, nuk do të bëjë dobi!..".

Të përparosh në rrugën e pjekurisë shpirtërore është e mundur jo vetëm duke lexuar një libër ose duke dëgjuar një bisedë fetare, por edhe duke nxjerrë një recetë nga ajo që lexoni dhe dëgjoni, duke jetuar në drejtimin që kërkon ajo dhe duke shërbyer në rrugën e Allahun. Për arritjen e kësaj, duhet të pajisesh me moralin dhe gjendjet e miqve të Allahut. Mashtrohen ata që ngecin në fjalë dhe mendojnë se devotshmëria përbëhet nga fjalë e bukura dhe elokuencë.

Mistikët kanë thënë:

"Tasavufi është gjendje, të cilën e njohin vetëm ata që e kanë shijuar."

Junus Emre e shpreh shumë bukur faktin se; misticizmi nuk është një vepër formale për pozitë dhe titull, por një vepër e zemrës:

"Dervish nuk të bën xhybja dhe çallma! Kush bën dervish zemrën, s'ka nevojë për xhybe!.. Po të bëheshe dervish me xhybe e çallmë, ne do kishim marrë tridhjetë dyzet copë!"

Shejh Sadi thotë:

"Të urtët dhe të devotshmit e vërtetë, marrin bukë me vete, që të tërhiqen në një cep dhe të adhurojnë me qetësi dhe kënaqësi shpirtërore. Përndryshe, ata nuk do të tërhiqen në cepin e adhurimit për të ngrënë bukë."

Për të pasur një mendim të saktë lidhur me një person, nuk mjafton vetëm të shikosh namazet dhe agjërimet e tij. Ashtu siç një namaz i vërtetë duhet ta pengojë robin nga imoraliteti dhe e keqja; ashtu si një agjërim i mbajtur mirë duhet të rafinojë shpirtin dhe të zhvillojë dhembshurinë e mëshirën, edhe një jetë e vërtetë mistike është çështje e zemrës dhe jo e formës.

Nëse nuk jeton me veprat e drejta, moralin e mirë, thellësinë e dijes, vetëdijen ndaj Zotit, sinqeritetin dhe ndjeshmërinë e takvasë që kërkon jeta e tasavufit, bartja e emrit, llojit, formës, etiketës dhe simboleve të sufizmit, nuk e bën një person të urtë, të devotshëm, dervish, murid, murshid apo sufist.

Tasavuf, do të thotë që njeriu të jetojë Islamin me unitetin e «sheriatit, tarikatit, të vërtetës dhe urtësisë» dhe të mbizotërojë veten, fjalët, sytë, duart, belin, e gjuhën; shkurt, të gjitha gjendjet dhe sjelljet e tij. Nëse kjo përsosmëri shpirtërore nuk ekziston, imitimi i thatë, forma dhe simbolet e jashtme nuk mund ta bëjnë sufi një person.

Dervishizmi; nuk është një koleksion ceremonish i përbërë nga forma, simbole dhe lëvizje pa shpirt, e pa thellësi kuptimi. Të jesh dervish, do të thotë të kultivosh zemrën. Siç është urdhëruar në një hadith:

"Padyshim se Allahu i Madhëruar nuk sheh trupat dhe pamjet tuaja, por vetëm zemrat tuaja!" (Muslim, Birr, 33.)

Besimtari ka nevojë për urtësinë dhe largpamësinë e gjerë të dashurisë hyjnore në çdo fazë të jetës së tij. Përndryshe, nuk mund të kalohet nga lëvozhga në thelb, nga forma në të vërtetën.

Jeta e tasavufit, nuk është të rendësh pas disa iluzioneve dhe ëndrrave në kërkim të kerameteve dhe mrekullive, por të jetosh urdhrat hyjnore me ndjeshmërinë e takvasë dhe të përparosh në shpirt.

Ebu Bekir Kettani ka thënë:

"Tasavufi është moral. Kush është më lart se ti në moral, është më lart edhe në grada shpirtërore."

Nëse dëshirojmë të shikojmë gjendjen tonë në ecurinë shpirtërore, mjafton të analizojmë sjelljet dhe gjendjen tonë.

Kriteri i përparimit në tasavuf nuk është vetëm ngritja në intervale të rregullta në mësimet shpirtërore dhe dhikër. Krahas kësaj, duhet të ngrihen edhe ndjeshmëria e zemrës e morali dhe të shtohen manifestimet e esencës hyjnore në atë zemër.

Dikujt që i rritet niveli në mësimet shpirtërore, duhet t'i shtohet edhe mirësia, edukata, butësia e zemrës, mëshira, dhembshuria, shërbimi, përpjekja dhe vetëmohim; ai duhet të jetë më falës, më mirëkuptues, më tolerant dhe të forcojë gjendjen e durimit dhe pëlqimit. Ai duhet të ketë një shpirt altruist dhe të butë, që do për vëllain e tij atë që do për veten e tij. Shkurt, treguesi më i madh i përparimit shpirtëror, janë gjendja dhe sjelljet e personit.

Kur një person e lavdëroi dikë në prani të Omerit ﷺ, ai i tha:

- A e ke fqinj, a ke bërë udhëtim me të, a ke bërë tregti bashkë me të?

Kur personi tha nuk kam bërë asnjërën, Omeri ﷺ, i tha:

"Ti e ke parë atë në xhami duke lexuar Kuran prandaj e lëvdon!? «Po tha personi!» Atëherë mos e lëvdo shumë, sepse sinqeriteti i njeriut nuk është në tundjen e kokës gjatë leximit të Kuranit!"

Është e kotë të presësh një zhvillim shpirtëror nga një person që nuk tregon kujdes në adhurime, sjellje dhe moral. Në lidhje me këtë, Omeri ﷺ, ka vendosur disa kritere të cilat nuk duhet t'i harrojmë:

"Tjetrit mos i shikoni namazin që fal apo agjërimin që mban, por shikoni;

- A thotë të vërtetën kur flet?

- A e respekton amanetin kur vjen koha për ta çuar në vend atë që i ke besuar?

- A kujdeset për hallallin dhe haramin kur merret me punët e kësaj bote?"



PASTRIMI I EGOS, PURIFIKIMI I ZEMRËS

Ashtu si bizhuteritë me vlerë nuk futen në kuti të ndotura dhe të rëndomta, por ruhen në ambiente të pastra dhe dinjitoze, ashtu edhe bota e zemrës duhet të mbahet shpirtërisht e pastër në mënyrë që aty të shfaqet mëshira hyjnore.

Dhurata më e bukur për t'i çuar Zotit të Plotfuqishëm, është një pasqyrë e ndritur, e pastër, e shkëlqyer dhe e hijshme e zemrës, në të cilën shfaqet bukuria e emrave të Tij hyjnor.

Ata që nuk e dinë urtësinë e ekzistencës së egos, qëllimin e dhënies së saj njeriut, marifetet dhe kurthet e saj, nuk mund ta kuptojnë siç duhet devotshmërinë e njeriut ndaj Zotit.



Për këtë është thënë: *"Kush e njeh veten, njeh edhe Zotin e vet"*. Një rob nuk mund të arrijë kënaqësi të qëndrueshme nëse nuk largohet nga kënaqësitë kalimtare. Njësoj si fëmijët që nuk mund të arrijnë ushqime më të mira dhe shijet jetike nëse nuk lënë qumështin e gjirit. Për këtë arsye, hapi i parë në rrugëtimin e edukimit mistik është eliminimi i obsesioneve egoiste që pengojnë përparimin shpirtëror.



Shpirti është si një pemë. Ashtu si fruti i papjekur është i lidhur fort pas pemës, ashtu edhe njerëzit e papjekur janë skllevër të egos. Mirëpo, ashtu si frutat e pjekur i braktisini pemët, edhe besimtarët e plotësuar largohen nga prirjet e ulëta të egos së tyre dhe bëhen udhëtarë të botëve sublime.



Njeriu është frymëzuar edhe me ndjenja të ulëta (shtazore dhe dëshira të egos), edhe nga ndjenja të larta devotshmërie (engjëllore dhe aftësi shpirtërore). Sprova e robit qëndron në eliminimin e këtyre ndjenjave shtazore dhe zhvillimi i anës së tij engjëllore. Kjo është mënyra për të arritur miqësinë me Allahun e Madhëruar.



Kalbja në rrënjën e një peme, shfaqet në gjethet dhe frutat e saj, ndërsa indiferenca dhe ngurtësia në zemër manifestohen në gjendjen dhe sjelljen e njeriut. Nëse frutat e një peme janë të pashijshme, ne e dimë se në rrënjën e kësaj peme ka një sëmundje dhe për të duhet treguar kujdes. Kështu është edhe zemra. Nëse zemra është bërë skllave e tekave dhe dëshirave të ulëta, është e nevojshme t'i nënshtrohet një edukimi shpirtëror. Përndryshe, veprat e njeriut nuk do të jenë të pranueshme.

Tasavuf do të thotë pastrim i egos dhe purifikim i zemrës me qëllim që të arrihet paqja dhe qetësia shpirtërore.

Për shembull; a mund ta pimë ujë nga një gotë e ndotur, edhe nëse e mbushim me ujë të pastër burimi? A nuk duhet të pastrojmë fillimisht gotën para se të pimë ujin?

Ja pra; edhe zemra duhet të pastrohet gjithashtu nga papastërtitë shpirtërore, në mënyrë që të mund të përfitojë shpirtërisht nga Kurani, hadithet dhe manifestimet e fuqisë dhe madhështisë hyjnore në univers.

Zemra duhet të pastrohet, në mënyrë që të jetë vendi ku shfaqen bukuritë e Zotit të Plotfuqishëm.

Zemra duhet të pastrohet, në mënyrë që ta njohë nga afër të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Zemra duhet të pastrohet, në mënyrë që pajiset me vlerat morale Islame.

Zemra duhet të pastrohet, në mënyrë që të mund të marrë frymëzim nga veprat e mira.

Qëllimi i tasavufit, është të sigurojë këtë pastërti në botën e brendshme të robit.

I ndjeri Mahmud Sami Ramazanoglu ka thënë: *"Plagës më parë i pastrohet qelbi. Nëse nuk pastrohet qelbi, plagës nuk i vihet ilaç. Edhe nëse i vihet, ai nuk do t'i bëjë dobi."*

Prandaj, largimi nga harami dhe gjynahet, ka më prioritet se sa përpjekja për shpërblime dhe vepra të mira.

Për këtë arsye edhe është thënë: *"Eliminimi i së keqes dhe së dëmshmes, është më primare se arritja e së mirës dhe së dobishmes."* Pra, dëbimi i gjërave që do të dëmtojnë vjen përpara përpjekjes për të fituar gjërat që do të bëjnë dobi.

Prandaj, në jetën shpirtërore, para së gjithash, thelbësore është pastrimi i brendshëm; pastrimi i egos dhe purifikimi i zemrës.

Ashtu si bizhuteritë me vlerë nuk futen në kuti të ndotura dhe të rëndomta, por ruhen në ambiente të pastra dhe dinjitoze, ashtu edhe bota e zemrës duhet të mbahet shpirtërisht e pastër në mënyrë që aty të shfaqet mëshira hyjnore.

Si çdo i vdekshëm që vjen në dynja, edhe ne jemi udhëtarë drejt ahiretit. Prandaj, ne duhet të jemi gjithmonë të përgatitur për këtë udhëtim. Për këtë arsye, është thelbësore që ne të përpiqemi të bëhemi robër të afërt të Zotit tonë duke eliminuar pasionet tona egoiste dhe duke zhvilluar aftësitë shpirtërore sa më shpejt të jetë e mundur.

Allahu i Plotfuqishëm na fton në Daru's-Selam/Xhenet. Por, si çdo ftesë, edhe kjo ka një kusht pranimi. Kushti i ftesës në Xhenet

është një zemër e mirë, një zemër e penduar dhe ego e paqësuar që ka arritur nivel të lartë me «takva». Vetëm atëherë Allahu i Madhëruar i drejtohet robit të Tij dhe urdhëron:

"Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!" (Fexhr, 29-30.)

Dhurata më e bukur për t'i çuar Zotit të Plotfuqishëm, është një pasqyrë e ndritur, e pastër, e shkëlqyer dhe e hijshme e zemrës, në të cilën shfaqet bukuria e emrave të Tij hyjnor.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"A e ke parë atë që e ka marrë për zot dëshirën e vet?.." (Furkan, 43.)

Nëse idhujt në zemër, pra dëshirat e ulëta të egos, nuk pastrohen, të gjitha përpjekjet njerëzore do të jenë të kota. Siç shprehet edhe Kurani, njerëz të tillë;

عَامِلَةٌ نَاصِبَةٌ

"…ata kanë punuar e janë rraskapitur (e kanë çuar jetën dëm në punë të padobishme)." (Gashije, 3.)

Zoti më i rremë që njeriu adhuron kur lë Zotit të tij, është egoja e vet. Janë vendimet e egos ato që pengojnë përmbushjen e urdhrit të Allahut.

Ato që bien në kundërshtim me rregullat e Islamit, janë shprehjet «sipas meje» dhe «për mendimin tim» . Adhurimet e

tyre nuk bëhen vetëm për shkak se është urdhër i Allahut, por janë të përziera me pritshmëritë e interesit të kësaj bote, si për shembull fitimi ose mos humbja e reputacionit në sytë e njerëzve.



Në një hadith thuhet:

"Ndër zotat e rremë që adhurohen në tokë, Allahu i Lartmadhëruar urren më shumë ndjekjen e tekave dhe dëshirave të egos." (Hejthemi, I, 188.)



Abdullah Dehlevi thotë:

"Si mund të jetë rob i Allahut një njeri që është rob i dëshirave të veta?!"



Ashtu si thjerrëza që vendosim nën dritën e diellit, e cila me rrezet e diellit të përqendruara në një pikë, i bën shkrumb e hi të gjitha gjërat e pista që ndodhen poshtë saj, ashtu edhe çdo besimtar duhet ta përqendrojë Kelime-i Teuhidin në zemrën e vet, duke e pastruar atë nga çdo gjë e papastër.



Ashtu si lumi Sakarja që derdhet në Detin e Zi, humbet në të dhe nuk mund të gjendet më në atë det, ashtu edhe besimtari duhet të eliminojë dëshirat e ulëta të egos dhe, duke ia nënshtruar plotësisht vullnetin e tij vullnetit të Allahut të Madhëruar, ai duhet të shkrihet në Të. Vetëm kështu robi përfiton nga e vërteta e teuhidit.



Të urtët thonë:

"Retë në qiell dhe ujërat në dete nuk kanë ngjyrën e tyre. Është Dielli në qiell që i bën ato ngjyra-ngjyra. Kështu edhe marifeti (njohja e Allahut e Plotfuqishëm në zemër), do të thotë, të kuptosh se je pa ngjyrë dhe, duke eliminuar dëshirat dhe pasionet e egos, të ngjyrosesh me «Sibgatullah» / bojën e Allahut.»[1]



Një fije formohet nga bashkimi i shumë fibrave. Që ajo të kalojë përmes vrimës së gjilpërës, duhet që fibrat të ruajnë unitetin e tyre. Nëse çdo fibër vepron veçmas në kokë të vet, skaji i fijes degëzohet, uniteti i tij prishet dhe për pasojë nuk mund të kalojë nëpër vrimën e gjilpërës. Kështu edhe një besimtar; sa më shumë që t'ia nënshtrojë vullnetin e vet vullnetit të Allahut të Madhëruar, aq më shumë mund të përfitojë nga e vërteta e teuhidit.



Kelime-i teuhid fillon duke thënë **«La ilahe/S'ka zot»**; pra duke eliminuar të gjithë zotat e rremë materialo-shpirtërore nga zemra dhe dëshirat e ulëta të egos. Më pas, duke thënë **"il-lAllah/ përveç Allahut"**, arrin përsosurinë kur zemra zbukurohet me cilësitë e bukurisë së Allahut të Madhëruar dhe kur sjelljet janë në drejtim të pëlqimit të Allahut.



Që imani/besimi të jetë i pranuar, duhet të refuzosh zotat e rrejshëm të jobesimtarëve, politeistëve apo paganëve dhe të besosh në Allahun Një e të vetëm. Mirëpo, kjo është pjesa e lehtë e punës në lidhje me arritjen e së vërtetës së teuhidit. Pjesa më e vështirë dhe më e rëndësishme është përmbysja e idhujve në

1. - shih. Bekare, 138.

botën e brendshme, pra eliminimi i dëshirave të ulëta, tekave dhe pasioneve të egos dhe dorëzimit vetëm ndaj Allahut.



Cilët janë idhujt që duhen pastruar nga bota e zemrës?

– Ndonjëherë, këto janë dëshirat e egos, që për robin janë më të rëndësishme sesa përmbushja e urdhrave të Allahut.

– Ndonjëherë, janë interesat kalimtare që nuk mund të braktisen për hir të Allahut dhe të bëjnë të harrosh ahiretin.

– Ndonjëherë, është një pozitë, që e largon robin nga Zoti i tij.

– Ndonjëherë, është fama dhe pasuria që na bën të harrojmë Allahun e Madhëruar.

– Ndonjëherë, është një epshi që ndjehet për gjininë e kundërt.



Babai im i ndjerë, Musa Efendiu, domosdoshmërinë e edukimit shpirtëror e shprehte me këto fjalë:

"Sado adhurime të kryejë njeriu; edhe sikur gjithë jetën ta kalojë në sexhde dhe agjërim, prapë s'fiton shumë shpërblime (në krahasim me mirësitë që i ka dhënë Allahut). Përparimi i lartë shpirtëror mund të arrihet përmes udhëtimit shpirtëror. Falë këtij udhëtimi, njeriu njeh veten (e kupton dobësinë e tij). Kur e njeh veten, ai fillon ta njohë Allahun, sepse vetëm ata që e njohin egon e tyre mund ta njohin Allahun e Madhëruar. Nëse një person nuk e njeh veten e tij, le të jetë i devotshëm, adhurues apo i ditur sa të dojë, të gjitha këto nuk mjaftojnë për arritjen e përsosmërisë së tij shpirtërore (pasi gjithmonë do ta nxjerrë egon e tij në plan të parë).



Jusuf Has Haxhib thotë:

"O njeri i ditur! Mos u bë skllav i egos! Nëse egoja të robëron, të kërkon fenë në këmbim të lirisë".



Që dija të kthehet në urtësi, është e nevojshme të bëhet pastrimi i egos. Sado dije të ketë njeriu, madje edhe sa një oqean, përsëri edhe ai oqean ka rrezik të helmohet. Për shembull, këtë helmim e shohim tek Karuni dhe Bel'am bin Baura. Ndërkohë që ata të dy ishin robër të drejtë, prirja e tyre ndaj nefsit i helmoi ata. Kjo do të thotë se; çdo besimtar duhet të mbrohet nga e keqja e nefsit të tij.



Ashtu siç nuk erdhëm pa qëllim në këtë botë, e cila është vend sprove, ne nuk jemi as pa mbikëqyrje. Bota nuk është një fushë interesi për dëshirat e egos. Nëse një person jepet tepër pas dëshirave të tij të egos, ai bëhet zullumqar pa e kuptuar fare. Kështu, ai shkatërron jetën e tij të përjetshme.



Zullumqari më i madh është egoja juaj. E në fakt, zullumqari i jashtëm më së shumti mund t'ju marrë jetën. Kurse zullumqari brenda jush, dëshiron t'ju grabitë përjetësinë tuaj!



Nakshibendi thotë:

«O Zot! Njerëzit kanë frikë prej Teje, kurse unë kam frikë nga vetja!

Sepse nga Ti gjithmonë kam parë mirësi, por nga vetja ime veç të keqe."



Sado të edukohet, kurrë nuk mund të jesh i sigurt nga e keqja e egos, sepse, kur dobësia më e vogël shfaqet në vullnetin e robit, ajo është si një armik tinëzar që rri në pritë për të ngritur kokën. Për këtë arsye, është e nevojshme të jeni vigjilentë ndaj egos në çdo kohë. Prandaj edhe Profeti ynë është lutur: *"O Zot! Mos më lër në dorë të vetes sime, as sa hap e mbyll sytë!.."*. (Shih el-Amiu's-Sagir, I, 58.)



Vehb bin Munebbih thotë:

"Sa të çuditshëm janë njerëzit! Qajnë për ata të cilëve u vdesin trupat, e nuk qajnë për ata që u vdesin zemrat. E në fakt, fatkeqësia e vërtetë, është vdekja e zemrës!"



Nëse para një maceje vendoset një qebap i shijshëm, ajo menjëherë fillon të hajë me oreks. Mirëpo, nëse përpara kalon një mi, ajo e lë atë qebap të shijshëm dhe menjëherë vrapon pas miut.

E tillë është edhe gjendja e egos së papërpunuar që nuk është edukuar. E lë lumturinë dhe vrapon pas mjerimit.



Mevlana ka thënë:

"Miu njeh shumë rrugë. Por të gjitha rrugët që njeh, janë nëntokë. Ai, e ka gërmuar tokën nga çdo anë duke bërë brima gjithandej. Edhe egoja jonë i ngjan miut. Ajo vrapon vetëm pas gjërave të kësaj bote dhe bren ëndrrat boshe. Në fakt, miut i është dhënë mendje, aq sa të ketë mundësi të sigurojë nevojat e tij në këtë botë."



Të gjitha harameve - si shkak i urtësisë së sprovës - u janë vënë nga një element që tërheq egon. Gjynahet, njëjtë si mjalti helmues, janë kurthe që në fillim japin kënaqësi, por pasojat e të cilave janë katastrofike.

Një ego e papastër, është gjithmonë gati të bjerë në këto kurthe. Gjynahet tërheqin egot që nuk e kanë fituar ende ndjeshmërinë e takvasë, të cilat janë të papërpunuara, naive dhe të shkujdesura. Për këtë arsye, është thelbësore ta mbani egon nën kontroll duke e pastruar. Prandaj, Allahu i Madhëruar na bën të ditur se shpëtimi i përjetshëm varet nga ky pastrim i nefsit duke thënë: **"Vërtet, kushdo që e pastron nefsin, do të shpëtojë!"** (Shems, 9.)



Një ego e papërpunuar, është një dritare sprove e hapur ndaj harameve. Për shkak se në tharmin e nefsit është vendosur prirja për harame, gjynahet e tërheqin atë si magnet. Kjo është edhe arsyeja pse njerëzit tërhiqen nga haramet. Prandaj, pastrimi i nefsit është thelbësor për çdo qenie njerëzore. Është kusht që shpirtërorja ta mbizotërojë egon.



Dhunun Misri thotë:

"Duhet të jesh mik i Allahut dhe armik i egos, e jo mik i egos dhe armik i Allahut!.."



Abdulkadir Gejlani thotë:

"Rebelimi yt qoftë ndaj egos, kurse bindja jote ndaj Zotit tënd!"



Në mënyrë që një besimtar të jetë gati për xhihad kundër armikut të jashtëm, ai së pari duhet të jetë i suksesshëm në luftën e tij kundër armikut në botën e tij të brendshme. Është e kotë të presësh një fitore të vërtetë kundër armikut të jashtëm pa fituar xhihadin shpirtëror duke veshur armaturën e takvasë kundër egos dhe shejtanit.



Adhurimi i Zotit kërkon një luftë të pandërprerë kundër nefsit, shejtanit, njerëzve të këqij, gjynaheve dhe gënjeshtrës deri në frymën e fundit. Për këtë arsye, një nga përkufizimet e shumta të tasavufit, është «*luftë pa paqe kundër egos*».

Besimtar është ai që i reziston së keqes dhe sulmeve të egos dhe shejtanit gjatë gjithë jetës së tij me forcën e besimit.



Pjekuria e botës së zemrës, kërkon të braktisësh gjërat që i pëlqejnë egos dhe ta disiplinosh atë me vështirësi që nuk i pëlqejnë.



Ashtu si dallgët, që duke goditur gurët në breg, u japin atyre një formë të re, të rrafshët dhe të lëmuar, edhe ne duhet t'i korrigjojmë të metat dhe papërsosmëritë e botës sonë të brendshme me valët e detit shpirtëror.



Njerëzit e dijes thonë: «*Vdisni para se t' ju vijë vdekja*». Ajo çfarë nënkuptohet këtu me shprehjen "vdis", është që të braktisim me vullnet të plotë dëshirat e ulëta dhe ambiciet e pashtershme të egos para se të vijë vdekja e vërtetë dhe papritur t'i themi lamtumirë botës.



Shpëtimi i egos nga papjekuria, kërkon kalimin e shumë fazave të lodhshme, sepse hekuri i papërpunuar nuk mund të dekorohet pa u futur në zjarr.



Para edukimit shpirtëror, zemra është e ftohtë si hekuri. Në mënyrë që ajo të arrijë konsistencën e dëshiruar, fillimisht duhet të kalohet në zjarr, të pastrohet nga ndryshku, papastërtia dhe skoria, të zbutet duke hequr qafe ngurtësinë dhe më pas t'i jepet formë. Kjo, sepse hekuri merr formën e dëshiruar vetëm pas këtyre fazave.

Pikërisht kështu, edhe përsosmëria e zemrës nuk mund të realizohet derisa të gjitha negativet që e mbajnë robin larg Zotit të tij nuk eliminohen nga bota e brendshme dhe nuk këputen zinxhirët e robërisë ndaj dëshirave të egos.



Frutat e pabëra kanë nevojë piqen nga nxehtësia e diellit, në mënyrë që të arrijnë pjekurinë e duhur. Kështu, e vetmja gjë që do t'i shpëtojë zemrat nga papjekuria dhe do t'i ngrejë ato në nivelin e përsosmërisë, është të piqen me sprova.



Mevlana thotë:

«*Nëse doni të përhapni dritë si dita (dielli), duhet të digjni dëshirat e egos suaj, që i ngjajnë natës!*»



Sekreti i paqes dhe lumturisë nuk është në përpjekjen për të ushqyer egon, e cila nuk ngopet kurrë, por në edukimin e saj dhe shpëtimin prej egoizmit.



Ngrënia e pakët e zbut dhe e ndriçon zemrën, ndërsa ngopja e tepërt e bën zemrën të zymtë dhe e errëson atë. Të ngrënit më pak e parandalon harbimin e nefsit dhe ia lehtëson atij që t'i drejtohet së vërtetës dhe së mirës, ndërsa ngrënia e tepërt i verbon ndjeshmëritë shpirtërore, e ngushton shpirtin dhe i bllokon kanalet e vetëdijes dhe të të kuptuarit për të arritur urtësinë.



Thellimi i zemrës me përsiatje, mësim dhe urtësi është më i lehtë në gjendjen e urisë dhe melankolisë, në të cilën ndjehet pafuqia. Kjo, sepse kur stomaku është shumë i mbushur, meditimi mpihet dhe ndjeshmëria e zemrës verbohet.

Mevlana thotë:

"Kur i ikën çdo gjë nga dora, kur pëson ndonjë bela apo fatkeqësi, robi (i cili e kupton dobësinë e tij) fillon e thotë: "O Zot, o Zot!" , duke e kujtuar Allahun e Plotfuqishëm dhe duke iu lutur: "Më shpëto!"



Bejazid Bistami thotë:

"Uria është si një re. Kur dikush përpiqet të hajë pak, në zemrën e tij fillojnë të bien shirat e urtësisë."



Një i urtë thotë:

«Mbaje barkun bosh, si fyell; rënko dhe vajtoj, zbraze atë që ke përbrenda si kallamishte; trego mistere, shkruaj fshehtësi!»



Babai ynë i ndjerë, Musa Efendiu, frymëzimin dhe begatinë e horizonteve që hapen në botën e zemrës si rezultat i edukimit shpirtëror, e shprehte kështu:

"Kur besimtari njeh nefsin e tij, çdo gjëje i ndryshon kuptimi... E për shkak se atij i ka ndryshuar botëkuptimi, çdo veprim i tij bëhet adhurim. Nëse ky rob, i cili ka filluar ta njohë Allahun e Madhëruar, fjala vjen, dëshiron të fitojë pronë dhe pasuri, qëllimi i tij do të ndryshojë.

Ndërkohë që më parë mendonte vetëm në mënyrë egoiste, duke thënë: "Të fitoj pasuri, të ha e të pi, të zotëroj shtëpi e familje dhe të gjithë më duartrokasin!", pasi arrin pjekurinë shpirtërore, fillon e thotë: "Me të mirat dhe pasurinë që më ka dhënë Allahu i Madhëruar, unë do të siguroj edhe ushqim për familjen time, por do t'i shërbej edhe Islamit dhe myslimanëve!".

Dhe, për shkak se kuptimi në nijetin e tij ndryshon, edhe veprat e tij të dynjasë bëhen adhurim. Kur mendimi i njeriut është gjithmonë Allahu i Madhëruar, çdo gjë konsiderohet adhurim. Ushqimi, gjumi dhe marrëdhëniet familjare janë gjithmonë adhurime…"



KËRKIMI I FALJES

Ashtu siç duhet ta pastrojmë një pasqyrë me një copë beze të pastër për t'i rikthyer ndriçimin dhe qartësinë që ka humbur, ashtu është e domosdoshme që kur t'i drejtohemi Allahut, të pastrojmë edhe zemrën tonë me teube dhe istigfar nga papastërtitë shpirtërore.

Ndonjëherë për faljen e një gjynahu duhet derdhja e shumë lotëve. Por, ndonjëherë edhe një pikë lot që rrjedh nga zemra, i fshin njëmijë gjynahe.

Të ndihet fajtor për gjynahun, e madje edhe për neglizhencën, tregon urtësinë e robit. Ndërsa, të kërkojë falje nga Zoti, është detyrë e ndërgjegjes së tij.

Zoti ynë, do një pendim që djeg qiriun e zemrës me zjarrin e keqardhjes dhe sinqeriteti i të cilit vërtetohet me vepra, jo vetëm me gjuhë. Aq, sa gjatë pendimit duhet kërkuar mëshira hyjnore me lot të nxehtë, e pastaj të braktisen gjynahet dhe gabimet, e të mos i përsëriten më kurrë.

Ashtu siç është e nevojshme harmonia e zemrës dhe e trupit në adhurim, edhe pendimi është më tepër një vepër e zemrës. Lidhur me këtë, në një hadith fisnik thuhet:

«Ndjenja e keqardhjes (së sinqertë) ndaj gjynahut, është pendim.» (Ibn Hanbel, I, 423.)

Jahja ibn Muadhi ﷺ, ka thënë:

"Kërkimi i faljes nga Allahu pa i braktisur gjynahet është mashtrim."

Omeri ﷺ, ka thënë:

"Është më e lehtë të braktisësh gjynahun se sa të angazhohesh me teube."

Abdulhalik Guxhduvani thotë:

"Dijeni se; fillimi i rrugës është pendimi. Pendimi është braktisja e të gjitha llojeve të fjalëve dhe veprimeve me të cilat Allahu nuk është i kënaqur."

Një pendim, sinqeriteti i të cilit nuk vërtetohet, ka nevojë për një pendim tjetër. Pra, kur gjuha thotë: «O Zot! Pendohem, më fal!», dhe gjendja e sjellja e personit nuk përputhet me atë që thotë, e robi vazhdon të kryejë të njëjtat gjynahe dhe gabime, atëherë kjo gjendje, siç shprehet edhe Mevlana, është «palaçollëk».

I penduari duhet të mendojë: Ashtu si Ademi dhe Havaja, që iu lutën Allahut të Madhëruar për falje dhe kërkuan strehim dhe mbështetje tek mëshira e Tij, kur nuk kishte njeri në botë përveç tyre, edhe ai duhet të marrë shembull e të përpiqet t'i përgjërohet Allahut për falje. Ashtu si dikush që ka mbetur i vetëm në një oqean të madh ose ka humbur rrugën në një pyll të errët në mënyrë të dëshpëruar, e thotë; «O Zot, më shpëto!», ashtu edhe ai që pendohet sinqerisht, kërkon strehim tek Allahu i Plotfuqishëm me një lutje kaq të zjarrtë.

Ashtu siç është në çdo vepër, sinqeriteti është i domosdoshëm edhe për pranimin e pendimit. Shenja më e madhe e kësaj është keqardhja dhe lotët.

Lotët që do të derdhin besimtarët si rrjedhojë e meditimit të manifestimeve të fuqisë dhe madhështisë hyjnore, me mirësinë

e Allahut, do të bëhen stolia e netëve të përkohshme, drita e errësirës së varrit dhe vesa e kopshteve të Xhenetit.

Rumiu thotë:

"Allahu Teala merr prej tyre në botë disa pika loti, por në vend të tyre të dhuron sa e sa kopshte Xheneti. Ai merr prej teje "ah"-et, të mbushura plot me dashuri dhe vuajtje dhe në vend të tyre jep sa e sa poste të larta dhe vende që nuk mund t'i arrish."

Lotët janë një gjuhë hyjnore që mbartin e shprehin kuptime që nuk mund t'i mbartin fjalët. Njeriu nëpërmjet lotëve kërkon prej Zotit gjëra që as nuk mund t'i imagjinojë.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Vetëm dy sy nuk i prek zjarri i Xhehenemit: Syrin që qan për Allahun dhe syrin që gdhihet i zgjuar duke bërë roje në rrugën e Allahut." (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 12/1639.)

Pendimi është strehimi tek Allahu i Madhëruar, duke pranuar pafuqinë dhe pamundësinë. Kjo është edhe pjekuria shpirtërore që nevojitet për të merituar mëshirën e Allahut të Madhëruar. Kur bëhet lutja e shiut, merren me vete të vetmuarit, jetimët, fëmijët, madje edhe kafshët dhe, të veshur me rroba të vjetra, në gjendje të përulur, e të pafuqishëm, i drejtohesh Allahut për ndihmë.

Istigfari i vërtetë, është ai kur njeriu, pa bartur asnjë lloj egoizmi në vetvete, thotë*: "O Allah! Unë jam i dobët, Ti je Kadir (i*

Gjithëfuqishëm). Ti je Rrahim (i Mëshirshëm), kurse unë një rob i mjerë që ka nevojë për mëshirën Tënde. Prandaj shfaqe mëshirën Tënde tek unë!" Dhe kjo, nuk duhet të lihet vetëm në fjalë, por duhet vërtetuar edhe me fakte, duke bërë vepra të mira.

Allahu është mëshirëplotë, por për falje ka kushte. Kushtet e teubes (pendimit), janë këto:

a. Të bëhesh pishman për të keqen që ke vepruar.

b. Ta urresh me zemër të keqen për të cilën bëhet teube dhe të përpiqesh të mos e veprosh më kurrë atë të keqe.

c. Sinqeritetin e teubes ta vërtetosh me punë të mira

Abdulkadir Gejlani shprehet:

"Vetëm me pendim, nuk mbaron puna. Gjëja kryesore është të jesh i qëndrueshëm në pendim. Në fakt, gjëja thelbësore në mbjelljen e një peme nuk është mbjellja e pemës, por ta rritësh pemën e mbjellë, ta bësh të japë fryte dhe të sigurohesh që ajo të japë gjithmonë fryte të mira".

Pendimi dhe istigfari nuk janë vetëm mjet për faljen e gjynaheve, por -njësoj si bamirësia- ai bëhet shkak për largimin e telasheve, mbizotërimin e veprave të mira dhe shfaqjen e mëshirës hyjnore .

Xhafer-i Sadik thotë:

"Kujt i është pakësuar rrizku, le ta shtojë menjëherë istigfarin!"

Allahu Teala i shpëton nga vështirësitë robërit e Tij që pendohen dhe i kërkojnë falje. Atyre u jep shumë mirësi.

Njëherë, katër vetë shkuan te Hasan el-Basriu. I pari u ankua prej thatësirës, i dyti prej varfërisë, i treti prej tokës që nuk jepte prodhim dhe i katërti për faktin që nuk kishte fëmijë. Ata të katërt i kërkuan Hasan el-Basriut që të bënte lutje për ta. Ky mik i madh i Zotit e këshilloi secilin prej tyre që të bënte "istigfar". Njerëzit e tjerë që gjendeshin pranë tij, i thanë:

"I nderuar! Problemet dhe vështirësitë e këtyre të katërve janë të ndryshme, por ju i dhatë të njëjtën këshillë secilit prej tyre?!." Hasan el-Basriu iu përgjigj atyre duke u lexuar këtë ajet fisnik:

"...Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm, t'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!" (Nuh, 10-12) (Ibn Haxher, Fet'hu'l-Bari, XI, 98; Ajni, Umdetu'l-Kari, Bejrut, pa datë, XXII, 277-278.)

Në të gjitha rastet, prej istigfarit ka dobi. Por kjo dobi herë shfaqet menjëherë, herë tjetër shtyhet për një afat të caktuar dhe herë tjetër shtyhet për në botën tjetër, sepse robi nuk e di se çfarë është e mirë për të.

Kur hasim vështirësi dhe probleme, para së gjithash, duhet të mendojmë se kjo mund të jetë për shkak të gabimeve tona në detyrat e devotshmërisë, prandaj duhet t'i kthehemi menjëherë pendimit dhe istigfarit. Një vëmendje dhe ndjeshmëri e tillë është një sjellje e rëndësishme e miqve të Zotit. Fudajl Bin Ijadi, i cili e ka kuptuar shumë më mirë këtë të vërtetë, ka thënë:

"Unë e kuptoj që nuk i jam bindur Allahut, kur nuk më bindet gomari dhe shërbëtori."

Kur një besimtar ndeshet me një problem, në vend që të rebelohet ose të ankohet, ai duhet të mendojë; "Të gjitha gabimet janë të miat. Vallë cilat nga gabimet e mia e ka shkaktuar këtë shqetësim?" Kështu, me këtë mendim, ai duhet të ekzami-

nojë gjendjen e tij shpirtërore dhe të përpiqet të plotësojë dhe përmirësojë mangësitë e tij.

Miqtë e Allahut e ndajnë pendimin në tre pjesë:

1- Pendimi i njerëzve të thjeshtë: Këta pendohen për gjynahet e tyre.

2- Pendimi i robërve të zgjedhur (havas): Këta pendohen për pakujdesinë ndaj Allahut në punët e tyre.

3- Pendimi i robërve më të zgjedhur: Këta pendohen që të jenë më afër Allahut.

Pendimi dhe kërkimi i faljes, në të vërtetë, janë mënyrat më efektive për të qenë pranë Allahut, pasi ato janë një keqardhje e thellë, rrëfim i dobësisë dhe strehim tek Allahu i Madhëruar. Ashtu siç e ndihmon zemrën të pastrohet nga papastërtitë shpirtërore, po ashtu e ndihmon edhe në largimin e perdes së shkujdesjes ndërmjet robit dhe Zotit të tij, dhe rrjedhimisht, në pëlqimin dhe dashurinë e Allahut. Në një ajet urdhërohet:

"...Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen." (Bekare, 222.)

Edhe nëse nuk do të bënim asnjë gjynah -gjë e cila nuk është e mundur, por edhe sikur të jetë- përsëri do të ishim të detyruar të bënim istigfar (të kërkonim falje) për pamundësinë e falënderimit të Allahut për të gjitha mirësitë që na ka falur. Për këtë arsye, edhe profetët të cilët ishin më të pastër se uji i shiut, kanë kuptuar dhe pranuar dobësitë e tyre dhe kanë jetuar gjithmonë duke bërë istigfar.

Edhe pse të Nderuarit tonë ﷺ, i ishin falur të gjitha gabimet e kaluara dhe të ardhshme, ai thoshte:

"Unë i lutem Allahut që të më falë, më shumë se shtatëdhjetë herë (sipas një transmetimi tjetër 100 herë) në ditë." (Shik. Ebu Davud, Vitr, 26; Ahmed, II, 450.)

Atëherë, gjuhët dhe zemrat tona që janë të mbushura me gjynahe, duhet të preokupohen pa reshtur me kërkimin e faljes nga Zoti kurdo që t'u jepet mundësia, veçanërisht në kohën e seherit.

Edhe nëse një besimtar është aq pa gjynahe sa momenti kur ka lindur, ai duhet të kërkojë shumë falje nga Allahu i Madhëruar, sepse ai nuk është në gjendje ta falënderojë Atë siç duhet për mirësitë e panumërta që i ka falur Ai. Kjo është një arsye tjetër për istigfar.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ

"Ti madhëroje Zotin tënd me lëvdatat dhe kërko falje nga Ai!.." (Nasr, 3)

Me fjalë të tjera, Allahu dëshiron që ne ta përmendim me lavdërim për të gjitha begatitë që na ka falur. Megjithatë, duke deklaruar se kjo nuk mjafton, Ai gjithashtu na urdhëron të kërkojmë falje për shkak të shkujdesjes dhe pamundësisë për ta falënderuar siç duhet.

Pendimi dhe istigfari nuk janë vetëm për gjynahet. Pendimi dhe istigfari kanë një vend të rëndësishëm në edukatën e adhurimit, sepse përveç të metave që dimë, kemi edhe shumë të meta që nuk i dimë ose jemi të pavetëdijshëm. Për këto është e nevojshme

që ne të jemi gjithmonë në gjendje pendimi dhe istigfari përballë Allahut ﷻ.

Ne duhet të mendojmë se; Zoti ynë nuk na i ndal bekimet e Tij, pavarësisht gabimeve, neglizhencave dhe dobësive tona të shumta që nuk i dimë. Edhe pse nuk jemi të denjë, Ai na jep shumë mirësi dhe begati. Prandaj, përderisa e lavdërojmë dhe falënderojmë Zotin e Madhëruar për begatitë e Tij, duhet edhe të kërkojmë falje për gabimet dhe të metat tona.

Profetët dhe njerëzit e devotshëm, kanë jetuar gjithmonë me dua. Të shkujdesurit, nga ana tjetër, i shpërfillin udhëzimet, urdhrat dhe ndalesat e Allahut të Madhëruar. Ata mashtrojnë veten duke thënë: «Zemra ime është e pastër(!)». Ata e harrojnë adhurimin, namazin dhe strehimin tek Allahu, sikur e kanë të garantuar xhenetin. Mirëpo, ata që harrojnë namazin bëhen mosmirënjohës e arrogantë, dhe me kalimin e kohës, devijojnë në rebelim dhe mizori. Kjo - Zoti na ruajt - është shkak i një humbjeje dhe katastrofe të përjetshme.

Neglizhenca më e madhe, është atëherë kur njeriu mashtron veten duke u strehuar në cilësitë “Rahman, Rahim dhe Gaffar” të Allahut, edhe pse ai nuk është në rrugën e Allahut.

Nefsi dhe shejtani përpiqen t’i mashtrojnë njerëzit me sugjerimet e mëposhtme:

“Sidoqoftë, Allahu është Gafur dhe Rahim, më i Mëshirshmi i Mëshiruesve. Edhe nëse bën gjynahe, Ai fal... Ti je ende i ri, shijoje jetën tani, se adhurimet i bën kur të plakesh...”

Allahu i Plotfuqishëm, i paralajmëron robërit e Tij që të mos mashtrohen nga sugjerimet e tilla duke urdhëruar:

«...Mos e lini jetën e kësaj bote t'ju mashtrojë dhe as shejtanin mos e lini t'ju mashtrojë për Allahun." (Lukman, 33.)

Myslimanit nuk i ka aspak hije të mos u bindet urdhrave dhe ndalesave hyjnore si duhet dhe të injorojë fundin e tmerrshëm të harameve duke u mbështetur në pafundësinë e mëshirës, faljes, mirësisë dhe bujarisë së Allahut, e duke menduar «*hë se, të gjithë do të falen!*» Sepse, të mendosh se Allahu është Gafar (falës) dhe Rahim (shumë i dhembshur dhe i mëshirshëm) dhe të injorosh se Ai është gjithashtu edhe Kahar (i cili ka një fuqi të parezistueshme dhe dërrmuese), edhe Shedidu'l-Ikab (dënon shumë rëndë), është një gabim dhe pakujdesi e madhe.

Njerëzit e mençur thonë:

"Njeriu i shkujdesur ka pesë shenja:

1. Harron gjynahet e shkuara, ndërkohë që ato janë të regjistruar tek Allahu.

2. Kujton veprat e mira të së kaluarës, ndërkohë që nuk i dihet nëse ato janë të pranuara nga Allahu apo jo.

3. Krahasohet me ata që janë në gjendje më të mirë se vetja për sa i përket kësaj bote dhe nuk falënderon Allahun.

4. Krahason vetveten me ata që janë në nivel më të ulët në aspektin fetar dhe ndihet i kënaqur me aq.

5. Zhytet në gjynahe duke u mashtruar nga shejtani, i cili thotë se «Sidoqoftë Allahu do të falë!"

Ata që nuk pendohen dhe këmbëngulin në mizori e padrejtësi, vetëm sa ia shtojnë vetes përditë e më shumë ashpërsinë e zemërimit dhe dënimit hyjnor. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"Mos mendo kurrsesi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) **deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen** (nga tmerret që do të shohin)." (Ibrahim, 42.)

Pendimi i vërtetë, nuk është ai që bëhet në mënyrë të pavullnetshme në pragun e vdekjes, por kur i drejtohesh Allahut me dëshirë dhe i dorëzohesh urdhrave dhe ndalesave të Tij me gjithë shpirt.

Xheneti është vendbanim i pastër, nuk mund të hyhet me gjynahe dhe rebelim ndaj Allahut. Njeriu që aspiron xhenetin, duhet të pastrohet nga të gjitha papastërtitë materiale dhe shpirtërore të dynjasë dhe dëshirat e egos së tij.

Zemra që Allahu i Madhëruar dëshiron nga robërit e Vet, është një zemër e pastruar, e rafinuar, dhe e kulluar. Por, si do të fitohet kjo? Sigurisht:

- Duke e mbrojtur zemrën nga papastërtia e gjynaheve dhe ambiciet egoiste.

- Duke u pastruar nga gjynahet, me lot keqardhjeje, pendim dhe istigfar...

- Duke u bërë robër të devotshëm, me përpjekjen për të dalë faqebardhë para Allahut me dinjitet, qetësi shpirtërore dhe ndërgjegje të pastër...



NAMAZI I NATËS

Nëse besimtari, kohën para agimit, që vlen një thesar shpirtëror, e humb në gjumë, i ngrirë si statujë, kjo i ngjan atyre fatkeqëve që vdesin nga uria, pa e ditur se janë ulur mbi një thesar.

Nëse një besimtar arrin ta përdorë kohën e agimi në përputhje me këshillën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, nata e tij do të jetë më e ndritshme se dita.

Kurani shprehet:

"Në një pjesë të natës bëji sexhde Atij dhe, natën falju gjatë Atij. Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin një Ditë të vështirë, që do t'u vijë." (Insan, 26-27.)

"Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne." (Sexhde, 16.)

"Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu)**."** (Dharijat, 17-18.)

Kohët para agimit, janë kohët më të begata për të kërkuar strehim tek Allahu, me qëllim që shpëtosh nga dënimi dhe të arrish mëshirën hyjnore. Zoti ynë na fton të kërkojmë falje në kohën para agimit. Ashtu siç vjen agimi, dhe errësira shpërndahet pas agimit, kërkimi i faljes në agim është mundësia më e jashtëzakonshme për të larguar errësirën e gjynahut dhe pakujdesisë dhe për të arritur dritën e faljes hyjnore.

Profeti ﷺ, në udhëtime të vështira si në Tebuk, nuk e ka lënë asnjë herë namazin e natës. Në lidhje me namazin e natës ka dhënë këto këshilla:

"Bëni kujdes! Mundohuni të ngriheni natën, sepse kjo është tradita e njerëzve të devotshëm para jush dhe mënyrë për t'u afruar tek

Allahu. (Ky adhurim) Të ndalon nga gjynahet, është shpagim për gabimet dhe eliminon problemet e trupit." (Tirmidhi, Deavat, 101/3549.)



"Më të nderuarit e umetit tim janë ata që i shërbejnë Kuranit (pra, hafizët që i shërbejnë Kuranit) dhe ata që ngrihen për adhurimin e natës." (Munavi, I, 522.)



Në agim, Allahu i Madhëruar ka paralajmërime të veçanta për zemrat që dëgjojnë dhe ndjejnë. Në atë kohë, kur ajri freskohet si një fllad i ëmbël, lulet lëshojnë aroma të këndshme dhe gjelat kanë filluar të këndojnë pothuajse si një orë me alarm, Allahu i Madhëruar i fton robërit e Tij të kërkojnë falje dhe u jep një mundësi të jashtëzakonshme shpirtërore.



Gjallërimi i kohës para agimit, është përgjigje ndaj ftesës së veçantë të Zotit tonë. Namazi i natës dhe dhikri, janë pothuajse si takimi dhe bisedë me Zotin e Madhërishëm. Të zgjohesh në agim kur të gjithë janë në gjumë dhe të hysh në klimën e mëshirës hyjnore, do të thotë të jesh një nga robërit e dalluar që marrin pjesë në kuvendin e dashurisë dhe njohjes së Allahut.



Gjallërimi i agimeve me adhurim, mund të arrihet në raport me forcën e dashurisë hyjnore në zemër. Kjo, sepse agimi është koha për t'u ngritur nga shtrati, që i tërheq njerëzit si magnet, për të ndërprerë gjumin e ëmbël dhe për t'u drejtuar drejt paqes hyjnore vetëm për hir të dashurisë ndaj Allahut. Për këtë arsye, kjo është edhe shprehje e qartë e dashurisë së sinqertë të robit ndaj Zotit të tij. Është e pamendueshme për një besimtar që e

do Zotin e tij në mënyrë të përsosur, të flejë deri në mëngjes në pakujdesi të thellë!..



Po ashtu, Xhelaledin Rumi në veprën e tij poetike *"Divani Kebir"*, e shpreh në vargje pasionin dhe ëmbëlsinë e adhurimit të përjetuar gjatë netëve:

Saki, mbushe kupën me dashuri hyjnore plot!
Lëre të dehurin, për bukë ç'i flet kot!
Shërbeje eliksirin të ngopen zemrat e etura!
Gjallesa që noton në det, veç ujit tjetër ç'do?
Mbushe nga ajo pije, mbushe prapë e na sill!
Të ndalet nata! Ndale natën në vend, o mik!
Lidhma gjumin me zinxhirë, çastet të mos kalojnë!
S'e kuptojnë sekretin e natës, o mik, ata që flenë!



Nëse interesi personal i një personi kërkon që ai të ngrihet në mes të natës, çfarëdo që të bëjë ai person, ai patjetër do ta ndërpresë gjumin në atë orë. Allahu i Madhëruar na fton ne, robërit e Tij, të takohemi në agim. Shfaqja më e madhe e dashurisë është vetëmohimi. Koha para agimit, kur hapen dyert e faljes dhe mëshirës hyjnore, është gjithashtu koha e mirësive të jashtëzakonshme, kur dashuria jonë për Zotin tonë vihet në provë.



Kohët e agimit, të cilat ringjallen me tehexhud, dhikër, falje dhe lutje, janë mundësitë më të begata për t'iu afruar Zotit. Dielli i begatshëm i ahiretit fshihet në muzgun e agimit.



Të gjithë miqtë e Allahut kanë përfituar nga shkëlqimi i agimit dhe kanë tërhequr vëmendjen për rëndësinë e ringjalljes së asaj kohe të jashtëzakonshme me adhurim. Bajezid Bistami ka thënë:

"Mua nuk m'u shfaq asnjë e fshehtë, derisa nata ime u bë ditë".



Në sytë e të dashuruarve të Allahut, agimet e kaluara larg namazit, dhikrit dhe meditimit, janë orët më të trishta të ndarjes.



Nëna e vet e këshillonte kështu Sulejmanin عليه السلام:

"Bir! Natën mos fli shumë! Sepse gjumi i tepërt të nxjerr të varfër në ditën e gjykimit."



Jahja ibn Muadhi thotë:

"Netët janë të gjata mos i shkurto ato me gjumë!.."



Lukmani عليه السلام, thotë:

"Biri im! Të mos jetë gjeli më i zgjuar se ti! Gjeli çdo agim bën dhikër kurse ti fle gjumë."



Nëse një besimtar e shpenzon gjithë natën në gjumë, duke u privuar nga frymëzimi hyjnor, pra i flijon netët për hir të gjumit, i ngrirë si një bust, është me të vërtetë një humbje e madhe.



Namazet e natës janë një model miniature e ditës, dhe ata që e kalojnë këtë kohë në gjumë, e dinë që nuk do t'i shijojnë frytet dhe begatitë e këtij çasti që ngjan me shirat e begatshëm të Prillit, që kur bien në det, në shkretëtirë dhe në shkëmbinj, humbasin frytet e tyre.



Agimi është koha për të zgjuar zemrën. Një person, agimi i të cilit është - shpirtërisht - i errët, ai nuk do të jetë i ndritshëm - shpirtërisht - as gjatë ditës. Për ata që nuk ia dinë vlerën natës, është e pamundur të mendojnë për vlerën e ditës. Atij që fle i shkujdesur gjatë gjithë natës, përgjithësisht edhe dita i kalon në një gjendje të privimit nga frymëzimi shpirtëror. Prandaj, që të mos na ngathtësohen zemrat, duhet të mos e burgosim veten në gjumin e natës.



Kohët e agimit, janë periudhat më pjellore të ditës. Në atë kohë, namazi, istigfari dhe lotët duhet të konsiderohen si mirësi. Në agim duhet të merret ushqimi i nevojshëm shpirtëror nga ajo tryezë e gostisë shpirtërore, në mënyrë që robi të hyjë me entuziazëm të lartë shpirtëror në jetën e ditës. Ai frymëzim shpirtëror e ruan zemrën gjatë gjithë ditës nga gjynahet, pakujdesia dhe të gjitha llojet e të këqijave që e largojnë zemrën nga Allahu. Zemra juaj shton pasionin për vepra të mira dhe rezistencën ndaj së keqes.



Njëherë, një person i ankohet Ibrahim bin Ed'hemit:

- Nuk po arrij të ngrihem në adhurimet e natës. Më jep një zgjidhje!

Ibrahim Ed'hemi, i thotë:

- Mos e kundërshto Allahun gjatë ditës, që Ai të të pranojë natën. Nëse Ai të pranon natën, ky është një nder shumë i madh, të cilin gjynahqarët nuk e meritojnë!

Nëse nuk mund të ngrihemi natën në kohën e agimit -përveçse kur jemi sëmurë-, atëherë duhet të rishikojmë ditën tonë:


– A ia kemi hedhur sytë ekraneve dhe imazheve haram?

– A ka folur gjuha jonë ndonjë fjalë të gabuar?

– A kanë dëgjuar veshët tanë zëra të gabuar; a kanë hasur thashetheme, përgojime, etj.?

– A na ka hyrë në stomak ndonjë kafshatë e ndaluar apo i dyshimtë?

Pra, është gjithmonë e nevojshme të kërkohet shkaku i sëmundjes dhe të merren masa paraprake. Ashtu siç ka mjekësi parandaluese në shëndetësi, edhe mjekësia mbrojtëse e zemrës është një domosdoshmëri shpirtërore...



ADHURIMET

Adhurimet janë si vitaminat që i jepen shpirtit. Ato janë mjetet e rezistencës shpirtërore kundër viruseve të gjynaheve që e largojnë robin nga Zoti i tij.

Mos u besoni veprave tuaja, sepse të gjitha ibadetet, veprat dhe shërbimet tona kanë nevojë për pranim, ashtu si lutjet tona.

Besimi i ngjan një burimi drite. Erërat e egos dhe të shejtanit fryjnë gjatë gjithë jetës sa herë që të munden, me qëllim që ta shuajnë këtë dritë. Ndërsa adhurimet janë si një fener që e ruan dritën e besimit nga erërat negative.

Për rrjedhojë, nëse adhurimet kryhen me qëllim të pastër dhe në mënyrë të pranueshme, edhe drita e besimit në zemër do të jetë e fortë dhe e shndritshme.

Allahu thotë në Kuran:

"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë?!" (Ankebut, 2.)

Allahu i Madhëruar e sprovon besimin tonë në çdo rast. Mbrojta e imanit kërkon të mos bësh lëshime nga të qenit rob i Allahut të Madhëruar. Nëse bëhen lëshime, Zoti na ruajt, do të krijohen çarje në themelin e besimit.

Njeriu indiferent, që mendon se; "unë jam mysliman dhe Allahu do të më falë, sepse është Gafur dhe Rahim.", në frymën e fundit mund të shkelë në një dërrasë të kalbur dhe - Zoti na ruajt- mund të humbasë edhe besimin. Për këtë arsye, është e nevojshme të bëhet një jetë me adhurime dhe me ndjeshmërinë e takvasë deri në frymën e fundit.

Ne i japim vitamina trupit tonë me ushqimin që marrim dhe jeta jonë vazhdon. Po ashtu duhet t'i japim vitamina shpirtërore

shpirtit tonë, në mënyrë që të zhvillohet jeta jonë shpirtërore. Adhurimet janë si vitaminat që i jepen shpirtit. Ato janë mjetet e rezistencës shpirtërore kundër viruseve të mëkatit që e largojnë robin nga Zoti i tij.

Njeriu që nuk kryen adhurime, ose i çon dëm ato për shkak shkujdesjes, nuk i vjen keq ta lërë shpirtin e tij të uritur, madje as t'i bëjë padrejtësi atij.

Besimtari duhet të brengoset për vdekjen e shpirtit të tij dhe jo të trupit të tij, sepse trupi, i cili është si rroba e shpirtit, në fund do të kthehet në origjinën e tij, pra në tokë. Shpirti, nga ana tjetër, do të ngrihet dhe do të lartësohet në raport me fuqinë e tij shpirtërore.

Nëse dikush na sjell dhurata shumë të çmuara, por na i jep ato me fytyrë të vrenjtur dhe pa dëshirë, ne nuk do të kemi shumë dëshirë t'i pranojmë ato. Mirëpo, edhe gjëja më e vogël që mund të na jepet nga shpirti, me sinqeritet dhe mirësjellje, ne do ta pranonim atë me shumë dëshirë dhe do të ndjenim dashuri për atë që na e jep.

E njëjta gjë vlen edhe për adhurimet dhe devotshmërinë që robi i ofron Allahut. Sa më shumë pasion dhe dëshirë të përmbanë adhurimet dhe veprat që bëjmë për hir të Allahut, aq më shumë vlerë do të kenë ato tek Ai.

Sheh Nakshibendi thotë:

"Nuk ka asnjë dobi nga puna që bëhet me zemërim, indiferencë, pa dëshirë dhe me zor."

Një person shkoi tek Bajezid Bistami dhe i tha:

"-Më mëso një gjë të tillë që të jetë shkaku i shpëtimit tim!"

Bajezid Bistami i dha atij këto këshilla:

"- Mbaji mend këto dy fjali; do të mjaftojnë si dije:

1. Allahu është më afër teje se damari i qafës, Ai di dhe sheh çdo gjë. (Kështu që ta dish se je gjithmonë nën mbikëqyrjen e kamerave hyjnore!)

2. Allahu nuk ka nevojë për veprat e tua. (Prandaj, përpiqu të bësh vepra të mira me ndjenjën e mirënjohjes dhe vetëdijen se ke nevojë për Të!)"

Shpirtrat e lartë jetojnë me një ndjenjë të vazhdueshme lutje-je dhe robërie, sepse zemrat e tyre drithërohen vazhdimisht nga paralajmërimi hyjnor në këtë ajet që flet për rëndësinë e lutjes:

"Thuaj: «Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...»" (Furkan, 77.)

Nuk duhet të harrojmë se; edhe sikur e gjithë bota ta mohonte ekzistencën e Allahut të Madhëruar, Qenies së Tij të Lartë nuk do t'i humbiste asnjë gram nga madhështia që ka. Edhe sikur të gjithë njerëzit të bekoheshin me besimin në Allah, ata nuk do të mund ta zmadhonin madhështinë e Tij. Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë për ne. Prandaj besimi ose mosbesimi ndikojnë vetëm tek ne; na sjellin të mira ose të këqija vetë neve.

Me qëllim që të ketë fitime të kënaqshme në tregti, tregtari i mençur i përgatit mallrat e tij me cilësinë që do t'i pëlqejë klientit të tij dhe përpiqet ti tregtojë ato në një mënyrë që do t'i pëlqejë klientit të tij. Kështu edhe në këtë botë, që është si një treg ku njeriu mundohet të blejë Xhenetin, besimtari duhet t'i kryejë të

gjitha ibadetet, veprat dhe bamirësitë, në një mënyrë që do ta kënaqin Zotin e Madhëruar dhe duhet t'i paraqesë përpjekjet për të fituar pëlqimin e Tij.

Të urtët kanë thënë:

"Adhurimi e çon njeriun në Xhenet. Ndërsa edukata dhe respekti gjatë adhurimit, e çojnë atë tek Allahu dhe e bëjnë mik me Të."

Në një ajet është urdhëruar:

"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë..." (Mulk, 2.)

E në fakt, nëse shohim me vëmendje, Allahu i Madhëruar, nuk ka thënë: "punë më të shumta" por, "punë më të mira".

Me fjalë të tjera, Ai shprehet se i jep më shumë rëndësi atij që do të veprojë "më mirë", sesa atij do të bëjë "më shumë".

Enes bin Malik ﷺ, ka thënë:

"Edukata në vepra, është tregues i pranimit të tyre."

Për këtë arsye, dëshira e zjarrtë ndaj ibadeteve është një shfaqje e dashurisë në zemër ndaj Allahut (xh.xh.). Ai që e do Allahun, e zbaton edhe urdhrin e Tij me dashuri, sepse namazi është një takim dhe bisedë me Allahun e Lartësuar. Le të përpiqemi të bëjmë vepra që i do Allahu, në mënyrë që edhe Allahu të na dojë, sepse, kur Allahu e do robin e Tij, i dhuron edhe dashurinë për të kryer veprat që Ai i do. Pra, ia mundëson atij t'i kryejë ato duke ndjerë një kënaqësi të papërshkrueshme.

Në dashuri ka një sekret të atillë, që i kthen vështirësitë në mëshirë. Kështu, ndërkohë që 20 rekate namaz i teravive me zemër të mbushur plot me dashuri besimi, e madje edhe namazi tehexhud që falet duke u ngritur në kohën më të ëmbël të gjumit, nuk janë aspak të vështirë, namazi i sabahut me 2 rekate, i falur pa dashuri në zemër, të duket shumë i vështirë.

Profeti ﷺ, na këshillon të lutemi në këtë mënyrë:

"O Zoti im! Më ndihmo në përmendjen time në falënderimin tim dhe ibadetin tim ndaj Teje!" (Ebu Davud, Vitr, 26.)

Shenja më e madhe e pranimit të adhurimeve tona, është ngritja e nivelit të moralit tonë.

Cilësia e adhurimit tonë, është një pasqyrë përmes së cilës ne mund të shikojmë anën tonë shpirtërore. Le të rishikojmë gjendjen tonë shpesh në këtë pasqyrë dhe të përpiqemi të korrigjojmë të metat tona dhe të përmirësojmë virtytet tona, nëse kemi.

Një ditë, kur Abdullah Dehleviu ishte agjërueshëm, në prani të tij folën keq për sulltanin. Abdullahu tha:

"Mos, na u prish agjërimi!"

Edhe pse një nxënës i tij i tha:

"I nderuar! Ju nuk përgojuat!", ai u shpreh:

"Po, ne nuk përgojuam, por e dëgjuam përgojimin. Shkujdesja shpirtërore reflektoi te ne dhe e dëmtoi përshpirtshmërinë e agjërimit, sepse në lidhje me përgojimin janë njëlloj si ai që e bën, si ai që e dëgjon."

Nëse një njeri e fal namazin dhe e mban agjërimin siç duhet, edhe morali i tij është i lartë e i rregullt. Domethënë se; kur flet e thotë të vërtetën, e ruan amanetin dhe bën kujdes ndaj hallallit e haramit.

Nëse do t'u përmbahemi me përpikëri këtyre cilësive etike, edhe namazin do ta falim me përkushtim të plotë dhe si rrjedhojë namazi ynë do të jetë i pranuar.

Mevlana ka thënë:

"Treguesi i pranimit të një adhurimi, është që pas tij të fillosh menjëherë një adhurim tjetër, duke vrapuar në mirësi njëra pas tjetrës."

Shenja e pranimit të një vepre, është që ajo të pasohet nga një tjetër vepër e mirë. Shenja e mospranimit të saj, është që ajo të pasohet nga një vepër e keqe. Por, më keq se kjo, është kur e keqja që vjen pas një vepre të mirë, e shkatërron atë të mirë.

Veprat e mira që nuk shoqërohen me sinqeritetin dhe devotshmërinë e zemrës kanë fatin të shkatërrohen si një ndërtesë e kalbur, pa marrë parasysh sa të shumta janë ato në numër.

Rregullimi i zemrës arrihet me rregullimin e veprave, rregullimi i veprave arrihet me rregullimin e qëllimit.

Ata që kanë qëllim të errët nuk shikojnë dritë në rrugë.

Ashtu sikur një radio që nuk jep zë të qartë kur nuk pozicionohet në frekuencën e duhur, ashtu edhe zemra, si rezultat i ndjenjave të gabuara dhe pakujdesisë, bie në shkatërrim.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Allahu i Madhëruar pranon vetëm adhurimet që bëhen për të arritur kënaqësinë e Tij, asgjë tjetër!" (Nesai, Xhihad, 24.)

Qëllimet duhet të jenë për hir të Allahut, në mënyrë që të kenë vlerë tek Allahu, përndryshe të gjitha janë të refuzuara. Në një hadith Kudsi Allahu thotë*: "Refuzoj personin dhe punën në të cilën më shoqërohet shok."* (Muslim, Zuhd, 46.)

Besimi, adhurimi, bamirësitë dhe veprat tona të mira janë si furnizimet që i ruajmë gjatë gjithë jetës për në ahiret. Por, nëse Allahu i Madhëruar nuk i pranon ato, e për më tepër, nëse e kemi humbur shpërblimin e atyre veprave për shkak të shëmtive të egos, si hipokrizia, mburrja, mendjemadhësia dhe zilia, ne nuk do të ndryshojmë aspak nga të shkujdesurit që përpiqen të bartin grurin në mulli me thasë të shpuar. Në këtë aspekt, ashtu si kryerja e veprave të mira, gjithashtu është e nevojshme edhe të ruhemi nga veprimet negative që do të dëmtojnë shpërblimin e tyre.

Jahja bin Muadh thotë:

"O mik! Kujdesu për kapitalin tënd të besimit, që të mos e brejnë minjtë e hipokrizisë dhe të karakterit të keq!"

Në varësi të nivelit të sinqeritetit të nijetit në zemër, Allahu i Madhëruar e bën më shumë të paktën e robit të Tij dhe me mirësinë e Tij dhuron shpërblime të mëdha si malet, qoftë edhe për një vepër të vogël. Nga ana tjetër, nëse adhurimet dhe bamirësitë bëhen për t'u dukur dhe pa sinqeritet, edhe veprat që duken të mëdha dhe madhështore sa malet, zvogëlohen, dhe shpërblimi i tyre shkatërrohet.

Kur shejtani, si armik i hapur i njeriut, nuk mund ta mashtrojë një besimtar për ta devijuar nga rruga e drejtë dhe për ta çuar në mëkat e rebelim, ai ndryshon taktikën. Herë tjetër, ai shfaqet në formën e së vërtetës. Ky ajet e përshkruan më së miri këtë lojë të shejtanit:

«...Unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë."
(A'raf, 16.)

Me fjalë të tjera, Iblisi e kryen detyrën e devijimit, jo vetëm në rrugë të prishura dhe të gabuara, por edhe në rrugën e drejtë.

Për shembull, dikë që nuk mund ta pengojë të ndërtojë një xhami apo një institucion bamirësie, ai e këshillon t'i vendosë asaj vepre emrin e tij. Kështu, ai përpiqet të shkatërrojë shpërblimin e veprave të mira, duke dëmtuar sinqeritetin, me hipokrizi, famë dhe mendjemadhësi.

Në këtë aspekt, një besimtar duhet të shmangë emërtimin e një bamirësie, si për shembull një xhami apo kurs Kurani, që ai ka ndërtuar. Megjithatë, nuk është e ndaluar që emri i tij të vendoset nga të dashurit e vet, pasi ai të ketë ndërruar jetë. Përkundrazi, kjo do të jetë një mundësi që ai të kujtohet me lutje dhe mëshirë.

Hasan Basriu thotë:

"Një person që shan veten mes njerëzve, në fakt ai po lavdërohet. E kjo është një nga shenjat e hipokrizisë."

Për shembull, "modestia" është një sjellje e bukur morale. Por, nëse teprohet me të, ajo mund të kthehet në një lloj mburrjeje indirekte, gjë e cila çon në shpërdorimin e modestisë. Dhe, me të vërtetë që disa njerëz mbajnë qëndrime modeste me qëllim që të kënaqin egon e tyre kur të dëgjojnë të tjerët që i përmendin si njerëz "modest". Kjo sjellje jo e sinqertë dhe për sy e faqe, nuk është gjë tjetër veçse një mburrje nën maskën e modestisë.

Për shembull, fjalë të tilla si, "unë jam i dobët në besim, por njëherë në tre ditë e lexoj komplet Kuranin", ose "unë jam i varfër, por arrita ta ndërtoj një xhami dhe kam ndihmuar kaq të varfër", nuk janë gjë tjetër veçse shfaqje e mburrjes dhe syefaqësisë nën perden e modestisë.

Zoti ynë kërkon gjithmonë sinqeritet prej nesh. Ai dëshiron që ne të jemi të sinqertë në qëllimet tona. Ai dëshiron që devotshmëria jonë të jetë e sinqertë, vetëm për Të. Pra, vetëm për hir të Allahut, sepse besimi monoteist nuk e toleron dot ortakërinë.

Besimtari monoteist, ashtu siç i refuzon zotat e rremë në botën e jashtme dhe njeh vetëm Allahun e Plotfuqishëm si Zot, ai duhet t'i përmbahet kuptimit dhe shpirtit të teuhidit edhe gjatë adhurimit, që konsiderohet takimi më privat me Allahun. Pra, duhet të përpiqet të mos lejojë që mendimet egoiste të ndërhyjnë mes Allahu dhe vetes së tij.

Duhet të mendojmë se; Allahu i Madhëruar është ai që na ka bekuar me jetë dhe pasuri. Për më tepër, ai na premton Xhenetin nëse këto begati përdoren për hir të kënaqësisë së Tij. A mund të japë dikush një shpërblim kaq të madh përveç Allahut? Cili i vdekshëm ka fuqi ta bëjë këtë?!

Prandaj, është e pamundur të imagjinohet një marrëzi më e madhe se t'i bësh të vdekshmit ortakë në adhurimin që duhet bërë vetëm për Allahun!

Të mos harrojmë se; Ditën e Gjykimit, vetëm Allahu mund t'i shpërblejë adhurimet dhe veprat tona të mira; jo të vdekshmit!

Njëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, ka theksuar se:

"Ajo që kam më shumë frikë për ju, është shirku i vogël." Sahabët e pyetën:

"Çfarë është shirku i vogël o i Dërguari i Allahut?"

Profeti ﷺ, tha:

"Syefaqësia! Pra, dëshira për t'u dukur. Ditën e Kiametit, kur njerëzit janë duke marrë shpërblimin e punëve, Allahu i Madhëruar u drejtohet dyfytyrëshve dhe u thotë:

«Shkoni kërkoni shpërblimin tuaj prej atyre, për të cilët keni punuar në dynja! Të shohim a do të gjeni ndonjë shpërblim tek ata?»" (Ahmed, V, 428, 429.)

Të kesh një qëllim tjetër në adhurim, përveç kënaqësisë së Allahut, do të thotë të biesh në shirk të fshehtë. T'i bësh punët e mira për hir të dikujt tjetër, krahas Allahut, do të thotë t'i çosh dëm ato.

Lutja; *«O Zot! Qëllimi im je vetëm Ti dhe kërkesa ime është vetëm pëlqimi Yt”*, duhet të jehojë në zemrat tona në çdo moment të jetës sonë.

Poeti Nexhip Fazëll Kisakurek, ndjenjën e «sinqeritetit» të miqve të Zotit, e përshkroi me këto vargje:

Adhurimet e përziera me ego, i përsërisin njëri pas tjetrit,

E nëse sytë u shkasin një çast tek një tjetër, ata dënohen me lot gjithë jetën.

Namazi, është një adhurim që na fal ndjenjën e ihsanit, pra vetëdijen e se në çdo moment jemi nën mbikëqyrjen e kamerave hyjnore. Një rob që e përjeton këtë miraxh zemre në praninë e Zotit të tij, fiton ndjeshmërinë për të shmangur me përpikëri çdo gjendje dhe sjellje të papëlqyeshme pas namazit. Me fjalë të tjera, namazi është një stërvitje e vullnetit që rrit rezistencën ndaj mëkateve.

Në një ajet urdhërohet:

“...Fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...” (Ankebut, 45.)

Prandaj, për të kuptuar nëse lutjet tona pranohen apo jo, mjafton të shohim se sa mund t’i shmangim mëkatet.

Namazi, është një lloj regjistri moral i robit. Kur morali nuk është i përsosur, as adhurimi nuk do të jetë i frytshëm. Për shembull, një person që nuk respekton të drejtat e njerëzve dhe i mashtron ata, as namazi i tij nuk është në rregull.

Një namaz i pranueshëm, i kryer në mënyrë korrekte, është ai që falet nga një person që qëndron larg së keqes dhe së shëmtuarës. Nëse një person që falet vazhdon të shkelë të drejtat e të tjerëve dhe të bëjë veprime që do ta zemërojnë Allahun, kjo do të thotë se ai nuk po falet në kuptimin e vërtetë. Ai person duhet të rishikojë abdesin e tij dhe namazin që ka falur, t'i kushtojë vëmendje se ku ka gabuar dhe të kërkojë të kompensojë gabimet e tij.

Nëse njeriu falet, por nuk shmanget nga kamata; agjëron por nuk shmanget nga përgojimi; jep zekatin e tij por nuk i kushton rëndësi të drejtave të robit, ai është mysliman në xhami, por në shtëpi dhe në punë sillet si njerëzit e dhënë pas kësaj bote... Të gjitha këto gjendje të paqëndrueshme janë shenja të nefsit levame. Islami është një tërësi; nuk duhet harruar në asnjë fazë apo çast të jetës.

Kur të jeni duke u falur, mbrojeni zemrën tuaj nga shpërqendrimi i kësaj bote. Falu duke qenë i vetëdijshëm se je në praninë e Allahut. Kështu, namazi e disiplinon robin dhe e mbron atë nga mëkatet.

Një person që qëndron në namaz vetëm në formë pa arritur të realizojë miraxhin e shpirtit, ai namaz e ka humbur thelbin duke u shndërruar në shprehi. Ata që nuk janë për të përqendruar dhe të thelluar në namaz janë në një neglizhencë të madhe. Allahu në lidhje me këtë thotë:

"Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet." (Maun, 4-5)

Namazi që Allahu kërkon prej nesh përshkruhet në këtë mënyrë në Kuran:

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përulur në namazin e tyre.” (Mu’minun, 1-2.)

Mevlana i nderuar ka thënë:

“Thirri mendjes dhe prej namazit mos përfito vetëm nga ana e jashtme, por edhe nga ana e brendshme! Mos e ul dhe ngri vetëm kokën si zogu që mbledh ushqim, duke qenë i pavetëdijshëm për Madhështinë e Allahut!.. Vëri veshin thënies së Profetit ﷺ: «Vjedhësi më i keq ndër njerëz, është ai që vjedh prej namazit».” (Hakim, el-Mustedrek, I, 353.)

Mevlana, atyre që janë të privuar nga frymëzimi shpirtëror, u drejtohet me këto fjalë:

“O ti njeri i pakujdesshëm! Ah sikur ta ktheje me sinqeritet fytyrën tënde nga Allahu, kur bie në sexhde, në mënyrë që të kuptosh siç duhet domethënien e thënies: «Zoti im, Më i Larti, është i pastër nga çdo mangësi.»” Pra, sikur të bëje sexhden e zemrës, jo vetëm formën e sexhdes!”

Allahu i Madhëruar, e fton robin e tij afër Vetes, duke urdhëruar: **«Bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!»** (Alak, 19.) Kështu, sa më shumë që zemrat tona të arrijnë në sexhde së bashku me ballin gjatë namazit, aq më shumë mund t’i afrohemi Zotit të Plotfuqishëm.

Allahu i Plotfuqishëm dëshiron që ne ta falim namazin me një ndjenjë të madhe edukate dhe madhërimi. Ashtu siç bëjmë kujdes për veten dhe sjelljet tona kur vizitojmë një njeri me pozitë të lartë, ashtu duhet të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe me edukatë gjatë namazit, që konsiderohet takim dhe dalje para Zotit të botëve.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

"O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni!..." (A'raf, 31.) Ndërsa në hadithet e Profetit ﷺ, rekomandohet përdorimi i misvakut dhe parfumit para çdo namazi dhe marrja e guslit para namazit të xhumasë. Të gjitha këto pastrime dhe përgatitje janë një tregues i ndjenjës sonë të madhërimit ndaj Allahut të Madhëruar.

Në fakt, të parët tanë i kushtonin një rëndësi kaq të madhe kësaj çështjeje, saqë para se të faleshin, drejtonin edhe thekat e qilimit të namazit.

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se; në namaz, po qëndrojmë në praninë e Zotit të botëve. Prandaj, duhet t'i ndërpresim lidhjet tona me gjithçka tjetër përveç Tij, të kuptojmë dobësinë tonë dhe të tregojmë përuljeje të madhe, respekt, frikë dhe strehim tek Ai. Duhet të përkulemi në ruku, të biem në sexhde dhe të përpiqemi të mbizotërojmë egon tonë me ndjenjat e përulësisë së një robi të dobët dhe nevojtar për Allahun e Madhëruar.

Për një zemër që është gjithmonë me Allahun, nuk ka dëm të jetë e zënë me punët e kësaj bote. Mirëpo, adhurimi me një zemër indiferente ndaj Zotit, për shkak të shqetësimeve të kësaj bote, ka shumë probleme!..

Një nga robërit e dashur të Allahut, Muhamed Parisa, rrugës për në Haxh, u kthye në qytetin e Bagdadit ku rastisi një argjendar në moshë të re, të cilit i ndriste fytyra. Kur e pa të riun që ishte duke tregtuar vazhdimisht me myshterinjtë e tij, mendoi se ai po shpenzonte shumë kohë në punët e kësaj bote. Për këtë arsye u mërzit dhe tha me vete:

"Sa keq! Atë e paska kapluar angazhimi me këtë botë, pikërisht në moshën kur mund të kryejë adhurime në mënyrën më të bukur!"

Mirëpo, kur e vëzhgoi me vëmendje, vuri re se zemra e të riut që shiste flori, ishte gjithmonë bashkë me Allahun, sepse ai e përkujtonte Atë vazhdimisht. Prandaj, duke e lavdëruar të riun tha:

"MashaAllah! Duart në këtë botë, por zemra me Allahun!..

Zoti ynë dëshiron një devotshmëri që është në harmoni me zemrën dhe trupin. Domethënë në namaz kibla e trupit duhet të jetë Qabeja, ndërsa kibla e zemrës duhet të jetë Zoti i Qabes.

Mexhnuni i cili endej nëpër shkretëtirë i dashuruar pas Lejlës, padashur kalon përpara një njeriu që po falte namaz. Kur e përfundoi namazin dhe dha selam, njeriu u ngrit dhe e qorton me ashpërsi:

"A nuk e di ti që nuk kalohet para dikujt që po fal namaz?!"

Ndërsa Mexhnuni ia priti me këto fjalë:

"Unë nuk të pashë fare ty, për shkak të dashurisë ndaj Lejlës! Po ti si më pe mua ndërkohë që ndodheshe në namaz para të dashurit tënd, Allahut?!"

Shah Nakshibendi thotë:

Një rob, qetësinë në namaz mund ta arrijë përmes katër gjërave:

1. Duke pasur kujdes të ushqehet vetëm me ushqim hallall dhe gjatë ushqimit të jetë në gjendje të zgjuar shpirtërore.

2. Gjatë abdestit të jetë i përqendruar në plotësimin e tij.

3. Kur të marrë tekbirin e parë ta konsiderojë veten para Allahut.

4. Jashtë namazit mos ta harrojë kurrë Allahun.

Edhe pse ne nuk mund ta shohim Allahun, le të falemi me vetëdijen se Ai na sheh gjatë gjithë kohës, me qëllim që namazi ynë të jetë një miraxh për ne.

Namazi, është miraxhi i besimtarit; është lidhja shpirtërore e robit me Allahun e Madhëruar. Por çfarë namazi?

– Një namaz në të cilën zemra i drejtohet Allahut në një gjendje të sinqeritetit, frikës dhe dorëzimit të plotë.

- Një namaz që është mundësia e fundit jetës për t'u lutur; mundësia e fundit e përgjërimit të një njeriu që po i jep lamtumirën botës.

Muadh bin Xhebeli ﷺ, e ka këshilluar kështu djalin e tij:

"Biri im! Kur të falësh namaz, mendo sikur të jetë namazi i fundit që fal dhe mos shpreso se do të arrish përsëri një kohë të tillë namazi!..

Në një hadith, Profeti ﷺ, ka thënë:

"Fale namazin, si namazi i atij që po ndahet nga kjo botë!.."
(Ibën Maxhe, Zuhd, 15.)

Me anë të këtyre këshillave, Profeti ﷺ, ka treguar anën edukative të meditimit të vdekjes. Riti i namazit është udhëtimi shpirtëror nga kjo botë për në botën tjetër. Pesë kohët ditore të namazit tregojnë nënshtrimin, dorëzimin, besnikërinë dhe devotshmëri-

në ndaj Allahut Teala. Namazi është një disiplinë shpirtërore që të bashkon me Allahun, duke qenë se në këtë botë njeriu ndodhet në një lloj kurbeti shpirtëror.

Namazi është një lloj miraxhi midis kësaj bote dhe botës tjetër. Besimtari, i cili kthehet në jetën e përditshme pasi e ka falur namazin në mënyrë të rregullt dhe i përqendruar thellësisht, vazhdon të jetojë sikur është kthyer përsëri në jetë, pasi ka vdekur njëherë. Besimtari që fal namazin e tij, siç e fal njeriu i cili po ndahet nga kjo botë, çdo gjë e sheh dhe e përjeton sikur po sheh nga dritarja e botës tjetër. A mund të jenë bashkudhëtarë me iblisin në jetën e kësaj bote ata që zotërojnë një shpirt të tillë? A mundet që pasionet e kësaj bote t'ua pushtojnë zemrën?..

Islami e ndalon individualizmin, egoizmin dhe mënyrën e jetës larg shoqërisë, duke u tërhequr në guaskën e vet. Përkundër kësaj, Islami urdhëron altruizmin, unitetin me bashkëbesimtarët, solidaritetin, bashkëpunimin dhe shoqërizimin. Padyshim, një nga mjetet më të bukura për arritjen e kësaj është falja e namazit me xhemat në xhami, që përfaqëson simbolin e unitetit të myslimanëve dhe teuhidin.

Është shumë e rëndësishme të falen me xhemat, jo vetëm namazet e teravive dhe xhumasë, por të gjithë namazet.

Ky transmetim në lidhje me Abdullah ibn Ummi Mektumin, është shumë domethënës. Ai ishte i verbër nga të dy sytë dhe një ditë erdhi tek Profeti ﷺ dhe i tha:

- O i Dërguari i Zotit! Shtëpia ime gjendet shumë larg xhamisë, nuk kam asnjë njeri që të më shoqërojë deri këtu. Në rrugë përballem me rreziqe. A do të më lejonit ta falja namazin në shtëpi?

- *"A e dëgjon thirrjen "hajde në namaz"*?- e pyeti Profeti ﷺ, pasi mendoi pak.

- E dëgjoj,- iu përgjigj ai.

- *"Atëherë vazhdo të vish në mesxhid!"* (Nesai, Imamet, 50.)

Kjo është një porosi që i jepet një të verbëri... Po ne, sa jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e kësaj!

I Dërguari i Allahut ﷺ, porosit:

"Po të shihni se dikush e ka bërë rregull të shkojë në xhami, dëshmoni për të se ka besim..." (Ibni Maxhe, Mesaxhid, 19)

Prandaj, të parët tanë kanë ndërtuar xhami të mëdha në qendra dhe xhami të vogla nëpër periferi, në mënyrë që askush të mos privohet nga falja e namazit me xhemat. Edhe ne duhet ta shndërrojmë në prioritet tonin këtë detyrë që e kërkon besimi.

Allahu thotë në Kuran:

"Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë." (Teube, 18.)

Në një farë kuptimi, mirëmbajtja e xhamive nuk nënkupton vetëm ndërtimin e tyre, por edhe mbajtjen gjallë të tyre me xhemat. Toka është xhami për gjithë besimtarët. E rëndësishme është mbushja e saj me besimtarë. Nëse xhamia nuk frekuentohet me besimtarë, ajo xhami është e destinuar të rrënohet.

Ne jemi nipërit e një "umeti luftarak" që lanë pas kupola në vendet e çliruara me madhështinë e besimit. Nëse sot i lëmë të shkreta ato xhami për shkak të mungesës së xhematit, si mund

t'u dalim para gjyshërve tanë në Ditën e Gjykimit? Si do të vejë puna jonë kur të ballafaqohemi me qortime për shkak të neglizhencës sonë ndaj këtij suneti të rëndësishëm të të Dërguarit të Allahut ﷺ, ndërsa lypim për ndërmjetësimin e tij në Ditën e Gjykimit?

Letrat e Omerit رضي الله عنه, drejtuar guvernatorëve të shtetit Islam:

"Për mua, puna më e rëndësishme që ju mund të bëni, është falja e namazit. Kush e ruan çdo kohë të namazit, e ka ruajtur fenë e tij; kush nuk e zbaton dhe e humb atë, do ta humbasë edhe fenë e tij në pak kohë." (Muvatta, Vukutu's-Salat, 6.)

Kur thirrej ezani, Profeti ynë ﷺ, ndërpriste gjithçka, sepse do të dilte para Allahut. Ai e falte namazin në fillim të kohës së vet dhe më pas vazhdonte punën e tij në atë frymë adhurimi. Prandaj, edhe ne; nëse arrijmë t'i organizojmë punët, planet dhe oraret tona të përditshme sipas namazit, duke ndjekur sunetin e Profetit tonë ﷺ, nëse ndërpresim çdo gjë sapo të hyjë koha e namazit dhe vrapojmë në praninë e Zotit tonë, -insha'Allah- do të gëzojmë pëlqimin e Tij. Veç kësaj, ky kujdes që do të tregojmë ndaj namazit, do të pasqyrohet në jetën tonë si një bekim dhe mëshirë më vete.

Namazi është detyra kryesore e besimtarit. Namazi që falet sapo të thirret ezani, ka një qetësi tjetër. Zoti ynë i lehtëson punët e atyre që i japin përparësi namazit. Mirëpo, nëse namazi vonohet pa arsye, i pakësohet edhe frymëzimi, asgjësohet edhe begatia e punëve që e bëjnë atë të vonojë.

Është e sigurt se; kur besimtari e ndal makinën sapo dëgjon ezanin dhe falet në kohën e parë me xhemat, rruga e tij do të jetë më e qartë dhe udhëtimi i tij më i qetë. Besimtarit i lehtësohet më tepër puna kur ai e ndërpret dhe vazhdon përsëri pas namazit. Po ashtu, edhe nxënësit i lehtësohet mësimi kur ai mbyll librin me të dëgjuar ezanin dhe vazhdon përsëri pasi e kryen mirë namazin; ai do të ndjejë se mendja e tij është më e pastër dhe zemra e tij më e ndritshme.

Të mos harrojmë se; namazi i largon njerëzit vetëm nga imoraliteti dhe gjynahet; gjërat që feja dhe arsyeja i shohin si të këqija dhe të shëmtuara. Pra, namazi nuk e pengon besimtarin nga punët e ligjshme dhe të mira. Përkundrazi, puna e besimtarit, i cili e ndërpret pak punën dhe e vazhdon atë pas faljes së namazit me përkushtim dhe frikë ndaj Allahut, do të jetë edhe më e dobishme dhe e frytshme.

Allahu i Plotfuqishëm paralajmëron me forcë ata që neglizhojnë namazet, xhamitë, xhematet dhe përpjekjet në rrugën e Allahut për hir të interesave të kësaj bote dhe justifikimeve egoiste si, «*Jam shumë i zënë, nuk mundësi*»:

«O ju që besuat, as pasuria juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit të Allahut! E kush bën ashtu, të tillët janë të humbur.» (Munafikun, 9.)

Allahu thotë në Kuran:

"Njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit)**, kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara."** (Nur, 37.)

Allahu i Madhëruar premton shpërblim të madh për namazin e falur me xhemat. Përveç kësaj, namazet me xhemat kanë më shumë gjasa të pranohen. Shpresohet që, për hir të robërve të devotshëm në xhemat, Allahu i Madhëruar t'ua pranojë namazet edhe robërve të tjerë.

Imam Maliku ka thënë:

"Ai që hyn në xhami dhe ka në zemër shenjë të hipokrizisë, i ngjan harabelit në kafaz. Sapo të hapet dera e kafazit, menjëherë fluturon dhe arratiset."

Bazuar në këtë të vërtetë, patjetër duhet të mendojmë për gjendjen e atyre që nuk e shoqërojnë xhematin.

Namazi, agjërimi, zekati, haxhi... Këto janë vepra të detyrueshme/farz. Megjithatë, ajo që tregon nivelin e pranimit të adhurimeve tona, është sjellja dhe morali ynë.

Për të qenë një rob i dashur nga Allahu i Plotfuqishëm, duhet të jesh i vetëdijshëm ndaj Allahut në çdo kohë dhe vend:

- Të adhurosh Allahun me frikë-respekt sikur je duke e parë Atë...

- Të luftosh në rrugën e Allahut, të kumtosh fenë dhe të shërbesh me edukatë dhe sinqeritet, sikur je duke e parë Atë...

– Të jesh përherë i ndershëm, falës, bujar, i durueshëm, i stolisur me moral të bukur, sikur je duke e parë Allahun...

- Të shpenzosh me sinqeritet sikur je duke e parë Allahun...

Allahu thotë në Kuran:

"O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kuj-

tuar ato (atyre që ua keni dhënë) **dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit."** (Bekare, 264.)

Namazet që nuk të pengojnë nga e keqja, do të thotë se nuk falen siç duhet. Gjithashtu, edhe agjërimi që nuk e thyen epshin dhe nuk shton dhembshurinë, nuk mbahet siç duhet.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"*Allahut nuk i duhet lënia e ushqimit dhe e pijes së atij që nuk heq dorë nga gënjeshtra dhe të vepruarit me të.*" (Buhari, Saum, 8.)

Ashtu siç ruhemi prej harameve shpirtërore, si përgojimi, gënjeshtra dhe mashtrimi, ashtu duhet të ruhemi edhe nga haramet materiale dhe gjërat e dyshimta, sepse statusi i një kafshate, ndikon shumë në gjendjen shpirtërore të njeriut.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"*Askush nga ju të mos thotë ndonjë fjalë të pahijshme apo të grindet me kënd ditën që të jetë agjërueshëm. Nëse dikush e fyen apo kërkon të zihet me të, atëherë le t'i thotë: «Sot jam agjërueshëm*!»" (Buhari, Saum, 9.)

Cilësia e adhurimit tonë është në të njëjtën kohë si grafiku shpirtëror i zemrës sonë. Ne duhet ta kontrollojmë veten shpesh në këtë drejtim. Për shembull;

– Deri në çfarë mase na çon namazi drejt frikë-respektit ndaj Allahut? Sa na pengon nga harami dhe veprat e papëlqyeshme? Sa arrijmë ta kuptojmë vlerën e namazit? Sa mirënjohës jemi për mirësinë e mundësisë që t'i bëjmë sexhde Allahut të Plotfuqishëm?

– Sa e rrit devotshmërinë agjërimi ynë? A e rrit mëshirën dhe dhembshurinë tonë? A i përmirëson ndjenjat tona të falënderimit ndaj Allahut të Plotfuqishëm? A na mbron nga thashethemet, fjalët boshe dhe punët e kota?

– A ndihemi të lumtur kur japim zekat, dhurime dhe sadaka? Apo qahemi duke menduar se "mu pakësua pasuria"? A e mendojmë faktin se Allahu i Madhëruar na e ka dhënë atë pasuri si sprovë dhe se; edhe pakësimi, edhe shtimi i saj është sprovë e Tij?

– A na mbron haxhi nga gjynahet, devijimi, grindja, e imoraliteti, duke na futur në atmosferën e dorëzimit të plotë ndaj Allahut? Sa arrijmë ta gurëzojmë shejtanin me vepra të mira, duke qenë të vetëdijshëm se shejtani na ndjek pas gjithë jetën? Sa arrijmë të strehohemi tek Allahu i Madhëruar nga e keqja e egove tona dhe shejtanit me anë veprave tona të mira?

Të gjitha këto, janë si një pasqyrë që tregon nivelin e afërsisë dhe dashurisë sonë ndaj Allahut të Madhëruar.

Mevlana thotë:

"Ata që shkojnë në haxh le të kërkojnë të zotin e Qabes. Nëse arrijnë ta gjejnë Zotin e Qabes (nëse zemrën e kthejnë në vend-strehim të manifestimeve hyjnore), tanimë Qaben mund ta gjejnë kudo."

Një ditë, Muhamed Ikbali, vizitoi haxhilerët që ishin kthyer nga Medina dhe u drejtoi një pyetje që ekspozonte horizontin e tij shpirtëror prej besimtari të vërtetë:

"E vizituat Medine Muneveren! Me çfarë dhuratash e mbushët shpirtin tuaj nga tregu shpirtëror i Medinës?

Dhuratat materiale që keni sjellë, takijet, tesbihët e sexhadet pas ca kohësh do të vjetërsohen, do të konsumohen dhe do të mar-

rin fund. A na keni sjellë nga dhuratat e Medinës që nuk vjetërsohen kurrë, e që i japin jetë shpirtrave?..

A ka mes dhuratave tuaja dorëzim dhe besnikëri si të Ebu Bekrit ﷺ, drejtësi si ajo Omerit ﷺ, ndjenjë turpi dhe bujari si të Osmanit ﷺ, klimë shpirtërore dhe zjarr të xhihadit si të Aliut ﷺ?

A do të mund t'i falni botës Islame, që sot përpëlitet në mijëra halle, emocionet e Epokës së Lumturisë?"

Të mos harrojmë se; *"gurëzimi i shejtanit"* nuk është një rit i veçantë vetëm për haxh. Është e nevojshme që ne ta gurëzojmë shejtanin në çdo fazë të jetës sonë. Të zbukurosh jetën tonë me adhurime dhe vepra të drejta, do të thotë të gurëzosh shejtanin që dëshiron të na pengoj nga ato. Nëse ne jemi indiferentë dhe e neglizhojmë këtë çështje - Zoti na ruajt - atëherë do të fillojë shejtani të na gurëzojë neve.

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Nuk ka mirësi në namazin që falet pa shpirt, në agjërimin që mbahet pa u larguar nga fjalët dhe veprat e kota, në leximin e Kuranit pa meditim, në diturinë që nuk depërton në zemër, në pasurinë që nuk nxit bujarinë, në vëllazërimin që nuk shfaqet në kohë të vështira, në nderin që nuk prodhon falënderim, në lutjen që nuk del nga shpirti e që nuk bëhet në mënyrë të sinqertë."

Njëherë, Ibrahim bin Et'hemin e pyetën:

- Pse nuk na pranohen duatë?

Ai u përgjigj:

"- Allahun e njihni, por urdhrat e Tij nuk i zbatoni!

- Profetin e njihni, por sunetin e tij nuk e veproni!

- Kuranin e lexoni, por me të nuk punoni!

- Hani nga të mirat që u ka falur Allahu, por nuk falënderoni!

- Xhenetin e dini, por nuk mundoheni ta fitoni!

- Xhehenemin e dini, por nuk shqetësoheni!

- Thoni se ka vdekje, por nuk përgatiteni!

- Baballarët dhe nënat tuaja i vendosni në varr me duart tuaja, por nuk merrni mësim!

Kur puna është kështu, si të pranohet duaja e dikujt që është kaq i shkujdesur!?" (Tedhkiretu'l-Evlija)

Ndihma e Allahut ndaj nesh do të jetë në raport të drejtë me adhurimet tona ndaj Allahut.

Allahu në Kuran thotë:

"O Besimtarë! Kërkoni ndihmë nga Allahu me durim dhe namaz..." (Bekare, 153.)

Namazi është një mburojë e fortë ndaj sulmeve të shejtanit dhe egos.

Ne në çdo namaz i lutemi Allahut: **"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë."** (Fatiha, 5.)

Në këtë ajet, tërhiqet vëmendja në devotshmërinë tonë ndaj Allahut, por të gjithë së bashku, pra si xhemat, jo individualisht. Me fjalë të tjera, deklarohet se; aq sa është bindja jonë si shoqëri ndaj urdhrave dhe ndalesave hyjnore, në atë masë do ta përfitojmë edhe ndihmën e Allahut.

Atëherë, kur shtohen problemet dhe fatkeqësitë e përgjithshme, është thelbësore të llogarisim kolektivisht veten tonë dhe

t'i drejtohemi korrigjimit të gabimeve dhe të metave tona. Me qëllim që të mos na ndodhin fatkeqësi dhe bela të mëdha, është e domosdoshme që të gjithë t'i drejtohemi pendimit dhe istigfarit dhe të tregojmë më shumë kujdes ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut. Është e domosdoshme që të lumturojmë të varfrit, jetimët, të vetmuarit dhe të vuajturit, duke bërë më shumë bamirësi dhe dhurime, sepse prej tyre varen suksesi, mirësia dhe mëshira e Allahut.

Çdo ngjarje e dukshme bazohet në disa shkaqe të padukshme/të brendshme që e shkaktojnë atë. Gjithashtu duhet t'i kushtojmë vëmendje edhe prapaskenave të sëmundjeve, fatkeqësive të ndryshme, konflikteve, trazirave dhe telasheve midis njerëzve në ditët tona, sepse, ndihma, mëshira dhe bekimet e Allahut vijnë kur shoqëria jeton një jetë adhurimi të bazuar në takua. Kur harrohet devotshmëria, është e sigurt që këto ndihma do të ndërpriten.

Sot, harrimi i Allahut dhe ahiretit, jeta e pamoralshme dhe përhapja e kamatës dhe ryshfetit, aq sa janë bërë pothuajse të natyrshme, janë ndër shkaqet e brendshme të shumë fatkeqësive.

Për sa kohë që adhurimi ndaj Allahut është i vazhdueshëm, edhe ndihma e Tij do vijë patjetër. Kjo është dëshmuar edhe në rritjen graduale të ndihmës hyjnore në Betejën e Bedrit. Si rezultat i sinqeritetit dhe durimit të besimtarëve; fillimisht ndihma e Zotit të Madhërishëm erdhi me njëmijë, pastaj me tremijë, pastaj me pesëmijë melekë.

Në Epokën e Lumturisë, kishte shumë sahabë të varfër, të vetmuar dhe të dobët, të cilët u persekutuan dhe u torturuan nga po-

liteistët mizorë. Por askush nuk ishte i stresuar apo i dëshpëruar, sepse, sahabët u strehuan te Zoti i tyre me sexhde kundra të gjitha llojeve të fatkeqësive. Ata u strehua tek Krijuesi duke thënë; «Unë nuk jam vetëm, kam një Zot të Plotfuqishëm!» Kështu, për çdo problem, ata e gjenin ngushëllimin tek Allahu i Madhëruar.

Një shoqëri që e mban namazin, pra e kryen atë siç duhet; do të jetë e shëndetshme si fizikisht ashtu edhe mendërisht. Njëherë, në Epokën e Lumturisë, në Medinë erdhi një mjek dhe nuk gjeti punë për të bërë. Për këtë arsye, Profeti e këshilloi atë të kthehej tek familja e tij. Po ashtu, kur shikojmë burimet historike, vihet re se në epokën e lumturisë nuk hasen çrregullime psikologjike apo revolta sociale. Kjo, sepse namazet që sahabët i kryenin me përkushtim të lartë, ishin pothuajse një mjet rehabilitimi shpirtëror për zemrat e tyre të lodhura. Ndërsa agjërimi, zekati dhe dhurimet zhvillojnë ndërgjegjet; falë vëllazërisë Islame, jetohej një jetë e qetë shoqërore.

Pa mirësinë, bujarinë, faljen dhe mëshirën e Zotit, në ahiret, asnjë rob nuk do të mund të arrijë shpëtimin falë adhurimit dhe veprave të tij të mira. Por, ata që do të gjejnë shpëtim atje, do të jenë ata që sinqerisht kanë bërë të gjitha përpjekjet e tyre për të shpresuar në mëshirën e Allahut të Plotfuqishëm sa ishin në këtë botë.

Sado të mira të kemi, gjithmonë duhet të strehohemi në mëshirën e Allahut, sepse, ashtu si lutjet tona, edhe veprat tona të mira kanë nevojë për pranim.

Njerëzit e devotshëm bënë një jetë me takua dhe treguan përpjekjet më të mira në rrugën e Allahut. Por, përsëri, ata e shihnin veten si robër të dobët që s'kanë mundur të bëjnë asgjë.

Pasi të përpiqemi t'i kryejmë detyrat tona të si robër të Allahut në mënyrën më të mirë që mundemi, ne duhet t'i shohim veprat tona të pamjaftueshme në krahasim me mirësitë e panumërta të Allahut të Madhëruar. Kështu, me vetëdijen dhe mirëkuptimin se jemi robër të pafuqishëm, duhet të strehohemi në mëshirën e Allahut të Madhëruar.

Ibrahimi ﷺ, edhe pse i kaloi sprovat më të rënda, me jetën, fëmijët, pasurinë dhe gjithë qenien e tij; edhe pse ishte "Halilullah", pra mik i Allahut, ai lutej kështu: **"**(O Zot!) **Mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit!.."** (Shuara, 87.) Kështu, ai na bën të kuptojmë se; nëse nuk e mëshiron Zoti, edhe veprat e tij vetëmohuese do të jenë asgjë.

Me rritjen e afërsisë së besimtarit me Zotin, në zemrën e tij hapen horizonte të tilla që, përballë madhështisë hyjnore, i shtohet edhe botëkuptimi i falënderimit, mirënjohjes dhe dhikrit. Po ashtu, ai i kupton më mirë mangësitë në njohjen dhe afërsinë ndaj Allahut dhe të metat në gjendjen e tij shpirtërore.

Për këtë arsye, të urtët që e njohin Allahun më së miri, janë ata që e kuptojnë se nuk mund ta njohin Atë siç duhet. Adhuruesit më të mirë të Allahut, janë ata që e kuptojnë se nuk janë në gjendje ta adhurojnë Atë siç duhet...

Ndërkohë që të diturit i shohin veprat e tyre të mëdha pothuajse si asgjë dhe tregohen modestë, njerëzit e shkujdesur i shohin

veprat e tyre të vogla të mjaftueshme për shpëtimin e tyre të përjetshëm dhe rehatohen. Kjo, sepse njerëzit e shkujdesur peshojnë gjithçka me peshoren e druvarit, kurse njerëzit e ditur me peshoren e argjendarit.

Ibrahim Desuki thotë:

"O vëlla! Bëj kujdes dhe mos pandeh se ke bërë diçka i vetëm. Dije se kur mban agjërim, Allahu ta ka mundësuar që ta mbash. Kur të falësh namaz, Allahu të ka bërë ta falësh.

Kur të bësh ndonjë punë, Allahu ta ka mundësuar që ta bësh. Nëse ke arritur nivelin e devotshmërisë, Allahu ta ka mundësuar që ta arrish. Nëse ke fituar ndonjë gjë shpirtërore apo materiale, Allahu ta ka mundësuar që ta fitosh."

Të mos harrojmë se, sado të shumta të jenë punët tona të mira, ato janë vetëm sa një kovë ujë e hedhur në oqean. Prandaj, adhurimet dhe punët tona duhet t'i shohim të pakta përpara mirësive që na ka falur Allahu i Madhëruar. Devotshmërinë tonë nuk duhet ta matim me nivelin më të ulët të shoqërisë, por me nivelin e sahabëve dhe të dashurve të Allahut, sepse Allahu i Madhëruar i ka bërë Ensarët dhe Muhaxhirët shembull për ne.

Besimtari duhet të jetojë mes frikës dhe shpresës (hauf dhe rexha). Ai duhet të bartë ndjenjën e një zemre që jeton mes frikës nga dënimi i Allahut dhe shpresës për arritjen e mëshirës së Tij. Nëse do të thoshin: "Vetëm një person ka për të hyrë xhehenem", besimtari duhet të mendojë me frikë; "a mos jam unë ai?" E nëse thonë: "Vetëm një person ka për të hyrë në xhenet", ai përsëri duhet të mendojë me shpresë, "a mos jam unë?".

Zemra e një besimtari duhet të jetë gjithmonë vigjilente nga frika se mos pëson zemërimin hyjnor dhe në një gjendje paqeje dhe ekuilibri me shpresën për të arritur mëshirën hyjnore.

Për njeriun është mister se me çfarë do të përballet në këtë botë sprovash. Pra, jeta është plotë surpriza, por nuk dihet se me çfarë surprizash është e mbushur...

Në këtë aspekt, asnjëherë nuk duhet të shikojmë gjendjen tonë aktuale dhe të themi "çfarë jam bërë unë"; të mos vetëkënaqemi, por përkundrazi, duhet të jemi vigjilentë me pyetjen se; "si do të jetë ahireti im".



MODESTIA

O Njeri!

– Mos e harro se ti je "asgjë" përballë Zotit tënd, i cili të krijoi si "njeri", krijesën më të nderuar, edhe pse nuk ke asnjë lloj kapitali!

– Mos harro se ti ekziston me urdhrin e Zotit, "bëhu" dhe se një ditë do të japësh shpirt me urdhrin e Tij, "vdis"!

– Merr mësim nga fakti se; kur urdhëron Allahu, edhe një mikrob i vogël, sa nuk mund të shihet me sy, e rrëzon përtokë edhe më të fortin që konsiderohet i pathyeshëm!..

Mevlana ka thënë:

"Shpata pret qafën e kryelartit. Ndërsa hijen nuk është e zonja ta presë asnjë shpatë, sepse është shtrirë për tokë dhe është bërë njësh me të."

Domethënë, nëse një besimtar arrin të heqë dorë nga vetë-pretendimi i tij se «është diçka» dhe e konsideron veten «asgjë», si një hije, ai do të jetë i sigurt nga shumë telashe dhe fatkeqësi të kësaj bote dhe të botës tjetër.

Të mos harrojmë se; në këtë botë kemi ardhur pa paguar asnjë çmim dhe me zero kapital. Allahu i Madhëruar e krijon njeriun nga një sasi lënde të papërfillshme dhe e dërgon në këtë botë të pafuqishëm, në mënyrë që njeriu të mendojë për origjinën dhe prejardhjen e tij dhe të njohë kufijtë e vet. Kjo, në mënyrë që ai ta kuptojë se është «asgjë» dhe i dobët përballë Zotit, të mos rebelohet kundër Atij, i Cili e krijoi atë nga asgjëja, dhe të jetë një rob i ditur dhe i urtë.

Përse njeriu nuk u krijua nga një pikë loti e çmuar, por nga një pikë uji thuajse e pisët? Përse jeta e tij është kalimtare? Përse pasi vdes, trupi i tij kthehet në dhe të kalbur? E si guxon një krijesë e tillë të mburret dhe të tregojë mendjemadhësi? Çfarëdo pozitash

dhe gradash të ketë një njeri, ai nuk duhet të harrojë se është veçse një "rob i mjerë".



Ebu Bekri ﷺ, ka thënë:

"Mos u lavdëroni! Çfarë dobie ka që të lavdërohet njeriu i cili është krijuar nga dheu dhe të cilin do ta hanë krimbat e insektet kur të kthehet në dhe!"



Aliu ﷺ thotë:

"Pse duhet të mburret i biri i Ademit? Ai fillon si nutfe/spermë dhe përfundon si xhife/cofëtinë! Ai as nuk mund ta krijojë furnizimin e tij dhe as ta shpëtojë veten nga shkatërrimi."



Në të kaluarën, në muret e teqeve vendoseshin tabela, ku me art kaligrafie shkruheshin thënie që përmbajnë këshilla dhe tërheqin vëmendjen. Në një nga këto tabela, shkruhet "hiç", e cila nënkupton faktin se për të përfituar prej mëshirës hyjnore, është kusht që më parë të çlirohesh nga dëshirat dhe epshet e nefsit. Pra, pa arritur gjendjen e "hiç"it duke u zhveshur prej egos, nuk mund të bëhet fjalë për përsosmëri shpirtërore. Kështu, edhe qëllimi i tasavufit, është vetëdija e robit për pafuqinë dhe gjendjen e hiçit përballë fuqisë, madhështisë dhe sovranitetit hyjnor.



Përballë Madhërisë Hyjnore, edhe njeriu edhe universi janë asgjë. Nëse i mbledh të gjitha të mirat e kësaj bote në këmbim të një mirësie të vogël të xhenetit; ato nuk do të vlenin asgjë. Po

ashtu, edhe të gjitha vështirësitë dhe sprovat që mund të kalohen në këtë botë, janë asgjë në krahasim me një moment mundimi në xhehenem.



Për njeriu, çdo gjë fillon pasi "hiç"i të ketë fituar mbi "egon". Edhe e fshehta e thënies "Kush e njeh veten, njeh edhe Zotin e tij", arrihet të kuptohet pas asaj pike. Pra, pas asaj pike i bëhet e mundur "marifetullahu / njohja e Zotit me zemër". Domethënë, ata që kuptojnë se janë krijuar nga hiçi dhe se kanë ardhur në këtë botë pa kapital, ata e kuptojnë thellë edhe ekzistencën, unitetin, fuqinë dhe madhështinë e Zotit të tyre. Një rob që arrin këtë realizim, nuk ka pse të jetë arrogant; as nuk duhet të pretendojë ekzistencë dhe ego... Prandaj, ata që nuk kanë ndjenjën e përulësisë dhe të hiçit, janë ata që nuk mund ta kuptojnë siç duhet Fuqinë dhe Madhështinë e Zotit.



Hapi i parë për t'u bërë një qenie njerëzore e përsosur, është të kuptosh se je «hiç». Të dish se Allahu i Plotfuqishëm është Fuqia e vetme që do të sjellë të mirën dhe do na mbrojë nga e keqja. Për këtë arsye, lufta më e rëndësishme e tasavufit, është eliminimi i ndjenjës së ekzistencës, egos, krenarisë dhe mendjemadhësisë në botë e brendshme.



Për të gjetur rrugën drejt Zotit të Plotfuqishëm, është e nevojshme të eliminohen dëshirat dhe entuziazmi i egos me anë të disiplinës shpirtërore, dhe në këtë mënyrë të eliminohet perdja e unit.

Kjo, sepse pasqyra e zemrës nuk mund të ndriçohet pa eliminuar krenarinë, mendjemadhësinë dhe arrogancën e egos. Ata

që i ruajnë zemrat e tyre nga intensiteti i dëshirave të tyre egoiste dhe shikojnë me dritën e Zotit, gjithmonë do ta gjejnë Zotin e Plotfuqishëm në zemrat e tyre. Kështu, njerëzit e ditur, lidhur me këtë të vërtetë shprehen; «*Nëse ti tërhiqesh, pas mbetet vetëm Krijuesi*».



Pikëpamjet, ndjenjat, mendimet dhe shprehjet e besimtarëve, të cilët e kapërcejnë perden e unit dhe durojnë me dorëzim të plotë ndaj Allahut të Madhëruar, gjithmonë bëhen të pajtueshme me vullnetin hyjnor. Bota e zemrave të tyre është si një pasqyrë e qartë, ku manifestohen shfaqjet e atributeve hyjnore të Zotit të Plotfuqishëm. Ata shikojnë gjithçka me një sy hyjnor.

Në një hadith kudsi, për këta besimtarë, të cilët arritën «të shkrihen në dashurinë për Allahun», thuhet:

«*...Robi Im nuk mund të më afrohet në ndonjë mënyrë më të mirë se sa me ato që Unë ia kam bërë farz (të detyrueshme). Robi Im vazhdon të më afrohet edhe me (vepra) nafile (vullnetare) dhe Unë e dua atë. Kur Unë e dua, bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin shikon, dora e tij me të cilën prek dhe këmba e tij me të cilën ecën. Nëse kërkon diçka prej Meje, ia jap, nëse strehohet tek Unë e mbroj.*" (Buhari, Rikak, 38.)



Krenaria, arroganca dhe mendjemadhësia është kanceri i jetës shpirtërore. Qëllimi i tasavufit, është t'i vërë vulën e anulimit mendjemadhësisë, duke e edukuar njeriun me faktin se të gjitha mirësitë vijnë nga Allahu.



Miqtë e Zotit thonë:

"Nëse tek njeriu mbetet qoftë edhe një shkronjë prej egos, ai nuk mund të jetë mik i Allahut."



Njëherë, dikush shkoi tek një i devotshëm dhe i kërkoi t'i lutej Allahut për t'ia falur gjynahet. Kështu, i devotshmi iu drejtua Allahut dhe u lut me këto fjalë:

"O Zot! Një robi Yt gjynahqar, kërkon lutje nga një rob tjetër gjynahqar. Fali që të dy!.."



Të gjithë mësuesit e mëdhenj kanë arritur pjekurinë shpirtërore që do t'i udhëheqë zemrat e tyre vetëm pasi kanë mposhtur sëmundjet e nefsit, si mburrja, krenaria dhe mendjemadhësia, me anë të shërbimit të tyre të sinqertë me përulësi dhe vetëmohim. Me fjalë të tjera, ata janë bërë kurora pasi kanë vënë egon e tyre nën këmbë.



Në sytë e njerëzve të thjeshtë, «pragu» nënçmohet dhe shihet si i pavlerë, sepse sipas tyre, pragu është pjesa e përparme e derës. Aty qëndrojnë vetëm shërbëtorët. Ata që mburren me veten, duan të ulen në krye, jo në derë. Mirëpo, pragu ka një vlerë të jashtëzakonshme në sytë e të urtëve.

Kështu, Junus Emre, i cili dëshironte të fitonte zemrën e mësuesit të tij, vendosi kokën në pragun e teqesë, sepse ai prag ishte në rangun e një shkolle të lartë, ku mësohet modestia ndaj "robërve të Allahut" për të fituar pëlqimin e Allahut.



Çështja më e rëndësishme në tasavuf, është thyerja e krenarisë dhe arrogancës së nefsit dhe eliminimi i mendjemadhësisë. Kështu, Aziz Mahmud Hudaji shiste mëlçi i veshur me xhyben e gjykatësit nëpër rrugët e Bursës, ku ai ishte gjyqtar; Junus Emre u edukua në pragun ku vuri kokën; dhe dijetarët e mëdhenj si Halid-i Bagdadi pastronin tualetet. Me metoda të ngjashme, u bënë shumë shërbime për të thyer idhujt e arrogancës së egos, sepse në tasavuf gjithçka fillon pasi kupton se je «asgjë»...

Ne duhet të mendojmë se; nuk kemi ardhur në këtë botë për të shfaqur bukuritë e trupit. Pra, nuk kemi ardhur për t'u llastuar e për t'u bërë arrogantë me mirësitë që zotërojmë. Por përkundrazi, kemi ardhur për të kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe për të shfaqur bukuritë shpirtërore, duke qenë të vetëdijshëm për dobësinë dhe mjerimin tonë para Krijuesit. Ja pra; në shkollën e kësaj bote, gjendemi për të arritur këtë pjekuri shpirtërore, sepse arsimimi më i rëndësishëm, është edukimi i zemrës me këto dije.

Kjo dua e Aziz Mahmud Hudajit te Zoti i Plotfuqishëm, shpreh ndjenjën e hiçit dhe pafuqisë në zemrën e tij:

«Ti je Ai që merr, je Ai që jep; Ti je që bën të mundur gjithçka; çdo gjë që kemi Ti na e ke dhënë; vet s'kemi asgjë?!.

Tasavuf, do të thotë të jetosh me vetëdijen se ne jemi "robër të dobët", pavarësisht se në çfarë rangu dhe pozicioni jemi. Prandaj, duke hequr nga zemra pretendimet për arritje dhe zotërim, për të gjitha mirësitë dhe sukseset, duhet të themi: *"Mirësia Jote, o Zot! Ti je i Plotfuqishmi, kurse unë jam një rob i pafuqishëm!..»*

Nëse njeriu ia atribuon vetes begatitë si pasuria, dituria, grada dhe pozita, ai bie në vorbullën e mendjemadhësisë. Për sa kohë që ai harron dobësinë e tij dhe vazhdon t'ia atribuojë meritat vetes së tij, ai nuk do të jetë në gjendje të heqë qafe dështimin. Kur ai të pushojë së thëni; "unë", dhe të thotë; "Mirësia Jote, o Zot!", dhe këtë ta ndjejë sinqerisht në zemrën e tij, atëherë ai do ta ketë eliminuar rrezikun e mendjemadhësisë.



Rumiu thotë:

"Kush zotëron një bukuri ta dijë se e ka borxh."



Atribuimi i gabimeve dhe të metave vetes, ndërsa suksesin Allahu, është pjesë e rëndësishme e edukatës së devotshmërisë. Të mos harrojmë se; atë që mburret duke thënë; "-ia dola, fitova, ia arrita me forcën time, diturinë dhe shkathtësinë time", Allahu i Madhëruar e urren derisa ai ta humbasë mirësinë që i është dhuruar.

Kur arrijmë ndonjë mirësi apo sukses, nuk duhet t'i atribuojmë vetes asnjë meritë për të, përkundrazi, duhet ta falënderojmë Zotin e Madhëruar duke pranuar hiçin, pafuqinë dhe dobësinë tonë.



Beteja e Bedrit, e cila rezultoi me fitoren e Islamit, është plot me mësime. Pas kësaj fitoreje madhështore, Allahu i Plotfuqishëm zbriti ajetin e mëposhtëm për t'i penguar myslimanët të ndihen krenarë dhe të mburren:

"(O i Dërguar!) (Atë ditë) **nuk i vratë ju ata, por i vrau Allahu. Edhe kur qëllove, nuk qëllove ti, por Allahu! Dhe këtë** (e

bëri) **për t'i vënë besimtarët para një prove të madhe! Pa dyshim, Allahu dëgjon dhe di!"** (Enfal, 17.)

Në të vërtetë, e vetmja fuqi dhe forcë është ajo e Allahut. Autori absolut është vetëm Allahu i Plotfuqishëm. Përdorimi i fuqisë dhe forcës që Allahu i Madhëruar i dhuroi njeriut varet edhe nga leja e Tij. Kjo është arsyeja pse në çdo punë duhet të themi:

لا حول و لا قوة الا بالله العلي العظيم

"Nuk ka asnjë fuqi e as forcë (që të shpie në të mirë dhe të mbrojë nga e keqja) përveç Allahut, të Fuqishmit dhe të Lartësuarit." Kështu, ne duhet të kërkojmë strehë tek Ai dhe nuk duhet të harrojmë kurrë dobësinë dhe robërinë tonë ndaj Tij. Ne duhet të dimë se të gjitha llojet e mirësive, fitoreve dhe sukseseve janë begati dhe sprovë nga Allahu dhe për këtë duhet të jemi mirënjohës.

Kur besimtari arrin një mirësi, gjithmonë duhet të thotë:

هٰذَا مِنْ فَضْلِ رَبِّى

"Kjo është prej bujarisë së Zotit tim"! Dhe, duke ia atribuuar atë mirësi pronarit të vërtetë, duhet të falënderojë i përulur. Po ashtu, nuk duhet të biem pre e nefsit tonë duke thënë: "E fitova me forcat e mia, apo e arrita me dijet dhe aftësitë e mia"!

T'ia atribuosh të gjitha bukuritë dhe mirësitë Allahu dhe të falënderosh për to, ndërkohë që të gjitha të metat dhe gabimet ia atribuon vetes dhe përpiqesh për t'i korrigjuar ato, është pjesë e rëndësishme e edukatës së devotshmërisë.

Një besimtar që fokusohet në të metat e veta, nuk ka pse të merret me të metat e të tjerëve, sepse kjo punë i mjafton dhe i tepron një zemre...



Shkaku i dritës në zemër, është aftësia e një besimtari për të llogaritur veten e tij dhe për të parë gabimet e veta para gabimeve të të tjerëve. Sa mirë tha poeti:

"Nuk ka urtësi më të madhe si njohja e të metave personale!"



Një besimtar duhet të shqetësohet për gabimet dhe të metat e veta, jo për ato të vëllezërve të tij. Ai duhet të dijë se; zemërimi me të tjerët dhe kritikimi i tyre nuk do ta shfajësojë atë, sepse fajësimi i të tjerëve duke mos parë gabimet personale, është si të shohësh qimen në syrin e të tjerëve, pa vënë re traun në syrin e vet.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Kush e diskrediton vëllain e fesë për shkak të ndonjë gjynahu, nuk vdes pa e bërë edhe vetë atë gjynah!" (Tirmidhi, Kiamet, 53/2505.)



Omeri رضي الله عنه, ka thënë:

"Atij që nuk merret me të metat e të tjerëve, i dhurohet aftësia për të përmirësuar të metat e nefsit të vet."



Sheh Sadi ka thënë:

"Të gjithë jemi mbartës të gjynaheve tona. Mos i poshtëroni të tjerët për shkak të gabimeve dhe mangësive."



Besimtari duhet qëndrojë si rojë në derën e zemrës së tij dhe të përpiqet të mos lejojë as një grimë krenarie, mendjemadhësie dhe mburrjeje të kalojë në atë derë. Me një përsiatje të thellë dhe vetëkontroll, ai duhet të ndiejë zemrën e tij në çdo moment dhe të merret me përmirësimin e gabimeve dhe të metave të tij.



Kushdo që e sheh veten kryelartë duke u rrëmbyer nga krenaria dhe mendjemadhësia, në të vërtetë, e poshtëron veten tek Allahu. Kush është i pavetëdijshëm për gabimet dhe të metat e tij dhe nuk e kupton se ai është "asgjë" përballë fuqisë dhe madhështisë së pafundme të Allahut, ai është zhytur në iluzionin e vetëvlerësimit me forcë dhe madhështi. Dhe kjo do të thotë të përpiqesh të jesh ortak në atributet e Zotit të Madhërishëm. Mirëpo, besimi i teuhidit nuk e toleron assesi shoqërimin e Zotit.



Mevlana ka thënë: *"Bëhu si tokë në modesti"* dhe e ka shpjeguar kështu:

"A gjelbëron një gur në stinën e pranverës? Bëhu modest si toka, që prej teje të dalin trëndafila dhe lule shumëngjyrëshe!.."

Gjallesat që shëtisin mbi tokë, e shkelin atë dhe hedhin aty të gjitha papastërtitë. Mirëpo, toka, me një modesti të jashtëzakonshme, i pastron të gjitha papastërtitë dhe pastaj, duke nxjerrë bimë me bukuri të ndryshme, i ushqen të gjitha gjallesat që

shëtisin mbi të. Ja pra, edhe shpirti i një besimtari të sinqertë, duhet të bëhet si një tokë e begatshme. Ata që fitojnë këtë gradë, i eliminojnë si toka të gjitha papastërtitë, dhe arrijnë përkryerjen. Kështu, ata bëhen njerëz të zemrës të mbushur me njëmijenjë virtyte si toka.

Toka është e sjellshme dhe e pjekur. Ajo gjithmonë të keqen e kthen me të mirë. Atij që i hedh pleh, i jep trëndafila. Atij që e pështyn, i jep burime me ujë. Ata që e shkelin me këmbë, i mban mbi kokë. Trupat e krijesave që vdesin, i ruan në gjirin e vet si amanet dhe i shkrin ato si një mister deri sa të ringjallen. Të gjitha ndyrësitë e krijesave i eliminon brenda vetes dhe duke i kthyer ato në energji, i gostit me fruta të ndryshme dhe të shijshme. E megjithatë, ajo është e kënaqur me detyrën që ka.

Njëherë, Isai عليه السلام, i pyeti ata që ishin me të:

- Ku mbin fara?

- Në tokë! - Thanë ata.

Atëherë Isai عليه السلام, tha:

"Po kështu, edhe urtësia mbin vetëm në një zemër që është (modeste) si toka."

Në një hadith, Profeti ynë ﷺ, është shprehur:

"...Allahu do ta lartësojë atë që tregon modesti për hir të Tij dhe do ta poshtërojë atë që tregohet mendjemadh..." (Hejthemi, X, 325.)

Shfaqjet e mëshirës hyjnore, derdhen si një shi i rrëmbyeshëm prej vendit të sexhdes për ata robër që vënë ballin në tokë përpara Zotit të tyre me një ndjenjë përulësie dhe hiçi. Allahu i Madhëruar i do robërit e tij të përulur, fytyrat e të cilëve janë në tokë, dhe u jep atyre mirësi të jashtëzakonshme; ashtu si uji i shiut që nuk grumbullohet në kodrat e larta, por në gropat poshtë.



Selman el-Farisiu ﷺ, thotë:

"Ji i përulur! Kush është i përulur në këtë botë për hir të Allahut, Allahu i Madhëruar do ta lartësojë dinjitetin e tij në Ditën e Gjykimit".



Shah Nakshibendi thotë:

"Është një përfitim i madh të mbështillesh me ndjenjën e «hiçit» në këtë rrugë; të braktisësh egon dhe të jesh i përulur. Këto janë elemente të rëndësishme për të arritur grada të larta."



Edhe pse ishte një nga njerëzit më të ditur të kohës së tij, Shah Nakshibendi u pajis me një modesti dhe me një vetëdije përulësie e hiçi. Shprehja e mëposhtme tregon më së miri gjendjen e tij të përkorë:

Bota grurë e unë kashtë,

Bota bukur e unë shëmtak!..



Fudajl bin Ijad thotë:

"Modesti, është ajo që; kur dëgjon të vërtetën, qoftë nga një i paditur apo nga një fëmijë, t'i nënshtrohesh dhe ta pranosh atë."



Modestia është një virtyt i jashtëzakonshëm që maturon robërinë ndaj Allahut dhe lidhet me shumë cilësi të mira. Kështu;

- Një besimtar i përulur është bujar. Për shkak se ai nuk është egoist, ai nuk ia atribuon vetes atë që zotëron, por e konsideron veten si një ruajtës i atyre mirësive. Prandaj, nuk është e vështirë për njeriun e përulur, të shpenzojë atë që vjen nga Zoti, po në rrugën e Zotit. Përkundrazi, kjo i jep atij një ëmbëlsi të papërshkrueshme.

- Një besimtar i përulur bëhet falës. Duke falur vazhdimisht të tjerët, ai përpiqet të jetë i denjë për faljen hyjnore.

- Besimtari i përulur, edhe të keqes i përgjigjet me të mirë.

- Besimtari i përulur është i durueshëm ndaj fatkeqësive që i ndodhin. Këto, ai i konsideron si mjet pastrimi dhe shpërblimi nga Allahu.

- Një besimtar i përulur bëhet njeri i shërbimit. Me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, ai e konsideron veten përgjegjës për shërbimin dhe si kujdestar ndaj vëllezërve të tij në nevojë.

- Një besimtar i përulur, është vetëmohues, i mirësjellshëm dhe me shpirt të butë...



Besimtari duhet të jetë njeri i ekuilibruar. Ai do të gjejë paqe vetëm nëse mund t'i përcaktojë mirë kufijtë e këtyre cilësive; të ruajë maturinë duke u shmangur nga mendjemadhësia, të ruajë sinqeritetin duke shmangur jo seriozitetin dhe të jetë modest pa e humbur dinjitetin. Por, nëse ai nuk mund të mbajë ekuilibrin delikat mes tyre, ai nuk do të mund t'i shpëtojë dështimit.




Shejh Sadi thotë:

"Ashpërsia e tepërt ngjall frikë. Butësia, e cila nuk tregohet në vendin dhe kohën e saj, eliminon dashurinë. Ashpërsia dhe butësia duhet të bashkëjetojnë. Për shembull, kirurgu shkakton edhe plagë, por vendos edhe ilaç...

Njeriu i mençur nuk është as i ashpër dhe as i butë, aq sa të humbasë respektin e njerëzve. Po ashtu, njeriu me mendje të shëndoshë as nuk krenohet dhe as nuk e përbuz veten, aq sa të poshtërohet nga të tjerët."





RUAJTJA NGA MBURRJA DHE MENDJEMADHËSIA

Nuk dihet se; kush dhe çfarë është në sytë e Zotit, sepse dritaret e zemrave janë të hapura për Allahun. Prandaj, duhet të mos përbuzni dhe të mos e lëndoni askënd. Ka shumë të përbuzur dhe të lënduar, të cilët janë nga robërit e drejtë të Allahut. Për këtë arsye kanë thënë: «Çdo natë konsideroje si Natë Kadri dhe çdokënd shiheni si Hidri.»

E gjithë e keqja fillon me mendjemadhësinë. Njeriu mendjemadh, bëhet budalla dhe torollak; ai gjithçka e sheh me fytyrë të vrenjtur dhe të vrazhdë.

Allahu thotë në Kuran**:**

"Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve." (Isra, 37.)

"Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!" (Lukman,18.)

"Mos u ngazëlle me pasurinë që ke, sepse Allahu nuk i do ata që ngazëllehen." (Kasas, 76.)

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Njeriut i mjafton si mëkat nënçmimi që i bën vëllait të tij mysliman..." (Muslim, Birr, 32.)

Një nga gjynahet më të mëdha, është përçmimi i robërve të Allahut. Njeriu duhet të pyesë veten: «*A je i sigurt për frymën tënde të fundit, që përçmon të tjerët!?*»

Shejh Sadi ka thënë:

"Mos u zemëro tepër dhe pavend, qoftë edhe me një skllav që është në urdhrat e tua dhe në shërbimin tënd! Ruaj kufijtë dhe mos

e tepro, sepse ditën e Mahsherit, nëse skllavi lirohet e ti që je zotëria i tij lidhesh me zinxhirë, do të jetë një poshtërimi i madh për ty!..”

Aliu ﷺ, ka thënë:

“Pozita e lartë, asnjëherë nuk duhet të bëhet shkak që dikush ta konsiderojë të madh shërbimin e tij të vogël. Por edhe pozita e vogël, asnjëherë nuk duhet të bëhet shkak që dikush ta konsiderojë të vogël shërbimin e tij të madh.”

I Dërguari i Allahut ﷺ, e eliminoi dallimin klasor në shoqëri. Bilal Habeshiu, që më parë ishte një skllav, u bë «Myezini i Profetit» i cili këndonte ezanin mbi Qabe. Përsëri, Profeti ynë emëroi Usamen, djalin e robit të tij të liruar Zejdit, si komandant ushtrie, pavarësisht nga mosha e tij (20), bazuar në aftësitë personale. Për rrjedhojë, i vetmi kriter i epërsisë në Islam, është «takvaja».

Ndonjëherë, një punëdhënës mund të qortojë punëtorin e tij. Por, pavarësisht se punëtori mund të ketë të drejtë, ai nuk mund të përgjigjet, sepse ai e di që, nëse përgjigjet, do ta gjejë veten te dera. Një besimtar duhet të mendojë gjithmonë se; të qenit i fortë ose të qenit në një pozitë më të lartë, nuk i jep të drejtën ta konsiderojë veten më të lartë se bashkëbesimtarët e tij që janë në një pozitë më të ulët. Në Kuran urdhërohet:

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...” (Huxhurat, 13.)

Një besimtar nuk mund të pretendojë kurrë të jetë më i lartë se asnjë nga vëllezërit e tij. Kjo, sepse i vetmi kriter epërsisë tek Allahu është "takvaja", dhe takua është sekret i Zotit të Madhërishëm në zemra. Për më tepër, përveç profetëve dhe atyre që janë përgëzuar me xhenet, për askënd tjetër nuk dihet se në ç'gjendje do të vdesë, pra nëse do të vdesë me besim apo jo.

Prandaj, një nga gjynahet më të mëdha, është "përçmimi i robërve të Allahut" me arrogancë dhe mendjemadhësi.

Vetëm Allahu e di se kush e ka ndjenjën më të lartë të takvasë në zemër, e për rrjedhim, kush është më i mirë. Prandaj Zoti ynë na paralajmëron në ajetin:

"O ju që keni besuar! Asnjë prej jush të mos tallet me të tjerë, se ata mund të jenë më të mirë se ju." (shih. Huxhurat, 11.)

Me fjalë të tjera, virtytet që ne mendojmë se i kemi në vetvete mund të gjenden tek shumë njerëz që i përçmojmë, ndoshta në nivel edhe më të lartë. Për këtë arsye, në realitet, përçmimi i robërve të Allahut është një sjellje që poshtëron vetveten.

Përgojuesi e sheh veten si më të mirë dhe e përçmon vëllanë e vet, të cilit i heton të metat. Përgojimi, është pasqyrim në gjuhë i arrogancës dhe i vetëpëlqimit. Në një ajet, Allahu i Madhëruar, ata që tallen me të tjerët me shenja dhe fjalë të shëmtuara, para ose pas shpinës së tyre, i paralajmëron kështu:

"Mjerë për çdo përqeshës – shpifës." (Humeze, 1.)

Nuk ka fatkeqësi tjetër që e shkatërron njeriun shpirtërisht dhe e bën të pësojë zemërimin hyjnor, sa përçmimi me mendjemadhësi ndaj robërve të Allahut.

Ai që tregohet krenar dhe arrogant duke pretenduar ortakëri me Zotin e Madhërishëm në titullin «Madhështor», do të pësojë pashmangshmërisht dënimin hyjnor.

Ata që guxuan të sfidojnë Allahun Teala në cilësinë e Madhështisë, zullumqarët që thanë "unë" përpara Hakut, popujt e fuqishëm si Adi dhe Themudi, të cilët u mburrën duke thënë: "Kush është më i fuqishëm se ne?" dhe ata që me mburrje e mendjemadhësi u mbështetën në mjetet të cilat i ndërtuan me aftësitë mendore që u kishte falur Allahu, gjithmonë u bënë shembujt më të këqij të hakmarrjes hyjnore, duke u shkatërruar nën kamxhikët e dënimit.

Mevlana thotë:

"Njerëzit e mençur, të cilët dëgjojnë për dënimin e Zotit që pësuan populli i Faraonit dhe i Ad-it, heqin dorë nga pretendimi për ego dhe e braktisin ambicien dhe krenarinë e tyre. Por, nëse nuk heqin dorë nga krenaria dhe lakmia e tyre, atëherë edhe këta do të pësojnë dënimin dhe të tjerët do të marrin një mësim nga fatkeqësia e tyre."

Historia është e mbushur plot me shembuj të atyre që kanë përfunduar në dështim, pasi janë mbështetur vetëm tek fuqitë e veta.

Në vitin 1912, kur anija gjigande Titanik doli në udhëtimin e saj të parë, me krenari dhe mburrje u tha: "Këtë anije nuk mund ta fundosë asnjë forcë". Por që në udhëtimin e parë, anija u përplas me një ajsberg dhe humbi në thellësitë e oqeanit së bashku me ata që kishte brenda.

Në vitin 1986 anija kozmike "Challenger", që do të thotë "Sfiduesja", shpërtheu 73 sekonda pas lëshimit dhe i gjithë ekuipazhi i saj vdiq.

Në 18 Mars të vitit 1915, luftanija e madhe franceze "Inflexible" që do të thotë "e papërthyeshme, e papërkulshme", u dëmtua rëndë dhe mbeti jashtë luftimi në luftën legjendare të Çanakalesë. Në të njëjtën ditë, edhe luftanija "Irresistible" që do të thotë "e papërballueshme", u përplas dhe u mbyt.

Edhe luftanija e madhe e flotës së Shteteve Aleate, e quajtur "Goliat", emër i frymëzuar nga Xhaluti, i cili u vra nga profeti Daud عليه السلام, u fundos në ujërat e Ngushticës së Dardaneleve, më 13 Maj të 1915 nga fregata Muavenet-i Millije, e cila dukej shumë më e vogël dhe më e pafuqishme në krahasim me të.

Ebrehe doli nga Jemeni me mendjemadhësi dhe mburrje. Qëllimi i tij ishte të shkatërronte Qabenë e Shenjtë. Përballë ushtrisë së tij, të cilën e kishte fortifikuar me elefantë që zinin vendet e tankeve në atë kohë, nuk kishte ndonjë ushtri tjetër që të bënte rezistencë. Ndërkohë që po përparonte me mendjemadhësi drejt qëllimit të tij, Allahu i Lartësuar e shndërroi atë dhe ushtrinë e tij si gjethe të mbjellash të përtypura e të copëtuara. Ata nuk i shkatërroi me luanë, tigra, gjarpërinj dhe akrepa, por me gurë që i hodhën disa zogj shumë të vegjël. Mirëpo, vetë Ebrehenë nuk e shkatërroi në Mekë dhe pranë Qabesë. Ai u kthye i plagosur dhe i nënçmuar në vendin e tij nga e cili kishte ardhur dhe pastaj vdiq pasi u poshtërua para njerëzve të tij.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Nuk mund të hyjë në xhenet ai që ka në zemër mendjemadhësi (qoftë edhe) sa një grimcë." (Muslim, Iman, 147.)

Lartësitë shpirtërore nuk mund të arrihen me një zemër të paedukuar dhe të plogësht. Po ashtu, nuk mund të shkelet në klimën e paqes dhe të lumturisë së Xhenetit me zymtësinë e zakoneve të këqija si krenaria, mendjemadhësia dhe arroganca, të cilat i kanë rrënjët në xhehenem.

As'ad Erbili thotë:

"I pari nga gjynahet që shkaktojnë privimin e robërve nga mirësitë e Allahut, është t'i japësh rëndësi egos, pra mendjemadhësia."

Sado njohuri të kemi, nuk duhet të harrojmë se; dija nuk ka fund. Të thuash "Unë di gjithçka!" është një dobësi e madhe. Pavarësisht se kush është, çdo person është mësues i asaj që di dhe nxënës i asaj që nuk di.

Ebu'l-Hasan Harakani thotë:

"Të gjithë mburren me atë që dinë, derisa të kuptojnë se nuk dinë asgjë. Kur më në fund e kupton se nuk di asgjë, i vjen turp për diturinë e tij, dhe pikërisht atëherë, dija (domethënë dituria e vërtetë, urtësia dhe afërsia me Zotin) arrin në përsosmërinë e saj, sepse dija e vërtetë është të dish që nuk di."

Është e lehtë të sjellësh në rrugë të drejtë ata që janë të vetëdijshëm për injorancën e tyre. Gjëja e vështirë, është të sjellësh në rrugë të drejtë pedantët krenarë dhe budallenjtë kokëfortë që mendojnë se janë dijetarë.

Ahmed ibn Hanbeli ka thënë:

"Kategoria më idiote e njerëzve, janë ata që u pëlqen të lavdërohen nga të tjerët."

Imam Shafiu ka thënë:

"Njeriu më arrogant, është ai që kur merr pozitë, shpërfill të afërmit, nuk njeh miqtë dhe tregon mendjemadhësi ndaj njerëzve të mirë."

I nderuari Ebu Ali Ruzbari thotë:

"...Dikush që e sheh nefsin e vet, qoftë edhe njëherë të vetme duke i dhënë më shumë vlerë se ç'e meriton, (pra ai që është peng i mendjemadhësisë dhe mburrjes), nuk mund të shohë asgjë që ndodhet në gjithësi, me syrin e urtësisë për të marrë mësim."

Ahmed ibn Hanbeli thotë:

"Nuk mund të gjeni mendje, në një kokë që mbart mendjemadhësi!"

Të rebelohesh kundër Allahut, i Cili i ka dhuruar mendjen njeriut, në vend që të jesh rob i Tij, do të thotë të jesh prej umetit të Iblisit/Shejtanit. Iblisi e përçmoi Ademin dhe u bë arrogant. Ai u rebelua edhe kundër Allahut të Madhëruar për hir të mendjemadhësisë së tij. Diskutimi i parë apo kundërshtimi i parë i Allahut, bazuar në mendjen, ndodhi kur shejtani u mposht nga mendjemadhësia e vet. Kur mendja e shejtanit u mbulua me mendjemadhësi, ai u shty në marrëzi dhe nuk i dëgjoi urdhrat e Allahut.

Zgjuarsi, nuk do të thotë të tregohesh mosmirënjohës ndaj Allahut, i Cili ka dhuruar mendjen, përkundrazi, do të thotë bindje dhe mirënjohje ndaj Tij. Pra, të përdorësh mendjen nën udhëzimin e shpalljes.

Shejtani, që nuk mundi ta kuptojë këtë, e kundërshtoi Allahun e Madhëruar me mendjen që i fali Ai. E për shkak të arrogancës së tij, ai nuk mundi as të pendohej. Kështu, ai u shkatërrua plotësisht në aspektin shpirtëror. Ky pra është fundi katastrofik i atyre që janë idhujtarë të mendjes së mangët kundër të vërtetave hyjnore!..

Duke ngrënë frutin e ndaluar, Ademi shkeli urdhrin hyjnor, por u pendua menjëherë. Shejtani, nga ana tjetër, nuk mundi të pendohej dhe të kërkonte falje, por u bë rebel edhe pse e dinte gabimin e tij.

Kjo do të thotë se; kur dikush bën një gabim, pranimi i menjëhershëm i tij dhe shfaqja e pendimit, mos këmbëngulja në gabim dhe kërkimi i menjëhershëm i faljes, janë thelbësore për shpëtimin nga ndëshkimi hyjnor.

Rumiu ka thënë:

"Dëbimi i Iblisit nga dera hyjnore, u bë për shkak të guximit për të folur pa edukatë përballë Allahut të Madhëruar. Nëse dëshiron t'i shtypësh kokën shejtanit, hapi sytë dhe shih! Ajo që e shkatërron shejtanin është edukata."

"Kush nuk ka edukatë, nuk është njeri, sepse dallimi midis njeriut dhe kafshës, është edukata!"

Edukimi shpirtëror fillon së pari me pastrimin e egos. Veset që shqiten më me vështirësi nga karakteri i njeriut janë mendjemadhësia dhe egoja. Njeriu bëhet rob i egos së tij dhe fillon t'i japë të drejtë vetes në çdo gjë, si Iblisi. Egoisti numëron pareshtur mangësitë e tjetrit dhe të mirat e veta. Prandaj, ai ndjen kënaqësi nga thashethemet dhe përgojimi. Egoisti, njëjtë si Iblisi, shfaq mendjemadhësi dhe nuk pranon asnjë këshillë nga të tjerët. Atij nuk i shkon kurrë nëpër mend se mund të jetë i gabueshëm.

Prandaj, një nga detyrat kryesore të misticizmit, është pastrimi i zemrës nga egoizmi.

Një nga sufitë e parë, Ebu Hashim es-Sufi ka thënë:

"Të gërmosh në mendjemadhësinë që ka mbirë te një zemër, është njësoj si të gërmosh në një mal duke përdorur gjilpërën."

Babai im i ndjerë, Musa Efendiu, horizontin e zemrës që do të sillte çlirimi nga krenaria, mendjemadhësia dhe arroganca, e shpreh si vijon:

"E gjithë puna qëndron tek braktisja e mendjemadhësisë nga ana e njeriut. Nëse një person triumfon mbi egon, atëherë ai përshkon distanca të mëdha në rrugën drejt përsosmërisë. Megjithatë, sa e lehtë është në dukje, po aq e vështirë është edhe të mposhtën egon. Kur triumfon mbi egon, gjithçka fillon të falë paqe; të gjithë bëhen miq! Një person i tillë, gjithmonë fillon të ketë dashuri dhe mendim të mirë në zemër ndaj të gjithëve, veçanërisht ndaj myslimanëve."



FALJA, TOLERANCA DHE PËRMBAJTJA

Allahu thotë në Kuran:

"...A nuk dëshironi t'ju falë Allahu?.." *(Nur, 22)*

Përderisa kemi nevojë për faljen e Allahut, duhet të bëjmë përpjekje që ta fitojmë faljen hyjnore duke falur krijesat e Tij.

Imam Shabiu, kur e ofendonin, në vend që të zemërohej thoshte:

"Nëse ato që thua janë të vërteta! Allahu më falte mu, nëse nuk janë të vërteta! Allahu të faltë ty!"

Resulullahu ﷺ, zemërohej vetëm atëherë kur cenohej ndonjë e drejtë dhe këmbëngulej në të. Por, pasi vinte në vend drejtësinë, qetësohej. Ai nuk zemërohej asnjëherë dhe nuk debatonte me askënd për veten e tij.

Si ummet i të Dërguarit të Allahut ﷺ, edhe ne duhet t'i ngjajmë atij si në sjellje ashtu edhe në ndjenja:

– Në vend që të kujtojmë të falim gabimet, të pajtohemi, të shoqërohemi, të jemi vëllezër, vetën nga Ramazani në Ramazan apo nga bajrami në bajram, ne duhet të jemi gjithmonë "njerëz të mëshirës" dhe me zemër të gjerë.

– Padrejtësitë që na bëhen nuk duhet t'i bëjmë çështje krenaria dhe egoje. Përkundrazi, dobësitë si hatërmbetja, mëria dhe zemërimi, duhet t'i kapërcejmë për hir të Allahut.

– Urrejtjen dhe ndjenjën e hakmarrjes gjatë zemërimit, duhet ta konsiderojmë si ashpërsi të zemrës dhe cektësi të të kuptuarit.

– Ne duhet të jemi në gjendje t'i falim gabimet dhe padrejtësitë që na janë bërë, duke e konsideruar këtë si pastrim shpirtëror dhe falje gjynahesh.

Mevlana thotë:

«Nëse vëllai yt të ka munduar njëherë, kujto se të ka bërë mirë njëmijë herë!.. Mirësia është si një ndërmjetës kundër gjynahut.»

Shejh Sadi thotë:

"Nëse të bëhet një e keqe, duro! Sepse duke falur je pastruar nga gjynahu!"



Mevlana pyet:

"Ti zemërohesh dhe acarohesh për çdo vështirësi dhe ndaj çdo të paedukati mbani mëri. Por, si do të bëhesh një pasqyrë pa u fërkuar për t'u pastruar?"



Pronari i vërtetë i faljes dhe mëshirës është Allahu ﷻ. Prandaj, edhe besimtarët duhet të jenë falës dhe të mëshirshëm në raport me dashurinë ndaj Allahut në zemrat e tyre.

Si munden zemrat e shkujdesura të kërkojnë falje nesër para Allahut, kur ata as që përpiqen t'i falin robërit e Tij sot?



Nëse dëshirojmë të pajisemi me këtë moral të Zotit tonë, i Cili është Teuuab, që e pranon shumë pendimin, edhe ne duhet të pranojmë kërkesën për falje të atyre që na kërkojnë falje.



Mëshira dhe bujaria ndaj krijesave të Zotit është treguesi më i qartë i dashurisë ndaj Allahut dhe mënyra më e mirë për të falënderuar Allahun për mirësitë e dhuruara. Ne jemi të detyruar të jemi bujarë dhe bamirës ndaj krijesave nevojtare të Allahut sepse ata janë një mjet sprove për ne në këtë botë.



"Ai që nuk mëshiron nuk do të mëshirohet, atij që nuk mbulon të metat e të tjerëve nuk do t'i mbulohen te metat, ai që nuk fal nuk do të falet, ai që nuk përpiqet të ruhet nga mëkatet nuk do të ruhet e nuk mund të arrijë në gradën e devotshmërisë." (Buhari, el-Edebul-Mufred, fq. 415, no: 371.)



Allahu thotë në Kuran:

"... A nuk dëshironi t'ju falë Allahu?.." (Nur, 22.)

Përderisa kemi nevojë për faljen e Allahut duhet të bëjmë përpjekje që ta fitojmë faljen hyjnore duke falur krijesat e Tij.



Besimtarët e përsosur, të cilët kanë arritur horizonte të larta në besim dhe moral, gabimeve që bëhen kundrejt tyre, preferojnë t'u kundërpërgjigjen me falje dhe mëshirë, në vend që të kërkojnë drejtësi me hakmarrje. Kjo, sepse ata shpresojnë se në peshoren hyjnore, edhe Allahu i Madhëruar do t'i trajtojë me falje, mëshirë, butësi dhe mirësi, e jo me drejtësi (për t'i dënuar për shkak të gjynaheve).

Në fund të fundit, a nuk është e gjithë kjo për të merituar mëshirën e Allahut në ahiret? Kjo është arsyeja pse besimtarët e drejtë nuk i përgjigjen në të njëjtën mënyrë padrejtësive dhe të këqijave që u bëhen atyre personalisht. Ata durojnë për Allahun dhe e gëlltisin zemërimin e tyre. Ata gjithmonë ndjekin rrugën e faljes dhe tolerancës.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Ai që është i butë nga natyra, i ka falur Zoti shumë mirësi. Ai

që nuk është i butë nga natyra, është privuar nga shumë mirësi."
(Tirmidhi, Birr, 67/2013.)

Besimtari i vërtetë, kur i bëhet një padrejtësi apo e keqe, toleron për hir të Allahut. Pavarësisht se me çfarë fatkeqësie sprovohet, në vend që të rebelohet, ata tregojnë durim dhe pëlqim në çdo rast duke thënë;

"*- Kjo është një sprovë për mua nga Zoti im; jam i kënaqur me vullnetin e Tij, mjafton që Ai të jetë i kënaqur me mua.*"

Kështu, njeriu jo vetëm që shpëton nga humbjet shpirtërore, por do të marrë edhe shpërblim për drejtimin tek Allahu i Madhëruar. Me fjalë të tjera, ai fiton edhe nga e mira, edhe nga e keqja që i ndodh...

Aliu ﷺ, ka thënë:

"*Ai që nuk zotëron sunetin e Allahut, të të Dërguarit të Tij dhe njerëzve të devotshëm, nuk zotëron asgjë. Suneti i Allahut është të mbash të fshehur sekretin; suneti i Resulullahut është të udhëhequrit e njerëzve me drejtësi; ndërsa suneti i të devotshmëve është të tregohesh i durueshëm ndaj mundimeve që të shkaktojnë njerëzit.*"

I Dërguari i Allahut ﷺ, dëshironte që çdo individ i umetit të tij, të ishte bashkë me të në xhenet. Për këtë arsye, të gjithë i këshillonte sipas shkallës së tyre. Ndërsa Enes bin Malikut, ﷺ, i tha:

"*Bir! Nëse mund ta arrish mëngjesin dhe darkën pa mbar-*

tur ndonjë dredhi në zemrën tënde për asnjë njeri (të mos ndjesh ftohtësinë edhe më të vogël dhe të falësh çdo besimtar), ashtu vepro!"

"Bir! Kjo është prej sunetit Tim. Kush e praktikon sunetin Tim, padyshim që më do Mua. Kush më do Mua, do të jetë bashkë me mua në xhenet." (Tirmidhi, Ilm, 16/2678.)



Imam Shafiu ka thënë:

"Njeriu më shqetësuar në botë është presoni që ka në zemër urrejtje dhe smirë."



Aliu ﷺ, ka thënë:

"Mendo mirë për robërit e Allahut. Nëse vepron kështu, shpëton nga shumë lodhje."



Shejh Sadi thotë:

"Kur një njeri i ditur dhe i urtë ofendohet nga njerëz të paedukatë, ai nuk duhet të fyhet apo t'i mërzitet. Një gur i keq mund të thyejë një enë të artë; por as vlera e gurit nuk rritet dhe as vlera e arit nuk ulet."



Mevlana i nderuar thotë:

"Dije se; edukatë, do të thotë të durosh dhe të tolerosh paturpësinë e të paturpit."



Imam Shabiu kur e ofendonin në vend që të zemërohej thoshte:

"Nëse ato që thua janë të vërteta! Allahu më faltë mu, nëse nuk janë të vërteta! Allahu të faltë ty."

Zemrat që piqen shpirtërisht nëpërmjet manifestimeve të sprovës hyjnore, fitojnë një forcë të jashtëzakonshme. Tashmë, ato nuk thyejnë më dhe nuk thyhen; pra nuk lëndojnë dhe nuk lëndohen. Në fakt, mësimi i parë i edukimit në Tasavuf, është të mos lëndosh, dhe mësimi i fundit, është të mos lëndohesh.

Të mos lëndosh është në dorë të njeriu. Por, të mos lëndohesh është e vështirë, sepse në zemër nuk ka vullnet. Prandaj, aftësia për të heshtur ankesën e zemrës ndaj padrejtësive që vuan, është një aftësi që e zotërojnë vetëm shpirtrat e lartë.

Shejh Sadi thotë:

"Nuk turbullohet deti me një gur. Njeriu që lëndohet, është ende si uji i cekët."

Dhembshuria dhe falja janë aftësi e zemrave të plotësuara shpirtërisht. Të falësh vuajtjet dhe padrejtësitë që të kanë shkaktuar njerëzit, për hir të Allahut, është horizonti i lartë i një zemre që e zotërojnë vetëm besimtarët e përsosur.

Allahu në Kuran thotë:

"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni." (Huxhurat, 10.)

"Të pyesin ty (o Muhamed) **për plaçkën e luftës. Thuaj: "Plaçka e luftës i përket Allahut dhe të Dërguarit". Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë!"** (Enfal, 1.)



Në Kuran, në mënyrë të qartë, urdhërohet pajtimi i besimtarëve të zemëruar me njëri-tjetrin. Pra, vëllazëria fetare kërkon mbylljen e debateve "unë kam të drejtë, ti s'ke të drejtë", të harrohen armiqësitë e shkuara dhe, nëse është nevoja, të sakrifikosh duke treguar virtytin e faljes së vëllait besimtar. Të qëndrosh i zemëruar, është mosbindje ndaj urdhrit të Allahut. Një besimtar i pjekur, sido që të jetë, kurrë nuk tregohet i pabindur në mënyrë të vetëdijshme ndaj urdhrit të Allahut.



Pavarësisht mizorisë që i bënë vëllezërit e tij, Jusufi ndaj tyre u soll gjithmonë me mirësi, dashamirësi dhe edukatë. Në fund ata e pranuan të vërtetën dhe thanë: **"Betohemi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne dhe ne paskemi qenë vërtet të gabuar"**. (Jusuf, 91.)

Por Jusufi عليه السلام, duke shfaqur edhe një virtyt tjetër, u tha: **"Sot s'ka qortim për ju; Allahu do t'ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!"** (Jusuf, 92.) Me fjalë të tjera, ai dëshironte që Zoti i Madhëruar t'i falë ata, ashtu siç i fali ai vëllezërit e tij.



Në kohët tona, kur ekuilibri mes materiales dhe shpirtërores është prishur, dashuria e besimit ka humbur dhe shpirtrat janë plogështuar. Myslimanët janë prishur e janë ftohur me njëri-tjetrin për interesa të ngushta të kësaj bote. Vëllazëria Islame është dobësuar nga injoranca, egoizmi dhe shterpësia emocionale.

Ndërsa Profeti ﷺ, urdhëron që të kultivohet në mënyrë të sinqertë atmosfera dashurore ndërmjet besimtarëve, duke i dhënë përparësi njëri-tjetrit, e jo nefsit apo egos personale.

Duhet theksuar mirë fakti se; dashuria nuk është një kauzë e kotë. Nuk mund të mendohet për ekzistencën e dashurisë pa u shkrirë me hallet e të tjerëve, pa sakrifikuar për të tjerët, e pa ua falur të metat atyre.



Një ditë Profeti ﷺ, i tha shokëve:

"A t'ju tregoj për një vepër që është më e vyer se agjërimi, namazi dhe zekati?"

Po, thanë shokët.

"Të pajtosh njerëzit. Kurse ngatërresa e njerëzve është rrënim i fesë." (Ebu Daud, Edeb, 50/4919.)



Xhaferri ﷺ, thotë:

"Ai që nxjerr shpatën e rebelimit, pret veten me atë shpatë. Kush i hap gropën vëllait, do të bjerë vetë në të."



Është e domosdoshme të ruhemi nga sjelljet për të cilat do të pendohemi në varr dhe në ahiret, si thyerja e zemrave dhe grind-

jet për hir të interesave kalimtare. Po ashtu, duhet të përpiqemi të ruajmë paqen dhe qetësinë e vëllazërisë Islame në planin shoqëror duke ndërtuar ura të pathyeshme dashurie mes zemrave. Sepse ky unitet dhe bashkim, nxit në vepra të mira dhe shuan shumë të këqija.

Mevlana thotë:

"Ji miqësor me njerëzit, sepse sa më i mbushur me njerëz dhe xhemat të jetë karvani, aq më lehtë do të thyhen kusarët."

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Njeriu më i dobët është ai që nuk mund të bëjë miq. Ndërsa më i dobët se ky është ai që i humb miqtë që ka fituar."

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Ju urdhëroj të bashkoheni dhe ju ndaloj nga ndarja, sepse shejtani është pranë të vetmuarit dhe larg dy njerëzve. Kush dëshiron të jetë në mes të Xhenetit, të mos ndahet nga shoqëria Islame!"

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Veprat e njerëzve i paraqiten Allahut ditën e hënë dhe të enjte. Por, përveç atij që mban mëri me vëllain e fesë, çdo robi tjetër që nuk ka bërë shirk, i falen gjynahet. Ndërsa melekët urdhërohen vazhdimisht: «Vonojeni procesin e faljes së këtyre dy personave, derisa të pajtohen me njëri-tjetrin!»" (Muslim, Birr, 35-36; Ebu Davud, Edeb, 47.)

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Nuk është hallall që një besimtar ta braktisë vëllain e tij në fe dhe të rrijë i zemëruar me të më shumë se tre ditë. Pasi të kalojnë

tre ditë, duhet të takohet me të dhe t'i japë selam. Nëse tjetri e pranon selamin e tij, që të dy kanë sevape. Përndryshe, ai që nuk e pranon selamin ka hyrë në gjynah. Ndërsa ai që ka dhënë selamin nuk konsiderohet i zemëruar." (Ebu Davud, Edeb, 47/4912.)



"Përhapeni selamin, ushqeni të varfrit, bëhuni kështu vëllezër, siç ju urdhëron i Madhërishmi, Allahu." (Ibn-i Maxhe, Et'ime, 1.)

"Më i dashur tek Allahu është ai që jep selam i pari." (Ebu Davud, Edeb, 132-133.)



Allahu thotë në Kuran:

"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit." (Enfal, 46.)



Nëse besimtarët nuk bashkohen dhe solidarizohen do të privohen nga mëshira e Allahut dhe do të humbin forcën dhe fuqinë. Hadithi profetik shprehet:

"Bashkimi është mëshirë kurse përçarja është dënim." (Ahmed, IV, 278, 375; Hejthemi, V, 217)



Ebu Bekri ﷺ, ka thënë:

"Mos u grind me fqinjin, sepse të gjithë largohen, kurse atë e ke aty gjithmonë."



Allahut thotë në Kuran:

"O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar." (Bekare, 208.)

Besimtarët janë vëllezër në fe, të cilët i besojnë një Zoti, janë umet i një profeti, drejtohen nga e njëjta kible, rreshtohen krah më krah në xhami dhe e shikojnë njëri-tjetrin si amanet e përgjegjësi.

Vëllazëria në besim është më e lartë se vëllazëria e lidhjes së gjakut e cila do të thotë që të lindësh nga prindër të njëjtë. Sepse bashkimi biologjik, domethënë lidhja e gjakut, nuk shpreh ndonjë vlerë nëse nuk ka bashkim shpirtëror. Megjithëse ishte biri i Nuhut ﷺ, kjo nuk i solli asnjë dobi Kenanit, i cili u dënua si gjithë të tjerët.

Në Kuran urdhërohet:

"O Nuh, ai nuk është nga familja jote, ai ka bërë punë të keqe. Mos më pyet për atë që ti nuk e di. Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga të paditurit". (Hud, 46.)

Të gjithë myslimanët janë vëllezër. Kurse racizmi, i cili filloi me pretendimin e shejtanit se ai është krijuar nga zjarri dhe për rrjedhojë është superior ndaj Ademit, i cili është krijuar nga dheu, është rreptësishtë i ndaluar në Islam. Hutbja e Lamtumirës është një dëshmi e mrekullueshme e kësaj.

Fatkeqësisht, kur dobësohen ndjenjat fetare, mbizotëron edhe injoranca. Kështu, ndjenjat racore mund të mbizotërojnë mbi ndjenjat fetare. I vetmi frenues ndaj racizmit është Islami.

Islami i ka shpallur të gjithë besimtarët vëllezër, pa dallim race. Vëllazëria e vërtetë është vëllazëria e besimit, vëllazëria e zemrës. Nëse kjo vëllazëri nuk ekziston, vëllazëria biologjike nuk ka dobi.

Në fakt, dy djemtë e Ademit, Habili dhe Kabili, ishin vëllezër në aspektin biologjik. Por, botët e zemrës së tyre ishin shumë të ndryshme. Kabili u bë vrasës për shkak të pasioneve egoiste dhe xhelozisë. Habili, nga ana tjetër, u bë hero i virtytit, duke preferuar të ishte një viktimë e shtypur sesa të merrte padrejtësisht një jetë.



Allahu në Kuran thotë:

"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) **dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë**." (Al-i Imran, 108.)



Islam do të thotë dorëzim te Allahu, jetesë në mirëkuptim dhe paqe, sepse esenciale në fenë tonë është paqja. Detyra e Islamit është të përmirësojë dhe përsosë individin dhe shoqërinë, duke krijuar në këtë mënyrë një shoqëri model dhe duke siguruar një mjedis të qetë dhe të paqtë. Nëse nuk krijohet një shoqëri e shëndetshme dhe harmonike nuk mund të realizohen siç duhet detyra që kemi ndaj Allahut.



Lukmani i urtë ka thënë:

"Biri im! Tri gjëra mësohen në tri situata: Butësia gjatë zemërimit, trimëria gjatë betejës dhe vëllazëria gjatë nevojës."



Në një hadith të Profetit ﷺ, thuhet:

"Nuk është trim ai që e mund kundërshtarin e tij në mundje, por trim i vërtetë është ai që, kur zemërohet e mund nefsin e tij." (Buhari, Edeb, 76.)



Ajo pjesë e jetës që të ka kaluar me zemërim, përbën historinë tënde më tragjike. Zemërimi është një gjendje kalimtare që nxjerr jashtë funksionit logjikën. Masa më e mirë parandaluese, në mënyrë që të frenohet zemërimi, është zotërimi i vlerave që të sjellin sevape dhe mbarësi, si falja e butësia. Allahu i Lartmadhëruar, në Kuran, lidhur me njerëzit që kanë vullnet të mirë dhe rezistencë, ka thënë:

"Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë, edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit." (Al-i Imran, 133-134.)



Kur një person kërkoi këshillë nga Profeti ﷺ, ai i tha tre herë: *"Mos u nxeh!"* (shih. Buhari, Edeb 76)



Të zemërohesh dhe të hakmerresh përballë të këqijave që të bëhen, është një kërkim për vetëkënaqësi i shpirtrave të papjekur. Kurse aftësia e besimtarit që has në diçka të tillë, për të shtypur zemërimin e tij duke falur dhe duke u përgjigjur me mirësi, është një fisnikëri e jashtëzakonshme shpirtërore që tërheq mëshirën hyjnore.



Ahnef bin Kajs, thotë:

"Vëllazëria është një xhevahir delikat. Nëse nuk e ruan, cenohet. Ruaje atë duke e mbizotëruar gjithmonë zemërimin tënd, që ai i cili të bën padrejtësi të vijë e të kërkoj vet falje. Mjaftohu me atë që ke. Mos kërko më tepër për veten dhe mos e shiko të metën e vëllait tënd!" (Ihja, II, 466.)



Amr ibn As ﷺ, i cili ka kryer me sukses detyrën e tij si Guvernatori i Egjiptit, u pyet se si e kishte arritur këtë sukses. Ai u përgjigj:

"Imagjinoja sikur mes meje dhe çdo njeriu tjetër rreth meje, kishte një litar. Kur litari tendosej shumë, aq sa gati këputej, unë e lëshoja pak. Por, kur mendoja se e kisha liruar shumë, atëherë e tendosja menjëherë. Në këtë mënyrë u përpoqa t'i mbajë në ekuilibër dhe baraspeshë marrëdhëniet me të gjithë njerëzit."



Omeri ﷺ, ka thënë:

"Trego fuqinë tënde pa ushtruar dhunë dhe trego butësinë tënde pa shprehur dobësi."



Teprimi në ashpërsi lind urrejtje. Ndërsa teprimi në tolerancë dobëson autoritetin. Suksesi është i mundur duke mbajtur ekuilibrin mes këtyre të dyjave.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Mikun duaje me masë, sepse një ditë mund të bëhet armiku yt. Edhe armikun urreje me masë, sepse një ditë mund të bëhet miku yt." (Tirmidhi, Birr, 60.)



Aliu رضي الله عنه, ka thënë:

"Nëse dëshiron të miqësohesh me ndokënd, mbaj një distancë të mirë përcaktuar ndaj tij. Në qoftë se ai sillet në mënyrë normale, atëherë vazhdoje miqësinë me të; në të kundërt hiq dorë."



I Dërguari i Allahut ka qenë njeriu më i butë në botë. Kjo bënte që ai të zgjidhte përherë më të lehtën në marrëdhëniet që krijonte me njerëzit dhe të mos linte vend për vështirësi, nervozizëm dhe mëri. Atë nuk e nxehte asgjë, me përjashtim të shkeljes së të drejtës dhe i falte përherë gabimet që të tjerët bënin kundër personit të tij. Sado me vrazhdësi të sillej personi që kishte përballë, ai nuk e prishte qëndrimin e tij të sjellshëm dhe ia kthente me të mirë atij që sillej me të me të keq.



Allahu thotë në Kuran:

"Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë." (Fussilet, 34.)



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Mos u bëni immea (njerëz pa karakter, pa vullnet dhe pa vendosmëri; që sipas vendit bëjnë kuvendin, duke thënë): Nëse njerëzit bëjnë mirë, edhe ne bëjmë mirë. Nëse njerëzit bëjnë padrejtësi, edhe ne bëjmë padrejtësi! Por ushtrojeni veten të bëni mirë kur njerëzit bëjnë mirë dhe të mos bëni padrejtësi kur ata bëjnë ligësi (qëndroni larg ligësive të atyre)!" (Tirmidhi, Birr, 62.)



Bërja e të mirave edhe ndaj atyre që bëjnë keq, edhe pse është e rëndë për egon, është një virtyt që fiton zemra. Aspekti i kësaj bote i këtij virtyti, mund të jetë i hidhur, por aspekti i botës tjetër, është shumë i ëmbël. Ky moral është arti i zemrës dhe fitorja e shpirtit. Nderi i një fitoreje është më i madh në raport me vështirësitë e duruara për ta arritur atë.



Profeti ynë ﷺ, ishte i ekspozuar ndaj sjelljeve të vrazhda të shumë njerëzve injorantë dhe të neveritshëm. Por, në vend që të lëndohej nga këto, zemra e tij, që ishte një burim mëshire e madhe, trishtohej që ata lëndonin veten. Pasi Zoti i tij ishte i kënaqur me të, ai nuk u shqetësua për mundimet dhe të këqijat që shkaktonin njerëzit.



I Dërguari i Allahut ﷺ, jo vetëm që e fali shtypjen dhe padrejtësinë që iu bë, por edhe të keqes iu përgjigj me të mirë. Madje, ai nuk u lut për shkatërrimin e banorëve të Taifit, të cilët e goditën me gurë, por u lut që pasardhësit e tyre të nderoheshin me udhëzim dhe të arrinin shpëtimin e përjetshëm. Në çlirimin e Mekës, në vend që të hakmerrej ndaj politeistëve, të cilët e kishin përndjekur dhe torturuar për vite me radhë, ai shpalli amnisti të

përgjithshme për ta dhe u mundësoi shumë armiqve të egër të bëhen miq të sinqertë.



Më e vlefshmja është t'i bësh mirë edhe atij që të bën keq. Tekefundit, vlera e një mirësie është në raport me vështirësinë që ajo shfaq. Sigurisht, është shumë e vështirë të presësh mirësi nga ai të cilit i është bërë keq. Prandaj, të parët tanë kanë thënë: *"Të bësh mirë pasi të kanë bërë mirë, është sjellja e gjithkujt, ndërsa të bësh mirë, kur të kanë bërë keq, është sjellja e njerëzve të arrirë."*



Hallaxh Mansuri, për ata që e gurëzuan, iu lut Allahut me këto fjalë:

"O Zot! Fali ata para se të më falësh mua, sepse ata po më gurëzojnë për hirin Tënd. Në fakt, ata nuk i dinë gjendjet që janë shfaqur tek unë. Nëse do t'i dinin nuk do të më gurëzonin. Ata kanë arsye që më gurëzojnë. Prandaj fali ata para se të më falësh mua!"



Ekzistojnë tre hapa në trajtimin me moralin Islam ndaj së keqes që të bëhet:

1) Kapërcimi i zemërimit.

2) Falja.

3) Të bësh mirësi...



Kur e patën pyetur Sehli Tusterin se çfarë ishte morali, ai u qe përgjigjur:

"Shkalla fillestare e moralit, është të përballosh shtypjen që të bëhet, pa ushqyer në zemër dëshirën për hakmarrje. Pastaj, të

mëshirosh personin që të bën ty padrejtësi, e më pas të të dhimbset në atë shkallë sa të kërkosh prej Zotit që ta falë atë." (Ihja, III, 163.)



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Mos u bëni të ziliqarë ndaj njëri-tjetrit! Mos u përpiqni të nxirrni inatin dhe zemërimin tek njëri-tjetri! Mos hetoni të metat e njëri-tjetrit! Mos përgjoni bisedat e të tjerëve!.. O robërit e Allahut, bëhuni vëllezër!" (Muslim, Birr, 30.)



Nëse duam që të metat tona të mbulohen nga Zoti ynë në Ditën e Gjykimit, duhet të përpiqemi të mbulojmë të metat personale dhe private të robërve të Tij sot.



Vëllazëria në Islam është si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Njësoj si Muhaxhirët dhe Ensarët...



Kushti i parë i miqësisë me vëllanë e fesë, është «të jesh i dobishëm dhe të mos bëhesh barrë». Pra, të mos jesh një barrë e panevojshme për vëllain tënd, përkundrazi, të përpiqesh t'ia lehtësosh barrën.



Miqësia me ata që nuk bëhen barrë dhe shoqërimi me ata që s'të shkaktojnë vështirësi, është e përhershme.





FALËNDERIMI

Asnjë qenie njerëzore nuk është krijuar sepse e meriton. Të qenit njeri midis të gjitha krijesave, e jo gjarpër, ujk, zog apo dhe e gjethe; të qenit besimtar midis gjithë njerëzve dhe të qenit prej umetit të Muhamed Mustafait ﷺ, në mesin (sipas transmetimeve) e 124 mijë profetëve, është një mirësi e madhe për të cilën nuk jemi në gjendje të falënderojmë sa duhet.

Edhe sikur të biem në sexhde falënderimi përballë Allahut për të gjitha këto mirësi dhe të mos e ngremë kokën gjatë gjithë jetës, përsëri është pak, përsëri është e mangët, madje një "hiç"...

Askush nuk është krijuar për shkak të meritës së vet. Krijimi i njeriut prej asgjësë, është një mirësi hyjnore aq e madhe, sa është e pamundur të falënderohet. Dalja prej asgjësë në botën e ekzistencës dhe krijimi jo si gjarpër apo insekt, gur apo dhe, bar apo gjethe, por si "njeri"; të qenit prej umetit të Muhamedit ﷺ, që është prijësi dhe kurora e 124 mijë e kusur profetëve, është një nga mirësitë më të mëdha për të cilat jemi të paaftë të falënderojmë siç duhet. Edhe sikur të uleshim me ballë në tokë duke bërë sexhde pa e ngritur kokën, e të falënderojmë një jetë të tërë vetëm për këtë mirësi, përsëri do të ishte pak, përsëri e mangët, e përsëri asgjë!..

Ne duhet të reflektojmë që na krijoi në cilësinë "njerëzore", duke na bërë krijesat më fisnike ndër të gjitha krijesat e Tij, edhe pse nuk kemi paguar asnjë çmim për këtë mirësi tek Ai që na udhëzoi në të vërtetën dhe të mirën duke na dërguar libra dhe profetë udhëzues. Të gjitha këto janë mirësi të cilave nuk mund t'ia shlyejmë kurrë detyrimet.

Të jesh në gjendje të falënderosh Allahun e Plotfuqishëm është një mirësi e jashtëzakonshme që kërkon gjithashtu falënderim më vete. Me fjalë të tjera, krahas mirësive të panumërta materiale dhe shpirtërore që ka arritur, robi duhet të jetë mirënjohës që është në gjendje të falënderojë për to. Ai duhet të jetë falënderues që ka mundësi ta përmendë Allahun, t'i bëjë sexhde Atij dhe të jetë rob i Tij.

Është e nevojshme që ne të falënderojmë Zotin tonë për të gjitha mirësitë për të cilat jemi të vetëdijshëm ose jo. Nëse mund të meditojmë siç duhet, do të kuptojmë menjëherë se jemi në një gjendje të përsosur me mirësitë e panumërta në çdo moment. Në fakt, edhe një frymë kërkon dy falënderime; njëri si falënderim për atë që marrim dhe tjetri për atë që japim...

Kur një besimtar sheh ndonjë nga krijesat e Allahut, ai duhet ta shtojë mirënjohjen e tij duke medituar mirësinë dhe favorin e Allahut të Madhëruar duke thënë: «Unë mund të isha në vendin e tij dhe ai mund të ishte në vendin tim». Në vend që të mburret, ai duhet të lavdërojë. Ai duhet të largohet nga shkujdesja e atribuimit të mirësive dhe favoreve vetes së tij dhe të falënderojë Allahun, i cili është pronari i vërtetë i atyre mirësive.

Shejh Shibli urdhëron:

«*Falënderim, nuk është të shohësh mirësinë, por Atë që e jep mirësinë.*"

Ne falënderojmë edhe atë që na sjell qoftë edhe një buqetë me lule. Atëherë, sa mirënjohës duhet t'i jemi Atij që i krijoi lulet në atë buqetë?

Po ashtu, ne mendojmë se do të ishte turp të mos falënderonim atë që na sjell qoftë edhe një gotë ujë. Pra, sa mirënjohës duhet t'i jemi Zotit tonë, i cili e krijoi atë ujë, e pastroi në filtra të mrekullueshëm atmosferikë dhe na e ofroi në një formë të pastër, të ëmbël dhe të kulluar?

Një besimtar që e di se; edhe mirësia edhe vështirësia janë në duart e Allahut, nuk do të mbështetet tek ato krijesa të përkohshme që janë thjesht mjete për të. Ai e falënderon njeriun që bëhet shkak i arritjes së një begatie dhe i është mirënjohës Allahut të Madhëruar, i Cili është Pronari i vërtetë i asaj begatie. Ai nuk mbetet tek rrizku, duke harruar Rrezakun.

Mirënjohje e vërtetë, është njohja e Pronarit të vërtetë të mirësive dhe të bëhesh rob i sinqertë i Zotit që i dhuroi ato, si në fjalë, ashtu edhe në vepra.

Ne erdhëm në botë pa paguar asnjë çmim. Megjithatë, është e nevojshme që ne të shkojmë në ahiret me një përpjekje për të paguar borxhin e mirënjohjes për të gjitha bekimet që na janë dhënë.

Allahu thotë në Kuran:

"**Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë** (e kësaj bote)!" (Tekathur, 8.)

Kur u zbrit ky ajet fisnik, një sahab shumë i varfër e nevojtar, u ngrit në këmbë dhe pyeti:

"(O i Dërguar i Allahut!) A kam unë ndonjë mirësi (për të cilën do të jap llogari)?"

Profeti ﷺ, iu përgjigj shkurtimisht:

"Hija, dy nallanet dhe uji i ftohtë." (shih. Sujuti, VIII, 619.)

Ne duhet ta shoqërojmë me falënderim, mirënjohje dhe dhikër faktin që Allahu e ka nënshtruar botën dhe çka në të për

ne si mirësi. Ne përballë gjithë këtyre mirësive duhet të thellohemi shpirtërisht.

Muhamed Es'ad Erbili e përshkruan falënderimin me këto fjalë:

«Falënderim, nuk është të thuash vetëm me fjalë: «Falemin-derit o Zot!» Përkundrazi, falënderim, do të thotë të përdorësh të gjitha mirësitë që ka dhuruar Allahu në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre..."

Falënderimi është dy llojesh:

Falënderim me zemër: Të fiksosh në zemër vetëdijen se Pronari i vërtetë i mirësive është Allahu. Falënderimi me vepra: Të mos i përdorësh ato mirësi për gjëra me të cilat Allahu nuk është i kënaqur, por të fitosh kënaqësinë hyjnore, duke i përdorur ato në përputhje me dëshirën e Allahut.

Çdo ditë, gjatë namazeve falënderojmë gojarisht të paktën dyzet herë duke thënë:

"Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!" (Fatiha, 2.) Megjithatë, kjo nuk duhet të kufizohet vetëm në gjuhë, sepse, siç thotë Xhunejd Bagdadi: *"Falënderim, do të thotë të mos e kundër-shtosh Allahun me mirësitë e Tij dhe të mos i përdorësh ato mirës në gjynahe."*

Është e domosdoshme për lumturinë tonë, që të njohim mirësitë që na janë falur dhe të falënderojmë për to. Dhe hapi i parë për këtë, është thellimi në meditimin rreth atyre mirësive.

Për shembull, të mendojmë për mirësinë e "syrit":

Nëse do të kishim lindur të verbër dhe vite më vonë do të na jepej mundësia për të shikuar, kushedi se çfarë gëzimi do të ndjenim në atë moment?! Kushedi se sa do të mahniteshim përballë madhështisë dhe bukurisë së mirësisë së shikimit?! Ne do të ishim mrekulluar me Zotin tonë, i Cili na e ka falur këtë mirësi.

Me të vërtetë që, kushedi se sa do të lumturoheshim nëse do t'i shihnim për herë të parë ngjyrat dhe tonet e panumërta të dritës, tablotë e mrekullueshme që krijon dielli gjatë perëndimit të tij, yjet, dritën e hënës, natën, ditën, oqeanet, kafshët dhe çdo vepër arti që Allahu i Madhëruar ka shfaqur në gjithësi!.. Ne do të ishim dehur vetëm prej kënaqësisë dhe gëzimit të papërshkrueshëm të mirësisë së shikimit. Krijesat që do të shihnim në atë moment, nuk do t'i shihnim rëndomtë si tani, por njësoj sikur shohim një oqean të thellë, duke ndjerë mahnitjen dhe urtësinë e tyre.

Allahu thotë në Kuran:

"Thuaju: «Është Ai që ju ka krijuar dhe ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrat, e megjithatë ju pak e falënderoni»"
(Mulk, 23.)

Nuk duhet të harrojmë se; për çdo mirësi dhe për çdo organ ka një falënderim të veçantë.

Për shembull;

• Falënderimi i syrit: Ky falënderim do të thotë që t'i mbrojmë sytë tanë nga haramet dhe vitrinat djallëzore. Do të thotë që t'i kthejmë sytë tanë drejt vitrinave shpirtërore. Do të thotë që kështu të meditojmë rreth madhështisë hyjnore në çdo gjë që shikojmë.

• Falënderimi i veshit: Ky falënderim do të thotë që të mos i dëgjojmë thashethemet, përgojimet dhe spiunimet. Do të thotë

që veshët tani t'i drejtojmë te zërat shpirtërore si Kurani Fisnik, ligjëratat fetare, ezani dhe leximet e dobishme.

• Falënderimi i gjuhës: Ky falënderim do të thotë që; ose të heshtim, ose të themi fjalë të mira. Do të thotë shtim i meditimit kur të heshtim. Heshtja e Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë ishte meditim. Shihte qiellin dhe meditonte. Shihte tokën dhe meditonte.

• Falënderimi i trupit: Ky falënderim do të thotë që fuqinë e forcën të cilat i ka dhënë Allahu t'i përdorim në rrugë të Zotit.

• Falënderimi i zemrës: Ky falënderim do të thotë që të mos e harrojmë Allahun Teala duke medituar gjithmonë rreth mirësive që na ka dhënë Ai.

Sadi Shirazi thotë:

"Gjuha është për falënderim. Ai që njeh Allahun nuk e përdor atë për përgojim. Veshi është për të dëgjuar këshilla, nuk është për të dëgjuar fjalë boshe dhe të kota. Sytë janë për të shikuar madhështinë e Allahut në univers, jo për të hetuar mangësitë e njëritjetrit."

Nëse një njeriu me mendje të shëndoshë i thonë: "Më jep sytë, merr Stambollin!", a t'i jep? Po edhe sikur t'i thonë: "Më jep shëndetin, merr botën!", kush i ndërron? Një njeri me mendje të shëndoshë, nuk e pranon kurrë diçka të tillë, sepse ai e di mirë se për të, kjo nuk do të jetë gjë tjetër veçse një dënim i mbushur me vuajtje dhe tortura.

Për këtë arsye, Sulltan Sulejman Kanuni, ka thënë:

Për popullin s'ka asgjë më të çmuar se shteti,

Por në këtë botë s'ka shtet (forcë) më të çmuar se një frymë shëndeti.

Atëherë, nëse mund të mendojmë siç duhet mbi mirësitë e panumërta që na janë falur, si shëndeti dhe mirëqenia, është e nevojshme që ne të mbushemi me ndjenja mirënjohjeje në atë masë sa të mendojmë se kemi ardhur në këtë botë vetëm për të falënderuar për to.

Një njeri i urtë dhe i devotshëm, për të kuptuar mirë vlerën e kohës dhe për ta vlerësuar atë sa më mirë, jep këto këshilla:

"Bëj vizita të herëpashershme në spital për të parë të sëmurët! Falëndero Zotin për gjendjen tënde shëndetësore dhe mendo edhe gjendjen e atyre të sëmurëve! Shko herë pas here në burgje dhe gjyko për jetën e përvuajtur të atyre njerëzve të burgosur! Mendoni për një çast se; krimi është kryer për një moment të caktuar, në mënyrë të pavetëdijshme; nga ana tjetër ashtu i rrënuar shpirtërisht hyni në burg e mendoni që edhe ju mund të ishit në vendin e tyre! Falëndero Zotin që të mbrojti dhe ruajti për të mos rënë në këtë gjendje! Lutu edhe për shpëtimin e atyre që janë atje! Më pas shko në varreza, dije vlerën e kohës, duke menduar se nuk ka asnjë vlerë pendimi pasi të kesh humbur mirësinë e jetës!"

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë!" (Ibrahim, 7.)

Me fjalë të tjera, falënderimi është një mjet për shtimin e begatisë së mirësive. Kurse mos falënderimi dhe mosmirënjohja, shkaktojnë humbjen e begative dhe zemërimin e Allahut.

Çdo besimtar që dëshiron vazhdimësinë e mirësive dhe begatinë e atyre që i janë dhënë, duhet të falënderojë shumë edhe

me gjuhë edhe me vepra. Ndërsa ndarjen e mirësive që i janë dhënë me ata që janë të privuar prej tyre, duhet ta konsiderojë si lumturinë më të madhe. Përndryshe, ai nuk duhet të harrojë se; mirësitë për të cilat nuk falënderohen, një ditë do të humbasin.

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Kur të varfërohesh dhuro lëmoshë duke bërë tregti me Allahun e Lartmadhëruar. Kur të të bjerë në dorë ndonjë pasuri, falëndero menjëherë Zotin! Kujdes! Mos e humb pasurinë tënde nëpërmjet falënderimit të paktë."

Atij që, kur të arrini një mirësi, i drejtohet Pronarit të vërtetë të të gjitha mirësive dhe thotë:

"Kjo është nga mirësia e Zotit tim, falënderoj Zotin, që ma ka bërë rrizk...", Allahu i Madhëruar ia shton vazhdimisht mirësitë dhe begatitë e Tij, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Më përmendni Mua, që unë t'iu përmend ju. Më falënderoni e mos më mohoni." (Bekare, 152.)

E kundërta e mirënjohjes, mosmirënjohja, do të thotë të injorosh faktin se të gjitha begatitë janë prej Allahut të Madhëruar dhe ta frysh egon me mendime të tilla si: «ia arrita vet, e fitova me forcat e mia...». Me fjalë të tjera, do të thotë; t'ia atribuosh vetes ato mirësi dhe suksese. Kjo, nënkupton shpërdorimin e mirësive në gjynahe dhe dëshira të ulëta.

Allahu i Madhëruar në këtë ajet urdhëron:

«Padyshim Ne i treguam atij rrugën e drejtë; e ai në daç të jetë mirënjohës, në daç mosmirënjohës.» (Insan, 3.)

Çfarëdo që robi të zgjedhë, falënderim apo mosmirënjohje, ai nuk mund t'i bëjë as dobi as dëm Allahut të Madhëruar. Megjithatë, ai patjetër do ta shohë shpërblimin e zgjedhjes së tij si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në varr, në Ditën e Gjykimit dhe shkurt, në jetën e amshuar.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Dhe po të numëroni mirësitë e Allahut, ju kurrë nuk do të ishit në gjendje t'i numëroni ato." (Ibrahim 34.)

Sa mosmirënjohje e madhe është të zhytesh në gjynahe dhe rebelim ndaj Allahut, në vend që ta falënderosh Atë për mirësitë e panumërta që të ka dhuruar dhe të përpiqesh të fitosh pëlqimin e Tij.

Nëse një mik i yni na jep dhurata të shumta, do të na vinte turp që të bënim gabimin më të vogël ndaj tij. Ne përmbahemi me përpikëri nga çdo veprim që mund ta lëndojë atë. Ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen dhe falënderimin tonë ndaj tij duke bërë vepra të mira me të cilat ai do të jetë i kënaqur.

Në këtë botë kalimtare në të cilën jetojmë, Allahu i Plotfuqishëm u jep robërve të Tij mirësi të panumërta, në mënyrë që ne t'i jemi mirënjohës Atij. Me këto mirësi, ai na vë në provë se kush do të jetë mirënjohës dhe kush do të jetë mosmirënjohës. Ai na bën të ditur se; ata që janë mirënjohës do të marrin mëshirën hyjnore, ndërsa ata që janë mosmirënjohës do të pësojnë zemërimin hyjnor.

Mevlana pyet:

"O njeri! Pabesia është faj dhe turp edhe për qentë. (Për qenin endacak e të pabesë nuk interesohet askush. Kurse për qenin besnik ndaj pronarit të tij tregohet përkujdesje.) Atëherë si mund të jeni ju, si qenie njerëzore, të pabesë dhe mosmirënjohës (ndaj Zotit tuaj)?!»

Shejh Sadi thotë:

"Në pamje të jashtme, krijesa më e nderuar është njeriu, kurse më e ulëta është qeni. Megjithatë, ekziston një konsensus për mendimin se: Një qen besnik, është më i mirë se një person mosmirënjohës që mohon mirësinë që i bëhet. Edhe nëse e godet njëqind herë me gurë një qen, ai përsëri nuk e harron kurrë kafshatën e bukës që i ka dhënë i zoti. Nga ana tjetër, edhe nëse përkëdhelni gjithë jetën një njeri të ulët dhe pa karakter, ai do të fillojë të grindet me ju për gjënë më të vogël dhe të parëndësishme."



DURIMI DHE KËNAQËSIA

Kur njerëzit e mençur ndeshen me surprizat e hidhura e të ëmbla të jetës, ata thonë: «Edhe kjo do të kalojë!» Kuptimi i kësaj shprehjeje është: "O njeri! Ashtu si pikëllimet dhe hidhërimet që ju vijnë, edhe gëzimet janë gjithashtu mysafirë në zemrën tuaj. Mos mendoni se janë të përhershme! Mos jini shumë të trishtuar dhe të pashpresë për problemet kalimtare që ju godasin, sepse ato janë të përkohshme. Mos u kaploni shumë nga gëzimet dhe lumturitë kalimtare që keni arritur, sepse as ato nuk janë të përhershme».

Allahu thotë në Kuran:

"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë «Ne besojmë», pa u vënë në provë?!" (Ankebut, 2.)



Të gjitha sprovat e hidhura e të ëmbla që Allahu i Madhëruar u jep robërve të Tij, në fakt nuk janë gjë tjetër veçse një provë e sinqeritetit, besnikërisë dhe nënshtrimit tonë në besim dhe robëri. Fytyra e vërtetë e njeriut zbulohet kur ai sprovohet me vështirësi dhe mirësi; e sidomos kur i shkelen damarët egos së tij.



Allahu thotë në Kuran:

"Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit!" (Bekare, 155.) Nëse bota nuk është një vend sprove hyjnore, çfarë tjetër është ajo?



Shejh Sadi thotë:

"Mos u mërzit nga ofendimi apo dëmi të të bën një njeri i rëndomtë. Sepse ata nuk janë të aftë as të rëndojnë dhe as të lehtësojnë. Miqësinë e mikut dhe armiqësinë e armikut kërko ta gjesh tek Allahu. Sepse zemra e tyre është në dorë të Allahut. Njeriu i mençur kur i hidhet shigjeta shikon tek harkëtari jo te harku."



Besimtari duhet të mendojë se; nëse të gjithë njerëzit do të mblidheshin dhe do të përpiqeshin ta pengonin atë, ata nuk do të mund të largonin një mirësi që ka caktuar Allahu. Përsëri, edhe sikur të gjithë njerëzit të bëhen bashkë, ata nuk do të ishin në gjendje të shmangnin një të keqe të caktuar nga Allahu.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

"Nëse Allahu vendos të të godasë ndonjë e keqe, askush nuk mund të ta largojë atë përveç Tij, e nëse Ai do të të bëjë ndonjë të mirë, s'ka kush që ta pengojë mirësinë e Tij. Ai ia jep atë mirësi kujt të dojë prej robërve të Tij. Ai është Falës dhe Mëshirëplotë." (Junus, 107.)



Besimtari duhet ta dijë se; në të gjitha situatat që përjeton, qofshin të hidhura apo të ëmbla, të mira apo të këqija, ato janë një sprovë hyjnore dhe duhet të përpiqet të përfitojë shpirtërisht nga këto sprova. Për këtë, para së gjithash, duhet t'i kushtohet vëmendje vullnetit hyjnor, i cili është shkaku kryesor i çdo ndodhie. Të urtët kanë thënë: *"As të keqen mos e konsideroni prej armikut, e as të mirën nga miku. Besojani çështjet tuaja Allahut, sepse edhe e keqja, edhe e mira janë sprova prej Tij"*.



Durimi është thelbësor në të gjitha çështjet:

– Durim për vazhdimësinë në adhurim dhe përpjekjen në punë të mira.

– Durimi në përballimin e tundimeve të gjynaheve, kënaqësive të harameve dhe dëshirave sensuale...

– Durim përballë fatkeqësive, sprovave dhe shqetësimeve, për të mos cenuar vetëmjaftueshmërinë dhe për të ruajtur kënaqësinë e zemrës...

– Durim për të mos rrëshqitur këmbët kur zotëron pasuri dhe kur mundësitë e prirjes drejt dëshirave egoiste janë më të mëdha...

– Durimi në varfëri, që të shtyn drejt mosbesimit, për të mos e lëkundur besimin dhe për të mos iu drejtuar rrugëve të paligjshme...



Të heqësh qafe papjekurinë është arti i përballimit me durim të vuajtjeve dhe vështirësive. Nuk gatuhet ushqimi pa mund dhe mëshira nuk shfaqet pa duruar vështirësitë.



Ashtu si një vakt ushqimi nuk mund të hahet apo të tretet pa u gatuar, edhe zemra arrin përsosmërinë vetëm duke u gatuar në zjarrin e vuajtjeve.



Rumiu ka thënë:

"Durimi i hënës gjatë natës së errët, e bëri atë të ndritshme. Durimi i trëndafilit ndaj gjembit i jep aromën e mrekullueshme trëndafilit."



Trëndafili arriti përsosmërinë dhe bukurinë falë miqësisë dhe harmonisë me gjembin. Pra, duke duruar gjembat, ai fiton një formë të bukur dhe një aromë të këndshme. Kështu edhe njeriu pastrohet dhe ngrihet shpirtërisht aq sa duron dhe toleron sprovat dhe mundimet.



Durimi kërkohet për të gjitha sprovat hyjnore. Të urtët për-

dorin një shprehje të goditur «guri i durimit». Guri ynë i durimit nuk duhet të thyhet kurrë, përkundrazi, mbi atë gur duhet të lulëzojnë sythat dhe trëndafilat. Me fjalë të tjera, ne duhet të durojmë të gjitha llojet e vuajtjeve dhe të bëjmë sakrifica në rrugën drejt arritjes së kënaqësisë së Allahut.



Është e pamundur që një përrua të kapërcejë malin. Por, nëse ai shkon përreth malit, ai do të arrijë qëllimin e tij. Megjithatë, edhe kjo kërkon durim.



Për të përftuar një gram ar, është e nevojshme që; me vështirësi dhe mund të kaloni tonelata dheu nëpër sitën e durimit.



Robi duhet të kapërcejë me durim peshën e sprovave me të cilat përballet në jetën e tij të kësaj bote. Në xhenet nuk ka nevojë për durim; ai na duhet në këtë botë!..



Momenti më i çmuar i durimit është momenti i parë kur fatkeqësia godet me gjithë intensitetin e saj. Durimi në atë moment është kulmi i durimit. I Dërguari i Allahut ka thënë:

«*Durimi i vërtetë është ai që tregohet në momentin e parë të fatkeqësisë!*» (Buhari, Xhenaiz, 32.)



Shejh Sadi e shpreh kështu mëshirën e fshehur në vuajtje:

"Druri i udit nuk e lëshon vet aromën. Ai lëshon aromë qelibari vetëm kur vendoset në zjarr."



Një besimtar duhet t'i konsiderojë sprovat dhe fatkeqësitë si mjete për zhvillimin e tij shpirtëror dhe mundësi për të eliminuar papjekurinë e shpirtit të tij dhe për t'u disiplinuar e pastruar shpirtërisht. Kjo, sepse shpirti i një personi që nuk vuan nga hallet dhe vështirësitë dhe realizon çdo dëshirë të tij, bëhet shumë i ngurtë dhe shndërrohet në një kalë të pazbutshëm. Ai kurrë nuk mund të imagjinojë se një virus shumë i vogël për t'u parë me sy të lirë ka shtrirë përtokë shumë mundës që konsiderohen të pathyeshëm. Duke qenë se e sheh veten të madh, të fuqishëm dhe madhështor, si pasojë e shkujdesjes së tij, ai largohet edhe nga mëshira e Zotit të vet.

Nga ana tjetër, shpirti i njeriut që rënkon nën vuajtje, e kupton më mirë se është i dobët, sa një letër e lagur. Kur e njeh veten me këtë cilësi, ai e kupton më thellë madhështinë e Zotit të tij.



Të mos harrojmë se; ajo që do të jetë eliksiri i lumturisë së përjetshme për zemrat, fshihet kryesisht në kohë të vështira dhe në sferat e vuajtjeve.



Allahu i Madhëruar urdhëron:

"O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit." (Bekare, 153.)



Pas durimit të vështirësive, vijnë shpërblime të mëdha, sepse durimi dhe këmbëngulja e afrojnë robin me Allahun. Kështu shfaqet mëshira hyjnore. Siç urdhërohet në Kuran:

"Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi! Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!" (Inshirah, 5-6.)



Shejh Sadi thotë:

«Rrushi i pabërë mirë ka shije të thartë, por nëse bëhet durim edhe disa ditë ai do të ëmbëlsohet.»



Paqja dhe lumturia e jetës sonë varet nga të kuptuarit se; caktimi i Allahu, është më i miri për ne. Ka shumë ngjarje që duken të zymta, rezultati i të cilave është mirësi; si varfëria pas së cilës vjen xheneti. Ka edhe disa situata që duken si mirësi, rezultati i të cilave është zhgënjimi i hidhur; si pasuria që nuk shpenzohet për hir të Allahut, por vetëm për veten, duke e bërë kështu robin t'i nënshtrohet një llogarie të vështirë në botën tjetër.



Shejh Sadi thotë:

"Trishtimi pas së cilit vjen gëzimi, është më i mirë se gëzimi pas së cilit vjen hidhërimi."

«Ai që nuk ka durim, nuk ka as njohuri për urtësinë.»

"Ajo që arrihet shpejt, shpesh nuk zgjat shumë. Gjërat arrihen me durim. Kush nxiton përmbyset me kokë poshtë."



Toka nuk mund të arrijë begatinë e pranverës pa duruar ashpërsinë e muajve të dimrit. Një nënë nuk mund të përjetojë gëzimin e një fëmije pa duruar nëntë muaj.



Ebu Bekri thotë:

"Nuk ka dëm në durim, e qëndresë dhe dobi në trishtim e nxitim."



Durimi në këtë botë mund të jetë i hidhur, por fryti i tij në botën tjetër është shumë i ëmbël. Njerëzit e devotshëm të cilët durojnë disa vështirësi dhe telashe për hir të Allahut në këtë botë, i konsiderojnë vështirësitë si mëshirë, telashet si begati dhe mundimet si mjete të lumturisë së përjetshme, sepse e dinë shpërblimin e tyre tek Allahu.



Xhunejd Bagdadi thotë:

"Durim, është të pish hidhësirën pa shtrembëruar fytyrën."



Allahu i Madhëruar i ka vënë robërit e Tij më të dashur në rrethin e sprovave, sepse vështirësitë në këtë botë, janë mundësi për zhvillimin e shpirtit. Për këtë arsye, sprovat më të rënda i kanë përjetuar, Profetët dhe besimtarët e drejtë e të devotshëm sipas gradës dhe afërsisë së tyre me Allahun.

Por, në të njëjtën kohë, ata janë edhe njerëzit më të qetë, që harrojnë hallet e veta dhe nxitojnë të gjejnë një zgjidhje për hallet e të tjerëve; janë burim ngushëllimi për ata që vuajnë dhe zemrat e tyre i bëjnë mëshirë për të mjerët. Kjo, sepse qetësia shpirtërore e të qenit së bashku me Allahun i bëri ata të harrojnë të gjitha problemet e kësaj bote dhe e bëri dhembshurinë dhe mëshirën ndaj krijesave për hir të Krijuesit kënaqësinë dhe lumturinë më të madhe.



Profeti ynë ﷺ, robi më i dashur i Allahut, lindi jetim dhe u rrit jetim. Ai varrosi me duart e veta gjashtë nga shtatë fëmijët e tij. Gjatë detyrës së tij si profet, ai iu nënshtrua shumë persekutimeve dhe torturave nga politeistët. Në Uhud ranë shehid 70 sahab të dalluar, veçanërisht Mus'ab bin Umejri dhe xhaxhai i tij Hamza, të cilët ai i donte shumë.

Megjithatë, në dorëzimin dhe nënshtrimin e tij ndaj Allahut të Madhëruar nuk pati asnjë ndryshim. Kështu, kur u godit me gurë nga njerëz të këqij dhe fatkeq në Taif, tha:

"O Mëshiruesi i Mëshiruesve! Nëse nuk je i zemëruar me mua, nuk dua t'ia di për vuajtjet dhe belatë që po heq!" (shih. (Ibn-i Hisham, II, 29-30; Hejthemi, VI, 35.)



Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

"...Në rrugën e Allahut jam sprovuar me vuajtje e mundime më shumë se askush tjetër." (Tirmidhi, Kiamet, 34/2472.)

Megjithatë, asnjë nga sprovat nëpër të cilat kaloi ai, nuk mundi ta prishë qëndrueshmërinë dhe qetësinë shpirtërore të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Përkundrazi, të gjitha këto i ka përballuar me shumë pjekuri dhe dorëzim ndaj Zotit. Ai kurrë nuk u ankua për gjendjen e tij. Edhe pse zemra e tij ishte djegur nga shumë dhimbje, buzëqeshja nuk i mungoi asnjëherë fytyrës së tij të trëndafiltë. Askush nuk e pa atë me një fytyrë të varur e të vrenjtur dhe vetulla të ngrysura, sepse ai ishte gjithmonë i buzëqeshur në qetësinë shpirtërore të të qenit së bashku me Allahun dhe në çdo çast, reflektonte fytyrën e qeshur të Islamit.



Kur shikojmë jetën plot dashuri dhe përpjekje të sahabëve, vërejmë se; nëse zemrat kanë arritur qetësinë e të qenit bashkë me Allahun, justifikimet do të avullojnë, hallet do të gjejnë zgjidhje, distancat e pakapërcyeshme do të shkurtohen dhe i nxehti përvëlues do të kthehet në freski dhe shpëtim shpirtëror. Kjo, sepse, asnjë dhimbje në zemrat e tyre nuk ishte aq e rëndë sa

dhimbja e ndarjes nga i Dërguari i Allahut ﷺ. Nëse ata ishin me të, e nëse ai u buzëqeshte, vuajtjet dhe hallet e humbnin rëndësinë e tyre.



Të jesh i kënaqur me caktimin e Allahut, do të thotë që të mos e prishësh ekuilibrin e zemrës përballë ndryshimit të kushteve të hidhura e të ëmbla të jetës dhe të ruash devotshmërinë në çdo situatë.

Të durosh sëmundjen, varfërinë dhe fatkeqësinë për hir të Allahut, bëhet shkak i kënaqësisë së Allahut të Lartësuar, i Cili i sprovon robërit e tij me to. Në raste të tilla, besimtari duhet të mendojë gjithmonë për sprovat e rënda që kaluan profetët dhe të ripërtërijë vendosmërinë dhe përpjekjen e tij.



Nëse dikush që zotëron triliona, humb një pjesë të vogël të parave kur është duke ecur në rrugë, a do të hidhërohet ai për këtë? E çfarë rëndësie kanë ato pak para për dikë që zotëron triliona? Po kështu edhe ne; kur na bie ndonjë fatkeqësi e kësaj bote, do të durojmë duke menduar se sa fatlum jemi, që jemi robër të Allahut dhe umet i Profetit tonë të dashur ﷺ. Ne duhet ta harrojmë hidhërimin tej mase, shkatërrimin e vetvetes, ankimet dhe qarjen për një fatkeqësi apo humbje të përkohshme të kësaj bote. Nuk duhet të themi: “Pse ndodhi kjo. Obobo!?”



Një besim i vërtetë kërkon që të harrohen ankesat përballë vështirësive që hasen në jetë, si pjesë e caktimit hyjnor dhe gjithmonë të strehohesh tek Zoti i Madhëruar. Në këtë aspekt, kur një besimtar i përsosur ndeshet me një fatkeqësi, ai mendon se ajo është një sprovë hyjnore dhe nuk e lë veten të bjerë në vorbullën e

pikëllimit dhe të dëshpërimit. Përkundrazi, sado sprovë të madhe të ketë, ai di ta ruajë qetësinë e tij shpirtërore duke thënë:

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ

"Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!" (Al-i Imran, 173.)



Kur të arrijmë një mirësi ose sukses, nuk duhet të llastohemi. Nuk duhet të harrojmë robërinë dhe pafuqinë tonë përballë Allahut. Nuk duhet të na kaplojë krenaria, arroganca dhe mendjemadhësia. Nuk duhet t'i shkelim kufijtë dhe të shkojmë përtej kufijve hyjnorë.

Nga ana tjetër, kur të sprovohemi me ndonjë fatkeqësi dhe vështirësi, në vend që të biem në dëshpërim dhe pikëllim, duhet të mendojmë se e gjithë ajo mund të jetë një pastrim nga gjynahet dhe ngritje në grada shpirtërore.



Matësja e një dashurie të vërtetë është sakrifica. Problemet dhe fatkeqësitë testojnë sinqeritetin e dashurisë. Dashuri e vërtetë, është ajo që nuk zhduket përballë vështirësive, por përkundrazi bëhet edhe më e fortë. Prandaj, një rob që e do vërtet Zotin e Plotfuqishëm, arrin të qëndrojë në gjendje lavdërimi, falënderimi dhe pëlqimi ndaj Tij, si në gëzim ashtu edhe në pikëllim.



Besnikëria nuk ka të bëjë vetëm me mbajtjen e një premtimi. Besnikëri e vërtetë, do të thotë të mos humbasësh në asnjë situatë gjendjen e besnikërisë, nënshtrimit dhe bindjes ndaj Allahut të Madhëruar. Të jesh në gjendje të ruash devotshmërinë gjatë gjithë jetës, jo vetëm për një kohë të caktuar.



Një zemër që të papriturat e hidhura e të ëmbla të jetës i pret me ankesa dhe rebelime, në vend që të falënderojë dhe t'i dorëzohet pëlqimit të Allahut, do të thotë se e ka humbur vetëdijen për të qenë së bashku me Allahun. Gjendja e falënderimit, mirënjohjes, dhikrit, pëlqimit dhe lutjes, duhet të jenë cilësi të pandryshueshme të besimtarit, edhe nëse ndryshojnë kushtet e jetës.



Pyetjes se: *"Kur do të jetë i kënaqur Allahu me robin e vet?"*, Rabia i përgjigjet kështu:

"Kur të falënderoni sikur jeni në mirësi, edhe kur jeni në vuajtje dhe vështirësi..."



Në një hadith të nderuar të Resulullahut ﷺ, besimtari krahasohet me arin:

"Besimtari ngjan me arin e pastër. Ari i pastër hidhet në zjarr, shkrihet dhe sërish del prej aty i plotë dhe i pastër siç ishte." (Ahmed, II, 199.)



Zoti ynë dëshiron që ne të kemi një pjekuri zemre të atillë, që mund të thotë gjithmonë, në kamje dhe në skamje, në lumturi dhe pikëllim: *«O Zoti im, lavdërimi të qoftë Ty!»*



Meqenëse dashuria e vërtetë i shndërron problemet në mëshirë, vështirësitë që na vijnë prej të dashurit janë të mirëseardhura, ashtu si mirësitë e tij. Për të kuptuar nëse dashuria e një personi është e vërtetë dhe për të matur nivelin e saj, mjafton të shohim se sa i toleron ai vështirësitë e të dashurit të tij.



Shejh Sadi thotë:

"O biri i Ademit! Ndonjëherë je kryelartë dhe i shkujdesur në mirësi, e ndonjëherë je i pashpresë dhe i trishtuar në varfëri... Ja pra, kjo është gjendja jote kur je i gëzuar dhe i trishtuar. Nuk e di; kur do ta adhuroni Zotin tuaj (me lavdërim, falënderim dhe të kënaqur)?!"



Një besimtar i përsosur, bëhet i pavullnetshëm përballë dashurisë ndaj Zotit, ashtu si fluturat e natës që sillen përreth dritës. Kjo, sepse devotshmëria ndaj Allahut e shoqëruar gjithmonë me ndjenjat e lavdërimit, mirënjohjes, pëlqimit dhe nënshtrimit, është fryti më i bukur i dashurisë për Zotin.



Një rob besimtar, nuk duhet të mashtrohet nga bukuritë mashtruese të jetës së përkohshme dhe nuk duhet të digjet nga dëshira për atë që nuk mund ta marrë. Ai duhet të ruajë gjithmonë qetësinë e tij duke parë lumturinë e fshehur në vuajtje dhe begatinë e fshehur në vështirësi.



Mysliman duhet të ketë gjithmonë një buzëqeshje në fytyrën e tij, edhe nëse është i trishtuar. Kur të arrijë një sukses, ai duhet t'ia atribuojë atë Allahut dhe ta falënderojë Atë. E, kur të haset me ndonjë vështirësi, ai duhet të kujtojë se gjithçka është një provë hyjnore dhe të jetë i durueshëm. Në çdo situatë, ai duhet të jetë i kënaqur me vullnetin e Allahut në mënyrë që Allahu të jetë i kënaqur me të.



Xhunejd Bagdadi thotë:

"Durimi ndaj telasheve dhe fatkeqësive është drita e dijetarëve dhe mësimi i dervishëve. Por të shkujdesurit nuk mund ta kuptojnë këtë."



Në një hadith fisnik thuhet:

"E çuditshme është çështja e besimtarit, sepse çdo gjendje e tij është mirësi për të dhe kjo është e tillë vetëm për të. Nëse besimtarit i ndodh një gëzim, ai falënderon (Allahun) dhe kjo i sjell dobi. E nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër), dhe po ashtu, edhe kjo i sjell dobi." (Muslim, Zuhd, 64.)

Një besimtar i sinqertë që ecën në rrugë të Allahut, nuk del kurrë i dëmtuar, sepse edhe nëse ai dëmtohet në aspektin e kësaj bote, ai është i fituar në aspektin e botës tjetër.



Mevlana thotë:

«Dhimbjet e lindjes janë të rënda për nënën, por për fëmijën në bark, është çlirim nga burgu.»

Pra; t'i shohësh vështirësitë që hasen në rrugën e Allahut nga dritarja e mirësive që do të pasojnë, është aftësi që e zotërojnë vetëm besimtarët e përsosur.



Çdo njeri ndjen kënaqësi prej gëzimit. Mirëpo çdo gjë ka një masë. Kështu edhe gëzimi. Ashtu siç është e gabuar zhytja në mërzi të thellë deri në vetshkatërrim në raste fatkeqësish, ashtu është i gabuar edhe teprimi në gëzim deri në dehje e shkelje të çdo norme, gjendje këto që tronditin vlerat dhe karakterin njerëzor.



Allahu i Madhëruar e sprovon njeriun në këtë botë edhe me pasuri edhe me varfëri. Por, është tradhti dhe mosmirënjohje e madhe ndaj Zotit që robi t'i drejtohet Zotit të tij dhe t'i lutet vetëm kur është në vështirësi dhe ta harrojë Atë kur të lehtësohet.



Në një hadith është urdhëruar:

"...Kush dëshiron që lutja e tij të pranohet në kohë të vështira, le të lutet shumë edhe në kohë rehatie..." (Tirmidhi, Deauat, 9.)



Aliu ﷺ, ka thënë:

"Jeta e kësaj bote përbëhet nga dy ditë. Njëra prej tyre është në dobinë tënde, ndërsa tjetra është në dëmin tënd. Kur të jesh në ditën tënde të mirë mos u llasto; gjithashtu mos u zemëro e mos anko kur të jesh në ditën tënde të keqe."



Në një hadith kudsij, thuhet:

"Disa prej robërve të Mi besimtar i mban të fortë (besimtarë) vetëm pasuria. Nëse do t'i bëja të varfër, kjo gjendje do t'i prishte ata.

Disa prej robërve të Mi besimtar i mban të fortë varfëria. Nëse do t'ua shtoja shumë rrizkun, kjo gjendje do t'i prishte ata.

Disa prej robërve të Mi besimtar dëshirojnë gradë (të lartë) në devotshmëri. Mirëpo, Unë nuk ia plotësoj këtë dëshirë, me qëllim që ata të mos bëhen mendjemëdhenj e të mos u pëlqej vetja, gjë e cila i prish ata.

Disa prej robërve të Mi besimtarë i mban të fortë vetëm shëndeti i mirë. Nëse do t'u jepja sëmundje, kjo gjendje do t'i prishte ata.

Çështjet e robërve të Mi, përfshirë edhe ato të zemrës, i drejtoj me dijen Time. Unë jam Ai që di çdo gjë dhe i njoftuar për gjithçka." (Bejhaki, el-Esma ue's-Sifat, fq. 122.)



Shumë njerëz mendojnë se varfëria dhe privimi nga diçka janë një «e keqe» në mënyrë absolute. Megjithatë, është ky privim që i mban shumë prej tyre në rrugën e duhur.

Para së gjithash, robi duhet të reshtë së supozuari se begatitë sjellin të mirën në mënyrë absolute. Nuk duhet harruar se; ato mund të jenë - si një thikë me dy tehe- shkaqe edhe për të mirën, edhe për të keqen. Megjithatë, besimtari duhet të gëzohet me mirësitë hallall për të cilat e falënderon Zotin. Nga ana tjetër, ai duhet të mendojë se privimi nga një begati që do ta çojë atë në shkujdesje ndaj Zotit, është në të vërtetë një mirësi hyjnore për të, dhe ai duhet të jetë mirënjohës edhe për privimin ndaj saj.



Në ditët e sotme ka shumë rëndësi që të arrihet pëlqimi i asaj që njeriu zotëron, sepse në kohën tonë, fatkeqësisht, materializmi dhe egoizmi e shtyjnë vazhdimisht njeriun drejt ekstravagancës dhe rënies në sy. E orienton atë drejt pasurisë materiale, famës dhe epshit. Njeriu nuk mendon se prirjet në fjalë janë në dëmin e tij. Secili dëshiron me çdo kusht të bëhet i pasur dhe i famshëm dhe të arrijë në pozita të larta.

Mirëpo në fakt, qëllimi i një besimtari nuk është pasuria dhe as postet e larta, por të arrijë të jetë një rob besnik dhe i kompletuar.



Besimtari, të cilit i caktohet pak prej kësaj bote, duhet të falënderojë duke menduar se; po të kishte më shumë, mund të bëhej

mendjemadh dhe të devijonte nga rruga e drejtë. Ai duhet të jetë mirënjohës se; po të kishte më shumë, ndoshta do t'i ngrinte krye Zotit të vet. Prandaj, duke kuptuar se edhe vuajtja edhe mirësia janë sprova, ai duhet të ruajë qetësinë e tij shpirtërore duke qenë i kënaqur me caktimin e Zotit.

Nuk duhet harruar se Karuni, i cili në fillim ishte një rob i drejtë, u llastua duke ia atribuuar vetes të mirat që i kishte dhënë Allahu si sprovë dhe u shkatërrua duke u varrosur nën tokë me thesaret e tij tek të cilat mbështetej.



Në jetën të shkurtër të kësaj bote, ku gjendemi për të kaluar sprovat hyjnore, ne duhet të mirëpresim çdo situatë që Zoti ynë ka caktuar për ne me falënderim, mirënjohje dhe pëlqim. Gjithashtu duhet të ruhemi nga admirimi i jetës së njerëzve të shkujdesur që janë të zhytur në kënaqësitë e egos. Në lidhje me këtë, Allahu i Madhëruar na jep këtë paralajmërim:

"Ti (o Muhamed) **mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!"** (Al-i Imran, 196-197.)



Shejh Sadi thotë:

"Vuajtjet që përjetojnë të mirët, do të kthehen në lehtësi. Kurse lumturia e të këqijve do të marrë fund."



Çdo besimtar duhet të punojë shumë për të fituar furnizimin e tij në rrugë hallall. Por ai duhet të dijë gjithashtu të kënaqet me sasinë e mjaftueshme për nevojat e tij dhe të falënderojë për atë

që ka. Ai duhet të jetë i kënaqur me furnizimin që Allahu ka caktuar për të, në mënyrë që Allahu të jetë i kënaqur me të.



Njeriu është një qenie me lakmi të pafundme. Kushti i parë për të shpëtuar këto lakmi është të ngulisë në zemër besimin se furnizimi, i cili është i paracaktuar në amshim, as do të rritet, e as do të pakësohet. Megjithatë, pasi të ketë punuar shumë dhe të ketë bërë të gjitha përpjekjet, besimtari duhet të jetë i kënaqur me furnizimin që i vjen nga Allahu.

Pa marrë parasysh se sa është ai furnizim, besimtari duhet të thotë: «Ajo që është më e mira për mua, është ajo që ka caktuar Zoti im.» Pastaj, ai duhet të shmangë shpërdorimin dhe të pasurohet me kënaqësinë e zemrës.

Në një ajet, Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar." (Hixhr, 21.) Këtu na bëhet e ditur se caktimi i gjithçkaje bëhet me vullnetin hyjnor dhe mbyll rrugën e lakmisë dhe ambicies për ata që kuptojnë...



Në një hadith thuhet:

"Pasuria e paktë për të cilën mund të shprehet mirënjohje është më e mirë se pasuria e shumtë për të cilën nuk bëhet falënderimi dhe mirënjohja sa duhet..." (Taberi, Xhamiu'l-Bejan, XIV, 370-372.)



Mirësia e vërtetë që do t'i sjellë dobi robit, është vetëm ajo e cila vlerësohet me falënderim dhe mirënjohje. Mirësitë që nuk vlerësohen dhe përdoren me shpërdorim dhe koprraci janë në

fakt, probleme dhe telashe. Njeriu i pakujdesshëm mendon se ajo është një mirësi, dhe lumturohet. E nëse privohet nga ajo, ai trishtohet. Kjo gjendje, tregon hutimin që sjell pandehma e mjerimit si lumturi dhe e lumturisë si mjerim.



Zemërimi ndaj ngjarjeve që shkaktojnë brengë dhe fatkeqësi, nuk përputhet me moralin e Islamit. Por, njeriu nuk mund të shpëtojë lehtë nga kjo dobësi njerëzore, derisa të mos ketë arritur kulmin e pjekurisë shpirtërore.

Kur ta pastrojë veten dhe të arrijë në gradën "Radije", u nënshtrohet dhe u dorëzohet pa mëdyshje të gjitha ligjeve të (kazasë së) vullnetit hyjnor, që mund të shfaqen në formë mirësie apo të keqeje, dhe nuk ankohet kurrë.



Allahu në Kuran thotë:

"Lufta është bërë detyrim për ju, ndonëse e urreni. Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini." (Bekare, 216.)



Mundësia e syrit për të parë dhe e veshit për të dëgjuar shkon deri në njëfarë kufiri. Është e pamundur të shikosh dhe të dëgjosh atë që është përtej atij kufiri. Edhe të kuptuarit e saktë të fatit e kalon mundësinë njerëzore, pasi ne i njohim ngjarjet dhe mundohemi t'i zgjidhim me arsye dhe pretekste. Se çfarë urtësie ka më pas nuk mund ta kuptojmë plotësisht.



Kushti kryesor i lumturisë është ta vendosësh mendjen nën udhëzimin e shpalljes, ta zbukurosh zemrën me moral të bukur dhe të jesh i kënaqur me caktimin e Allahut.



Kur e shohim nga horizonti i besimit dhe i diturisë; a jemi më pranë Allahut në pasuri apo në varfëri? Kështu, gjendjen që na afron më tepër me Allahun, duhet ta konsiderojmë më të mirë për veten tonë.



Ebu Bekri ka thënë:

"Për mua është më e pranueshme të jem me shëndet dhe të falënderoj, se sa të jem në sprovë dhe të duroj."



Imam Gazaliu thotë:

"aftësi e vërtetë është të durosh në kamje."



Shejh Sadi ka thënë:

"Allahu nuk është i kënaqur me atë që nuk është i kënaqur me caktimin e Tij."



Jeta është e mbushur me batica dhe zbatica; domethënë, me manifestime gëzimi dhe pikëllimi. Të gjitha këto janë sprova hyjnore. Ne duhet të jemi të kënaqur me gjykimin e Zotit tonë për ne, në mënyrë që Allahu i Madhëruar të jetë i kënaqur me ne.



Kur Omer bin Abdulazizi u pyet:

- Zotëri, çfarë ju pëlqen më shumë?

Ai u përgjigj:

- Gëzimi im është vetëm për kaderin tim. E dua çdo vendim të Allahut për mua..."

E në fakt, nëse një besimtar, nuk e sheh gjykimin dhe caktimin hyjnor për të si më të vlefshme se dëshira e tij, ai nuk mund të arrijë gjendjen e pëlqimit të vërtetë.



Ahmed ibn Hanbeli ka thënë:

"Për çdo gjë ka fisnikëri. Fisnikëria e zemrës është që të jetë e kënaqur prej Krijuesit dhe ta pranojë kaderin."



Devotshmëri e vërtetë është:

– Arti i të qenit i kënaqur me vullnetin e Allahut të Madhëruar.

– Aftësia për të qëndruar mik me Allahun në çdo kohë dhe vend.

– Aftësia për të mos thyer ekuilibrin përballë baticave dhe zbaticave, ndryshimit të kushteve dhe surprizave të jetës dhe harresa e ankesës dhe qarjes.



Sulejman ﷺ, mirësitë dhe mundësitë e jashtëzakonshme që i kishte falur Allahu, i përdori si një amanet në rrugën e Allahut dhe ishte mirënjohës. Për këtë Allahu i Madhëruar e lavdëron atë me këto fjalë: **«...Një rob i mrekullueshëm...!»** (shih. Sad, 30-40.)

Po ashtu, edhe në lidhje me Profetin Ejjub ﷺ, të cilin e kishte sprovuar me vështirësi ekonomike dhe sëmundje, Allahu i Madhëruar thotë: **«...Një rob i mrekullueshëm...!»** (shih. Sad, 41-44.)

Kjo do të thotë s;e «agnija-i shakirin», të pasurit falënderues dhe «fukara-i sabirin», të varfrit durimtarë që pajtohen me gjendjen e tyre, janë në të njëjtat nivele të virtytit në aspektin e arritjes së kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut.

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Sa bukur është kur të pasurit tregojnë modesti duke shpresuar në shpërblimin e Allahut të Lartmadhëruar. Por akoma më bukur është kur i varfëri, duke u mbështetur tek Zoti i Lartmadhëruar, tregohet sy ngopur përballë të pasurve."

"Ndershmëria është stolia e të varfrit, ndërsa falënderimi është stolia e të pasurit."

"O Zot! Tek Ti mbështetem nga intriga e varfërisë dhe pasurisë!" (Muslim, Dhikr, 49.)

"Mjaftueshmëria është një thesar që nuk ka të mbaruar." (Dejlemi, III, 236/4699.)

Është qetësimi i zemrës duke u pasuruar shpirtërisht si rezultat i afrimit me Allahun Teala, sepse zemra që pasurohet me bindje dhe istigna, qetësohet nga shqetësimet dhe frikat e kësaj bote.

Shejh Said thotë:

"Uthulla dhe lakërishta e fituar me djersën e ballit, është më mirë se buka e freskët dhe qengji i agait të fshatit."

"Mos lakmoni atë që kanë të tjerët dhe mbretëroni në lirinë e të qenit të kënaqur me ato që zotëroni! Kush braktis lakminë, i shtohet nderi dhe dinjiteti."





DASHURIA DHE URREJTJA PËR HIR TË ALLAHUT

Dashuria është detyrimi i shpirtit ndaj shpirtit. Kurse detyrimi i trupit ndaj trupit nuk është dashuri, por epsh.

Ashtu siç kujdesemi që të mos na hyjë në stomak asnjë kafshatë haram, duhet të kemi kujdes që edhe në zemër të mos na hyjnë dashuria për ata që s'e meritojnë.

Në një ajet urdhërohet:

"...Ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç'i duan idhujtarët idhujt e tyre)..." (Bekare, 165.)

Kulmi i dashurisë është dashuria për Allahun, «el-Uedud» dhe për të Dërguarin e Allahut, i cili është i dashuri i Tij. Një jetë që nuk është gjallëruar nga dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, por është robëruar nga dashuria për gjërat kalimtare, do të thotë se është një jetë e çuar dëm në shkujdesje - Zoti na ruajt -.

Duke përqendruar të gjitha rrezet diellore në një pikë të vetme, lupa bën pluhur e hi çdo gjë që ndodhet poshtë saj. Edhe dashuria hyjnore e përqendruar tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, shkrumbon të gjitha dëshirat egoiste. Kështu, çdo sëmundje që ka depërtuar në shpirt, pastrohet dhe zemra bëhet dimensioni i manifestimit të emrave të bukur të Allahut.

Besnikëri e vërtetë, do të thotë që: si rezultat i ndjenjës së mirënjohjes dhe falënderimit ndaj Allahut të Madhëruar, të jetosh me ndjenjën e dashurisë, respektit, lutjes dhe falënderimit edhe ndaj të Dërguarit të Allahut, të gjithë profetëve, familjes dhe shokëve të Profetit, e më pas ndaj të gjithë besimtarëve të drejtë që kanë shërbyer në përcjelljen e fesë deri tek ne, mësuesve dhe

dijetarëve që udhëzojnë zemrat tona, prindërve, të afërmve dhe vëllezërve tanë të fesë.

Nëse nuk e lartësojmë dashurinë e Allahut mbi dashurinë për të tjerët, ne nuk mund të arrijmë një besim të vërtetë dhe rrugën e drejtë. Ne mund të shijojmë kënaqësinë e dashurisë dhe miqësisë hyjnore aq sa mund t'i kapërcejmë edhe pasionet dhe dashuritë tona të kësaj bote.

Lum besimtarët që e vendosin dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij mbi çdo dashuri të vdekshme dhe që nuk mashtrohen nga lulet e rreme të kopshteve të egra!

Një besimtar që e do Allahun do të sprovohet në shumë raste për sa i përket sinqeritetit të tij në këtë dashuri. Njësoj si të godasësh arin mbi gurin e provës dhe të dallosh të vërtetin nga i rremi...

Jeta përbëhet nga një tufë provash me anë të të cilave sprovohet sinqeriteti në besim dhe dashuria për Allahun në zemër. Në raport me suksesin e tij në këto sprova, besimtari bëhet rob i afërt me Zotin e tij, madje mik i Zotit të tij dhe arrin dhuntitë e jashtëzakonshme të miqësisë së vërtetë.

Ibrahimi kaloi nëpër sprova të rënda në rrugën drejt miqësisë me Allahun. Allahu i Madhëruar i dhuroi jetës, pasurisë dhe pasardhësve të tij mirësi dhe favore të jashtëzakonshme. Ai e bëri zjarrin të ftohtë dhe të sigurt për të. Ai i dha begati të madhe pasurisë dhe pronës së tij.

Aq sa besimtarët filluan të urojnë njëri-tjetrit për begati duke thënë: «Allahu i dhëntë begatinë e Halil Ibrahimit!»

Duhet të mendohet; çfarë mund t'i japë një i vdekshëm një të vdekshmi tjetër? Secili mund të dhurojë vetëm aq sa zotëron.

Nga ana tjetër, Zoti i Plotfuqishëm, Zoti i botëve, u jep begati dhe favore jashtë imagjinatës miqve të tij, të cilët mund të heqin dorë nga interesat e tyre të vdekshme, të kësaj bote dhe interesat personale për hir të kënaqësisë hyjnore.

Çmimi më i rëndë në jetë, paguhet për hir të dashurisë, sepse njësia matëse e një dashurie të vërtetë është sakrifica. Dhe treguesi më i rëndësishëm i dashurisë për Allahun, është se sa rrezik mund të marrë një rob për Allahun dhe sa mund të sakrifikojë prej gjërave që i do kur është e nevojshme.

Imani është dashuria më e madhe. Dhe, dashuria kërkon prova. Treguesi i sinqeritetit në dashuri, është sakrifica dhe vështirësitë e duruara për hir të të dashurit. Një person që nuk mund të heqë dorë nga rehatia dhe interesat e tij për atë që dashuron, nuk dashuron në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Çdo mirësi e ka një çmim. Të pretendosh pronësinë e diçkaje për të cilën nuk ke paguar, qoftë ajo materiale apo shpirtërore, është absurde. Pasuria më e vlefshme për të cilën duhet të paguajmë në këtë botë është besimi ynë.

Allahu i Madhëruar, pas besimit, kërkon nga robi i Tij vepra të mira, sepse besimi nuk duhet të mbetet me fjalë; ekzistenca e tij duhet vërtetuar duke jetuar. Lidhur me njerëzit e pakujdesshëm,

të cilët pretendojnë dashurinë me gjuhën e tyre dhe jetojnë larg të vërtetës së saj, Mevlana thotë: «Mos u bëni palaço të fjalëve tuaja!».

Njeriu shfaq pasion dhe admirim ndaj atij të cilit i ka dhënë zemrën. Dashuria kërkon sakrificë. Falë sakrificës, edhe adhurimet bëhen më të ëmbla, e veprat sjellin paqe.

Nga dashuria, vuajtjet bëhen të ëmbla. Bakri bëhet flori nga dashuria. Sëmundjet e pashërueshme shërohen nga dashuria. Të vdekurit ngjallen nga dashuria. Vuajtjet dhe fatkeqësitë bëhen gëzim nga dashuria. Mundimet bëhen mëshirë për shkak të dashurisë. Kur nuk ka dashuri, edhe qiriu bëhet hekur.

Shumë urtësi dhe të vërteta që nuk mund të arrihen me dije dhe mendja, mund të arrihet me një zemër të pjekur. Dhe, kapitali më i rëndësishëm i kësaj, është një dashuri e pastër dhe e sinqertë. Në tasavuf, mjeti më i vlefshëm i arritjes shpirtërore, është dashuria. Ndërsa rezultati i saj është edukata, pra respektimi i edukatës së devotshmërisë në çdo fazë të jetës.

Të mos harrojmë kurrë se; dështimet e mendjeve të mangëta me filozofi sakate, nuk do ta shpëtojnë dot robin në frymën e fundit, në varr, në ditën e gjykimit, në mahsher, mizan dhe sirat. Mirëpo, dashuria e thellë, nënshtrimi i sinqertë dhe bindja e sinqertë ndaj Allahut dhe të Dashurit të Tij do të jenë kapitali i vetëm i zemrës për lumturinë e përjetshme.

Shkrimi i shkruar mbi një akull, shkrihet nga dielli. Por, sado e vështirë të jetë, shkrimi mbi një gur graniti është i përhershëm. Kështu pra, edhe ne duhet të shkruajmë dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij në zemrat tona ashtu si shkrimi në granit. Dhe, është shkruar apo jo në zemrat tona, këtë do ta vërtetojë gjendja dhe sjellja jonë...



Është e pamundur të flitet për sinqeritetin e një dashurie që nuk është vërtetuar me sakrifica. I dashuri e konsideron si detyrë të bëjë sakrifica në masën e dashurisë së tij për atë që do. Shpenzimi për krijesat e Allahut është një nga manifestimet më të bukura të dashurisë për Allahun.



Mevlana ka thënë:

"Çfarë është ari, çfarë është jeta, çfarë është perla dhe merxhani, nëse nuk shpenzohen për dashurinë dhe nuk sakrifikohen për Një Bukuri!"



Një herë, Profeti ﷺ, tha:

"Sa kam pasur dobi prej pasurisë së Ebu Bekrit, nuk kam pasur dobi nga pasuria e askujt tjetër..."

Ky sahab, që ishte shembulli i besnikërisë dhe kishte sakrifikuar çdo gjë në rrugën e Profetit ﷺ, duke vërejtur në shprehjen e Resulullahut një dualizëm në dukje, me lot në sy tha:

"O Resulullah! A nuk të përkasim ty unë dhe pasuria ime?!"
(Ibn Maxhe, Mukaddime, 11; Ahmed, II , 253.)



Kush dashuron me sinqeritet dhe vërtetësi, edhe nëse jep jetën për hir të atij që dashuron, ai përsëri nuk mendon se ka bërë një sakrificë. Ai e zbukuron gjithë qenien e tij, sikur po paguan ndonjë borxh. I tillë është shërbimi, mundi dhe sakrifica që një besimtar i vërtetë duhet të bëjë për Allahun.

Kush nuk njeh dashurinë dhe miqësinë dhe nuk merr atë që i takon, do të thotë se nuk ka arritur maturinë e duhur dhe jeton me epshin e tij. Zemra e atij që nuk di të dashurojë, është si lënda e parë e tokës së papunuar. Thelbi i punës është të duash, i ekzistencës qëndron në dashuri.

E gjithë fitorja e Mexhnunit, i cili është ngritur nga dashuria metaforike në dashurinë e vërtetë, është se ai nuk e merr Lejlën si stacion të fundit në rrugën drejt Zotit. Lejla, ndonjëherë përfaqëson gjininë e kundërt, e ndonjëherë pasurinë, gradat dhe pozitat. Por, sa e trishtueshme është ta kthesh mjetin në synim!..

Dashuria e përkohshme, ka vlerë aq sa ndihmon në rrugën drejt dashurisë ndaj Allahut. Dashuria në kuptimin e saj të vërtetë është pasioni i shpirtit ndaj shpirtit. Kurse pasioni i trupit për trupin nuk është dashuri, por epsh.

Mevlana thotë:

«Ki mëshirë! Sa gjë e bukur është dashuria! Janë zakonet e tua të këqija që e dëmtojnë atë. Ti e quajte epshin dashuri! Ah sikur ta dinit, sa e largët është distanca midis epshit dhe dashurisë! Dashuria hyjnore e mban zgjuar besimtarin. Dashuria e kësaj bote dhe sensuale, nga ana tjetër, e bën njeriun budalla dhe torollak.”

Zemra vishet me ngjyrën, formën dhe harmoninë e mjedisit ku ndodhet, vetëm se kjo gjendje është faza fillestare e hedhjes rrënjë dhe vendosjes së ndikimeve të caktuara në zemër. Ndikimet pozitive ose negative të më pasme, për shkak të ngjashmërisë ose kundërshtisë me të mëparshmet, mund të jenë edhe pozitive, edhe negative. Por, në qoftë se në fillim zemra nuk vihet nën ndikime të mira për t'u sjellë në një konsistencë të caktuar, ndodhet nën një rrezik të madh. Sepse zemra e bërë objekt i ndikimeve të jashtme, ose mbetet nën ndikimin e tyre në raport të drejtë me afërsinë që tregon ndaj tyre, ose luan një rol kundërshtues ndaj tyre gjithashtu në raport të drejtë me neverinë që ndjen ndaj tyre.

Shejh Sadi thotë:

"Kur shikohet me sy armiqësor, edhe aftësia dhe zgjuarsia shihen si një turp. Dielli, i cili ndriçon Tokën, duket i shëmtuar për syrin e lakuriqit të natës. Nëse njeriu nuk e do dikë dhe e shikon me urrejtje, ai do t'i duket i shëmtuar edhe nëse është i bukur si Jusufi. Por, nëse ai e shikon atë me syrin e dashurisë, edhe shejtani do të duket si melek në sytë e tij."

Ashtu siç fizika nuk e pranon zbrazëtinë, as zemrat nuk e pranojnë zbrazëtinë. Siç thotë Imam Shafiu: «*Nëse nuk e angazhoni shpirtin tuaj me të vërtetën, do t'ju pushtojë e pavërteta.*»

Prirjet dhe animet e njeriut, janë pasqyra e tij. Njeriu mendon dhe thur ëndrra për atë që kërkon. Thënë me fjalët e Rumiut: *"Njeriu vlerësohet në bazë të asaj që kërkon."*

Prandaj, kujdes! Çfarë po kërkojmë? Cili është drejtimi i

kërkimeve tona, dynjaja apo ahireti? A është kursi i ëndrrave tona në vijën e egos, apo në vijën e shpirtit?

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Një person ka vlerë aq sa dëshirat dhe ëndrrat e tij."

"Kushdo që ka si dëshirë të vetme gjërat që hyjnë në stomak, edhe vlera e tij është sa gjërat që dalin prej stomakut të tij!"

Mevlana Xhelaledin Rumi ka thënë:

"O vëlla! Ti duhet të gjallërohesh me meditim. Trupi yt i përbërë prej mishi dhe kocke, është i njëjtë edhe tek kafshët. Nëse meditimi yt është trëndafil, atëherë ti je në kopshtin e trëndafilave. Pra, je në xhenetin e kësaj bote. Por, nëse meditimi yt është gjemb, ti s'je veçse një trung për t'u djegur."

Ashtu si gjurma e gishtit që luan rolin e një identiteti material, ashtu edhe bota e meditimit të njeriut, formon identitetin e tij shpirtëror.

Meditimi mbi çështjet hyjnore e pastron zemrën dhe rrit nivelin e kënaqësisë shpirtërore, e ruan njeriun nga kurthet e egos dhe i hap atij horizonte të reja urtësie.

Ashtu si prishet motori i një makine nëse i hedhim ujë në vend të benzinës, edhe bota shpirtërore e zemrës ndotet nëse e ushqejmë me gjëra boshe të cilat nuk përmbajnë asnjë urtësi në vetvete. Prandaj, është shumë e rëndësishme të bëhet ndarja midis gjërave të dobishme dhe të padobishme.

"Mendja dhe zemra", të cilat janë qendra e mendimit dhe ndjenjës në trupin e njeriut, janë si një basen. Siç shprehet edhe i ndjeri Nexhip Fazëll, "ulluqet që mbushin këtë basen janë dy; prej njërit rrjedh dritë, prej tjetrit ndyrësi...". Pra, nëse prej këtyre tubave kalojnë gjithmonë dëshira egoiste, lakmi dhe indiferentizëm, bota jonë e brendshme do të kthehet në një plehërishte. Por, nëse prej këtyre tubave kalojnë burime të frymëzimit shpirtëror, zemrat shndërrohen në një oqean urtësie...

Në këtë botë, gjithçka ekziston bashkë me të kundërtën e saj. Për shkak se e kundërta e dashurisë është urrejtja, të urresh ato që nuk i do Allahu, është kriteri më i natyrshëm i dashurisë ndaj Allahut.

Të urresh ata që nuk i do Allahu, po aq sa të duash Allahun dhe ata që do Ai, është kusht i një besimi të shëndoshë. Të mos bartësh ndjenja urrejtjeje dhe kundërshtimi ndaj së keqes dhe së kotës, në të njëjtën masë që bart dashuri për Allahun dhe të mirën, është tregues i një dobësie dhe të mete në besim.

Besimi kërkon dashuri për atë që meriton dhe urrejtje për atë që e ka hak. Pra:

– Të urresh Nemrudin aq sa do Ibrahimin.

- Të urresh faraonin po aq sa do Musain.

- Të urresh Ebu Xhehlin po aq sa do Profetin.

Nisur nga kjo, në suren Tebbet, ne këshillohemi të urrejmë Ebu Lehebin, i cili ishte një politeist i egër, pavarësisht se ishte xhaxhai i Profetit tonë ﷺ.

Isai ﷺ, ka thënë:

"Bëhuni miq të Allahut, duke u bërë armiq të mohuesve të Zotit! Qëndroni afër Zotit, duke u qëndruar larg mohuesve të Tij dhe fitoni kënaqësinë e Allahut duke i urryer ata!.."

Nëse humbet ndjenja e urrejtjes për hir të Allahut, si rezultat i imitimit të mënyrës materialiste të jetesës së jomyslimanëve, dalëngadalë do të fillojnë të zhduken edhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet nesh dhe atyre. Nëse besimin do ta konsideronim si një litar, kur të dobësohej ndjenja e kundërshtimit për hir të Allahut, fijet e litari do të fillonin të këputeshin një e nga një.

Ashtu si zemërimi i pavend, që bëhet shkak për trazira dhe ligësisë, edhe të mos zemërohesh për hir të Zotit kur nevojitet zemërimi, pra kur shkelet e drejta dhe duartrokitet shtypja, është një dobësi e besimit dhe e moralit që ka të njëjtin rezultat.

Zemërimi që buron nga nefsi, e që e shtyn njeriun të gabojë e të humbasë mendjen, duhet të edukohet dhe të përmirësohet. Të jesh i matur dhe i qetë në rast se sulmohet feja, imani dhe vlerat morale, nuk do të thotë se e ke përmirësuar dhe edukuar nefsin. Një veprim i tillë është një gaflet dhe huti. Aq sa është e rëndësishme të mundësh zemërimin për hir të Allahut, po aq e rëndësishme është edhe të zemërohesh në vendin dhe në kohën e duhur për hir të Tij.

Nëse zemërimi buron nga nefsi, kjo është fatkeqësi; është degë e marrëzisë dhe një gjendje e shëmtuar, sepse një zemërim që buron nga egoja, e eliminon mendjen dhe e bën njeriun lodër

të shejtanit. Por, nëse zemërimi është për Allahun dhe buron nga besimi, atëherë ai kthehet në një virtyt të madh që e dërrmon shejtanin.

Besimtari nuk duhet ta kuptojë urrejtjen për hatër të Allahut, si një zemërim të thatë e pa arsye. Ai duhet të dijë shumë mirë ku dhe kur duhet të zemërohet. Duhet të kujdeset për burimin e zemërimit të tij. Ta ketë të qartë; nëse zemërimi lidhet me nefsin apo me besimin e tij. Kur zemërimi është nga nefsi, ai të shkatërron. Ndërsa, kur ai është për Allahun e Lartmadhëruar, të lartëson.

Në lidhje me këtë, veprimi i Aliut ﷺ, kur ai po luftonte me një mohues, është një shembull i përsosur. Kur Aliu ﷺ, fitoi dyluftimin ndaj një mohuesi dhe po bëhej gati t'i jepte goditjen e fundit, mohuesi e pështyu me qëllim përçmimi. Atë çast, Aliu ﷺ, ndaloi dhe ia fali jetën. Mohuesi, i çuditur nga veprimi i Aliut ﷺ, e pyeti:

- O Ali! Pse ndalove, tek ishe bërë gati të më vrisje? Çfarë të ndodhi që nga një gjendje zemërimi, u qetësove në çast? Pse u bëre si një mot i kthjellët ndërsa po shkreptije si një vetëtimë? Ç'ishte ky ndryshim i papritur?

Aliu ﷺ, i dha këtë përgjigje:

- Unë luftoj veç në rrugë të Allahut të Lartmadhëruar. Ua pres kokat armiqve të Allahut për hatër të Tij. Këtë gjë kurrë nuk e përziej me nefsin/egon time... Duke më pështyrë, ti dëshirove të më përçmosh dhe të më nervozosh. Sikur të nervozohesha atë çast, do të vrisja për hatër të nefsit tim; një arsye kjo shumë e ulët. Por unë nuk luftoj për të kënaqur egon time, por për hatër të Allahut të Lartmadhëruar. Ky virtyt i Aliut ﷺ, bëri që ai armik Islamit të bëhej mysliman.

"Është plotësuar besimi i atij që do dhe urren për hir të Allahut dhe që jep e nuk jep për hir të Allahut." (Tirmidhi, Sifatu'l Kijame, 60.)


Abdullah ibn Abbasi ka thënë:

"Atë që do, duaje për hir të Allahut! Atë që braktis, braktise për hir të Allahut! Dije se kështu fitohet kënaqësia e Tij. Sot, për fat të keq, njerëzit janë bërë shumë materialistë. Dashuria dhe urrejtja e tyre lidhen vetëm me interesat e kësaj bote..."

Kur shkojmë për të vizituar një mik, dëshirojmë t'i çojmë atij një dhuratë që i pëlqen. Kriteri më e rëndësishme e dashurisë, është të duash ata që do ai dhe të urresh ata që urren ai.

Nëse meditojmë lidhur me këtë kriter, mund të themi se:

Të gjithë jemi udhëtarë në rrugën drejt Allahut ﷻ, i Cili kërkon një zemër të pastër prej nesh. Pra, çfarë lloj zemre do t'i paraqesim Atij?



QËNDRIMI ME NJERËZIT E MIRË DHE TË DEVOTSHËM

Një fllad ere, që fryn mbi një kopsht të zbukuruar me lule të bukura dhe aromë të mirë, si trëndafilat dhe karafilat, kudo që shkon, shpie edhe aromën e tyre që kënaq zemrat e njerëzve. Ndërsa një erë që fryn mbi kalbësira me erë të keqe, do t'i përhapë ato aroma të këqija kudo përreth. Në këtë mënyrë, ajo ua zë frymën dhe ua ngushton kraharorin njerëzve. Për rrjedhojë, edhe miqësia me njerëzit e këqij dhe gjynahqarë, bëhet kanceri i jetës shpirtërore.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Njeriu është në fenë e shokut të tij. Prandaj, secili prej jush duhet të bëj kujdes se me kë shoqërohet!" (Tirmidhi, Zuhd, 45.)

Prandaj besimtari duhet ta ndërtojë miqësinë mbi perspektivën e besimit.

Zakonisht, ata që e çojnë njeriun në rrugën e drejtë ose të gabuar, janë ata me të cilët shoqërohet. Kjo do të thotë që; nëse personi me të cilin shoqëroheni është i mirë, ju do të arrini mirësi; nëse ai është gjynahqar, do të pësosh fatkeqësi në çdo aspekt.

Nëse një person qëndron me njerëz të mirë, ai priret të jetë mirë, dhe e kundërta; nëse shoqërohet me njerëz të këqijtë, ai do priret për vepra të këqija.

Të formosh miqësi, do të thotë të familjarizohesh me rrethin dhe të ndikohesh prej tij, gjë e cila është në natyrshmërinë e njeriut. Mirëpo, është e domosdoshme të bëjmë kujdes me kë miqësohemi dhe të jemi të vetëdijshëm në lidhje me ndikimet pozitive e negative me të cilat mund të përballemi.

Një fllad ere, që fryn mbi një kopsht të zbukuruar me lule të bukura dhe aromë të mirë, si trëndafilat dhe karafilat, kudo që shkon, shpie edhe aromën e tyre që kënaq zemrat e njerëzve. Ndërsa një erë që fryn mbi kalbësira me erë të keqe, do t'i përhapë ato aroma të këqija kudo përreth. Në këtë mënyrë, ajo ua

zë frymën dhe ua ngushton kraharorin njerëzve. Për rrjedhojë, edhe miqësia me njerëzit e këqij dhe gjynahqarë, bëhet kanceri i jetës shpirtërore.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Vetmia është më e mirë se shoku i keq. Ndërsa shoku i devotshëm është më i mirë se vetmia..." (Hakim, III, 343.)

Miku më i mirë, është njeriu i devotshëm që thotë: "Eja, vëllai im! Të bëjmë edhe një punë të mirë për Allahun sa të kemi mundësi; ta lëmë përtacinë dhe ta shtojmë edhe pak zellin për devotshmëri..."

Ndërsa miku më i keq, është njeriu i shthurur që të thërret për shkujdesje dhe egoizëm duke thënë: "Eja, miku im! Ta shijojmë këtë jetë edhe pak sa të kemi mundësi; të argëtohemi dhe të kënaqemi sot..."

Ai që na buzëqesh dhe na komplimenton për të na çuar në rrugë të gabuar dhe na fton në gjërat që i pëlqejnë egos, në të vërtetë nuk është miku, por armiku ynë, i cili dëshiron që ne të vuajmë humbjen e përjetshme. Kurse ai që na paralajmëron me fjalë që nuk i pëlqejnë egos sonë për të na sjellë në rrugën e drejtë, është miku ynë i vërtetë, i cili dëshiron lumturinë tonë; shpëtimin tonë të përjetshëm.

Sa bukur e ka shprehur Profeti ﷺ, rëndësinë e qëndrimit me të sinqertët dhe atë të ruajtjes nga përzierja me gjynahqarët:

"Shembulli i shokut të mirë dhe atij të keq është si ai që bart aromë të mirë dhe ai që punon si farkëtar. Mbartësi i aromës së mirë, ose do të dhurojë një aromë të mirë, ose do t'ia blesh, ose atij

do t'i vijë aromë e mirë. Ndërsa farkëtari, ose do të djegë rrobat, ose do të ngjisë erën e keqe." (Buhari, Buju, 38.)

Të duash njerëzit e drejtë dhe të qëndrosh larg njerëzve gjynahqarë, e lumturon njeriun shpirtërisht. Në të kundërtën, të duash ata që nuk janë të denjë për t'u dashur dhe të urresh besimtarët e drejtë, e bën njeriun të mjerë. Për këtë arsye njeriu duhet të jetë jashtëzakonisht i kujdesshëm se kë do dhe kë urren.

Ashtu si çdo zog fluturon me llojin e vet, çdo karakter gjen paqe me të ngjashmin e vet. Për këtë arsye, ekuivalenca e zemrës dhe uniteti i zemrës mes njerëzve me të cilët duhet të shoqërohet është shumë më i rëndësishëm se ekuivalenca materiale dhe afërsia e sipërfaqësore.

Të shoqërohesh me robërit e drejtë dhe besnikë të Allahut, ka vlerën e një thesari shpirtëror. Në të kundërtën, të shoqërohesh me jobesimtarë që nuk i do Allahu, të cilët janë robër të besëtytnive, njerëz të shkujdesur dhe skllevër të egos, është një fatkeqësi shpirtërore që helmon shpirtin.

Në një ajet urdhërohet:

"....Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në ruajtjen nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!..." (Maide, 2.)

Pra, aq sa është e pranueshme të bashkohemi dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin në mirësi e devotshmëri dhe të jemi një "bashkësi" që shumëfishon mirësinë, po aq e papranueshme është të jesh një "organizatë/sekt" që bashkohet në të keqe dhe hasmëri dhe shumëfishon të keqen.

Besimtari duhet t'i kushtojë vëmendje rrethit të tij për të mbrojtur besimin dhe moralin e tij. Në mënyrë të veçantë, ai duhet t'i përmbahet kësaj në zgjedhjen e arsimit, martesës dhe profesionit, të cilat janë pikat e kthesës së jetës së tij.

Gjatë zgjedhjes së shkollave ku do të shkollohen fëmijët e tij, besimtari duhet t'i kushtojë rëndësi të madhe gjendjes shpirtërore të mësuesit dhe shokëve të shkollës.

Kur blini një shtëpi, duhet t'i kushtoni vëmendje dy gjërave:

"Të jetë afër xhamisë dhe të ketë fqinj të mirë."

Parimet që ndjekim gjatë jetës, janë të njëjta edhe për pas vdekjes: *"Të dashurit tuaj që ndërrojnë jetë, varrosini mes njerëzve të drejtë. Ashtu si një i gjallë shqetësohet nga një fqinj i keq, ashtu edhe një i vdekur shqetësohet nga një fqinj i keq."* (Ebu Nuajm, Hilje, VI, 354.)

Kjo është edhe arsyeja që varri i Ebu Ejub el-Ensariut në Stamboll dhe varret e liderëve të mëdhenj shpirtërojë në shumë qytete, janë shndërruar në varrezë qyteti nga ata që duan të jenë fqinjët e tyre.

Në natyrë ekzistojnë disa rrezatime që nuk mund të shihen nga syri i lirë, si: alfa, beta, gama, ultravjollcë, etj. Edhe pse ne nuk mund t'i shohim, secila prej tyre ka një efekt apo ndikim të posaçëm. Në mënyrë të ngjashme mund të flitet edhe për disa efekte të zemrës dhe të syrit. Disa prej tyre janë ndikime pozitive që i quajmë fejz apo ruhanijet (përshpirtshmëri), të tjera janë negative që i quajmë gaflet, kasvet (shkujdesje, ashpërsim i zemrës).

Lidhur me këtë, Krijuesi Fuqiplotë shprehet:

"O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)**!"** (Teube, 119.)

"...Mos rri me keqbërësit!" (En'am, 68.)

Njeriu ka prirjen për të imituar. Kjo mund të jetë pozitive ose negative. Kështu, njeriu e zgjedh atë që do të imitojë sipas nivelit të tij shpirtëror. Për shembull, një person i ulët, imiton ata që janë në krye të punëve të ulëta; vishet si ata, përpiqet të duket dhe të sillet si ata.

Por, nëse është besimtar i drejtë, ai merr si shembull profetët, dijetarët dhe të devotshmit. Ai përpiqet të imitojë gjendjen e tyre, fjalët, uljen, qëndrimin në këmbë, etj.

Ahmed ibn Hanbeli ka thënë:

"Nuk ka gjë më të dobishme për njeriun, sesa të qëndrojë bashkë me të devotshmit, në mënyrë që ta rregullojë zemrën dhe të arrijë begatinë e prehjen shpirtërore."

Ashtu siç përhap radiacion atomi kur ndahet, ashtu është edhe energjia që del nga zemra. Ashtu siç ekzistojnë rrezet e dobishme që nuk shihen me sy dhe prej tyre ka përfitime në fusha të ndryshme, si mjekësia, teknologjia, etj., ashtu ekzistojnë edhe rrezet të dëmshme që e dëmtojnë rëndë njeriun dhe natyrën. Pra, në saje të këtyre shembujve është shumë e lehtë ta kuptojmë ndikimin shpirtëror të shoqërisë dhe ushqimit.

Dashuria dhe miqësia lindin afërsi mes zemrave. Kjo afërsi, me kalimin e kohës çon në njësimin e tyre. Hapi i parë që duhet bërë në rrugën drejt të qenit besnik, është të ushqeni dashuri për të devotshmit dhe të jeni në kuvendin e tyre të bisedave, brenda rrethit të miqësisë dhe afërsisë. Dhe, të jesh besnik, është rezul-

tati më i natyrshëm i kësaj, sepse aroma e trëndafilave përçohet edhe tek ai që shëtit në kopshtin e trëndafilave.

Një mik i vërtetë, është ai që ju shpëton nga kurthet e rrezikshme të egos suaj. Ai është një person që vendos sigurinë e jetës suaj shpirtërore dhe të përjetshme, përpara interesave materiale dhe kalimtare. Dikush që të paralajmëron për të të sjellë në rrugën e drejtë, qoftë edhe me fjalë që egos së tij nuk i pëlqen, është miku juaj i vërtetë.

Omeri ﷺ, ka thënë:

"Personi që dua më shumë, është ai që më njofton për të metat dhe të gabimet e mia".

Natyrisht, ky paralajmërim miqësor duhet të bëhet privatisht dhe në një gjuhë të përshtatshme, në mënyrë që të jetë një mjet përmirësimi për zemrën, e jo ta thyejë atë.

Bilal bin Sa'd, prej gjeneratës së Tabi'inëve, ka thënë:

«Miku që të shton devotshmërinë, është më i mirë se shoku që të vë një copë ari në dorë sa herë që takoheni.»

Ai që ka një mik të vërtetë, i cili e do për hir të Allahut, e paralajmëron për hir të Allahut, e mbron për hir të Allahut dhe e mban përdore për hir të Allahut në kohë të vështira, do të thotë se zotëron pasurinë më të çmuar në botë.

Ahmed ibn Habneli ka thënë:

"Nëse një njeri privohet nga një shok i sinqertë, kjo është një humbje e madhe për të."

Rumiu thotë:

"Bëhu mik me njerëzit e mirë, që të shtohet karvani i besnikëve, sepse sa më i madh të jetë ky karvan, aq më lehtë thyhen kusarët në udhë."

Vizitoni miqtë, sepse rruga në të cilën nuk kalon njeri, kaplohet nga ferrat.

Xhaferi ﷺ, ka thënë:

"Konsultohu me njerëzit e devotshëm para se të ndërmarrësh ndonjë veprim."

Të shohësh besimtarë të zellshëm dhe të marrësh pjesë në entuziazmin e tyre të besimit dhe ndjeshmërisë ndaj takvasë, dhe kështu të zgjohesh nga gjumi i pakujdesisë, është një mirësi e madhe. Kjo gjendje është një mjet i ringjalljes dhe frymëzimit shpirtëror, ashtu si rimbushja e një pajisjeje që i ka mbaruar energjia.

Për këtë arsye, në tasavuf, që do të thotë edukim shpirtëror, frekuentimi i kuvendeve të të devotshmëve dhe qëndrimi bashkë me ta me intervale të rregullta, është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Ashtu si trupi ka nevojë për ushqim material, edhe shpirti ka nevojë për ushqim shpirtëror. Secili prej adhurimeve është në formën e vitaminave që i jepen shpirtit. "Biseda Fetare", është një

nga metodat më të rëndësishme të edukimit shpirtëror, e po ashtu edhe një sofër shpirtërore që përforcon frymëzimin e zemrës.

Prandaj mund të themi që; sohbetet që bëhen sipas shembullit të Profetit tonë të nderuar, janë një vazhdim i traditës profetike. Gjendja shpirtërore që krijohet në sohbete është një fllad ere që vjen nga sohbetet e Resulullahut. Kjo ngjan me qiriun i cili i jep dritë edhe qirinjve të tjerë... Zjarri që ndez qirinjtë dhe që ndriçon ambientin, është i njëjti zjarr. Besimtari, edhe nëse ndriçohet nga qiriu i fundit, ai gjithsesi është ndriçuar nga i njëjti zjarr.

I Dërguari i Allahut ﷺ, i edukoi shokët e tij me ligjëratat e tij. Prandaj, është e mundur të thuhet se; ajo që e bën një sahab "sahab", është përsosmëria që kanë arritur ata falë begatisë së ligjëratave profetike. Në fakt, fjalët «sohbet/bisedë, ligjëratë» dhe «sahab» vijnë nga e njëjta rrënjë. Në këtë aspekt, biseda, e cila është një mjet frymëzimi shpirtëror dhe është përcjellë prej epokës së Lumturisë deri më ditët tona, është sunet mueked.

Përveç haditheve që dilnin nga goja e bekuar e Profetit, sahabët u përsosën duke përfituar edhe prej gjendjes së tij shpirtërore. Kjo, sepse dashuria ndërton një linjë midis zemrave. Dhe në këtë lidhje dashurie ndodhin shumë shkëmbime të përzemërta, bekime, shfaqje dhe frymëzime shpirtërore. Në fakt, ky është edhe qëllimi kryesor i bisedave fetare. Bisedat janë një lloj transferimi i gjendjes shpirtërore. Përndryshe, njeriu mund të lexojë edhe një libër në shtëpi.

Mirëpo, ai nuk mund ta marrë asnjëherë frymëzimin shpirtëror që do të merrte në bisedat fetare. Me fjalë të tjera, në bisedë, ekziston një energji që reflektohet midis zemrave. Dhe qëllimi është të arrijmë të përfitojmë prej asaj energjie.

Gjatë bisedave, sahabët e dëgjonin Profetin ﷺ, me një entuziazëm dhe një vëmendje aq të madhe, sikur të kishin ndonjë zog mbi koka dhe do t'u ikte nëse lëviznin.

Prandaj, një bisedë e vërtetë nuk ka të bëjë vetëm me leximin e një libri, predikimin dhe dhënien e këshillave dhe dëgjimin e tyre. Përfitimi i vërtetë në bisedat shpirtërore nuk buron nga rreshtat e librit, por nga përhapja e gjendjes nga njëri tek tjetri.

Kuvendi i bisedave, është një qendër rehabilitimi dhe marrëdhënieje shpirtërore. Junus Emre thotë; "Biseda me të devotshmit e shton përsosmërinë shpirtërore..." Prandaj, mund të thuhet se; bisedat shpirtërore nuk janë veprimtari e përcjelljes së informacionit në mendje, por një përhapje gjendjeje shpirtërore që rrit dritën e sinqeritetit, takvas, dashurisë dhe diturisë në zemër. Për këtë, të mëdhenjtë tanë thonë: «Rruga jonë është ajo e bisedës shpirtërore».

Lukman Hakimi i dha këtë këshillë djalit të tij:

"Biri im! Shoqërohu me njerëzit e ditur dhe përpiqu të mos e braktisësh kuvendin e bisedave të tyre! Sepse Allahu i ngjall zemrat me dritën e urtësisë, ashtu siç ngjall tokën me shi." (Ahmed bin Hanbel, Kitabu'z-Zuhd, nr. 552.)

Ebu Bekri ka thënë: *"Bëhu skllav i njeriut të urtë që njeh Zotin!"*

Jusuf Has Haxhib thotë:

"Respekto të mëdhenjtë, që edhe ti të ngrihesh, por edhe lumturia e tyre reflektohet tek ty."

Rumiu ka thënë:

"Si mund ta gdhendë një thikë bishtin e saj nëse nuk gjendet një thikë tjetër? Andaj shko dhe tregoja plagët një kirurgu zemre. Ti nuk mund t'i shërosh vetë ato..."

"Shëndetin për ndjenjat dhe mendimet e kësaj bote mësoje nga mjeku. Ndërsa saktësinë e çështjeve hyjnore që e lartësojnë njeriun drejt pafundësisë, mësoje nga murshidi i përsosur."

Duke u bazuar në hadithin e Profetit ﷺ:

"*Besimtari, është pasqyra e besimtarit.*"[1], mund të themi se dijetarët e devotshëm janë një pasqyrë shumë e pastër për ne, dhe shpirti ynë e sheh thelbin e vetes dhe ekzistencës në këtë pasqyrë të shndritshme. Ata që janë të privuar nga një pasqyrë e tillë, jo vetëm që nuk i kuptojnë gabimet e veta, por nuk arrijnë as të zgjohen nga injoranca që i bën ta pandehin mjerimin lumturi.

"Dije se njeriu që nuk e ka zemrën të mbushur me dashurinë hyjnore, është shumë i shkretë; ndoshta është më poshtë se kafsha. E në fakt, edhe qeni i as'habu'l-kehfit që pati fatin të shoqërohet me njerëz të mbushur me dashuri hyjnore, u nderua duke u përmendur në Kuran bashkë me ata robër të veçantë."

Për ta mbrojtur zemrën nga çdo gjë që e largon atë nga Allahu dhe për të qenë gjithmonë me prirje pozitive, është e nevojshme të jeni në kontakt të ngushtë me njerëzit e drejtë dhe besnikë, prej të cilëve mund të frymëzohesh shpirtërisht.

Është e nevojshme që ne të tregojmë dashamirësi, miqësi dhe afërsi me njerëzit e takvasë, dijetarët dhe të urtët, në mënyrë që

1. Buhari, el-Edebu'l-Mufred, n. 238; Ebu Davud, Edeb, 49/4918.

ata të na çojnë drejt asaj përsosmërie. Përndryshe, është shumë e mundur që në vend të udhëzimit, të ekspozohemi ndaj devijimit.

Allahu i Madhëruar nuk i shikon me syrin e mëshirës vendet ku kryhen gjynahe dhe punë të padobishme. Madje, Sami Efendiu rekomandonte që të mos kalohet fare në rrugët e vendeve ku kryhen haramet dhe punët e papëlqyeshme.

Nga ana tjetër, Qabeja, Ravza, Mesxhidi Aksa, xhamitë dhe vendet e tjera ku gjenden të devotshmit dhe besimtarët, janë vende ku manifestohet mëshira dhe begatia hyjnore. Prandaj, është e domosdoshme të bëhet përpjekje për të përfituar nga frymëzimi shpirtëror i këtyre vendeve.

Profeti ﷺ, së bashku me sahabët e tij vendosën të pushonin në një zonë ku njëherë e një kohë kishte jetuar populli i Themudit. Sahabët morën ujë prej puseve të atij vendi për të kryer nevojat e veta. Po ashtu, me këtë ujë gatuan edhe brumë për bukë. Mirëpo, Profeti ﷺ, i urdhëroi ata t'i derdhnin enët me ujë dhe t'ua jepnin deveve brumin e gatuar. Më pas, u tha të merrnin ujë nga pusi ku kishte pirë deveja e Profetit Salih عليه السلام. (shih. Buhari, Enbija, 17.)

Edhe pse nga ajo kohë kanë kaluar me mijëra vite, akoma sot personat që kalojnë andej nuk e përdorin atë ujë për abdest, si rezultat i mallkimit hyjnor ndaj atij vendi.

Kjo do të thotë që, po aq sa duhet qëndruar larg femohuesit, të devijuarit apo të shkujdesurit, po aq duhet qëndruar larg edhe vendeve ku ka rënë mallkimi hyjnor për shkak të haramit dhe mosbindjes.

Në këtë botë sprovash, tregu për çdo produkt është i veçantë. Robi që kërkon lumturinë, duhet të qëndrojë larg nga bredhja nëpër pazaret e mjerimit dhe vështrimi i vitrinave egoiste dhe djallëzore.

Një besimtar duhet të shmangë rreptësishtë miqësinë me njerëzit e këqij dhe bredhjen në çdo vend ku ai e di se shkelen kufijtë hyjnorë, sepse, edhe nëse nuk përzihet në ndyrësitë e tyre, prania rreth tyre, e vë atë në pozitë të gabuar.

Imam Rabbani, jep një shembull të tillë:

"Ai që shoqërohet me kumarxhinjtë, ndoshta nuk luan kumar dhe mendon se nuk është ndotur. Mirëpo, për sa kohë që vazhdon të shoqërohet me kumarxhinjtë, ndikohet negativisht prej tyre dhe me kalimin e kohës fillon ta shohë normale kumarin, gjë që është një shkatërrim shpirtëror."

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Mos iu afroni zinasë!.." (Isra, 32.). Kjo, sepse ai që afrohet, ka shumë të ngjarë të bjerë në atë gjynah, e për këtë shkak ndjenja e tij e nderit do të dëmtohet.

Është një fakt i njohur se; ata që enden të shkujdesur në buzë të greminave, herët a vonë, këmbët e tyre do të rrëshqasin dhe do të rrëzohen. Në këtë aspekt, një nga faktorët më të rëndësishme që i bën njerëzit të rrëshqasin shpirtërisht, është afërsia me njerëzit gjynahqarë dhe të këqij.

Xhaferi ﷺ, thotë:

"Babai më edukoi me tre gjëra:

- Biri im! Kush shoqërohet me një shok të shkujdesur dhe gjynahqar, nuk do të jetë në paqe.

- Kushdo që hyn e del në vendet ku bëhen gjynahe do të jetë i dyshuar.

- Kush nuk i del zot gjuhës, do të pendohet!"

Musa efendiu këshillonte në këtë mënyrë:

"Njeriu i mençur duhet të mbrojë veten dhe të afërmit nga njeriu me moral dhe fe të dobët; duhet të mbajë distancë ndaj tyre, sepse shoqërimi me një person ndikon në moralin dhe gjendjen shpirtërore."

Imam Shafiu ka thënë:

"Nëse njeriu, me vetëdije bën miq njerëz të pandërgjegjshëm dhe të paskrupullt, konsiderohet ortak me ata në çdo sjellje të keqe, sado që në pamje duket sikur ka moral të lartë."

Abdulhalik Guxhduvani ka thënë:

"Largohu prej njeriut të shthurur siç largohesh prej luanit."

Ashtu siç duhet t'i shmangemi kurtheve të nefsit dhe shejtanit, me qëllim që përpjekjet tona të adhurimit dhe devotshmërisë të mos shkojnë kot, ne duhet të shmangim me përpikëri edhe ndjekjen e armiqve të Allahut dhe të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe imitimin e stilit të tyre egoist të jetesës, për të mos e kthyer ahiretin tonë në një zhgënjim të përjetshëm.

Të qëndrosh pranë dhe të përkrahësh armiqtë e Islamit për të fituar prestigj në jetën e kësaj bote, e shkatërron reputacionin e dikujt në sytë e Allahut. Në një ajet është urdhëruar:

"...Nderi i vërtetë i takon vetëm Allahut, Profetit të Tij dhe besimtarëve. Por hipokritët nuk e dinë këtë." (el-Munafikun, 8.)

Është e papajtueshme me vetëdijen e besimit të bësh lëshime nga kriteret hyjnore për të fituar komplimentet, favorin dhe vlerësimin e njerëzve të vdekshëm ose për të shmangur dënimin dhe përjashtimin e tyre. Është urdhëruar në ajetin:

"...Në të vërtetë, fuqia është e Allahut, e të Dërguarit të Tij dhe e besimtarëve, por hipokritët nuk e dinë..." (Fatir, 10.)

Shejh Sadi thotë:

"Nëse kërkon diçka prej të poshtërve me mirënjohje, mund ta mbushësh qesen tënde materiale, por do të dëmtosh shpirtin tënd."

Miqtë e Hakut, jo vetëm që nuk janë joshur nga stili i të jetuarit të zullumqarëve dhe jobesimtarëve, por u kanë qëndruar larg edhe mirësive të tyre. Njeriu mundet nga e mira. Ndaj njerëzve që të bëjnë mirë, lind në shpirt një ndjenjë afiniteti dhe dashurie. Kur njeriu ka një nevojë, të cilën i duhet ta ndajë me dikë për ta zgjidhur, atëherë duhet ta ndajë me vepër mirët. Vazhdimisht i duhet bërë dua Allahut të Lartmadhëruar, që të mos na bëjë nevojtarë të njerëzve të këqij.

Islami inkurajon shoqërizimin, jo individualizmin. Ai rekomandon mirëkuptimin dhe tolerancën. Megjithatë, këtu ka disa kufizime. P.sh; një mysliman nuk mund të shkelë ligjet e Al-

lahut të Plotfuqishëm për të qenë i mirë me njerëzit. Besimtari e di se; nuk ka bindje ndaj asnjë krijese në rebelim kundër Krijuesit!

Imam Shafiu thotë:

"Nuk mund t'i kënaqësh të gjithë njerëzit. Ju përpiqeni të rregulloni marrëdhënien tuaj me Allahun! Pasi të ndodhë kjo, injoroni të shkujdesurit!"

Sidomos sot, në marrëdhëniet njerëzore është thelbësore të shpëtojmë nga sëmundja e "përshtatjes me turmën". Si mysliman, nuk duhet të harrojmë kurrë se kriteri ynë janë urdhrat dhe ndalesat e Allahut, jo mendimet dhe zakonet e përbashkëta në shoqëri.

Megjithatë, është e mundur t'u përmbahesh zakoneve dhe traditave të shoqërisë që janë legjitime dhe të pranueshme. Mirëpo, të pajtohesh me shoqërinë në një çështje që është në kundërshtim me Islamin, e për më tepër, me çoroditjen e indiferencës duke thënë; "Ç'të keqe ka kjo, të gjithë po e bëjnë!?» dhe të japësh pëlqimin për situatat me të cilat Allahu nuk është i kënaqur, e çojnë njeriun të devijojë nga rruga e drejtë.

Është e nevojshme që zemra të mbrohet nga shfaqja e simpatisë dhe admirimit për armiqtë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, apo edhe shikimi i tyre me zilinë më të vogël. Përndryshe, qëndrime të tilla do të rrisin reputacionin e tyre dhe do të shkaktojnë zemërimin e Allahut.

Afrimi ndaj armiqve të Islamit dhe mbështetja e tyre me qëllimin për të arritur famë e pushtet në këtë botë, ia shkatërron vlerën njeriut te Allahu (xh.xh.). Në hadithin fisnik thuhet:

"Mos i thoni «zotëri» hipokritit. Nëse do ta pranoni atë si zotëri, do të tërhiqni mbi ju zemërimin e Zotit të Madhëruar." (Ebu Davud, Edeb, 83; Ahmed ibn Hanbel, V, 346.)

Edhe nëse për një mur që ka bërë një armik i fesë thuhet "sa bukur e paska bërë", mundet që në zemër të ndikojë negativisht. Të pëlqesh veprat e një mohuesi, duke i hapur rrugë ndikimit të brendshëm nga ai, si dhe për faktin që ia rrit vlerat një njeriu që është armik i Allahut të Lartmadhëruar, mundet që zemra jote të pësojë dënimin e Allahut.

Myslimani është i detyruar të përfaqësojë dinjitetin, personalitetin dhe karakterin e Islamit në çdo kohë dhe vend. Në ajetin e fundit të sures Fatiha, të cilën e lexojmë në çdo rekat të namazit:

صِرَاطَ الَّذِينَ اَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَ الضَّالِّينَ

"...(Mos na shpie) në (rrugën) e të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!" (Fatiha, 7.), kërkojmë mbrojtje tek Allahu i Madhëruar që të mos ndjekim rrugën e njerëzve të tjerë përveç Islamit dhe të mos jemi të ngjashëm me gjendjen e tyre.

Allahu i Plotfuqishëm dëshiron që ne të qëndrojmë larg atyre që janë të humbur, të mos imitojmë zakonet, veshjet dhe stilet e tyre të jetesës dhe të përfaqësojmë personalitetin dhe karakterin e Islamit me dinjitet. Të mos jesh si jomyslimanët është gjithashtu një shenjë besimi.

Roger Garaudy pati dhënë një konferencë në Sarajin Jëlldëz, në Stamboll. Shprehjet dhe të vërtetat që i tha aty akoma janë një fakt i gjallë:

"I sëmuri i vërtetë është vetë perëndimi. Ndërsa ju jeni plotësisht të shëndetshëm ngaqë jeni në të vërtetën. Por, për fat të keq, ju po e imitoni perëndimin ngaqë nuk jeni të vetëdijshëm për këtë shëndet që posedoni. Po ashtu, për fat të keq ju nuk e njihni në mënyrë të mirëfilltë dijetarin madhështor mysliman të jurisprudencës islame në shkallë botërore siç është Imam Azami. Prandaj unë jam i detyruar t'ua shpjegoj myslimanëve gjenialitetin e atij, edhe pse s'ka shumë kohë që jam bërë mysliman..."

Pavarësisht mirëqenies materiale që bota perëndimore ka arritur ditët e sotme, ajo nuk ka mundur të shpëtojë nga problemet shpirtërore. Prostitucioni, alkoolizmi, narkomania dhe vetëvrasjet kanë arritur nivele alarmante të papara në historinë njerëzore, gjë e cila është një tregues i qartë i mjerimit shpirtëror. Me gjithë tejngopjen materiale të çdo lloji, uria shpirtërore, prishja e vlerave etike e humane dhe industria e armëve, që ka marrë një trajtë të frikshme, bota materialiste po i drejtohet një fundi të tmerrshëm, si një akrep që vetëvritet duke pickuar veten.

Prandaj, është shumë e rrezikshme që të rinjtë me zemrat e mbushura me iman, të admirojnë stilin e jetës perëndimore të zhytur në probleme shpirtërore, duke u mashtruar nga mirëqenia e tyre materiale. Kjo i ngjan njeriut të shëndetshëm që shikon me zili të sëmurin dhe e imiton atë.

Zëvendësguvernatori i Teksasit në Amerikë, mbrojti mendimin se ata mbi moshën shtatëdhjetë vjeç, të cilët janë në grupin më të rrezikuar ndaj epidemisë, duhet të kujdesen për veten e tyre në mënyrë që të mbajnë në këmbë ekonominë e vendit.

Në Francë, dëshpërimi i pacientëve të moshuar që u dërguan në shtëpitë e tyre me arsyetimin se nuk kishte vend në reanimacionet e spitaleve, u pasqyrua në të gjitha mediat.

Kurse në Spanjë, të moshuarit që qëndronin në shtëpitë e braktisura të pleqve, u gjetën të vdekur në shtretërit e tyre...

Si mund t'i neglizhojë njeriu prindërit e tij në pleqëri? Çfarë njerëzimi është ky, çfarë ndërgjegjeje është kjo, çfarë qytetërimi është ky?!.

Kjo është tabloja e trishtuar e Perëndimit, e cila fshihet pas maskave të praruara dhe e merr fuqinë e saj nga armët, kolonializmi dhe forca brutale, e cila zbulohet kur përballet me një krizë humanitare! Një gërmadhë qytetërimi me filizat e mëshirës dhe dhembshurisë në gjendje të kalbur!..

Qytetërimi i vërtetë është Islami, feja e mëshirës. Qytetërimi islam është para së gjithash një qytetërim i mëshirës. Islami e konsideron mosbindjen ndaj prindërve si gjynah të madh. Ai urdhëron rreptësishtë që; kur prindërit të plaken, kujdesi ndaj tyre të jetë përzemërt dhe me fjalë të buta, duke e ndaluar madje që t'u thuhet qoftë edhe «uf». Ky është qytetërimi dhe njerëzimi i vërtetë, sepse kriteri i vërtetë i qytetërimit, është të vlerësosh të gjitha qeniet, veçanërisht njerëzit, për hir të Krijuesit.

Në fakt, është vërtet domethënëse që në ditët e vështira të pandemisë, Turqia ka siguruar furnizime mjekësore edhe për shtetet që janë ekonomikisht më të forta se ajo. Kështu që:

– Qytetërim i vërtetë, nuk është pasuria e portofolit, por pasuria e ndërgjegjes.

– Qytetërimi i vërtetë, nuk do të thotë të kesh armë që do të shkatërrojnë botën, por vlera morale që do t'i kthejnë gjembat në trëndafila dhe egot rob ndaj Zotit.

– Qytetërimi i vërtetë nuk është mizoria për të parë një pikë nafte më të vlefshme se një pikë gjaku, por virtyti i shpëtimit të jetës së një personi, po aq të vlefshëm sa shpëtimi i gjithë njerëzimit.

Nuk duhet harruar se; ruajtja nga ngjasimi me jo myslimanët është një nga kushtet më të rëndësishme të ruajtjes së personalitetit dhe pjekurisë Islame. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, ka urdhëruar që agjërimi i ditës së 10 të muajit Muharrem, e cila agjërohet edhe nga hebrenjtë, të bëhej duke agjëruar bashkë me të edhe një ditë para, ose një ditë pas saj, si dallim prej tyre. Pra, Profeti ﷺ, na e ka ndaluar t'u ngjajmë jomyslimanëve edhe në adhurime.

"Agjëroni ditën e ashures! Por agjëroni një ditë para saj dhe një ditë mbas saj. Në këtë mënyrë jeni në opozitë me jahuditë." (Ahmed, I, 241; Bezzar, no. 1052; Hejthemi, III, 188)

Mos ngjasimi me jo myslimanët është nga kushtet për ruajtjen dhe mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit të myslimanit.

Një gjë është e sigurt se; Islami, që është e vetmja fe e vërtetë tek Allahu, zotëron përsosmërinë për t'i dhënë përgjigje nevojave të të gjithë njerëzimit deri në ditën e Kiametit. Madje, ai nuk ka nevojë as për fetë e tjera të prishura, as për besimet e kota dhe as për filozofit e mangëta njerëzore.

Në një hadith është urdhëruar:

«Kushdo që përpiqet të imitojë një popull, ai është prej tyre.» (Ebu Daud, Libas, 4/4031.)

Festimi i Vitit të Ri, i cili konsiderohet festë pagane, është kundër personalitetit dhe karakterit të Islamit, sepse Islami është i përsosur. E përsosura, nga ana tjetër, nuk ka asgjë për të fituar nga traditat pagane.

Përveç kësaj, asnjë ditë e shenjtë nuk mund të perceptohet dhe të ringjallet me argëtime që kënaqin nefsin, me harame dhe çmenduri djallëzore. Mjafton vetëm ky fakt për të shprehur se sa traditë e rreme është të festosh natën e ndërrimit të viteve.

Detyra e besimtarit në fillim të vitit, qoftë Hënor apo Diellor, është të bëjë llogari për vitin që ka kaluar dhe të kthehet në pendim dhe istigfar për kompensimin e gabimeve dhe gjynaheve të tij dhe të përpiqet të rrisë përpjekjet e tij fetare në mënyrë që pjesa tjetër e jetës së tij të jetë më e mirë se e kaluara.

Të mos harrojmë se; Ai që krijoi ditët dhe netët, Zoti ynë, që rinovon muajt e vitet, në Ditën e Gjykimit, do të na marrë të gjithëve në llogari për begatitë e jetës. Në mënyrë që llogaria jonë të jetë e lehtë në atë ditë të vështirë, është thelbësore që sot ta llogarisim shpesh veten dhe të jetojmë me besim dhe vepra të mira.

Nuk i ka hije një myslimani të humbasë një kohë që duhet të ringjallet me një vetllogari të tillë, duke imituar zakonet e jomyslimanëve, në argëtime të paarsyeshme me gjela deti, torta, bredha dhe në kundërshtim me vlerat Islame.

Megjithatë, nëse kemi vëllezër fetarë të pavëmendshëm që priren ndaj këtyre lloj sjelljeve, është gjithashtu përgjegjësi e besimit t'i paralajmërojmë ata në një mënyrë të butë dhe me mirësjellje.

Është jashtëzakonisht e trishtueshme që në një vend mysliman shiten miliona bileta lotarie me pretekstin e "Natës së Vitit të Ri", që është një nga zakonet e jomyslimanëve sot. Lotaria dhe lojërat e fatit të ngjashme (!) janë bixhoz i dukshëm, një "fatkeqësi" e plotë që helmon jetën shpirtërore. Bixhozi është një vepër që Allahu e ka ndaluar. Është një fatkeqësi dhe katastrofë që nuk

sjell paqe dhe lumturi. Edhe nëse në dukje mund të fitosh ndonjëherë, në të vërtetë je i humbur.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

"O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e shejtanit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!" (Maide, 90.)

Një besim i vërtetë, kërkon dashuri për atë që meriton dhe urrejtje për atë që e ka hak. Në fakt, në ajetin e fundit të sures Feth, kur përmenden cilësitë e besimtarëve që ishin me Profetin, thuhet se **«ata janë të ashpër ndaj jobesimtarëve** (d.m.th. janë të pa kompromis) **dhe të mëshirshëm mes tyre.»**. Kjo do të thotë se; nga besimet supersticioze të jomyslimanëve nuk duhet të reflektohet as gjëja më e vogël; nuk duhet të ndjehet as prirja apo simpatia më e vogël ndaj zakoneve, traditave dhe besimeve të tyre.

Të shohësh pasurinë dhe madhështinë e kësaj bote të njerëzve që janë robër të egos dhe t'i imitosh ata me admirim, duke ndjekur zakonet, traditat, stilin e jetesës dhe modën e tyre dhe duke u përpjekur të bëhesh si ata; pra të përpiqesh të largohesh nga identiteti personal dhe të lëshosh pe në personalitetin dhe karakterin e Islamit, është një vetë mashtrim i madh.

Kjo, sepse myslimani që jeton si jomysliman dhe jomyslimani që jeton si mysliman, nuk mund ta arrijë kurrë lumturinë. Ajo që do t'u bëjë dobi njerëzve tek Allahu është të jetojnë me gëzimin e Islamit të Epokës së Lumturisë, domethënë të jetojnë në besim me dashuri.

Sëmundja e imitimit të jomyslimanëve apo gjynahqarëve dhe imitimi i mënyrës së tyre egoiste të jetesës është një nga çështjet që rrezikojnë besimin. Shumë prej shpërbërjeve në bazë të besimit, dhe degjenerimeve intelektuale e morale, fillojnë me imitime të tilla. Imitimi bëhet zakon dhe traditë me kalimin e kohës. Më pas, me kalimin e kohës, bashkimi formal çon në bashkim mendor dhe bashkimi mendor çon në bashkimin e zemrës. Dhe kjo, shkakton shkatërrimin shpirtëror të njeriut.

Alija Izzetbegoviç ka thënë:

"Lufta nuk humbet kur mundesh, por kur i ngjan armikut."

Sot, fatkeqësisht bota islame është alienizuar nga kultura dhe qytetërimi i vet. Dhe faturën e kësaj është duke e paguar shumë rëndë.

Le të mendojmë pak: Kujt i ngjajmë ne dhe brezat tanë sot?

– A u ngjajnë marrëdhëniet tona me farefisin, fqinjët dhe miqtë, atyre të të parëve tanë të lavdishëm, apo armiqve të tyre të përbetuar?

– A u ngjajnë rrugët, qyteti, pazari-tregu ynë atyre të të parëve tanë myslimanë, apo atyre të jomyslimanëve?!.

Të mos harrojmë se; ata që kanë vendosur rregullat bazë të rendit të sotëm të jetës janë ata që nuk u japin rëndësi parimeve të Islamit. Prandaj, si myslimanë, ne duhet ta rindërtojmë nga e para të gjithë këtë sistem; në mënyrë Islame dhe me parimet e larta të Islamit.



RUAJTJA NGA HARAMET

Çdo kafshatë mbart me vete dosjet e së shkuarës. A është fituar ajo kafshatë në mënyrë haram apo hallall? A është dhënë zekati asaj kafshate?

A kanë pasur të drejtë trashëgimtarët në të? Në çfarë gjendje shpirtërore ka qenë personi që ka përgatitur ushqimin?

Sepse të gjitha këto ndikojnë në gjendjen shpirtërore të atij që e ha. Nëse ushqimi është hallall, jep ndikim pozitiv në gjendjen shpirtërore të personit. Në të kundërt, e ngarkon personin me energji negative...

Ibrahim Et'hemi ia tha dikujt që kërkoi këshilla prej tij: *"Nëse do të bësh ndonjë gjynah, të paktën mos ha prej mirësive të Allahut! A është e drejtë që edhe të hash prej furnizimit të Allahut, por edhe t'i ngresh krye Atij?"*



Gjynahet janë perde ndërmjet robit dhe Zotit të tij. Ajo që e lë pas më së shumti robin në rrugën drejt Zotit, është pikërisht barra e rëndë e gjynaheve. Me një shpirt të dërrmuar nën këtë peshë të rëndë, nuk mund të bëhet as përparim shpirtëror.



Faktorët që ndikojnë më tepër në karakterin e njeriut janë dy: I pari është mjedisi shoqëror dhe i dyti fitimi i pasurisë.



Duhet të bëjmë kujdes, të mos e përziejmë haramin në fitimet tona dhe të hamë prej hallallit, sepse nëse kafshata është haram ose i dyshimtë, ajo e helmon jetën shpirtërore. Kjo e bën zemrën më të shkujdesur, të plogështon ndaj adhurimit dhe të dembelos ndaj shërbimit në rrugën e Allahut.

Nga ana tjetër, nëse kafshata e ngrënë është hallall, rrit frymëzimin e zemrës dhe forcon shpirtin, shton oreksin për vepra të mira, i jep gjallëri trupit, ushqen shpirtin dhe shëron zemrën.



Hallalli është prej Allahut, e harami prej shejtanit. Në hallall është begatia dhe bollëku i Allahut të Madhëruar, kurse në haram është shterpësia dhe djallëzia e shejtanit.



Rumiu ka thënë:

"Ushqimi që e rrit dhe forcon dritën e zemrës është ushqimi i fituar në rrugë hallall."



Rumi ka thënë:

"Kënaqësia në Ibadet është shenjë e njerëzve të devotshëm. Kjo arrihet duke u larguar prej ushqimeve haram dhe duke e drejtuar zemrën në botën tjetër."



Shah Nakshibendi ka thënë:

"Veprat e mira bëhen të mundura me ushqim hallall. Por edhe ushqimi nuk duhet ngremë në gjendje indiference."



Nëse në organizëm hyn haram, së pari largohet lezeti dhe qetësia e ibadetit.



Mos kënaqësia në adhurim dhe humbja e gjendjes së përkushtimit, janë rezultat i fitimit dhe ushqimit të përzier me gjëra haram ose të dyshimta, si dhe pasioni i kësaj bote në zemër. Përderisa këto gjëra negative nuk eliminohen dhe nuk merren parasysh, është e pamundur të ndihet kënaqësia shpirtërore që njerëzit e takvasë marrin nga adhurimi i tyre.



Ja si shprehet Baki Billah në lidhje me ushqimin:

"Nuk duhet të mjaftohemi me ushqimin e pakët, por duhet t'i japim rëndësi edhe gjendjes hallall të druve, ujit dhe enëve me të cilat përgatitet ai ushqim. Përveç këtyre, ai që e përgatit ushqimin, duhet të jetë i vetëdijshëm se ndodhet para Allahut. Kjo, sepse prej ushqimit që përgatitet pa pasur kujdes në këto çështje, del një tym i tillë, që i mbyll të gjitha kanalet e frymëzimit shpirtëror."



Këto fjalë të Hidrit, gjatë vizitës së njërit prej të dashurve të Allahut, Abdulhalik Guxhduvani (Allahu e mëshiroftë), janë shumë domethënëse për sa i përket ndjeshmërisë shpirtërore në lidhje me ngrënien dhe pirjen:

Hidri, nuk e hëngri ushqimin me të cilin e gostiti Abdulhalik Guxhduvani dhe tërhiqet nga sofra. I zoti i shtëpisë, habitet dhe thotë:

- Ky është ushqim hallall, përse nuk hani?

Hidri përgjigjet:

- Po, ushqim hallall është; mirëpo ai që e ka gatuar ka qenë i zemëruar dhe i pakujdesshëm ndaj Allahut."



Përveç kriterit hallall-haram të ushqimit, në gjendjen shpirtërore të njeriut, në veprat dhe në adhurimet e tij, ndikon edhe atmosfera shpirtërore në të cilën janë gatuar ato. Kjo gjë e tregon qartë qëndrimin që duhet të mbajmë ndaj ushqimeve.



Rumiu ka thënë:

"Këtë mëngjes u zgjova pa frymëzim. Kuptova që në trupin tim kishte hyrë kafshatë e dyshimtë. Edhe dituria edhe urtësia burojnë

nga kafshata e lejuar. Dashuria dhe mëshira janë vijimësi e kësaj kafshate. Kafshata që ushqen shpirtin është ajo e fituar në rrugë të lejuara. Nëse kafshata është shkak për një lajthitje, dije se ajo ose është e dyshimtë, ose e ndaluar."



Sufjan Theuri ka thënë:

Besimi i njeriut matet me ndjeshmërinë që ka në fitimin hallall të jetesës.



Njerëzit e shkujdesur kërkojnë ortakë për mëkatet e tyre. Si pretekst shprehen: "Të gjithë po e bëjnë. Të gjithë po marrin kamatë. Të gjithë po bëjnë përgojime." Ndërkohë që shoqëria të cilën mund ta marrim për shembull është shoqëria e sahabëve të nderuar, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

"Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim..." (Teube, 100.)

Shembull nuk merret periudha e sotme, por Epoka e Lumturisë. Shoqëria shembull për ne është shoqëria e sahabëve të nderuar.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Mbi njerëzit do të vijë një kohë e tillë që askush nuk do të mbetet pa ngrënë kamatën! Edhe nëse nuk e përfiton direkt prej saj, atë do ta prekë pluhuri i saj." (Ebu Daud, Buju, 3/3331.)

Kanë ardhur ditët në të cilat shumë njerëz kanë rënë në kamatë për shkak se i përdorin kartat e kreditit pa menduar. Pakujdesia ka arritur kulmin në çështjen e fitimit dhe të riskut.

Ja, në një kohë të tillë, është më e vështirë se dje që ta kërkosh dhe ta gjesh hallallin. Të kesh kujdes ndaj kësaj, është më e rëndësishme se dje... Edhe shpërblimi i atyre që ruhen, është më i madh se i atyre në të kaluarën.



"Muhaxhir (emigrant) i vërtetë është ai që braktis ato që ka ndaluar Allahu." (Buhari, Iman, 4, 5, Rikak, 26; Muslim, Iman, 64 - 65.)

Ashtu si sahabët, që për të jetuar Islamin braktisën pasurinë dhe emigruan, në ditët tona çdo besimtar duhet të distancohet nga haramet edhe nëse duhet të heqë dorë nga interesat materiale të kësaj bote. Ai duhet të jetojë me vetëdijen për botën tjetër.



Sot, hixhreti më i rëndësishëm, është ai që bëhet drejt kënaqësisë, dashurisë dhe miqësisë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ. Hixhreti i vërtetë, është largim nga gjynahet, veset dhe përfitimet e paligjshme, drejt veprave të mira, sepse çdo shekull i jetuar larg Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, në thelb është një shekull ku mbizotëron injoranca. Egërsitë e çdo shekulli të pareformuar nga parimet hyjnore dhe profetike, janë të barabarta me njëra-tjetrën.

Shmangia e neglizhencës së injorancës moderne dhe marrja si shembull i jetës së devotshme të Profetit dhe sahabëve të tij të shquar, është hixhreti më i madh i kësaj kohe.



Abdullah ibn Mesudi رضي الله عنه, ka thënë:

"Kur një sahab kthehej në mbrëmje në shtëpi, gruaja e tij së pari i bënte këto dy pyetje:

"Sa ajete u zbritën sot nga Kurani?"

"Sa prej haditheve të Profetit ﷺ, ke mësuar përmendësh sot?"

(Në mëngjes) Kur dilte nga shtëpia, gruaja i thoshte:

"Ki frik Allahun, mos fito në haram! Ne e durojmë urinë në këtë botë, por nuk mund ta durojmë dot zjarrin në ditën e Kiametit!". (Abdulhamid Keshk, Fi fihabi't-tefsir, I, 26.)



Në hadithe thuhet:

"Allahu i Madhëruar e do robin e tij që lodhet duke vrapuar pas hallallit." (Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, I, 65.)

"Askush nuk ka ngrënë rrizk më të mirë sesa prej asaj që ka fituar vetë." (Buhari, Buju', 15.)



Një nga shkaqet kryesore të shqetësimeve në këtë periudhë është mungesa e ndjeshmërisë nga fitimit të jetesës. Profeti ﷺ, në lidhje me këtë ka thënë:

"Do të vijë një kohë e tillë kur njeriu nuk do të shqetësohet se si e fiton pasurinë, me hallall apo me haram." (Buhari, Buju, 7, 23.)



Profeti ﷺ, thotë:

"Kush shkon në haxh me para të fituara haram; kur të thotë Lebejk do t'i thuhet: «Për ty nuk ka as lebejk as sadejk, sepse fitimi yt është haram, ushqimi yt është haram, kafsha me të cilën udhëton është haram. Kthehu si mëkatar pa marrë asnjë shpërblim. Shqetësohu për përballjen me gjëra që nuk i dëshiron.»" (Hjethemi, III, 209-210.)



Dërguari i Allahut ﷺ, tregon për një udhëtar, i cili ka bërë rrugë të gjatë për të fituar para, është bërë kokë e këmbë dhé e pluhur dhe ngre duart nga qielli e thotë: "O Allah! O Zoti im!".

Pas kësaj Profeti ﷺ, thotë:

"Ajo që ka ngrënë ky udhëtar është haram, ajo që ka pirë është haram, ajo që ka veshur është haram. Pra, ai ushqehet me haram. E si t'ia pranojë Allahu lutjen një njeriu të tillë?" (Muslim, Zekat, 65.)



"Edhe qeni nuk e ha pa nuhatur një kockë apo një copë bukë që i hidhet."

Domethënë, njeriu, të cilit i është verbuar syri prej lakmisë, përballë mirësive të kësaj bote nuk tregon kujdes dhe hezitim qoftë edhe sa një qen. Kaq shkatërrimtare dhe tragjike është lakmia e dynjasë!



Njeriu i shkujdesur mendon se çdo gjë që mund të arrijë pa e vrarë mendjen nëse është hallall apo haram, është në dobi të tij. Mirëpo, për një besimtar, një qindarkë e fituar në hallall, është shumë më e vlefshme se milionat që mund të vijnë nga harami. Për besimtarin, pasuria hallall, për të cilën mund të japë lehtësisht llogari në ahiret, është pasuria më e mirë. Kurse pasuria haram, për të cilën ai nuk do të mund të japë dot llogari në ahiret dhe do të shkaktojë dënimin e tij, është me të vërtetë një problem i madh për të.



Lidhur me respektimin e hallallit, duhet pasur shumë kujdes që: Nëse një nëpunës apo punëtor nuk i kryen si duhet detyrat, ose nëse nuk e respekton orarin e tij të punës, ai do ta përziejë pagën e tij me haram.

Po ashtu, nëse një imam xhamie nuk merret mjaftueshëm me xhematin e tij; nuk i këshillon dhe nuk i udhëzon siç duhet; apo

një mësues që nuk kujdeset siç duhet për nxënësit e tij, do të përziejnë haramin me duart e veta në rrogat e tyre.



Është fakt i vërtetë se; ata të cilët kanë marrë trashëgimi nga pasuria haram, nuk mund të ecin përherë në rrugë të drejtë, pasi paraja ka një sekret; ajo kalon nga rruga që ka ardhur. Një mall i ardhur nga një rrugë haram shpërdorohet nëpër rrugë të këqija, duke i shkuar trashëgimtarit nga pas. Një mall i tillë i ngjan gjarprit që hyn nga i njëjti vend ku ka dalë. Mënyra e harxhimit të mallit varet nga mënyra e fitimit të tij.



Besimtari do t'i kushtojë vëmendje dy gjërave në lidhje me trashëgiminë:

E para: Ai duhet të fitojë në rrugë hallall, duhet të hajë gjëra hallall dhe ajo që do të lërë pas duhet të jetë hallall.

E dyta: Duke i edukuar edhe pasardhësit e tij me këtë ndjeshmëri ndaj hallallit, ai duhet t'u lërë atyre trashëgim "vetëdijen e takvasë".



Gjithkush pandeh se e zotëron paranë e tij dhe e harxhon ku të dëshirojë. Por paraja shkon në vendin e duhur sipas pastërtisë apo papastërtisë shpirtërore me të cilën është fituar. Edhe vullnetin e të zotit të saj, e shpie drejt vendit ku shkon vetë. Kështu: Nëse paraja është fituar në rrugë hallall, e çon të zotin drejt hallallit. Por, nëse është fituar në rrugë haram, e çon të zotin drejt haramit.



Një prej nxënësve të Ebu Abbas Nihavendin, që merrej me tregti, e pyeti atë se kujt duhej t'ia jepte zekatin.

"Jepja atij që të thotë zemra!" – iu përgjigj ai.

Pasi largohet nga mësuesi i tij, nxënësi takon në rrugë një lypsar të verbër. Atij i vjen keq për të, nxjerr nga xhepi një qese me florinj dhe ia jep si zekat. Lypësi i verbër, pasi e kontrollon mirë qesen dhe bindet se ajo është plot e përplot, largohet gjithë gëzim prej aty. Të nesërmen e asaj dite, nxënësi në fjalë kalon në të njëjtën rrugë dhe sheh se i verbëri i djeshëm, të cilit i kishte dhënë zekatin ishte duke folur me një shok të tij, i cili ishte gjithashtu i verbër. Nga biseda që po bënin dy shokët e verbër, atij i zuri veshi këto fjali:

"Dje, një njeri fisnik më dhuroi një qese plot me florinj. Kurse unë shkova në pijetore dhe piva për qejfin tim..."

Kjo gjë e mërziti shumë nxënësin. Ai shkoi menjëherë tek Ebu Abbasi. Sapo arriti atje, ende pa filluar t'ia sqarojë mësuesit të vet meselenë, Ebu Abbasi kërkoi prej tij që t'i dhuronte personit të parë që do të haste në rrugë një shumë parash, të cilën e kish fituar nga shitja e një qylafi.

Nxënësi largohet menjëherë për të kryer detyrën që i la mësuesi. Ashtu siç qe porositur, shumën e parave ia dhuroi njeriut të parë që takoi në rrugë. Më pas, u bë kurioz dhe filloi ta ndjekë atë nga pas. Burri në fjalë hyri në një rrënojë aty afër. Nxori nga rrobat e tij një thëllëzë të ngordhur dhe e la aty. Teksa ai po largohej prej aty, nxënësi i doli përpara dhe e pyeti:

- O njeri! Më thuaj çfarë po ndodh, pashë hatrin e Zotit! Çfarë është kjo thëllëzë e ngordhur që sapo hodhe këtu?

Kur pa përballë njeriun që pak më parë i kishte dhuruar shumën e parave, burri tha me zërin që i dridhej nga emocionet:

- Tash shtatë ditë nuk kam mundur të siguroj kurrfarë ushqimi për fëmijët e mi. Unë dhe gruaja po e duronim urinë, por fëmijët nuk ishin në gjendje të duronin më!.. Megjithatë, s'më

bëhej të dilja për të lypur. Duke u sjellë andej këndej me gjithë këtë shqetësim, gjeta në rrugë këtë thëllëzë të ngordhur. Në pamundësi për të siguruar ndonjë ushqim tjetër, mendova ta çoja në shtëpi këtë shpend të ngordhur prej ditësh. Ndërkohë, po i lutesha Allahut me gjithë shpirt: "O Zoti im, më ndihmo të dal nga kjo gjendje kaq e vështirë!". Pastaj, para syve të mi u shfaqe ti. Unë e falënderova Zotin me të gjithë forcën e shpirtit dhe e flaka atë shpend të ngordhur që do ta hanim të detyruar. Tani do të shkoj në pazar dhe do t'i blej familjes diçka për të ngrënë me atë shumë parash që më dhurove ti.

Shumë i çuditur nga kjo situatë, nxënësi vrapoi drejt mësuesit të tij shpirtëror. Kur nxënësi arriti te Ebu Abbasi, ky i fundit nuk i dha fare kohë të shpjegohej, por i tha:

"O biri im! Nga e gjithë kjo histori, unë po kuptoj se gjatë punës tënde ti nuk paske treguar kujdes të veçantë ndaj gjërave të dyshimta ose gjërave haram. Kështu që, edhe pse ti u përpoqe të zgjidhje të varfrin, zekati yt shkoi për konsum vere. Gjërat, ashtu siç fitohen, po ashtu edhe largohen nga dora jonë. Urtësia, e cila bëri të mundur që ajo shumë parash të arrinte te i varfëri i vërtetë, qëndron në faktin se ato para ishin krejt hallall..."



Shkalla e legjitimitetit të parasë, mund të vlerësohet duke parë se si shpenzohet ajo. Nëse origjina e fitimit është e errët dhe e dyshimtë, edhe vendi ku shpenzohet ai nuk do të jetë i ndritshëm dhe i qartë. Nëse në jetën tonë - Zoti na ruajt - ka shpërdorim dhe koprraci, kjo gjendje është një paralajmëruese e problemeve shpirtërore në fitimet tona.



Fatkeqësisht, sot, sidomos në qytetet e mëdha, në shumë shtëpi thuajse nuk ka më kuzhinë, sepse rrugët dhe rrugicat janë bërë kuzhina e tyre.

Në vend të ushqimeve që dikur gatuheshin në shtëpi me abdes, bismilah, salavate, frymëzimin shpirtëror të dhikrit dhe entuziazmin e adhurimit, sot, në jetën moderne, të fokusuar tek shpejtësia dhe kënaqësia, për fat të keq, preferohen më tepër ushqimet që përgatiten me çfarëdo lloj materiali dhe me çfarëdo lloj gjendjeje shpirtërore dhe sillen nëpër shtëpi me servis.

Kështu, ai që ha, nuk është i vetëdijshëm për cilësinë shpirtërore të asaj që ha dhe as gjendjen e personit që e përgatit atë ushqim. A janë myslimanë ata që e presin atë mish, a kanë abdes ata që i gatuajnë ato gjellë, a janë njerëz të namazit, a kanë thënë bismilah gjatë gatimit, etj., nuk pyet, nuk mendon, e as nuk bën kujdes kush...

Këtu duhet kërkuar arsyeja për problemet si, mungesa e begatisë në shoqëri, mospranimi i lutjeve, shtimi i krizave materiale dhe shpirtërore, apatia, egoizmi, ngathtësia, shqetësimi, stresi dhe depresioni.



Sot, njerëzit qahen për dëmet materiale. Në krye të këtyre, vjen inflacioni, kostoja e jetesës etj. Mirëpo, të gjithë flasin më tepër për shkaqet e jashtme të këtyre problemeve, kur në fakt, është e nevojshme të shikohen edhe shkaqet e tyre të brendshme. Fatkeqësisht, në një pjesë të shoqërisë sot, ashtu si tek popujt e shkatërruar në histori, është harruar ahireti, është dobësuar ndjeshmëria ndaj hallalli-haramit dhe janë cenuar kriteret e nderit dhe dinjitetit. Mashtrimi, bixhozi, ryshfeti, interesi dhe tregu i zi janë përhapur gjerësisht.

Këto dhe gjynahe të ngjashme, janë ndër arsyet kryesore pse ndërpritet ndihma e Allahut dhe largohet begatia. Pa dyshim se; mënyra për t'i korrigjuar këto, është të heqim dorë nga këto lloj gabimesh si shoqëri dhe të pendohemi e të përmirësojmë gjendjen tonë.



Po ashtu, problemet psikologjike që në të kaluarën kanë qenë të pakta, sot po shtohen dita ditës. Aq, sa edhe njerëzit e pasur dhe të zhytur në luks, po përjetojnë stres dhe depresion si pasojë e humbjes së jetës shpirtërore...

Mirëpo, në ditët tona mbizotëron një tablo shumë e zymtë. Sot është harruar haku i syrit dhe aty ku shiten ushqime, gëlojnë reklamat joshëse dhe konkurruese që tërheqin sytë e të gjithëve. Vitrinat e mbushura me ushqime, ekspozohen pa u shqetësuar fare për ndjenjat e nevojtarëve, të uriturve, jetimëve dhe të dobëtëve.



Mirëpo, në të kaluarën tonë të ndritur, shohim edhe shembuj të atillë, që krahas kujdesit ndaj kafshatës hallall, janë marrë masa që edhe ushqimi hallall të mos ekspozohet në sytë e atyre që nuk kanë, me qëllim që të mos u hyhet në hak. Për shembull: Nëpër restorante ushqimet nuk ekspozoheshin në vitrinë, por mbuloheshin me perde me qëllim që, nëse kalonte ndonjë i varfër, të mos ndihej keq për faktin se nuk kishte mundësi për atë ushqim.



Nëse ka ndryshim qetësie shpirtërore dhe frikë-respekti ndaj Allahut Teala ndërmjet namazeve që falen në xhamitë historike të cilat na ka ngelur sot prej gjyshërve tanë dhe namazeve që falen në xhamitë e ndërtuara në kohët e fundit, shkakun duhet ta kërkojmë në pastërtinë e parave që janë harxhuar për ndërtimin e tyre. Po ashtu duhet të shikohet edhe fakti se është respektuar apo jo e drejta e njeriut.

Është një shembull historik fakti që;

Kanuni Sulltan Sulejmani, pasi përfundoi mbarimi i xhamisë Sulejmanije, u kërkoi hallallëk të gjithë arkitektëve, mjeshtërve dhe punëtorëve. Ai sulltan i madh, pati nxjerrë edhe këtë ferman për kafshët që përdoreshin në ndërtimin e xhamisë:

"Kafshët e lodhura do të lihen të pushojnë dhe nuk do të lihen të uritura!"



Sot, shumë të drejta njerëzore përdhosen në mënyrë të pavetëdijshme. Mirëpo, të gjitha këto do t'i dalin para njeriut Ditën e Gjykimit. Për shembull, punëdhënësit duhet t'i kushtojnë vëmendje të madhe të drejtave të punonjësve të tyre. Ata duhet të tregojnë dhembshuri dhe mëshirë ndaj tyre, sepse kur i trajtojnë ashpër, shumica prej tyre nuk kundërshtojnë nga frika se mos ngelen pa punë. Për këtë arsye, atyre mund t'u duhet të vuajnë padrejtësitë e punëdhënësit. Në raste të tilla, punëdhënësi mund ta neglizhojë këtë, pasi nuk përballet me ndonjë kundërshtim. Për rrjedhojë, në ahiret, ai do të bartë mbi supe peshën e rëndë të shkeljes së të drejtave të robit pa qenë i vetëdijshëm.



Profeti ynë ﷺ, i cili ia kumtoi dhe ia mësoi umetit të vet këto të vërteta, edhe në frymën e fundit, derisa iu shua fare zëri i bekuar, vazhdoi të jepte këto dy porosi:

"Kini frikë Allahun, në lidhje me namazin (që është lidhja e robit me Zotin e vet) Kini frikë Allahun, në lidhje me njerëzit që keni nën urdhrat tuaja..." (Bejhaki, Shuab, VII, 477)



I Dërguari i Allahut ﷺ, ia tregoi të gjithë njerëzimit sesi mund të përhapet drejtësia duke dhënë një shembull nga vetja:

"Së fundi edhe unë jam një njeri. Andaj mund t'i kem hyrë në hak disave prej jush. Këdo që e kam goditur në shpinë, ja ku e ka shpinën time. Le të vijë dhe të më godasë! Kujtdo që ia kam marrë pasurinë pa dashje, ja ku është pasuria ime. Le të vijë dhe ta marrë!" (Ahmed, III, 400.)



Njëra prej gjërave për të cilat duhet të kemi më së shumti kujdes, është bërja hallall ndaj njëri-tjetrit.

Profeti ynë i nderuar ﷺ, ka thënë:

"O njerëz! Kushdo që ka një hak (të dikujt) mbi supe, le ta shlyejë menjëherë atë dhe të mos thotë se po turpërohet në këtë botë! Dijeni mirë, se turpërimi në këtë botë, është shumë më i lehtë në krahasim me turpërimin në botën tjetër!" (Ibni Sa'd, II, 255; Taberi, Tarih, III, 191)



Profeti ﷺ, në lidhje me vendosjen në vend të drejtësisë në ditën e gjykimit, ka thënë:

"Kush i ka bërë vëllait të fesë ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me të para se të vijë dita e kiametit, ku nuk do të ketë flori dhe argjend. Në të kundërtën, nëse ka vepra të mira, do t'i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi. (dhe i jepet atij që i është bërë padrejtësi). Por, nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynaheve të vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe do t'i ngarkohen atij." (Buhari, Mezalim, 10, Rikak, 48.)

Nuk duhet harruar se; haku i robit është shumë i rëndësishëm, sepse është një çështje që ruhet deri në Kiamet. Dalja në Ditën e Gjykimit me hakun e dikujt mbi shpinë është një humbje e madhe.



Në një hadith tjetër thuhet:

"*Allahu i Madhëruar ia fal dëshmorit të gjitha gjynahet, përveç hakut të robit.*" (Muslim, Imare, 119.)

Ditën e Kiametit, dëshmorët e rënë në rrugën e Allahut do të jenë në gradën më të lartë, pas profetëve, por as kjo nuk do t'i

shpëtojë nga llogaridhënia, kur bëhet fjalë për çështjen e hakut të robit. Imagjinoni gjendjen e robërve të tjerë!..



Vetëm Allahu i Madhëruar e di natyrën e librit të veprave. Mirëpo, sipas asaj që na është bërë e ditur, ai është libri ku do të shënohet çdo gjë e madhe apo e vogël që ka vepruar njeriu, pa u anashkaluar qoftë edhe vepra më e imët. Lidhur me këtë, në Kuran sqarohet:

"**Dhe Libri** (i veprave të tyre) **do t'u vihet përpara, e do t'i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: «Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë?» Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt."** (Kehf, 49.)

Siç vihet re në këtë ajet, njerëzit do të ankohen për shkak se do të shohin të shënuara edhe gjynahet që ata kanë menduar se kanë qenë të vogla.

Në një ajet fisnik, urdhërohemi të lutemi kështu:

"...Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë!.." (Bekare, 286.)



Allahu urdhëron:

"Ai që ka punuar edhe një grimcë punë të mirë ka për tu përballur me të. Ai që ka punuar edhe një grimcë punë të keqe ka për tu përballur me të." (Zelzele, 7-8.)

Ne na kërkohet të ruhemi dhe distancohemi nga të gjitha llojet e mëkateve sado të vogla të jenë.



Kasim ibn Muhamed ka thënë:

"Një nga mëkatet e mëdha, është që mëkatin, ta konsiderosh të vogël."



Lukman Hakimi ka thënë:

"Mos i nënvlerëso punët e vogla, sepse pak nga pak ato bëhen të mëdha."



Abdullah bin Mesud ka thënë:

"Besimtari, e sheh gjynahun si një mal nën të cilin është ulur dhe në çdo moment ka rrezik t'i bjerë mbi kokë. Ai gjithmonë rri me frikën se mos ai mal i madh i bie mbi kokë. Kurse i shkujdesuri, e sheh gjynahun si një mizë që po kalon mbi hundën e tij." (Buhari, Deauat, 4; Muslim, Teube, 3.)



Bilal bin Sa'd e ka shprehur shumë bukur ndjeshmërinë e njerëzve të devotshëm ndaj gjynaheve:

"Mos shih vogëlsinë e gjynahut, por kundër kujt e bën atë gjynah!"



Një hap i gabuar i hedhur në buzë të humnerës, mund ta çojë njeriun drejt shkatërrimit. Prandaj, në devotshmërinë tonë ndaj Allahut të Plotfuqishëm, duhet të shmangim me përpikëri edhe gjendjen dhe qëndrimin më të vogël të gabuar që mund të shkaktojë zemërimin hyjnor. Kjo, sepse shumë gjendje dhe qëndrime të gabuara, të cilave nuk u kushtohet rëndësi, mund të shkaktojnë zemërimin hyjnor dhe t'i çojë dëm të gjitha punët tona.

Siç transmetohet në një hadith; një grua gjynahqare që i dha ujë një qeni të etur, u fal për këtë mëshirë dhe u bë prej banorëve të xhenetit. Nga ana tjetër, një grua që nuk u kujdes për macen e saj, duke e lënë të ngordhte nga uria, u bë prej banorëve të xhehenemit për shkak të kësaj mizorie.



Edhe mëshira edhe zemërimi hyjnor, mund të manifestohen herë në diçka të vogël, herë në diçka mesatare, e herë në diçka të madhe. Me fjalë të tjera, një mirësi e vogël që duket aq e thjeshtë dhe e parëndësishme, ndonjëherë e tërheq aq shumë mëshirën e Allahut, saqë bëhet shkak i shpërblimeve të mëdha. Për këtë arsye, është e nevojshme të mos i neglizhojmë as veprat e vogla të mira që mendohen të jenë të parëndësishme. Nga ana tjetër, një gjynah që nganjëherë mendohet se është i thjeshtë dhe i parëndësishëm, e zemëron Allahun aq shumë, saqë mjafton ta shndërrojë jetën e përtejme të njeriut në një dënim të përjetshëm.



Fahreddin er-Razi, shprehet:

"Allahu i Madhëruar, e ka fshehur se me cilin adhurim kënaqet më shumë, me qëllim që të kryhen të gjitha adhurimet.

E ka fshehur se me cilin gjynah zemërohet më shumë, me qëllim që të kihet kujdes ndaj çdo gjynahu.

I ka fshehur miqtë e Vet midis njerëzve, me qëllim që të respektohen të gjithë njerëzit.

E ka fshehur lutjen e pranuar ndër lutjet e tjera, me qëllim që të bëhen të gjitha lutjet.

E ka fshehur Emrin e Tij më Madhështor midis emrave të tjerë, me qëllim që të madhërohen të gjithë."



Në jetën e përditshme bëhen shumë gabime -për fat të keqpa u konsideruar si shkelje e rëndë e të drejtës së robit. Për shembull:

• Parakalimi i makinave të tjera në trafik kundër rregullave, është shkelje e të drejtave njerëzore.

• Shkundja e i qilimave dhe tapetave nga dritarja apo ballkoni, duke ndotur xhamin ose ballkonin e fqinjit në katin e poshtëm, është gjithashtu një shkelje e të drejtave njerëzore.

• Po ashtu edhe shqetësimi i fqinjëve me fishekzjarrë dhe lëshim të muzikës me zë të lartë, është shkelje e të drejtave njerëzore.

• Thashethemet, bartja e fjalëve dhe hetimi i jetës private të të tjerëve, është shkelje e të drejtave.

• Shfaqja e pakujdesisë, sjelljes impulsive dhe sjelljes së shëmtuar në një mënyrë që rrezikon shëndetin fizik dhe mendor të të tjerëve është gjithashtu një shkelje e rëndë e së drejtës njerëzore.

Besimtari nuk duhet të harrojë se; Ditën e Gjykimit, ai do të përballet me të gjitha këto të drejta që ka shkelur. Respektimi i të drejtave njerëzore dhe bërja e një jete me ndjeshmëri të lartë devotshmërie, duhet të jetë shenja dalluese e çdo besimtari.

I nderuari Musa Topbash ka thënë:

"Shumë njerëz pandehin se zhvillimi shpirtëror arrihet vetëm me adhurim të tepërt! Jo! Zhvillimi i vërtetë realizohet duke u vetëdijesuar që je në prani të Zotit kudo dhe kurdo, dhe duke sistemuar jetën sipas istikametit të Sunetit. Ka shumë njerëz që bëjnë shumë adhurime nafile, por nuk kujdesen për hallallin dhe haramin dhe nuk përpiqen të pajisen me moralin islam. Kohën e lirë e kalojnë me thashetheme. Çdo gjë që u bie në dorë, e përdorin sipas dëshirave të nefsit. Ah sikur këta persona të ulnin dozën e

adhurimeve nafile dhe të përpiqeshin të shtonin moralin e tyre dhe të ishin më të ndjeshëm ndaj të drejtave."



Ibn Abasin ﷺ, e pyetën:

- Është një person që përpiqet të bëjë vepra të mira, por bën edhe disa gjynahe. Është edhe një njeri që nuk përpiqet shumë për vepra të mira, por nuk bën as gjynahe. Cili nga këta është më i mirë?

Ai u përgjigj:

«*Për mua, më e dashur është të qëndrosh larg gjynahut.*» (Ebu Davud, Zuhd, 356.)



Reklamat që stimulojnë dëshirat e ulëta të egos, moda që shtyn drejt luksit dhe shpërdorimit, programet negative të televizionit, shtigjet e gabuara të internetit dhe propagandat që nxisin çdo gjë negative, kanë sjellë me vete një erozion shpirtëror të jashtëzakonshëm dhe kanë futur në kaos gjithë botën e mendjes dhe të zemrës njerëzore. Duhen përpjekje për të zhdukur të keqen sepse zhdukja e të keqes ka më përparësi se ofrimi i të mirës. Së pari duhet pastruar plaga pastaj duhet mjekuar me ilaç. Duhet qëndruar larg gjynaheve në mënyrë që të arrihet kënaqësia në ibadete.



Në një ajet urdhërohet:

"Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta..." (En'am, 120.)

Ashtu siç qëndrohet larg alkoolit, bixhozit, interesit bankar dhe ryshfetit, duhet qëndruar edhe larg zilisë, hipokrizisë, gënjeshtrës, shpërdorimit dhe koprracisë. Ashtu siç nuk i afro-

hesh zinasë (imoralitetit), nuk duhet t'i hapet asnjë derë edhe të gjitha llojeve e formave të fshehta dhe të hapura të imoralitetit që kërcënojnë sytë, veshët dhe fjalët.



Sepse Islami është tërësia e urdhrave dhe ndalesave hyjnore. Islami nuk duhet të zbatohet në një pjesë të jetës dhe të harrohet në një pjesë tjetër të saj. Islami nuk duhet të ngujohet në xhami. Islami nuk duhet të pandehet vetëm si kryerje e adhurimeve të dukshme dhe largim vetëm nga haramet e dukshme.

E dukshmja dhe e padukshmja janë faktorë që e plotësojnë njëri-tjetrin. Pothuajse janë si enët e kombinuara në fizikë. Kur të shohësh të dukshmen, shih edhe të padukshmen. Kur të shohësh të padukshmen, shih edhe të dukshmen!..



Për fat të keq, në ditët e sotme po vëmë re se;

Teksa shfaqet kujdes dhe përpikëri për të qëndruar larg harameve të dukshme në jetën fetare, nuk po shfaqet kujdes për largimin nga haramet e padukshme.

Për shembull:

Një mysliman nuk fut në gojë mish derri përgjatë gjithë jetës së vet. Ai ndjen neveri prej tij. Madje nuk i merr as produktet ushqimore të paketuara të cilave nuk u beson dhe nuk i fut në shtëpi. Shumë bukur. Një ndjeshmëri dhe vetëdije e tillë është domosdoshmëri e besimit dhe devotshmërisë...

Por i njëjti njeri nuk e ruan gjuhën nga mashtrimi, përgojimi dhe thashethemet. Ndërkohë këto harame të padukshme janë të pështira dhe të shëmtuara po aq sa mishi i derrit.



Allahu Teala, për të na bërë të ndjejmë neveri nga përgojimi, ka urdhëruar:

"...Mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?!.." (Huxhurat, 12.)

Përgojimi në Kuran është përngjasuar me ngrënien e mishit të vëllait të vdekur, për të treguar sa mëkat i tmerrshëm është.



Aishja ﵂, ka thënë:

"Sa e çuditshme është që njeriu lan gojën për kafshatën hallall që ha, por jo për fjalët e shëmtuara që i tha vëllait të tij!»



Fudajl ibn Ijad ka thënë:

"Aty ku hyn përgojimi largohet vëllazëria."



Për shpëtimin tonë të përjetshëm, është e domosdoshme që, kundër nefsit, shejtanit dhe të keqes së njerëzve të këqij, të veshim "rrobën e takvasë" deri në frymën tonë të fundit. Dhe rroba e takvasë, është të përmbahemi me përpikëri nga gjendjet, qëndrimet dhe sjelljet që nuk i pëlqejnë Allahut të Plotfuqishëm, duke qenë të vetëdijshëm se jemi gjatë gjithë kohës nën vëzhgimin hyjnor. Në këtë aspekt, nuk duhet të jesh i shkujdesur ndaj nefsit dhe shejtanit, qoftë edhe për një moment. Prandaj, ne duhet ta bëjmë parim të jetës sonë këtë lutje të Profetit tonë ﷺ:

«O Zot! Mos më lër në dorë të nefsit tim as sa hap e mbyll sytë!.."



Omeri ﷺ, ka thënë:

"Dëshmitari më i fshehtë i një vepre të keqe është ndërgjegjja."



Në një ajet fisnik, urdhërohet:

"**Thuaj: "Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë."** (Teube, 105.)

Nuk duhet të harrojmë se, të gjitha veprat që bëjmë dhe nuk bëjmë, shihen gjithmonë nga Allahu, e madje, i prezantohen edhe Profetit ﷺ. Për rrjedhojë, duhet të ruhemi dhe të turpërohemi nga bërja e veprave që nuk do t'i bënim kurrë para syve të tyre. Ruajtja sot nga gabimet, do ta shpëtojë robin nga turpërimi nesër, në ditën e gjykimit.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Dijeni mirë se; unë do të shkoj para jush dhe do t'ju pres atje. Vini re! Vendi i takimit tonë nesër (në jetën tjetër) është kreu i hauzit të Keutherit. Kush dëshiron të takohet nesër me mua, ta largojë dorën dhe gjuhën nga gjynahet..." (Buhari, Salat, 80; Ibni Sa'd, II, 227.)

"Jeta ime është në dobinë tuaj; ju flisni me mua dhe njoftoheni (me shpalljen hyjnore dhe ligjet). Por edhe vdekja ime është në dobinë tuaj. Punët tuaja më tregohen edhe mua. Kur shoh një punë të mirë, falënderoj Allahun, e kur shoh një punë të keqe, i kërkoj falje Atij për ju." (Hejthemi, IX, 24.)

"Mos më turpëroni me gjynahet që bëni." (Muslim, Haxh, 147; Ebu Davud, Menasik, 56.)



Për një jetë të pranueshme devotshmërie, është e domosdoshme të bëhet një udhëtim nga «imani» në «ihsan». "Ihsan", do të thotë të arrish vetëdijen se Allahu i Madhëruar, i cili është i pakufizuar nga koha dhe hapësira, është gjithmonë i pranishëm dhe i gatshëm dhe na vëzhgon në çdo kohë dhe vend. Kështu, ne duhet të fitojmë vullnetin dhe urtësinë për të mos qenë të pavëmendshëm ndaj Allahut qoftë edhe për një çast, dhe të shmangim gabimet që nuk mund t'i bëjmë para të tjerëve, edhe në kohët dhe vendet ku nefsi ynë të jetë vetëm për vetëm me gjynahet.



Rumiu thotë:

"Një roje kalaje që gjendet në skajin tjetër të vendit, domethënë në kufi, e mbron dhe e ruan kalanë nga armiqtë edhe pse gjendet shumë larg padishahut dhe kryeqytetit. Edhe pse i propozohet ryshfet pa kufi e llogari, ai prapë se prapë nuk e shet kalanë te armiqtë. Ai shfaq besnikëri ndaj padishahut sikur ta kishte aty pranë edhe pse gjendet shumë larg, në skajin tjetër të kufirit, pra aty ku nuk është padishahu. Për padishahun është më i mirë ai roja që gjendet larg, sesa ata që gjenden pranë tij dhe e sakrifikojnë veten për të."



Imam Shafiu ka thënë:

Këto tre vepra janë më të vështirat për t'u bërë:

1. Të jesh bujar kur ke pak.
2. Të thuash gjithmonë të drejtën.
3. Të ruash devotshmërinë kur je vetëm.



Takva, do të thotë të eliminosh dëshirat egoiste, të zhvillosh aftësitë shpirtërore dhe të fiksosh në zemër vetëdijen se gjendesh gjithmonë nën mbikëqyrjen e kamerave hyjnore. Takva, do të

thotë të largohesh nga harami dhe veprat e papëlqyeshme, për shkak të frikës së humbjes së kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut dhe të shmangesh me përpikëri edhe nga punët e dyshimta.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Njeriu nuk ka mundësi të arrijë gradën e të devotshmëve të vërtetë, derisa nuk largohet edhe prej disa veprave të dyshimta!"
(Tirmidhi, Kijame, 19/2451.)



Osmani ﷺ, ka thënë:

Pesë shenjat e njerëzve të devotshëm janë:

1. Shoqërimi me ata që përpiqen në çështjet fetare.

2. Pastrimi i nefsit dhe kontrollimi i gjuhës.

3. Të qenit i vetëdijshëm se çdo gjë që i përket kësaj bote dhe që sjell harresën e Zotit është diçka e dëmshme që të shpie në humbje, ndërsa çdo gjë nga feja e tij është pasuria e vërtetë.

4. Të mos e mbushë stomakun me gjëra të dyshimta, qofshin këto edhe hallall (të jetë sa më i përpiktë dhe i kënaqur në këtë drejtim).

5. Të mendojë se të gjithë njerëzit kanë shpëtuar, ndërsa vetëm ai ka humbur.



Një ditë, Omeri ﷺ, e pyet Ubej bin Kabin ﷺ, se çfarë është devotshmëria. Ubej ﷺ, iu përgjigj:

- O Omer! A ke ecur ndonjëherë në një rrugë me gjemba?

Omeri ﷺ, u përgjigj:

- Po, kam ecur!

Ubej ﷺ, e pyet përsëri:

- Po mirë, çfarë bëre?

Omeri ﷺ, u përgjigj kështu:

- Përvesha rrobën time dhe bëra shumë kujdes për t'u ruajtur nga gjembat.

Atëherë Ubej ﷺ, thotë:

"Ja pra, kjo është devotshmëria!" (Ibn Kethir, Tefsiru'l-Kurani'l-Adhim, Bejrut 1988, I, 42.)



Takvaja, është përpjekja që bëhet në këtë botë, që është vetëm një udhëtim nga djepi në varr, për të ruajtur rrobën e Islamit dhe besimin nga copëtimi ose dëmtimi prej ferrave të gjynaheve, harameve, neglizhencës dhe lëshimeve...



Ebu Bekri ﷺ, ka thënë:

"Njeri me mend është njeriu i devotshëm, ndërsa njeri pa mend është keqbërësi."



Kush shkel të drejtat e të tjerëve, nuk i bën padrejtësi vetëm atyre. Për arsye se ai ka bërë një gjynah që shkakton dënimin në botën tjetër, në fakt ai i ka bërë padrejtësi vetes.



Mizoria më e madhe, është ajo që njeriu i bën vetes duke u zhytur në gjynahe dhe rebelim, sepse, ndërkohë që padrejtësia e

dikujt tjetër do të rezultojë maksimumi në marrjen e jetës së personit, domethënë dhënien fund të jetës së tij të vdekshme, mizoria e nefsit ndaj vetvetes duke u zhytur në haram dhe rebelim, do të rezultojë në shkatërrimin e jetës së tij të përjetshme.



Si besimtarë, ato për të cilat duhet të frikësohemi dhe të shqetësohemi në këtë botë, nuk janë fatkeqësitë dhe problemet kalimtare, por rebelimi, mosmirënjohja, mos falënderimi, gjynahet, shkujdesja dhe pasionet egoiste, të cilat, -Zoti na ruajt-, mund ta kthejnë jetën e përjetshme në një dënim pafund.



Herë-herë neve na kaplon frika nga katastrofat dhe fatkeqësitë e mëdha që ndodhin. Ne frikësohemi kur ndodh një tërmet apo një përmbytje. Po ashtu, frikësohemi edhe nga falimentimi apo nga humbja e mundësive materiale. Sigurisht që një frikë e tillë është e natyrshme për ne si njerëz. Mirëpo, ajo për të cilën duhet të frikësohemi me të vërtetë, janë gjynahet tona që na largojnë nga Allahu i Madhëruar dhe e helmatisin jetën tonë shpirtërore.



- Duhet të kemi frikë nga gjynahet tona!

- Duhet të kemi frikë nga fjalët e gabuara që dalin nga goja jonë!

- Duhet të kemi frikë nga varfëria në mëshirë e dhembshuri!

- Duhet të kemi frikë nga paaftësia e shfaqjes së personalitetit dhe karakterit Islam!

- Duhet të kemi frikë nga paaftësia e shfaqjes së fytyrës së bukur të Islamit!

- Duhet të kemi frikë nga përballja me skenat e tmerrshme në ditën e Kiametit, për shkak të këtyre gabimeve dhe të metave tona!

- Duhet të kemi frikë nga të gjitha gjynahet, me qëllim që në frymën tonë të fundit, të mund të bëhemi prej robërve fatlumë, të cilët melekët i përgëzojnë me "siguri prej frikës dhe hidhërimit"!



Njerëzit e devotshëm, pa qenë të detyruar, nuk kanë preferuar të qëndrojnë as në hijen e vendeve ku janë vepruar harame, sepse edhe aty ka rrezik të ndotjes së pastërtisë së zemrës. Kujdesi dhe qëndrimi larg këtyre vendeve është shenjë e devotshmërisë. Sepse hapi i parë për t'u mbrojtur nga mëkatet është qëndrimi larg tyre.



Ashtu siç e kërkon "mjekësia parandaluese" qëndrimin larg vendeve me mikrobe, kujdesin ndaj pastërtisë dhe forcimin e sistemit mbrojtës të organizmit ndaj viruseve për të mos u sëmurur, ashtu edhe myslimani duhet të ketë një ndjeshmëri të tillë kundër gjynaheve dhe njerëzit e këqij, e veçanërisht ndaj ndikimeve negative të televizionit, internetit dhe modës, të cilat janë ndër fatkeqësitë më të përhapura të kohës sonë.



Kushtet e jashtëzakonshme në të cilat jetojmë sot për shkak të epidemisë, duhet të na çojnë në vetë llogaritje në shumë aspekte. Prandaj duhet të mendojmë se:

- Deri në çfarë mase e zbatojmë rregullin e distancës sociale, që respektojmë për t'u mbrojtur nga viruset, për të ruajtur shëndetin tonë shpirtëror? Pra, a jemi ne në gjendje të distancohemi nga haramet, veprat e papëlqyeshme, vitrinat djallëzore, ekranet që nxisin nefsin për keq dhe ata nga të cilët Allahu është i zemëruar?

- Ndërkohë që dezinfektojmë duart dhe shtëpinë, a mundemi t'i pastrojmë zemrat tona nga ndyrësia e gjynahut dhe shkujdesjes, me lotët e pendimit, istigfarit dhe keqardhjes?

- Duke mediturar rreth masave të karantinës që kemi marrë për të mbrojtur veten dhe familjen tonë nga sëmundjet, a mund ta rrisim ndjeshmërinë tonë për t'u mbrojtur nga epidemitë në botën shpirtërore të shoqërisë; pra, nga idetë dhe besimet superstticioze, mungesa e sjelljeve të mira dhe modestisë?

- Ashtu siç marrim suplemente vitaminash për të mbështetur sistemin tonë imunitar dhe i kushtojmë vëmendje ushqimit tonë për shëndetin tonë fizik, a mund t'i përmbahemi edhe masave të takvasë që do të rrisin rezistencën tonë shpirtërore kundër gjynaheve për shëndetin dhe sigurinë e shpirtrave tanë?



Ashtu siç është e nevojshme të merren masa materiale, veçanërisht pastrimi/higjiena kundër epidemisë, e cila është një fatkeqësi e madhe mbarë botërore, është e nevojshme të merren edhe masa paraprake të "takvasë" deri në frymën e fundit kundër fatkeqësive shpirtërore që shkatërrojnë shpirtrat. Kjo, e bën të domosdoshme të mbajmë dorën, gjuhën, sytë, veshët, mendjen dhe zemrën të pastër nga papastërtitë e gjynaheve.



Ebu'l-Hasan Harakani thotë:

"Allahu i Madhëruar ju dërgoi të pastër në këtë botë, prandaj mos dilni të papastër para Tij!"



Megjithëse njeriu e ka burimin nga uji i turbullt, kur lind ai ka aromë të këndshme, sy të përdritur dhe aftësi për të paqtuar

zemrat. E gjitha kjo zë fill prej të qenit të tij i pafajshëm dhe i pastër nga gjynahet. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar dëshiron që ne të mbetemi të dëlirë ashtu siç jemi dërguar në këtë botë, të bëjmë një jetë të pastër, të kemi librin e punëve të panjollosur dhe të kthehemi përsëri tek Ai me zemër të kulluar.

Allahu në Kuran thotë:

"**Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!"** (Shu'ara, 88-89.)



Ebu'l-Hasan el-Harakani thotë:

"Kyçe gjuhën tënde në atë mënyrë që të mos flasë gjëra për të cilat Allahu nuk është i kënaqur! Kyçe zemrën tënde në atë mënyrë që të mos anojë aty ku Allahu nuk është i kënaqur!"

"Kyçe gojën tënde në atë mënyrë që të mos kalojë asgjë e ndaluar! Po ashtu ruaji edhe gjymtyrët e tjera të trupit tënd që të mos e humbasin sinqeritetin."



Kur zemra pushtohet plotësisht nga njollat e gjynaheve, ajo zhytet në errësirën e indiferencës dhe ngurtësimit. Pluhurat dhe njollat që formohen me kalimin e kohës mbi një pasqyrë, e turbullojnë kthjelltësinë e saj. Në të njëjtën mënyrë, edhe njollat e gjynaheve e verbojnë syrin e zemrës dhe e paaftësojnë njeriun në dallimin e të bukurës dhe të shëmtuarës, të mirës dhe të keqes. Pas një farë kohe, shuhet edhe drita e besimit që i jep jetë zemrës. Një kraharor i tillë, tashmë nuk ndryshon aspak nga një varr që mban brenda një kufomë.



Le ta krahasojmë zemrën me një gotë të pastër dhe të imagjinojmë sikur po e mbushim me cilësi të mira si besimi, dashu-

ria dhe mëshira. Nëse në këtë gotë bie një pikë papastërtie, a do të mbetet në të ndonjë gjurmë prej bukurisë së saj? Fare! Ja pra, kështu janë veset e shëmtuara si urrejtja, smira, arroganca, lakmia, mosmirënjohja dhe gjynahet të cilat janë pasqyrimi i tyre në vepra, si përgojimi, gënjeshtra, shpifja dhe shpërdorimi. Këto janë si pika papastërtie që helmojnë botën tonë të zemrës.



Për hir të emrit të bukur të Tij, "es-Settar", Zoti ynë ua ka mbuluar shumë gjynahe robërve të Vet dhe i ka bërë pika të zeza të fshehura në zemër. Në fakt, kjo është nga mëshira e Tij e pafund, sepse, nëse rezultati i mëkateve të kryera nuk do të shfaqej në formën e një njolle të zezë në zemër, por në ballë, askush nuk do të guxonte të shikonte dikë tjetër...



Largimi nga çdo lloj harami dhe gjynahu, është thelbi i një devotshmërie e cila nuk do të na turpërojë kurrë përpara Allahut Teala. Në mënyrë të veçantë, është kusht të kemi kujdes ndaj shumë gjynaheve të mëdha e shkatërruese, të cilat janë injektuar në shoqërinë tonë si gjynahe të rëndomta.



Në këtë kohë, ne duhet të jemi të kujdesshëm, veçanërisht me sytë tanë, sepse pamjet e disa rrugëve dhe rrugicave, adresave të gabuara të internetit dhe programeve negative të televizionit po helmojnë shpirtrat. Syri sheh, por zemra mban peshën e pakujdesisë dhe zymtësisë së tij.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Shikimi i haramit është një prej shigjetave të helmuara të Iblisit. Kushdo që e braktis shikimin e haramit për shkak të frikës ndaj Allahut, Ai do t'i dhurojë një besim, ëmbëlsinë e të cilit do ta ndiejë në zemër." (Hakimi, IV, 349/7875.)



"O Ali, mos i shto shikimit një shikim të dytë! I pari është shikimi yt, tjetri është i shejtanit!" (Tirmidhi, Edeb, 28; Ebu Davud, Nikah, 44.)

Pra shikimi i parë i pavullnetshëm është i justifikuar kurse vazhdimi i shikimit është haram. Për shembull, çdo makina ka targa. Por kur njerëzit shohin një makinë, nuk vështrojmë me vëmendje për të lexuar targën. Pikërisht kështu edhe ne jemi të prekur nga peizazhet negative që hasim në shoqëri. Ne duhet të mbrohemi nga ky mjedis armiqësor.



Kur një besimtar ndeshet me diçka që i kënaq shpirtin, fillimisht duhet të ndalet dhe të mendojë: Ai duhet të peshojë çdo gjë që bën me kriteret hyjnore dhe të vendosë nëse është vërtet e dobishme apo e dëmshme për jetën e tij në këtë botën dhe në ahiret, duke e filtruar atë përmes «takva»-së.

Nuk duhet harruar se; shumë gjëra që nga jashtë duken si mirësi, në fakt mund të jenë shkak i një fatkeqësie të përjetshme. Në fakt, i Dërguari i Allahut në një hadith ka thënë:

"Xhehenemi është i rrethuar me gjëra që i pëlqejnë nefsit (egos); ndërsa xhenneti është i rrethuar me gjëra që nuk i pëlqejnë nefsit." (Buhari, Rikak, 28; Muslim, Xhenet, 1.)



Abdulkadir Gejlani, ka thënë:

"O bir! Kur të mbledhësh pasuri, mos u bëj si ai njeriu që mbledh dru natën, por që nuk e di se çfarë ka fituar. Ki kujdes nëse pasuria që ke fituar është hallall apo haram, është e lejuar apo e ndaluar. Të gjitha veprat e tua bëji sipas tevhidit dhe devotshmërisë."



Besimtari nuk duhet të harrojë se kjo botë është vend sprove, e jeta e vërtetë, është jeta e ahiretit. Për këtë arsye, ai nuk duhet të veprojë sipas qejfit, pa marrë parasysh hallallin dhe haramin. Lukman Hakimin e pyetën:

- Nga kush e mësuat urtësinë?

Ai dha edhe këtë përgjigje:

- Urtësinë e mësova nga të verbrit, sepse ata nuk bëjnë një hap pa e ndjerë vendin me shkopinjtë e tyre.



Omer bin Abdulazizit ka thënë:

"Haramet janë zjarr. Drejt tyre e zgjasin dorën vetëm ata që kanë zemra të vdekura. Nëse ata që i zgjasin duart do të kishin zemra të gjalla, patjetër që do ta ndjenin djegien e atij zjarri."



Indiferentizmi është një lloj verbërimi shpirtëror, është si një perde që pengon shikimin e zemrës. Gafleti e bën njeriun të ecë drejt vendeve të mbushura me mina.



Omeri ﷺ, ka thënë:

"Ai që nuk e njeh të keqen bëhet preh e saj."



Jahja bin Muadh, gjendjen e njerëzve të shkujdesur që harrojnë botën tjetër dhe nuk i shmangen mjaftueshëm gjynaheve, e shpjegon me këtë shembull:

"Është për t'u habitur me një person që largohet nga ushqimi hallall nga frika e sëmundjes, por nuk largohet nga harami nga frika e xhehenemit."



Bishr bin Haris el-Hafi, shprehet:

"Në qoftë se njerëzit meditojnë ashtu siç u ka hije rreth madhështisë së Allahut, ata nuk do të tregoheshin të pabindur ndaj urdhrave të Tij dhe nuk do të bënin gjynahe." (Ibn Kethir, I, 448.)



Kur Kasëm bin Muhammed, dëgjoi dikë të thotë për një tjetër:

"-Sa i guximshëm është filani përballë Allahut!", ai e qortoi duke i thënë:

"-Biri i Ademit nuk mund të jetë i guximshëm përball Allahut! Në lidhje me të, mund të thuash vetëm: Sa pak e njeh Allahun ai njeri!" (Ibn-i Asakir, Tarihu Dimashk, V. 49, fq. 180.)



M. Sami Ramazanogllu thotë:

"Fëmijën që kundërshton një baba të butë, e quajnë të çmendur. Prandaj, çfarëdo që të thuhet për atë që kundërshton urdhrat e Allahut të Madhëruar, i Cili është më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve, është vërtet pak!.."



Shejh Sadiu ka thënë:

"Kur babai im ishte duke i dorëzuar shpirtin Allahut, më këshilloi kështu:

«Biri im! Çdo dëshirë egoiste që të largon prej Allahut, është një zjarr i frikshëm, prandaj ruhu prej saj! Mos ia ndiz vetes zjarrin e Xhehenemit! Nëse nuk ke forcë të digjesh në atë zjarr, hidhi ujë që sot me durim!»"



ÇERDHJA E NGROHTË FAMILJARE

Çerdhja më e lumtur në botë, është familja e Profetit tonë, Muhamedit ﷺ. Ai është shembulli më i mirë i një kryefamiljari dhe një babai ideal.

Ndërsa shembujt më të bukur të grave të devotshme, janë Hadixheja, Fatimeja, Aishja dhe nënat tona të tjera. Fëmijët e edukuar sipas kritereve të tyre, marrin shembull prej nipërve të nderuar të Profetit tonë ﷺ, Hasanit dhe Husejnit. Ja pra, vetëm atëherë fëmijët tanë do të jenë pasardhës të mirë dhe sadaka të rrjedhshme për ne.

Martesa është rruga e profetëve, Suneti i Resulullahut ﷺ, pranvera e brezave, nderi dhe edukata e burrit dhe e gruas, kështjella e namusit dhe dinjitetit dhe privilegj për njeriun.

Muhjiddin Arabiu -Allahu e mëshiroftë-, në lidhje me virtytin e nxitjes së martesës dhe ndihmesës së të martuarve, thotë:

"Sadakaja e rrjedhshme më e mirë, është të bëhesh shkak i një martese, sepse njeriu fiton shpërblime prej çdo mirësie që do të bëjnë ata që do të lindin prej asaj martese."

Allahu i Madhëruar shprehet:

"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë." (Rum, 21.)

Në bashkimin e mrekullueshëm të dy personave të panjohur me anë të nikahut, fshihen mësime dhe urtësi të holla që i mahnitin mendjet. Lidhja e zemrave të dy të rinjve të panjohur të cilët janë ndarë nga shtëpia e prindërve, me dashurinë dhe mëshirën që ka falur Allahu midis tyre, madje të jetojnë me një sinqeritet të ngrohtë dhe joshës, aq sa të lënë në hije edhe çerdhen e prindërve prej të cilëve janë ndarë, është manifestimi i një urtësie shumë madhështore.

Allahu i Madhëruar, dëshiron që robi të jetojë me nder dhe në paqe. Dhe gjëja më e bukur që siguron nderin, është martesa. Ashtu siç duhet të martohen ata që kanë mundësi të martohen, ashtu edhe martesa e atyre që nuk kanë mundësi, është një detyrë fetare që i është ngarkuar shoqërisë islame. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

"I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju! Po ashtu edhe skllevërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu do t'i begatojë ata me mirësinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshëm." (Nur, 32.)

Në periudhën e Perandorisë Osmane, janë ngritur vakëfe të posaçme për të kryer këtë shërbim të lartë, sepse rregulli dhe morali i shoqërisë, janë të lidhur fort me jetën e ndershme dhe të qetë të individëve.

Nuk duhet harruar se; elementi më themelor që e mban në këmbë një popull, është struktura fetare dhe morale. Dhe, mënyra më efikase e formimit dhe mbrojtjes së një strukture të tillë, është nikahu. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ﷺ, duke e porositur umetin e tij në lidhje me lehtësimin e tij, thotë:

"Nikahu më i mirë, është ai më i thjeshti." (Ebu Daud, Nikah, 32.)

Për rrjedhojë, mund të themi se; zakonet që e vështirësojnë nikahun, duke kërkuar shpenzime të tepërta, janë zbatime të dëmshme, të cilat i vonojnë martesat ose i bëjnë ato të pamundura.

Duhet theksuar se; të bësh dasma me shpenzime të mëdha, të cilat bëhen shkak rrënimi për familjet, është diçka që Islami nuk mund ta pranojë kurrë. Kjo, sepse Islami urdhëron të bëhet

kujdes të mos shpërdorohet uji edhe kur merret abdest në një lum që rrjedh, dhe kërkon të mësohemi të veprojmë me maturi dhe përmbajtje.

Për rrjedhojë, edhe nëse familjet janë të pasura, ato duhet të veprojnë duke zgjedhur rrugën e mesme dhe duke menduar për nevojtarët dhe të mjerët që jetojnë në shoqëri. Në ditët tona, shumë të pasur (myslimanë) i bëjnë dasmat madhështore, duke dashur të tregojnë pasurinë e tyre të madhe, gjë e cila i shpie në çmendurinë e shpërdorimit. Por, të gjitha këto tregojnë se ata nuk e kanë përvetësuar ashtu siç duhet Islamin.

Sot, një nga aspektet më të kompromet uara të takvasë, janë qëndrimet joislame të ekspozuara në ceremonitë e dasmave. Shoqëri të tilla, ku bijtë tanë fillojnë një jetë të re, duhet të ring-jallen me lexime të Kuranit, lutje, biseda shpirtërore dhe gosti në të cilat ftohen të varfrit.

Fatkeqësisht, në ditët e sotme, ceremonitë e dasmave, të cilat ngjajnë me një sfilatë, ku ndjeshmëria e privatësisë dobësohet, ftohen të pasurit dhe harrohen të varfrit, kthehen në një furi shpërdorimi dhe një shfaqje pushteti.

Këto janë skena që largojnë mëshirën hyjnore dhe tërheqin zemërimin. Të hedhësh një hap në një rrugë të bekuar si martesa me një fillim të keq, është një shkujdesje dhe injorancë e madhe. Të mos harrojmë se; Islami është një tërësi. Ai nuk mund të jetohet në disa faza të jetës dhe të braktiset në disa faza të tjera. Ne duhet të rregullojmë çdo fazë të jetës sonë me standardet e Islamit, në mënyrë që mëshira e Allahut të Madhëruar të shfaqet mbi ne.

Allahu ka vendosur që njeriu të krijojë familje në mënyrë legjitime. Vetëm në këtë mënyrë mund të krijohet një familje e

lumtur dhe e qetë. Në një familje të tillë secili anëtar luan rolin e vet në familje.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

"*Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete). Imami është çoban dhe përgjegjës për tufën e tij. Burri është çobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij. Gruaja është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj. Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet.*" (Buhari, Ahkam,1; Muslim, Imaret 20.)

Babai, është një diell në qiellin e lumturisë familjare, ndërsa nëna është një hënë, e cila në veten e saj, ka derdhur në argjend shkëlqimin e zemrës dhe perden e nderit. Kurse fëmijët, janë yje si perla në qiejt e virtytit. Një baba, i cili ia ka kushtuar mendjen, fuqinë, vullnetin, dijen dhe përvojën e tij, edukimit, prosperitetit dhe përsosmërisë së familjes, pa asnjë dyshim, meriton respekt, bindje dhe dashuri. Mosbindja, kryeneçësia, mosmirënjohja dhe fjalët e këqija ndaj tij, nuk janë aspak të hijshme. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, ka thënë:

"Kënaqësia e Allahut, është e fshehur në kënaqësinë e babait. (Po ashtu) Edhe zemërimi dhe dënimi i Tij, është i fshehur në zemërimin dhe nevrikosjen e babait." (Tirmidhi, Birr, 3.)

Ajo ishte një familje aq e lumtur dhe e qetë, saqë, megjithëse në shtëpinë e tyre për ditë të tëra nuk gatuhej ushqim për shkak të varfërisë, aty buronte vetëm gëzim, lumturi, qetësi dhe harmoni. Dhomat e bashkëshortëve ishin shumë modeste dhe të thjeshta. Megjithatë, ajo familje ishte shembull tipik i mirësisë, kënaqësisë, durimit dhe nënshtrimit të plotë.

Në jetën familjare duhet të sundojë dashuria, respekti harmonia dhe sakrifica, të gjitha këto nën atmosferën shpirtërore.

- Asnjë grua nuk mund ta dojë bashkëshortin ashtu siç e kanë dashur bashkëshortet Profetin ﷺ.

- Asnjë burrë nuk mund t'i dojë bashkëshortet ashtu siç i ka dashur Profeti ﷺ.

- Asnjë fëmijë nuk mund ta dojë babanë e vet si Fatimja رضي الله عنها.

- Asnjë baba nuk mund ta dojë fëmijën e tij siç i donte i Dërguari i Allahut ﷺ.

Profeti ﷺ, e përshkruan kështu atmosferën e dashurisë në familje:

"Kush zgjon gruan në mesin e natës dhe të dy së bashku falin nga dy rekat namaz, Allahu i shkruan midis burrave dhe grave që përmendin shumë Allahun." (Ebu Davud, Tatavvu 18, Vitir 13.)

"Allahu e mëshiroftë burrin i cili ngrihet për të falur namaz nate, zgjon edhe gruan e tij dhe, nëse ajo nuk zgjohet, ia lag fytyrën me ujë. Gjithashtu, Allahu e mëshiroftë edhe gruan, e cila zgjohet për të falur namaz nate dhe e zgjon burrin e saj, E, nëse ai nuk zgjohet, ia lag fytyrën e tij me ujë." (Ebu Davud, Tatavvu 18, Vitir 13.)

Babai im i nderuar Musa Efendi, i këshillonte kështu të porsamartuarit:

"Burri dhe gruaja duhet të jenë të mëshirshëm me njëri-tjetrin. Dhembshuria dhe mëshira juaj e vërtetë mund të kuptohen duke mbështetur njëri-tjetrin në rrugën e Allahut. Zgjimi i njëri-tjetrit për namazin e natës dhe të sabahut konsiderohet një shenjë e mëshirës së vërtetë."

Në Epokën e Lumturisë, gratë sahabe, i pyesnin burrat e tyre kur vinin në shtëpi në mbrëmje:

"-Cilat ajete u shpallën sot? Çfarë mësuat në nga i Dërguari i Allahut?». Po ashtu, ato këmbëngulnin që fëmijët e tyre të frekuentonin kuvendet e Profetit ﷺ.

Ne duhet ta rishikojmë botëkuptimin tonë në lidhje me çerdhen tonë familjare. Ajo çerdhe e shenjtë, nuk është as hotel dhe as vend shkujdesjeje. Ajo është një kopsht zemre ku mblidhen frytet e dashurisë, solidaritetit dhe shërbimit për hir të Allahut. Trëndafilat, zymbylat dhe bilbilat e këtij kopshti duhet të gjejnë gëzim në frymëzimin shpirtëror të Kuranit dhe Sunetit, në mënyrë që jeta jonë e përjetshme të mbushet me paqen dhe bukurinë e një klime të qetë pranverore.

Mevlana thotë:

"Aromën e këndshme, trëndafili e fitoi sepse shkonte në harmoni me gjembin. Këtë të vërtetë dëgjoje nga vetë trëndafili. Dëgjo çfarë thotë:

Pse të hidhërohem nga bashkëjetesa me gjembin, pse të pikëllohem? Unë, që të qeshurën e fitova duke duruar qëndrimin bashkë me të. Nëpërmjet tij, gjeta mundësinë për t'i dhuruar gjithë botës aroma të këndshme."

Bashkëshortët duhet të mendojnë për cilësitë e mira të njëritjetrit në kohë të vështira dhe duhet të bëjnë durim duke i kujtuar ato. Andaj në një hadith fisnik thuhet:

"Besimtari nuk duhet të ushqejë ndjenja të këqija për gruan e tij! Nëse atij nuk i pëlqen një zakon i saj, do t'i pëlqejë një zakon tjetër." *(Muslim, Rada, 61.)*



Në kohën e kalifatit të Omerit ﷺ, një burrë erdhi te shtëpia e kalifit që të ankohej për sjelljet e papëlqyeshme të bashkëshortes së tij. Ai u ul përpara derës dhe filloi të priste që Omeri të dilte nga shtëpia. Ndërkohë që po priste, nga brenda erdhi një zë i lartë. Gruaja e Omerit po i bërtiste me të madhe gjithë atij kalifi, por Omeri ﷺ, as që e hapte gojën për t'i thënë ndonjë fjalë. Kur dëgjoi këtë, burri i shkretë uli kokën dhe tha me vete:

"Kur e ka gjendjen kështu edhe Omeri, pavarësisht fuqisë dhe ashpërsisë së tij, e për më tepër që është edhe prijës i besimtarëve, si mund t'i gjejë ai zgjidhje hallit tim?" Kështu, u nis të largohej. Në atë kohë Omeri ﷺ, doli nga shtëpia dhe i thirri burrit nga pas:

"Urdhëro, çfarë halli kishe?"

Burri u përgjigj kështu:

"O prijësi i besimtarëve! Pata ardhur të ankohesha për sjelljen e keqe të bashkëshortes sime dhe mosrespektin që tregon ajo ndaj meje. Kur dëgjova që edhe gruaja juaj nuk la gjë pa ju thënë, hoqa dorë dhe thashë me vete: «Kur sillet kështu edhe gruaja e prijësit të besimtarëve, si mund t'i gjejë ai zgjidhje problemit tim?»"

Atëherë Omeri ﷺ, i tha këto fjalë atij burri:

"Vëlla, përpiqem të jem durimtar me gruan time për shkak të të drejtave që ka ajo mbi mua, sepse ajo për mua është kuzhiniere, është furrtare, është rrobalarëse, është edhe nëna e fëmijëve të mi. Për më tepër ajo nuk e ka aspak për detyrë t'i bëjë këto. Mbi të gjitha, ajo është personi që më pengon të bie në haram. Prandaj edhe bëj durim ndaj çdo sjelljeje të saj."

Kur dëgjoi këto fjalë, burri tha:

"O prijësi i besimtarëve! Edhe gruaja ime kështu është."

Nisur nga kjo Omeri, ﷺ, i tha:

"Atëherë vëlla, mundohu ta durosh bashkëshorten tënde! Jeta kalon sa hap e mbyll sytë." (Dhehebi, el-Kebair, fq. 179.)

Sot, pavarësisht rritjes së mirëqenies materiale, marrëdhëniet familjare janë dobësuar, divorcet janë shtuar, familjet janë përçarë dhe depresioni e problemet psikologjike janë shtuar. Këto janë pasojat e trishtueshme të largimit nga spiritualiteti dhe i zhytjes në jetën e dëshirave të egos.

Pra, si pasojë e programeve negative të televizioneve që nxisin egot, adresave të gabuara të internetit që përhapin imoralitet, mashtrimeve të modës dhe reklamave që ndezin pasionet, bota brendshme e njerëzve është kthyer përmbys dhe peizazhi shpirtëror i shumë prej tyre, i ngjan një spitali fushor.

Dëmet e tërmeteve materiale mund të kompensohen deri në një masë, por nëse nuk merren masat paraprake të nevojshme kundër tërmeteve shpirtërore, shoqëritë nuk mund t'i shpëtojnë rënies në shkatërrim shpirtëror.

Sot, janë shfaqur trazirat «Fund-Kohës». Kanë ardhur ditët kur shejtani është ortak në pronë dhe fëmijë. Në një kohë të tillë, është shumë më e vështirë se dje të kërkosh dhe të gjesh hallall. Por nga ana tjetër, t'i kushtosh vëmendje kësaj, është shumë më e rëndësishme dhe më e vlefshme se dje...

Islami i refuzon plotësisht marrëdhëniet e kalbura dhe të mjera që thuajse e vrasin familjen, e cila është thelbi i shoqërisë. Për këtë arsye, veprën e «zinasë», Islami e ndalon si një nga hara-

met më të rënda, e cila është më e keqja nga poshtërsitë jashtë martesore. Kjo vepër e shëmtuar, është një sulm i egër ndaj elegancës, bukurisë dhe legjitimitetit të martesës; është një vrasje mizore që shkatërron të ardhmen e njerëzimit. Nuk mund të ketë marrëzi dhe injorancë më të madhe sesa të ndërrosh një botë lumturie dhe paqeje si martesa me ndyrësinë e imoralitetit dhe prostitucionit!..

Në Kuran, Allahu i Madhëruar na njofton për disa nga popujt që i ka shkatërruar për shkak të mendjemadhësisë, zullumit, mohimit të botës tjetër, imoralitetit dhe mashtrimit në jetën tregtare, -në mënyrë që të marrim një mësim-; si populli i Adit, i Themudit dhe i Shuajbit...

Por më i keqi prej tyre, ishte populli i Lutit. Fatkeqësisht, homoseksualiteti i popullit të Lutit ﷺ, që është perversiteti më famëkeq dhe paturpësia më e tmerrshme, në injorancën e sotme moderne po promovohet si një "e drejtë njerëzore". Ky turp, që është kundër natyrës njerëzore, e që edhe kafshët nuk e i afrohen, helmon botën shpirtërore të individit, familjes dhe shoqërisë.

Një turp i tillë, është përshkruar kështu nga Zoti i Madhërishëm në Kuran:

«Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbura» (Furkan, 44.)

Prandaj, të përpiqesh që ta tregosh një vepër të tillë si diçka të pafajshme dhe normale nën parullën e «lirisë» dhe «të drejtave të njeriut» është forma më e keqe e këtij imoraliteti...

Familje do të thotë martesë, nder. Dëlirësia, nderi dhe dinjiteti i burrave dhe grave ruhen më së shumti në një çerdhe familjare të krijuar me anë të martesës.

Nderi është një cilësi njerëzore. Pandershmëria apo imoraliteti, nga ana tjetër, është braktisje e dinjitetit njerëzor; është një jetë e papërgjegjshme, e turpshme dhe vulgare si kafshët. Për më tepër, kafshëve nuk u janë dhënë cilësi si mendja dhe ndërgjegjja. Për këtë arsye, ato nuk mund të fajësohen për jetën e tyre. Po njeriu?

Malik bin Dinar thotë:

«Allahu nuk e ka ndëshkuar kurrë një zemër, aq sa atë që e ka zhveshur nga turpi.»

Sipas thënies së sahabëve, i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte më i turpshëm dhe më i kujdesshëm se një vajzë e virgjër e veshur me mbulesën e saj. (Shih. Buhari, Adab, 77.)

Feja jonë i ka dhënë shumë rëndësi nderit. Merjemja është lëvduar në Kuran për shkak të pastërtisë dhe nderit të saj dhe për këtë është përmendur plot 34 herë. Asnjë grua nuk e ka pasur nderin të përmendet kaq shumë sa Merjemja në Kuran.

Osmani thotë:

"Sa perde e bukur e epshit është ruajta e syrit nga harami."

Mevlana thotë:

"Epshi, i cili i ngjan zjarrit, nuk pakësohet duke u djegur. Ai pakësohet duke mos i dhënë atë që dëshiron. A shuhet zjarri kur i hedh dru?"

Sot, paturpësia u imponohen brezave tanë të rinj, veçanërisht me anë të publikimeve negative, vitrinat, modat dhe reklamat djallëzore. Kështu, si rezultat i parullave: "Të gjithë vishen kështu; të gjithë bëjnë kështu...", njerëzve u ka plasur cipa e turpit.

Mirëpo, për t'u mbrojtur nga problemet materiale dhe morale, është e domosdoshme të respektohet me përpikëri modestia dhe ndjenja e turpit.

Babai ynë Ademi عليه السلام dhe nëna jonë Havaja, u mbuluan nga turpi si shenjë e parë e keqardhjes dhe pendimit. Pra, edhe pse në xhenet nuk kishte asnjë qenie njerëzore përveç tyre, ata u përpoqën të mbuloheshin me turp. Kjo pra i ka hije edhe një besimtari që dëshiron të mbrohet nga dënimi hyjnor.

Gjërat e vlefshme dhe të çmuara ruhen dhe mbrohen gjithmonë. Një diamant i çmuar nuk mund të mbahet dhe të shfaqet në publik. Kështu, edhe hixhabi i gruas, është gjithashtu shprehje e vlerës së lartë që Islami ia atribuon asaj.

Islami i urdhëron dhe i këshillon gratë që me anë të mbulesës t'i mbajnë të mbuluara stolitë e tyre. Hixhabi ia mundëson një gruaje të shpalosë bukurinë e saj vetëm tek burri i saj dhe t'i mbulojë ato ndaj të huajve. Kjo ruan dinjitetin dhe nderin e gruas.

Një nga problemet më të rëndësishme të kohës sonë, është se ndjeshmëria e mbulesës ka filluar të zhduket. Hixhabi nuk ka të bëjë vetëm me mbulimin e kokës. Fatkeqësisht, sot, shumë gra myslimane veshin fustane të ngushta, pantallona etj., të cilat nuk i përshtaten shpirtit të hixhabit.

Mirëpo, Allahu i Madhëruar në një ajet urdhëron:

"O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth

trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët...” (Ahzab, 59.)

Xhilbabi i urdhëruar në ajet, është një veshje e jashtme që hidhet mbi një rrobë normale, e cila nuk zbulon linjat trupore dhe shërben për të mbrojtur femrat nga shikimet e burrave të huaj. Me fjalë të tjera, nuk është thjesht mbulim i kokës.

Resulullahu ﷺ, kur pa që motra e madhe e nënës sonë Aishes رضي الله عنها, Esmaja, kishte veshur një rrobë transparente, ka kthyer kokën dhe, duke i treguar fytyrën dhe duart, i ka thënë:

“Esma! Pasi femra hyn në moshën e pubertetit, nuk është e drejtë që ajo të shfaqë tjetër pjesë nga trupi, përveç këtyre e këtyre!”
(Ebu Davud, Libas, 31/4104.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me ato që vishen vetëm për t’u stolisur, që veshin rroba tërheqëse kur dalin jashtë dhe që veshin rroba të ngushta dhe transparente për të treguar linjat e tyre trupore, ka përdorur shprehjen; «lakuriqë të veshur».

Gratë duhet të mbulojnë të gjithë trupin e tyre, përveç duarve, fytyrës dhe këmbëve. Ndërsa burrat duhet të mbulojnë zonën midis kapakut të gjurit dhe barkut. Rrobat që janë aq të holla sa tregojnë pjesët intime dhe aq të ngushta sa tregojnë linjat trupore, nuk duhet të vishen. Përveç kësaj, çdo burrë dhe grua është i lirë të vishet sipas shijes, kulturës, kushteve dhe mundësive personale dhe lokale, me kusht që të mbulojë pjesët intime.

Mirëpo sot, brezat që rriten të pavetëdijshëm në shoqëri janë të rrëmbyer furia e modës, ashtu si trungjet që merren para në një përmbytje. Burra me vathë që ecin me pantallona të shkurtra, rroba të shthurura e të grisura dhe prerje flokësh që i bëjnë

meshkujt të duken si femra dhe femrat si meshkuj, fatkeqësisht kanë gjetur vend edhe në shoqëritë myslimane nën pretekstin e «modës».

Mirëpo, Islami dëshiron që burrat dhe gratë të jetojnë në përputhje me personalitetet dhe karakteristikat e tyre. Prandaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka mallkuar burrin që përpiqet të imitojë femrat dhe gruan që përpiqet të imitojë meshkujt.

Në periudhën moderne po propagandohet fort barazia gjinore. Kjo ka sjellë dëmtimin e natyrës së gruas, për të cilën ajo është krijuar, humbjen e qetësisë familjare, dëmtim të personalitetit të individit dhe tronditje të jetës shoqërore.

Femra nuk mund të jetë e barabartë me mashkullin, sepse natyra fizike dhe shpirtërore e saj nuk janë të njëjta me të mashkullit. E rëndësishme nuk është barazia midis gjinive, por ekuilibri i të drejtave dhe detyrave midis tyre.

Islami nuk e detyron gruan të bëjë punët e botës jashtë vullnetit të saj. Për shkak të dallimit në natyrë dhe përgjegjësi, dhënia e të drejtave dhe përgjegjësive të veçanta për gratë dhe për burrat, është vetë drejtësia.

E kundërta, pra, të detyrosh gratë të jenë të barabarta me burrat duke injoruar dallimet e tyre natyrore, në të vërtetë, është e padrejtë dhe e pamëshirshme. Në fakt, hulumtimet tregojnë se në Perëndim gratë janë të shtypura në shkolla dhe në botën e biznesit, dhe ato detyrohen të bëjnë të njëjtën punë me burrat, por për më pak para.

Botëkuptimi që i nxiti gratë jashtë shtëpive me parullat "barazi, konkurrencë, karrierë, liri", e ka dobësuar jashtëzakonisht shumë

institucionin e familjes. Sot, familja në botën perëndimore është në shkatërrim. Gruaja ka mbetur në mes të tragjedive, ka humbur pozitën si nënë dhe është braktisur e vetme përballë sulmeve fizike e shpirtërore të meshkujve pamëshirë. Prandaj, t'i falësh asaj «braktisjen» nën emrin e «të drejtave dhe lirive të saj», është një absurditet që i shkon vetëm botës perëndimore.

Në Evropë, rendi njerëzor është prishur si pasojë e detyrimit të grave që punojnë jashtë natyrës së tyre, duke ia përkëdhelur asaj egon. Tani, popullsia në Evropë po zvogëlohet dhe familja po dobësohet dita ditës. Mirëpo, a quhet «dhënie e të drejtave të grave», t'i shtysh ato të garojnë si kuajt e garës në botën e vrazhdë të burrave dhe në të njëjtat kushte, që t'i marrësh asaj shpirtin dhe ta detyrosh t'i thotë lamtumirë natyrës së saj femërore?!.

A quhet «shoqëri që respekton gratë» thyerja e kristaleve dhe e mbushjes së rrugëve me copa xhami?!. Vallë, a është mirësi, që gruan e privuar nga mëmësia, ta bësh një mjet në fushën e biznesit, ku duhet të përdorë sharmin e saj në punë dhe t'i nënshtrohet orarit të punës?!.

Në kohët kur udhëtimet bëheshin mbi deve, njerëzit i nxitnin devetë me ritmin e shkretëtirës. Në një udhëtim të tillë, një shërbyes i quajtur Enxheshe, i nxiste devetë duke kënduar ode. Mirëpo, kjo shpejtësi, mund të mos ishte e përshtatshme për gratë që ndodheshin në kabinën sipër devesë. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, tha:

"O Enxheshe! Kujdes mos na thyhen qelqurinat!" (Buhari, Edeb, 95; Ahmed, III, 117.)

Kështu, duke aluduar gratë, Profeti ﷺ, u shpreh sikur ato të ishin enë kristali për të cilat duhet treguar shumë kujdes. Si natyrë, burrat janë më të fortë, kurse gratë më të ndjeshme dhe

të brishta. Profeti ﷺ, edhe gjatë udhëtimit tregonte kujdes për gratë në mënyrë që të mos lodheshin nga kushtet e vështira të udhëtimit.

Në epokën tonë ka nisur tashmë një garë artificiale dhe e padrejtë a barazisë midis burrave dhe grave. Kjo garë që bie në kundërshtim me tiparet e natyrshme të krijimit të gruas, ka sjellë me vete dobësimin e rolit të gruas në familje dhe misionit të saj të mëmësisë duke rezultuar në dëmtimin e jetës familjare.

Për këtë arsye, rastet gjithnjë e në rritje të aborteve në ditët e sotme, nuk janë gjë tjetër vetëm se një formë e modernizuar e groposjes gjallë të vajzave të periudhës së injorancës, pra një formë vrasjeje e këtij shekulli.

Edhe në injorancën moderne, amësia përbuzet; sjellja në jetë e një fëmije, shihet si një dëm që do të prishë bukurinë e trupit dhe të bëhesh me fëmijë konsiderohet një barrë e rëndë. Si rezultat i këtij botëkuptimi, shumë fëmijë vriten në barkun e nënave me anë të abortit. Madje, kjo vrasje mbrohet sikur të ishte "e drejtë dhe liri e gruas". Mirëpo, vrasja me anë të abortit nuk mund të konsiderohet kurrë e pafajshme, përveçse në rastet kur rrezikohet jeta e nënës ose e fëmijës!

Sipas transmetimit të Katades, arsyeja pse vajzat groposeshin të gjalla në periudhën e injorancës nga fiset arabe të asaj kohe ishte:

"Nga frika e nëpërkëmbjes së nderit të tyre në rast robërimi nga fiset e tjera si dhe druajtja nga varfëria."

Për t'iu shmangur kësaj gjendjeje, thuhet se i vrisnin fëmijët e tyre vajza që në moshë të vogël dhe në vend të tyre ushqenin qentë. (Taberî, Tefsîr, VIII, 68, [el-En'âm, 140])

Në injorancën e kohëve të shkuara, vajzat e vogla groposeshin të gjalla, ndërsa në injorancën e kohëve tona ato po mbyten nga xhelatët e abortit. Foshnjat po shuhen që në barkun e nënës. Kurse fëmijët po lihen pas dore me justifikimin se prishin rehatinë e nënave.

Këto janë shenja të venitjes së ndërgjegjes dhe zhdukjes së mëshirës nga zemrat e tyre. Nëse shohim botën e kafshëve, edhe një mace është më e mëshirshme ndaj të vegjëlve të saj. Stili i sotëm i jetës materialiste dhe shekullare, i ka bërë njerëzit më të egër dhe egoistë. Në lidhje me aktin barbar të vrasjes, Allahu i Lartësuar i tërheq vërejtjen njeriut të periudhës së injorancës po aq edhe njeriut modern duke u shprehur:

"**Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vrarë;** (atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur për këtë Ditë.)**"** (Tekvir, 8-9.)

Ata që martohen dhe nuk duan fëmijë për arsye të papranueshme dhe jolegjitime, ose që përpiqen t'i eliminojnë ata me ndërhyrje të ndryshme në mitër, bëhen shkak i shkatërrimit të së ardhmes. Me çfarë logjike dhe ndërgjegjeje mund të shpjegohen përpjekjet e njeriut, që është më i nderuari i krijesave, për të minuar të ardhmen e vet, ndërkohë që edhe bimët dhe kafshët shfaqin një mijë e një tablo mësimdhënëse për vazhdimësinë e brezit të tyre!?

Edhe një gjarpër i lë vezët e tij në një vend të fshehtë dhe i mbron ato në mënyrë të sigurt. Sa i hidhur është privimi nga këto ndjenja dhembshurie dhe mëshire i njeriut, që është qenia

më e nderuar në univers, në krahasim me kafshët që luftojnë me ndjenjën e mbrojtjes së pasardhësve të tyre!

Grua në familje, është si një llambadar kristali që ndriçon shoqërinë. Nëse shfletojmë faqet e historisë, do të shohim se shoqëritë kanë arritur zhvillim në saje të grave, por edhe janë rrënuar nga duart e tyre. Nëse grave u tregohet rruga, si mjet lumturie, rrugët e jetës do të mbushen me xhama të thyer.

Në shoqëritë ku edukimi moral i gruas është lënë pas dore, nuk mund të fillojë pranvera e njerëzimit. Gruaja humbet vlerën e saj të vërtetë dhe mbetet në rrugë. Ky është një fenomen shumë i hidhur, sikur të hidhje një diamant në koshin e plehrave.

Lumturia më e madhe e grave është e mundur vetëm kur ato jetojnë si zonja shtëpie. Nëse një grua del jashtë detyrës së saj kryesore, ajo do të thajë vatrën familjare. Pjesëmarrja e një gruaje në jetën e jashtme mund të jetë e mundur vetëm për arsye thelbësore dhe për punë të përshtatshme për natyrën e saj. Këto arsye të nevojshme duhet gjithashtu të vlerësohen drejt.

Me fjalë të tjera, të përcaktohet sipas nevojave të shoqërisë dhe të mos kalohen kufijtë e arsyeshëm dhe legjitim. Nëse kufijtë shkelen me ambicie dhe justifikime të kota, ky është një vetëmashtrim, rezultati e të cilit është gjithmonë dështimi.

Në këtë mënyrë, shumë nga gratë dhe vajzat tona kanë humbur në vorbullat e pakujdesisë së Fundit të Kohës. Shumë sy, të mashtruar nga poshtërsitë e mbuluara me zbukurime, janë verbuar përballë të vërtetave hyjnore dhe kanë humbur lumturinë e tyre.

Në historinë e njerëzimit, gruaja ka arritur të gjejë reputacionin që meritonte vetëm në atmosferën sublime të Islamit. Edhe pse të gjitha sistemet e tjera jashtë Islamit mund të pretendojnë se e vlerësojnë gruan, në të vërtetë, ato e vlerësojnë atë vetëm si mall vitrine dhe e shohin si një e mirë ekonomike dhe mjet për plotësimin e dëshirave të egos.

Para Islamit, gruaja ishte e përbuzur dhe e poshtëruar dhe nuk iu dha kurrë e drejta të fliste për ndonjë çështje. Por, falë Islamit, ajo arriti dinjitetin dhe nderin që meritonte dhe mundi të mbronte të drejtat e saj. Po ashtu, me urdhrat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, u vendosën edhe të drejta ligjore për to.

Islami e refuzoi kategorikisht rolin e neveritshëm dhe të mjerueshëm që i ka caktuar grave edhe injoranca e hershme e moderne, edhe Judaizmi dhe Krishterimi i manipuluar. Përkundër kësaj, Islami e ngriti atë në pozitën e nderuar që meritonte.

Ekzistenca e një sureje në Kuran të quajtur «en-Nisa/Gratë» dhe fakti që të drejtat civile të grave si martesa, mehri, trashëgimia, divorci dhe mbështetja ekonomike ishin të garantuara në atë dhe shumë sure të tjera, mjaftojnë për të treguar ndjeshmërinë e Islamit në këtë çështje.

Gjatë epokës së injorancës, gratë nuk kishin pjesë në trashëgimi. Madje, vetë gruaja ishte mall i trashëgueshëm. Ndërsa në injorancën e sotme moderne, në disa rajone, femrës i grabitet pjesa e trashëgimisë duke u justifikuar me doket dhe zakonet. Madje, edhe kur ajo shpreh të drejtat e saj, asaj i mbyllet goja, duke e konsideruar atë si turp.

Kurse në disa rajone të evropianizuara, nën pretekstin e barazisë gjinore, shkelen standardet kuranore dhe uzurpohen të drejtat e meshkujve. Mirëpo, pasi Allahu i Madhëruar e ka shpjeguar në mënyrë të hollësishme ligjin e trashëgimisë në suren Nisa, i ka përgëzuar me lumturinë dhe shpëtimin e përjetshëm ata që u përmbahen këtyre dispozitave. Ndërsa ata që shkelin normat hyjnore, i kërcënoi me një dënim poshtërues. (Shih. Nisa, 13-14.)

Në hutben e lamtumirës Profeti ﷺ në lidhje me gratë la këtë porosi:

"O njerëz! Respektoni të drejtat e grave! Silluni me mirësi dhe dashuri ndaj tyre! Ju këshilloj t'i frikësoheni Allahut për hakun e tyre. Ju i keni marrë gratë tuaja si amanet nga Allahu dhe i keni bërë të lejuara nderin dhe dëlirësinë e tyre në emër të Allahut!" (Muslim, Haxh, 147.)

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Pas devotshmërisë, besimtari, me tepër mirësi gjen tek një bashkëshorte e mirë. Nëse e urdhëron këtë grua, ajo i bindet, nëse e shikon atë, ndjen gëzim dhe nëse ai betohet të bëjë apo të mos e bëj diçka, ajo vepron atë që duhet dhe e shpëton burrin nga betimit. Po ashtu, nëse ai largohet dhe shkon në një vend të largët, gruaja ruan edhe namusin e saj, por vepron me drejtësi edhe në lidhje me pasurinë e tij." (Ibn Maxhe, Nikah, 5/1857.)

"Kjo botë është një pasuri (gjithçka nga e cila përfiton përkohësisht). Dhe, pasuria më e mirë e saj është gruaja e mirë (e ndershme dhe fetare)."

Theubani ﷺ, transmeton se:

Kur u zbrit ajeti; **"...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm."** (Teube, 34) ne ishim duke udhëtuar së bashku me Resulullahun ﷺ. Disa prej sahabëve, thanë:

"- Ka zbritur gjithçka që mund të zbriste në lidhje me arin dhe argjendin (tashmë nuk do t'i mbledhim më, por do t'i dhurojmë). Ah sikur ta dinim se cila është pasuria më e mirë dhe të fitonim prej saj!.." Sapo dëgjoi këto fjalë, Resulullahu ﷺ, tha:

"Më e çmuara prej atyre që posedohen, është një gjuhë që e përmend Allahun, një zemër falënderuese dhe një grua e mirë që e ndihmon besimin e burrit të saj..." (Tirmidhi, Tefsir, 9/9.)

Islami ka hedhur hapat më të drejtë dhe më të qytetëruar në rrugën e mbrojtjes së të drejtave të gruas. I Dërguari i Allahut e ka refuzuar konceptin e injorancës ku burri është superior ndaj gruas.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Trajtoni në mënyrë të barabartë fëmijët tuaj kur i shpërbleni. Nëse do të mbaja dikë më lart, do të mbaja vajzat." (Hejthemi, IV, 153; Ibn-i Haxher, el-Metâlibu'l-Âlije, IV, 69.)

Vajzat janë nderi, begatia dhe mëshira e familjes. Ato duhet të jenë sulltaneshat e familjes; zonjat dhe bareshat që mbajnë në këmbë shtëpinë, edukojnë fëmijët dhe i udhëzojnë ata në të vërtetën dhe mirësinë.

Klasa e parë në të cilën shkollohen fëmijët, është zemra e nënës. Këtë fakt e shpreh edhe thënia: *"Nëna është shkollë më vete"*.

Për arsye se nëna është më shumë me fëmijët e saj në shtëpi, ajo duhet të jetë "edukuesja e parë dhe më e madhe", duke u dhënë shembuj të mirë dhe duke lënë gjurmë të përhershme në shpirtin e tyre. Çdo fjalë që del nga goja e nënës është si një tullë e vendosur në ndërtimin e personalitetit të fëmijës. Zemra e nënës është shkolla e parë ku edukohet fëmija. Nënat janë burimi më i madh i dhembshurisë. Edukimi i fëmijëve të privuar nga edukata e nënës, është më i vështirë. Personat me karakter të lartë, janë kryesisht fëmijë të rritur nga nëna të mira.

Në kulturën dhe qytetërimin tonë, femra është vlerësuar vazhdimisht, sidomos nëna është ngritur në piedestal. Kur një person erdhi tek Profeti ﷺ, dhe i tha:

- Kush është personi që meriton më shumë nga gjithë njerëzit e tjerë që të sillem mirë me të?

Ai iu përgjigj:

"Nëna jote, nëna jote, nëna jote, - u përgjigj Profeti ﷺ. – Pastaj babai yt dhe më pas farefisi që ke më të afërt." (Muslim, Birr, 2.)

Profeti ﷺ, në lidhje me nënat që janë pajisur me aftësitë e duhura për ta kryer ashtu siç duhet këtë detyrë, thotë:

"*Xheneti është nën këmbët e nënave.*" (Ahmed, III, 429.)

Këtu bëhet fjalë për një vlerësim të mirë ndaj nënave. Dhe ky vlerësim, bëhet për shkak se nëna ka cilësinë e të qenit edukuesja më e rëndësishme në shoqëri. Nënat janë ato krijesa, të cilat na mbajnë për një farë kohe në bark, pastaj në krahë dhe deri në fund të jetës na mbajnë në zemër. Prandaj, ato meritojnë dashurinë dhe respektin tonë më të thellë.

Imam Ebu Hanife, refuzoi të ishte gjykatës i Bagdadit në mënyrë që të mos ishte një instrument i padrejtësive të sundimtarëve. Prandaj, Kalifi Ebu Xhafer Mansuri e dënoi atë me burg dhe e torturoi me kamxhik. Për më tepër, ai ia shtonte çdo ditë numrin e kamxhikëve. Mirëpo, pavarësisht vuajtjeve që po hiqte, Imamin e nderuar e shqetësonte mendimi: «Vallë, po sikur nëna ime ta marrë vesh gjendjen time?». Për këtë arsye, ai u dërgoi fjalë miqve të tij, duke i porositur:

"Ju lutem! Nëna ime nuk duhet ta marrë vesh gjendje timen. Ajo nuk i duron dot vuajtjet e mia dhe do të shkatërrohet!.. Kurse unë s'e duroj dot hidhërimin e saj!»

Abdurrahman Xhami ka thënë:

"E si mos ta dua nënën; ajo për një kohë më ka mbajtur në trupin e saj, pastaj për një kohë të gjatë më ka mbajtur në prehër dhe, derisa vdiq më mbajti në cepin e mëshirës së zemrës së saj."

Mevlana ka thënë:

"Kujdes ndaj hakut të nënës! Bëje kurorë mbi kokë, sepse sikur nënat mos të vuanin dhimbjet e lindjes, fëmijët nuk do të gjenin rrugë të vinin në këtë botë."

Bahauddin Nakshibendi, duke shprehur respektin, besnikërinë dhe dashurinë e thellë që ndjente për nënën e tij, la këtë amanet:

"Ata që duan të vijnë për vizitë në varrin tim, së pari duhet të vizitojnë varrin e nënës sime!"

Nënat e mira, janë heroinat e padukshme që i japin orientim shoqërive. Edhe pse Perëndimi, falë sëmundjes së islamofobisë vazhdon të përsërisë mitin se Islami i përçmon gratë, përgjigja më madhështore ndaj iluzioneve të tyre, janë nënat me zemrat plot besim, që i rritin fëmijët e tyre me dashuri për fenë, besimin, atdheun, flamurin dhe të shenjtën.

Sot, xhihadi kryesor i grave, është të mbrojnë familjen e tyre ashtu siç ka urdhëruar Allahu dhe të përpiqen për të rritur një brez besimtar. Më pas, ato duhet të shfaqin gjithmonë fytyrën e qeshur të Islamit me mirësi dhe hijeshi. Gra të tilla të devotshme, janë arkitektet e vërteta të shoqërisë.

Në qytetërimin tonë, dashuria dhe respekti për zonjat dhe të moshuarit, nuk ka qenë e posaçme vetëm për ditë të caktuara të vitit, siç ndodh sot. Atë kohë, çdo ditë ishte "dita e nënës"; nënave u putheshin duart në çdo rast, shërbimi ndaj tyre ishte i përsosur, atyre u merrej bekimi dhe u kërkohej hallall për çdo gjë. Po ashtu, në qytetërimin tonë, "dita e babait" ka qenë çdo ditë, jo një herë në vit, dhe për të moshuarit e familjes tregohej respekti i plotë.

Gratë trajtoheshin me respekt çdo ditë, jo vetëm njëherë në vit në përvjetorin e martesës. Ndërsa dashuria nuk tregohej me dhurata të shtrenjta apo stolitë e kësaj bote, por me komplimente të përzemërta, mirësjellje, moral të mirë dhe trajtim të mirë.

Në botën e sotme, kur shtëpitë e familjeve në mbarë botën janë gati të shemben për shkak të tërmeteve të mosbesimit,

imoralitetit, neglizhencës dhe mungesës së dashurisë, Zoti ynë na dhëntë aftësinë për të ndërtuar dhe mbajtur familjet tona me forcë dhe fuqi të palëkundur. Qofshin shtëpitë tona një xhenet dashurie, paqeje dhe lumturie! Dhe dera e fundit e këtij xheneti, u haptë drejt xheneteve të pafundme, ku do manifestohet takimi me bukurinë e Allahut.

Amin!..





SHQETËSIMI PËR BREZAT

Një besimtar, lidhur me fëmijët e tij, shpesh duhet t'ia bëjë vetes këto pyetje:

– Çfarë po bën për edukimin e fëmijëve të tu, të cilët të janë besuar nga Allahu?

– Çfarë po u mëson, çfarë kulture po u jep?

– A po i kushton më shumë rëndësi të ardhmes së përjetshme të fëmijëve të tu, apo të ardhmes së tyre të kësaj bote?

– A po kujdesesh për edukimin e fëmijëve të tu me Kuran?

– A po i mëson ata që në moshë të vogël me namazin, xhaminë, xhematin, bujarinë dhe bamirësinë?

Fëmijët janë një dhuratë hyjnore për ne. Janë filiza me vlerë që kanë dalë nga vetë ekzistenca jonë. Sipas zemrave të ndjeshme, poezia e parë e lumturisë së shtëpisë fillon me zërat qetësues të fëmijëve që lindin. Siç shprehet edhe Profeti ynë ﷺ, në hadithet e tij: Fëmijët janë «lulet e xhenetit», «frutat e zemrës», «mirësi dhe furnizim hyjnor».

Ndonjëherë, edhe pse njeriu kapet pas shkaqeve dhe i mbështetet Allahut nëpërmjet lutjes, Zoti i Plotfuqishëm mund të mos i dhurojë fëmijë. Në këtë, ka shumë urtësi. Askush nuk e di të fshehtën përveç Allahut. Zoti ynë e di më mirë se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe për ne. Vlerësimi i Tij për ne është padyshim më i mirë se ajo që dëshirojmë ne për veten. Allahu i Madhëruar i privon robërit e Tij nga disa mirësi, në mënyrë që; duke treguar durim dhe pajtim me caktimin hyjnor, të ngrihen në grada të larta tek Allahu dhe të marrin më shumë shpërblime të përjetshme në botën tjetër, të cilat janë më të mira dhe më jetëgjata se ato të dynjasë. Në këtë aspekt, është e nevojshme që ne të jemi gjithmonë në gjendje durimi, mirënjohjeje, falënderimi, pëlqimi dhe nënshtrimi ndaj caktimit hyjnor.

Fakti që Allahu i privon robërit e Tij nga disa begati, nuk do të thotë se Ai nuk i do ata. Për shembull, gruaja e Profetit ﷺ, Aishja رضي الله عنها, nuk kishte fëmijë. Mirëpo ajo, me dijen, urtësinë dhe moralin e saj, u bë nënë e një populli të tërë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, duke u martuar me Aishen, vajzën e mikut të tij më të shtrenjtë Ebu Bekrin, i dha asaj formimin më të plotë në fushën e jurisprudencës, duke e kthyer atë në një burim të rëndësishëm të diturisë; aq sa ka thënë: *"Një të tretën e diturisë, kërkojeni nga shtëpia e Aishes!"* (Dejlemi, II, 165/2828.)

Aishja رضي الله عنها, përmes nipërve të vet, ka ndarë diturinë e saj në rreth 300 nxënës. Sipas Ibn Abbasit رضي الله عنه, nuk ka dijetarë që të mos kenë përfituar nga dituria e Aishes.



Nëse duam të rrisim një fëmijë të përsosur, fillimisht, si prindër, duhet të jemi të përsosur.



Aliu رضي الله عنه, ka thënë:

"Nuk mund të mbledhësh buqeta trëndafilash nga ara ku mbillen ferra!"



Gjatë edukimit të fëmijëve tanë, çfarëdo që mbjellim në kopshtin e zemrës së tyre, çfarëdo emocioni që u japim, pikërisht reflektimin e atyre ndjenjave do të gjejmë edhe kur ne të plakemi dhe të kemi nevojë për kujdesin e tyre. Nëse u japim frikë nga Allahu, mëshirë dhe takua, do të gjejmë besnikëri dhe mirënjohje. Nëse i kemi edukuar larg ndjenjave shpirtërore, do të bëhemi viktima të egos sonë. Nëse u kemi injektuar ndjenjat e lakmisë për këtë botë, mizorisë dhe oportunizmit, do të përballemi me përçmimin, ftohtësinë dhe vrazhdësinë e tyre.



Nga nënat dhe baballarët na vijnë ankesa nga më të ndryshmet. Ata duhet të pyeten:

Çfarë i ke dhënë ti këtij fëmije dhe çfarë pret tani? A e edukove me njohuri fetare dhe kuranore? A u kujdese për ta dërguar në një shkollë ku mësohet feja?



Veçanërisht në ditët e sotme, prindërit fetarë duhet ta vendosin kokën midis dy duarve dhe të mendojnë:

- Vallë a po edukohen fëmijët tanë, sikur me të vërtetë janë tanët?

- Kush ua formon personalitetin dhe karakterin?

- Me botëkuptimin dhe orientimin e kujt edukohen?

- Çfarë shembujsh dhe cilët personalitete ndodhen në zemrat, idealet dhe synimet e fëmijëve tanë?

- Fëmijët tanë e përdorin televizionin, internetin dhe telefonin, apo këto aparate po i komandojnë fëmijët tanë?!.



Le të mendojmë për gjendjen e fëmijëve, të cilët, të ekspozuar ndaj propagandës së mosbesimit, paturpësisë dhe imoralitetit, shikojnë mëngjes e mbrëmje publikimet helmuese të njerëzve mohues nga ekranet, telefonat, televizionet dhe rrugët e pista të internetit. Nëse i braktisim përpjekjet tona në arsim, trajnim dhe edukim, nëse nuk i kryejmë siç duhet shërbimet tona të mësimdhënies dhe orientimit, fëmijët tanë do të bëhen e ardhmja e të tjerëve.



Në ajet thuhet se **"shejtani bëhet ortak në pasuri dhe fëmijë"**. (Shih el-Isra, 64.)

Sot nuk mjafton vetëm të jesh prind biologjik i një fëmije. Nëse shpirtin e tij e ushqen shejtani dhe mendjen e tij njerëzit pa besim, ai bëhet fëmijë i tyre. Mendjet dhe zemrat e brezave të

rinj po largohen nga identitetet e tyre, nga feja dhe qytetërimi i tyre. Pas kësaj faze, afërsia biologjike nuk ka vlerë dhe klithmat e prindërve nuk kanë asnjë dobi.



Ushqimi me qumësht i fëmijës së saj, është një nga detyrat më thelbësore të nënës. Mirëpo, nëse aty ku ndodhet ajo bie zjarri, asnjë nënë nuk mund të vazhdojë t'i japë qumësht fëmijës. Për atë moment, shpëtimi i vetes dhe foshnjës së saj nga zjarri bëhet detyra më jetike.

Tabloja në ditë tona, është e qartë:

Zjarret shpirtërore kërcënojnë fëmijët tanë nga të gjitha anët. Dhuna e ndikimeve negative i kanë rrethuar nga të gjitha anët. Detyrat dhe përgjegjësitë e një prindi në mes të këtyre zjarreve, nuk mund të jetë thjesht plotësimi i nevojave biologjike të fëmijës së tyre.



Një prind, nuk e zë gjumi gjithë natën nëse fëmija i tij është i sëmurë me temperaturë, por shkon mjek më mjek derisa ta shërojë. Mirëpo sot, fatkeqësisht është shfaqur një varfëri shpirtërore. Pakujdesia e konsiderimit të së ardhmes së fëmijëve në këtë botë si më të rëndësishme se e ardhmja e tyre e përjetshme në botën tjetër, është përhapur edhe në familjet që ne i quajmë fetare.

Shohim që prindërit shkojnë në provimet e universitetit, presin te dera me orë të tëra me emocion dhe thonë: «Unë jam po aq i emocionuar sa fëmija im!», «Vallë a do mund t'ia dalë mbanë; a do të fitojë?»...

Por, nga ana tjetër, sa përpjekje bëni për jetën shpirtërore të fëmijës suaj? A ndjeni të njëjtin shqetësim për ahiretin e fëmijës tuaj si për këtë botë?!.



Dhembshuria dhe mëshira e vërtetë që duhet t'u tregohet fëmijëve është që; detyrën prindërore për t'i ushqyer, për t'i veshur me rroba të bukura, për t'u argëtuar shpirtrat dhe për t'u garantuar rehatinë fizike, të mos e realizosh duke e konsideruar jetën të përbërë vetëm nga kjo botë. Përkundrazi, dhembshuria dhe mëshira e vërtetë, është të shpëtosh të ardhmen e tyre të përjetshme nga të qenit një kapitull vuajtjeje dhe t'u japësh vlera shpirtërore, që do t'u sjellë një pranverë lumturie të përjetshme; pra, para së gjithash t'u ushqejmë shpirtrat.

Njeriu që i beson Allahut dhe botës tjetër, kur vihet përball me lumturinë e fëmijëve të tij në këtë botë dhe në tjetrën, pa menduar për asnjë moment, e shtyn këtë botë me të pasmen e dorës dhe zgjedh botën tjetër... Ai nuk bëhet mendjelehtë dhe të lërë detin për një pikë ujë.

Sigurisht, çdo nënë e mbulon të voglin e saj që ka ftohtë. Ajo dëshiron ta shohë atë të veshur me rrobat më të bukura. Mirëpo, një nënë me besimin në botën tjetër, mendon dhe shqetësohet më tepër se, a do ta mbështjellë fëmijën e saj me mëndafshin dhe atllasin e xhenetit apo me zjarrin flakërues të xhehenemit në botën tjetër.

Prindi nuk mund të zgjedhë që fëmija të hajë këtu në këtë botë, pa në botën tjetër le të hajë ç'të dojë! Le të ketë një të ardhme të ndritur në këtë botë, pa në botën tjetër le të bëhet edhe prej faqezinjve!..

Nëse neglizhohet edukimi shpirtëror dhe molepsen pas vesveve të këqija, në Ditën e Gjykimit ata fëmijë do të jenë palë akuzuese për prindërit e tyre.

Allahu në Kuran urdhëron:

"**O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët**." (Tahrim, 6.)

Profeti ﷺ, me qëllimin e komentimit të ajetit tha:

"Nëse i largoni fëmijët nga haramet dhe i inkurajoni për të kryer urdhëresat, atëherë i keni shpëtuar dhe mbrojtur nga Xhehenemi." (Alusi, XXVIII, 156.)



Në këtë botë, fëmijët kanë nevojë për prindërit e tyre gjatë rritjes. Mirëpo nga fundi i jetës së tyre, prindërit kanë nevojë për fëmijët. Ndërsa pas vdekjes, prindërit kanë përsëri nevojë për lutjet e fëmijëve të tyre dhe që ata të jenë sadaka xharije për ta. Përndryshe, prindërit do të mbeten pa vizitorë dhe të vetmuar në varret e tyre, edhe pse kanë shumë nevojë.

Mbi të gjitha:

Kur fëmijët lihen në qejf të tyre, duke thënë: "S'ka gjë, ai është ende i vogël, me kalimin e kohës do të rregullohet..." dhe nuk e edukohen në vijën e Kuranit dhe Sunnetit, në ditën e Kiametit ata do t'i padisin prindërit e tyre duke thënë:

"Prindërit e mi më lanë pas dore dhe nuk më edukuan si mysliman të mirë..."



Ne nuk jemi të vetëdijshëm për shumë të drejta të njerëzve. Por, të gjitha ato do të na dalin para Ditën e Gjykimit. Prandaj, prindërit nuk duhet të harrojnë se; shpërfillja e edukimit moral të fëmijëve që u janë besuar si amanet hyjnor, është një shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijëve të tyre.



Nuk duhet të neglizhohen deri në atë masë saqë t'i pëlqejnë rrobat e papërshtatshme me mendimet e formës: "Sidoqoftë janë të vegjël në moshë...", "Le të kënaqen!" Sepse me kalimin e kohës kjo gjendje sjell në pah një varësi prej të cilës nuk mund të hiqet dorë.

Mos të harrojmë që gjërat që mësohen në moshë të hershme janë si gdhendje në gurë mermeri, të cilat nuk fshihen më. Prandaj të parët tanë kanë thënë: Pemës mund t'i japësh formë sa është e njomë"



Shejh Sadi thotë:

"Njeriu i paedukuar në fëmijëri, nuk mund të edukohet më kur të rritet dhe s'mund të përmirësohet. Një degë të njomë mund ta përkulni si të doni. Por, për të drejtuar degën e thatë, duhet ta vendosni në zjarr.»



Këshilla e parë që duhet t'i jepet një prindi, është të jetë i mëshirshëm me fëmijën e tyre. Prindërve duhet t'u thuhet: "-Sa është dhembshuria juaj për fëmijën tuaj? Shiko, sa do të hidhëroheshe, nëse fëmija juaj do të vdiste këtu! Nëse doni që nesër, në botën tjetër, të jeni me fëmijën tuaj, së pari duhet të jeni vetë në rrugën e duhur dhe pastaj do të bëni përpjekje që fëmija juaj të rritet me kulturë dhe moral islam!»



Në këtë botë, prindërit, fëmijët, shokët-miqtë, të afërmit, etj., jetojnë në bashkësi. Mirëpo në botën tjetër do të ketë një "jeumu'l-fasl", një "ditë ndarjeje", pra dita kur ndahen rrugët, për të cilën Allahu i Madhëruar na njofton në Kuranin Fisnik. Duke folur për banorët e Xhenetit thuhet:

"Paqe!, do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë!" (JaSin, 58.)

Allahu i Madhëruar bën të ditur se Ai do t'i ftojë robërit e mirë në Xhenetin e Tij, me mirësi dhe lavde të shumta. Mirëpo, edhe nëse janë prej së njëjtës familje apo bashkësi, gjynahqarëve do t'u thuhet:

"**Veçohuni sot ju, o kriminelë!"** (JaSin, 59.)

Në këtë mënyrë, atje do të marrë fund miqësia apo afërsia që kishin në këtë botë dhe gjynahqarëve do t'u tregohet rruga e Xhehenemit.

Mbase atje do të ndahen me mijëra bashkëshortë. E me mijëra fëmijë e prindër do të jenë udhëtarë të rrugëve të ndryshme. Të afërmit e fqinjët, që në dynja jetonin së bashku, por që në fakt busullën e zemrave e kishin në drejtime të ndryshme, do të ndahen një pjesë nga një anë e një pjesë në anën tjetër. Ajo do të jetë një ditë e tmerrshme ndarjeje!..

Me qëllim që atë ditë të mos hidhërohemi, duhet të bëjmë që sot kujdes edhe në drejtimin personal, edhe në edukimin në mënyrën më të bukur të fëmijës.

Në ahiret, çdo prind e pret e ardhmja e panjohur e fëmijëve të tyre. Vallë si do të dalin fëmijët tanë nga situatat e tmerrshme të kiametit dhe tubimit në Ditën e Gjykimit? Sa kemi mundur t'i përgatisnim fëmijët tanë për atë ditë të ashpër dhe të vështirë?

Nëse sot, arrijmë t'i edukojmë fëmijët tanë me moralin e Kuranit dhe Sunetit, do të përjetojmë edhe paqen dhe gëzimin e shikimit të tyre në rrugën e drejtë në këtë botë, edhe do të jenë sadaka e rrjedhshme për ne në botën tjetër, por edhe do të lumturohemi bashkë me ta në xhenetet madhështore në ahiret.

Fëmijët e mbarë, janë sadaka rrjedhëse për prindërit e tyre. Me fjalë të tjera, fëmijët e mbarë janë mundësi shpërblimi për prindërit edhe pas vdekjes së tyre...

Mirëpo, nëse fëmijët nuk edukohen të mbarë, nëse tregohet neglizhencë dhe mangësi në këtë drejtim, fëmijët e tillë do të jenë fatkeqësi për prindërit e tyre, si në këtë botë, ashtu edhe në ahiret!..



Fëmijët gjynahqarë janë një e keqe rrjedhëse për prindërit e tyre që nuk janë kujdesur për edukimin e tyre!.. D.m.th., fëmija i keq, bëhet shkak që në librin e veprave të prindërve, të shënohen të këqija dhe gjynahe edhe pasi të kenë vdekur!..

Prandaj, është thelbësore t'i shohim fëmijët si një amanet dhe sprovë hyjnore dhe t'i kushtojmë vëmendje edukimit të tyre shpirtëror!..



Prindërit më të mëshirshëm, janë ata që e përgatisin njëritjetrin dhe fëmijët e tyre në devotshmërinë ndaj Allahut.

Të mos harrojmë se fëmijët vijnë në këtë botë me një pastërti që meriton Xhenetin. Mirëpo nëse prindërit e neglizhojnë edukimin shpirtëror të fëmijëve të tyre, që janë një amanet hyjnor për ta, këta zogj të Xhenetit -Allahu na ruajt !- mund të fluturojnë në vende të gabuara.



Poeti Nexhip Fazëll shprehet:

«Një pemë që nuk ka hall për fruta, është thjesht dru.» Me këto fjalë, ai përmbledh përgjegjësinë kryesore të prindërve. Nëse prindërit i rrisin fëmijët me kulturën Islame, ata nesër do të jenë fëmijë të drejtë dhe besnikë. Por, nëse i lënë fëmijët e tyre në shoqëri me njerëzit e shkujdesur duke thënë «le të përshtaten me turmën», ata do të përballen me një pendesë të madhe, si në këtë botë ashtu edhe në ahiret.



Kur nëna e Merjemes, ishte shtatzënë, ajo shqetësohej për fëmijën që kishte në bark. Kështu, duke menduar se e kishte djalë, ajo ia kushtoi atë shërbimit të Bejt-i Makdis. Në fakt, ky ishte një manifestim i madh i devotshmërisë. Sepse;

- Të dëshirosh që fëmijët të rriten si njerëz të drejtë në frymën e adhurimit,

- Të dëshirosh që fëmijët të bëhen sadaka e rrjedhshme,

- Dhe për këtë arsye, t'i shkëpusë ata nga zemra e t'ia kushtosh rrugës së Allahut, është tregues i madh i besimit dhe devotshmërisë.



Siç njoftohemi në Kuran, sahabët këshilluan njëri-tjetrin me vetëdijen e ruajtjes së besimit të tyre duke thënë:

«Me të vërtetë, nëse ju zbulojnë, ata do t'ju gjuajnë me gurë ose do t'ju kthejnë (me forcë) **në fenë e tyre dhe atëherë nuk do të shpëtoni kurrsesi!»** (Kehf, 20.)

Pra, edhe sot, një prind duhet të ketë një shqetësim të tillë për mbrojtjen e fesë dhe besimit të fëmijës së tij: *"A mund ta ruajnë fëmijët e mi besimin dhe moralin e tyre nëse shoqërohen me gjynahqarët dhe njerëzit e shkujdesur dhe nëse janë në unitet mendor me ta në vendet ku bëhen vepra të shëmtuara?"*

Kështu, prindërit duhet të mendojnë dhe të përpiqen të ndërtojnë një të ardhme në rrugë të drejtë për fëmijët e tyre.



Të kapësh një sorkadhe dhe ta lësh atë në mes të ujqërve dhe çakejve, nuk është asgjë tjetër veçse budallallëk. E njëjta gjë është edhe kur njeriu e shkollon fëmijën e tij në vende të gabuara, ku nuk ekziston edukimi shpirtëror dhe ku helmatiset vazhdimisht shpirti i tij.



Të rritësh fëmijët tanë me ndërgjegje dhe moral Islam, nuk është një detyrë e thjeshtë që mund të arrihet vetëm duke i dërguar ata në një xhami të mbushur me njerëz gjatë pushimeve verore. Nëse mendojmë se e kemi përmbushur detyrën duke u kënaqur me këtë, do të thotë se edukimin fetar e kemi vendosur në plan të dytë. Përveç kësaj, konsiderimi i edukimit shpirtëror kaq të thjeshtë, shpreh dobësinë dhe mangësinë e vetëdijes Islame në zemër.



Të mos harrojmë se; i Dërguari i Allahut ﷺ, i bëri sahabët e tij të plotësojnë arsimin Islam, duke e përjetuar dhe ua mësuar atë për 23 vjet rresht.



Për edukimin e Kuranit, duhen shfrytëzuar mirë dhe në mënyrë të veçantë pushimet verore. Mirëpo, nuk duhet të mjaftohemi me dërgimin e fëmijëve tanë në kurset e Kuranit apo xhami, por si prindër duhet të monitorojmë me kujdes gjendjen e tyre. Ne duhet të kontrollojmë shpesh nivelin e kulturës kuranore dhe gjendjen e njohjes së fesë dhe fikhut dhe duhet t'i inkurajojmë gjithmonë me interesin që shfaqim.



Sot, për të mësuar një gjuhë të huaj, bëhen gjithë ato munde dhe nuk kursehet asnjë lloj shpenzimi. Përkundër kësaj, nënvleftësimi i kurseve të Kuranit dhe privimi i të vegjëlve tanë nga drita e tij, është diçka shumë e dhimbshme.



Çdo prind është i shqetësuar për të ardhmen e fëmijës së tij. Ai dëshiron t'u japë atyre një edukim të mirë dhe t'u përgatisë një të ardhme të mirë.

Por, është e nevojshme të mos harrojmë se; edhe e ardhmja edhe jeta e vërtetë është ajo e botës tjetër. Prindërit më të mëshirshëm ndaj fëmijëve të tyre janë ata që shqetësohen për të shpëtuar jo vetëm të ardhmen e tyre tokësore, por edhe të ardhmen e tyre të përjetshme.



Që nesër të mos mbetemi fillikat me një pendesë të thellë në varrin e shkretuar dhe që të sigurojmë lutjet e fëmijëve tanë për ne, duhet të përpiqemi sot sa kemi mundësi t'i edukojmë fëmijët tanë me frymëzimin shpirtëror të Kuranit. Ne duhet të interesohemi nga afër me edukimin e fëmijëve, duke u përpjekur të injektojmë në zemrat e tyre të pastra dashurinë për Allahun, të Dërguarin e Tij ﷺ dhe kulturën e Kuranit e Sunnetit. Duke u nisur nga fakti se motivimi është një nga mënyrat më të mira të edukimit, ne duhet t'i motivojmë ata me dhurata dhe fjalë inkurajuese me qëllim që tek fëmijët tanë të gjallërohen më lehtë bukuritë dhe mirësitë shpirtërore.

Imam Maliku ka thënë:

"Sa herë që unë mësoja përmendësh një hadith, babai më jepte një dhuratë. Por erdhi një kohë që edhe nëse babai im nuk më jepte dhuratë, mësimi përmendësh i haditheve u kthye në kënaqësi për mua."



Një prind duhet ta shfrytëzojë me synime të larta kohën që kalon në shtëpi dhe të përfitojë nga mundësitë për rritjen e fëmijëve të tij. Prindërit duhet të mbrojnë pasardhësit e tyre nga të këqijat e televizionit dhe internetit, të bisedojnë më shumë me ta, të përpiqen të rrisin kulturën e tyre islame duke futur moral të mirë në zemrat e tyre. Ata duhet të përpiqen të kultivojë zakonin e adhurimit tek fëmijët e tyre dhe të shtojnë njohuritë e tyre me Kuran.



Profeti ﷺ, ka thënë: «*Namazi është bërë dritë e syve të mi*». Prandaj, të dëshirosh që namazi të jetë "drita e syrit" edhe për fëmijët tanë, është një porosi kuranore e Zotit të Madhëruar për ne besimtarët. Atëherë, ne duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë rëndësinë e namazit dhe t'u japim atyre entuziazmin e adhurimit plot ndriçim dhe frymëzim shpirtëror, në mënyrë që ata të jenë dritë e syve tanë, krenari dhe sadaka rrjedhëse për ne.

Një nga shqetësimet më të rëndësishme që pushtonte zemrën e Ibrahimit, i cili ishte Halilullah/Miku i Allahut, ishte shqetësimi që ai ndjente për pasardhësit e tij. Duke dashur t'u linte trashëgim pasardhësve të tij vlerat shpirtërore që kishte fituar, ai iu lut Zotit të Madhërishëm me këto fjalë:

"O Zot më bëj mua dhe pasardhësit e mi prej atyre që falin namaz..." (Ibrahim, 40.)

Edukimi që i dha Ibrahimi عليه السلام, djalit të tij Ismailit, është një shembull i mrekullueshëm i sakrificës për një baba në lidhje me edukimin e fëmijëve. Në përputhje me vullnetin hyjnor, Ibrahimi عليه السلام, e la gruan e tij, Haxheren, dhe djalin e tij, Ismailin, në mes të shkretëtirës, në një luginë të papërshtatshme për bujqësi. Dhe, arsyen e kësaj, Ibrahimi عليه السلام, e shpjegon duke thënë: «që ata të falin namaz». Me fjalë të tjera, Ibrahimi عليه السلام, po përpiqej të ndërtonte një brez besimtarësh, të bazuar në udhëzimet hyjnore, larg nga pjesa tjetër e botës, në Hixhaz.

Fëmijët tanë duhet të rriten me botëkuptimin se; pronari i vërtetë i çdo gjëje është Allahu. Ashtu siç jemi të detyruar t'i mësojmë fëmijët tanë me namaz që në moshë të vogël, ashtu duhet t'u injektojmë atyre entuziazmin e dhurimit për hir të Allahut dhe t'i mësojmë ata me qetësinë shpirtërore që të jep gëzimi i zemrave të nevojtarëve.

Të mos harrojmë se; dhurata më e madhe që mund t'u bëjmë fëmijëve tanë, është një edukim i mirë; trashëgimia më e vlefshme që mund t'u lëmë është trashëgimia e ahiretit, pra personaliteti dhe karakteri i Islamit. Prindërit që arrijnë ta lënë këtë trashëgimi, janë të denjë për mirënjohje të përjetshme.



Ka dy lloje trashëgimie:

Trashëgimi materiale: Pasuria që ndahet sipas kritereve që ka përcaktuar Allahu.

Trashëgimi shpirtërore: Morali, edukata dhe personaliteti Islam që lejnë prindërit pas. Nëse trashëgimia shpirtërore është e shëndoshë, atëherë, pasardhësit, edhe trashëgiminë materiale e përdorin siç duhet. Për më tepër, ata bëhen sadaka e vazhdueshme për prindërit. Por, nëse privohen nga trashëgimia shpirtërore, atëherë nuk dihet si do ta përdorin trashëgiminë materiale; ndoshta do ta përdorin në rrugë të këqija duke e shndërruar në një barrë edhe për prindërit në botën tjetër.



Kalifi Omer bin Abulazazi jetonte një jetë shumë të thjeshtë dhe modeste edhe pse ishte udhëheqësi i shtetit Islam që kishte shtrirë kufijtë e tij në përmasa kolosale.

Një ditë, veziri i propozoi:

"Zotëri, shuma që merrni nga "thesari i shtetit (bejtu'l-mal)" duket se nuk ju mjafton. Sikur të merrni pak më shumë në mënyrë që të kurseni diçka dhe pas vdekjes suaj t'u mbetej fëmijëve dhe nipërve tuaj për nevojat e tyre të domosdoshme?! Kalifi dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

"Nëse pasardhësit e mi do jenë nga të mirët (salih), nuk druhem aspak për të ardhmen e tyre, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë: **"Në të vërtetë, Mbrojtësi im është Allahu, i Cili ka zbritur Librin dhe kujdeset për të mirët."** (Araf, 196)

Nuk shqetësohem aspak për sa kohë Allahu i Lartësuar është mbrojtësi dhe kujdestari i tyre në çfarëdolloj situate me të cilën mund të përballen në të ardhmen.

Në të kundërt, nëse ata do jenë nga shpërdoruesit (sefih) atëherë Allahu i Lartësuar thotë për ta në Kuran: **"Mos e lini në dorë të të paaftëve mendërisht pasurinë tuaj**." (Nisa, 5) E si mund t'i lë trashëgimi diçka fëmijëve të mi pas kësaj ndalese hyjnore?"[2]



Për të eliminuar injorancën moderne në kohën tonë, detyra jonë më e rëndësishme është që; në vend që të ankohemi për vështirësitë e kushteve, të përpiqemi të edukojmë një brez me personalitet dhe karakter Islam, të fortë materialisht dhe shpirtërisht.

– Një rini besimtare, të ndërgjegjshme, me ndjenja, vetëmohuese dhe modeste.

– Një rini me vullnet të fortë që mund të mbizotërojë egon e vet.

– Një rini e matur që mund ta kuptojë menjëherë se ku të çon çdo rrugë në ahiret...

Për këtë, është i domosdoshëm një edukimi dhe trajnimi profetik; institucione dhe përpjekje si Daru'l-Erkam dhe Suffe, që do të edukojnë personalitete të jashtëzakonshme...



Musa Topbash ka thënë:

"Mbrojtja e fesë, atdheut, flamurit dhe kombit, varet vetëm nga edukimi i një rinie sakrifikuese."



2. (Ebu'l-Ûlâ Mardin, Huzur Dersleri, Istanbul 1966, II-III, 769-770)

Siç shprehet edhe një mendimtar:

"Dallimi më i rëndësishëm midis popujve sundues dhe atyre të sunduar, është një grusht njerëzish të edukuar mirë!"

Ja pra, përballimi i etjes materialo-shpirtërore të shoqërisë, eliminimi i terrorit dhe përhapja e drejtësisë, varet nga ky grusht njerëzish.



Përpjekja për të edukuar një person të kualifikuar, ndonjëherë kushton mijëra njerëz. Nuk do të ishte shpërdorim nëse talenteve të mëdha do t'ia shtronit përpara të gjitha mundësitë.



Tokat, qytetet dhe ndërtesat nuk mund të edukojnë njerëz të kualifikuar. Por një person i kualifikuar, mund të ringjallë tokën dhe të ndërtojë qytetërim...



Muhammed Ikbali ka thënë:

"*O njeri i mençur, pasuria e një populli nuk është paraja, argjendi, kumashi dhe floriri. Pasuria e tij e vërtetë, janë fëmijët e fortë, të shkathët dhe punëtorë, të cilët kanë mendje të gjallë dhe të shëndetshme*."



Imam-i Rabbani thotë:

"Një luftë fitohet me aleancën e dy ushtrive. Njëra është ushtria në shesh të luftës, dhe tjetra është ushtria që lutet. Arritja e fitoreve të vërteta varet nga edukimi i një brezi të mbushur me besim, me devotshmëri dhe që lutet shumë."





DITURIA E VËRTETË

Shoqëritë nuk mund të arrijnë shpëtimin me shpirtin e pedantëve të cilët rrinë mbi librat me kapakë të errët të filozofisë që kanë mbetur në raftet e pluhurosur të bibliotekave.

Ai që do ta shpjerë njeriun në lumturinë dhe shpëtimin e vërtetë, është shpirti i të devotshmëve që kanë arritur urtësinë dhe përsosmërinë duke u brumosur me kulturën e Kuranit dhe Sunetit.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

"Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit (për asgjë tjetër)**, përveçse që të Më adhurojnë Mua!"** (Dharijat, 56.)

Mësimi më i rëndësishëm i atyre që vijnë në shkollën e kësaj bote, është; "Adhurimi i Allahut Teala. E shprehur ndryshe: "Të njohësh Allahun me zemër. (shih. Ibn-i Kethir, IV, 255.)

Për besimtarët e devotshëm, në këtë shkollë të përkohshme të kësaj bote, nuk ka as qëllim më të rëndësishëm se të adhurosh Zotin e Plotfuqishëm dhe as një gradë më të lartë se devotshmëria ndaj Tij.

Ne jemi të gjithë nxënës të shkollës së kësaj bote, e cila është hapësira e sprovës hyjnore. Edukimi ynë do të përfundojë me vdekjen dhe ne do të varrosemi me veprat tona. Të gjithë ne kemi ardhur në këtë botë për të arritur zemrën e pastër që Allahu i Madhëruar dëshiron prej nesh.

– Edukimi më i rëndësishëm në jetë, është marifetullahu/ njohja e Allahut.

– Arti më i bukur, është të jetosh si mysliman.

– Aftësia më e madhe, është të vdesësh si mysliman.

Qëllimi që Allahu i Madhëruar i ka dhënë «dituri» njeriut, është që ai të arrijë «njohjen e Allahut». Me fjalë të tjera; të dish të jesh rob i Zotit, duke e kuptuar se përballë fuqisë dhe madhështisë hyjnore je «asgjë» dhe «i dobët» .

Dija e dobishme, është ajo që së pari e prezanton njeriun me veten dhe i hap derën e "marifetullahut/njohjes së Allahut", duke i bërë të ditur qëllimin e ekzistencës.

Junus Emre shprehet:

Dituria është njohje
Dituria është të njohësh veten
Nëse ti nuk njeh veten
Ç'të vlen kjo dituri?

Një edukim që nuk të çon në njohjen e Allahut, është një përpjekje e thatë. Ata që ndjekin këto përpjekje të kota, janë siç shprehet Allahu në Kurani:

"...ata që kanë punuar e janë rraskapitur (e kanë çuar jetën dëm në punë të padobishme)**."** (Gashije, 3.)

Për shkak të mëshirës së tij ndaj njerëzve, Allahu i Madhëruar ofron mundësi udhëzimi në çdo rast dhe e fton robin e Tij në xhenet. Për këtë, Ai ka dërguar profetë, ka zbritur Libra dhe na ka shpalosur universin, i cili është i mbushur me shfaqje të panumërta fuqie dhe madhështie nga grimca më e vogël, deri tek trupi më i madh, si manifestim i urtësisë dhe mësimit. Kështu që, kudo që

të shikojë njeriu, ai mund të shohë shenjat e fuqisë së Allahut të Madhëruar. Pra, le të shikojë veten, le të shikojë përbërjen e tokës, le të shikojë atmosferën dhe të admirojë veçantinë e artit hyjnor në gjithçka që sheh...

Këtu, dituria dhe urtësia e vërtetë është të shohësh hirin e pafund dhe begatitë e panumërta të Allahut të Plotfuqishëm dhe të jesh në gjendje të jetosh një jetë adhurimi me ndjenjat e mirënjohjes ndaj Tij.

Injorancë nuk është mosnjohja e shkencave të kësaj bote. Injorancë e vërtetë, është mosnjohja e Allahut të Madhëruar. Mosnjohja e fuqisë madhështore të Allahut, në sajë të të Cilit ekziston dhe në sajë të mirësive të të Cilit jeton.

Për të njohur veten kërkojnë përgjigje këto pyetje:

- Përse je krijuar?
- Përse je në këtë botë?
- Në pasurinë e kujt jeton?
- Çfarë drejtimi ka udhëtimi yt?
- Si do jetë përfundimi yt?
- A je gati për gjykimin hyjnor?
- A je përgatitur për botën tjetër?

Një person që mund të ketë mbaruar shumë fakultete, ka lexuar libra të panumërt dhe ka themeluar dhjetëra fabrika, por që nga ana tjetër ka mbetur i huaj ndaj vetes së tij, do të thotë se ai jeton i pavetëdijshëm për qëllimin e ekzistencës në këtë botë.

Profeti ﷺ, lutej:

"Allahu im! Mbështetem tek ti nga dituria që s'jep dobi, nga zemra që s'rrëqethet, nga nefsi që s'ngopet dhe nga lutja që nuk pranohet!" (Muslim, Dhikr, 73.)

Ndërkohë që trupi i përkohshëm i anijes përpëlitet në vorbullën e vdekjes, asaj nuk do t'i bëjnë dobi dijet e thata që nuk i japin përgjigje nevojave kryesore, që nuk përjetohen dhe nuk kthehen në urtësi.

Sadi Shirazi ka thënë:

"Sado që të lexosh, nëse nuk sillesh sipas asaj që ke mësuar je injorant."

Dituria fiton vlerë nëse zbatohet në jetë. Përndryshe ajo nuk ka asnjë vlerë. Allahu i Madhëruar, gjendjen e atyre që nuk punojnë me dijen e tyre, e ngjason me atë të gomarit që bart vëllime të tëra me libra.

Injorant i vërtetë, nuk është ai që nuk ka kapur kurrë laps dhe letër me dorë, por ai që nuk e ka kuptuar se; edhe pse çanta e tij është mbushur me dengje diplomash, ai është «asgjë» përballë madhështisë së Zotit të tij. Për shkak të krenarisë dhe mendjemadhësisë së egos së tij, sytë e zemrës së tij janë verbuar.

Shejh Sadi thotë:

"Një njeri i paditur dhe i devijuar, është më i mirë se një njeri i ditur që nuk i frikësohet gjynaheve, sepse i padituri ka humbur

rrugën për shkak të verbërisë së tij, kurse i dituri ka rënë në një pus edhe pse ka parë me të dy sytë."

Ajo që do ta lartësojë njeriun, nuk është depozitimi në mendje e asaj që shkruhet në letra. Ka shumë njerëz të ditur, të cilët edhe pse e dinë se ajo që po bëjnë është e gabuar, kanë rënë në gabime që edhe shumë injorantë nuk do t'i bënin, sepse u mbizotëruan nga egot e tyre.

Prandaj, ajo që do ta lartësojë njeriun dhe do ta bëjë atë një «besimtar të përsosur», është pjekuria e botës së tij të brendshme dhe pajisja e saj me ndriçim dhe frymëzim shpirtëror, pa e lënë pas dore botën e tij të jashtme.

Allahu i Madhëruar dëshiron që ne të marrim pjesën tonë prej "marifetullahut". Por kjo nuk është e mundur thjesht me informacione që akumulohen në mendje, sepse informacioni i thatë nuk ka dobi. Madje, mund të shkaktojë edhe dëm. Për shembull, dijetarët e Beni Israilit, të cilët i shisnin ajetet e Allahut për pak para të dynjasë, kishin njohuri të tilla, të thata.

Studimet fetare të privuara nga devotshmëria ,nxjerrin në pah" prishës të fesë "me gradën" dijetar të fesë ,"të cilët edhe të vërtetat hyjnore i vlerësojnë në varësi të interesave të kësaj bote dhe egos së tyre .Njerëz të tillë anojnë nga ambiciet e egos së tyre, si dëshira për pasuri ,epsh dhe famë .Për rrjedhojë ,edhe në fetvatë e tyre do të anojnë nga interesat personale ,duke neglizhuar "ndjekjen e Kuranit dhe Sunetit "dhe duke" shpikur në emër të fesë."

Njohuritë e depozituara në mendje, qofshin ato edhe njohuri fikhu, përsëri nuk janë dobishme më vete. Kjo, sepse, fikh-u fiton vlerë vetëm në masën që brumoset me takva në zemër. Për këtë arsye, Mevlana, kohën kur ishte në kulmin e dijeve ekzoterike, e shpreh duke thënë; *"isha ende papjekur!"*. Ndërsa përsosmërinë e tij shpirtërore dhe brumosjen me takva në zjarrin e dashurisë, e shpreh duke thënë; *"u poqa!"*. Kurse fazën e pjekjes me dashuri hyjnore, ai e e shpreh duke thënë; *"u dogja!"*.

Mevlana i nderuar shprehet:

"Ka shumë dijetarë pa urtësi; ata e kanë mësuar dijen përmendsh, por nuk kanë mundur të bëhen miq të dashur të Allahut!"

Nëse ato që kemi mësuar nuk na nxitin për vepra të mira dhe nuk kanë forcën dhe fuqinë për të na ndaluar nga mëkatet, atëherë ai akumulim njohurish nuk ka arritur të transferohet në urtësi.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët..." (Fatir, 28.)

Pra, «*takva/frika ndaj Allahut*», është një domosdoshmëri për një dijetar të vërtetë. Allahu i Madhëruar vetëm një rob të tillë e quan «dijetar»... Jo të shkujdesurit, të cilët nuk kanë as frikë nga Allahu, e as turp nga i Dërguari i Tij, por pandehin se mendjet e tyre të mangëta janë kriteri i vetëm i së vërtetës, duke filtruar kështu fenë përmes saj, duke zgjedhur atë që u përshtatet mendjes së tyre dhe duke hedhur poshtë atë që nuk i përshtatet!

Ata që i drejtohen ndonjë dege gjatë arsimimit në këtë botë, mësojnë njohuri të shumta në atë fushë për shumë vite. Por, bota nuk përbëhet vetëm prej tyre. Ato njohuri janë thjesht thërrmija. Dhe, këto thërrmija njohurish, mund të gjenden gjithashtu edhe tek indiferentët, gjynahqarët dhe shpirtzinjtë. Madje, këta njerëz mizorë, mund të shkatërrojnë jetën e tyre të përjetshme duke kryer padrejtësi më të mëdha me dijet e tyre, të cilat mund të përdoren edhe për të mirë, edhe për të keq, si një thikë me dy tehe.

Ashtu siç është e nevojshme që; në fillim të rrënjosësh ndjenjën dhe vetëdijen e drejtësisë në zemrën e një njeriu të drejtësisë, ashtu edhe -në çdo fushë tjetër- është e nevojshme që në zemrën e atyre që marrin dituri, të rrënjosësh frikën dhe dashurinë ndaj Zotit, ndjeshmërinë ndaj të drejtave të robit dhe frytet e para të besimit, që janë dhembshuria dhe mëshira.

Rumiu thotë:

"T'i mësosh dituri të pamoralshmit është sikur t'i japësh shpatë kusarit."

Imam Shafiu ka thënë:

"Ai që i mëson dije dikujt që nuk e njeh veten, e çon dëm të drejtën e dijes. Ndërsa ai që e fsheh dijen nga ai që e meriton, bën padrejtësi."

Botëkuptimi i sotëm i dijes nuk kalon përtej zbulimit dhe evidentimit të ligjeve fizike të materies që Allahu ka krijuar në gjithësi. Në këtë mënyrë, anashkalohet procesi i njohjes së Allahut, i Cili i ka vendosur këto ligje, pra neglizhohet thelbi i vërtetë i kësaj çështjeje. Shoqërisë nuk i shpjegohen shfaqjet e artit hyjnor dhe ajo nuk edukohet për t'u lidhur shpirtërisht me Allahun, i Cili është edhe Artisti i të gjitha këtyre shfaqjeve. Për rrjedhojë, formohet një botëkuptim diturie i mangët dhe i përgjysmuar, si zogu me një krah. Mirëpo, edukimi i njëanshëm dhe i privuar nga aspekti shpirtëror është i mangët. Në edukim, ekuilibri fizik dhe metafizik është kusht i domosdoshëm. Përndryshe, njeriu do të bëhet si zogu që mundohet të fluturojë me një krah dhe bie pre e një maceje të uritur.

Mevlana thotë:

«Dituria ka dy krahë, dyshimi ka vetëm një... Një zog me një krah bie shpejt në tokë.»

Edukimi shkencor i privuar nga spiritualiteti shkatërron edhe ahiretin e fëmijëve tanë.

Sot, avancimi i teknologjisë, konsiderohet si qytetërim. Mirëpo, në të vërtetë, qytetërimi bazohet në vlera njerëzore. E në fakt, përparimi teknologjik nuk arriti të zhvillonte virtytet njerëzore, përkundrazi, ndryshoi natyrën e personit që kishte marrë rob. Njësoj si perimet dhe frutat me hormone...

Problemi i njerëzimit sot, buron nga fakti se; ndërkohë që

është mekanizuar dhe zhvilluar në çdo fushë, ai është vetmuar e dobësuar shpirtërisht dhe i ka dhënë lamtumirë vlerave njerëzore. Paqja që njerëzimi kërkon sot, nuk është as në mekanizim e as në përparim material, sepse këto nuk kanë as mëshirë, as dashuri, as ndërgjegje...

Sot, në një kohë kur shkenca dhe teknologjia kanë arritur në nivelet më të larta në histori dhe po kërkohen mundësitë e jetës nëpër univers, njerëzit kanë harruar dobësinë e tyre dhe adhurojnë egot e tyre. Mirëpo, një epidemi virusi që ka prekur të gjithë botën e ka shkatërruar këtë krenari dhe arrogancë të njeriut. Ekonomitë gjigante u përmbysën, sistemet shëndetësore ishin të pamjaftueshme dhe vendet shkuan në prag të falimentimit...

Pra:

- Të fokusohesh tek shkaqet dhe të harrosh Allahun që i krijon shkaqet,

- Të fokusohesh në fitimin e rrizkut dhe të harrosh Zotin që na e jep rrizkun,

- E, të fiksohesh pas ngjarjeve dhe të mos njohësh Allahun e Madhëruar, Krijuesin Absolut, është injoranca më e madhe.

Në ditët e sotme, ateistët dhe deistët, me sloganin «Feja apo shkenca?», po përpiqen të mbjellin një farë të re të së keqes në mendjet dhe zemrat e brezave të rinj. Përgjigja për këtë është mjaft e thjeshtë:

Para së gjithash, feja dhe shkenca nuk janë alternativa për njëra-tjetrën. Ajo që ne e quajmë shkencë konsiston në përcaktimin e rregullave që Allahu i Madhëruar ka vendosur në univers.

Nëse Zoti i Madhëruar nuk do t'i kishte vendosur këto rregulla në univers dhe nuk do t'i kishte dhënë njeriut aftësitë njohëse për t'i zbuluar ato, si do ta zbulonte njeriu një gjë të tillë si «shkenca»?! Për rrjedhojë, Allahu i Plotfuqishëm nuk ua ka dhënë aftësinë për t'u angazhuar në dituri krijesave të tjera të cilave Ai nuk ua ka ngarkuar as përgjegjësinë e të qenit robër të Tij. Ai ia ka dhuruar këtë aftësi vetëm njeriut. Në një ajet, Allahu urdhëron: **"...juve nuk ju është dhënë veçse pak dije!"** (Isra, 85.)

Prandaj, ta kthesh shkencën në një idhull kundër Zotit të Plotfuqishëm, i Cili është Pronar i dijes së pafundme dhe absolute, me këto thërrime dijeje, është vetëm një tregues se në çfarë grope të thellë shkujdesjeje dhe budallallëku kanë rënë ateistët dhe deistët.

Allahu i Plotfuqishëm i ka dhënë njerëzimit fenë dhe po Ai ia ka dhuruar dijen dhe shkencën. Ato nuk janë të ndara nga njëratjetra. Islami e ka inkurajuar shkencën gjatë historisë, dhe ndërsa bota perëndimore ishte në errësirën e injorancës dhe besëtytnive, bota islame arriti një nivel magjepsës në shkencë dhe qytetërim. Kjo, sepse vetë ajetet e Kuranit hedhin dritë mbi shkencën. Zbulimet shkencore të bëra nuk mundën të kundërshtonin asnjë ajet të Kuranit, përkundrazi, e vërtetuan atë.

Islami, feja e vetme e vërtetë, nuk ka probleme me shkencën. Përkundrazi, Kurani shkon i pari dhe shkenca e ndjek atë duke e konfirmuar.

Në fakt, faktet rreth krijimit të njeriut, qumështit të nënës, daktiloskopisë, dermatologjisë, gjenetikës, mjekësisë parandaluese, botanikës, astronomisë, gjeologjisë, fizikës, gjeografisë, historisë dhe shkencave të ngjashme të shpallura në Kuran 14

shekuj më parë, janë zbuluar vetëm kohët e fundit nga qarqet shkencore dhe është vërtetuar vazhdimisht se sot, Kurani është i vetmi libër i vërtetë.

Në Perëndim, duke qenë se feja është shtrembëruar, ajo ka rënë në konflikt me zbulimet shkencore dhe autoriteti kishtar, i cili dominon shoqërinë dhe udhëheqjen, e ka penguar shkencën për të mbuluar këtë situatë. Prandaj, kundërshtimi i fesë duke mbrojtur shkencën është një qëndrim i popullarizuar në Perëndim dhe që prej andej u përhap në botë. Megjithatë, në botën islame, nuk ka asnjë bazë të saktë ku mund të reflektohet ky qëndrim.

Pra, pyetja; «Feja apo shkenca?», është një nga helmet e injektuara nga qarqet dashakeqe që duan të mbjellin farën e dyshimit dhe të mohimit në mendjet e pastra të brezave të rinj, gjoksi i të cilëve është plot besim. Prandaj, është detyrë e çdo myslimani që të jetë jashtëzakonisht i kujdesshëm dhe vigjilent ndaj viruseve të tilla.

Si rezultat i trishtë i mungesës së një edukimi të duhur Islam, sot po përballemi edhe me problemin e deizmit. Sipas kësaj teze, Zoti ekziston – sepse nuk ka sesi të mohohet- por ashtu sikurse Ai krijoi bimët e bagëtitë dhe nuk i ngarkoi me detyrën e adhurimit, edhe njeriu është i tillë, pra pa përgjegjshmëri, pa ndonjë detyrim.

Deizmi është një sëmundje më vete. Thamë se; të mohosh Krijuesin e Lartë është marrëzi. Prandaj, deisti sipas tij, nuk mohon Krijuesin, por refuzon të qenët e Tij Zot. E thënë ndryshe nuk pranon rendin hyjnor që Ai ka urdhëruar, refuzon Librin, Profetin dhe dispozitat fetare. Atëherë ç'ndryshim ka midis njeriut

dhe krijesave të tjera? Ndërsa Krijuesi i Gjithësisë në Kuranin Famëlartë vazhdimisht tërheq vërejtjen duke thënë:

"**Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë?!"** (Ankebut, 2.)

"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?" (Kijame, 36.)

"Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t'u zbavitur!" (Duhan, 38; Enbija, 16.)

Në ditët e sotme shohim shumë nga vëllezërit tanë të rinj, të ditur e të kulturuar që kanë mbaruar universitetin dhe kanë përfunduar studimet e larta. Por, për fat të keq, nuk kanë asnjë lloj informacioni nga kultura e Kuranit dhe Traditës Profetike. Për edukimin që kanë marrë, pandehin se është dija që lavdërohet në Kuran dhe Sunet. Ndërkohë që dija e cila nuk e shpie mendjen dhe zemrën e njeriut te Allahu dhe që nuk bëhet shkak për perceptimin e fuqisë dhe madhështisë së tij, ndoshta në këtë botë mund t'i japë njeriut ndonjë etiketë, profesion, pozitë dhe para, por nuk mund të ketë ndonjë dobi për shpëtimin e përhershëm.

Në bisedat që bënte i nderuari Sami Efendiu, shprehej se dituria e vërtetë është të ndjesh në zemër fuqinë dhe madhështinë e Allahut të Madhëruar. Madje, mirësinë e kësaj diturie e shprehte sa herë që kishte mundësi. Një ditë, një person që kishte ardhur për ta vizituar, dëshironte të merrte edhe duanë e hoxhës së nderuar, por ta njihte atë edhe me nipat e vet. Kur hynë brenda, u përshëndetën me selam dhe duke ia prezantuar nipat e vet, i tha:

"I nderuar! Këta djem kanë studiuar në Amerikë dhe janë bërë inxhinierë. Dëshirojmë të marrim edhe duanë tuaj!".

Mirëpo, i nderuari Sami Efendiu, me një buzëqeshje shumë domethënëse, tha:

"Edhe unë i varfri jam diplomuar në Daru'l-Funun/Universitet. Por arsimi i vërtetë është "marifetullahu" (njohja e Allahut)!"

Kur Omeri ﷺ, ndërroi jetë, Ibni Mesudi ﷺ, pati thënë:

"Iku nga kjo botë nëntë e dhjeta e diturisë."

Sahabët që ndodheshin aty, i thanë:

"Në mesin tonë ka ende dijetarë!"

Ai tha:

"Unë e pata fjalën për diturinë shpirtërore."

Ajeti Kuranor thotë:

"...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët..." (Fatir, 28.)

Siç kuptohet edhe nga ajeti; dituria që nuk zgjon ndjenjën e frikës dhe devotshmërisë ndaj Allahut, nuk është dituria për vlerën e së cilës flasin Kurani dhe Hadithi. Një tjetër problem shqetësues është neglizhenca ndaj një sërë urdhëresash me pretekstin e të qenit në kërkim të diturisë. Kjo nuk është gjë tjetër përveçse një vetëmashtrim i qartë.

Ndonjëherë më pyesin:

«-Ku duhet të bëjmë një karrierë?» Unë u them:

«Së pari, bëni një karrierë në takva, pastaj mund të bëni master ose doktoraturë kudo që dëshironi.»

Vallë, a jemi dërguar në këtë botë për të kënaqur egot, për të marrë diploma të çmuara dhe grada të larta, për të grumbulluar pasuri dhe mall? Apo mos vallë jemi kapluar nga sëmundja e kthimit në qëllim të këtyre fazave, që supozohej të ishin vetëm mjete në rrjedhën e jetës?!.

Përfitimi që do të arrihet përmes edukimit në këtë botë do të mbetet ende po në këtë botë, ndërsa edukimi në lidhje me njohjen e Allahut, do të jetë mjet i lumturisë së përjetshme. Prandaj, çdo dije duhet mësuar në emër të Allahut, me syrin e urtësisë dhe me thellësinë e besimit dhe takvasë, në mënyrë që të hapen dritaret e njohjes së Allahut në zemër.

Gjendemi brenda dy shkollave. Njëra është e kësaj bote dhe tjetra është e ahiretit. Detyra e besimtarit; është që shkollën e kësaj bote ta përfshijë në atë të ahiretit. Domethënë, çdo përshtypje që marrim nga kjo botë duhet të na çojë prej pasojës drejt Shkakut, prej veprës tek Vepruesi dhe prej artit tek Artisti. Në këtë mënyrë, mësimet e dynjasë duhet të përbëjnë një kapital për mësimet e ahiretit dhe të jetohet duke i kombinuar të dyja.

Përndryshe, siç thuhet në një hadith: *"Kush e shton dijen e dynjasë, por jo devotshmërinë dhe përkushtimin, ai njeri shton vetëm largësinë prej Allahut."* (Sujuti, Xhamiu's-Sagir, II, 169.)

Jeta është plot ulje ngritje (sfida); rinia dhe pleqëria, shëndeti dhe sëmundja, pasuria dhe varfëria... Si duhet të përballemi me këto dhe situata të tjera të jetës; si duhet fituar kënaqësia e Allahut? Jeta 23 vjeçare profetike e të Dërguarit të Allahut ﷺ, është përgjigjja më e bukur e këtyre pyetjeve. Ai ﷺ, përmes kulturës Islame arriti të ndërtonte Epokën e Lumturisë.

Ne jemi nevojtarë të kësaj kulture për të sotmen dhe për të ardhmen. Jemi nevojtarë të këtij edukimi të vënë në jetë dhe të praktikuar nga Ai ﷺ.

Njohja e të Dërguarit të Allahut ﷺ, nga afër dhe ndjekja e tij me dashuri dhe respekt, është edukimi më i rëndësishëm që duhet të shohim në shkollën e kësaj bote. Ai që është i privuar nga ky edukim, pra një person që nuk e njeh të Dërguarin e Allahut ﷺ, konsiderohet ende i paditur, edhe nëse ka lexuar mijëra libra dhe është i mbushur me informacione të panumërta në mendjen e tij.

Brezave të rinj, të cilët kalojnë vitet të tëra rrugës për në shkollë dhe copëtojnë bërrylat në krye të librave dhe fletoreve, për hir të fitimit të dijes, ne duhet t'u mësojmë sekretin që e kthen diturinë në diçka të dobishme, domethënë të vërtetën e afërsisë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ. Përndryshe, siç shihet në situatën aktuale, ajo që do të na mbesë në dorë sa i përket moralit, sjelljes së mirë dhe njerëzillëkut, do të jetë vetëm një lodhje e hidhur. Kështu, në vend që të lëmë pas vetes një qytetërim virtytesh, do të mbetet vetëm një plehërishte njerëzore!..

Neglizhenca e edukimit fetar, sjell plagën e materializmit. Pra; ndjekjen vetëm të interesave të kësaj bote, që është një nga faktorët dhe gurët e themelit të pafesisë. Materializmi nuk është filozofi, është mjerim intelektual. Nuk është mençuri, është sëmundje.

Shoqëritë nuk mund të arrijnë shpëtimin me shpirtin e pedantëve të cilët rrinë mbi librat me kapakë të errët të filozofisë, që kanë mbetur në raftet e pluhurosur të bibliotekave.

Ai që do ta shpjerë njeriun në lumturinë dhe shpëtimin e vërtetë, është shpirti i të devotshmëve që kanë arritur urtësinë dhe përsosmërinë duke u brumosur me kulturën e Kuranit dhe Sunetit.

Sot, edukimi në fushat e kësaj bote mund t'i sjellë lumturi njerëzimit dhe fëmijëve tanë vetëm nëse zhvillohet së bashku me edukimin që lidhet me botën tjetër. Përndryshe, vetëm edukimi i kësaj bote, për fat të keq bëhet një mjet për t'i larguar fëmijët tanë nga vlerat e tyre. Fëmijët tanë bien pre e modës, stilit të jetesës dhe reklamave mashtruese të kulturave të huaja. Kështu, ata shndërrohen në robotë të disa sistemeve që nuk i sjellin lumturi dhe paqe njerëzimit.

Që nga periudha e Tanzimatit, lëvizjet perëndimorizuese në arsim, nuk kanë dhënë rezultatet e dëshiruara. Në fillim, synimi ishte të arrinim Perëndimin në shkencë dhe teknologji. Por, kjo nuk ndodhi... E çështë më e keqja, gjatë këtij procesi, ne humbëm shumë nga cilësitë dhe virtytet tona të bukura që ishin më superiore se ato në Perëndim.

Pra, si rezultat i perëndimorizimit, ne filluam të imitojmë dhe t'u ngjajmë jomyslimanëve. Siç thotë edhe një mendimtar:

«Disfata e vërtetë ndaj armikut, është t'i ngjash atij.»

Një paralajmërim për brezat e rinj nga poeti i ndjerë Nexhip Fazëll:

«Dega që nuk i pëlqen rrënjët dhe fruti që nuk i pëlqen degët, kalbet pa u pjekur!»

Herë pas here, kur hapet çështja e arsimit, paraqiten disa propozime, ku përmenden parimet arsimore të një vendi evropian, metodat e edukimit të një filozofi, apo sukseset e një shkolle perëndimore.

Mirëpo, ashtu si çdo rrënjë që nuk pranon shartim nga çdo pemë, edhe një qytetërim shpesh vuan më shumë sesa përfiton nga «kontributi» i kulturave që janë shpirtërisht të huaja për të.

Qytetërimi ynë, është Qytetërimi Islam, i cili është ndërtuar nga Profeti ynë ﷺ, mbi bazën e Kuranit dhe Sunetit. Kultura e parë dhe më e rëndësishme që duhet të studiohet, është kultura Islame, kultura e Kuranit dhe e Sunetit.

Çdo qytetërim formon tipin e vet të njeriut. Ky njeri shfaq sjellje në harmoni me qytetërimin të cilit i përket. Civilizimi Islam është një pikë kulmore që është arritur një herë në historinë e njerëzimit. Shkaku i kësaj, falë Islamit, është pajisja e aftësive të natyrshme me dijen dhe urtësinë hyjnore. Domethënë, njerëzit e

zgjedhur të kësaj shoqërie i patën mbushur zemrat e tyre me dije e urtësi të vërtetë duke i mënjanuar problemet vetjake.

Në kohën tonë, -elhamdulilah- mundësitë për edukim fetar janë zgjeruar shumë në krahasim me të kaluarën. Janë themeluar një numër i madh i shkollave 9 vjeçare dhe të mesme me orientim fetar Islam, si dhe shumë Fakultete të Teologjisë dhe Shkencave Islame. Mirëpo, nëse në këto shkolla jepet vetëm informacion sipërfaqësor dhe personaliteti, karakteri, edukata, morali dhe etika lihen në duart e rrugës, televizionit, internetit, modës dhe reklamave, fatkeqësisht, nga këto shkolla nuk do të merret asnjë rezultat i dëshiruar.

Prandaj, nëse bëhet e mundur që në këto institucione arsimore të zhvillohen virtytet shpirtërore, përulësia, personaliteti, edukata, morali i mirë, bujaria dhe trimëria, atëherë mund të lindin sërish njerëz me virtyte të larta dhe lider shpirtërorë edhe në fushat e dijes Islame. Kështu, do të arrihen edhe shumë fitore si në botën materiale, ashtu edhe në atë shpirtërore.

Sistemi i sotëm arsimor, është produkt i botëkuptimeve materialiste, pozitiviste dhe laike të imponuara nga perëndimorizimi që filloi me Tanzimatin. Në këtë sistem arsimor, edukimi fetar konsiderohet njësoj si zdrukthëtaria dhe farkëtaria. Prandaj, nxënësve u thuhet: "Lexoni këtë libër, kaloni këto provime, e jeni të kompletuar".

Mirëpo, edukimi fetar nuk mund të jepet kështu. Po, njohuritë e përgjithshme janë të nevojshme. Por pastaj është e nevojshme që zemra t'i përpunojë ato njohuri dhe t'i gdhendë ato në personalitetin tuaj. Nëse ne vetë jemi të tillë, kështu do të jenë edhe nxënësit tanë. Nxënësve duhet t'u japim jo vetëm njohuri,

por edhe shembull personal. Kështu, nxënësi do të ndjekë shembullin tonë.

Prandaj, edukata fetare, nuk është as profesion zdrukthëtari, as farkëtari, e as ndërtimi. Profesioni i mësimdhënies së fesë së Allahut të Madhëruar përveç diturisë, kërkon kulturë, gjendje shpirtërore, dashuri dhe respekt. Dija merr vlerë me zbatimin e saj, e kjo arrihet me dashuri. Feja nuk mësohet siç mësohet zanati i mekanikut. Përndryshe, çdo gjë humbet njësoj si shkrimi në akull kur e rreh dielli. Të jesh fetar, nuk do të thotë të dish gjithçka për fenë, por të përpiqesh të vësh në jetë ato që di dhe ta mbash fenë gjallë me entuziazëm dhe frymëzim shpirtëror.

Për shembull, studimi i Historisë së Profetit ﷺ, nuk duhet të zhvillohet vetëm si mësimi i thatë një biografie ose kronologjie. Pra, studimi i jetëshkrimit të Profetit ﷺ, i përbërë vetëm nga informacione sipërfaqësore, si p.sh; kur dhe ku ka lindur Profeti ynë, kur dhe ku ka migruar, çfarë luftërash ka zhvilluar, në çfarë moshe dhe ku ka vdekur, etj., është larg nga arritja e përfitimit të dëshiruar në aspektin e orientimit të jetës së njerëzve.

Në këtë aspekt, edukimi i vërtetë i Historisë së Profetit, është të lexosh, të kuptosh dhe të përjetosh sjelljen shembullore të Profetit tonë ﷺ, që prej lindjes deri në vdekje, moralin e tij të bukur, dashurinë dhe zellin e tij për të mësuar dhe përcjellë Kuranin dhe përpjekjet e tij në rrugën e Allahut. Pra, të bësh përpjekje për të përvetësuar shpirtërisht botën ndjenjës, mendimit dhe shpirtit të tij madhështor.

Të gjitha të dhënat e librave i ngjajnë një fare në realitet. Farat që nuk mbillen, por ruhen në një vend, sado vite që të kalojnë, ato përsëri mbesin të njëjta. Kështu pra edhe informacioni i li-

brave; kur ato mbesin në faqet e tyre ose në rafte, dhe nuk lexohen, s'kanë asnjë dobi. Në të kundërtën farat mbjella, rriten dhe zhvillohen sipas cilësive të tyre, aq sa disa bëhen edhe pemë gjigande. Të ngjashme me këto janë edhe farat e shkencës të mbjella në tokën e shpirtit, të cilat e bëjnë zemrën një kopsht shpirtëror dhe atëherë arrihet edhe e fshehta edhe mirësia, që janë frytet e vërteta të shkencës dhe dijes.

Edukimi më i vështirë ndërmjet të gjitha gjallesave, është ajo e qenieve njerëzore. Për këtë arsye, Allahu i Plotfuqishëm dërgoi robërit e Tij më të dashur, profetët, si «edukuesit e njerëzimit». Prandaj, mund të thuhet se; "Edukimi është profesion profetik".

Një mendimtar thotë:

«Nëse dëshiron të jesh një mësues i mirë në tokë, duhet të jesh nxënës i qiellit.» Me fjalë të tjera; ne duhet të jemi nxënës të përjetshëm të Kuranit dhe Sunetit; ne duhet t'i jetojmë dhe t'i mbajmë gjallë ato brez pas brezi. Vetëm atëherë mund të korrni frytet më të ëmbla të jetës si nxënës dhe të bëheni mësues të vërtetë.

Ashtu si mësuesia, që kërkon edukim serioz, edhe edukuesit janë në pozitën e nxënësve të shkollës së Kuranit dhe Sunetit. Me fjalë të tjera, të gjithë në këtë botë janë në pozitën e një nxënësi, që në frymën e fundit, do të dalin para Allahut dhe do të marrin diplomën e tyre.

Duhet të dimë se; ta kalosh jetën kot, është shkak i një dështimi të madh. Mos ruajtja e amaneteve madhështore që kemi në

duar, është një shpërdorim shumë i madh. Sidomos në çështjen e edukimit të njeriut; ta çosh dëm atë duke mos e edukuar në përputhje me natyrën e tij si krijesa më e nderuar, është humbja më e madhe.

M. Akif Ersoj, e përkufizon kështu një edukator ideal:

"Veten mësues për ta quajtur, besimtar duhet të jesh,
I moralshëm, kompetent, e më pas ndërgjegje duhet të kesh..."

Pra, një mësues, para së gjithash duhet të jetë besimtar i mirë, prej zemrës së të cilit buron mëshirë. Më pas, duhet të jetë i moralshëm dhe të gëzojë një karakter shembullor. Po ashtu, ai duhet të jetë kompetent, ta zhvillojë veten vazhdimisht duke qenë i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka. Krahas këtyre, ai duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe ta vërtetojë humanizmin e vet me virtyte të tilla, si mëshira, butësia dhe vetëmohimi.

Edukimi, me tepër se përcjellje njohurish, është rrënjosje personaliteti dhe karakteri, sepse njeriu dashurohet pas personalitetit dhe karakterit të fortë.

Përpjekjet materiale dhe shpirtërore si kushte të domosdoshme për edukimin e një njeriu janë:

– Të jesh një edukator që do dhe duhet,

– Të punosh me vetëmohim,

– Të jesh i duruar dhe tolerant,

– Të kujdesesh dhe të mbrosh,

– Të kesh zell dhe butësi,

– Të ushqesh shpresë dhe të lutesh...

Të mos harrojmë se; ashtu si bimët e çmuara që nuk rriten shpejt, ashtu edhe njeriu nuk edukohet lehtë.



Të jesh edukues, është një profesion i sakrificës së sinqertë. Sa më entuziast të jetë një edukator në klasën e tij, aq më efektiv do të jetë në mësimdhënie.

Për këtë arsye, edukatorët cilësorë, që i përkushtohen fesë, atdheut dhe kombit dhe arrijnë të lënë trashëgim «njerëz të edukuar», meritojnë mirënjohje të përjetshme...





PREDIKIMI DHE METODA

«Të fitosh një zemër», nuk është thjesht të bësh një person të lumtur në aspektin material të kësaj bote. «Të fitosh një zemër», në të vërtetë do të thotë të afrosh një zemër me Allahun, sepse besim, do të thotë të njihesh me Kuranin dhe Profetin. E në këtë mënyrë, të ndërtosh dhe të shpëtosh jetën e tij të përjetshme.

Mirësia dhe dashamirësia, janë forma më e bukur e predikimit të Islamit. Kjo, sepse njeriu mposhtet nga dashuria. Qytetet pushtohen me ushtarë, ndërsa zemrat me mirësi dhe dashamirësi.

Nëse në ndonjë kohë apo vend vihet re se jeta fetare është venitur dhe njerëzit kanë rrëshqitur në rrugë të gabuara, thirrja Islame në atë vend, vjen si detyrë parësore, pas besimit dhe farzeve. Për rrjedhojë, pa u kumtuar e drejta dhe e mbara, nuk kanë dobi as shumë prej veprave të mira.



Në kohët kur shoqëria tërhiqet në mosbesim dhe imoralitet si trungjet në përmbytje, shërbimi i përcjelljes së mesazhit Islam, është detyrë parësore e besimtarit.



Çdo mirësi e ka një çmim. Ne jemi nderuar me mirësinë e Islamit edhe pse nuk kemi paguar ndonjë çmim për të.

Prandaj, për të paguar çmimin e besimit tonë, duhet të përfaqësojmë dhe përcjellim bukuritë e moralit Islam në jetën tonë, duke qenë mirënjohës për këtë mirësi të pafund të Zotit tonë.



Sot, ne duhet ta konsiderojmë detyrë të besimit dhe ndërgjegjes që ta kapim përdore njeriun që ka rënë në vorbullën e të këqijave të kohës, të shpëtojmë nga ajo vorbull shoqërinë së cilës i përkasim dhe t'i tregojmë atyre se çfarë është lumturia e përjetshme dhe e vërtetë.



Edhe pse sot nuk ka një sistem të dukshëm skllavërimi, ne kemi shumë vëllezër dhe motra që janë nën zinxhirë të paduk-

shëm dhe rënkojnë me klithma të heshtura. Prandaj, është detyra e ndërgjegjes sonë që t'u shtrijmë dorën atyre dhe t'i çlirojmë nga zinxhirët e dynjasë, egos dhe shejtanit.



Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)**!"** (Tekathur, 8.)

Prandaj, është përgjegjësi e madhe që na e detyron besimi ynë, që t'i shtrijmë dorën e ndihmës atyre që janë të privuar nga kjo mirësi, me qëllim që të shlyejmë borxhin e mirënjohjes për bekimin më të madh që na është dhuruar, «Imanin».



Sot, mjerimi shpirtëror ka shkuar përtej mjerimit material. Por, për shkak se mjerimi shpirtëror paraqitet me një makijazh mashtrues nën një maskë të rreme lumturie, fatkeqësia e saj nuk kuptohet plotësisht. Detyra më e rëndësishme për ne, është të përpiqemi për të eliminuar mjerimin shpirtëror së bashku me mjerimin material.



Edhe nëse një person ka të gjithë pasurinë e kësaj bote dhe arrin kulmin e mirëqenies materiale, asgjë tjetër nuk mund ta mbushë zbrazëtinë shpirtërore të shkaktuar nga privimi i besimit dhe urtësisë së vërtetë.

Mevlana thotë:

"Duhet të ndjejmë keqardhje për mundimin e shkaktuar nga mungesa e besimit, sepse nuk ka shërim tjetër për atë pikëllim."



Fatkeqësisht, sot, shumë njerëz të shkujdesur, për shkak se nuk e njohin lumturinë e vërtetë, mendojnë se mjerimi i tyre

është lumturi. Pra, ai që ka rënë, nuk e di se ka rënë... Si mund ta njohin diellin sytë që nuk e njohin dritën?



Zemrat e privuara nga dielli i besimit, janë vetëm gërmadha shpirtërore. Kurse zemrat e ndriçuara nga dielli i besimit, janë vende pranverore të lumturisë së përjetshme.



Shpirti i një besimtari të vërtetë nuk mund të gjejë ngushëllim vetëm në besimin e tij, kur rreth tij ka njerëz që kanë nevojë për udhëzim.



Shërbimi më i madh, është të fitosh zemrat, të rrënjosësh besimin në shpirtra dhe në zemra dhe t'u hedhësh një mjet shpëtimi atyre që po mbyten shpirtërisht. Shpirtrat e përsosur, gjithmonë kërkojnë qenie të tjera rreth tyre për t'i shpëtuar, në mënyrë që të arrijnë shpëtimin e përjetshëm.



Sot, zemrat kanë nevojë për dhembshurinë dhe fytyrën e buzëqeshur të Islamit. Disa kanë humbur mundësinë, e disa besimin. Prandaj, sot, mëshira nuk mund të tregohet vetëm me ndihmë financiare. Një fjalë ngushëllimi, një këshillë e ëmbël dhe një mesazh i dhënë nga zemra, është shfaqja më e bukur e dhembshurisë dhe mëshirës.



Dhurimi dhe bujaria nuk konsistojnë vetëm në ndarjen e mundësive materiale. Duhet të shpenzohet nga gjithçka që ka dhënë Zoti. Të predikosh Islamin duke e jetuar vetë atë, është forma më e bukur e dhurimit.



Shërbimi më i madh që mund t'i bëhet një personi është ta ndihmosh atë të fitojë të ardhmen e tij të përjetshme. Mënyra për ta bërë këtë, është ta orientosh atë drejt devotshmërisë ndaj Allahut.



Sot, shërbimet e kryera në rrugën e Allahut, janë shumë të rëndësishme. Për shembull, nëse do të ishit pranë një burimi dhe do t'u ofronit ujë njerëzve që vinin e shkonin, do të ishte një bamirësi shumë e mirë. Por, nëse ia jepni atë gotë ujë një personi që po vdes nga uria duke u përpëlitur në shkretëtirë, do të shpëtoni një jetë. Pra, ju e shpëtoni atë nga etja që i jep nxehtësia e zjarrit të kësaj bote.

Kështu, edhe detyra e një besimtari sot, është të shpëtojë njerëzit nga zjarri i botës tjetër! Madje, ai është i detyruar ta shpëtojë atë, sepse besimtari, është një person altruist që e di se shpëtimi i tij qëndron në shërbimin e shpëtimit të të tjerëve.



Zemra, e cila është bërë vend i mëshirës duke u brumosur me besim, fillon të rrahë me dhembshuri. Ajo nxiton në shërbim dhe sakrificë me sinqeritet. Bukuria e besimit të sinqertë dhe e moralit Islam vërshon prej shpirtrave që kanë arritur këtë pjekuri, duke i gjelbëruar dhe fituar zemrat përreth tyre. Shqetësimi i tyre, nuk është të mbledhin ndjekës, por të shpëtojnë njerëzit nga zjarri. Ai përpiqet të çlirojë zemrat që janë bërë skllave të egove, shejtanit, të keqes dhe gënjeshtrës dhe janë duke u tërhequr zvarrë në xhehenem.



Në një ajet urdhërohet:

"...Nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpë-

tuar jetën e krejt njerëzve...” (Maide, 32.) Nëse shpëtimi i jetës së përkohshme dhe të kësaj bote të një personi është kaq i vlefshëm, kushedi se sa e vlefshme është ruajtja e jetës së tij shpirtërore dhe të përjetshme në sytë e Allahut?



Në lidhje me rëndësinë e predikimit në Islam Profeti ﷺ thotë:

“Nëse Allahu e udhëzon dikë përmes teje, kjo është më e vyer për ty sesa gjithçka mbi të cilën lind Dielli!” (Hakim, Mustedrek, III, 690.)



Islami inkurajon shoqërizimin, jo individualizmin. Dhe, të shoqërizohesh, do të thotë të bashkohemi për hir të Allahut, të ndihmojmë njëri-tjetrin në mirësi dhe devotshmëri, të jemi çelësi i veprave të mira, kyç i të këqijave dhe t’i përgjigjemi ftesës së Allahut si bashkësi. Në një ajet urdhërohet:

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) **ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...”** (Ali-Imran, 110.)



Çdo besimtar është i detyruar t’i kushtojë vëmendje orientimit të vet. Por më e rëndësishme se kjo, është se; nëse ai është kryefamiljar, ka një përgjegjësi të madhe ndaj fëmijëve të tij, nëse është mësues, ndaj nxënësve, nëse është punëdhënës, ndaj punëtorëve, nëse është kryetar shteti, ai ka një përgjegjësinë e madhe për të gjithë shoqërinë. Dhe kjo, është që ai të bëhet shembull i mirë për ta me gjendjen, fjalën dhe moralin e tij.



Në shoqëri, gjithmonë ka pasur nevojë për myslimanë shembullorë që do t’i udhëheqin njerëzit në devotshmëri. Sot, kjo nevojë është në kulmin e saj. Por ne, nuk mund të presim që ata

njerëz shembullorë të zbresin nga qielli. Për këtë, para së gjithash, ne duhet të përpiqemi të jemi vetë një mysliman shembullor. Më pas, edukimin e atyre myslimanëve shembullorë, duhet ta konsiderojmë si detyrën tonë, duke bërë të gjitha llojet e sakrificave për të arritur këtë qëllim.



Sot, kuptimi modern i injorancës, veçanërisht ai që vjen nga Perëndimi, ka pllakosur kudo. Mirëpo, për myslimanin nuk ka dëshpërim dhe pikëllim! Zgjidhja e kësaj, është të përpiqemi të përçojmë mesazhin duke marrë shembullin e Profetit tonë dhe sahabëve të tij dhe të mobilizojmë të gjitha mjetet tona në këtë drejtim.



Të mos i harrojmë përpjekjet e zjarrta të Resulullahut ﷺ, për të shpallur thirrjen e shpëtimit të përjetshëm për njerëzimin, ndërkohë që bota ishte zhytur në errësirën e injorancës. Le të llogarisim shpesh veten; si ummet i tij, sa e vëmë në jetë sunetin e tij dhe sa e meritojmë cilësinë si "dëshmitarë të Allahut në tokë"?



Në kushtet e vështira të asaj kohe, sahabët udhëtuan në të gjitha anët e botës për të shlyer borxhin e mirënjohjes së mirësisë së udhëzimit dhe për të përmbushur detyrimin e përcjelljes së mesazhit. Ata lanë rehatinë e tyre dhe sakrifikuan jetën dhe pasurinë e tyre. Kjo e vërtetë duhet të na bëjë të mendojmë thellë: Sa i përmbushim detyrat dhe përgjegjësitë tona në lidhje me përcjelljen e mesazhit Islam dhe udhëzimin e njerëzve?..



Të heshtësh kur duhet të flasësh, është një sjellje po aq e shëmtuar sa të flasësh pa dije. Kjo, sepse ndonjëherë, të flasësh, mund të jetë e dëmshme; por ndonjëherë, për arsye se mund të fshihet e vërteta, të heshtësh, mund të jetë një gjynah i madh. Prandaj, kur kërkohet të thuhet e vërteta, njeriu nuk duhet të heshtë.

Ebu Ali Ed Dekkak ka thënë:

"Ai që e di të vërtetën dhe nuk e thotë është si një shejtan i memec.."

Ndërsa ata që ia kushtojnë zemrën Allahut, frymëzohen prej forcës së të drejtës. Dhe, me dinjitetin e mbështetjes në Allahun, ata gjenden gjithmonë pranë së drejtës dhe kundër zullumqarit.

Kjo është edhe arsyeja që i nderuari Hasan Basriu nuk heshti përballë zullumqarit Haxhxhaxh, i cili ishte i njohur për mizoritë e tij, duke vazhduar të flasë dhe të përhapë të drejtën dhe drejtësinë me çdo kusht. Po ashtu, edhe Imam Adhami, Ebu Hanifja, e pagoi me tortura dhe burg refuzimin e postit të gjykatësit të Bagdadit, sepse nuk donte të bëhej vegël e qëllimeve të padrejta të kalifit Xhafer Mansur...

Është krejt e natyrshme të hasësh në reagime dhe kundërshtime gjatë detyrës në predikimin e së drejtës dhe të vërtetës. Dhe këto, duhet të përballohen me durim dhe tolerancë. E në fakt, njerëzit që zgjojnë të fjeturit, gjithmonë kundërshtohen dhe akuzohen. Mirëpo, njerëzit e urtë, këto akuza i konsiderojnë si një mjet për të pastruar egon e tyre dhe për t'u ngritur në grada shpirtërore. Ata nuk demoralizohen kurrë nga qortimet dhe kundërshtimet, por përpiqen vazhdimisht të përmbushin urdhrin e Allahut.

Aty ku hesht e vërteta, ngrihet e pavërteta. Heshtja përballë tiranit, do të thotë ta idhujtarizosh atë. Nisur nga kjo, njerëzit si Hamani që ishin pranë Faraonit dhe e inkurajuan atë aq sa të thoshte, "Unë jam zoti juaj i lartë!", nuk janë gjë tjetër veçse shejtanë me fytyrë njeriu. Për shkak se ata u bën përkrahje e tiranisë së Faraonit, edhe ata pësuan të njëjtin shkatërrim të përjetshëm, sepse mbështetja e padrejtësisë për hir të interesave të kësaj bote, bëhet shkak i një poshtërimi dhe dështimi të përjetshëm.



Në një hadith, Profeti ﷺ ka thënë:

"Kur të shihni dy prej vëllezërve tuaj të grinden, ndihmojeni edhe të padrejtin edhe atë që i bëhet padrejtësi!" Ndërsa sahabët pyetën:

"O Resulallah! Mirë atë që i bëhet padrejtësi, por të padrejtin si ta ndihmojmë?" I Dërguari fisnik përgjigjet duke thënë:

"Duke e penguar atë nga padrejtësia e tij..." (Buhari, Ikrah, 7; Muslim, Birr, 62.)



Të këshillosh për mirë dhe të ndalosh nga e keqja: Kjo është një nga cilësitë më të rëndësishme të një besimtari. Urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja, është një rrugë e frytshme e ruajtjes nga dënimi hyjnor. Prandaj, çdo rob besimtar dhe i devotshëm zotëron cilësinë e urdhërimit të së mirës dhe ndalimit të së keqes.

Zejnep binti Xhahsh e pyeti Profetin ﷺ:

- O i Dërguari i Allahut! A do të shkatërrohemi edhe nëse gjenden të mirë mes nesh?

- *"Po, atëherë kur të shtohen mëkatet dhe e keqja!"* - u përgjigj Profeti ﷺ. (Buhari, Enbija, 7.)



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Allahu Teala nuk i ndëshkon të pafajshmit për shkak të mëkateve që bëjnë njerëzit në përgjithësi, përveç nëse e shohin kryerjen e mëkatit dhe nuk e ndalojnë edhe pse kanë mundësi." (Ahmed, V, 192.)

Ky paralajmërim i Profetit ﷺ, është shumë i rëndësishëm:

"Betohem tek Ai, në dorë të të cilit është shpirti im, ju ose do të urdhëroni për mirë dhe ndaloni nga e keqja, ose përndryshe Allahu do t'ju dënojë, do t'i luteni, por lutja nuk do t'ju pranohet." (Tirmidhi, Fiten, 9.)

Inkurajimi i të mirës dhe parandalimi i të keqes është prej detyrave themelore të fesë Islame. Në lidhje me këtë Profeti ﷺ, ka thënë:

"Kush nga ju sheh një të keqe, le ta korrigjojë atë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi për këtë, atëherë le ta bëjë me gjuhën e tij. E, nëse nuk ka mundësi as për këtë, atëherë le ta urrejë me zemrën e tij. Mirëpo, kjo është gjendja më e dobët e besimit." (Muslim, Iman, 78.)

Profeti jep një shembull shumë të bukur në lidhje me përgjegjësinë e inkurajimit ndaj të mirës dhe ndalimit nga e keqja:

«Shembulli i atyre që nuk i kalojnë kufijtë e vendosur nga Allahu dhe mjaftohen të qëndrojnë brenda tyre, në krahasim me ata që i thyejnë kufijtë e vendosur nga Zoti dhe i tejkalojnë ato, ngjason me njerëzit që janë mbledhur dhe hedhin short mes tyre, se kush do të hip në anije. Një pjesë e tyre u vendosën në pjesën e poshtme të anijes, ndërsa pjesa tjetër sipër. Kur ata që gjendeshin poshtë dëshironin të merrnin ujë, kalonin afër atyre që ishin lart (duke i shqetësuar). Prandaj thanë:

- Po sikur të hapim një vrimë këtu poshtë aq sa të marrim ujë për veten tonë dhe të mos i shqetësojmë ata që janë lart!

Nëse ata që janë lart do ti lënë të lirë ata që janë poshtë që të përmbushin këtë dëshirë të tyre, ata do të fundosen që të gjithë. E, nëse i pengojnë, do të shpëtojnë edhe vet, edhe ata që gjenden poshtë.» (Buhari, Shirket 6, Shehadat 30, Tirmidhi, Fiten 12.)

– Besimtari nuk duhet të konsiderojë të mjaftueshme vetëm korrektësinë e orientimit të vet për shpëtimin e tij të përjetshëm.

– Ai duhet ta konsiderojë veten përgjegjës për rrjedhën e ngjarjeve në kohën e vet dhe për njerëzit përreth.

– Ai duhet të përpiqet t'i eliminojë me dorë dhe me gjuhë të këqijat, e sidomos padrejtësitë me të cilat përballet.

– Ai duhet të mos e harrojë kurrë se; përçimi i mesazhit sa më shumë që të mundet, është përgjegjësi që ia dikton besimi i tij.

Profeti ﷺ, në një hadith tregon se si filloi shthurja në popullin hebre.

"Në fillim, (Bijtë e Izraelit) kur shikonin dikë që bënte një të keqe, e paralajmëronin: "Shiko këtu, vëlla! Ki frikë Allahun dhe largohu nga kjo punë, sepse kjo nuk është hallall (e lejuar) për ty!". Të nesërmen, kur e shihnin të kryente të njëjtën gjë, (duke vënë në plan të parë interesat) nuk e qortonin më, me qëllim që të kishin mundësi të hanin, të pinin e të uleshin së bashku. Ja pra, atëherë Allahu i Lartmadhëruar, ua bëri zemrat të ngjashme me njëritjetrin". (Ebu Davud, Melahim, 17/4336.)

Një nga fatkeqësitë më të mëdha të ditëve të sotme, është braktisja e emr-i bi'l-maruf dhe nehj-i ani'l-munker / urdhërimin në punë të mira dhe ndalimin nga të këqijat. E thënë ndryshe, braktisja e përpjekjeve për të përcjellë mesazhin, udhëzimin dhe paralajmërimin, pavarësisht se gjynahet dhe shkujdesja kanë kapluar çdo anë.

Nuk duhet harruar se; në kohën e Daudit عليه السلام, një grup njerëzish, edhe pse e jetonin fenë, u shkatërruan së bashku me të këqijtë, për shkak se nuk i paralajmëruan ata dhe neglizhuan detyrën e tyre të përcjelljes së fesë . (Shih el-A'raf, 163-166.)



Besimtari duhet të shmangë përdorimin e fjalëve që nuk i pëlqejnë vëllait të tij mysliman, qoftë në prani, e qoftë në mungesë të tij. Mirëpo, në çështjen e emr-i bi'l-marufit dhe nehj-i ani'l-munker / urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat, heshtja nuk është e lejuar. Domethënë, kur është e nevojshme, duhet të jepet këshilla me një gjuhë të përshtatshme për të paralajmëruar vëllanë e fesë në privat dhe vetëm për vetëm me të. Në një rast të tillë, nuk ka rëndësi nëse i pëlqen apo jo, sepse, megjithëse këto paralajmërime duken të rënda në fytyrë, ato janë në fakt një favor i madh për të.



Imam Shafiu thotë:

"Nëse e këshillon vëllanë tënd fshehurazi, sinqerisht dhe me gjuhë të ëmbël, do të kesh këshilluar vërtet. Nëse flisni pa kujdes në publik, do ta ofendoni ose e turpëroni atë."



I nderuari Sufjan Theuri ka thënë:

"Kur dikush bën një gabim dhe ai që pretendon se është vëllai i

tij nuk e qorton me butësi, dijeni se dashuria që ka për të nuk është për hir të Allahut. Nëse do të ishte për hir të Allahut, ai do ta qortonte atë që i ngre krye Atij, në një mënyrë që ta kuptonte."



Duhet të jemi të vetëdijshëm se; shumë njerëz, të cilët i kemi neglizhuar në këtë dynja dhe nuk i kemi këshilluar në të mirë, ditën e Mahsherit mund të na kapin për jake duke na thënë:

"Ti u nderove me Islam në sajë të përpjekjeve të sinqerta të atyre që ishin para teje. Në sajë të tyre e mësove Islamin dhe besimin. Po mua, pse nuk ma tregove? Përse nuk më ndihmove të shpëtoja edhe unë nga zjarri?!"



Të qëndrosh mënjanë duke thënë se: *"Nuk mjaftojnë gjendja ime, veprat e mia, dituria dhe urtësia ime!.."*, nuk e çliron besimtarin nga përgjegjësia e përcjelljes së fesë. Ashtu si absurditeti i shtyrjes së obligimit të haxhit në vitet e pleqërisë, që mund të vijë apo jo, duke thënë: *"Pas haxhit, nuk bëhen më gjynahe!.."*. Mirëpo, në të vërtetë, shmangia nga gjynahet është përgjegjësi e çdo besimtari, qoftë ai haxhi apo jo. Po kështu, është detyrë parësore e çdo besimtari që të përpiqet për të fituar një personalitet Islam të denjë për shërbimin e predikimit.



Është thelbësore që; ata të cilët janë në pozitën e përcjelljes së Islamit te njerëzit, para së gjithash, duhet të jenë të sinqertë dhe të besueshëm, duhet të miratohet dhe aprovohet personaliteti dhe karakteri i tyre, pra të marrin nga shoqëria njëfarë diplome të gjendjes së mirë.

Falë kësaj, as vetë armiqtë e Profetit tonë ﷺ, nuk mund ta mohonin personalitetin e tij të lartë, që bartte virtytet «el-Emin/i Besueshëm» dhe «es-Sadik/Besnik» . Një person që nuk i ka këto cilësi, nuk mund të jetë zëdhënës i së vërtetës.

Sahabët, të cilët u edukuan në edukimin shpirtëror të të Dërguarit të Allahut ﷺ, u bënë sahab me vepra, jo me fjalë. Gjendja dhe sjellja e tyre i vërtetonte gjithmonë fjalët e tyre. Duke zbatuar rregullat dhe moralin e Islamit në jetën e tyre, ata e përcillnin mesazhin së bashku me fjalët dhe veprat e tyre. Pra, ata e jetuan atë që predikuan dhe predikuan atë që jetuan. Ata na kanë treguar me jetën e tyre se si bëhet shërbim i vërtetë i «emr-i bi'l-maruf dhe nehj-i ani'l-munker» ...

Ne nuk mund të presim që fjalët tona të kenë efekte pozitive në zemra e njerëzve, përveç nëse ato janë në harmoni me veprimet dhe sjelljet tona. Duhet të dimë se; vetëm shprehjet e sinqerta nga zemra e gjejnë rrugën drejt zemrave. Në të kundërtën, fjalët e thëna në mënyrë të pasinqertë nga gjuha, ndërkohë që zemra është e shkujdesur, vetëm sa hyjnë në njërin vesh të dëgjuesit dhe dalin nga tjetri; pra, nuk mund të depërtojnë në zemrën e tij.

Në lidhje me njerëzit të cilëve pjesa e jashtme nuk u përputhet me pjesën e brendshme, Allahu në Kuran thotë:

"**Allahun e përlëvdon gjithçka, që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti! O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni?"** (Saff, 1-2.)

Ebu Bekri ka thënë:

"Allahu nuk e pranon fjalën e robit pa veprim!"



Rumiu thotë:

«Fjala e urtë që nuk jetohet, është si një rrobë e bukur e marrë borxh...»



Ai që vetë ka rënë në gjumë, nuk mund të zgjojë të tjerët. Prandaj, para së gjithash, është e nevojshme të zgjojmë mendjet dhe zemrat tona me të vërtetat hyjnore dhe të rregullojmë gjendjet dhe sjelljet tona, në mënyrë që predikimi dhe sugjerimet që do t'u bëjmë të tjerëve, të rezultojnë me një përfundim pozitiv.



Ashtu si nuk mund të qerasësh askënd me një gotë të zbrazët, ashtu edhe ata, paralajmërimet dhe këshillat e të cilëve kundërshtojnë njëra-tjetrën, fjalët e të cilëve bien në kundërshtim me ato që jetojnë dhe që janë të privuar nga fjalët e zemrës, nuk mund të prekin zemrat e të tjerëve. Kjo, sepse efikasiteti i fjalës është në përpjesëtim të drejtë me atë që njeriu e jeton në të vërtetë me sinqeritet dhe takua.



Tipare të tilla si mëshira, dhembshuria, altruizmi, bujaria, ndërgjegjja, mirësia dhe delikatesa, janë nga veprat e mira më të çmuara në strukturën shpirtërore të Islamit. Nëse forma dhe pamja e Islamit është një vazo, atëherë këto cilësi dhe virtyte të bukura që meritojnë lavdërim, janë si lulet në atë vazo. Një jetë fetare e privuar nga këto bukuri, është si një vazo bosh. Mesazhi i atyre që nuk i kanë këto bukuri në jetën e tyre, është si të zgjasësh

një pjatë të zbrazët për të qerasur dikë ose t'i prezantosh një zarf bosh si dhuratë.



Është e kotë të presësh diçka në këmbim, pa dhënë asgjë më parë. Ashtu siç nuk mund të pritet prodhim nga një tokë ku nuk është mbjellë asnjë farë, që nuk është ujitur dhe nuk është kujdesur për të, ashtu nuk mund të fitohet një zemër pa dhënë më parë zemrën. Një person që nuk dashuron, nuk mund të dashurohet. Prandaj, ne duhet të hapim zemrat tona ndaj të gjithë njerëzve, madje edhe ndaj të gjitha krijesave për hir të Krijuesit të tyre; të ofrojmë bujarisht dhembshurinë, mëshirën dhe dashurinë tonë dhe t'i fitojmë zemrat duke shfaqur fytyrën e buzëqeshur të Islamit.



Njerëzit më të lumtur janë ata, të cilët arrijnë të mbjellin në zemrat e tyre dashurinë për gjithësinë duke pranuar të hyjnë në botën e Kuranit dhe Sunetit.

Vlera dhe rëndësia themelore e njeriut është të jetojë me zemër të mirë dhe të begatë dhe të predikojë mbi bazën e saj. Të predikosh atëherë kur zemra është plot gjemba në aspektin shpirtëror, është një lodhje e kotë dhe një dëm i madh.



Omeri ﷺ, ka thënë:

"Për të përmirësuar të tjerët, së pari duhet të përmirësojmë vetveten."



Ai që nuk merr njohuritë dhe dijet e nevojshme kur ka mundësi, nuk kujdeset për zhvillimin e tij moral e shpirtëror dhe

nuk është kompetent në punën e tij, nuk mund të kryejë një shërbim serioz në mënyrë të denjë. Për rrjedhojë, i nderuari Musa Efendi ka thënë:

«Nëse mblidhni njëqind gjysma njerëz, nuk e bëjnë kurrë një njeri të plotë.»



Predikimi i fesë, është një detyrë jashtëzakonisht e rëndësishme në jetën e myslimanit. Mirëpo, tentativa për ta kryer këtë detyrë pa meritë, pa kujdes dhe seriozitet mund të shkaktojë humbje të pariparueshme. Është sikur "të nxjerrësh sytë, ndërkohë që dëshiron të bësh vetullën". Dhe ky është një gjynah shumë i rëndë.



Nuk mjafton të shprehësh të vërtetat fetare thjesht me gojë. Veçanërisht, ata që merren me dijet fetare, duhet të jenë shembull duke e përfaqësuar mirë fenë me sjelljen, gjendjen, adhurimin, moralin dhe mënyrën e jetesës. Shembulli më i keq, është njohësi i dijeve, i cili nuk mund ta përfaqësojë fenë duke përcjellë të vërtetën dhe mirësinë te të tjerët me gjendjen dhe jetën e tij, dhe që është i dhënë pas kësaj bote. Në vend të përfitimit, prej tyre vjen vetëm dëm.

Të tillë janë edhe sufistët e papjekur shpirtërisht dhe të privuar nga dija. Një person, që është i privuar nga dituria, do të ketë shumë gabime dhe mangësi si në adhurime, ashtu edhe në sjelljet, marrëdhëniet njerëzore dhe strukturën morale. Në këtë aspekt, sufistët e paditur, nuk mund të jenë shembull për umetin. Madje, ata mund të jenë të dëmshëm, duke i çuar njerëzit në mënyrë të pavetëdijshme në rrugë të gabuara.



Në personalitetin e myslimanit, nuk ka vend për ndonjë sjellje që është e papajtueshme me vlerat morale islame. Një besimtar duhet të jetë një «njeri i mëshirës» nga dora dhe gjuha e të cilit njerëzit janë të sigurt dhe ruajtur. Përndryshe, ai kurrë nuk duhet të harrojë se veprimet dhe sjelljet e tij të gabuara do të dëmtojnë jo vetëm veten, por edhe reputacionin e Islamit në sytë e njerëzimit dhe se kjo do të jetë një barrë e rëndë në ahiret.



Ashtu siç është një virtyt i lartë «të fitosh një zemër», po ashtu, edhe «të thyesh një zemër», është një katastrofë e rëndë e botës tjetër. Mirëpo, të konsiderosh thyerjen e zemrës vetëm si lëndim të një personi apo mërzitje të tij, është një kuptim i mangët. Kjo, sepse zemrat janë vendi i besimit. Çdo gjendje dhe sjellje që e largon zemrën nga besimi, Islami, Kurani, Suneti dhe si rrjedhim nga lumturia e përjetshme, në të vërtetë është shkatërrim i zemrës. Njerëzit që i largojnë zemrat e njerëzve nga Islami me qëndrimet dhe sjelljet e tyre, janë njerëz fatkeq që shkatërrojnë zemrat në kuptimin e vërtetë!..



Çdo besimtar duhet të përpiqet të jetë përfaqësues i mirë i vlerave morale Islame në shoqërinë ku jeton. Ai nuk duhet të harrojë se; veprat e mira që bën, janë një mjet efektiv për të përcjellë në zemra atë prirje drejt Islamit. Nga ana tjetër, ai duhet të ketë parasysh se gabimet e tij mund t'i atribuohen edhe Islamit dhe mund të bëjnë që zemrat të largohen nga feja e vërtetë.



Të jesh shembull i mirë për njerëzit, në mirësi, bamirësi, zell dhe devotshmëri, është një mjet i lumturisë së përjetshme. Përndryshe, të bëhesh shembull në të keqe, gënjeshtra, gjynahe dhe shkujdesje, është një falimentim katastrofik për jetën tjetër.



Njerëzit admirojnë personalitetin dhe karakterin. Kështu, shumë nga ata që u bënë myslimanë në Epokën e Lumturisë, nuk dinin shkrim e këndim. Por edhe ata që dinin, u nderuan me udhëzim jo thjesht se lexonin Kuranin, por për shkak se panë bukurinë e moralit të Kuranit në personin e të Dërguarit të Allahut dhe shokëve të tij dhe e kuptuan se Islami është feja e vërtetë. Prandaj, shfaqja e personalitetit dhe karakterit të Islamit me qëndrimet dhe sjelljet tona, është forma më efektive e transmetimit.

Mendimi njerëzor ka vështirësi në kuptimin e të vërtetave abstrakte. Por kur sheh të njëjtat të vërteta në shembuj të gjallë, e kupton lehtësisht. Prandaj, përcjellja e të vërtetave hyjnore duke i zbatuar ato në jetën tonë jep rezultate shumë më të frytshme sesa thjesht deklarimi i tyre verbalisht.

Mevlana thotë:

"Ai që këshillon me gjendje, është më i mirë se ai që këshillon me fjalë.»

Të mos harrojmë se; në këtë botë kemi ardhur për të dëshmuar, jo për ta zotëruar atë. Ne ndodhemi në këtë bujtinë të quajtur dynja për të vërtetuar se jemi dëshmitarë të Allahut në tokë me adhurimet, devotshmërinë dhe moralin tonë të mirë.

Një ditë, Omeri ﷺ, tha:

"Bëhuni ftues të popullit me heshtjen tuaj!". Për këtë, e pyetën:

"O Kalif! Si të bëhesh ftues duke heshtur/duke mos folur?"

Ai urdhëroi:

"–Me gjendjen dhe moralin tuaj..."

Ja pra, të parët tanë Osmanë, e zbatuan këshillën e Omerit ﷺ, të «*predikimit me moral*» në një gjeografi të gjerë.

Pasi Murati i I. mori Kosovën dhe Sulltan Mehmed Fatihu mori Bosnjën, ata vendosën në këto vende njerëz të zemrës dhe të pastër të Anadollit. Për rrjedhojë, nëntëdhjetë për qind e shqiptarëve dhe të gjithë boshnjakët, të cilët e admiruan jetën e tyre shpirtërore, u nderuan me Islam.

Aspekti i jashtëm i fesë kuptohet dhe mësohet me anë të mendjes, aspekti i brendshëm shpirtëror, pra, thelbi i saj, kuptohet dhe mësohet me zemër. Rezultatet më të begata në edukimin dhe menaxhimin e njerëzve, arrihen në sajë të mëshirës dhe dashurisë, sepse shumë njerëz që nuk mund të kontrollohen me forcë, mund t'i nënshtrohen dashurisë dhe mëshirës.

Për këtë arsye, sot, ne duhet të pajisemi me cilësi të bukura që janë shfaqje e mëshirës, si dhurimi, ndihma dhe mbështetja e nevojtarëve.

Ashtu siç hekuri ka nevojë të vendoset në zjarr për t'u zbutur dhe marrë formë, e më pas të goditet me çekiç, edhe zemrat nuk mund të kthehen pa u zbutur me zjarrin e dashurisë. Shprehjet artificiale të dala nga një shpirt pa dashuri nuk kanë asnjë efekt mbi zemrat.

Bamirësia dhe dashamirësia janë forma më e bukur e përçimit të Islamit, sepse njeriu mposhtet nga dashamirësia. Qytetet pushtohen me ushtarë, kurse zemrat pushtohen me mirësi dhe dashamirësi.

Nëse njeriu të cilit i drejtohesh me mirësi dhe dashamirësi është armik, armiqësia e tij zvogëlohet. Nëse nuk është as mik, as armik, ai do t'i afrohet miqësisë. Por, nëse është mik, miqësia do të bëhet më e fortë.



Kushdo që shërben në predikim dhe udhëzim, duhet të mendojë si një mjeshtër riparues, sepse tek riparuesi vjen vetëm sendi i prishur. Nëse nuk ka sende të prishura, as riparuesi nuk mund ta kryejë zanatin e tij. Prandaj, riparuesi e konsideron sendin e thyer si një mirësi për veten e tij. Po kështu, edhe besimtarët, që predikojnë dhe udhëzojnë të tjerët në fe, në vend që të zemërohen me njerëzit që nuk kanë mundur të mbrohen nga gabimet dhe gjynahet, duhet t'i konsiderojnë ata si mirësi shpirtërore për veten e tyre dhe të përpiqen t'i ringjallin me dashuri në zemrat e tyre.



Mevlana ka thënë: *Eja, eja, çfarëdo qofsh eja!..*" Qëllimi i kësaj ftese mjaft tolerante, është prezantimi i njeriut me thelbin e vet, pastrimi i tij nga ndyrësitë e gjynahut nën frymëzimin e dhembshurisë dhe mëshirës, duke e bërë atë të shijojë ëmbëlsinë e besimit. Bota e zemrës së besimtarëve të përsosur, është si një qendër rehabilitimi shpirtëror, ku kurohen sëmundjet shpirtërore me metodën e mëshirës.



Suksesi në shërbimet dhe zellin e mistikëve gjatë gjithë historisë për ta mbajtur gjallë jetën fetare, për t'ua përcjellë atë brezave pasues, për orientimin e popullit dhe për kumtimin e Islamit, është para syve.

Dijetari i shquar islam i shekullit të kaluar, Muhammed Hamidullah, thotë kështu:

"Mënyra se si jam rritur dhe përgatitur unë, është racionale. Kërkimet dhe studimet juridike m'i kanë hedhur poshtë të gjitha gjërat e pa përshkruara e të pavërtetuara në mënyrë bindëse. Pa dyshim, unë i kryej detyrat Islame si namazi, agjërimi, etj., jo për shkaqe mistike, por juridike; dhe them me vete:

«Allahu është Zoti im, është Zotëria im. Ai më ka urdhëruar t'i kryej këto. Pra, më duhet t'i kryej. Veç kësaj, të drejtat dhe detyrat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Allahu m'i ka urdhëruar këto me qëllim që të përfitoj prej tyre. Atëherë, unë e kam për detyrë ta falënderoj Atë!»

Qysh nga koha kur fillova të jetoj në shoqërinë perëndimore, në një mjedis të tillë si Parisi, nisa të shoh me habi se ajo që i shtyn të krishterët ta pranojnë Islamin, nuk janë pikëpamjet e dijetarëve të fikhut e të kelamit, por mistikë të tillë si Ibni Arabiu dhe Mevlana. Mbi këtë çështje, edhe unë formova përvojën time personale. Kur më kërkohej shpjegimi i një çështjeje islame, përgjigjja ime e mbështetur në argumente racionale, domethënë, në arsyen, nuk e kënaqte personin që bënte pyetjen, kurse shpjegimi mistik nuk vononte të jepte fryt. Kështu, me kohë, unë e humba forcën ndikuese dhe tani besoj se të paktën në Evropë dhe Afrikë, ajo që do t'i shërbejë Islamit nuk është as arsyeja, as shpata, por zemra, domethënë, tasavvufi!

Gjatë një bisede të Mevlanës, vjen një i dehur. Nxënësit e Mevlanës mundohen të nxjerrin jashtë me zor. Mirëpo, Mevlana i nderuar, duke menduar se i dehuri ishte një njeri që ka ardhur vetëm për të kërkuar të vërtetën, i drejtohet atyre që po mundoheshin ta nxirrnin, duke i qortuar me këto fjalë:

"Ai ka pirë verën, por më duket se jeni dehur ju!"

Metoda e tasavufit, kërkon që urrejtja ndaj gjynahut, të mos reflektohet tek gjynahqari, dhe në vend të zemërimit, ndaj tij duhet treguar dhembshuri. Atyre që janë të privuar nga mirësia e besimit dhe atyre që janë kapluar nga dobësitë e egos së tyre, u duhet afruar me gjuhën e mëshirës dhe jo gjuhën e ftohtë e të helmatisur të gjarprit, duke fituar në radhë të parë zemrat e tyre.



Vëllazëria e Islamit, është më e lartë se vëllazëria e gjakut. Ashtu siç nuk i lejohet njeriut të fshijë një të afërm i cili është zhytur në gjynahe, po ashtu nuk lejohet që për shkak të gabimeve dhe gjynaheve, njeriu ta refuzojë plotësisht një person me të cilin është bërë vëlla në fe. Gjëja më e mirë që duhet bërë, është të përpiqesh ta ngresh atë ka rënë.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar, për të afërmit e Profetit ﷺ, ka thënë:

«E, nëse nuk të dëgjojnë, thuaju: «Unë nuk jam përgjegjës për ato që bëni ju».» (Shuara, 216.) Nëse i kushtohet vëmendje, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar që të thuhet: **"Unë jam larg asaj që bëni ju"** dhe jo *«Unë jam larg jush!»*.

Me fjalë të tjera, duhet që urrejtja ndaj gjynahut të mos na bëjë të urrejmë gjynahqarin. Përkundrazi, është e nevojshme që gjynahqarin ta shohësh si dikë që ka nevojë për kurim dhe dhembshuri, gati si një zog i plagosur.



Thuhet se: *«Ai që kërkon një mik të përsosur mbetet pa shok.»* Prandaj, detyra e myslimanit, nuk është që t'i braktisë vëllezërit dhe motrat e tij të fesë, të cilët nuk mund të rrinë larg gabimeve dhe gjynaheve, duke i përjashtuar ata, por t'i ndihmojë ata të kthehen në një jetë të denjë duke iu qasur me butësi dhe tolerancë.



Asnjë shpërblim nuk mund të pritet pa përpjekje. Ne nuk kemi të drejtë të zemërohemi me askënd pa ia mësuar dhe pa ia përcjellë të vërtetën. Nëse do të zemërohemi, fillimisht duhet të zemërohemi me veten tonë.



Aliu ﷺ, ka thënë:

"Nuk do të pyeten të paditurit: «Pse nuk u bëtë të ditur?», pa u pyetur më parë të diturit: «Pse nuk e shpërndatë diturinë tuaj, ashtu që t'ua mësonit edhe të tjerëve?»"



Dijetari i hadithit dhe fikhut prej brezit të tabiinëve, Mutarrif bin Abdullahu, ka thënë:

"Ai që nuk ndjen përbrenda mëshirë ndaj gjynahqarëve, të paktën le të lutet duke kërkuar falje për ta. Të kërkosh falje prej Allahut për banorët e tokës, është prej moralit të melekëve."



Njeriu është i dalë nga xhenetit, njësoj si Haxheru'l-Esved (guri i zi). Sado të bjerë në gjynahe, vlera në thelbin e tij mbetet po ajo. Për këtë arsye, është e nevojshme që armiqësia ndaj gjynahut të mos reflektohet si urrejtje ndaj gjynahqarit. Megjithatë, as toleranca ndaj gjynahqarit nuk duhet të reflektohet si tolerancë ndaj gjynahut.



Ibrahim bin Et'hemi kishte larë gojën me erë të ndyrë dhe të pistë të një pijaneci. Kur u pyet se pse e bëri këtë, ai tha:

- Nëse do t'ia kisha lënë ashtu, me erë të keqe dhe të pistë gjuhën dhe gojën e tij, të cilat janë krijuar për të falënderuar Allahun e Madhëruar, do të ishte mungesë respekti...

Kur pijaneci erdhi në vete, i thanë:

Zahidi nga Horasani, Ibrahim bin Et'hemi të ka larë gojën...

Zemra e pijanecit, që u turpërua nga kjo ndodhi, u zgjua nga gjumi i shkujdesjes dhe tha:

- Atëherë edhe unë u pendova!...

Arsyeja që Ibrahim bin Et'hemi, u bë shkak i këtij udhëzimi, bëri që Allahu, t'i flasë në ëndërr, duke e përgëzuar me këto fjalë:

- Ti e pastrove gojën e tij për Ne! Prandaj edhe Ne e pastruam zemrën e tij për ty!..



Shpëtimi i një zemre, që është vend-shikimi hyjnor, nga errësira e mosbesimit, shirkut, hipokrizisë, mëkatit dhe shkujdesjes, dhe përpjekja për ta sjellë atë në pastërtinë që do të jetë e denjë për shikimin plot dashuri të Allahut, është shërbimi më i madh që mund t'i bëhet një personi.





EDUKATA

Historia dëshmon se mendjemëdhenjtë si Faraoni, Nemrudi, Atilla, Aleksandri, Hulagu dhe të ngjashmit me ta, të cilët ishin robër të mendjeve të tyre të kufizuara, u bënë armiq të mbarë njerëzimit me mizoritë e tyre. Dielli, i cili dikur lindte mbi pallatet e tyre madhështore, tani lind mbi rrënojat e tyre.

Nga ana tjetër, Mevlana, Shah-i Nakshibendi, Abdulkadir Gejlani dhe njerëz të tjerë të devotshëm të Zotit, të cilët i bënë zemrat e tyre vend mëshire, duke arritur në burimin hyjnor të miqësisë dhe dashurisë, u bënë një mjet paqeje dhe lumturie për njerëzimin. Ata do të mbeten miq të mbarë njerëzimit deri në fund të botës.

Është e pamundur që; një njeri, të jetë edhe besimtar, edhe arrogant, edhe grindavec e i paedukatë, sepse feja jonë e bukur, Islami, është plotësisht e përbërë prej "edukatës dhe mirësjelljes".

Duke u thelluar në urtësinë e krijimit të trëndafilave, zambakëve dhe bimëve shumëngjyrëshe, një besimtar duhet të tregohet delikat dhe i butë si lulet dhe bujar si pemët frutore.

Edukata është si një aromë trëndafili që qetëson shpirtin tonë. Kjo aromë duhet të përhapet në çdo pjesë të zemrës sonë dhe të ndihet në çdo çast të jetës sonë.

Pasuria që sjell ari dhe argjendi ikin një ditë, por pasuria që sjell edukata mbetet përjetësisht...

Rumiu ka thënë:

"Kush nuk ka edukatë, nuk është njeri, sepse dallimi midis njeriut dhe kafshës, është edukata!"

"Hapi sytë dhe shihe fund e krye fjalën e Allahut! I gjithë Kurani, ajet për ajet, është një trajnim edukate."

Edukata më me vlerë, është ajo kur njeriu duke i ditur kufijtë e vet, i ruhet kalimit të cakut. Për këtë arsye është thënë; *"Ruaje gjuhën pranë të diturve, zemrën pranë evliave, dorën prej sofrës dhe syrin kur je mysafir!"*

Ebu Bekr Verrak thotë:

"Edukatë, është të mbrosh gjuhën kur flet, zemrën kur je vetëm, sytë kur del jashtë, dorën kur e zgjat, këmbët kur ecën dhe kohën e të gjitha punëve të tua. Kush nuk i ruan gjymtyrët dhe humb kohën e tij, gjymtyrët e tij do ta çojnë atë në fatkeqësi...»

Muhammed Masumi ka thënë:

"Askush që ka patur mungesë edukate nuk ka arritur afrimitet me Allahun."

Feja jonë nuk e pranon kurrë që një besimtar të jetë i vrazhdë, lëndues dhe arrogant. Islami do besimtarë që nuk janë egoistë, por vetëmohues dhe altruistë, bujarë jo dorështrënguar, me edukatë jo të pasjellshëm.

Poeti i famshëm Junus Emre thotë:

Zemra është froni i Allahut,
Atë sheh Ai!
Kush e lëndon atë,
Është më fatkeqi i dy botëve...

Ne gjithmonë duhet ta vendosim veten në vendin e bashkëbiseduesit tonë:

– Nëse ne do të ishim në vendin e tij, do ta trajtonim atë ashtu siç do të donim të na trajtonin neve.

– Nëse duam të vlerësohemi, edhe ne duhet të vlerësojmë bashkëbiseduesin tonë.

– Mirësia jonë ndaj të tjerëve nuk duhet të jetë më e vogël se mirësia që presim prej tyre.

Të parët tanë, për të ruajtur edhe dinjitetin njerëzor të të sëmurëve mendorë, në lidhje me ta përdornin shprehjen "të nderuarit e dobët", ndërsa për lebrosët e braktisur nga shoqëria kanë ndërtuar streha të cilat i kanë quajtur "teqeja e të dobëtëve".

Kurse në Perëndim, të sëmurët psikik i quanin, "të pushtuar nga shejtani", dhe për këtë, i hidhnin në zjarr. Ky është dallimi midis dy qytetërimeve.

Delikatesa dhe mirësjellja në shoqërinë Osmane kishte arritur shkallën kulminante. Në dritaret e shtëpive ku kishte ndonjë të sëmurë, vendosej një trëndafil i kuq që fëmijët të mos luanin aty afër e të mos shqetësonin të sëmurin me lojërat e tyre. E po ashtu, që shitësit ambulant të mos bërtisnin për të shitur mallrat e tyre pranë këtyre shtëpive.

Ebu Hanife ka thënë:

"Dije se; nëse nuk kalon mirë me njerëzit, ata të bëhen armiq. Madje, nuk do të të pëlqenin edhe nëse do të ishin nëna apo babai yt. Nëse kalon mirë me njerëz që nuk i ke të afërm, ata mund të të bëhen nënë e baba."

Shejh Sadi thotë:

"Kur shihni kokëfortësi, padrejtësi dhe armiqësi, jini të sjellshëm, sepse një shpatë e mprehtë nuk mund të presë mëndafshin e butë. Me butësi, njeriu mund të tërheqë edhe një elefant."

Rumiu ka thënë:

"Nëse nuk dëshiron të vijë ndonjë e keqe nga njerëzit, mos thuaj fjalë të rënda, mos nxit për keq dhe mos mendo negativisht!"

Sa bukur e shpreh poeti:

"Edukata është një kurorë prej dritës hyjnore
Vendose atë kurorë dhe sigurohu nga çdo bela..."

Shejh Sadi thotë:

"Edukata, mirësjellja dhe karakteri i mirë, janë kurorë nga drita e Allahut. Vëre atë mbi kokë dhe shko ku të duash. Kudo do të jeni të respektuar."

"E rëndësishme është të kesh natyrë trëndafili; edhe pse ndodhesh mbi gjemba, duhet të shpërndash mirësi në botë dhe të kurosh zemrat e plagosura."

Fytyra dhe paraqitja e përgjithshme e njeriut, është vitrina e tij. Përveç të gjitha gjuhëve të qenieve të ndryshme, ekziston edhe gjuha e gjendjes, e cila është më e rëndësishmja. Pra, njeriu, edhe nëse nuk flet fare, me qëndrimin e tij shpreh qartë shumëçka. Fytyra e njeriut ka një shenjë që reflektohet prej shpirtit të tij. Të gjitha çehret, për sytë që munden të shohin, janë përkthyesit e botës së brendshme. Prej këtu themi se një buzëqeshje e nurtë në fytyrë, është reflektimi më i bukur i botës së brendshme.

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Kurrë mos e nënçmo asnjë vepër të mirë, qoftë ajo edhe pritja e vëllait me buzëqeshje!" (Muslim, Birr, 144.)

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Myslimani ka buzëqeshjen në fytyrë, ndërsa dëshpërimin në zemër."

Mevlana thotë:

"Edukatën e një njeriu e kupton nga mënyra si qesh, ndërsa nivelin mendjes dhe zgjuarsisë nga arsyeja për të cilën qesh!"

Një mysliman i vërtetë duhet të shfaqë fytyrën dhe zemrën e qeshur të Islamit me personalitetin e tij. Predikimi më i bukur i një myslimani, është ai që bën me gjuhën, sjelljen, moralin, edukatën dhe delikatesën e tij. Pra, myslimanët duhet të lënë gjurmë pozitive tek të tjerët, aq sa ata t'i admirojnë dhe të mendojnë; «Sa njerëz të mirë janë këta!»

Profeti ynë ﷺ, gjithmonë jepte rekomandime të ndryshme sipas nevojave të bashkëbiseduesve të tij. Lidhur me këtë, Ebu Hani رضي الله عنه, tregon:

"E pyeta të Dërguarin e Allahut ﷺ:

- Më trego diçka që do të më futë në Xhenet?" Ai më tha:

"Përpiqu të thuash fjalë të mira dhe t'u japësh shumë të tjerëve!"
(Buhari, Halku Ef'ali'l-Ibad, Rijad: Daru'l-Maarif, f. 68.)

Drejtojuni aq mirë personit që keni përballë, saqë me një fjalë tuajën, zemra e tij të gjejë qetësi. Zëri i besimtarit duhet ta freskojë zemrën si zëri i bilbilit.

Kurani na fton të përdorim fjalë të bukura dhe shprehje të hijshme:

Ai i urdhëron njerëzit të thonë *"kaulen sedida"*, fjalë të drejta (të vërteta) ndaj të gjithë njerëzve. (shih. Ahzab, 71.)

Ai na urdhëron të themi *"kaulen kerima"*, pra fjalë të buta dhe përgëzuese ndaj prindërve dhe të mos u themi madje as "of". (shih. Isra, 23.)

Nëse nuk kemi diçka për t'u dhënë të varfërve dhe të mjerëve, Kurani na urdhëron që të paktën t'u themi *"kaulen mejsura"*, pra fjalë dashamirëse, të cilat u qetësojnë shpirtin dhe i ngushëllojnë. (shih. Isra, 28.)

Në vend të një lëmoshe përçmuese dhe lënduese, Kurani na urdhëron që më mirë të themi *"kaulun ma'rufun"*, pra fjalë të ëmbla. (shih. Bekare, 263.)

Ndërsa për të zbutur zemrat e zullumqarëve, Kurani na urdhëron të themi *"kaulen lejjina"*, pra fjalë të buta. (shih. Ta Ha, 24.)

Përsëri, Kurani na urdhëron që gjatë bisedës të përdorim *"kaulen beliga"*, pra fjalë që ndikojnë në zemër. Që fjala jonë të jetë ndikuese dhe të arrijë në zemër, ajo duhet të dalë nga zemra (shih. Nisa, 63.)

Një besimtar, i cili është edukuar me moralin e Kuranit Kerim, duhet ta ledhatojë shpirtin me bukurinë dhe aromën e këndshme si një lule e sapoçelur. Çdo fjalë e tij duhet të përbëhet nga shprehje të arta, të cilat ushqejnë shpirtin. Në fytyrën e tij nuk duhet të mungojë kurrë buzëqeshja dhe me gjuhën e ëmbël duhet të përhapë mëshirë.

Duhet të bëjmë kujdes që edhe tonin e zërit ta rregullojmë sipas gjendjes së dëgjuesit. Edhe të folurit me zë të lartë dhe në mënyrë që të gërric veshin, është prej mënyrave të të folurit, të cilën e ndalon Kurani Famëlartë. Në një ajet fisnik thuhet:

"Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!" (Lukman, 19.)

Sot, kur gjuhët e huaja mësohen në të gjitha shkollat dhe kurset, nga kopshti deri te universitetet, sa jemi të njohur me gjuhën e bukur që kërkon Kurani nga ne? Sa rëndësi u kushtojmë gjuhëve njerëzore dhe sa rëndësi u kushtojmë edukatës gjuhësore që na mëson Kurani?..

Është shumë e rëndësishme të jetë nën kontroll zemra që është vatra e ndjenjave dhe gjuha që është pasqyra e saj. Duhet të kemi shumë kujdes dhe të përgjegjshëm për atë që themi.

Profeti ﷺ, thotë:

"Po qe se robi thotë aty për aty një fjalë pa e menduar dhe peshuar mirë, për pasojë, bie në vendin më të largët në mes lindjes dhe perëndimit të xhehenemit!" (Buhari, Rikak, 23.)

Shprehja, «E mundi sëmundjen!», është një shprehje tepër e guximshme, madje edhe disi e pahijshme, që nuk i përshtatet edukatës sonë Islame dhe gjuhës së qytetërimit tonë. Kjo, sepse edukata Islame mëson mirësjelljen që gjithmonë mirësia dhe suksesi t'i atribuohet Allahut. Shprehja e saktë për të thënë kur dikush shërohet nga sëmundja është, «Allahu i ka dhënë shërim".

Një shërbyesi, mund t'i drejtohesh në mënyrë të ashpër, duke i thënë:

"Më jep shpejt një gotë ujë!" Por, edhe me mirësjellje, duke i thënë:

"Nëse nuk të shqetëson, a mund të më sjellësh një gotë ujë?"

Në të dyja rastet kërkoni ujë. Por, në njërën prej tyre ka vrazhdësi, shprehet arrogancë që lëndon bashkëbiseduesin. Ndërsa në rastin e dytë, ka delikatesë dhe vlerësim ndaj njeriut.

Për rrjedhojë, ajo gotë uji ndikon tek pirësi sipas humorit të atij që e sjell. Uji, i cili kërkohet në mënyrë të vrazhdë, nuk do të jetë i dobishëm për atë që e pi, pasi ai do të sillet me detyrim dhe padëshirë. Ndërsa uji që kërkohet me mirësi, bëhet shërim, sepse sillet me dashuri.

Nëse virtytet si mirësjellja, hiri, edukata dhe modestia zbukurojnë shpirtin dhe sjelljen e një personi, ajo zemër është bërë kopsht trëndafilash. Por nëse nga goja dalin shprehje vulgare, gënjeshtra, përgojime, thashetheme, shpifje, tallje, fyerje, grindje dhe sharje, kjo do të thotë se zemra është e mbuluar me gjemba dhe kaktuse të neveritshëm.

Fjalët që dalin nga goja janë si një pasqyrë që tregon zemrën e atij që i shqipton. Për këtë, besimtari duhet ta zbukurojë gjithmonë gjuhën e tij me zikrullah dhe të mësohet të thotë fjalë të bukura dhe të mençura. Kjo gjendje është një tregues i paqes dhe ndriçimit shpirtëror në zemër. Po ashtu, besimtari duhet të shmangë me përpikëri ndotjen e gjuhës së tij me sharje, fjalë të pahijshme dhe të turpshme, sepse këto janë fatkeqësitë e gjuhës dhe janë pasqyrë e veseve dhe ndjenjave të shëmtuara në zemër.

Fjalët e liga që shpojnë zemrat dhe zërat e vrazhdë që shpojnë veshët vijnë vetëm nga zemrat e dobësuara nga shkujdesja.

Besimtari është njeri i besueshëm. Me përshkrimin e Profetit, ai është njeri i sigurt në të gjitha aspektet, «nga dora dhe gjuha e të cilit janë të sigurt të gjithë myslimanët». Prandaj, shëmtia që i lëndon njerëzit, si gënjeshtra, shpifja, përgojimi dhe thashethemet nuk i përshtaten gjuhës së myslimanit.

Selman-i Farisi thotë:

"Ata që kanë më shumë gjynahe në Ditën e Gjykimit, janë ata që merren më shumë me fjalët e ndaluara nga Allahu."

Njeriu nuk duhet të harrojë se është përgjegjës për çdo fjalë që thotë. Allahu urdhëron në Kuran:

"Njeriu nuk ka fjalë që e thotë dhe të mos e regjistrojë ndonjë melek që i gjendet pranë. " (Kaf, 18.)

"Padyshim që mbi ju ka vëzhgues, shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni" (Infitar, 10-12.)

Pra çdo vepër dhe fjalë e njeriut është e regjistruar. Ai nuk duhet ta harrojë kurrë këtë të vërtetë.

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Ai që është vetëdijesuar se edhe fjalët janë pjesë e veprave, flet krejt pak. Ai flet vetëm për çështjet që i interesojnë."

Shejh Said thotë:

"Njeriu i mençur, fillon të flasë kur e kupton se nëse nuk flet, do të ketë dëm; dhe e shtrin dorën drejt tryezës, kur kupton se shëndeti i tij do të përkeqësohet nëse nuk ha. Pa dyshim, fjalët e një personi të tillë, do të jenë urtësi, dhe ajo që do të hajë do të jetë shërim".

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Ai që është i plotë me mendtë e kokës, flet shumë pak."

Zoti i dha njeriut dy veshë dhe një gojë. Kuptimi i kësaj është që; pasi të keni dëgjuar shumë dhe të keni kuptuar mirë, duhet të flisni pak dhe shkurt.

Janë fjalët që dalin nga goja ato që e çojnë njeriun drejt lumturisë apo fatkeqësisë. Ashtu siç duhet të bëjmë kujdes nëse kafshata e bukës që fusim në gojë është hallall apo haram, ashtu duhet të bëjmë kujdes edhe nëse fjalët që dalin nga goja jonë, shkaktojnë të mira apo të këqija; pastaj të flasim apo të zgjedhim të heshtim. Në një hadith fisnik urdhërohet: *"Ai që beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit ose të flasë mirë, ose të heshtë!"*. (Buhari, Edeb, 31, 85, Rikak 23.)

Nëse fjala është argjend, heshtja është flori, thotë proverbi. Nëse nuk ke diçka të mirë për të folur duhet të heshtësh. Por, nëse duhet patjetër të flasësh atëherë flit fjalë të dobishme.

"...Të thuash fjalë të dobishme, është më mirë se të heshtësh. Ndërsa të heshtësh është më e mirë se të thuash fjalë të këqija".
(Hakim, III, 343.)

Shejh Sadi ka thënë:

"Gjëja më e mirë për injorantin është heshtja. Por sikur të dinte të heshte nuk do të ishte injorant."

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Të heshtësh deri atëherë sa të të pyesin, është më mirë se të flasësh deri atëherë sa të të thonë: "A po e mbyll gojën tani?"

Jusuf Has Haxhib ka thënë:

"Fjala e kotë është si zjarri, pasi ta nxjerrësh nga goja do digjesh vetë."

Omeri ﷺ, ka thënë:

"Ai që flet shumë, gabon. Atij që gabon shumë, i zvogëlohet ndjenja e turpit. Atij që i zvogëlohet turpi, i humbet kujdesi dhe frika ndaj gjërave të dyshimta që të shpien në gjynah dhe haram. Atij që i humbet kujdesi dhe frika ndaj gjërave të dyshimta, i vdes zemra."

Shejh Sadi ka thënë:

"Dy gjëra tregojnë mendjelehtësi: heshtja kur duhet folur dhe fjala kur duhet heshtur."

Imam Evzai thotë:

"Nëse Allahu dëshiron të dënojë një popull, u hap derën e debateve të kota dhe i largon ata nga puna."

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Mos iu përgjigj një fjale që është thënë me poshtërsi, sepse i zoti i asaj fjale, zotëron edhe shumë fjalë të tjera të ulëta si ajo dhe, sërish me to do të të përgjigjet."

Allahu thotë në Kuran:

"**Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: "Paqe qoftë!".** (Furkan, 63.)

Rumiu ka thënë:

"Përballë injorantëve bëhu i heshtur si një libër."

Shejh Sadi ka thënë:

"Kush nuk dëshiron të dëgjojë këshilla, kërkon të injorohet."

Atë që nuk e bën dot të heshtë me Kuran dhe Hadith, është më mirë të mos i përgjigjesh fare.

Njeriu indiferent, nuk i jep rëndësi asaj që flet me gjuhën e tij, aq sa i jep asaj që bën me duart e tij. Mirëpo, në shumicën e rasteve, asgjë nuk mund të shërojë plagën në zemër të shkaktuar nga gjuha. Për këtë arsye, me justifikimin se; «gjuha nuk ka kockë», shpesh i nënvleftësojmë fjalët e pakthyeshme që godasin si shigjetë. Mirëpo, kjo mund të ngarkojë me përgjegjësi të rëndë për botën tjetër.

Zejd ibn Thabiti ka thënë:

"Kush nuk zotëron gjuhën nuk mund të jetë i sjellshëm."

Në ditët tona, shumë prej vështirësive që hasen në marrëdhëniet ndërnjerëzore, rrjedhin nga përdorimi i gabuar i gjuhës. Gjuha mund të jetë çelësi i mirësisë, por kur nuk përdoret në mënyrën e duhur, mund të shndërrohet edhe në çelësin e së keqes.

Prandaj duhet të mendohemi para se të flasim dhe të llogaritim mirë se ku do të shkojë fjala që do të themi. Të flasësh, është njësoj sikur të marrësh një gur dhe ta hedhësh. Duhet bërë kujdes se ku do të bjerë ai gur. Profeti ﷺ, këtë të vërtetë e ka shprehur kështu:

"...Mos thuaj asgjë, për të cilën do të duhet të kërkosh falje!.."
(Ibën Maxhe, Zuhd 15.)

Duhet të bëjmë kujdes për çdo fjalë që nxjerrim nga goja. Gjuha jonë nuk duhet të jetë gjemb që ngulet në zemër, por gjuhë që përhap mëshirë. Të parët tanë kanë thënë: plaga e shpatës shërohet kurse plaga e gjuhës nuk shërohet. Një xham që thyhet mund të ngjitet por shenja e ngjitjes do vazhdojë të qëndroje përjetë.

Lukman Hekimin e kanë pyetur se çfarë t'i japin për të ngrënë të sëmurëve. Lukmani i ka dhënë këtë përgjigje mbresëlënëse:

"Mos u jepni të hanë fjalë të rënda! Përveç këtyre, çfarëdo që t'u jepni nuk u bën dëm InshaAllah."

Profeti ﷺ, përpiqej të mos e turpëronte individin përballë shoqërisë dhe për këtë arsye ai e bënte fajin të papërcaktuar, duke kritikuar në përgjithësi. Ndonjëherë, për të mos turpëruar personin përballë për fajin që mund të kishte bërë, ai shprehej kështu:

"Çfarë më ka ndodhur mua që po ju shoh kështu?" (Buhari, menakib, 25, Muslim, salat, 119.)

Ebu Bekri رضي الله عنه, ka thënë:

"Mendoje mirë fjalën që thua, kur e thua dhe kujt ia thua!"

– Mos e thuaj gjithçka që të vjen në mendje, pa zgjedhur fjalën më të mirë!

– Fshini fjalët e këqija nga kujtesa juaj dhe pastrojeni fjalorin tuaj prej tyre!

– Përdoreni siç duhet fjalën duke e matur dhe peshuar!

–Thuaj fjalë që i përshtaten kohës, vendit, gjendjes së bashkëbiseduesve dhe situatës! Siç thotë Mevlana: "Mos shit pasqyra në pazarin e të verbërve, dhe mos thur poezi në pazarin e të shurdhërve!"

– Dhe më e rëndësishmja; mos u trego injorant e të thuash fjalë të këqija zemërthyese!..



NJERI I MËSHIRSHËM

Mëshira e Zotit është një det i tillë, që mjafton vetëm një pikë nga ai për t'u mbushur shpirti ynë. Në momentin kur ajo pikë uji bie në shpirt dhe arrin shijen e detit, ai shpirt arrin te deti.

Tashmë, shpirtra të tillë, dëgjojnë rënkimet e heshtura të atyre që nuk e kanë kuptuar qëllimin e krijimit të tyre, e që rënkojnë me gjuhën e vet, duke thënë; "Kini mëshirë për ne!".

Fruti i parë i besimit është mëshira. Treguesi më i madh i mëshirës është t'i japësh nga ajo që ke nevojtarëve dhe të plotësosh nevojat e tyre.



Të tregosh mëshirë/dhembshuri është një bekim i madh nga Allahu. Vetëm për një person të dhembshur, mund të flitet për zemrën, logjikën dhe ndërgjegjen.

Një besimtar i mëshirshëm; është bujar, i përulur, shërbyes dhe i ndërgjegjshëm. Në një zemër pa mëshirë dhe dhembshuri, nuk ka frymëzim shpirtëror.



Është e pamendueshme që; një zemër, e cila thotë «Allah» të privohet nga mëshira, dhembshuria, bujaria dhe falja.



Mëshira është një zjarr që nuk shuhet kurrë në zemrën e një besimtari. Dhembshuria është elementi më i çmuar i njerëzisë sonë në këtë botë, e cila na çon në dashurinë, pëlqimin, afërsinë dhe bashkimin me Zotin.



Besimtari duhet të jetë i butë (i dhembshëm) si flladet e lehta dhe bujar si shiu që bie; çdo çast, ai duhet të shpërndajë paqe në kërkim të kënaqësisë së Allahut.



Mevlana ka thënë:

"Ji si dielli në butësi dhe mëshirë!"

Siç bëhet dielli dritë, nxehtësi dhe ushqim për të gjitha krijesat në sipërfaqen e tokës dhe siç arrin deri në vendet më të shkreta me madhështinë e nxehtësisë dhe gjerësinë e horizonteve të tij; edhe zemra e një besimtari, duhet të jetë përfshirëse, e gjerë dhe të ketë horizonte sublime në butësi dhe mëshirë.



Allahu i Madhëruar, më së shumti na e prezanton Veten si "Rrahman dhe Rrahim". Pra na afrohet me mëshirë. Po ashtu, edhe Profetin tonë të nderuar ﷺ, e ka cilësuar si "Rauf dhe Rrahim"; një Profet i mëshirës:

Për rrjedhojë; edhe robërit e Zotit tonë Rrahman e Rrahim dhe umeti i Profetit, që është dërguar si mëshirë për botët, duhet të jenë "njerëz të mëshirës". Pra, myslimani duhet të jetë një njeri, prej zemrës së të cilit rrjedh gjithmonë mëshirë dhe butësi.



Mëshira e Zotit është një det i tillë, që mjafton vetëm një pikë nga ai për t'u mbushur shpirti ynë. Në momentin kur ajo pikë uji bie në shpirt dhe arrin shijen e detit, ai shpirt arrin te deti.

Tashmë, shpirtra të tillë, dëgjojnë rënkimet e heshtura të atyre që nuk e kanë kuptuar qëllimin e krijimit të tyre, e që rënkojnë me gjuhën e vet, duke thënë; "Kini mëshirë për ne!".



Është e domosdoshme që mëshirën ta lartësomë mbi të gjitha dashuritë e kësaj bote. Le të jemi të mëshirshëm me krijesat e Allahut, në mënyrë që të bëhemi të denjë për mëshirën hyjnore dhe të përfitojmë prej të atributit «Rrahman» të Allahut.



Nëse duam të fitojmë mëshirën e Allahut, duhet që; edhe ne të mëshirojmë krijesat e Tij në tokë. Në një hadith Profeti ﷺ, ka thënë:

"Ata që mëshirojnë, do t'i mëshirojë Allahu i Madhëruar, i Cili është i Mëshirshëm, Rrahman. Mëshironi dhe kini dhembshuri ndaj atyre që janë në tokë, që t' ju mëshirojnë ata që janë në qiell."
(Tirmidhi, Birr, 16/1924.)



Mëshira është një përgëzim për paqen e ndërgjegjes në këtë botë dhe lumturinë e përjetshme në ahiret. Besimtari e di se; *"Ai që nuk tregon mëshirë, nuk do të mëshirohet."* (Buhari, Edeb, 18.) Atij që tregohet egoist dhe dorështrënguar dhe ia kthen shpinën nevojtarit kur ka mundësi, do t'i kthehet shpina kur ai të ketë më shumë nevojë. Koha kur robi do të ketë më shumë nevojë edhe për të mirën më të vogël, është padyshim Dita e Gjykimit. Për të merituar mëshirën dhe faljen hyjnore atë ditë, ne duhet që sot ta konsiderojmë mëshirën dhe dhembshurinë ndaj robërve të Allahut si një pasuri dhe mirësi më vete.



Rumiu ka thënë:

"Aty ku ka ujë të rrjedhshëm ka edhe gjelbërim. Aty ku derdhet loti vjen mëshira dhe rahmeti i Zotit. Derdh lot nga sytë duke nxjerr tinguj si çikriku i ujit që të të gjelbërohet kopshti i zemrës! Nëse kërkon (gjallërimin e zemrës) përlotjen e syrit, atëherë ki dhembshuri për ata (që nga vuajtjet e ndryshme) nuk u thahen sytë nga lotët. Nëse dëshiron të mëshirohesh e të dhembshurohesh duhet të kesh mëshirë e dhembshuri për të dobëtit e të vobektët."



Njeriu i mëshirshëm:

- Mendon për vëllanë e tij të fesë para se të mendojë për veten. Ai ka më tepër përparësi lumturinë e vëllait sesa lumturinë e vet,

- Bëhet bujar, vetëmohues dhe shërbyes,

- Përpiqet të ringjallë zemrat e shkretuara ashtu si shiu,

- Të gjithë besimtarët i konsideron nën përgjegjësinë e vet,

- Ai përpiqet ta bëjë zemrën e tij një shtëpizë dhembshurie dhe mëshire, në të cilën gjejnë paqe të gjitha krijesat.



Treguesi më i rëndësishëm i nivelit shpirtëror të një besimtari, është se njerëzit përfitojnë nga dora, gjuha, gjendja dhe morali i tij. E kjo do të jetë një shkak i madh lumturie, sepse kjo gjendje është dallimi më i rëndësishëm i miqve të Allahut. Allahu i Madhëruar gjithashtu i lajmëron robërit e drejtë duke thënë: **"...Ata nuk do të frikësohen e as nuk do të mërziten."** (Junus, 62.)



Kur njeriu arrin përsosmërinë në besim, zemra e tij zgjerohet dhe përfshin të gjitha krijesat, sepse, kushdo që miqësohet me Zotin e tij, bëhet mik me krijesat e Tij. Ashtu si personalitetet shembullore si Mevlana, Junus Emre, Abdulkadir Gejlani, Nakshibendi dhe Hudaji, të cilët i shikonin krijesat me syrin e dhembshurisë së Krijuesit, vazhdojnë të jetojnë ende në zemrat tona, ashtu edhe sot duhen besimtarë të cilët ecin në gjurmët e tyre dhe do ta çojnë njerëzimin drejt lumturisë së përjetshme.



Në botën e sotme, ku shumë njerëz kanë rënë në një zbrazëti shpirtërore dhe çrregullimet psikologjike dhe psikiatrike janë në rritje, ka nevojë më shumë se kurrë për njerëz të dijes dhe të vërtetës hyjnore, të cilët:

– Ndriçojnë zemrat me dritën e besimit mes errësirës së besëtytnive dhe ideologjive të kota,

– Zgjojnë dashurinë ndaj Zotit në zemra,

– Dhe nxisin njerëzit t'i shikojnë krijesat me syrin e dhembshurisë dhe mëshirës. Kjo, sepse miqtë e Zotit kanë shumë për t'u thënë atyre që kërkojnë lehtësim nga ngushtimi i zemrës. Sot, i gjithë njerëzimi ka nevojë të dëshpëruar për kulturën, arsimin, mençurinë, ndërgjegjen dhe vlerat shpirtërore që e bënë Junus Emrenë atë që ishte.

Konfliktet, grindjet, trazirat dhe rritja e rrezikshme e shkallës së divorceve, të cilat sot vërehen shpesh, vijnë si pasojë e pakësimit në shoqëri të njerëzve vetëmohues, të kënaqur me çka zotërojnë, altruistë dhe të dhembshur.

Për shkak të mungesës së edukimit shpirtëror, nefsi tërbohet dhe i çon njerëzit në një jetë egoiste dhe oportuniste ku mungon dhembshuria dhe mëshira. Kjo situatë është armiku më i madh i ndjenjave të vëllazërisë, miqësisë dhe bashkimit, të cilat janë materiali lidhës më i rëndësishëm i shoqërisë.

Të mos harrojmë se; sa më bujare dhe e mëshirshme të jetë bota jonë e zemrës, aq më të pasur do të jemi; e sa më koprrace dhe e pamëshirshme të jetë, aq më të varfër do të jemi.

Edhe pse në këtë botë është shumë e nevojshme të ndjesh keqardhje për të varfrit, të vetmuarit dhe të shtypurit, ata që kanë më shumë nevojë për dhembshuri, janë zullumqarët, sepse ata janë fukarenj të mëshirës. Kur shikohet nga dritarja e ahiretit, shihet qartë se; ata që kanë vërtet nevojë për mëshirë, janë zullumqarët mizorë të kësaj bote.

Në këtë aspekt, duke menduar për fundin e tyre të trishtë, duhet të ndjejmë më shumë keqardhje për:

– Kapitalistin e egër që i ka dhënë lamtumirë ndjenjave njerëzore,

– Materialistin e privuar shpirtërisht,

– Interesaxhiun që nuk njeh mëshirë dhe lot,

– Shpirtin e mjerë të padronëve zullumqarë të cilët shkelin të drejtat e punëtorëve të tyre dhe atyre që kanë në vete,

- Dhe fytyrat e ftohta e të vrenjtura që tregohen të shurdhër ndaj klithmave të atyre që thonë «Ki mëshirë për ne!».



Kushdo që nuk njeh dhembshuri dhe mëshirë ka humbur çelësin që hap derën e lumturisë së botës tjetër. Për këtë arsye, më tepër është e nevojshme të ndjejmë keqardhje për zemrat e humbura të shtypësve të pamëshirshëm.



Njeri më i mjerë, është ai që shpërdoron mëshirën e tij. Mëshira është dëshmitarja më e madhe e njerëzimit në këtë botë. Nëse zhduket dhembshuria, nga njerëzimi nuk mbetet shumë gjë.



Njerëzit zemërgur, të cilët nuk janë të vetëdijshëm për të vërtetat hyjnore dhe u mungon dhembshuria, e cila është fryti i parë i besimit, e përdorin njerëzimin vetëm si maskë për veten e tyre. Të tillët, po të jenë ide, e vrasin të vërtetën, po të jenë poetë, i kalbin shpirtrat, e po të ishin moralista, do ta shkatërronin moralin.

Mevlana thotë:

"Këta njerëz, edhe nëse marrin në dorë një trëndafil, ai do të bëhej gjemb për të tjerët. Nëse i afrohet një shoku, ai e kafshon atë si gjarpër." Me pak fjalë, ata janë vrasës të zemrave...

Kudo qoftë në rruzullin tokësor; nëse ju bie në sy një drejtësi që qeveris mes njerëzve, një mëshirë që i lidh zemrat e njerëzve me njëri-tjetrin, të pasur që nxitojnë të ndihmojnë të varfrit duke u sjellë me mëshirë, të fuqishëm që mbrojnë të dobëtit, të shëndetshëm që ndihmojnë të sëmurët, të kamur që kujdesen për jetimët dhe ushqejnë vejushat. Dijeni se të gjitha këto virtyte kanë mbetur prej profetëve dhe njerëzve të mirë që kanë ecur gjurmëve të tyre.

Në "qytetërimin e virtyteve", themelet e të cilit u hodhën nga feja e mëshirës, Islami, pas asaj periudhe të errët të shtypjes dhe padrejtësisë, "njeriu" arriti vlerën e vërtetë që meritonte.

Kur myslimanët po ktheheshin fitimtarë nga Bedri në Medinë, ata hipnin me radhë në deve bashkë me politeistët që kishin zënë rob. Kështu, ata treguan mëshirë për ta duke thënë: "Edhe pse nuk janë besimtarë, ata janë të barabartë me ne si qenie njerëzore." Për rrjedhojë, shumë prej atyre robërve u nderuan me udhëzim përballë kësaj bujarie. Ja pra, kjo është vlera që qytetërimi Islam i jep qenieve njerëzore!..

Në pikëpamjen e fesë së mëshirës, Islamit, "njeriu" është një qenie e nderuar, të drejtat e të cilit duhen respektuar. Prandaj, edhe përmendja e të metave dhe gabimeve pas shpinës së një

gjynahqari, konsiderohet si një nga gjynahet e mëdha që quhet "përgojim". Edhe nëse është jobesimtar, ne jemi të urdhëruar të ruhemi nga mallkimi i të shtypurit.



Pavarësisht nga feja apo raca e tyre, Islami është gjithmonë në krah të të shtypurve. Një nga shembujt e panumërt të kësaj, është shpëtimi i hebrenjve, të cilët u ekspozuan ndaj persekutimit dhe masakrës së krishterë në Spanjë, duke u sjellë në Stamboll nga osmanët, pasi Andaluzia doli nga dominimi i myslimanëve. Popullli mysliman i Stambollit gjithashtu, ndanë mundësitë e tyre, u ofruan mirësi e dashamirësi dhe shfaqën madhështinë e moralit Islam, duke thënë:

"Këta njerëz kanë vuajtur persekutim të ashpër; edhe pse janë jomyslimanë, ata janë njerëz si ne." Kështu, ata u bënë shkak i udhëzimit të shumë njerëzve fatlumë, sepse njeriu mposhtet nga mirësia.



Sot, ne kemi miliona vëllezër dhe motra të fesë, të cilët janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre dhe janë duke luftuar për jetën e tyre në kampet e refugjatëve. Ne ndihemi të trishtuar kur shohim apo dëgjojmë për gjendjen e tyre të mjerueshme. Por, sa ensar mund të jemi ne për ata muhaxhirë?

Dhembshuri, nuk do të thotë vetëm të jesh i trishtuar dhe të kesh një dridhje të ndërgjegjes! Mëshirë e vërtetë, do të thotë të ndash bujarisht me të privuarit mundësitë që ke...



Përpjekja e Osmanëve për të përhapur dhe vendosur drejtësinë është vlerësuar edhe nga jo myslimanët. Për shkak të drejtësisë Perandoria Osmane ishte një vend i preferuar për të jetuar nga shumë jomyslimanë.

Të gjithë ata që largoheshin nga dënimet e inkuizicionit në Evropë gjenin strehim në Perandorinë Osmane. Në shtetin Osman sundonte pikëpamja e lartë, sipas së cilës, edhe jomyslimanët, konsideroheshin "vediatullah", amanet i Allahut dorëzuar shtetit!

Madje, në Poloni, thënia; "Pa pirë ujë kuajt e osmanëve në lumin e Vistulës, vendi nuk do ta arrijë dot lirinë dhe pavarësinë", ishte bërë proverbiale! Reformatori gjerman Martin Luter (Martin Luther) ka thënë:

"O Zot! Silli turqit e mëdhenj sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që përmes tyre edhe ne të begatohemi nga drejtësia Jote hyjnore."

Islami, është ngjallje e njeriut. Të gjitha emocionet që burojnë nga natyra sublime e Islamit, janë ndjenjat më elegante dhe njerëzore në kuptimin e vërtetë të fjalës. E megjithatë, disa armiq të Islamit i referohen Islamit me fjalën "terror", që është një nga fatkeqësitë e sotme. Mirëpo, terrori dhe anarkia bazohen në mizori dhe ata nuk kanë nevojë për ndjenja të larta si morali i mirë.

Në kundërshtim me shpifjet, Islami, që nga dita e lindjes i ka kundërshtuar të gjitha llojet e terrorit, anarkisë, shtypjes dhe padrejtësisë dhe gjithmonë ka marrë për bazë respektimin e të drejtave të njerëzve. Jeta 23-vjeçare profetike e Profetit tonë ﷺ, i cili u dërgua si mëshirë për botët, ka kaluar duke luftuar kundër terrorizmit ndaj njerëzve, kafshëve dhe bimëve.

Islami nuk e toleron dhunën, jo vetëm ndaj qenieve njerëzore, por ndaj asnjë krijese. Ai nuk lejon as mizorinë ndaj kafshëve. Madje, në Islam është gjynah edhe shkundja me dhunë e një peme, sepse Islami është fe e dhembshurisë, mëshirës, mirë-

sisë dhe delikatesës. Të qenit armik i dhunës dhe të admirosh mëshirën dhe dhembshurinë është gjithashtu një kërkesë e fisnikërisë shpirtërore.



Një nga të drejtat të cilat duhet të respektojmë ne, është ajo e krijesave, sepse Zoti ynë i krijoi ato për ne. Ato janë të gjitha shfaqje të emrave dhe cilësive të Allahut, si «el-Bari» (krijues pa shembull) dhe «el-Musavvir» (që përshkruan dhe formëson në mënyrën më të bukur). Neve na janë besuar të gjitha llojet e krijesave që zbukurojnë faqet e librit të universit. Macja, qeni, zogu me krahë të thyer në derën tonë... Ne duhet të tregojmë mëshirë për secilën krijesë dhe t'i shikojmë ato me syrin e dhembshur të Krijuesit.



Çdo qytetërim ndërton tipin e vet të njeriut. Qytetërimi Islam ka ndërtuar njeriun e mëshirshëm, mëshira e të cilit përfshin gjithë krijesat. Islami përpiqet të kultivojë tek njeriu mëshirën dhe dhembshurinë.

Dhembshuria dhe mëshira e të Dërguarit të Allahut ﷺ, kishte përmasa universale. Një ditë, ai tha:

"Betohem në Atë që ka në dorë shpirtin tim se, deri sa ju të mos mëshironi njëri-tjetrin nuk do të mund të hyni në xhenet." Sahabët thanë:

"O Resulullah! Të gjithë jemi të mëshirshëm!"

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

"Mëshira (për të cilën po flas), nuk është vetëm ajo që duhet të keni ndaj njëri-tjetrit, siç e kuptoni ju, por mëshira e cila përfshin të gjitha krijesat, po të gjitha krijesat!.." (Hakim, IV, 185/7310.)



Mëshirë, dhembshuri dhe bujari e vërtetë, nuk është vetëm mirësia e një personi ndaj familjes dhe rrethit të ngushtë. Përkundrazi, është dhembshuria dhe mëshira e treguar ndaj të gjitha krijesave për hir të Krijuesit, siç shprehet edhe Profeti ynë ﷺ; «*të përfshish të gjitha krijesat, duke filluar nga më të afërtit*».

I Dërguari i Allahut ﷺ, jo vetëm që tregoi dhembshuri dhe mirësi të pashoqe ndaj njerëzve, por gjithashtu tregoi ndjeshmëri të jashtëzakonshme ndaj kafshëve dhe bimëve. Paralajmërimet e shumta që ai dha për të mos frikësuar qoftë edhe një qen që ushqente me qumësht të vegjlit e vet, për të mos shqetësuar zogjtë në foletë e tyre dhe për të mos thyer qoftë edhe një degë të njomë pa nevojë, ishin manifestime të mënyrës se si Krijuesi i tij i shikon krijesat me syrin e dhembshurisë.

Njëherë, Profeti ﷺ, pa një fole milingonash së cilës i ishte vënë zjarri. Ai u pezmatua nga një gjë të tillë. Foleja e djegur e milingonave ia kishte hidhëruar aq shumë zemrën e tij të ndjeshme, prandaj dhe me hidhërim të madh tha:

"Kush e ka djegur këtë fole? Dënimin me zjarr, i takon ta japë vetëm Zoti i zjarrit." (shih. Ebu Daud, Xhihad 112/2675)

Njëherë tjetër, kur Profeti ﷺ, ishte duke udhëtuar për në Mekë bashkë me sahabët, panë një gazelë që po flinte në rrugë. Profeti ﷺ, që ishte dërguar mëshirë për botët, urdhëroi njërin prej sahabëve të qëndronte pranë gazelës derisa të kalonin të gjithë, me qëllim që kafsha të mos trembej. (Muvatta, Haxh, 79; Nesai, Haxh, 78.)

Ashtu siç Allahu i Plotfuqishëm i vuri të gjitha krijesat në dispozicion të qenieve njerëzore, Ai gjithashtu e bëri sprovë hyjnore edhe respektimin e të drejtave të tyre. Siç ka transmetuar i Dërguari i Allahut, një grua gjynahqare, e cila, kur pa një qen që lëpinte rërën i rraskapitur nga etja në shkretëtirë, nxori ujë nga pusi me këpucën e saj sepse nuk kishte enë tjetër dhe ia shoi etjen asaj kafshe. Për këtë mëshirë që tregoi, Allahu e fali dhe e futi në xhenet.

Nga ana tjetër, një grua, e cila nuk u kujdes për macen e saj, por përkundrazi, i shkaktoi vdekjen duke e lënë të uritur, u hodh në zjarr për shkak të pamëshirshmërisë ndaj asaj krijese. Të mos harrojmë se; edhe kënaqësia, edhe zemërimi i Zotit tonë fshihen në vepra që herë duken të mëdha, herë të mesme, e herë të vogla. Për këtë arsye, është e nevojshme të mos neglizhohet asnjë vepër e mirë dhe asnjë gjynah të mos konsiderohet si i parëndësishëm.

Një nga detyrat tona më të rëndësishme, është të shprehim mëshirë ndaj krijesave të Allahut në tokë. Të tregojmë përkujdesje dhe të bëjmë të pamundurën që kafshët të mos vuajnë.

Kur po shkonin për të çliruar Mekën, Profeti dhe sahabët shfaqën edhe një tablo tjetër të mrekullueshme në lidhje me trajtimin e kafshëve. Kjo sjellje është gjithashtu një shfaqje e kujdesit ndaj krijesave, parë me syrin e Krijuesit. Rrugës duke shkuar nga Arxh drejt Talubas me ushtrinë e tij të mrekullueshme prej dhjetë mijë ushtarësh, Profeti ynë ﷺ, pa një qen që i kishte mbledhur rreth vetes dhe po u jepte gji të vegjëlve të tij. Ai thirri menjëherë ashabin Xhejl bin Suraka dhe e caktoi të ruante qenin dhe të vegjlit e tij. Ai e porositi atë të kujdesej që qeni nënë dhe të vegjlit e saj të mos trembeshin nga ushtria Islame.

Të mos harrojmë se; të gjitha krijesat na janë besuar neve. Ne jemi përgjegjës edhe për macen dhe qenin në derën tonë, sepse ato janë krijesa të Allahut, po ashtu si ne. Ato mund të krijoheshin si ne, e ne mund të krijoheshim si ato...



Një besimtar duhet t'i trajtojë të gjitha krijesat e Allahut me dhembshuri, mëshirë, butësi dhe delikatesë, si shenjë mirënjohjeje që është krijuar si «njeri», krijesa më e nderuar.

Në Epokën e Lumturisë, një shërbyes, ndante me një qen të uritur ushqimi i tij i përditshëm. Me këtë sjellje, ai donte të thoshte se:

"Zoti që krijoi atë kafshë, është i njëjti Zot më krijoi edhe mua. E, meqenëse mua më krijoi si njeri do të thotë se atë ma besoi mua..."



Fudajl bin Ijad thotë:

"Edhe nëse njeriu i bën të gjitha llojet e veprave të mira dhe bamirësive, ai nuk do të shkruhet në mesin e të mirëve, nëse lë pas dore qoftë edhe një pulë që ka nën përgjegjësi."

Një zemër vërtet e dhembshur nuk mund të vrasë as një milingonë, e as të këpusë një lule pa pasur nevojë.



Poeti Ebu'l-Kasim Firdeusi, shprehet kështu në veprën e tij "Shehname":

"Mos lëndo qoftë edhe një milingonë që tërheq një kokërr ushqimi, sepse edhe ajo ka shpirt! Dhe shpirti është i ëmbël e i dashur."

Një prej të dashurve të Allahut, i nderuari Bejazid Bistami, gjatë një udhëtimi, ulet dhe pushon nën një pemë për të ngrënë.

Më pas, ngrihet dhe vazhdon rrugën. Pasi ecën për njëfarë kohe, vë re se në trastën e tij ndodhej një milingonë dhe thotë me vete:

"E paskam ndarë prej vendit të vet këtë krijesë të Allahut!" Për këtë arsye, ai kthehet pas dhe e lë atë milingonë përsëri nën pemën ku pushoi më parë.

Ditën e kijametit, bashkë me birin e njeriut do të ringjallen edhe krijesat e tjera, të cilat do të marrin të drejtat e tyre që u janë shkelur në dynja. Për këtë arsye, fetarisht, është e ndaluar t'i shkaktosh vuajtje një kafshe apo ta lodhësh tepër atë, ose të këpusësh një degë peme të gjelbër pa shkak.

Në Perandorinë Osmane, e cila ishte një shoqëri e mëshirës, dhembshuria shtrihej deri edhe tek zogjtë. Aq, sa ata vendosën fole zogjsh në muret e xhamive dhe themeluan vakëfe që u shërbenin shpendëve shtegtarë që plagoseshin gjatë rrugës.

Të parët tanë Osmanë, luftën me shpatë e ndërthurën me fitimin e zemrave, ndërsa ndërtimin e ndërtesave me ndërtimin e shpirtit. Nga duart e tyre të bekuara, lindi një qytetërim vakëfesh i cili shpërndante mëshirë për njerëzit, kafshët, e madje edhe bimët. Atëherë, ekzistonte një vëllazëri e jashtëzakonshme në shoqëri. Zemrat u bekuan me dashuri. Mes të varfërve dhe të pasurve, fisnikëve dhe fshatarëve nuk u formua kurrë ndonjë hendek. Lagjja ku jetonte jetimi dhe e veja, u bë garancia e tyre.

Në një shoqëri, zemrat e së cilës janë të mbërthyera me një dashuri dhe dhembshuri të tillë, sigurisht që nuk ndodhin drama dhe çmenduri, nuk vërehen depresione dhe nuk dëgjohen vetëvrasje...

Gjatë historisë së njerëzimit, ndërkohë që ata të cilët kanë pasur hall vetëm luftën, kanë djegur dhe shkatërruar, ata të cilët kanë dëshiruar të pushtojnë zemrat, kanë ndërtuar dhe ringjallur vendet. Ata u bënë ngushëllim për zemrat e shtypura dhe të pikëlluara. Krahas institucioneve që ushqenin të uriturit, ndërtuan edhe institucione që ushqenin zemrat në nevojë. Krahas banjave që pastronin papastërtinë e lëkurës, ata ndërtuan edhe vende që pastronin nxirjen e zemrës. Ata lanë pas kupola të shumta dhe kujtime të këndshme nën kupën qiellore...

Në Qytetërimin tonë të virtyteve, në një shoqëri të devotshme ku sulltanët kanë qenë shërbëtorë të miqve të Zotit, ushtarët dervishë të çlirimeve, tregtarët mishërim i ndershmërisë, të pasurit bujarë e modestë, të varfrit janë të vetë-mjaftueshëm e dinjitozë, dijetarët të sinqertë e të virtytshëm, gjyqtarët të drejtë e të dhembshur, burrat të dashur e besnikë dhe gratë plot mirësjellje dhe hir, natyrisht që nuk shfaqeshin asnjëherë çrregullimet psikologjike. Kush dhe për çfarë arsye mund të binte në depresion në një shoqëri ku themelet e dhembshurisë dhe mëshirës ishin thurur si një rrjetë?..

Mëshira në atë civilizim arriti një horizont aq të lartë, saqë punonjësit e vakëfit filluan të kërkonin shërbime të vogla dhe private.

Vakëfi që ndërtoi në Sham Bezmi Alem Valide Sulltani, është shumë interesant. Fusha e shërbimit të vakëfit ishte sistemimi i gjërave që thyenin apo që humbitnin gabimisht shërbëtorët, në mënyrë që atyre të mos u prekej sedra.

Ne ende përfitojmë nga vakëfet, të cilat janë mishërimi i virtyteve dhe mëshirës së të parëve tanë. Po nipërit tanë, prej cila veprave tona do të përfitojnë? Çfarë do të lëmë ne pas; lojërat, zbavitjet, arrogancën, ambicien dhe rrënojat, apo institucione vakëfesh, pra, monumente të dhembshurisë, mëshirës, shërbimit dhe vetëmohimit, siç na kanë lënë të parët tanë?



Të mos harrojmë se; ne jemi vazhdimësia dhe përfaqësuesit e qytetërimit të virtyteve dhe shoqërisë së mëshirës të ndërtuar nga të parët tanë. Detyra jonë, ashtu si paraardhësit tanë, është të jemi «njerëz të mëshirës", prej dorës, gjuhës, sjelljes dhe jetës së të cilëve përfitojnë të gjitha krijesat.





SHËRBIMI

Shërbimi në rrugën e Allahut është pasqyra më e bukur, e cila reflekton nivelin e pjekurisë së ndërgjegjes. E shprehur ndryshe, është kartëvizita e ndërgjegjes së personit.

Të gjithë miqtë e Zotit e kanë konsideruar veten përgjegjës për shoqërinë dhe kanë qenë të shqetësuar për problemet e nevojtarëve dhe të shtypurve. Për shembull, në vitet e para të rrugës së tij shpirtërore, Bahauddin Nakshibendi për shtatë vjet rresht ndihmoi të sëmurët, kuronte kafshët e lënduara, pastronte rrugët ku kalonin njerëzit dhe tregon se përfitimin më të madh shpirtëror e ka marrë nga këto shërbime.

Shërbimi në rrugën e Allahut është një përgjegjësi shoqërore që Zoti i Madhëruar na e ka ngarkuar si detyrë neve, robërve të tij. Rruga më e rëndësishme për të shpëtuar nga mundimet e botës tjetër është zbatimi i frytit të parë të besimit: mëshirës dhe dhembshurisë, si përgjegjësi të ndërgjegjes.

Shërbimi në rrugën e Allahut është pasqyra më e bukur, e cila reflekton nivelin e pjekurisë së ndërgjegjes. E shprehur ndryshe, është kartëvizita e ndërgjegjes së personit.

Shejh Sadi ka thënë:

"Mirësia e shërbimit është të heqësh barrën e të dobëtëve kur ndihesh i fortë dhe i shëndetshëm."

Shërbimi është kërkimi i kënaqësisë së Allahut duke shpëtuar prej egoizmit dhe duke iu drejtuar çdo krijese me një shpirt altruist.

Çdo punë e sinqertë në rrugën e Allahut, e cila bëhet vetëm për të përfituar kënaqësinë e Allahut, duke qenë larg mendimit për përfitim nga kjo botë, është një përshkrim i kërkimit të takimit me Zotin dhe një pasqyrim i kësaj dëshire në sjellje dhe vepra.

Mevlana thotë:

"Ata që shkojnë në haxh le të kërkojnë të zotin e Qabes. Nëse arrijnë ta gjejnë Zotin e Qabes (nëse zemrën e kthejnë në vend-strehim të manifestimeve hyjnore), tanimë Qaben mund ta gjejnë kudo."

E rëndësishme është që të jesh në çdo kohë dhe në çdo vend në kërkim të dashurisë së Allahut.

Rrugët që të çojnë tek Allahu, -sipas shprehjes së famshmejanë aq shumë, sa edhe frymët e krijesave. E rëndësishme, është të zotërosh një pjekuri shpirtërore, në sajë të së cilës do t'i perceptosh këto rrugë që të takojnë me Allahun dhe të përfitosh prej tyre në mënyrën më të bukur.

Allahu thotë në Kuran:

"**O besimtarë! Kini frikë Allahun, kërkoni mënyrën që t'i afroheni Atij dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar!"**
(Maide, 35.)

Musa efendiu ka thënë:

"Shumë njerëz ndihen të qetë duke pandehur se, me faljen e namazeve dhe mbajtjen e agjërimeve, i kanë kryer të gjitha detyrat fetare. Mirëpo këto adhurime nuk mjaftojnë. Bashkë me respektimin dhe madhërimin e urdhrave të Allahut, duhet të tregohet mëshirë edhe ndaj krijesave. Kjo mund të arrihet vetëm me sakrificë dhe shërbim të sinqertë.

Çështja që duhet të ketë më tepër kujdes çdo mysliman me mendje të shëndoshë, pasi të ketë plotësuar farzet dhe të jetë ruajtur nga gjynahet, është shërbimi ndaj Islamit, shoqërisë dhe të

gjitha krijesave, duke u bërë i dobishëm për ta, sepse këto që u përmendën, janë plotësuesit e farzeve dhe pjesë të sunetit të Profetit tonë ﷺ.

Kur ishte kalif, Omeri ﷺ, ka thënë:

Nëse do të jem gjallë do të shëtis midis njerëzve për një vit. E di që njerëzi kanë nevoja që nuk mund të m'i paraqesin. Kurse guvernatorët nuk m'i informojnë.

- Do të shkoj në Sham dhe do të qëndroj dy muaj,

- Pastaj do të shkoj Xhezire dhe atje do të qëndroj dy muaj,

- Pastaj do të shkoj në Egjipt ku do të qëndroj përsëri dy muaj,

- Do të shkoj në Kufe dhe do të qëndroj dy muaj po ashtu edhe në Basra. Ai vit do të jetë një vit shumë i mirë! (Taberi, Tarih, Bejrut: Daru't-Turas, 1387, IV, 201-202.)

Jeta e Musa Efendiut, si një nga robërit më të përpiktë në këtë drejtim për të cilin jemi dëshmitarë të urdhrit të Tij, në çdo aspekt paraqet tregues që na drejtojnë për mirësi dhe tek Zoti.

Edhe gjatë kohës, kur ishte i sëmurë, si rezultat i së cilës ndërroi jetë, nuk reshti së menduari: *"Ah sikur të kisha forcë dhe të shëtisja qytet më qytet, fshat më fshat dhe të përpiqesha të lehtësoja vështirësitë materiale dhe shpirtërore të vëllezërve të mi!"*

Ai i kishte vënë detyrë vetes që të jetonte me vetëdijen e robërisë, si nga ana fizike e financiare ashtu edhe nga ana shpirtërore. Ai përqafonte çdo zemër të plagosur; të gjitha krijesat që mund t'i arrinte me dorë, e ndonjëherë me shpirt, sipas forcës që kishte. Kur u hapën dyert për herë të parë në Azinë e Mesme, ai

vrapoi atje me një emocion, forcë dhe gjallëri që nuk pritej nga mosha e thyer. Nga ana tjetër, shkoi në Afrikën Jugore, në Evropë dhe u përpoq të mbarte atje bukurinë shpirtërore dhe sociale.

Shkurt, ai gjithë jetën e kaloi me përpjekjen për t'u bërë njeri i cilësive të mira, me qëllim që të meritonte "med'h-u sena" lavdërimin e Zotit të shprehur në Kuran me fjalët "sa rob i mirë!". Në këtë mënyrë, ai mbeti një zë tingëllues që do vazhdonte më tej në të përhershmen. Mbeti një çiltërsi (vefa) e këndshme, një zemërgjerësi e këndshme, një shpirt i këndshëm, një thirrje e këndshme, një moral i këndshëm, mbi të gjitha një jetë shembullore plot bukuri...

Buzëqeshja, përshëndetja, heqja e një guri nga rruga, orientimi i një të huaji, mësimi, sigurimi i jetesës në rrugë legjitime, bamirësia, vizita e të sëmurit, vizita tek të afërmit, falja e namazit në xhami me xhemat, ndihma e të tjerëve kur kanë nevojë; të gjithë këto dhe të ngjashme, janë ibadete dhe shërbime shumë të vyera për besimtarin. Allahu i ka lehtësuar rrugët e mirësisë, dhe për çdo mirësi ka premtuar shpërblim të madh. Prandaj besimtarët nuk ngopen me vepra të mira deri sa të hyjnë në xhenet.

Jeta e një besimtari duhet të jetë e mbushur me aktivitete të vlefshme që e gjallërojnë ditën e tij dhe që shërbejnë për ta jetuar dhe mbajtur gjallë Islamin.

I Dërguari i Allahut i pyeste shokët e tij fisnikë:

"A keni përkëdhelur sot kokën e ndonjë jetimi?"

"A keni vizituar sot ndonjë të sëmurë?"

"A keni ushqyer sot ndonjë të uritur?"

"A keni përcjellë sot ndonjë xhenaze (një të vdekur)?" (Shih, Muslim, Fedailu's-Sahabe, 12.)

Pëlqimi i Allahut të Madhëruar, herë fshihet në ndonjë vepër të madhe, herë në ndonjë mesatare, e herë në ndonjë të vogël. Ndonjëherë, pëlqimin hyjnor e tërheq edhe një mirësi e vogël që sjell buzëqeshje në fytyrën e një të varfëri. Nuk dihet se lutja e kujt do ta shpëtojë robin bamirës.

Nuk duhet të harrojmë se; shumë njerëz, të cilët nuk vlerësohen dhe madje përçmohen në sytë e njerëzve, mund të jenë të dashur në sytë e Zotit. Prandaj, është e nevojshme që robër të tillë të kërkohen dhe të bëhet përpjekje për të përfituar nga lutjet e tyre të sinqerta.

Pozicioni dhe vlera e njerëzve me zemër të thyer është e lartë në syrin e Allahut. Ata që dëshirojnë të arrijnë kënaqësinë hyjnore, duhet t'i gëzojnë shpirtrat e lënduar. Lidhur me këtë, edhe Musai një ditë bëri një dua të tillë:

"O Zot! Ku të kërkoj Ty?" Allahu Teala iu përgjigj:

"Më kërko tek zemërthyerit!". (Ebu Nuajm, Hilje, II 364.)

Rruga për afrimin tek Allahu kalon nga ringjallja e atyre që kanë zemrat e thyera.

Çlirimi më madhështor, është ai i zemrave. Lum ata që i ngjallin zemrat e thyera në pallatin e zemrës së tyre si shtëpi mëshire...

Emir Kylali e këshillon kështu nxënësin e tij, Bahauddin Nakshibendiun:

"Përpiqu të lumturosh ndonjë zemër, bëhu hyzmeqar i të dobëtëve! Mbroji të dobët dhe zemërthyerit! Ata janë njerëz të atillë, që edhe pse nuk kanë asnjë të ardhur nga populli, prapësepraprë e shtyjnë jetën me qetësi shpirtërore, me modesti dhe shqetësim. Kërkoji dhe gjeji ata!"

Ashtu siç është Qabeja qendra shpirtërore e universit, ashtu edhe në trupin e njeriut, zemra është qendra ku përqendrohet shikimi hyjnor. Rruga më e shkurtër për t'iu afruar Zotit të Plotfuqishëm, është të fitosh zemra, të hysh në një zemër, të ngushëllosh një zemër të pikëlluar, t'u sjellësh buzëqeshje fytyrave të trishtuara dhe, më e rëndësishmja, ta zgjosh zemrat nga pakujdesia dhe t'i ringjallësh ato me dritën e besimit.

Shejh Sadiu ka thënë:

"Të fitosh të mira materiale nuk është ndonjë aftësi dhe talent i madh. Talent dhe aftësi është fitosh një zemër."

"Nuk duhet të harrojmë se; ne mund të fitojmë vetëm atë të cilit i zgjidhet problemi."

Shejh Sadiu ka thënë:

"Bir! Bëj bamirësi! Kafshët e egra gjuhen me gracka kurse zemra e njeriut fitohet me bamirësi."

Mevlana thotë:

"Nëse na doni ne dhe pëlqimin tonë, mos harroni se kjo varet vetëm nga fitimi i një zemre! Jepni gjithçka që keni dhe fitoni një zemër! Fitoje, që ajo zemër të të japë dritë në atë natë të errët në varr!"

Të arrish të fitosh lutjet e të vuajturve, nevojtarëve, të varfërve dhe të vobektëve, do të thotë të kesh një thesar të mrekullueshëm të ahiretit.

Jeta jonë, vazhdon edhe pas vdekjes, në raport me sakrificën dhe shërbimin që kemi bërë në jetë.

Shejh Sadi ka thënë:

"Zemra e mbushur me dashuri, është falëse. Nëse ti je thjesht një formë e thatë, kur të vdesësh, përveç trupit, do të vdesë edhe emri... Nëse je bujar dhe njeri i përkushtuar ndaj shërbimit, pas trupit tënd, jeta jote do të vazhdojë aq sa ke sakrifikuar dhe ke hyrë në zemra."

Ahmet Kasani thotë:

"Bota është vend shërbimi, kurse ahireti është vend afrimi tek Allahu. Afrimi i njeriut tek Allahu është në raport të drejtë me shërbimin e kryer në këtë botë."

Për të qeshur nesër në ahiret, duhet të derdhësh shumë lot dhe djersë sot, sepse të presësh shpërblim pa bërë gjë, do të thotë të shpresosh kot.

Në këtë botë, është e nevojshme të kërkojmë ata që janë në errësirë edhe gjatë ditës, të vrapojmë në drejtimin e atyre që kërkojnë udhëzim dhe të ndihmojmë ata që kanë nevojë, në mënyrë që këto përpjekje të jenë nesër një llambë për errësirën tonë në varr.

"Kushdo që mundohet t'ia plotësojë nevojën një vëllai musliman dhe ia plotëson atë, për të është më e mirë se dhjetë vjet qëndrim në itikaf. Ndërsa, kush hyn një ditë në itikaf për hir të Allahut, Ai krijon tri hendeqe mes tij dhe xhehenemit; gjerësia e çdo hendeku është sa largësia ndërmjet lindjes dhe perëndimit." (Bejhaki, Shuab III, 424-425. shih. Hejthemi VIII, 192.)

Të jesh një besimtar i vetëdijshëm se ndodhesh nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, që e madhëron Allahun sikur e sheh, që dridhet para madhështisë dhe fuqisë së Tij dhe derdh lot nga pesha e detyrës dhe përgjegjësisë së tij...

Të jesh një besimtar që ndjen mbi supe barrën e asaj që ke marrë përsipër si amanet, që ndjen vuajtjet materiale, e sidomos ato shpirtërore të atyre që të janë lënë nën kujdesje dhe që në këtë rrugë, derdh djersë po aq sa lot...

Ja pra, këto janë cilësitë e besimtarëve që nuk do t'i djegë zjarri i Xhehenemit...

Në një ajet fisnik urdhërohet:

"Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit..." (Teube, 111.)

Kjo botë është një treg. Është tregu i blerjes së Xhenetit duke vënë në dispozicion të rrugës së Allahut jetën, pronën dhe të gjitha mundësitë që po Allahu i Madhëruar i ka dhuruar. Allahu i Madhëruar dëshiron që ne të zgjohemi në dynja, para se të vdesim dhe të jemi të vetëdijshëm për këtë treg ku blihet Xheneti...

Pse u drodhën profetët, sahabët dhe të devotshmit para të vërtetave hyjnore? Pse e lanë rehatinë e tyre dhe bënë mund dhe sakrifica të mëdha në rrugën e fesë? Pra, si mund të shpresojmë të jemi me ta në ahiret pa bërë ndonjë sakrificë serioze?

Pa vështirësi nuk ka mëshirë dhe pa përpjekje nuk ka begati. Pra, ndihma shpirtërore është një dhuratë për ata që përpiqen sinqerisht.

Të shpresosh për ndihmë pa bërë përpjekje, është një iluzion, njësoj si të presësh prodhim nga toka pa mbjellë farën.

Që të fitohet mëshira, falja dhe providenca hyjnore, Islami duhet të jetohet me devotshmëri, duhet të rritet zelli fetar në zemrat dhe duhet të bëhen sakrifica të sinqerta në rrugën e Allahut. Të arrish lumturinë dhe sigurinë e përjetshme pa vuajtje, pa kapërcyer vështirësitë me durim, pa bërë përpjekje dhe pa vetëmohim, është një pritje e kotë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, edhe vajzën e tij të dashur, Fatimenë رضي الله عنها, e këshilloi të bënte vepra të mira; përndryshe, as ai nuk do të mund ta shpëtonte nga dënimi i Allahut.

Herë pas here, dëgjojmë që disa njerëz, me mendje dhe zemra të turbullta, të cilët edhe mbajnë distancë nga feja, por edhe nuk guxojnë të shkëputen plotësisht nga ajo, e që thonë fjalë të tilla si; «gjyshi im ka qenë hoxhë; babai im ka qenë haxhi...». Por siç është urdhëruar në një hadith:

«*...Njeriun që e kanë lënë pas punët, nuk ka për ta çuar përpara prejardhja e tij.*" (Muslim, Dhikr 38, Ibn Maxhe, Mukadime 17.)

Prandaj, përderisa askush nuk ngopet me ushqimin që hanë prindërit e tij, atëherë secili është i detyruar të bëjë përpjekje serioze për shpëtimin e tij të përjetshëm.

Allahu ﷻ, në një ajet ka thënë:

"Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.." (Nexhm, 39)

Në rrugën e Allahut, ne duhet të bëjmë çdo përpjekje që kemi mundësi. Ne duhet të harrojmë të gjithë lodhjen e kësaj bote me qetësinë që na jep mundësia për të arritur kënaqësinë e Allahut. Megjithatë, pasi të bëjmë këtë përpjekje, duhet të shpresojmë në mëshirën hyjnore. Përndryshe, do të mashtronim veten me një dëshirë boshe.

Abdullah Dehlevi thotë:

"*Të mëdhenjtë tanë, u jepnin nxënësve të tyre detyrën e shërbimit, sepse shërbimi të çon në përparimin e zemrës dhe në shpërblime.*"

Në edukimin shpirtëror, rëndësia e shërbimit është shumë e madhe për të eliminuar dëshirat e egos dhe për të zhvilluar aftësitë shpirtërore. E në fakt, që të arrish ndihmën hyjnore, duhet begatia e shërbimeve të sinqerta.

Kështu, gjykatësi i Bursës, Mahmudi, u bë Aziz Mahmud Hudaji pas shërbimeve të tij me përulësi dhe durim. Ai shërbente si pastrues në teqen e dervishëve me urdhër të mësuesit të tij, Uftades, dhe shiste mëlçi në pazare i veshur me xhyben e gjykatësit.

Shërbimi, ndërkohë që nga një anë është shkak për t'u bërë i dobishëm ndaj të tjerëve, nga ana tjetër, i ngre dhe i lartëson ata që shërbejnë me sinqeritet dhe me aq sa kanë mundësi. Mbase në këtë mënyrë, dobia që kanë ata, është më e madhe se sa e atyre ndaj të cilëve shërbejnë.

Rumiu ka thënë:

"Nëse shikoni me syrin e zemrës, të cilin e përfitoni nga adhurimet, dhurimet, mirësitë dhe shërbimet që bëni, do të shihni edhe ngjyra të tjera përveç atyre që shihni zakonisht. Në vend të gurëve të rëndomtë, do të shihni perla e xhevahire. E çfarë është perla në fund të fundit? Ti vetë bëhesh det, bëhesh diell, që lundron e shëtit në qiell."

Shërbimi është një shkallë e lartë dhe e veçantë e cila i ngre shpirtrat në majat e larta hyjnore. Besimtari i cili posedon shpirtin dhe vetëdijen e shërbimit, di të gjejë edhe mjetet, edhe mundësitë për të shërbyer.

Dielli nuk pret përgjërimet e atyre që duan të përfitojnë prej ngrohtësisë dhe dritës së tij. Kështu, edhe një besimtar i mençur e bën vet atë që pritet prej tij, pa pritur t'ia thonë.

Është thelbësore të shërbejmë për hir të Zotit tonë me çdo mundësi të dhënë prej tij. Besimtari nuk duhet të kërkojë justifikime; përkundrazi, duhet të kërkojë një mundësi për të shërbyer dhe t'i konsiderojë të gjitha llojet e shërbimeve si begati. Në çdo rast, ai duhet të jetë gjithmonë në kërkim të shërbimit me ndjenjën e përgjegjësisë dhe me mendimin: *"Çfarë mundësish më dha Zoti dhe si mund të shërbej në rrugën e Tij me këto mundësi?"*.

Sahabët e nderuar, duke kapërcyer shkretëtirat në kushtet e vështira dhe njëmijenjë pamundësitë e katërmbëdhjetë shekujve më parë dhe duke ndjerë në qafat e tyre frymën e xhelatëve që ishin gati t'u prisnin kokën, shkuan për të përcjellë mesazhin Islam para mbretërve dhe arritën të bëjnë çlirimin e madh, që shtrihet nga Oqeani Atlantik deri në Kinë. Le të mendojmë:

Nëse sahabët do të kishin mjetet e sotme të transportit dhe komunikimit, nëse do të kishin forcën materiale të ditëve tona, kushedi sa sukses do të kishin në predikimin dhe përhapjen e fesë me entuziazmin që zotëronin.

Është shumë interesante që, në Ligjëratën e lamtumirës, të pranishëm ishin 120.000 sahabe. Vetëm 20.000 prej tyre prehen në varrezat e Mekës së begatë dhe të Medinës së përndritur. Të tjerët, janë të përhapur në mbarë rruzullin tokësor me qëllim që të ftonin njerëzit në Islam. Vendi më i largët që kanë mbërritur, ka qenë edhe varri i tyre.

Allahu i Madhëruar na i paraqet sahabët si një gjeneratë shembullore që të mund të krahasojmë situatën tonë me gjendjen e tyre. Le të mos biem në vetëkënaqësi duke i krahasuar përpjekjet tona fetare me gjendjen e dobët të shoqërisë. Le ta krahasojmë situatën tonë me sakrificat e sahabëve dhe të përpiqemi të rrisim besimin tonë.

Një nga sahabët fisnikë, Enes ibn Malik ﷺ ka thënë:

"Ju kryeni disa veprime, të cilave nuk u kushtoni rëndësi as sa një qime. Por në kohën e Resulullahut, ﷺ, ato veprime ne i konsideronim si gabime të mëdha e shkatërruese." (Buhari, Rikak, 32.)

Ata, në saje të dashurisë dhe frikës që kishin në zemrat e tyre ndaj Allahut, edhe gjynahet e vogla i konsideronin humbje të mëdha; madje, i konsideronin si shkak shkatërrimi. Ata nuk shikonin vogëlsinë e gabimit, por madhështinë e Allahut ndaj të cilit bëhej gabimi.

Ne jemi Umeti i Profetit që erdhi 1400 vjet më vonë. Sot, nuk kemi më mundësi të jemi "sahabë". Megjithatë, mundësia për të qenë një nga «njerëzit e mirë që ndjekin muhaxhirët dhe ensarët» të përmendur në ajet, do të zgjasë deri në fund të ditës për të gjithë Umetin e Muhamedit ﷺ. Nëse ne mund të migrojmë nga e pavërteta në të vërtetën, nga e keqja në të mirën dhe nga egoizmi në sakrificë si të parët tanë muhaxhirë; nëse mund të mobilizojmë të gjithë forcën tonë për t'i shërbyer fesë së Allahut si të parët tanë ensar, dhe të ndajmë bujarisht mundësitë tona me të shtypurit dhe vëllezërit tanë nevojtarë, atëherë do të jemi në hapat e sahabëve dhe do të jemi prej besimtarëve që pasojnë mirësinë, InshaAllah.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

"Ummeti im i ngjan shiut, që nuk dihet se cila pjesë e tij është më e mirë; fillimi apo fundi i tij" (Tirmidhi, Edeb, 81.)

Prandaj, mundësia që ky shi i begatë të jetë pikë mëshire, është një derë e paqes dhe qetësisë që mbetet e hapur për të gjithë ne deri në Ditën e Gjykimit.

Tek sahabët, të cilët Allahu i Madhëruar na i paraqiti si gjeneratë shembullore:

– Prona dhe jeta ishin shndërruar në mjet për të fituar shpërblimet e Zotit;

– Ishte arritur shija e imanit;

– Ishte zgjeruar mëshira;

- Shërbimi, mundi dhe sakrifica ishin bërë mënyrë jetese;

– Personaliteti dhe karakteri i Islamit shfaqej në çdo kohë e vend;

– Ngjasimi me gjendjen e të Dërguarit të Allahut ishte qëllimi i tyre më i madh;

– Shpërdorimi, koprracia, luksi, grykësia ishte një mënyrë jetese e panjohur për brezin e sahabëve, sepse ata jetonin me vetëdijen se; nesër, vendbanimi i egos së tyre do të ishte varri.

I vetmi shqetësim i sahabëve ishte rreth pyetjeve të mëposhtme:

"Vallë, a është Allahu i kënaqur me mua? A do të më qortojë i Dërguari i Allahut ﷺ në Ditën e Gjykimit? Vallë, a do të jem pranë Tij në Ditën e Gjykimit?

Kështu, edhe ne duhet të llogarisim veten tonë:

A shqetësohemi se po na mbaron pasuria kur japim për hir të Zotit? Apo arrijmë kënaqësinë që të jep dhurimi, sa më shumë që të japim? A lodhemi dhe mërzitemi nga përpjekjet tona në rrugën e Allahut? Apo shërbejmë me entuziazëm dhe pasion deri në pikën e fundit të fuqisë sonë?

Sahabët treguan sakrifica të pashoqe:

• Ata garuan për të rënë dëshmorë në Bedr, sepse ata u zotuan me entuziazëm për besnikërinë e tyre për faktin se do të sakrifikonin jetën e tyre për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

• Ata bënë përpjekje vetëmohuese në Hendek, mes urisë dhe ankthit të jashtëzakonshëm.

• Komandantët që shkuan në Mute, vrapuan në front sikur po shkonin për bajram, duke e ditur se do të binin dëshmorë.

• Ata u përhapën në të gjithë botën me qëllim të komunikimit të Islamit dhe ngritjes lart të Fjalës së Allahut. Ata nxituan me vetëmohim pa thënë asnjëherë; "Si do t'i kaloj shkretëtirat? Sa do të paguhem? Apo kush do të më mbrojë nga xhelatët?". Dhe, me këtë frymë, ata arritën fitore të përjetshme.

Në historinë e Profetit tonë ﷺ, shohim zotimet e sahabëve. Ata i dhanë besën Profetit në Akabe. Në Bedr, dhanë besën e tyre duke thënë: *"O i Dërguari i Allahut! Nëse ju hyni në det, atëherë edhe ne do të hyjmë bashkë me ju!"*.

Kur e panë Profetin tonë të pikëlluar në Uhud, ata u zotuan se do të bien dëshmor. Në Hudejbije, treguan një dorëzim të plotë dhe thanë:

"Ne besojmë çdo gjë që ke në zemrën tënde, o i Dërguar i Allahut!".

Pra, ne duhet të ndjekim shembullin e sahabëve dhe, si ata, ta mbajmë besnikërinë tonë ndaj Profetit. Ne duhet të rrisim besnikërinë tonë ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, përmes adhurimit, bindjes, bujarisë, vetëmohimit dhe përpjekjeve tona.

Beshir bin Hasasijje ﷺ, tregon:

Shkova tek Resulullahu ﷺ, për t'i dhënë besën dhe ai më vuri këto kushte: *Të dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij, të fal namazin, të jap zekatin, të bëj haxhin si mysliman, të agjëroj Ramazanin dhe të luftoj në rrugë të Allahut.*

Unë i thashë:

"O i Dërguari i Allahut! Vallahi, për dy nga këto, nuk kam mundësi. Këto janë lufta dhe bamirësia. Myslimanët thonë se ai që ikën nga lufta, kthehet duke marrë mbi vete zemërimin e Allahut. Dhe unë kam frikë se kur të dalim në sheshin e luftës, do të më kaplojë frika e vdekjes. Për sa i përket bamirësisë, unë nuk kam tjetër përveçse një tufe të vogël delesh dhe dhjetë deveve. Ato janë burimi i të ardhurave dhe kafshët e udhëtimit të familjes sime."

Resulullahu ﷺ, tha:

"Luftë nuk bën, bamirësi nuk bën! Po me çfarë do të hysh në xhenet?!"

Unë menjëherë i thashë:

"O Resulullah, të jap besën!" Dhe i dhashë besën për të gjitha kushtet që ai më vuri. (Ahmed, V, 224; Hakim, II, 89/2421; Bejhaki, Shuab, V, 8; Hejthemi, I, 42.)

Kurani e quan luftën kundër shtypjes dhe padrejtësisë "xhihad". Xhihadi ka një kuptim shumë më të gjerë se «lufta». Një dëshmi e qartë e kësaj, është shpallja e ajeteve që urdhërojnë xhihadin edhe në periudhën e Mekës, kur myslimanët nuk kishin fuqi serioze luftarake dhe nuk lejoheshin të luftonin. Zoti ynë urdhëron:

"Mos i dëgjo mohuesit, por luftoji ata me forcë nëpërmjet këtij (Kurani)**!"** (Furkan, 52.)

Në periudhën e Mekës, besimtarët luftuan me durim dhe qëndresë të madhe kundër terrorit të njerëzve të injorancës vetëm duke demonstruar personalitetin dhe karakterin e Islamit, pra duke përcjellë të vërtetat kuranore, moralin e mirë, mirësinë, drejtësinë, shkurt, njerëzillëkun e vërtetë dhe duke mos lëshuar pe në besimin monoteist.

Qëllimi i xhihadit nuk është vetëm lufta me shpatë. Shpata është një copë hekuri që përdoret në raste domosdoshmërie për të eliminuar shtypjen e tiranëve dhe vendosjen e drejtësisë. Xhihadi nuk ka të bëjë me ujitjen e tokës me gjak për të pushtuar toka. Qëllimi është t'u vijë në ndihmë të shtypurve dhe të çlirojë zemrat që presin udhëzim.

Çlirimi më i madh, është ai i zemrave me bukuritë e Islamit. Kjo është arsyeja kryesore pse çlirimet Islame ishin të qëndrueshme. Çlirimet Islame nuk ishin si pushtimet e Atillas dhe Aleksandrit, të cilat u shuan pas njëfarë kohe, por ishin çlirime të përhershme dhe të mëdha.

Në Historinë Islame, njerëzit e shumë vendeve të çliruara nga tiranët, e pritën ardhjen e myslimanëve me gëzim dhe paqe. Në Siri, Anadoll, Ballkan, Bosnjë dhe shumë vende të tjera, njerëzit e

rajonit i ndihmuan ushtritë Islame për të eliminuar shtypësit dhe tiranët. Kështu, Islami u bë i përhershëm në ato vende.

Xhihadi i kërkuar nga Kurani:

• Para së gjithash, është ringjallje e botës së zemrës së besimtarit me frymëzimin shpirtëror të Kuranit dhe Sunetit,

• Është përpjekje e besimtarit në rrugën e Allahut me jetën, pasurinë dhe të gjitha mjetet e tij për fitoren e së drejtës dhe të mirës,

• Është edukim i myslimanëve që do të përfaqësojnë dhe përcjellin Islamin, duke ndërtuar dhe ringjallur institucione si Daru'l-Erkam dhe Ashab-i Suffe, ku do të studiohet dhe mësohet Kurani dhe Suneti,

• Është përpjekje për t'u bërë shkak udhëzimi, duke shkuar në çdo cep të botës,

• Është përpjekje për të përdorur çdo mjet publikimi, si predikim dhe botimet në rrugën e të jetuarit dhe të mbajtjes gjallë të Islamit,

• Është përpjekje për eliminimin e pengesave, fitneve dhe mizorive që hyjnë mes njerëzve dhe Islamit.

Sot, Islami sulmohet nga të gjitha anët. Për shkak se Islami është feja e vetme e vërtetë që na kujton ahiretin dhe thërret në drejtësi e ndershmëri, mbrojtësit e së pavërtetës, e sulmojnë atë në çdo rast. Përkundër kësaj, është e nevojshme që besimtarët ta shohin veten si përgjegjës për të ardhmen e Islamit dhe të ushtrojnë të gjitha mjetet e tyre për këtë kauzë.

Nëse sot jemi të bekuar me mirësinë e Islamit, kjo ka qenë falë sahabëve, të cilët u përpoqën në rrugën e Allahut me përgjegjësinë e përcjelljes së fesë dhe entuziazmin e të qenit shkak udhëzimi dhe paraardhësve tanë të lavdishëm që i ndoqën ata me bindje.

Nëse ata nuk do t'i kishin bërë këto përpjekje e sakrifica, por do të ishin marrë me vreshtat dhe kopshtet e tyre, duke u dhënë pas kënaqësive të botës, ne do të ishim të privuar nga kjo mirësi.

Prandaj, edhe ne duhet të mendojmë për njerëzit që mund të arrijnë mirësinë dhe udhëzimin përmes përpjekjeve tona. Ne duhet të mendojmë për individët dhe shoqëritë që do të privohen nëse ne shmangemi nga sakrificat. Po ashtu, ne duhet të mendojmë se; kur të merremi në llogari Ditën e Gjykimit, mbi shpatullat tona do të peshojë edhe shpërblimi i atyre që janë udhëzuar dhe edukuar për shkakun tonë, por edhe gjynahu i atyre, të cilët janë privuar nga besimi për shkakun tonë.

Sot, ne duhet t'i marrim seriozisht përpjekjet në rrugën e fesë. Në çfarë niveli janë përpjekjet tona dhe vetëmohimi në rrugën e së vërtetës, në krahasim me sahabët dhe paraardhësit tanë të lavdishëm? Cila është gjendja e jetës sonë në adhurim, familje, punë e biznes, sipas kritereve të «sinqeritetit», «takvasë» dhe «ihsanit» që kërkon Allahu i Madhëruar prej nesh?

Duhet të mos harrojmë që; mirësia Islame ka arritur deri tek ne prej vitesh me njëmijenjë vuajtje dhe mundime që prej 1400 vitesh. E kemi për detyrë që këtë porosi tua pasojmë brezave të ardhshëm me të njëjtin dinjitet. Koha kërkon të jemi të gatshëm për të fituar mirësinë dhe për t'u afruar me Zotin, pavarësisht nga

sakrificat. Kjo në fakt është një e vërtetë logjike pasi nuk mund të krahasohet mundi i një personi që shtyn makinën, kur rrotat e saj kanë ngecur në baltë, me mundin e një personi që shtyn makinën kur ajo është në një pozicion të rregullt. Këtu ka edhe një detaj i rëndësishëm. Për të nxjerrë nga balta një makinë duhet të përpiqet çdokush që ka mundësi. Përndryshe, faji i një njeriu që ka mundësi, por që në atë moment delikat bëhen sehir i ulur në një qoshe dhe nuk bën detyrën e tij, vështirësohet edhe më tepër. Në një kohë kur besimet dobësohen, kur rinia përfshihet në shumë rryma të ndryshme, kur njerëzimi pikësëpari i është dorëzuar forcës dhe jeton me autoritetin vetjak, duhet të lëvizim sipas sjelljes së kohës duke menduar se; për pak mundim, merret shumë sevap dhe për pak pakujdesi, merret një dënim i madh.

Shërbimet e kryera dhe përpjekjet për të edukuar njerëz të mirë, nuk humbasin as në këtë botë dhe as në botën tjetër. Allahu Teala i shpërblen me çmime të veçanta punët e mira që bëhen në këto kohë të vështira në të cilat ndodhemi, ku morali Islam është dobësuar së tepërmi. Allahu i shkruan ato, si "një borxh i mirë që i është dhënë Atij." Ndërsa shpërblimi i saj do t'u jepet shumë herë më i madh, ashtu siç u jepet "shpërblim vështirësie" nëpunësve të cilët punojnë në kushte të vështira në këtë botë.

Allahu thotë në Kuran:

"...Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo Allahu u premton të gjithëve më të mirën (Xhenetin)..." (el-Hadid, 10.)

Ashtu si sahabët, që jetuan dhe e mbajtën Islamin gjallë në kohë të vështira, edhe ata që bëjnë sakrifica për Islamin përballë

vështirësive në Fundin e Kohës, do të marrin një pjesë të vlerës që arritën sahabët. Ashtu si lindja e Islamit nuk ishte pa vuajtje, ashtu edhe ne, në këtë Fundkohë, kur po shfaqen shenjat e vogla, e madje të mesme të Kiametit, duhet t'i kujtojmë sakrificat e sahabëve dhe të shtojmë përpjekjet tona në rrugën e Allahut, si ata. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për mundimet dhe vuajtjet që mund të hasim në këtë rrugë dhe duhet t'i konsiderojmë ato si mjet për edukimin dhe pastrimin e nefsit tonë.

Sahabët shkuan në Kinë, në Semerkand dhe Kajrevan, duke u përballur me injorancën e asaj kohe. Kështu, ata e përcollën fytyrën e buzëqeshur të Islamit dhe flladet e tij të mëshirës në një pjesë të madhe të botës. Ata nuk thanë kurrë; është larg, është e vështirë, është e rrezikshme apo është e pamundur; ata nuk u dorëzuan, nuk përtuan dhe ia arritën. Edhe sot, bota po jeton në një epokë moderne të injorancës. Me fjalë të tjera, dëshirohet një botë e lirë nga bota e përtejme. Prandaj, ne kemi një përgjegjësi të madhe përballë kësaj injorance. Përgjegjësia jonë më e madhe, është:

– Shkuarja në çdo vend dhe edukimi i njerëzve të Kuranit, të Sunetit dhe rrugës së drejtë.

– Të edukojmë njerëz të drejtë, që do të jenë dëshmitarë të Allahut në tokë, pra përfaqësues të Islamit.

- Të edukojmë një ummet besnik, që do ta bëjë të Dërguarin e Allahut të buzëqeshë në Ditën e Gjykimit.

– Të edukojmë zemra që i binden sinqerisht urdhrit të Profetit tonë ﷺ, që na e ka dhënë në Hutben e Lamtumirës: *"...Mos më turpëroni (duke bërë gjynahe)!"*...

Profeti ynë u godit me gurë në rrugën e Allahut, u detyrua të shpërngulej nga vendlindja e tij dhe përjetoi kohë kur ishte plotësisht i uritur dhe lidhte një gur në barkun e tij të bekuar. Megjithatë, ai vazhdoi të predikonte pa treguar mungesë shprese, lodhje, mërzitje dhe dobësi. Ai nuk tha kurrë; "Më lini të pushoj ca ditë nën atë pemë; apo të bëj një javë pushim; apo mos ejani tek unë për ca kohë!..". Pra; ai nuk mori asnjë ditë pushim, por gjithmonë pushonte dhe gjente qetësinë me ibadet, dhikër dhe çështje të predikimi dhe udhëzimit.

Profeti ﷺ, për t'u mbrojtur nga dembelizmi është lutur në këtë mënyrë:

"Allahu im! Mbështetem tek Ti nga dobësia, përtacia, frika, pleqëria, kur njeriu mblidhet sa një grusht, dhe nga koprracia..."
(Muslim, Dhikr, 50.)

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"...Mos e hidhni veten në rrezik!.." (Bekare, 195.)

Nisur nga kjo, duhet të kuptojmë se; ndërkohë që para nesh kemi mundësinë të fitojmë kënaqësinë e Allahut duke shërbyer dhe duke u përpjekur për hir të Tij, ne nuk duhet të mashtrohemi nga joshja e kësaj bote të përkohshme, iluzionet, stolitë, komfortet dhe kënaqësitë e saj! Përndryshe do të vëmë në rrezik jetën tonë në botën tjetër.

Një nga njerëzit më të afërt të Dërguarit të Allahut ﷺ, Ebu Ejub el-Ensari رضي الله عنه, udhëtoi dy herë deri në Stamboll në moshën 80-vjeçare dhe aty ra dëshmor. Pra, ai nuk tha; "mjaft i kemi shërbyer fesë së Allahut, tani ne po pushojmë, të tjerët të bëjnë

xhihad", por bëri një përpjekje të madhe besimi deri në frymën e fundit, për të përcjellë mesazhin dhe ftesën e të Dërguarit të Allahut ﷺ, në zemrat e njerëzve. Kështu pra mund të shndërrohet Historia e Profetit në një edukim të përjetshëm dhe të pajisemi me moral profetik. Me fjalë të tjera, të jesh nxënës besnik i të Dërguarit të Allahut ﷺ, deri në frymën e tij të fundit, do të thotë të jetosh një jetë të devotshme me vetëdije dhe entuziazëm të vazhdueshëm.

Ebu Hasan Harakani ka thënë:

"Kerameti më i madh është t'i shërbesh krijesave të Allahut pa u lodhur dhe mërzitur."

"Shërbimi nuk është një detyrë kalimtare por një detyrë sublime që duhet të vazhdojë deri në frymën e fundit."

Shërbimi në rrugën e Allahut, si një stil jetese e profetëve dhe e robërve të dashur të Allahut, është një virtyt kaq i lartë, saqë këto personalitete të nderuara nuk hoqën dorë prej tij edhe kur ishin të sëmurë, madje edhe kur gjendeshin në shtratin e vdekjes.

Pa vuajtur në këtë botë, nuk mundur të arrish paqen në botën tjetër. Kjo botë nuk është vend pushimi. Rehatia e besimtarit të përsosur, fillon kur të jetë në varr.

Ebu Hatim رضي الله عنه, thotë:

"O Vëlla! Nëse do të hysh në xhenet, shtyji për më vonë katër gjëra:

1. Gjumin, për në varr,

2. Rehatinë, për në sirat

3. Lavdërimin, për në mizan,

4. Dëshirat e nefsit, për në xhenet."

Sot, në çdo anë ka zjarre shpirtërore. Ka fëmijë, të mjerë dhe breza të tërë të shkatërruar në flakë. Atyre u duhet ardhur në ndihmë.

A mundet një mysliman që; përballë një skene të tillë, të tërhiqet në një cep duke thënë «tani është koha që unë të push-oj»? Apo prej tij pritet që ai të bëjë sakrifica sipas fuqisë së tij, si domosdoshmëri e ndërgjegjes dhe e besimit të tij?

Sahabët e bartnin gjithmonë në këtë botëkuptim dhe, me këtë ndërgjegje vrapuan në mbarë botën pa u ndalur. Po ne?..

Për ne nuk ekziston një kufi që mund të themi; "Mjaft tani! Unë i kam bërë këto shërbime për Allahun»... Ne e dimë sasinë e zekatit; kur një person i pasur jep një të dyzetën e pasurisë, ai e ka shlyer borxhin e zekatit. Por, si do ta shlyejë ai borxhin e mirënjohjes për të gjitha begatitë - veçanërisht atë të besimit - që Allahu i Madhëruar i ka dhuruar? Për këtë nuk ka kufi minimal. Prandaj, nuk ka rrugë tjetër veçse të shërbejmë në rrugën e Allahut me një përpjekje gjithnjë e më të madhe gjatë gjithë jetës.

"Një sahab kaloi pranë një burimi në një mal dhe i pëlqeu shumë. Aty mendoi me vete; sikur të banonte në atë vend të qetë duke u distancuar prej njerëzve. Por në fillimi mendoi të merrte leje prej Profetit ﷺ. Ai shkoi pranë Profetit ﷺ dhe i paraqiti dëshirën. Profeti ﷺ, i tha:

«Të përpiqesh në rrugën e Allahut, është më mirë se të falësh vetëm shtatëdhjetë vjet namaz. A nuk dëshironi t'ju falë Allahu dhe t'u pranojë në Xhenet? Atëherë luftoni në rrugën e Allahut...»"
(Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 17.)

Allahu i Plotfuqishëm nuk na ngarkon me përgjegjësi për shërbimet dhe përpjekjet përtej fuqive tona. Por kjo, do të thotë se ne jemi përgjegjës për aq sa kemi fuqi.

Sprova e çdo robi është në përputhje me mundësitë dhe aftësitë që i janë dhënë. Me rritjen e mundësive dhe aftësive, rriten edhe përgjegjësitë e robit.

Le të llogarisim pak nivelin e robërisë sonë ndaj Zotit dhe zellin tonë në rrugën e fesë:

– A janë lutjet dhe veprat tona të mira në atë cilësi që të mund të na japin pëlqimin e Zotit tonë?

– A është në gjendje ndjeshmëria jonë e devotshmërisë të na mbrojë nga zemërimi hyjnor?

– A do të na kalojnë në Sirat sakrificat që bëjmë në këtë botë?

– A do të na i zbardhin fytyrat në peshore veprat e mira që bëjmë sot?

- A na çon në xhenet jeta që bëjmë?

– Kur të pyetemi për përgjegjësinë që kemi ndaj shumë njerëzve, të cilët sot i kanë djegur të dyja botët e tyre, e kanë bërë hi në zjarrin e blasfemisë dhe gjynaheve, a do kemi mundësi të themi: «-O Zot! Bëra çfarë kisha mundësi..."?

Allahu Teala në Kuranin Fisnik urdhëron:

"O ju që keni besuar! Nëse e ndihmoni (fenë) **e Allahut, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."** (Muhammed, 7.)

Për të ruajtur orientimin tonë deri në frymën e fundit është e domosdoshme të vrapojmë në rrugën e Allahut.

Allahu thotë në Kuran:

"Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme)**, përpiqu fort** (në adhurim) **dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!"** (Inshirah, 7-8.)

Ebu Bekri ka thënë:

"Nëse të shpëton një mirësi, mundohu ta kapësh; kur ta arrish, mundohu ta kalosh që të arrish një më të mirë!"

Muadh bin Xhebeli ﷺ, e ka këshilluar kështu djalin e tij:

"Biri im! Një njeri besimtar, duhet të vdesë ndërmjet dy punëve të mira. Domethënë, kur besimtari bën një punë të mirë, duhet të synojë të bëj një punë tjetër të mirë dhe nuk duhet të fusë ndërmjet tyre asnjë punë të keqe!"

Njeriu, sado i uritur të jetë, nuk mund të hajë më shumë se një sasi të caktuar. Edhe sikur t'i japin ushqimet më të shijshme,

ai nuk mund të hajë më pas ngopjes. Kjo vlen për kënaqësitë e kësaj bote. Kurse për kënaqësitë e botës tjetër nuk është kështu. Një person që ka shijuar kënaqësinë e shërbimit, nuk ngopet kurrë me atë.

Kur besimtari arrin dashurinë hyjnore, vetëmohimi arrin pikën kulmore, çdo vështirësi shndërrohet në lehtësi.

Për njerëzit e zemrës shërbimi në rrugën e Allahut nuk përbën lodhje por një kënaqësi dhe qetësi.

Për të arritur këtë kënaqësi shpirtërore në sakrificë nevojitet pjekuri shpirtërore. Atyre, të cilët janë mbytur në vorbullën e dëshirave të dynjasë, u duket shumë e rëndë sakrifica.

Ndërkohë që po vazhdonin përgatitjet për Luftën e Tebukut, munafikët që kishin sëmundje në zemër, filluan të bënin propaganda negative:

"- Mos shkoni në luftë në këtë të nxehtë!"

Mirëpo, Allahu ﷻ, ata që po largoheshin nga sakrifica, i paralajmëroi:

"**Xhehenemi është më i nxehtë!**" (Shih. Teube, 81.)

Le të meditojmë për Betejën e Tebukut:

Në njërën anë, është lëvdata hyjnore që marrin ata të cilët sakrifikojnë veten në rrugën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ...

Në anën tjetër, është kërcënimi, paralajmërimi dhe ndëshkimi hyjnor për ata që neglizhojnë në këtë çështje!

Askush prej nesh nuk duhet të harrojë se; të gjithë jemi në një fushatë Tebuku. Për këtë arsye, ato që bëjmë në rrugën e Allahut, duhet t'i shohim përherë të pamjaftueshme dhe të vazhdojmë të përpiqemi fort deri në frymën tonë të fundit.

Suksesi vjen prej Allahut. Vetëm Allahu i Plotfuqishëm mund të japë sukses. Të mos harrojmë se; ne nuk jemi përgjegjës për luftën në rrugën e Allahut në të cilën morëm pjesë dhe nuk e fituam, por për luftën në të cilën nuk morëm pjesë edhe pse patëm mundësi.

Detyra e besimtarit është të përpiqet me durim, duke u kapur pas shkaqeve në çdo punë, dhe suksesin t'ia atribuojë vetëm Allahut. Edhe nëse ai nuk e arrin qëllimin e tij në fund të punës, besimtari duhet të jetë mirënjohës për përmbushjen e përgjegjësisë së tij duke bërë më të mirën.

Mos e humbni shpresën në Allahun për asnjë punë të mirë. Mos thoni; nuk bëhet! Edhe në çështjet më të pamenduara dhe më të papritura, çdo gjë mund të ndodh nëse do Allahu! Kur dëshiron Ai, a nuk e bën të gufojë uji si kristal edhe nga një gur i fortë? Nëse dëshiron Ai, edhe zjarrin mund ta kthejë në trëndafilishte. Nëse dëshiron Ai, edhe më e pamundura bëhet e mundur. Shkurt, një mysliman, nuk duhet të jetë kurrë pesimist, por gjithmonë optimist.

Edukuesve që u tërhoqën nga shërbimi dhe përpjekja duke u justifikuar për neglizhencën dhe përtacinë e tyre apo duke rënë në dëshpërim, me arsyetime të tipit "Çfarë të bëj, s'ka talent, është kohë e keqe, nuk vjen njeri!", Zoti i Plotfuqishëm u ka dhënë mësim me urtësi nga libri i universit, duke bërë të mbijë edhe pemën fikut me fruta të bollshme nga një mur guri.

Mevlana thotë:

"Sado e errët të jetë errësira, një shkrepëse po të dish ta ndezësh, errësirë nuk mbetet."

"Vlera e shërbimit është në raport të drejtë me sakrificën që kapërcehet gjatë shërbimit."

Furnizimi i njerëzve që shërbejnë në rrugën e Allahut, duhet të jetë durimi, dhe mbështetja e tyre duhet të jetë vetë Zoti. Çelësi kryesor i suksesit në shërbim, është durimi dhe qëndresa.

Ata që kanë të gjitha mundësitë dhe nxjerrin gjithfarë pretekstesh për të mos shërbyer janë si pemët pa fruta.

Njeriu që nuk shpëton nga egoizmi nuk mund të jetë në gjendje të shërbejë. Kurse ai që qëndron larg shërbimit nuk mund të arrijë asnjë nivel shpirtëror.

Është thënë:

"Tre lloje njerëzish janë larg Zotit:

• Ata që shmangin shërbimin duke menduar për komoditetin e tyre.

• Ata që nuk u afrohen të vuajturve dhe të mjerëve me justifikimin se janë të ndjeshëm e thonë: «Nuk duroj dot!» .

• Ata që bëhen bashkë me shtypësit dhe indiferentët."

Në shërbimin e sinqertë që bëhet në rrugë të Allahut, ka begati të mëdha, sepse Allahu i Madhëruar e ndihmon në vështirësitë e tij personale atë që i shërben fesë dhe mundohet t'u zgjidhë hallet nevojtarëve. Ndërsa ata që merren vetëm me dertet e veta, i lë vetëm për vetëm me ato derte që kanë.

Ata që janë indiferentë ndaj shërbimeve në rrugën e Allahut, një ditë, të gjithë do të përballen me shpenzimin dhe shpërdorimin e pasurisë së tyre në qëllime shumë vulgare. Ata që nuk janë të gatshëm dhe guximtarë për të përballuar vështirësitë për qëllime të mëdha hyjnore, një ditë do të mbyten në një enë të vogël uji.

Një shërbim pa dashuri dhe mëshirë është thyerje zemrash.

Një shërbim i privuar nga mirësjellja, delikatesa dhe edukata, nuk quhet virtyt dhe kthehet mangësi nëse e cenon dinjitetin e nevojtarit.

Abdullah bin Munazil ka thënë:

"Edukata në shërbim është më e vyer se vetë shërbimi."

Një shërbim i cili është larg prej ndjesive shpirtërore, i ngjan një kove me ujë e cila derdhet në shkretëtirë. E shprehur ndryshe, një farë që hidhet në një tokë të thatë, është e dënuar të bjerë pre e minjve të arave. Ndërsa farat e shërbimit që hidhen në zemër, bëhen pemët e së ardhmes.

Begatia e shërbimi është në raport të drejtë me sinqeritetin. Shërbimi që bëhet me sinqeritet nuk humbet kurrë.

Të jesh një shërbyes i vërtetë në rrugë të Allahut, është një nder i lartë, që Allahu i Madhëruar mund t'i japë robit të Tij. Prandaj, duhet t'ia dimë mirë vlerën kësaj mirësie dhe të përpiqemi që çdo punë ta bëjmë me sinqeritet, duke qenë në rrugë të drejtë. Në të kundërtën, nuk duhet të harrojmë se kjo mirësi mund të na merret nga duart.

Musa Efendiu ka thënë:

"Për sa kohë vazhdon të shërbejë në rrugën e Allahut, shërbyesi duhet të përparojë edhe nga ana shpirtërore. Ai duhet t'i përkushtohet shpirtërisht Allahut dhe të përpiqet t'i kryejë detyrat e tij me sinqeritet, edukatë dhe modesti.

Nëse shërbyesi në rrugën e Allahut nuk zhvillohet shpirtërisht, egoja e tij merr përparësi dhe shërbimet që kryen nuk japin as-

një fryt. Si përfundim, nuk arrihet asgjë tjetër përveç lodhjes së kotë. Kjo, sepse qëllimi dhe përpjeka e tij është e dobët dhe për këtë shkak, ai privohet nga ndihma hyjnore."

«Egoja» dhe «vetëbesimi i tepërt» është kanceri i rrugës së shërbimit. Te njeriu i shërbimit, «egoja» dhe «vetëbesimi i tepërt», duhet t'ia lënë vendin dashurisë, pasionit dhe përpjekjes.

Musa efendiu ka thënë: *"Përpjekja jonë është shërbimi, por si pishtar i saj."*

Ai që ndodhet në krye të shërbimit, duhet të shërbejë me më shumë dinamizëm dhe të përpiqet më shumë se ata që ka nën vete, me qëllim që të jetë shembull edhe për të tjerët.

Ata që gjenden në rrugën e shërbimit për hir të Allahut, nuk duhet t'i bëjnë punët vetëm duke urdhëruar të tjerët, por duhet të japin edhe kontributin e vet personal, duke u përkushtuar me gjithë zemër në shërbim. Ata që nuk kapin punë me dorë, por thjesht japin urdhra përqark nga vendi ku rrinë ulur, duke pandehur se shërbejnë për hir të Allahut, janë njerëz që nuk e kanë kuptuar thelbin e çështjes.

Shërbimi nuk kryhet në distancë me telekomandë. Shërbyesi duhet të jetë vazhdimisht në krye të punës.

"Zotëria i një populli, është ai që u shërben atyre!" (Dejlemi, Musned, II, 324.)

Ai që drejton shërbimin duhet të jetë i pari në kontributin ndaj shërbimit.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka qenë në ballë të çdo pune që bëhej për hir të Allahut. Edhe pse ishte kryetar shteti, ai barti qerpiçë së bashku me shokët e tij në ndërtimin e xhamisë në Medinë.

Gjatë ndërtimit të xhamisë, kur një person i cili po mbartte dhé ndeshi me Profetin ﷺ, i thotë:

"O Profet i Allahut! Më lejoni ta mbaj unë qerpiçin që keni në duar!" Kurse Profeti ﷺ, i përgjigjet:

"Ti shko dhe merr një tjetër! Në të vërtetë, ti nuk ia ke nevojën Allahut më shumë se unë!" (Semhudi I, 333.)

Para se të bëhej Kalif, Ebu Bekri رضي الله عنه, ndihmonte vajzat jetime, duke mjelë delet e tyre dhe duke u plotësuar nevojat. Kur u bë Kalifi i myslimanëve, njerëzit menduan se tashmë kushtet e jetës do të ndryshonin dhe ai nuk do të kishte më kohë për t'u marrë me këto shërbime të vogla. Mirëpo, asgjë nuk ndryshoi. Për shkak se ai e konsideronte një mirësi të madhe për veten e tij, Ebu Bekri رضي الله عنه, vazhdoi ta bënte këtë shërbim me të njëjtën modesti.

Musa Efendiu (Allahu e mëshiroftë), thotë:

"Besimtari duhet të përpiqet të kryejë me sinqeritet dhe sipas mundësisë, të gjitha adhurimet dhe punët e mira pa shikuar a janë të mëdha apo të vogla, sepse shumë njerëz që bëjnë shërbime të mëdha, i neglizhojnë disa shërbime të cilat duken të vogla. Në fakt, ne nuk e dimë se ku dhe në çfarë pune është kënaqësia e Allahut."



NDJESHMËRIA PËR PROBLEMET E UMETIT

Ndërkohë që feja jonë e lartë, Islami, u thotë nevojtarëve: "Bëhu i pavarur, mos i kërko askujt tjetër pos Allahut!"; të pasurit i urdhëron: "Kërkojini, gjejini dhe ndihmojini nevojtarët!"

Është e lehtë të arrish nevojtarin që e shpreh nevojën e tij. Mirëpo, ne jemi të detyruar të gjejmë edhe nevojtarin, i cili për shkak të modestisë dhe dinjitetit të tij të lartë, nuk mund ta shprehë gjendjen e tij dhe nuk ua shtrin dorën njerëzve.

Ashtu siç është e pamundur për diellin të mos ngrohë, ashtu është e pamundur edhe për shpirtrat e fuqishëm të cilët e jetojnë jetën në mënyrën më të bukur dhe me vetitë më të mira, të jenë të padobishëm për veten e tyre e për të gjitha krijesat e tjera dhe, të mos përhapin përreth bukuri përreth tyre.



Asnjë besimtar që shpreson të arrijë mëshirën dhe mirësinë e Allahut, nuk mund të jetë pa mëshirë dhe zemërgur. Ai nuk mund të qëndrojë indiferent ndaj thirrjeve me zë apo të heshtura të ndonjë prej krijesave të Zotit, e veçanërisht të «njerëzve», dhe nuk mund t'ia kursejë asnjë të mirë që ka mundësi të bëjë.



Profeti ﷺ, thotë:

"Në dashurinë, dhembshurinë dhe në ruajtjen e njëri-tjetrit, besimtarët janë si një trup i vetëm. Kur një nga organet e trupit sëmuret, atëherë edhe organet e tjera sëmuren dhe digjen flakë nga temperatura." (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66.)



Kujdesi ndaj përgjegjësisë që lind prej vëllazërisë së besimit, është shumë i rëndësishëm. Edhe pse besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç

i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

"Nuk është prej nesh ai që nuk shqetësohet për hallet e vëllait të tij besimtar!" (Hakim, IV, 352; Hejthemi, I, 87.)

Kur një besimtar sheh nevojtarët dhe të vuajturit, duhet të bëjë llogarinë e egos së vet, duke thënë: «Unë mund të isha në vendin e tyre, e ata mund të ishin në vendin tim».

Përballë çdo fatkeqësie, duhet të mendojmë:

"Edhe ne mund ta kishim pësuar atë fatkeqësi."

Me këtë mendim, ne duhet ta falënderojmë Allahun, i Cili na dhuron shëndet dhe mirëqenie dhe si shprehje reale e këtij falënderimi, duhet t'u vijmë në ndihmë të vuajturve.

Profeti ﷺ, ka thënë: *"Nuk mund të jesh besimtar i vërtetë, përderisa nuk dëshiron për vëllain mysliman atë që dëshiron për veten tënde."* (Buhari, Iman, 7.)

Nuk duhet të heqim dorë nga mesatarja në të ngrënë, pirë dhe në veshje. Kur të jemi në sofër duke ngrënë, të mendojmë për ata që nuk mund t'i gjejnë ato kafshata që po hamë; të mendojmë për ata që vajtojnë nën padrejtësitë e zullumqarëve.

Të mendosh vetëm komoditetin personal, pa e vrarë mendjen për të tjerët, pra, të jesh indiferent ndaj njerëzve përreth, nuk mund të jetë morali i një myslimani.



Një besimtar i përkushtuar në shërbim, është njeri altruist. Është një njeri që e di se shpëtimi i vet kalon përmes përpjekjes dhe shërbimit për të shpëtuar të tjerët. Në fakt, Allahu nuk e do njeriun që mendon vetëm interesin e vet, të vrazhdë, egoist dhe koprrac.



Ne s'mund ta konsiderojmë të lehtë për vëllain e fesë një vështirësi që nuk duam të na ndodhë neve. Ja pra, një ndërgjegje dhe një zemër të tillë altruiste kërkon Islami; na urdhëron që ta vëmë dhe ta shohim veten në vend të të varfërve, të shtypurve dhe nevojtarëve.



Nëse në një ndërtesë përballë nesh bie zjarr dhe prej andej vijnë klithma që thërrasin për ndihmë, a mund të themi: «Sa të pi një filxhan kafe-çaj, e po vij»?

Aktualisht, nga e gjithë bota, neve na vijnë thirrje të tilla që thonë:

"-Kemi rënë në hall, po digjemi, po zhdukemi, na duhet ndihmë!".

Cili besimtar i ndërgjegjshëm mund të qëndrojë i heshtur përballë këtyre zjarreve?



Gjatë kohës kur në Egjipt kishte pllakosur zia e bukës, Jusufin ﷺ, e pyetën:

"Ti je një udhëheqës që menaxhon thesarin e shtetit. Përse e lë të uritur veten?"

Ai u përgjigj:

"Kam frikë se nuk do ta kuptoja gjendjen e të uriturve, nëse do të isha i ngopur!"



Allahu i Madhëruar i ka bërë besimtarët përgjegjës ndaj njëritjetrit. Për t'u bërë rob i dashur tek Allahu, është e nevojshme t'i shkosh në ndihmë vëllait të fesë, sidomos në kohë të vështira; t'i qash hallet, të përpiqesh për t'ia zgjidhur problemet, për ta ngushëlluar me fjalë të ëmbla dhe të përjetosh gjendjen e isarit, d.m.th; të mendosh për vëllanë e fesë, para vetes. Kështu, para se të thuash; «unë», të thuash «vëllai im i fesë»!



Shfaqja e dhembshurisë dhe mëshirës ndaj krijesave për hir të Krijuesit, bëhet shkak i kënaqësisë së Allahut të Madhëruar. Kurse indiferenca ndaj thirrjeve të nevojtarëve, bëhet shkak i zemërimit hyjnor.



Nëse të troket ndonjë hallexhi në derë, mos e nis atë duarbosh! Larg qoftë, ndoshta një ditë bëhesh ti vetë i tillë, e detyrohesh të trokasësh derë më derë. Interesohu për zemërthyerit, kujdesu sa të mundesh për ta! Ndoshta një ditë edhe ti do të biesh në gjendjen e tyre.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Besimtarët ndaj njërit-tjetrit, janë si ndërtesa e cila përbëhet nga pjesë të mbërthyera me njëra-tjetrën." Për ta bërë më të qartë këtë, Profeti ﷺ, gërshetoi gishtat e dy duarve duke i mbërthyer fort. (Buhari, Salat, 88.)



Miqësia e vërtetë për hir të Zotit, është si të jetojnë dy njerëz në një zemër. Allahu i Madhëruar ka dashur që besimtarët, të cilët i ka bërë vëllezër, të jenë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën dhe i ka bërë ata përgjegjës për njëri-tjetrin.

- I forti, për të dobëtin...

- I pasuri, për të varfrin...

– I shëndetshmi, për të sëmurin...

– Dhe besimtarët e fortë, përgjegjës për ata që presin të udhëzohen.

– Të gjithë të fuqishmit, të pasurit dhe të diturit gjithashtu, janë nevojtarë për lutjet e vëllezërve të tyre të varfër.



Të parët tanë u kujdesën për të dobëtit në shoqëri, duke krijuar vakëfe të posaçme sidomos për jetimët dhe të vejat. Të mos harrojmë se; edhe sot, jetimët, të vejat, të varfrit dhe të shtypurit, na janë besuar neve. Po ashtu, na është besuar feja dhe atdheu. Me pak fjalë, të gjithë jemi përgjegjës ndaj njëri-tjetrit!..



Profeti ynë ﷺ, i cili kishte një shpirt shumë të lartë, është marrë vetë personalisht me jetimët e ummetit dhe i ka dhuruar njerëzimit këtë shembull të bukur:

"Unë jam më afër çdo besimtari sesa vetja e tij. Kur vdes dikush, pasuria që lë, i takon të afërmve të tij. Por, nëse lë borxhe dhe jetimë, borxhet më takojnë mua (t'i shlyej), ndërsa për jetimët e kam unë për detyrë të kujdesem." (Muslim, Xhuma, 43.)



Fëmijët e braktisur rrugëve, të rinjtë që kanë rënë në kthetrat e drogës dhe alkoolit dhe jetimët nëpër jetimore, konsiderohen fëmijët tanë. Të rinjtë, shumica e të cilëve ende nuk kanë arritur moshën e pjekurisë dhe janë si një degë e njomë pranverore, janë shtyrë drejt plehërishtës së shoqërisë përpara syve të botës. Me anë të helmeve që thithin, janë duke djegur mushkëritë dhe duke asgjësuar funksionet e trurit dhe të zemrës së tyre. Duke u kthyer në armiq të shoqërisë, ata bëhen pjesëtarë të detyrueshëm të bandave kriminale. Pra, sa e ndiejmë veten përgjegjës që nuk ua kemi kultivuar ndjenjat fetare, morale dhe atdhedashëse?



Për njeriun indiferent, i cili nuk ka shqetësime të tjera përveç rehatisë së vet, që nuk bën asnjë përpjekje për lartësimin e Islamit, nuk merr përsipër shërbimet për edukimin e brezave të dobishëm dhe që qëndron larg nga sakrificat në rrugën e Allahut, është e kotë që të shpresojë kënaqësinë dhe mirësitë e Allahut. Kjo thënie e të ndjerit Nexhip Fazëll, përshkruan pikërisht gjendjen e njerëzve të shkujdesur që humbasin jetën e tyre në këtë mënyrë:

«Pema që nuk shqetësohet që të çelë sytha, është thjeshtë një dru!» .

Dhe me të vërtet: Një pemë e thatë, të cilës nuk i intereson të lulëzojë, të japë fryte dhe t'ua ofrojë ato njerëzve, për çfarë tjetër mund të duhet, përveçse të pritet dhe të hidhet në zjarr?!.



Shejh Sadi thotë:

"Bijtë e Ademit janë si gjymtyrët e një trupi, sepse krijimi i tyre është nga e njëjta lëndë. Ata janë krijuar nga e njëjta substancë. Nëse një ditë të dhemb një nga gjymtyrët e trupit, edhe gjymtyrët e tjera do të shqetësohen po ashtu. Por, nëse nuk shqetësoheni për hallet dhe dhimbjet e të tjerëve, nuk jeni të denjë të quheni «njerëz»."



Marrëveshja vëllazërore Muhaxhir-Ensar, që realizoi Profeti ﷺ, është një tablo e pashoqe virtyti. Ensarët nuk fshehën asgjë nga pasuria, dhe shprehën gatishmëri të plotë për ta ndarë atë në mënyrë të barabartë me vëllezërit e tyre Muhaxhirë. Nga ana tjetër, përballë kësaj bujarie të Ensarëve, Muhaxhirët u treguan të matur dhe të pjekur dhe, me një gjendje shpirtërore që nuk e njihte lakminë dhe pangopësinë, u shprehën:

"Allahu i Lartmadhëruar e bekoftë pasurinë tuaj! Mjafton të na tregoni rrugën se si mund ta fitojmë vetë atë."



Një besimtar duhet të arrijë një intuitë të tillë, që mund ta njohë nevojtarin që heziton të shprehë nevojat e tij, duke arritur sekretin e ajetit **«...Ti i njeh ata nga fytyrat e tyre...»** (Bekare, 273) Me fjalë të tjera, zemra e një besimtari duhet të fitojë një ndjeshmëri të tillë që të funksionojë si një radiografi shpirtërore dhe të kuptojë gjendjen e nevojtarit dhe të shqetësohet për problemet e tij.



Ata që janë të dashuruar vërtet me Profetin ﷺ dhe të cilët kanë marrë prej cilësive të dhembshurisë dhe mëshirës në zemrën e të Dërguarit të Allahut, janë shpirtra të lartë, të cilët nuk mund të ngrohen për sa kohë ka besimtarë që ndjejnë të ftohtë

në tokë, nuk mund të flenë të ngopur kur fqinjët e tyre janë të uritur, vuajnë nga dhimbjet e vëllezërve të tyre të fesë dhe të cilët ndjejnë mbi vete përgjegjësinë ndaj të shtypurit, të varfrit, jetimit dhe të vetmuarit, duke i bërë zemrat e veta vend mëshire për ta.



Mevlana Xhelaludin Rumi ka thënë:

"Shemsi më mësoi mua:

«Nëse një besimtar i vetëm ka ftohtë në këtë dynja, ti nuk ke të drejtë të ngrohesh!»

Unë e di që në jetën e kësaj bote ka shumë besimtarë që ndjejnë ftohtë, prandaj unë nuk ngrohem më kurrë!..."



Shija e shërbimit në zemrën e një besimtari të vërtetë, vjen përpara ndjenjës së plotësimit të urisë së vet. Ai nuk mund të shijojë atë që ha kur rreth tij ka të uritur. Ai nuk mund të gjejë paqe pa ia lehtësuar vuajtjen të sëmurit pranë tij.



Besimtar është ai që jeton me lumturinë që i jep gëzimi i nevojtarit.



Mevlana thotë:

"Ti, për shkak se ke kapërcyer veten, nuk kërkon ilaç për plagën tënde, por bëhesh ilaç për plagët e të tjerëve!" (Divan-i Kebir)

Përfaqësuesi më i lartë i kësaj pjekurie shpirtërore, është padyshim i Dërguari i Allahut ﷺ. Familjes së Profetit tonë ﷺ,

herë pas here i vinin plaçkë lufte dhe dhurata. Mirëpo, shpesh, në ato shtëpi të bekuara nuk do të kishte ushqim për ditë me radhë dhe zjarr për muaj të tërë. Nuk bënte vaki që në shtëpitë e tyre të gatuhej bukë gruri tri ditë rresht dhe të ngopeshin me të. Kjo, sepse i Dërguari i Allahut ﷺ, në çdo rast thoshte: *«Më parë populli im»*; pra, në çdo rast do të preferonte nevojtarët e umetit të tij para vetes dhe familjes së tij.

Të urtët e dinë se:

«Trupi i njeriut ngopet me ushqim, ndërsa shpirti i tij duke ushqyer të tjerët...»

Profeti ynë ﷺ, nuk mendoi të shuante urinë e tij pa ushqyer më parë e umetin e tij. Kur populli i tij lidhte një gur në bark për shkak të urisë, ai vetë lidhte dy. Kur i binte në dorë ndonjë mirësi, nuk zinte rehat dhe nuk mund të flinte i qetë pa ua shpërndarë të tjerëve, -përveç asaj që kishte lënë mënjanë për të shlyer ndonjë borxh-. Përpjekja për të gjetur zgjidhje për hallet e të vuajturve, e bënte atë të harronte hallet e veta. Ushqyerja e të uriturve i jepte një kënaqësi të tillë shpirtërore, sa gati e harronte urinë e vet.

Profeti ynë ﷺ, i cili u dërgua si mëshirë për botët, synoi të pushtonte zemrat. Ai dëshironte me gjithë zemër të ofronte zgjidhje dhe kura për çdo problem të umetit të tij. Për këtë, ai ishte i gatshëm të vuante, të gurëzohej, të shahej, të derdhte lot e djersë dhe të rrinte me net pa gjumë.

Në zemrën e Profetit tonë ﷺ, e cila ka qenë gjithmonë një vend mëshire:

- Gjendej dëshira për t'i çuar drejt shpëtimit të përjetshëm të gjithë njerëzit. Për të, fitimi i një zemre do të thoshte të shpëtoje edhe një njeri tjetër nga fatkeqësia e përjetshme.

- Gjendej përpjekja për udhëzuar myslimanët të cilët ishin të nderuar me Islam, por që nuk kishin arritur ende thellësinë e takvasë.

- Gjendej lufta për të shndërruar armiqësitë në vëllazëri dhe për të ndërtuar ura të pathyeshme dashurie midis zemrave.

- Gjendej kauza e pengimit të padrejtësive, e ndihmës ndaj të shtypurve dhe e ngritjes së drejtësisë.

- Gjendej vendosmëria për të qenë ilaç për hallet e të vuajturve. Në mënyrë të veçantë, gjendej përgjegjësia e kujdesit për të vetmuarit, jetimët, të sëmurët dhe të varfrit e umetit të tij.

- Gjendej shqetësimi për t'u bërë burim ngushëllimi për të pafajshmit, pleqtë e pafuqishëm, të vejat pa mbrojtje, jetimët dhe krahëthyerit që përpëliten nën vuajtje e dhimbje...

Sa bartim ne prej këtyre cilësive të Profetit tonë ﷺ, zemra e të cilit rrihte me dhembshuri dhe mëshirë për sigurinë dhe lumturinë e umetit të tij? A mund ta braktisim egoizmin dhe të shqetësohemi për problemet e umetit? Sepse shenja më e dukshme e dashurisë sonë për Profetin ﷺ, është dhembshuria dhe mëshira që ndiejmë për umetin e tij.

Sot, shumë vende Islame janë bërë vende pikëllimi dhe zie. Mijëra myslimanë vdesin, qindra mijëra mbeten të pastrehë e pa atdhe, të uritur dhe pa ilaçe. Kjo është një sprovë si për ata, ashtu

edhe për ne. Për ta, është sprovë e durimit dhe e qëndresës; për ne është sprovë e besnikërisë ndaj vëllait besimtar...



Shejh Sadi ka thënë:

"Miqtë vlejnë në kohë të vështirë. Atëherë evidentohen miqtë e vërtetë, sepse në tryezën e ushqimit edhe armiku duket si mik."



Besimtarët janë përgjegjës ndaj njëri-tjetrit. Asnjë besimtar nuk mund të thotë për një vëlla tjetër; «Ç'më duhet mua me të!». Çdo lloj problemi i vëllait të tij, material apo shpirtëror qoftë, është edhe problem i tij. Uria e vëllait, është edhe uria e tij. Mungesa e takvasë së vëllait, është gjithashtu edhe shqetësim i tij.

Allahu i Plotfuqishëm deklaron se besimtarët që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut do të mbrohen nën hijen e Arshit në ditën e tmerrshme ku nuk do të ketë hije tjetër përveç tij. (Shih. Buhari, Ezan, 36.)

Megjithatë, kjo vëllazëri nuk duhet të ngatërrohet me shoqërinë e çajit dhe kafesë në kohë të mira dhe të rehatshme. Kjo vëllazëri është vëllazëria e eliminimit të problemeve materiale e shpirtërore të njëri-tjetrit në ditë të vështira.



Një nga veprat më të çmuara të besimtarëve, është që t'i duan vëllezërit e tyre të fesë pa asnjë interes të kësaj bote dhe të jenë të gatshëm të ndajnë sa lumturinë e tyre në ditët e tyre të mira, po aq edhe pikëllimet e tyre në kohë të vështira; veçanërisht në kohën tonë kur bota Islame po kalon kohë të vështira.



Misionarët e huaj e shpenzojnë të gjithë forcën e tyre materiale dhe shpirtërore në zonat ku myslimanët janë të vetmuar dhe të dobët. Ata japin bursa për studentët që vazhdojnë arsimin e lartë dhe i detyrojnë ata të angazhohen në aktivitete misionare në Afrikë në këmbim të këtyre bursave. Kështu, ata po përpiqen t'i ndajnë nga ne njerëzit tanë, vëllezërit dhe motrat tona.

Sot, nga shumë vende të botës po ngrihen vajtime të dhimbshme. Një nga këto vajtime shprehej kështu:

"Ju jeni nipërit e Fatihëve dhe Abdylhamidëve. Ku mbetët? Pse nuk keni ardhur deri tani? Gëzohem që keni mundur të vini sot! Ju lutemi mos na harroni më!.."



Përreth nesh, por edhe kudo në botën Islame, ka shumë myslimanë të uritur, të pafuqishëm, të shtypur dhe të papërkrahur!.. Nëse ne me të vërtetë kërkojmë pëlqimin, kënaqësinë, mëshirën dhe afrimin me Allahun e Lartmadhëruar, atëherë duhet seriozisht të pyesim:

Sa njësohet shpirti dhe zemra jonë me shqetësimin dhe trishtimin e myslimanëve në nevojë? Të mirat materiale që na i ka dhuruar Allahu i Lartmadhëruar i harxhojmë veç për vete apo edhe për nevojtarët, të vetmuarit dhe të pashpresët?



Ne që jetojmë në vende ku mbizotëron paqja, kemi përgjegjësi të veçanta. Një nga këto detyra që na e diktojnë këto përgjegjësi, është që të bëhemi melhem (ilaç) për plagët e gjakosura të vëllezërve tanë myslimanë në Palestinë dhe vende të ngjashme me të dhe t'i ndajmë me ta mundësitë tona materiale dhe shpirtërore...



Ne duhet të mendojmë se; sot ne mund të ishim në vendin e vëllezërve tanë sirianë të ardhur nga vendi i brutalitetit dhe masakrës, dhe ata mund të jetonin në tokën tonë. Nëse do të ishim strehuar në derën e tyre, si do të donim të na prisnin dhe çfarë do të mendonim për trajtimin që do të merrnim?



Ashtu si dje, kur muhaxhirët e Mekës iu besuan ensarëve të Medinës, edhe sot, refugjatët sirianë u besohen ensarëve të Anadollit/Turqisë. Prandaj, detyra jonë është të kujdesemi për nevojat e tyre materiale dhe shpirtërore, dhe më e rëndësishmja, t'i bëjmë ata të ndjejnë se nuk janë vetëm.



"...Kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...." (El-Maide, 32.)

Kush vret dikë padrejtësisht, cenon të drejtën e jetës, shkel ndalesën e derdhjes së gjakut dhe pafajësinë e shpirtit dhe, duke inkurajuar të tjerët në këtë drejtim, bën krimin më të madh. Pastaj, kushdo që vret një njeri, meriton zemërimin e Allahut sikur të kishte vrarë të gjithë njerëzit.

Por, kush shpëton qoftë edhe një jetë njeriu; d.m.th, nëse e ndihmon vazhdimin e jetës së tij duke falur, duke e penguar që të vritet padrejtësisht ose duke e shpëtuar nga rreziku i vdekjes, është sikur të ketë shpëtuar të gjithë njerëzit dhe do të arrijë kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Në këtë kontekst, është e nevojshme të kuptohet vlera që kanë tek Allahu ndihmat materiale dhe shpirtërore të dhëna për refugjatët sirianë.



Profeti ﷺ, ka thënë:

"Xhebraili më porositi aq shumë për t'i bërë të mirë komshiut, saqë pandeha se ka për ta bërë komshiun trashëgimtar të komshiut!" (Buhari, Edeb, 28; Muslim, Birr, 140-141.)

Duhet të mendojmë se; si rezultat i rritjes së mundësive të transportit dhe komunikimit, bota është bërë më e vogël dhe distancat janë afruar shumë. Prandaj, tashmë jemi bërë fqinjë me të gjithë vëllezërit e fesë që kemi mundur të arrijmë, edhe sikur të jenë në anën tjetër të botës. Sot, duhet të jemi të ndërgjegjshëm për detyrat dhe përgjegjësitë tona që dalin nga këto kushte.



Abdullah ibn Mubarek, një prej dijetarëve të famshëm asket të brezit të tabiinëve, pasi kreu ritualet e haxhit, e zuri gjumi pranë Qabes dhe pa në ëndërr dy engjëj duke zbritur nga qielli, ku njëri nga melekët i thoshte tjetrit:

Këtë vit kanë kryer haxhin 600 mije veta. Të gjithëve u është pranuar haxhi për respekt të këpucarit Ali ibn Muvaffak nga Shami. Ky person dëshironte të shkonte në haxh por nuk mundi. Për një vepër të tij u pranua haxhi i të gjithë pelegrinëve të tjerë.

Kur u zgjua, Abdullah ibn Mubareku, i tronditur dhe i habitur njëkohësisht u nis për Sham me një karvan. Kur e gjeti personin i tha:

- Ç'është ajo vepër e mirë që ke bërë?

Kur personi e pa veten përballë dijetarit të famshëm Abdullah ibn Mubarekut mbeti i habitur dhe i shastisur. Më pas, tha:

- Ka 30 vjet që dëshiroj të shkoj në Haxh, dhe për këtë mblodha 300 dirhem. Kur po nisesha, bashkëshortja që ishte shtatzënë më tha po vjen era mish nga komshiu. A po shkon kërkon pak mish për mu?

Shkova tek komshiu dhe i tregova për situatën.

Komshiu filloi të qajë pastaj tha:

Ka shtatë ditë që fëmijët janë të uritur. Rrugës gjeta një kafshë të ngordhur, preva një pjesë prej saj dhe po e ziej për fëmijët. Nëse nuk gjej ushqim tjetër hallall jam i detyruar t'i ushqej me të. Nëse dëshiron, të jap, por ndërsa për ne mund të lejohet të hahet për ty nuk lejohet.

Kur dëgjova këtë, më përfshiu një pikëllim. Të 300 dirhemët që kisha mbledhur për haxh ia dhashë atij dhe u luta: **"O Zot! Ma prano qëllimin e haxhit!"**

Në një hadith thuhet:

"Nuk është besimtar, ai që fle i ngopur ndërkohë që fqinji i tij është i uritur!" (Hakim, II, 15.)

Me këtë paralajmërim profetik, sot duhet të meditojmë shpesh për përgjegjësitë tona ndaj refugjatëve sirianë, të cilët janë fqinjët tanë. Ne duhet të ndjejmë vuajtjet e vëllezërve dhe motrave tona fetare në Siri, Palestinë, Afrikë, Mjanmar dhe Turkistanin Lindor. Me pak fjalë, në të gjithë botën, duke filluar nga më të afërmit prej nesh. Si besimtarë, ne duhet të bëjmë një llogari të thellë; sa arrijmë të mendojmë për veten dhe sa për të tjerët jashtë vetes!..

Ebu'l- Hasan Harakani thotë:

"Gjembi që lëndon gishtin e vëllait tim besimtar në hapësirën midis Turkistanit dhe Damaskut, ka lënduar edhe gishtin tim; guri që godet këmbën e tij, ka lënduar edhe këmbën time. Nëse një zemër është lënduar, ajo është zemra ime."

Koprracët dhe të shkujdesurit bëjnë si të shurdhër përballë rënkimeve që ngrihen përreth tyre duke thënë: "Kini mëshirë për ne! O mëshirë, ku je?". Ata e mashtrojnë veten me disa justifikime që krijojnë në botën e tyre të brendshme, duke thënë; «Gjithsesi, dikush do t'i dëgjojë e do t'i ndihmojë!..». Megjithatë, ata që thellohen në besim, arrijnë të dëgjojnë edhe rënkimin e një myslimani në anën tjetër të botës. Ata nuk ngrohen dot nëse vëllai i tyre ka ftohtë, e nuk mund të gëzohen kur ai është në hall.

Dijetarët Islamë kanë mendim të përbashkët se; myslimanët të cilët kanë mundësi dhe nuk i ndihmojnë vëllezërit e tyre të fesë, të cilëve u bëhet padrejtësi dhe shtypen në cilindo vend të botës, do të kenë gjynah të madh.

Gjendja e mjeruar e vëllezërve tanë të fesë në vendet si Siria, Gaza, Afrika, etj., është tablo e një sprove hyjnore që duhet të na nxisë të gjithëve drejt një vetllogarie të ndërgjegjes!..

Në Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do të urdhërojë:

- O bir i Ademit! Unë u sëmura dhe ti nuk më vizitove.

Biri i Ademit do t'i thotë:

- E si mund të të vizitoja Ty, ndërkohë që Ti je Zoti i botëve!?

Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

- Filan rob u sëmur dhe ti nuk shkove ta vizitoje. Nëse do ta vizitoje atë, Mua do të më gjeje pranë tij. A nuk e di këtë? O bir i Ademit, Unë doja të më ushqeje, ti nuk më ushqeve.

Biri i Ademit do t'i thotë:

- E si mund të të ushqeja Ty, ndërkohë që Ti je Zoti i botëve!?

Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

- Filan rob kërkoi ushqim prej teje dhe ti nuk i dhe. Po t'i jepje atij ushqim, atë që do të jepje do ta gjeje patjetër tek Unë. A nuk e di këtë? O bir i Ademit, nga ti kërkova ujë e ti nuk më dhe.

Biri i Ademit do t'i thotë:

- O Zoti im! E si mund të të jepja ujë Ty, ndërkohë që Ti je Zoti i botëve!?

Allahu i Madhëruar do t'i thotë:

- Filan rob kërkoi ujë prej teje dhe ti nuk i dhe. Po t'i jepje atij atë që të kërkoi, mirësinë e asaj që dhe do ta gjeje tek Unë. A nuk e di këtë?" (Muslim, Birr 43.)

Prandaj ne si besimtarë duhet të ndjejmë përgjegjësinë tonë ndaj shoqërisë dhe në asnjë mënyrë të mos i neglizhojmë ibadetet kolektive.

Duhet të marrim pjesë në të gjitha ibadetet si; urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja, falja e 5 namazeve ditore, namazit të xhumasë dhe të bajrameve, marrja pjesë në kuvendet e diturisë, vizita e të sëmurëve, shoqërimi i xhenazes, ndihma e të varfërve dhe nevojtarëve.

Të qëndrosh indiferent ndaj dhimbjes së vëllait të fesë, konsiderohet një gjynah shumë i rëndë. I nderuari Serijji Sakati, i cili për një moment u tregua i shkujdesur në lidhje me këtë çështje, e shpreh kështu pendesën e madhe që ndjeu prej kësaj gjendjeje:

"Një ditë, ishte djegur çarshia e Bagdadit. Dikush erdhi me vrap tek unë dhe më tha: «E gjithë çarshia e Bagdadit u dogj dhe vetëm

dyqani juaj ka shpëtuar. Përgëzime!" Ndërsa unë, pa menduar për vëllezërit e tjerë të cilëve iu dogj dyqani, thashë «Elhamdulilah!» për veten time. Mirëpo, tani u bë tridhjetë vjet që po kërkoj falje për këtë çast në të cilin u tregova i pakujdesshëm." (Hatib el-Bagdadi, Tarih, IX, 188; Dhehebi, Sijer, XII, 185, 186.)

Të qëndrosh duke u penduar tridhjetë vjet për shkujdesjen e një momenti kur je treguar indiferent ndaj vuajtjeve të vëllezërve të fesë të cilëve u ka rënë fatkeqësi!.. Çfarë ndjenje vëllazërie!..

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Myslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk i bën padrejtësi atij dhe nuk e dorëzon atë tek armiku. Kush e plotëson një nevojë të vëllai të tij, edhe Allahu do të plotësojë nevojën e tij. Kush ia largon një myslimani çfarëdolloj vështirësie, edhe Allahu i Madhëruar do t'i largojë atij një nga vështirësitë e ditës së kiametit..." (Buhari, Medhalim, 3; Muslim, Birr, 58.)

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Për sa kohë që robi ndihmon vëllain në fe, edhe Allahu e ndihmon atë." (Muslim, Dhikr, 37-38.)

Nxënësi që i shërbente Davud-i Tai, i tha një ditë atij:

- Kam pjekur pak mish. A dëshironi të hani?

Mësuesi heshti dhe kjo nënkuptoi miratim për nxënësin. Mirëpo, Davud-i Tai, tek po shikonte mishin që nxënësi i solli, e pyeti atë:

- Kemi ndonjë gjë të re për gjendjen ekonomike të filan jetimëve, bir?

Nxënësi iu përgjigj:

- Nuk ka asnjë gjë të re në lidhje me ta, vetëm të vjetra, ato që i dini edhe ju.

Pas kësaj përgjigjeje, Davud-i Tai tha:

- Atëherë këtë drekë dërgojua atyre, menjëherë!

Nxënësi i tij i sinqertë, që dëshironte ta ndante këtë ushqim me mësuesin e tij, këmbënguli duke i thënë:

- Mësues i nderuar, ka kohë që ju nuk keni ngrënë aspak mish!.. Mirëpo, Davud-i Tai ia ktheu:

"O bir, nëse unë do ta ha këtë mish që ke sjellë dhe përgatitur enkas për mua, pa kaluar shumë ai do të dalë jashtë. Por, nëse mishin në fjalë do ta hanë jetimët, ai do të ngjitet deri në Arshi Ala, ku do të na paraqitet si sevap në botën tjetër!.."

Nëse i mbrojmë njerëzit e dobët, nevojtarët dhe të vuajturit në shoqërinë tonë, veçanërisht vëllezërit tanë emigrantë sirianë, me dhembshuri, mëshirë dhe mirësi, shpresojmë që me bekimet e lutjeve të atyre të dobëtëve, do të arrijmë mirësitë dhe mbrojtjen e Allahut të Madhëruar.

Në një hadith fisnik thuhet:

"Thirrmëni të dobëtit tuaj, sepse ju ndihmoheni dhe furnizoheni vetëm (me lutjen dhe begatinë) e personave të dobët nga ju!"
(Ebu Davud, Xhihad, 70; Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 198.)

"Allahu e ndihmon këtë popull për shkak të duave, namazeve dhe sinqeritetit të të dobëtëve." (Nesai, Xhihad, 43.)

Besimtari e konsideron veten përgjegjës për rrjedhën e kohës në të cilën jeton dhe shqetësohet për problemet e umetit. Për këtë arsye, nëse mundet, besimtari e ndihmon umetin me dorën e tij, në mënyrë që të jetë ilaç për problemet. Me fjalë të tjera, ai nxiton të ndihmojë personalisht me pasurinë dhe jetën e tij. Nëse ai nuk mund të ndihmojë me dorën e tij, ai përpiqet të ndihmojë me gjuhën e tij. Pra, nxit ata që kanë mundësi. Nëse ai nuk mund ta bëjë as këtë, të paktën përpiqet të jetë me të vuajturit me anë të lutjeve të përzemërta.



Në një hadith fisnik thuhet:

"Nuk ka dua që pranohet më shpejt se duaja që bën vëllai për vëllain e tij kur nuk e ka pranë." (Tirmidhi, Birr, 50.)



Të mendojmë për vëllezërit tanë të fesë që jetojnë nën dhunë dhe shtypje dhe të kërkojmë zgjidhje për hallet e tyre duke thënë: «Çfarë mund të bëj për ta?», është detyrë e besimit dhe ndërgjegjes sonë. Po ashtu, nëse nuk mund të bëjmë dot asgjë, të paktën të lutemi për ta siç lutemi për problemet tona.



Ne duhet të lutemi shumë për umetin islam. Në lidhje me këtë, në një hadith fisnik thuhet:

"Nuk ka lutje më të dashur tek Allahu, se sa kur robi i tij thotë:

اَللّٰهُمَّ ارْحَمْ أُمَّةَ مُحَمَّدٍ رَحْمَةً عَامَّةً

«O Allah! Mëshiroje umetin e Muhamedit ﷺ, me një mëshirë gjithëpërfshirëse!» (Ali Muttaki, no: 3212, 3702.)

Kjo lutje që bënte Profeti ﷺ, për umetin, është një mjet për të arritur dashurinë profetike.

Maruf Kerhi ka thënë:

"Ai që thotë dhjetë herë në ditë:

«O Allah, përmirësoje gjendjen e umetit të Profetit Muhamed ﷺ!

O Allah largoja vështirësitë (mërzinë) umetit të Profetit Muhamed ﷺ!

O Allah mëshirojë umetin e Muhamedit ﷺ!»

Renditet në listën e robërve të mirë të Allahut Teala." (Ebu Nuajm, Hilje, VIII, 366.)

Ebu Bekri رضي الله عنه, ka thënë:

"Katër lloj njerëzish janë prej robërve të mirë të Allahut:

1. Ai që gëzohet kur sheh dikë që bën teube (pendohet).

2. Ai që i përgjërohet Allahut për faljen e gjynaheve.

3. Njeriu që bën dua për vëllanë e tij të fesë kur ai nuk ndodhet i pranishëm.


4. Ai që ndihmon dhe i shërben dikujt që është nevojtar më shumë se ai vetë."

Sot, mërzitemi teksa shikojmë vuajtjet në ekrane, në gazeta dhe në rrjetet sociale; mbase derdhim lot, e ndoshta edhe lute-

mi; “Zoti i ndihmoftë!”. Por, sa arrijmë ta tregojmë mëshirën e vërtetë, duke menduar; «Çfarë mund të bëj për të kompensuar vuajtjet e vëllait tim besimtar?»



Të mund t’i japësh hakun vëllazërisë Islame, varet nga sakrificat që bëhen, veçanërisht në kohë të vështira. Lutjet, dhurimet dhe sakrificat që do të bëjmë për njerëzit e shtypur, të pikëlluar dhe të vuajtur të Umetit të Muhamedit ﷺ, do të jenë shprehja më e mirë e lavdërimit dhe falënderimit ndaj Zotit tonë dhe e besnikërisë, dashurisë dhe përkushtimit ndaj Profetit ﷺ.



TË PREFEROSH AHIRETIN PARA DYNJASË

Ne jetojmë në një epokë, ku mundësitë e kësaj bote janë në kulmin e tyre. Mirëpo, shpirtrat janë të sëmurë dhe zemrat të uritura! Njerëzimi sot është në krizë për shkak të urisë shpirtërore!

Mirëpo, kur shikojmë Epokën e Lumturisë, nuk hasim në një krizë shpirtërore, pavarësisht nga pamundësitë e dynjasë, sepse ata e kuptuan domethënien e paqes dhe lumturisë së vërtetë; ata e kuptuan se jeta e vërtetë, është jeta e ahiretit.

Ndryshe nga dëshira e njerëzimit të sotëm për të jetuar pak më rehat dhe më gjatë në këtë botë, dëshira më e madhe e brezit të sahabëve ishte që të mund të shkonin në ahiret me zemër dhe ndërgjegje të pastër.

Dërguari i Allahut ﷺ, edhe kur arrinte suksese, edhe kur privohej nga diçka, edhe në gëzim, edhe në vështirësi, edhe në lumturi, edhe në fatkeqësi, gjithmonë thoshte kështu:

اللّهُمَ لا عَيْشَ إِلّا عَيْشُ الآخِرَةِ

«O Zot! Jeta e vërtetë, është vetëm ajo e ahiretit".

Kështu, ai e paralajmëronte umetin e tij nga rënia në pesimizëm dhe rebelim në kohë të vështira dhe nga rënia në shkujdesje dhe vetëkënaqësi në kohë rehatie. Ai kujtoi se edhe kënaqësitë e kësaj bote edhe vështirësitë e saj, ishin të përkohshme dhe këshilloi që të mos mashtrohemi prej tyre.

Ndjenjat e Profetit ﷺ, gjithmonë mbizotëroheshin nga kriteri i parapëlqimit të ahiretit ndaj dynjasë. Prandaj, sipas tij:

"Gjëja kryesore për t'u shqetësuar është humbja e ahiretit."

"Gjëja kryesore për të cilën duhet të jemi të lumtur është shpëtimi në ahiret."

Kriteret e tij të trishtimit dhe gëzimit ishin kriteret e vetme edhe për sahabët e tij. Shqetësimi i tyre më i madh, ishte frika se mos e humbnin në ahiret ëmbëlsisë e të qenit me të Dërguarin e Allahut ﷺ, të cilën e kishin përjetuar në këtë botë. Po zemrat tona sipas cilave kritere punojnë? Për çfarë pikëllohemi apo gëzohemi?

A janë gëzimet dhe hidhërimet tona kryesisht për jetën tonë të përjetshme apo për interesa të përkohshme dhe kalimtare?

Bashkësia e sahabëve, të cilët u edukuan nga dora e Profetit ﷺ dhe u bënë shembull për ne, kishin një horizont të atillë, saqë tek ata, mendimet për interesa të kësaj bote, e kishin humbur rëndësinë e tyre. Në këtë aspekt, asnjëri prej tyre nuk do të ankohej për gjendjen e kësaj bote.

I gjithë halli i tyre përbëhej nga shqetësimi për botën tjetër: "A është Zoti i kënaqur me mua? A do të mund të jem me të Dërguarin e Allahut në botën tjetër?"

Në krahasim me dëshirën dhe shqetësimin e sotëm të njerëzimit për të jetuar më rehat dhe më gjatë, dëshira më e madhe e brezit të sahabëve, ishte të shkonin në botën tjetër faqebardhë, me ndërgjegje të qetë dhe zemër të pastër.

Një ditë, Ibën Mes'udi رضي الله عنه, u tha shokëve të tij:

"Ju agjëroni, falni namaz dhe bëni punë të mira më shumë se sahabët e Resulullahut ﷺ, por ata ishin më të mirë se ju".

Ata të habitur pyetën:

"E si është e mundur kjo?"

"Ata ishin më larg kësaj bote dhe e dëshironin më shumë se sa ju botën tjetër."-Tha ai. (Hakim, Mustedrek, 4/135.)

Ebu'd-Derda رضي الله عنه, thoshte:

"Kam frikë se mos jepeni pas dëshirave vetjake te fshehta, duke u përhumbur në mirësitë të cilat e zbavitin njeriun. Këto dëshira vetjake sipas dijes shfaqen mbasi ta mbushni stomakun me ushqim kur jeni të uritur. Më i miri prej jush është ai që i jep shokut të vet këtë këshillë:

-Eja të agjërojmë përpara se të vdesim.

Më i keqi prej jush është ai që i thotë mikut të vet:

-Eja dhe të zbavitemi para se të vdesim, të hamë dhe të pimë, ta shijojmë jetën..." (Ebu Nuajm, Hilje, I, 218.)

Profeti ynë ﷺ, shokët e tij dhe dijetarët e devotshëm që shkuan pas gjurmëve të tyre, me vetëdijen se jeta e vërtetë është ahireti, i përqendruan të gjitha përpjekjet e tyre në rrugën e Allahut dhe nuk e shikonin këtë botë kalimtare as me konsideratën më të vogël.

Prandaj, të bësh një jetë të shkujdesur sikur nuk do të vdesësh kurrë, me iluzionin e një bote pa ahiret dhe të qëndrosh në bujtinën kësaj bote sikur të ishe vendas, është një vetëmashtrim i hidhur!

Edhe kënaqësia më e madhe e kësaj bote kalimtare, është një «hiç» në krahasim me mirësinë më të vogël të xhenetit. Po ashtu, edhe të gjitha sprovat dhe vështirësitë që mund të kalohen në këtë botë, janë «asgjë», në krahasim me një moment dënimi në xhehenem.

Osmani رضي الله عنه, shprehet:

"Padyshim se dynjaja është e përkohshme, ndërsa Ahireti i përjetshëm. Mos t' ju përkëdhelë e mos t' ju harbojë e përkohshmja... mos t' ju pengojë nga e përhershmja! Zgjidhni të përhershmen në vend të së përkohshmes, sepse dynjaja ka fund dhe kthimi është tek Allahu. Kini frikë Allahun!" (Ibni Ebi'd-Dunja, Meusu'a, I, 77.)

Një njeri i urtë ka thënë:

"Nëse dynjaja do të ishte prej ari dhe e përkohshme, ndërsa Ahireti prej balte dhe i përjetshëm, njeriu i mençur do të zgjidhte të

përjetshmen në vend të përkohshmes. Po sikur të ishte e kundërta e kësaj, pra dynjaja të ishte prej balte dhe e përkohshme, ndërsa Ahireti prej ari dhe i përjetshëm, vallë çfarë duhej bërë?!"

Omeri ﷺ, ka thënë:

"E çfarë është dynjaja krahasuar me Ahiretin, përveçse si kërcimi i një lepuri?!!"

Sa kohë nga ditët tona e shpenzojmë për krijuar rehatinë në këtë botë ku jemi vizitorë për një kohë të përkohshme? Nga ana tjetër, sa orë në ditë e ndajmë për përgatitjen për ahiretin, ku do të qëndrojmë përgjithmonë?

Të mos harrojmë se; në ahiret askush nuk do të shqetësohet se, "Jetova pak apo jetova shumë në dynja". Por do të shqetësohen se; sa të mira dhe sa të këqija ka bërë në jetën e tij të kaluar...

Kundërshtimi i parë ndaj Islamit në kohën e injorancës, kaq qenë në lidhje me besimin në ekzistencën e botës tjetër. Ata thoshin:

"O Muhammed! Hiq dorë nga ligjërimi për botën tjetër dhe mos i prek idhujt tanë! Atëherë ne do të të ndjekim ty!.." I gjithë halli i tyre ishte çështja e ahiretit.

Po kështu edhe sot, një rrymë e asaj injorance që do të na bëjë të harrojmë ahiretin po kërcënon fëmijët tanë. Disa programe në internet dhe televizion, disa modele dhe reklama negative po përpiqen t'i bëjnë brezat tanë të harrojnë ahiretin.

Fuqitë globale, përfaqësuesit më të mëdhenj të injorancës së sotme, po vrapojnë nga një mizori në tjetrën me iluzionin e një bote pa jetë të përtejme. Të fuqishmit, të cilët nuk mendojnë për llogarinë hyjnore, shtypin pamëshirshëm të dobëtit, duke shfaqur një spektakël të tmerrshëm brutaliteti. Kjo, sepse kur njeriu largohet nga të vërtetat hyjnore, ai i jep lamtumirën edhe njerëzillëkut. Kur i kthen shpinën edukimit të shpalljes hyjnore, ai shndërrohet në një krijesë «mizore dhe injorante», ndërgjegjja e së cilës është atrofizuar dhe konkurron me hienat në brutalitet dhe vrasje!..

Detyra e njeriut është të mos harrojë Allahun, ahiretin dhe përjetësinë e tij. Përndryshe, bota e zemrës kthehet në një plehërishte pasionesh kalimtare dhe egoiste.

Nëse jeta e kësaj bote, e cila kalon si një re verore, jetohet pa u shqetësuar për ahiretin, kjo është njësoj sikur ta konsiderosh ditën pa mbrëmje.

Bota e përkohshme është si një pikë. Kurse ahireti është si oqean. Të sakrifikosh oqeanin për një pikë ujë është humbje e madhe.

Sa marrëzi është të harrosh jetën e pasosur duke u stresuar dhe duke punuar me një zell të tepruar e plot ambicie për jetën e kësaj bote që do të soset për çdokënd, pa asnjë përjashtim, herët apo vonë, nga alarmet e exhelit, e që fundi i së cilës është me vështirësi pleqërie e sëmundjeje, pra, në vend që ta ndërtosh pafundësinë, ta lësh atë mes zjarresh!

Rumiu ka thënë:

"O i gjorë që për një kafshatë buke e hedh tutje thesarin e imanit, e që shet një thesar të çmuar për një kokërr elbi! Nemrudi nuk ia dha shpirtin Ibrahimit عليه السلام*, por ia dorëzoi atë një mushkonje."*

Omeri رضي الله عنه, ka thënë:

"Njeriu më injorant është ai që shet ahiretin për këtë dynja."

Ai që jep të përkohshmen në këmbim të së përhershmes, është i mençur; kurse ai që jep të përhershmen në këmbim të përkohshmes është i marrë.

Isai عليه السلام, po vraponte me shpejtësi të rrufeshme sikur po e ndiqte një luan. Një burrë, i çuditur nga kjo shpejtësi, i ngjitet nga pas dhe i thotë:

"- Çfarë ka ndodhur? Pse dhe për ku po vrapon kështu si një zog i frikësuar? Nuk shoh asgjë pas teje!"

Profeti Isa عليه السلام, po vraponte aq shpejt sa nuk arriti as t'i kthente përgjigje pyetjes së personit në fjalë. Burri i cili ishte kurioz dhe në merak për vrapin e shpejtë dhe të beftë të Profetit, iu afrua edhe më tepër dhe e pyeti sërish:

"- O profet i Zotit! Ky vrapimi yt kaq i shpejtë më bëri shumë kureshtar, nuk mund të duroj pa të pyetur. Nga kush po largohesh kështu?"

Pas kësaj Isai عليه السلام, iu përgjigj:

"- Po vrapoj për të ikur nga i marri!.. Ik të lutem dhe mos më pengo që ta shpëtoj veten!.."

Kësaj here burri e pyeti mbi urtësinë e kësaj ikjeje, pasi ia kujtoi mrekullitë Profetit të Allahut جل جلاله:

"-A nuk je ti Mesihu i cili me frymën tënde gjetën shërim të verbrit dhe shurdhët?"

Isai ﷺ, u shpreh:

"- Po, unë ia kam lexuar emrin më të madh të Zotit, Ismi Azam-in, të shurdhërve dhe të verbërve. Ata u përmirësuan dhe gjetën shërim. Ia kam kënduar të vdekurit dhe i vdekuri është ngjallur. Mirëpo kur të njëjtin emër të Allahut ﷻ, ia lexova me mëshirë dhe dhembshuri budallait, atij nuk i bëri asnjë dobi."

Të urtët thonë:

«Tre njerëz nuk mund të jenë miq të Zotit: Mendjemadhi, koprraci dhe mendjeshkurtri.»

Mendjemadhësia është sëmundja e shfaqjes së vetes. Kjo i shtyn njerëzit në shpërdorim. Ndërsa shpërdorimi është një përpjekje për të shtypur ndjenjën e inferioritetit. Koprracia do të thotë të mbledhësh pasuri vetëm për vete; të jesh bujar me veten dhe dorështrënguar me të tjerët.

Mendjeshkurtësia është kanceri i jetës shpirtërore. Është sikur një person t'i mbyllë sytë me gishta dhe të bëhet i verbër ndaj të vërtetave hyjnore.

Një njeri mendjeshkurtër, bëhet dëshmitar i skenave të panumërta ceremonish mortore; në gurët e varreve lexon emrat e shumë njerëzve që kanë vdekur më të rinj se ai, por kurrë nuk mendon se edhe vetë do të vdesë një ditë; nuk e kujton fare botën e varrit dhe ahiretin e përjetshëm. Ai dëshiron të jetojë një dynja pa ahiret. Dhe për shkak se syri i zemrës së tij është me perde, mjerimin e vet e konsideron lumturi.

Rumiu ka thënë:

"Njeriu çmohet duke parë se me çfarë merret dhe çfarë kërkon."

"Nëse gomari bëhet klient dhe dëshiron të blejë diçka, padyshim se do të marrë bostanin e papjekur."

Kjo botë është si një treg ku blihet e shitet ahireti. Por, në të njëjtën kohë, ky treg është edhe një terren sprove. Ajo, është e pajisur me njëmijenjë hijeshi që do t'i bëjnë njerëzit të harrojnë qëllimin e dërgimit të tyre në këtë botë. Prandaj, robi nuk duhet të harrojë kurrë se jeta e vërtetë është ajo e ahiretit dhe se çfarë duhet të kërkojë në tregun e kësaj bote.

Ebu Bekri ﷺ, ka thënë:

"Dynjaja është pazari i besimtarëve; nata dhe dita janë kapitali i tyre; punët e mira, mallrat e tregtisë, Xheneti janë fitimi, ndërsa Xhehenemi është dëmi e tyre."

Ne erdhëm në botë për të fituar sprovën e ahiretit. Të harrosh këtë dhe ta lejosh zemrën të kaplohet nga lakmitë e kësaj bote, të mbytesh në vorbullën e joshjeve të përkohshme dhe të humbësh kohë në dashuritë kalimtare, është një vetëmashtrim i hidhur.

Të mos harrojmë se; ajo që do të na sjellë dobi në frymën e fundit, në varr, në kiamet, në llogari, në sirat; me pak fjalë, në jetën e amshuar, nuk janë dashuritë kalimtare e të përkohshme si mirazhet që shihen në shkretëtirë, por, sa shumë mund t'i shërbejmë Zotit tonë në këtë botë dhe sa mund të bëjmë në rrugën e kënaqësisë së Tij.

Dëshirat e vdekshme, e humbin rëndësinë e tyre pas bashkimit me Zotin. Kjo, sepse shijet kalimtare konsumohen. Pasuritë materiale, titujt dhe epoletat i sigurojnë egos lumturi të përkohshme dhe rehati të trupit. Mirëpo, ajo që nuk mund të sigurojë, është paqja e përhershme e zemrës dhe qetësia e ndërgjegjes. Lumturia e përjetshme do t'u jepet vetëm atyre që shkojnë me besim në botën tjetër, e cila është vendbanimi i përjetshëm.

Të jepesh pas përfitimeve materiale duke humbur rastet e përjetshme është shenjë e mungesës së vetëdijes së besimit.

Shumë njerëz i lënë pas dore detyrat e tyre ndaj Zotit, që është qëllimi i dërgimit të tyre në këtë botë, herë si shqetësim për furnizim, herë si preokupim me gradat dhe pozitat në këtë botë dhe herë si të burgosur të dëshirave dhe pasioneve egoiste si, pasuria, epshi dhe fama. Mirëpo, në rezidencën e quajtur botë, ne përjetojmë qëndrimin tonë të përkohshëm si mysafir. Të humbasësh kohë në këtë bujtinë sikur do të jetojmë përherë, të qëndrosh larg përmendjes së Allahut, namazit dhe detyrave të tjera të robërisë dhe të shtysh pendimin dhe istigfarin për të nesërmen -që nuk dihet a do të vijë-, duke u kapluar nga lakmitë sikur do t'i mbarojmë ne të gjitha punët e pafundme të botës, bëhet shkak i një zhgënjimi shumë të madh.

Ata që janë të pavetëdijshëm ndaj Allahut dhe përplasen nga erërat e fatit në shirësen e jetës, nuk i qan as bota që lënë pas, e nuk u qesh as bota tjetër që i pret përpara.

Osmani ﷺ, ka thënë:

"Mendimi për dynjanë është errësirë në zemër, ndërsa mendimi për Ahiretin është dritë në zemër."

Lufta mes prirjes së dynjasë dhe prirjes për ahiret do të vazhdojë deri në frymën e fundit. Mirëpo, edhe pse ne kërkojmë pjesën tonë nga kjo botë, ne gjithmonë duhet t'i drejtojmë zemrat tona nga ahiret, në mënyrë që lakmitë e kësaj bote të mos i pushtojnë zemrat tona.

Allahu ka thënë në Kuran"

"**Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t'ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t'i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në jetën tjetër."** (Shura, 20.)

Lukman Hakimi ka këshilluar:

"Flijoje dynjanë tënde për Ahiretin, që t'i fitosh të dyja. Por mos e flijo Ahiretin për dynjanë, sepse i humbet të dyja."

Jusuf Has Haxhib thotë:

«Pasuria e kësaj bote ka mëri ndaj fesë. Shumë nga ata që arritën pasuri në botë e lanë pas dore fenë e tyre. Kujdes, mos u bë edhe ti prej tyre!"

Një i urtë ka thënë:

"Ata që duan fenë nuk kanë humbur asgjë nga kjo botë; kurse ata që duan këtë botë kanë dalë prej feje."

Në bazë të logjikës dhe mendjes së shëndoshë, interesat e vogla dhe të përkohshme braktisen për hir të fitimeve më të mëdha, të cilat zgjasin pafundësisht. Mendje e shëndoshë është ajo që zgjedh të përhershmen në vend të së përkohshmes.

Ndërsa në një hadith të nderuar, Profeti ﷺ, shprehet kështu, në lidhje me zotëruesit e mendjes:

"I mençur është ai që e mbizotëron nefsin (egon), i kërkon llogari (nefsit) dhe përgatitet për (jetën) pas vdekjes. Ndërsa mendjelehtë është ai që shpreson (mirësi) nga Allahu, megjithëse nefsi i tij shkon pas epsheve dhe dëshirave." (Tirmidhi, Kiamet, 25/2459.)

Aliu رضي الله عنه, ka thënë:

"Ai që dëshiron Xhenetin vrapon drejt punëve të mira. Ai që i frikësohet zjarrit, ruhet nga epshi i tij. Atij që beson se një ditë do të vdesë, i shuhet egoja."

Nuk mund të ketë mashtrim dhe dështim më të madh se sa të çosh dëm të ardhmen e vërtetë, që është Ahireti, për shkak të lakmive egoiste dhe shqetësimeve për të ardhmen në këtë botë. Allahu i Madhëruar nuk i jep vlerë personit që e harron Ahiretin dhe e robëron zemrën e tij pas kësaj bote, e cila për Allahun nuk ka vlerë as sa krahu i një mize. Ata që e harrojnë Allahun duke u kapluar nga telashet e kësaj bote, do të jenë prej të harruarve nesër, kur të ndahet mëshira hyjnore në botën tjetër.

Aliu رضي الله عنه, ka thënë:

"Imani (besimi) i atij njeriu që nuk i beson më shumë punëve të Zotit sesa punëve të tij nuk është përsosur akoma!"

Mendja e atyre që zgjedhin dynjanë në vend të Ahiretit, nuk ndryshon aspak nga mendja e fëmijës që kujton se qepa që ka në dorë është ushqimi më i shijshëm në botë, për shkak se nuk i njeh ushqimet e tjera të llojllojshme.

Njeriu që nuk shkon në botën e përjetshme me besim dhe vepra të mira, edhe nëse ka notuar mes mirësive dhe ka mbretëruar mes kënaqësive në këtë botë, në të vërtetë ai është një i falimentuar i mjerë, një lypës i Ditës së Gjykimit. Nga ana tjetër, nëse njeriu që ka besuar dhe e ka ringjallur jetën me vepra të mira, ai në të vërtetë është nga sulltanët e ahiretit që zotëron gjithçka, edhe nëse nuk ka pasur asgjë në këtë botë, madje edhe nëse ka jetuar si skllav.

Privimet në këtë botë, janë për një periudhë të caktuar kohore. Kurse, mungesa e besimit, bëhet shkak i privimit të përjetshëm, i cili përbën edhe problemin më të madh.

Atëherë, duhet të llogarisim veten; sa gëzohemi për një mirësi të kësaj bote dhe sa mirënjohës dhe falënderues jemi për mirësinë e besimit që do të na çojë në lumturinë e përjetshme?

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Jetët tuaja s'kanë çmim tjetër përveç Xhenetit! Prandaj, jetët tuaja shitini vetëm në këmbim të Xhenetit!"

Në këtë botë sprovash nuk erdhëm vetëm për të fituar mirësitë e kësaj bote, por për të shpëtuar ahiretin tonë. Prandaj, kur bëhet fjalë për një zgjedhje mes dynjasë dhe ahiretit, gjilpëra e busullës së zemrës sonë duhet të tregojë gjithmonë ahiretin.

Kushti i parë i lumturisë, është të jesh rob i Allahut. Lumturia, të cilën njerëzit e shkujdesur dhe larg së vërtetës, e kuptojnë si jetë sipas dëshirës dhe «shijim i jetës», është një iluzion i hidhur dhe mjerim për zemrat besimtare.

Në botën tjetër, të gjithë do të shohim shpërblimin për atë që kemi bërë në këtë botë. Ajo që mbjellim sot në arën e dynjasë, do të jetë produkti i vetëm që do të marrim nesër në të korrat e ahiretit. Në këtë aspekt, jeta e vërtetë është ahireti. Kurse kjo dynja duhet konsideruar si arë e ahiretit, sepse kjo është e vetmja mënyrë për ta bërë dynjanë dhe ahiretin një kopsht xheneti.

Shekujt dhe brezat janë karvanët e migrimit hyjnor. Prandaj, në këtë botë kalimtare ku jemi vetëm udhëtar i përhershëm, nuk duhet të jetojmë si vendas!..

Osmani ﷺ, ka thënë:

"Janë katër gjëra, e dukshmja e të cilave është virtyt, ndërsa e padukshmja është farz:

1. Qëndrimi me njerëzit e mirë është virtyt, pasimi i tyre është farz!

2. Leximi i Kuranit është virtyt, ndërsa puna me të është farz!

3. Vizita e varreve është virtyt, ndërsa përgatitja për atje është farz!

4. Vizita e të sëmurit është virtyt, ndërsa marrja mësim prej situatës është farz!

Jeta e kësaj bote, është një kapitull i shkurtër. Detyra jonë më e rëndësishme në këtë kohë të shkurtër, është:

– Të jemi vëllezër që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut.

- Të jemi myslimanë shembullor dhe mirëkuptues.

– Të fitojmë zemra dhe të marrim lutje të hajrit nga të tjerët.

– Të jemi të dobishëm për të gjithë dhe të mos bëhemi barrë për askënd.

– Në këtë mënyrë; të arrijmë të dalim para Allahut, duke marrë dëshminë «njeri i mirë» nga besimtarët, të cilët janë dëshmitarët e Allahut në tokë.

Të urtët kanë thënë:

- Puno për këtë botë aq sa do të qëndrosh në të!

- Puno për ahiretin aq sa do të qëndrosh në të!

- Bindju Allahut aq sa ke nevojë për të!

- Vepro mëkate aq sa mund të durosh zjarrin!

O Zoti ynë! Më i Mëshirshmi i mëshiruesve! Na mbro nga fati i atyre që e shkatërrojnë veten në një gotë ujë, duke e zhytur veten në bukuritë e kësaj bote! Bëje jetën dhe vdekjen tonë të stolisur dhe të nderuar me lumturinë, shpëtimin dhe bashkimin me Ty, të cilën ua ke dhuruar robërve të tu të drejtë! Amin!..



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

Dielli dhe Hëna; dy kalendarë që rrotullohen në qiell, në bazë të të cilëve njeriu e llogarit kohët në jetën e tij.

Mirëpo, edhe njeriu vjen në këtë botë me kalendar. Jeta jonë është një kalendar mundësish i përbërë nga ditë të numëruara.

Për më tepër, është si një pëlhurë me metrazh të panjohur, që nuk dihet ku dhe kur do të mbarojë. Kjo është arsyeja pse është thelbësore që në çdo kohë të jesh i gatshëm për të vdekur.

Një dorë e padukshme heq çdo ditë nga një fletë prej kalendarit tonë dhe ia lë erërave të vdekjes. Çdo frymëmarrje na largon pak më shumë nga kjo botë dhe na afron një hap më tepër drejt varrit. Prandaj, duhet të mendojmë; sa përpiqemi për jetën tonë të përjetshme dhe sa përpiqemi për botën kalimtare që do të largohemi?..



Ata që e humbin kapitalin e jetës së tyre në shkujdesje, do të kërkojnë që t'u jepet afat në ahiret. Mirëpo, jeta është një mirësi që jepet një herë të vetme; jeta e kësaj bote nuk ka përsëritje. Nëse dështojmë në provimet e kësaj bote, ne mund t'i përsëritim ato. Por, mirësia e jetës nuk ka as përsëritje dhe as kompensim. Për më tepër, Allahu i Madhëruar çdo natë na jep gjumë, që konsiderohet vëllai i vdekjes dhe çdo mëngjes na bën të përjetojmë «ba'thu ba'de'l-meut», domethënë «ringjalljen pas vdekjes». Kështu, Zoti ynë hap një faqe të re në kalendarin e jetës çdo mëngjes dhe na jep një mundësi dhe afat të ri.

Ky sistem hyjnor duhet të na bëjë të mendojmë për keqardhjen e tmerrshme të atyre që duan të kthehen përsëri në këtë botë pas vdekjes, dhe kështu të shtojmë përpjekjet tona për të fituar botën tjetër.



Njëherë, i nderuari Hasan Basriu, Allahu e mëshiroftë, mori pjesë në një xhenaze. Pasi mbaroi ceremonia e varrimit, pyeti një person që kishte afër:

"-Vallë, a mendon ky i vdekur të kthehet pas në këtë botë që të shtojë punët e mira, dhikrin dhe kërkimin e faljes për gjynahet e veta?" Personi i thotë:

"-Po, sigurisht që mendon!" Pas kësaj, Hasan Basriu, tha:

"-Atëherë, po ne ç'kemi që nuk mendojmë si ky i vdekur?"



Çdo mëngjes kur zgjohemi, duhet ta fillojmë ditën duke medituar:

"Allahu i Madhërishëm më hapi një faqe tjetër nga kalendari i jetës. Ka shumë njerëz që dje kanë qenë gjallë dhe sot nuk janë. Nuk dihet nëse do të kem jetë edhe nesër. Vallë çfarë ka shkruar dje Kiramen Katibin në dosjen time të ahiretit? A do të jem në gjendje të jap llogari për atë faqe në ditën e gjykimit? Çfarë duhet të shkruaj sot në librin tim të veprave, të cilin do ta lexoj në Ditën e Gjykimit?»



Disa këshilla nga njerëzit e urtë, se si duhet të llogarisim veten në jetën e përditshme:

• Si e hape fletoren e jetës këtë mëngjes?

• A e falënderove Zotin tënd që të bekoi me një ditë të re?

• A e ke ripërtërirë devotshmërinë ndaj Zotit tënd në këtë ditë të re?

• A ke menduar ndonjëherë se mund të vdesësh sot; se mund të mbështillesh me qefin dhe të futesh në varr, që e gjithë familja, të afërmit dhe miqtë tuaj mund të të vendosin në varr e të kthehen, e ju të mbeteni në varr vetëm me besimin dhe veprat tuaja?..



Kur një njeri fiton pasuri të vlefshme si ari, ai përpiqet t'i dalë zot asaj atë deri në miligram. Pra, ai nuk çon dëm asnjë miligram të saj. Si blerësi ashtu edhe shitësi e peshojnë atë në peshoren më të saktë. Kështu, edhe koha është një mirësi jashtëzakonisht e çmuar që i është dhuruar njeriut. Prandaj, njeriu, aq sa e vlerëson çdo ditë, çdo orë dhe çdo minutë të saj në përputhje me vullnetin e Allahut, aq ia di edhe vlerën kësaj mirësie dhe e shënon atë në librin e tij të veprave si një fitim i përjetshëm.

Pasuria më e çmuar është koha. Atë nuk mund të japësh dhe nuk mund ta marrësh hua; të djeshmen nuk mund të kthesh pas çfarëdo pasurie të japësh. Siç thotë një fjalë e urtë: «Rubinët mund të blihen me kohë, por kohët nuk mund të blihen me rubinë».

A jemi të vetëdijshëm për rëndësinë dhe e vlerën e madhe të kohës? Allahu thotë në Kuran:

"Pasha kohën! Nuk ka dyshim njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm." (Asr, 1-3.)

Jeta është një kohë e dhënë vetëm për njëherë. Nëse të ikën nga dora njëherë, nuk të kthehet më. Edhe nëse njeriu e jep gjithë pasurinë e tij, ai nuk mund ta vonojë qoftë edhe për një sekondë kohën e vdekjes, të cilën e ka caktuar Allahu i Madhëruar. Prandaj, shpërdorimi më i madh, është ai i kohës!..

Allahu thotë në Kuran:

"Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) **do t'u duket se kanë qëndruar** (në Tokë) **veç një mbrëmje apo një mëngjes."** (Naziat, 46)

Le të mendojmë pak nëse Allahu do na kishte dhënë njëmijë vite jetë, pra nëse do të lindnim në vitin 1000 e do të jetonim në luks e mirësi deri në vitin 2000... Në fund, përsëri do të vdisnim! Pra sado gjatë të jetonim, jeta e përkohshme e dynjasë do të ishte vetëm një periudhë e shkurtër në krahasim me jetën e përjetshme të Ahiretit.



Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë përkohshmërinë dhe në çdo moment duhet të përpiqemi të jemi gati për vdekjen e përtej saj. Të mos harrojmë se; nëse do të ishim jetëgjatë si Nuhu عليه السلام, të pasur sa Sulejmani عليه السلام dhe të pashëm sa Jusufi عليه السلام, por të mos ishim të vetëdijshëm ndaj përkohshmërisë, do të thotë se ne jemi në humbje.



Osmani رضي الله عنه, ka thënë:

"Humbja më e madhe, është jeta e gjatë, në të cilën i zoti i saj nuk përgatitet për udhëtimin e Ahiretit."



Jeta, e cila është si një pikë uji përballë amshueshmërisë së ahiretit, është një e vërtetë aq sublime, sa nuk mund të kufizohet në distancën mes djepit dhe varrit. Një ditë, vdekja, të cilën të gjithë do ta shijojnë, do t'i japë fund të gjitha kënaqësive kalimtare, tundimeve dhe shkëlqimeve mashtruese. Pas kësaj pike, nuk është më e mundur të bësh asgjë për të ardhmen e përjetshme dhe të pendohesh për të kaluarën është e kotë.



Koha më e çmuar, është e tashmja midis së shkuarës dhe së ardhmes, sepse dosjet e së shkuarës janë mbyllur dhe e ardhmja nuk dihet.



Xhunejd Bagdadi ka thënë:

"Një ditë e kësaj bote, është më e vlefshme se njëmijë vjet të botës tjetër, sepse në një ditë të kësaj bote, ekziston mundësia për të fituar kënaqësinë hyjnore. Por në botën tjetër nuk ekziston një mundësi e tillë. Atje do të ketë vetëm dhënie llogarie."



Jeta i është dhënë njeriut vetëm njëherë, afati i saj është i kufizuar dhe i panjohur. Një moment i saj është i mjaftueshëm për ta dërguar njeriun në lumturinë e përjetshme ashtu siç është i mjaftueshëm për ta dërguar në një dënim të përhershëm. Besimtari ditën e sotme e vlerëson si një mirësi e madhe për të siguruar furnizimin për ditën e gjykimit; ai, në asnjë mënyrë nuk neglizhon punën e sotme duke e shtyrë për nesër.



Çdo gjallesë që lind është kandidat për të vdekur dhe çdo njeri është në moshë për të vdekur. Nëse shkojmë në një varrezë, do të shohim se atje gjenden shumë të vdekur në moshë më të re se ne.

Për këtë arsye, lënia e namazit dhe e haxhit për në moshën e pensionit dhe shtyrja e teubes, punëve të mira dhe devotshmërisë për një të nesërme të panjohur, bëhet shkak i një dështimi shumë të hidhur. Do të vijë një ditë, e cila nuk do të ketë të nesërme!



Osmani ﷺ, ka thënë:

"Bëni vepra të mira para se t'u vijë vdekja."



Omeri ﷺ, ka thënë:

"Mos e le punën e sotme për nesër! Nëse puna mbetet pa u kryer në kohën e duhur, është shumë e vështirë par ta plotësuar më vonë."



E tashmja, është rasti më i volitshëm për të bërë vepra të mira dhe për të përmirësuar gjendjen tonë duke u penduar. Të mos harrojmë se; edhe nëse ne mund jemi të pavëmendshëm ndaj kësaj mundësie, kur të vijë koha e vdekjes, Azraili nuk do të jetë i pavëmendshëm ndaj detyrës së tij, qoftë edhe për një moment.

Osmani ﷺ, ka thënë:

"O biri Ademit! Dije se; meleku i vdekjes të vjen vërdallë që kur ke ardhur në këtë botë. Madje duke kërcyer prej zverkut tënd, ai kap një tjetër. Kjo vazhdon për sa kohë ti të jesh në këtë botë. Mirëpo, do të vijë një ditë që ai do të kërcejë prej zverkut të të tjerëve e do të të kapë ty. Kjo do të ndodhë në një moment të papritur për ty. Prandaj përgatitu për frymën e fundit dhe përpiqu të mos zihesh i shkujdesur, sepse meleku i vdekjes nuk është kurrë i shkujdesur ndaj teje!..

O biri Ademit! Dije se; nëse ti je i shkujdesur ndaj vetes tënde dhe nuk përgatitesh për vdekjen, padyshim se askush nuk do t'i bëjë përgatitjet për ty. Mos e harro kurrë se ti patjetër do të dalësh para Allahut dhe për këtë arsye bëje vetë përgatitjen për veten, duke siguruar furnizim për të! Pra mos guxo t'ia lësh dikujt tjetër këtë punë!" (Ali el-muttaki, no: 42790.)

Pas frymës së fundit, tashmë ka përfunduar edhe testi i devotshmërisë. Ne nuk do të mund të bëjmë më asnjë vepër të mirë; as në varr, as në ditën e kiametit, e as në ditën e tubimit.

Siç shprehet edhe Aliu ﷺ:

"Sot është dita për të punuar, por nuk ka llogari. Kurse nesër ka llogari, por nuk ka mundësi për të vepruar."

Profeti ﷺ, thotë:

"Me vdekjen e njeriut ndërpritet edhe shpërblimi i të gjitha punëve, përveç tri punëve: sadakaja xharije, dituria e dobishme (që lë pas, si librat etj.) dhe fëmija i mirë që lë pas, e i cili lutet për të." (Muslimi, Vasijje 14.)



"Dija vlerën pesë gjërave para se të vijnë pesë të tjera:

-Vlerën e rinisë para pleqërisë,

-Vlerën e shëndetit para se të sëmuresh,

-Vlerën e pasurisë para se të varfërohesh,

-Vlerën e kohës së lirë para se të vijnë angazhimet,

-Vlerën e jetës para se të vijë vdekja." (Buhari, Rikak, 3)



Sipas një transmetimi, kur Iljasi عليه السلام, takohet me melekun që merr shpirtrat rrëqethet paksa. Për këtë arsye, Azraili عليه السلام, thotë:

"Ti je një profet o Iljas! U frikësove nga vdekja?"

Iljasi عليه السلام, përgjigjet:

"Jo, nuk u frikësova nga vdekja. Por u hidhërova nga fakti se më mbaroi jeta. Unë e kam kaluar jetën time duke bërë adhurime e duke ligjëruar dhe ndjeja ëmbëlsi të madhe prej të qenit rob i Allahut. Mirëpo tani do të jem peng në varr deri në ditën e kiametit. Për këtë arsye u pikëllova".



Amir ibn Abdilkajsi, prej brezit të tabiinëve, e ndjeu se po i afrohej vdekja dhe filloi të qante. Kur e pyetën: "Pse po qan?", - ai u përgjigj:

"Nuk po qaj as nga frika e vdekjes, e as për shkak të lakmisë për këtë botë. Unë po qaj sepse do të privohem nga agjërimi në ditët e nxehta dhe ngritja në adhurimet e natës." (Dhehebi, Sijer, IV, 19)



Është shumë e rëndësishme të jemi gjithmonë në gjendje dhikri, falënderimi dhe adhurimi, vetëm në këtë mënyrë mund të arrijmë të jemi afër Allahut. Çdo moment i harxhuar në fjalë, punë dhe vepra që të largojnë nga Allahu, është humbje për këtë botë dhe botën tjetër.



– Deri më sot, sa kohë prej jetës sonë ka kaluar në harmoni me pëlqimin e Allahut?

– A kemi kohë të humbura në televizion dhe internet, në lojëra dhe argëtime, në profesione të kota dhe të padobishme; veçanërisht në blerjet e panevojshme të bëra nga dashuria e modës dhe markave, në ceremonitë plot luks, shpërdorim dhe dukuri, dhe në vepra që nuk e kënaqin Allahun? Nëse po, çfarë të bëjmë për t'i kompensuar ato?

– Sa arrijmë ta përdorim kohën tonë të tanishme për të fituar jetën e përjetshme me pendim, istigfar, zikrullah, Kuran, vepra të mira, shërbim, mundim dhe sakrifica në rrugën e Allahut?

– Vallë, mes të gjitha shqetësimeve të panumërta, i sati në radhë është shqetësimi ynë për frymën e fundit, për varrin dhe botën tjetër?..



Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë se; në dynja kemi ardhur për Ahiretin. Ne duhet të meditojmë shpesh se:

- Për ku udhëtojnë gjithë këto krijesa?

- Për çfarë arsyeje ekziston kjo rrjedhë e ardhjes në dynja, e vajtjes në Ahiret, nga një anë me lindje, e nga ana tjetër me vdekje?

- Pse kemi ardhur në dynja, në pronën e kujt po jetojmë dhe për ku po udhëtojmë?

- Si do të jetë përfundimi ynë? A jemi gati për llogaridhënien në Mahsher?

- Çfarë kemi përgatitur sot për Ahiretin?..



Çdo udhëtim ka disa vështirësi. Por, njeriu ndjehet rehat në udhëtimin e tij aq sa ai është përgatitur për të. Po ne, a jemi gati për udhëtimin tonë të përjetësisë?

Të mos harrojmë se; për një besimtar, e gjithë jeta përbëhet nga përgatitja për të vdekur si mysliman.



Jeta e përkohshme, është përgatitje për jetën e përjetshme. Besimtari duhet të mbledhë adhurime të sinqerta, vepra të mira, përpjekje vetëmohuese, shërbime dhe virtyte që mund t'ia lehtësojnë atij kalimet e vështira të varrit dhe ahiretit dhe të cilat mund t'ia paraqesë Allahut të Madhëruar për të kërkuar mëshirën e Tij.



Nëse dëshirojmë që Allahu të na ndihmojë në momentet më të vështira të rrugëtimit të përjetshëm siç është fryma e fundit, varri dhe gjykimi në ditën e Kijametit, ne duhet të respektojmë me përpikëri urdhëresat dhe ndalesat hyjnore. Vetëm duke qenë të devotshëm mund të meritojmë ndihmën hyjnore.

Veçanërisht, duhet të përmendim, të adhurojmë dhe t'i lutemi Zotit në kohë mirëqenie dhe rehatie, në mënyrë që Allahu të na gjendet pranë me ndihmë e Tij në ditë të vështira.

I lutemi Allahut të Madhëruar që të na ruajë sinqeritetin tonë, sidomos në frymën e fundit. Në udhëtimin e jetës, kthesa e fundit në shtegun e exhelit, është shumë e fortë dhe e rrezikshme. Prandaj, gjëja më e rëndësishme, halli dhe shqetësimi ynë më i madh, duhet të jetë kalimi i suksesshëm i kësaj kthese. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"O besimtarë! Kijeni frikë Allahun, ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!" (Al-i Imran, 102.)

Çdo diplomë që njeriu merr në këtë botë, është e vlefshme për gjatë gjithë jetës së tij. Mirëpo, në jetën shpirtërore nuk funksionon kështu! Aty nuk ka një garanci të tillë, sepse ekziston rreziku që çdo gjendje dhe pozitë që fitohet të mund të humbet në çdo moment. Kurani Fisnik na jep shembull njerëzit si, Bel'am ibn Baura dhe Karuni, të cilët kanë rrëshqitur nga rruga e drejtë në momentet e fundit. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të jemi vigjilentë deri në frymën e fundit. Allahu thotë në Kuran:

"Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja)."
(el-Hixhr, 99)

Diploma më e rëndësishme që mund të marrë një besimtar në këtë botë të përkohshme, është diploma e besimit në frymën e fundit.

Të nderuarit Sufjan Theurit i ishte kërrusur beli që në moshë të re dhe atyre që e pyesnin për shkakun, u përgjigjej:

"Kisha një mësues prej të cilit merrja dituri. Kur i erdhi momenti i vdekjes, u përpoqa ta nxisja të shqiptonte shehadetin, por sado që u mundova ai nuk arriti ta thoshte. Dhe pikërisht kjo ndodhi ma kërrusi belin."

Nëse doni që frymën e fundit ta jepni me besim në Allah, duhet ta jetoni jetën në atë mënyrë (me besim). Në të kundërt, shpresa për të thënë Fjalën e Njësisë në çastin e fundit të jetës, ndërkohë që pjesa tjetër e jetës ju ka kaluar duke u marrë me gjëra të tjera, është vetëm një ëndërr boshe, sepse në Kuran thuhet:

"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë 'Ne besojmë', pa u vënë në provë?! (Ankebut, 2.)

Prandaj është e domosdoshme që besimi të zbukurohet me vepra të mira.

Në lutjet e tij Profeti ﷺ, i është përgjëruar shpesh Zotit:

"Allahu im, që i kthen zemrat nga një gjendje në tjetrën, mbama fort e të palëkundur zemrën në fenë tënde!" (Tirmidhi, Kader, 7/2140, Deavat 90, 124; Ahmed, IV, 182, VI, 91, 251, 315.)

Asnjë rob, përveç profetëve dhe atyre për të cilët profetët vetë kanë lajmëruar, nuk shpëton nga rreziku i lëkundjes së besimit. Shumë njerëz e harrojnë këtë dhe në këtë mënyrë bien në indiferentizëm ndaj jetës së botës tjetër. Ata shpresojnë në ndërmjetësime të kota. Ndërmjetësimi është i vërtetë, por ai është në dorë të Allahu, gjë e cila për ne është e panjohur.

Një nga sahabët që ishte i njohur për përkushtimin që kishte ndaj adhurimit, Uthman ibn Madh'un ﷺ, ndërroi jetë në qytetin e Medinës, në shtëpinë e një gruaje të quajtur Ummu'l-Ala. Kjo grua tha:

"O Uthman! Betohem se në këtë moment Allahu Teala po të gostitë me të mira."

Profeti i Allahut ﷺ, ndërhyri:

"Nga e di ti se Allahu është duke e gostitur?"

Gruaja tha:

"Betohem për Allahun që nuk e di!"

Profeti ﷺ, sqaroi:

"Shikoni! Uthmani ndërroi jetë. Unë personalisht për të shpresoj të mirën prej Allahut. Mirëpo, megjithëse jam Profet, as unë nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua dhe me ju".

Ummu'l Ala ka rrëfyer:

"Betohem për Allahun se pas kësaj ndodhie, nuk fola më në lidhje me askënd". (Buhari, Tabir, 27.)

Selman Farisiu ﷺ, kishte një karakter spikatës në Islam, të cilin e rrezatonte me të gjitha gjendjet e tij, saqë edhe Ensarët, edhe Muhaxhirët donin ta kishin të tyrin dhe thoshin:

"Selmani është prej nesh."

Pas kësaj përpjekje për ta bërë Selmanin ﷺ, pjesë të tyren, Profeti Muhamed ﷺ, ia fitoi zemrën duke e përgëzuar:

"Selmani është prej nesh, është pjesë e Ehli Bejtit." (Ahmed, II, 446-447; Hejthemi, VI, 130.)

Njëherë, dy persona shkuan tek sahabi Selman Farisiu ﷺ, dhe pasi e përshëndetën me selam, e pyetën:

"A je prej sahabëve të Profetit ﷺ?"

"Nuk e di!" - u përgjigj ai.

"Mos vallë kemi ardhur gabim?" - thanë ata duke ngurruar.

Pra, edhe pse ishte përgëzuar nga vetë Profeti ﷺ, me fjalët: *"Selmani është prej nesh, prej Ehl-i Bejtit"* dhe gëzonte virtyte të larta, ky sahab i bekuar nuk i quante asnjëherë të mjaftueshme përpjekjet e tij fetare. Madje, me zemrën që i dridhej midis ndjenjave të "frikës" dhe "shpresës", ai u shpreh me këto fjalë:

"Po, unë e kam parë të Dërguarin e Allahut ﷺ, dhe jam gjendur në tubimet e tij. Por sahabi i vërtet i të Dërguarit të Allahut ﷺ, është ai që arrin të hyjë së bashku me të në Xhenet." (Hejthemi, VIII, 40-41; Dhehebi, Sijer, I, 549.)

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Mirësia më e madhe arrihet kur vdes si mysliman."

Sado që të falënderojmë, është pak. Ne kemi ardhur në këtë botë me mirësinë e Islamit si manifestim i emrit hyjnor "el-Hadi". Mirëpo, nuk ka asnjë garanci se; edhe frymën tonë të fundit do të mund ta japim me këtë mirësi. Prandaj, një nga lutjet më të rëndësishme që nuk duhet ta harrojmë në këtë jetë të përkohshme të kësaj bote, e cila është kapitali i vetëm i shpëtimit të ahiretit tonë, është të dëshirojmë që ta mbyllim këtë jetë si myslimanë të mirë.

Ne duhet që çdo frymë të jetës sonë ta përjetojmë nën dritën e Kuranit dhe Sunetit, si fryma e fundit, dhe nuk duhet ta harrojmë duanë e Jusufit ﷺ, i cili përgjërohej:

"**O Zoti im! Ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar shpjegimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!"** (Jusuf, 101.)

Ubejdullah Ahrar tregon:

Një njeri i mirë pa në ëndërr Bahauddin Nakshibendin pas vdekjes së tij dhe e pyeti:

"Çfarë duhet të bëjmë për të arritur shpëtimin në botën e përjetshme?"

Ai iu përgjigj:

«–Bëni atë që duhet bërë në frymën e fundit!» Pra, ashtu siç është e nevojshme që në frymën e fundit të mendojmë plotësisht vetëm Allahun e Madhëruar, ashtu duhet të veprojmë edhe gjatë gjithë jetës!"

Gjithë jeta është e varur nga momenti i fundit. Gjendja shpirtërore e frymëve që japim dhe marrim, me adhurime, vepra dhe moral të bukur në jetën e kësaj bote, është si një letër për frymën tonë të fundit. Në të njëjtën kohë është edhe pasqyrë në këtë botë i gjendjes sonë në botën tjetër.

Në një hadith fisnik thuhet:

"Njeriu vdes ashtu siç ka jetuar dhe ringjallet ashtu siç ka vdekur." (Munavi, Fejzu'l-Kadir, V, 663.)

Jeta i ngjan pikave të ujit në një gotë, kthjelltësia e të cilit varet nga pastërtia e pikave të ujit. Hedhja e një pike uji të fundit në gotë bën që uji të derdhet. Kjo i ngjan pikërisht frymës së fundit.

I nderuari Behlul Dana shpesh qëndronte duke vëzhguar murin e anuar të një shtëpie të shkatërruar dhe gjithmonë meditonte për fundin e vet. Përsëri, një ditë, kur ishte ulur përpara shtëpisë së shkatërruar dhe po meditonte thellë, papritur muri rrëzohet. Kjo gjë e lumturoi pamasë Behlul Danën, aq sa lumturia mund të dallohej lehtë në fytyrën e tij. Njerëzit, të cilët e panë, nuk arritën ta kuptonin gëzimin e tij të jashtëzakonshëm dhe me kureshtje të madhe e pyetën për shkakun e këtij gëzimi.

"A nuk e patë, muri u shemb nga ana që ishte anuar!" -tha Behluli.

Të habitur nga kjo përgjigje, njerëzit e pyetën përsëri:

"Mirë, por çfarë ka për t'u çuditur këtu?!"

Atëherë Behlul Dana tha:

"Meqenëse në këtë botë çdo gjë rrëzohet në anën që anon, kur të vdes edhe unë do të shkoj tek Allahu inshAllah, sepse edhe animi im është kah Ai. O njerëz! Të mundohemi ta shtojmë animin tonë nga Zoti i gjithësisë me anë të rukuve dhe sexhdeve, që të mos rrëzohemi në ndonjë anë tjetër!.."

Ata që jetojnë me shqetësimin për botën tjetër janë pikërisht ata që do të gëzohen në frymën e fundit, në varr, në ditën e gjykimit dhe në urën e siratit.

Një besimtar duhet të meditojë mbi shenjat e përkohshmërisë që janë gdhendur në të gjithë jetën dhe universin. Ai duhet të jetojë me shqetësimin se mirësia e jetës mund të përfundojë në çdo moment. Pra, ai duhet të jetë i përgatitur. Kështu, ai duhet të eliminojë gjendjen e frikshme të vdekjes me takva dhe ta zbukurojë vdekjen...



Vdekja do të dalë para gjithsecilit sipas gjendjes shpirtërore. Ndërsa për besimtarin do të shfaqet si një atmosferë e qetë festive, për mosbesimtarin do të jetë një udhëtim gjithë dënim i mbushur me makth...



Ebu Hazim ka thënë:

"*Vepërmirët do të dalin të lumtur e të qetë si personat që kthehen në familjen e tyre pas një kurbeti të gjatë. Kurse ata që kanë qenë robër të epsheve të tyre, do të dalin para Allahut si skllavi që kapet duke u arratisur dhe sillet para pronarit.*"

Nuk duhet të harrojmë se; vdekja, e cila është akti përmbyllës i teatrit të jetës, është si një pasqyrë ku të gjithë do të shohin fundin e tyre të përjetshëm. Prandaj sot, ne nuk duhet ta nxijmë pasqyrën e frymës së fundit me njollat e gjynaheve, indiferencës dhe të këqijave, me qëllim që vdekja të mos na vijë si një fatkeqësi, por si një gëzim takimi.



Ebu Hazim ka thënë:

"Gjeji dhe braktisi veprat, për shkak të të cilave vdekja të duket e papëlqyeshme! Kështu ato nuk do mund të të bëjnë dëm, kurdo që të vdesësh."



Të urtët kanë thënë:

مُوتُوا قَبْلَ اَنْ تَمُوتُوا

"Vdisni para se të vdisni!", duke nënkuptuar vdekjen e dëshirave para se të vijë vdekja e vërtetë.

Vdekja sipas caktimit të Zotit nuk është e njohur për ne se, ku, kur dhe si do të vijë. Për këtë arsye, është e domosdoshme që zemrat të brumosen me enigmën që fshihet në shprehjen "vdisni para se të vdisni" dhe në çdo moment duhet të jeni gati për të shkuar tek Zoti. Në të kundërt, fryma e fundit bëhet një frymë e mërzitshme, e mbushur plot britma "Për ku kështu!"

Allahu në Kuran thotë:

"Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër)**: ja; kjo është ajo së cilës përpiqesh t'i ikje."** (Kaf, 19.)

Njëherë, një sahab e pyet të Dërguarin e Allahut ﷺ:

"Cili prej besimtarëve është më i mençur o i Dërguari i Allahut?"

Profeti ﷺ, u përgjigj:

"Ata që e kujtojnë shpesh vdekjen dhe përgatiten mirë për kohën që e pason vdekjen. Ja pra, ata janë njerëzit më të mençur..." (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 31)

Dielli i lumturisë së përjetshme lind në horizontet e atyre që dinë të jetojnë duke iu përkushtuar me zemër udhëzimit të fjalëve dhe shpalljeve hyjnore dhe emigrojnë në Ahiret me ndërgjegje të qetë.

Osmani ﷺ, ka thënë:

"Njeriu më i mençur është ai, i cili i kërkon llogari vetvetes, që arrin ta menaxhojë mirë atë, që punon për jetën e përtejme dhe që do të meritojë dritën e Allahut në errësirën e jetës së varrit."

Në këtë botë kalimtare, nuk mund të ketë një fatkeqësi më të madhe sa humbja e jetës në moçalin e mosbesimit, e trupit në imoralitet dhe e pasurisë në padrejtësi. Njeri i zgjuar, është ai që; në korsinë e jetës së vet arrin të lërë vepra të mira, të cilat janë shfaqje e besimit, adhurimit, moralit dhe virtytit; vepra me shpërblim të pandërprerë dhe kujtime të mira.

Është e sigurt se; një natë e errët e kësaj bote, e kaluar duke bërë një jetë të privuar nga drita e besimit dhe e adhurimeve të kryera me frymëzim shpirtëror, me të gjitha llojet e argëtimeve, çmendurive, mizorive dhe padrejtësive, nuk do të mund sjellë kurrë një mëngjes të ndritshëm të përjetësisë. Dëshirat rozë të jetës egoiste të kësaj bote, tregojnë zbehtësinë e fundit që po vjen, ndërsa gajasjet moskokëçarëse, janë paralajmërues të kërcitjeve të hapave të xhehenemit.

Ali ﷺ, ka thënë:

"Nuk mund të mbledhësh buqeta trëndafilash nga ara ku mbillen ferra!"

Ashtu si njeriu është i krijuar nga toka, edhe bota shpirtërore është si toka për sa i përket kultivimit. Çfarëdo që të mbjellë për ahiretin në këtë botë, njeriu do ta gjejë në botën tjetër.

Rumiu thotë:

"A të ka ndodhur ndonjëherë që të mbjellësh grurë dhe të mbijë elb?

Nëse mbjell ferra dhe kaktus, ferra dhe kaktus do të korrësh. Prandaj duhet ta shfrytëzojmë kohën në mënyrën më të mirë, duke bërë vepra të mira, sidomos gjatë rinisë, në mënyrë që në botën tjetër të korrim shpërblime."



Mevlana ka thënë:

"Çfarë ke, çfarë ke fituar? Çfarë perle ke nxjerrë prej fundit të detit? Kjo do të shihet ditën e vdekjes!"



Imam Rabbani ka thënë:

"Vdekja nuk është fatkeqësi, fatkeqësia më e madhe është të mos dish çfarë do të ndodhë pas vdekjes."



"Vdekja është një portë pas së cilës është një lindje. Ashtu si shikon perëndimin e diellit, medito edhe lindjen e tij përsëri!"



Rumiu ka thënë:

"A mund të thuhet për një farë që bie në tokë se ka "vdekur"?

Ashtu si lindjet duken fenomene normale, edhe lindja në ditën e gjykimit do të jetë shumë normale."



"Dije se vdekja është dhimbja e lindjes së shpirtit në një botë tjetër. Në lidhje me këtë botë të përkohshme, emri i saj është «vdek-

je», por në raport me botën tjetër të përjetshme emri i saj është «lindje»!..”



Vdekja është realitet. Çdo i përkohshëm do ta shijojë patjetër atë kur të përfundojë frymëmarrjet e tij të numëruara. Të jetosh jetën e kësaj bote pa e njohur realitetin e varrit, është po aq absurde sa të mendosh ditën pa mbrëmje.



Nuk është parë asnjëherë që; kush frikësohet nga vdekja të shpëtojë. Ashtu siç frika nuk ka ndikim në afatin e vdekjes, ashtu nuk ka dobi as frika e sëmurë, e cila në vend që ta inkurajojë, e bën më pasiv robin. Detyra e robit, nuk është që t’i ikë vdekjes, por të përpiqet të jetë gati për ta takuar atë në çdo moment.



Njeriu që harron përkohshmërinë e dynjasë, faktin se jeta e vërtetë është ajo e ahiretit, përgjegjësitë ndaj Zotit të tij, lutjen, pendimi, shkurt; robërinë e tij ndaj Zotit, bëhet mendjeshkurtër dhe fillon të kërkojë lumturinë në tregun e mjerimit. Në vend që të përgatitet për vdekjen dhe përtej saj, që është e ardhmja absolute e çdo njeriu, ai merr përsipër të shpëtojë nga vdekja.



Indiferentizmi i vërtetë, është të mos jesh i vetëdijshëm që çdo ditë po afrohesh drejt vdekjes, duke menduar se po i largohesh të panjohurës. Në caktimin hyjnor nuk ka as vonesë as nxitim; e njëjta gjë vlen edhe për vdekjen.



Nuk duhet të harrojmë se; as në këtë botë nuk ka ndonjë vend apo kohë për t’i shpëtuar vdekjes, as në varr nuk ka ndonjë mundësi për t’u kthyer pas, dhe as në ditën e kiametit nuk ka ndonjë vend ku mund të strehohesh për t’u mbrojtur nga tmerri i saj.

Allahu i Madhëruar, si strehën e vetme të shpëtimit, na tregon Veten e Tij duke urdhëruar: **"Andaj ikni drejt Allahut!.."** (Dharijat, 50.)



Një jetë që nuk ndriçohet nga meditimi rreth vdekjes, është si një natë e errët fatkeqësie. Nëse zemrat nuk thellohen në misterin e «vdekjes», nuk mund të arrihet as sekreti i botës së ardhshme. Ndërsa, të ikësh nga vdekja, të lodhesh kot, të përpiqesh ta shpërfillësh dhe ta harrosh atë, është budallallëku më i madh.



Në momentin e vdekjes, i gjithë njerëzimi, në mënyrë të pavullnetshme do t'i nënshtrohet vullnetit hyjnor dhe do të dorëzohet. As tiranët dhe mendjemëdhenjtë që tërë jetën kanë kundërshtuar urdhrat hyjnorë me kokëfortësi, nuk do të mund të kundërshtojnë aspak në atë moment. Kështu, njeriu, të cilit tashmë i janë hequr perdet e panumërta të shkujdesjes, vetëm në atë moment do të jetë në gjendje të kuptojë në mënyrë absolute se; sovraniteti i vërtetë në univers i takon vetëm Allahut. Por asgjë s'do të ketë dobi!..



Qëllimi i dërgimit tonë në këtë botë, nuk është që t'i ikim vdekjes apo të mashtrojmë veten me iluzionin e një bote pa ahiret, por për të ringjallur çdo frymëmarrje tonë me vetëdijen e përgatitjes për frymën e fundit, me vepra të mira. Jo për t'i përgatitur varrin vetes, por për të përgatitur veten për varrin.



Njeriu, herë pas here kalon kohë të vështira në rrugëtimin e kësaj jete. Në këto kohë, ai kërkon një dorë për ta ndihmuar, një litar shpëtimi apo një dritë për t'i ndriçuar rrugën. Dhe, momenti më i vështirë i njerëzve në këtë botë, është fryma e fun-

dit, kur ata i thonë lamtumirë jetës. Ata që kanë mundur të përgatiten në kohë për atë moment, shijojnë kënaqësinë e kthimit te Zoti i tyre me qetësinë e një nate festive. Në të kundërtën, ata që shpërdorojnë kapitalin e tyre jetësor në kërkim të dëshirave të tyre epshore, kur të vijë koha, do të shkatërrohen me një pendesë e papërshkrueshme.

I Dërguari i Allahut, duke dashur të na tërheqë vëmendjen neve, umetit të tij, ka thënë: *"Nuk do të ketë asnjë person që do të vdesë, e nuk do të ndjehet pishman."*

Kur sahabët e pyetën: *"Për çfarë do të bëhet pishman o i Dërguar i Allahut?"*, ai u përgjigj:

"Nëse (i vdekuri) është njeri i mirë, do të bëhet pishman se nuk ka vazhduar dot të bëjë më tepër mirësi (duke përfituar më shumë prej mirësisë të jetës). Por, nëse (i vdekuri) është njeri i keq, ai do të bëhet pishman se përse nuk ka hequr dorë nga veprat e këqija dhe të përmirësojë veten." (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403.)

Edhe vepërmirët do të bëhen pishman që nuk kanë bërë më shumë vepra të mira. Imagjino si do të jetë gjendja e indiferentëve! Fjalët nuk mjaftojnë për të shprehur gjendjen e tyre.

"Njerëzit janë në gjumë, kur të vdesin do të zgjohen..." (Keshfu'l-Hafa, II, 312)

Vdekja është një kiamet individual. Të zgjohemi para këtij kiameti në mënyrë që të mos jemi prej atyre që zgjohen në fatkeqësinë e madhe.

Fryma e fundit është si një pasqyrë pa avull, pa gërvishtje dhe pa njolla. Në këtë pasqyrë, çdo njeri sheh shumë qartë gjithë jetën e tij me bukuritë dhe gjërat e shëmtuara. Në atë moment, asnjë perde kundërshtimi dhe indiference nuk t'i pengon sytë dhe veshët. Përkundrazi, ato largohen të gjitha dhe çdo lloj rrëfimi e përfshin mendjen dhe shpirtin në pendim. Prandaj, duhet të bëjmë kujdes që; pasqyra e parë ku e shohim jetën duke medituar, të mos jetë fryma jonë e fundit!..

Duhen shfrytëzuar të gjitha mundësitë sa jemi në jetë, në mënyrë që të mos bëhemi pishman kur të vijë caktimi hyjnor.

Ata që harxhojnë kapitalin e jetës së tyre vetëm për të fituar disa mirësi në këtë botë kalimtare, do të pësojnë një falimentim katastrofik në jetën e përjetshme. I ndjeri Nexhip Fazëll, si paralajmërim nga rënia në këtë zhgënjim, shprehet:

«*Argjendari i kujdesshëm, qep një qese tjetër për veten, dhe aty mbledh atë monedhë që i bën punë edhe në varr!..*

Çdo njeri, pas frymës së tij të fundit, do të dojë të rrahë gjunjët i penduar duke thënë: "Ah sikur të mos e kisha bërë këtë gabim; ah sikur ta kisha bërë atë të mirë...". Por fatkeqësisht!.. Tashmë, atij nuk i kanë mbetur më as duar, e as gjunjë!..

Mjerë për ata që i kuptojnë këto të vërteta vetëm atë ditë! Lum për ata që arrijnë t'i kuptojnë sot dhe angazhohen me përgatitjet për botën tjetër!..

Shko në varreza, dije vlerën e kohës, duke menduar se pendimi pasi të kesh humbur mirësinë e jetës nuk ka asnjë vlerë! Lexo një Fatiha për të vdekurit dhe përpiqu ta shfrytëzosh këtë kohë të mbetur duke falënderuar Zotin tënd!



Aliu ﷺ, ka thënë:

"Islami të mjafton si mirësi e kësaj bote! Adhurimet dhe bindja ndaj Allahut të mjaftojnë si angazhim! Ndërsa vdekja të mjafton si mësim!"



"A nuk është qefini rroba më origjinale e tregut të jetës, e cila anulon të gjitha shitblerjet e përkohshme të kësaj bote?"



Resulullahu ﷺ, ka thënë:

"Kujtojeni shpesh vdekjen; ajo që i shkatërron me rrënjë të gjitha kënaqësitë." (Tirmidhi, Zuhd, 4/2307.)



Vdekja nuk ka ndonjë gjuhë të veçantë. Por, kushedi se sa kuptime madhështore ka groposur ajo brenda heshtjes së thellë! Vdekja është një mësim pafjalë për njerëzit e ndjeshëm dhe të zgjuar nga indiferenca. Ajo u jep atyre leksione dhe u tregon të vërtetat me gjuhën e saj të natyrshme, në një mënyrë më të përsosur se gjuhët më elokuente.



Përgjigjen më kuptimplotë të pyetjes "çfarë është jeta?", e jep çdo gur varri, i cili është strukur në heshtjen e vdekjes. Ata janë këshillues të flaktë që flasin me gjuhën e gjendjes së tyre. Përgjigjet që vijnë nga bota, ndaj retorikës këshilluese të vdekjes,

janë vetëm lotët dhe lemza e thatë. Është një gëzim i madh të arrish të marrësh mësim nga gurët e heshtur të varreve.

Kur shohim një xhenaze, duhet të mendojmë; "Sot, në atë arkivol mund të isha unë". Më pas duhet të fillojmë të bëjmë llogarinë e jetës sonë në mënyrë të detajuar, duke menduar se trajtimi që po i bëhet xhenazes që sapo pamë, një ditë do të na bëhet edhe neve...

Aliu ﷺ, i vizitonte shumë shpesh varrezat. Një ditë atij i thanë:

"- Si është halli yt o Ali? Je bërë komshi i varrezave?!"

Ai u dha këtë përgjigje:

"- Kam parë që ata janë komshinj besnikë, nuk na bëjnë asnjë të keqe dhe na kujtojnë vazhdimisht ahiretin!" (Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VII, 102/34514.)

Meditimi rreth vdekjes sjell gjallëri shpirtërore në zemër. Kjo, sepse, një besimtar që jeton me vetëdijen se një ditë do të vdesë:

- Ruhet nga sjellja sikur është i përjetshëm në këtë bujtinë të përkohshme.

- E di se një ditë do të japë llogari për çdo gjendje dhe sjellje të tij.

- Nuk zhytet në gjynahe dhe vepra të papëlqyeshme, nuk e cenon vëllain e fesë, nuk ngul gjemba në asnjë zemër, nuk thyen qoftë edhe një degë të njomë pa nevojë, e madje nuk e vret as një milingonë padrejtësisht.

- Nuk i shkelë kurrë me vetëdije kufijtë hyjnorë dhe asnjëherë nuk i neglizhon detyrat e tij të devotshmërisë.

- Ia di vlerën çdo frymëmarrjeje dhe nuk e harxhon kapitalin e jetës së tij me gjëra të kota.



"Meditimi i vdekjes" zë një vend të rëndësishëm në edukimin mistik. Të mos e harrosh përkohshmërinë dhe të mendosh se; në këtë botë, ku i kemi hapur sytë duke qenë të zhveshur, do të jetojmë aq sa na është caktuar nga Zoti, e më pas do të përcillemi në botën tjetër të mbështjellë me qefin, është ilaçi më efektiv për të mbrojtur zemrën nga pushtimi i dëshirave egoiste.



Për të mos u privuar nga horizonti i zemrës që sjell meditimi i vdekjes, të parët tanë i ndërtuan varrezat brenda qytetit dhe përballë xhamive.

Atje, ata medituan për të ardhmen e tyre të vërtetë dhe e kuptuan me gjithë shpirt përkohshmërinë e tyre. Ata u ruajtën nga vetëmashtrimi i rinisë, shëndetit e fuqisë dhe shmangën shkujdesjen nga mendimi se janë të përhershëm në këtë botë, u larguan nga gjërat e kota dhe të padobishme dhe bënë përpjekje për të siguruar sa më shpejt kapitalin e pastër të jetës së përjetshme. Kështu, ata e jetuan jetën e kësaj bote në atmosferën e botës tjetër.

Në injorancën e sotme moderne, dëshirohet që njerëzit të harrojnë vdekjen, varrin dhe ahiretin me arsyetimin se ua prishin humorin. Prandaj, pandehet se paqja dhe lumturia arrihet duke i nxjerrë këto çështje nga jeta. Kështu, gëzimi kërkohet në dehjen e shkujdesjes, ndërsa lumturia në pazarin e mjerimit.



Nëse shohim prej dritares së botës tjetër, do të kuptojmë se mirëqenia dhe rehatia e kësaj bote nuk janë gjë tjetër, veçse përfitime të vogla.

Prandaj çështjet që duhet të kemi kujdes në këtë botë janë:

- Si do të jetë fryma e fundit në rrugëtimin e përjetësisë.

- Sa të gatshëm jemi në dhënien e llogarisë së varrit.

- A do të jetë varri një bahçe e Xhenetit apo një greminë e Xhehenemit.

Një nga faktet që duhet ta përkujtojmë vazhdimisht, është se të gjithë jemi nxënësit e shkollës së kësaj bote, e cila është vendi i sprovës hyjnore. Arsimimi ynë në devotshmëri, do të marrë fund me certifikatën e vdekjes, pas së cilës do të varrosemi në gjirin e tokës së bashku me punët tona..

Përballimi i dënimit të varrit dhe xhehenemit, është i pamundur. Prandaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, lutej në këtë mënyrë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِن عَذَابِ جَهَنَّمَ، وَمِنْ عَذَابِ القَبْرِ،

وَمِنْ فِتْنَةِ المَحْيَا وَالْمَمَاتِ، وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ المَسِيحِ الدَّجَّالِ

"O Allah! Kërkoj strehim tek Ti prej dënimit të Xhehenemit dhe dënimit të varrit, prej sprovave të jetës, të vdekjes dhe mesihut (të rremë) Dexhxhallit!" (Buhari, Xhenaiz, 88; Muslim, Mesaxhid, 128-134.)

Prandaj duhet të distancohemi nga çdo vepër e keqe që është shkak për dënimin hyjnor. Duhet të mbrohemi nga dëshirat dhe cytjet e shejtanit siç ruhemi nga zjarri.

Dita e Kiametit, është një ditë e tmerrshme që, edhe fëmijët e pafajshëm mund t'i kthejë në pleq të thinjur. Një ditë, kur sytë e shtypësve do të dalin nga zgavrat e tyre dhe zemrat e sytë e tyre do të shastisen. Një ditë e vështirë dhe e mundimshme, kur gratë gjidhënëse do të harrojnë fëmijët e tyre, gratë shtatzëna do të abortojnë foshnjat e tyre, njerëzit do të dehen nga tmerri dhe do të kërkojnë një vend për të shpëtuar...

Për më tepër, ajo ditë është një ditë e pafundme, pa të nesërme!..

Atë ditë, nëse nuk arrin mëshira e Allahut, do të ketë mundime të dhimbshme, fatkeqësi që do ta shkatërrojnë njeriut!..

Prandaj njeriu, frikën dhe shqetësimet e vërteta në zemrën e tij, duhet t'i orientojë për tek ajo ditë. Në vend që të derdhë lot për mundimet dhe vuajtjet e përkohshme që i bien në këtë botë kalimtare, duhet të shqetësohet për ngjarjet që mund të shkatërrojnë jetën e tij të përjetshme.

Imam Gazaliu rrëfen këtë ngjarje:

Një burrë, tek po e shihte vëllain e tij të gajasej së qeshuri, i tha:

- A të ka ardhur ndonjë lajm i mirë në lidhje më Ahiretin, je i sigurt se do të shpëtosh nga xhehenemi?

Pasi mori përgjigjen "Jo", ai i tha:

- Atëherë, si mund të qeshësh kështu?

Sëmundja më e rëndë shpirtërore është indiferenca. Ajo e mashtron njeriun, duke bërë t'i duket e përjetshme lumturia apo gëzimi që po përjeton. E shtyn njeriun drejt harresës së stacioneve të vështira që e presin, si vdekja, ringjallja, llogaria, ura e siratit etj. Kjo veçori e përgjithshme njerëzore, në Kuran është shprehur kështu:

"...Dhe po qeshni e nuk po qani? Madje, jeni edhe të shkujdesur!" (Nexhm, 60-61.)



Të qeshësh e të gëzohesh jashtë mase për shkak të kënaqësive të kësaj bote, e bën njeriun të harrojë gjërat e vështira që e presin përpara, si vdekjen, varrin, ringjalljen, llogarinë dhe urën e siratit. Këto sjellje i fshijnë ndjenjat në zemër dhe e zhdukin frymëzimin shpirtëror.



Muhamed bin Vasi, ka thënë:

"Aq sa është i çuditshëm të qarët e një personi që ka fituar xhenetin, aq është e habitshme edhe e qeshura deri në gajasje e një personi, që akoma nuk e di se ku do të jetë fundi i tij (në xhenet apo në xhehnem)." (Ihja, III, 289.)



Kjo botë, është një vend sprove. Një han me dy porta, që nga njëra anë mbushet, nga ana tjetër zbrazet. Pasi edhe personi i fundit të ketë kaluar testin e tij, funksioni i kësaj bote të vdekshme do të përfundojë, dhe do të vijë Dita e Kiametit. Më pas, Ditën e Gjykimit do të lexojmë diplomën e edukimit tonë në këtë botë.

E gjithë skena e sprovës së jetës sonë, do të na shfaqet përsëri që ta shohim deri në detajet më të vogla. Atëherë do të dalë në shesh gjithçka. Aty do të përjetojmë ndjenjë të thellë turpi për shkak të të metave tona në devotshmëri, falënderim, mirënjohje dhe përpjekje përballë mirësive të panumërta që na ka dhënë Allahu.



Profeti ﷺ thotë:

"Ditën e Kiametit (gjykimit) asnjë rob nuk do të hedhë qoftë

edhe një hap, pa u pyetur se ku e ka shpenzuar jetën, çfarë ka bërë me diturinë e vet, si e ka fituar dhe si e ka shpenzuar pasurinë dhe ku e ka mplakur trupin e tij!" (Tirmidhi, Kiamet, 1/2417.)

Ditën e Kiametit, kur të na jepet libri ynë i veprave, në atë ekran të botës tjetër, do të shikojmë edhe gabimet tona për të cilat kemi qenë të vetëdijshëm, edhe ato për të cilat nuk kemi qenë të vetëdijshëm:

Ndoshta kemi bërë thashetheme, kemi parë shtrembër një vëlla, kemi tallur dikë me shenja, kemi shkundur një tapet nga dritarja e shtëpisë sonë dhe kemi shqetësuar fqinjin e katit të poshtëm ose një person që kalonte pranë shtëpisë sonë. Mbase jemi treguar moskokëçarës ndaj urisë së një qeni apo maceje në derën tonë. Mbase kemi bërë parakalime të gabuara për të ecur përpara në trafik, apo kemi kaluar shpejt mbi një pellg uji dhe kemi lagur dikë në trotuar. Mbase kemi rrezikuar jetën e njerëzve duke nxituar kundër rregullave, etj. Për të mos u përballuar me koston e rëndë të të gjitha gjynaheve tona për të cilat kemi qenë ose jo të vetëdijshëm, duhet të pendohemi dhe të kërkojmë falje. Kjo, sepse edhe pse nuk jemi të vetëdijshëm për disa nga gabimet tona, ato nuk i shpëtojnë zbulimit të melekëve Kiraman Katibin. Edhe nëse ne harrojmë, libri i veprave nuk harron.

Në ditën e gjykimit, dëshmitari kryesor në favor ose kundër, do të jetë vetë personi. Allahu thotë në Kuran:

"**Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes**!" (Isra, 14.)

"Sot Ne do t'ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë." (JaSin, 65.)

“Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë. Ata do t’u thonë lëkurëve të veta: «Pse dëshmuat kundër nesh?» - e ato do të përgjigjen: «Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni!»”. (Fussilet, 20-21.)

Në këtë botë kemi vetëm një gjuhë, kurse në Ditën e Gjykimit do të flasin të gjitha gjymtyrët e trupit, madje edhe vendet do të dëshmojnë në favor ose kundra nesh. Atë ditë, libri do të na shfaqet përpara me të gjitha detajet. Në këtë botë çdo gjë është e regjistruar... Melekët Kiramen Katibin regjistrojnë çdo moment...

Fajtorët në këtë botë mund të arrijnë të fshehin fajet dhe hilet që kanë bërë gjatë jetës, por në ditën e gjykimit nuk do të kenë asnjë mundësi të tillë përballë gjykimit suprem. Atë ditë të gjithë sekretet dhe të fshehtat do të dalin në shesh, askush nuk mund të fshehë gjë sepse kundër atyre atë ditë do të dëshmojnë edhe gjymtyrët e tyre.

Omeri ﷺ, ka thënë:

“Llogariteni vetveten para se të llogariteni. Zbukurohuni (me vepra të bukura) për audicionin tuaj më të madh (për ditën kur të dilni para Allahut)! Padyshim se për atë që e ka llogaritur vetveten në jetën e kësaj bote, llogaridhënia do të jetë e lehtë në Ditën e Gjykimit.” (Tirmidhi, Kiamet, 25/2459.)

Allahu thotë në Kuran:

"Atje, ata do të thërrasin: «O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë!» (Atyre do t'u thuhet):

«Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)**?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni** (dënimin)**! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi»!"** (Fatir, 37.)

Ky është një ajet shumë mësimdhënës, mbi të cilin duhet të qëndrojmë e të meditojmë seriozisht. Edhe pse jeta e kësaj bote të përkohshme është vetëm një çast shumë i shkurtër në krahasim me Ahiretin, për ata që dëshirojnë të mendojnë e të marrin mësim, është një afat kohor më se i mjaftueshëm.

Në një hadith profetik thuhet:

"Pendimi më i rëndë është ai në ditën e gjykimit." (Sujuti, Xhamius Sagir, nr 3164.)

Banorët e xhenetit do të pyesin banorët e xhehenemit:

"**Çfarë ju ka sjellë në Sekar?"** (Muddeththir, 42.)

Ata do t'u përgjigjen:

"- Nuk ishim nga ata që falnin namaz

- dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit.

- Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët

- dhe mohonim Ditën e Llogarisë, derisa na erdhi vdekja." (Muddeththir, 43-47.)

Kurani e përshkruan në këtë mënyrë pendesën dhe gjendjen e mjerueshme të mosbesimtarëve në ditën e gjykimit:

"«Mjerë ne! Ah sikur t'i ishim bindur Allahut dhe Profetit!»" (Ahzab, 66.)"

"Ai do të thotë: «Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!»" (Fexhr, 24.)

"Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!"

"Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës." (Furkan, 28.)

Në ditën e gjykimit, edhe kafshët do të ringjallen për t'u vendosur drejtësia në vend. Pasi të vendoset drejtësia, ato do të kthehen përsëri në dhe. Kur të shikojnë këtë gjendje, jobesimtarët do të luten të ishin në vend të kafshëve, e do të thonë:

"Ah, sikur të isha dhe!" (Nebe'e, 40.)

Që të mos përballemi me një gjendje të tillë në ditën e gjykimit, duhet të respektojmë urdhëresat dhe ndalesat hyjnore.

"Veprat tuaja u tregohen të vdekurve prej të afërmve dhe farefisit tuaj. Nëse veprat tuaja janë të mira, ata gëzohen. Por nëse nuk janë të mira, ata luten duke thënë: «O Allah! Mos ua merr shpirtin pa i udhëzuar edhe ata, ashtu siç na udhëzove neve!»" (Ahmed, III, 164; Hakim, Mustedrek, IV, 342/7849.)

Allahu thotë në Kuran:

"O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se çfarë ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!" (Hashr, 18.)

Në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar përdor fjalën "nesër" kur flet për Ahiretin. Zoti ynë, i Cili nuk ndikohet nga koha dhe hapësira, në lidhje me vaktin e Kiametit dhe Ahiretit flet për një kohë që është e afërt sa e "nesërmja", ndërkaq mohuesve u duket sikur s'do të vijë kurrë, ndërsa indiferentëve u duket larg.

Allahu thotë në Kuran:

"**Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara. Atë Ditë do të ketë** (edhe) **fytyra të pluhurosura, që do t'i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët**."
(Abese, 38-42.)

Një gjë nuk duhet harruar kurrë; ajo që do të përcaktojë gjendjen e pamjes dhe fytyrës sonë nesër në ditën e Kiametit, është niveli shpirtëror i zemrës sonë në këtë botë.

Ajo që do të na ndihmojë në rrugën e përjetësisë, nuk është bukuria trupore, forca fizike dhe pasuria materiale, por besimi dhe veprat e mira. Prandaj duhet të mendojmë mbi:

- Çfarë kemi siguruar për udhëtimin e përjetësisë?

- Sa kemi sakrifikuar për atë ditë?

- A jemi në gjendje që; kur të kalojmë urën e siratit t'i lutemi Zotit: O Allah! Më mbro nga rënia, sepse kam bërë vepra të mira. Apo ne jemi duke dërguar atje vetëm mëkate dhe faje.

Çdo person që largohet nga kjo botë për në botën tjetër e dërgon atje prej kësaj bote edhe lumturinë dhe mjerimin e vet.

Ata që nuk mbjellin farën e punëve të mira në arën e kësaj bote, nuk do të mund të korrin prodhimin e lumturisë në botën tjetër. Ata do të privohen nga shpërblimet në botën tjetër. Ata që mbjellin farat e mëkateve nuk do të marrin gjë tjetër përveç dënimit si shpërblim.



Zjarri në Xhehenem ndizet me cilësitë dhe veprat e këqija të njerëzve, kurse kopshtet e Xhenetit lulëzojnë me besimin, moralin dhe virtytet e larta të njerëzve.



Nëse bie tërmet ose shpërthen ndonjë bombë, ne menjëherë themi: "kërciti kiameti". Ndërsa Kiameti i vërtetë, ai kur yjet do të derdhen, qielli do të mbështillet si letër e malet do të bëhen pluhur, është një shpërthim aq i madh, sa mendja e njeriut nuk arrin ta konceptojë... Ajo është një ditë kur foshnjat do të thinjen nga frika, gratë shtatzëna do të abortojnë, sytë do të dalin nga vendi dhe njerëzit do të bëhen si të dehur pa pirë. Lidhur me robërit fatlumë që do të jenë të sigurt dhe nën mbrojtjen hyjnore nga hidhërimi dhe frika e një ditë të tillë të tmerrshme, në Kuran urdhërohet:

"Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar. (Të tillë janë) **ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut)."** (Junus, 62-63.)



Fizikisht, njeriu është i destinuar të zhduket pas vdekjes. Ajo që jeton prej tij, është personaliteti dhe karakteri i mirë që është

së pas, i cili nuk harrohet as pas vdekjes. Prandaj, njerëzit me personalitet dhe karakter të lartë vazhdojnë të jetojnë në zemrat e njerëzve.

Aliu ﷺ, ka thënë:

"Bëj një jetë aq të drejtë, saqë sa të jesh gjallë, njerëzit të të kërkojnë, e pas vdekjes tënde t'i marrë malli për ty!.."

Të fitosh prej besimtarëve një dëshmi si "njeri i mirë", është një lumturi e madhe në ditën e gjykimit.

Sadi Shirazi thotë:

"Jeto një jetë plot me mirësi që kur të vdesësh, njerëzit të përkujtojnë me mëshirë duke thënë: "Një diell perëndoi, një yll u shua..." Mundohu të lësh pas ca fjalë të urta, një brez të mirë dhe një jehonë të këndshme.

Lum për ata që kthehen tek Allahu para vdekjes!

Lum për ata që jetojnë një jetë plot devotshmëri, me moral të lartë, dhe me zemrën të mbushur dhe zbukuruar me besim!

Lum për njerëzit e mirë që kur të largohen, do të lenë një emër të mirë me plot vepra të mira!